

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I FILOLOGJISË
dhe
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË**

**SEMINARI XLI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË
DHE KULTURËN SHQIPTARE**

**THE XLI INTERNATIONAL SEMINAR ON ALBANIAN
LANGUAGE, LITERATURE AND CULTURE**

REVISTË / JOURNAL

41

ISSN 2521-3687

**Materialet e punimeve të Seminarit XLI Ndërkombëtar për
Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare**

Prishtinë, 14-25 gusht, 2023

Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë

SEMINARI XLI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE
KULTURËN SHQIPTARE
Prishtinë, 14 – 25 gusht, 2023

Kryeredaktor: Bardh Rugova

Redaksia: Bardh Rugova (Prishtinë), Anton Berishaj(Prishtinë),
Teuta Abrashi (Prishtinë), Abdulla Rexhepi (Prishtinë),
Shpëtim Elezi (Prishtinë), Zahrije Kapllanaj (Prishtinë),
Remzije Shahini-Hoxhaj (Prishtinë)

Drejtor: Bardh Rugova

Bashkëdrejtor: Shezai Rrokaj

Sekretar: Abdulla Rexhepi

Bashkësekretare: Laura Smaqi

Sekretarë profesionalë: Jeta Abazi-Gashi & Liridona Bërkolli

Drejtor nderi: akademik Idriz Ajeti

Përgjegjës i kurseve të gjuhës: Shpëtim Elezi

Redaktor teknik: Nuhi Simnica

Botues: Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë

ISSN 2521-3687

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	3
GJUHËSI	7
Ranko MATASOVIĆ IMAGINING ‘ILLYRIAN’	9
Stefano CANALIS THE ROLE OF QUANTITY AND EPENTHESIS IN ALBANIAN WORD STRESS	21
Shezai RROKAJ SHQIPJA POTENCIALISHT OSE REALISHT GJUHË NË RREZIK (GJNR): RASTI I BULLGARISË, RUMANISË, TURQISË DHE UKRAINËS.....	31
Yll RUGOVA ALFABETI I KODIKUT TË BERATIT, NDËRLIDHJA E MUNDSHME ME GRAVURËN E ARDENICËS DHE ANONIMIN E ELBASANIT	47
Adelajda BAFTIU DIZAJNI I KORPUSIT TË FOLUR NË KOSOVË	69
Bahri KOSKOVIKU KONCEPTI ‘GJYMTYRË TË DYTA TË FJALISË’ DHE PËRKUFIZIMI I TYRE NË GRAMATIKAT SHQIPE.....	83
Flamur SHALA PASKAJORJA E TIPIT “ME PUNUE” DHE LIDHORJA “TË PUNOJ” - PREJARDHJA, NGJASHMËRITË DHE DALLIMET	97
Isa SULÇEVSI DIMENSIONI SINTAKSOR I KONTAKTEVE TË TURQISHTES ME SHQIPEN	111
Hana RADONIÇI THEKSI I SHQIPES DHE VARIACIONET GJEOGRAFIKE	121
Qëndresa JAKUPI TOPIKË DHE FOKUS, DY KONCEPTE “TË PANJOHURA” PËR GRAMATIKAT E SHQIPES (KODIMI I TYRE NË GJUHËN SHQIPE).....	137
Mensur VOKRRI RRJEDHORJA E SHQUAR SHUMËS NË SHQIPEN E MESHARIT TË BUZUKUT.....	151
Rijetë SIMITÇIU-TURHANOĞLU RREZIKU I SHQIPES NDËR SHEKUJ (XVI-XIX)	167

Festime MEHDIU	
ANGLICIZMAT NË GJUHËN SHQIPE – RAST STUDIMI LIGJI	
PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	181
Vaide KQIKU-HOXHA	
NDËRRIMI I PARADIGMËS SË EMRAVE PERSONALË	
TË SHQIPTARËVE NË KOSOVË.....	195
LETËRSI	207
Lumnije JUSUFI	
EQREM BASHA DHE “VARRË” SI ZË I FUQISHËM	
KUNDËR NDARJEVE DHE KUFIJVE	209
Blerina SUTA	
MES INTRAKULTURALIZMIT DHE INTERKULTURALIZMIT,	
PËR NJË POETIKË KRAHASIMTARE NË STUDIMET SHQIPE ...	221
Edlira MACAJ	
NË POETIKËN MJEDJANE.....	237
Evalda PACI	
KULTURA EVROPIANE E LËVRIMIT LIBROR SI NJË ASPEKT	
FORMËSIMI NË VEPRAT E LETËRSISË SË VJETËR SHQIPE	257
Ermir XHINDI	
OBJEKTE TË KOMPETENCËS NDËRKULTURORE	
DHE PRAGMATIKA E RE E LEXIMIT: “AUTOMOBILI”	
NË LETËRSINË SHQIPE	269
Marius DOBRESU	
LETËRSIA SHQIPE E PËRKTHYER NË RUMANI NË	
GJYSËMSHEKULLIN E FUNDIT	279
Jorida SOTIRI	
KOLIQLI, KOZMOPOLIT I DIJES INTERKULTURORE,	
NË KËRKIM TË QYTETËRIMIT.....	283
Leonora HAJRA	
NDËRVEPRIMET KULTURORE ORIENTALE NË ROMANIN	
E TEKI DERVISHIT, BEQIR MUSLIUT DHE MUSA RAMADANIT	
(“HEREZIA E DERVISH MALLUTËS”, “VEGULLIA”	
DHE “ANTIPROCESIONI”	293
Veron DOBROSHI	
SHKRIRJA KULTURORE NË VARGJE: PASQYRIMI I	
INTERKULTURALIZMIT NË POEZINË E XHEVDET BAJRAJT ...	303
Neli NAÇO	
PËR NJË RITIPOLOGJIZIM TË RRËFIMEVE	
TË MITRUSH KUTELIT	311

Erenestina GJERGJI (HALILI), Kastriot GJIKA DRAMA DHE TEATRI - URA INTERKULTURALE E GJINIVE LETRARE, ARTIT DHE KULTURËS	321
Arta SULA LETËRSIA KLASIKE <i>NUTRIMENTUM SPIRITUS</i> I LETËRSISË SHQIPTARE NDËR SHEKUJ	333
Esma DODAJ KULTURA DHE IDENTITETI NË ROMANIN “LA MANO CHE NON MORDI” TË ORNELA VORPSIT, NJË PËRVOJË ÇORIENTIMI DHE TRANSFORMIMI PREJ (RI)KTHIMIT NË (RI)ZBULIM.....	343
Vebi BEHXHETI ASPEKTE INTERKULTURORE SHQIPTARE NË VARGJET POETIKE TË PËRMBLEDHJES “TRIMDITA”, TË ZEF SKIRO DI MAXHOS	357
Mimoza HASANI PLLANA LETËRSIA SHQIPE NË GJUHËT BALLKANIKE	373
Eraldo HATIJA VËZHGIME MBI SHFAQJEN E INTERKULTURALITETIT NË ROMANET E ISMAIL KADARESE “DIMRI I VETMISË SË MADHE” DHE “KONCERT NË FUND TË DIMRIT”	383
Loreta LOLI <i>LES LETTRES ALBANAISES</i> – REVISTA QË PËRÇOI LETËRSINË SHQIPE NË KULTURËN FRANKOFONE GJATË VITEVE 1970-1990	391
KULTURË dhe HISTORI.....	399
Nikollë LOKA LËVIZJET KONKURUESE NACIONALISTE DHE PËRPPJEKJET PËR HAPJEN E SHKOLLAVE SHQIPE NË MAQEDONI.....	401
Butrint BALAJ PEIZAZHE GJUHËSORE NË PRIZREN	417
Dhurata LAMÇJA SFIDA TË MËSIMDHËNIES SË LËNDËVE GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI NË KLASAT E ARSIMIT TË MESËMTË LARTË ..	435
Blerta ALIU IMAZHI I GRUAS NË TEKSTET E MUZIKËS SË POPULLARIZUAR SHQIPE	447
Iljaz REXHA SHTRIRJA E VENDBANIMEVE MESJETARE MBI BAZEN E TOPONIMIT <i>BARD BARL-BARZ</i> BRENDA DHE JASHTË AREALIT TË DARDANISË	463

GJUHËSI

Ranko MATASOVIĆ

IMAGINING ‘ILLYRIAN’

1. Introduction: “Can you translate my dialogues is into Illyrian”?

In the spring of 2017 I was contacted by Simon Bogojević Narath, a Croatian director and writer, who was working on a very interesting project – a film set in the first century B. C. in what is today Dalmatia, a coastal province of Croatia. The film’s title was to be *Illyricum*, and Simon wanted the characters to speak the languages current at the time of the action, which meant that the Romans would speak Latin, and the non-Romanized natives of the land would speak “Illyrian”. Simon asked me whether I could translate the dialogues spoken by the non-Roman characters into “Illyrian”, to which I flatly answered ‘No’, because too little is known about the pre-Roman language and/or languages spoken in the Roman province of Illyricum. Since we do not have any pre-Roman (i.e. non-Latin) inscriptions from Illyricum, we know virtually nothing about the grammar, and very little about the lexicon of the language(s) of its inhabitants, and therefore it is impossible to translate any text into “Illyrian”. As I said to Simon then, it is unclear even if “Illyrians” (I will use this name to refer to the pre-Roman inhabitants of Illyricum) spoke a single language, or a group of languages that were more or less genetically related.

After hearing my rebuff, Simon then asked me whether I could reconstruct Illyrian for the purpose of his film. Simon knew that, in principle, linguists can reconstruct dead languages by comparing their descendants, as when Slavic scholars reconstruct Proto-Slavic (the common ancestor of Russian, Polish, Croatian, etc.), or Proto-Indo-European, on the basis of lexica and grammars of its descendants, which include Latin, Greek, San-

skrit, Albanian and the Slavic languages (among others). The problem with “Illyrian”, I said, is that it may have only one attested descendant, namely Albanian, which almost certainly developed from one of the pre-Roman languages of Illyricum. Hence, the comparative method cannot be used to reconstruct Illyrian, but we could make a reasonable guess that at least some Illyrians spoke a language that was close to Proto-Albanian, the ancestor of Modern Albanian.

Simon then asked me, “Can you do that, can you make a reasonable guess about how Illyrian might have sounded like and create that language for my film?” I agreed, because I found that task challenging and interesting, creative but not wholly separated from the exigencies of scientific rigor – since I wanted to create an artificial, imagined idiom that sounded like a real language, not some unnatural gibberish. Moreover, I wanted to create a language that would be at least similar to what “Illyrian” might have been like. But I made it clear to Simon that my contribution to his film will owe more to artistic imagination than to scientific method, and that my “Illyrian” would be created, not discovered or reconstructed.

In this paper, I will first show how little we know about the Pre-Roman language(s) of Illyricum. Then I will explain what one of those languages might have been like, in terms of phonology, grammar and vocabulary, and in the final paragraph I will present the basics of the structure of “Illyrian”, the language purposefully created for Simon Bogojević Narath’s film *Illyricum*, which was released in late 2022 and received very favourable reviews.

2. Who were the ‘Illyrians’ and what language(s) did they speak?

First of all, there are very few reasons to believe that the whole eastern coast of the Adriatic and its interior, from the river Arsia in Histria to Epirus in northern Greece, was inhabited by a population which in pre-Roman times spoke a single language that might be called “Illyrian”. If one looks across the Adriatic to Italy, one will find that dozens of languages were spoken there before Romanization: some were Italic, like Latin’s close relative Faliscan and the more distant relatives like Umbrian and Oscan, some were

Indo-European, but not Italic (like Messapian, Gaulish and Ligurian), and some were non-Indo-European, like Etruscan and, very probably, North Picene (Matasović 2010). It is *a priori* probable that the linguistic diversity in pre-Roman Illyricum was not much more limited, although there is little evidence for linguistic remains of non-Indo-European languages on the eastern coast of the Adriatic. Nearly all the onomastic evidence found there *can* be interpreted as belonging to Indo-European languages (although there is no definite proof that this was indeed so, and speakers of non-Indo-European idioms *could* have been present in Illyricum until the Romanization). Be that as it may, in the earliest Greek texts that mentions the *Illyrioi*, they are a political entity rather than a loose ethnic designation (Wilkes 1992). They are usually mentioned as enemies of the Macedonians, e.g. in the campaign of Perdiccas in 423 B.C.; (Thucydides, 4. 124-5). They appear as the northern neighbours of Macedonia, and their initial domain is in the interior of present-day Albania, Kosovo and Montenegro. Later, the *Illyricum Regnum* expands to the Adriatic coast (Stipčević 1989). The tribes of *Liburni* (from Raša to Zrmanja) and *Delmatae* (who appear in the 2nd century B.C. from Zrmanja to Cetina on the coast) were originally not considered Illyrians (e. g. by Pliny the Elder). However, in later Roman sources, the term *Illyrii* spreads to the whole Roman province of *Illyricum* (to the river *Arsia* > *Raša* in Istria).

Later Roman authors reserve the term *Illyrii proprie dicti* (in contrast to the inhabitants of the province Illyricum) for “original” Illyrians, the inhabitants of the *Regnum Illyricum* with which they waged wars in the 3rd and 2nd centuries B. C. For Pliny (*Nat. Hist.* 3.144), they inhabited the coast from *Lissus* (Lesh in Albania) to *Epidaurum* (Cavtat in Croatia). By the time of Diocletian, Illyricum was a huge province (prefecture) stretching from Austria to Greece, much beyond the original ethnic territory of the Illyrians.

The Roman authors never imply that all of the (aboriginal) inhabitants of Illyricum spoke the same language. One of these languages (or dialects) is probably the ancestor of Albanian (indeed, one tribe in Northern Albania or Kosovo is called *Albanoi* in Greek sources).

The pre-history of Albanian lexicon and grammar can be partly reconstructed by studying loanwords (from Slavic, Latin and Greek) and by the methods of comparative grammar (Beekes 1995, Matasović 2012). For

example, if we know that Latin *imperatōrem* yielded Albanian *mbret*, if Latin *amīcum* ‘friend’ yielded Albanian *mik*, while *sanitātem* ‘health’ yielded Albanian *shëndoshë*, we can see not just that the language underwent many complex sound changes, but we can also deduce some of them, such as the apocope of final syllables (as well as the loss of certain initial and middle syllables), the change of initial *s-* to *sh-*, the loss of the distinction between short and long vowels, etc. If we apply such changes reversely to Albanian words that were inherited from Proto-Indo-European, we can deduce how they may have sounded before those changes took place, i. e. before the contact between the speakers of Proto-Albanian and the Romans.

3. How ‘Illyrian’ might have sounded?

Of all the languages spoken in pre-Roman Illyricum only one developed into a language still spoken today, and that is Albanian. From this it follows that at least one language spoken in Illyricum sounded like Proto-Albanian, which means that we can model our “Illyrian” on Proto-Albanian. Therefore, the language I created for the film “Illyricum” was intended to be similar to Proto-Albanian, but not identical to it, for the following two reasons: firstly, because I am not such an expert on Albanian historical grammar as to be able to reconstruct Proto-Albanian precisely (and it is unclear if such a precise reconstruction is at present attainable by the comparative method) and, secondly, because the language of the tribe of Liburni in the film was probably not the direct ancestor of Albanian, but rather a language or a dialect closely related to it. That the tribe of Liburni is the tribe of the majority of native characters in the film is clear from several details: for example, the Liburnian goddess *Anzotica* is invoked, and the main character, *Volsus*, has a typical Liburnian name; furthermore, one of the placenames mentioned is *Senia* > Croat. *Senj* in historical Liburnia. The film takes place in 37 B.C., when the interior of present-day Croatia that had been inhabited by the Liburni was not yet fully conquered, so the director’s assumption that the natives would still have spoken “Illyrian” is wholly reasonable.

Virtually no original words belonging to the languages spoken in Pre-Roman Illyricum have come down to us. Greek and Roman authors were not at all interested in the languages of the barbarians, so they did not bother

to write their grammars or dictionaries. However, certain features of the language(s) of Illyricum can be deduced from Pre-Roman and pre-Greek place-names preserved from the Antiquity. For example, the name *Birziminium* (a hillock near Podgorica in present-day Montenegro) is plausibly derived from the Proto-Indo-European root **bherg'h-* 'high', (cf. Sanskrit *br̥hat-*, German *Berg* 'hill'); similarly, the place-name *Asamum*, identified with medieval *Lapida* > *Lapad* (Croatian peninsula in Dubrovnik), can be from Proto-Indo-European **h₂ek'mon-* 'stone' (cf. Sanskrit *aśman-*, Lithuanian *akmuo*). This etymology looks particularly plausible, since the Medieval Latin name *Lapida* is probably just a loan translation of the native name *Asamum*. Such etymologies show that at least part of the "Illyrian complex" showed *satem*-reflexes of PIE palatals (**k'*, **g'* and **g'h*), which means that such sounds became fricatives or affricates, as e. g. in Slavic, Albanian and Sanskrit, but unlike in *centum*-languages such as Latin or Greek (Beekes 1995: 127ff.). However, there are few reliable etymologies of pre-Roman place-names, and it may well be that PIE palatals had *centum*-like reflexes in idioms spoken in different, more northern parts of Illyricum (cf., e. g., the personal name *Vescleves* in the Liburnian territory, compared to Sanskrit *Vasu-śravas-* 'of good fame', where the second element of the compound contains *-c-* as the reflex of the PIE palatal **k'*).

Another important source of knowledge about the pre-Roman languages of Illyricum are personal names found on Greek and Latin inscriptions on the East Adriatic coast and in its interior (Rendić Miočević 1989). Such names are usually preserved in funerary inscriptions in Latin (less often in Greek), but they are neither Roman nor Greek, which means they must belong to the onomastic system of the indigenous population (i. e. to the "Illyrians"). Radoslav Katičić, who examined the Pre-Greek and pre-Roman personal names of Illyricum discovered that three onomastic areas in the province could be distinguished (Katičić 1976):

- (1) "North Adriatic" (corresponding to Liburnian area): Volsus, Aplus, Ceunus, Vescleves, Aetor...
- (2) "Central Adriatic" (partially corresponding to the area of the tribe Delmati in central Dalmatia): Aplis, Baezus, Scenobarbus, Beuzas, Vendo...

- (3) "South Adriatic" (corresponding to the area of *Illyrii proprie dicti*):
Bardylis, Gentius, Verzo, Teutana...

It is impossible to say whether these onomastic areas correspond to different languages or dialects spoken in pre-Roman Illyricum or not. Sometimes, different onomastic systems can be the result of religious, or cultural differences: for example, the systematic onomastic differences in the Central South Slavic dialect continuum tend to reflect the religious differences between the Catholics, Muslims and Orthodox Christians, rather than differences of language. However, it is reasonable to assume that the neat geographical distribution of the different onomastic systems discovered by Katičić at least partly testifies to the linguistic diversity of Illyricum.

4. How I imagined “Illyrian”?

In deciding how to shape the phonology, lexicon and grammar of “Illyrian” for the film “Illyricum” I decided to follow a few simple rules, which followed from both theoretical and practical considerations:

- (1) The language had to be phonologically simple, which means that it should not have many consonants (especially not ones that are rare or non-existent in European languages, such as glottalics or implosives), it should have a simple vowel system and predictable accentuation. I knew that the actors in the film would be Croats and Albanians from Kosovo, so I decided that the language would have only the vowels and consonants that exist in both Croatian and Albanian (with the exception of /dz/, which is a consonant cluster in Croatian, but a single affricate consonant in Albanian (spelled <x>)). This was necessary to make it easier for the actors to pronounce the “Illyrian” words.
- (2) Since I wanted to make “Illyrian” similar to the ancestor of Albanian, it shares several early sound changes with Proto-Albanian (for those, see Matasović 2012): for example PIE aspirated stops are reflected as “Illyrian” voiced stops (e. g. **bh* > *b*, **dh* > *d*, etc.), PIE **o* changed to *a*, PIE palatals changed to fricatives (e. g. PIE **gʰ* changed to “Illyrian” *dz* (rather than Alb. *dh*), **kʰ* > *ts* (rather than Alb. *th*), etc.).

- (3) I constructed the grammar of “Illyrian” as a “simplified Proto-Indo-European” with some features of Proto-Albanian. Most Indo-Europeanists will recognize the case endings and verbal endings of “Illyrian” as similar to those that are reconstructed for Proto-Indo-European (see Beekes 1995), and most of the grammatical morphemes posited for “Illyrian” were at least possible in a language closely related to Proto-Albanian (Matasović 2012). A few “Illyrian” paradigms will be illustrated below.
- (4) The lexicon of “Illyrian” draws heavily (but not exclusively) on Albanian inherited lexicon. I hoped that speakers of contemporary Albanian would be able to recognize the roots of at least some “Illyrian” words and feel that they are somehow close to the words of their own language. However, some technical terms of “Illyrian” are borrowed from Latin (e.g. *stipendium* ‘salary’). I assumed that there would have been some Latin loanwords in “Illyrian” for words denoting elements of Roman culture and technology, since this type of lexical borrowing is usual in similar contact situations.

Here are some examples of “Illyrian” words actually used in the dialogues of “Illyricum” with their equivalents in contemporary Albanian:

- neris* ‘man’ (Alb. *njeri*) < PIE **h₂ner-* (cf. Gr. *anēr*);
bilia ‘daughter’ (Alb. *bijë*) < PIE **dheh₁i-* (cf. Lat. *fīlia*);
udnijan ‘water’ (Alb. *ujë*) < PIE **wodn-/*udn-* (cf. Skt. *udán* ‘in water’);
ulkas ‘wolf’ (Alb. *ujk*) < PIE **wlk^wos* (cf. Gr. *lýkos*, Lith. *vilkas*);
tsi ‘eye’ (Alb. *sy*) < PIE **h₃k^wo-* (cf. Croat. *oko*, Lat. *oculus*);
dzeja ‘earth’ (Alb. *dhe*) < PIE **g^hdhem-* (cf. Croat. *zemlja*, Lat. *humus*);
gnā ‘woman’ (Alb. *grua*) < PIE **g^hneh₂-* (cf. Croat. *žena*, Goth. *qino*)
en ‘in’ (Alb. *në*) < PIE **en(i)* (cf. Lat. *in*);
sakan ‘blood’ (Alb. *gjak*) < PIE **h₃sok-n-* (cf. Lat. *sanguis*);
emen ‘name’ (Alb. *emër*) < PIE **h₃nomn* (cf. Lat. *nōmen*, Gr. *ónoma*);
ugnas ‘I’ (Alb. *unë*) < PIE **eg^hh₁V-n-* (cf. Lat. *ego*)

In some cases, “Illyrian” has words that are not similar to Albanian reflexes of PIE words, because Albanian did not preserve the PIE lexeme:

brater ‘brother’ < PIE **bhreh₂tēr* (cf. Lat. *frāter*, Croat. *brat*; Alb. *vëlla* ‘brother’ does not have a clear etymology);

tuta ‘army’ < PIE **tewteh₂* (Lith. *tauta* ‘people’; the same root is probably attested in the name of the Illyrian queen *Teuta*. The Albanian word for ‘army’, Alb. *ushtri*, was borrowed from Lat. *exercitus*).

Finally, as mentioned earlier, I assumed that already in the 1st century B. C. there would have been some “Illyrian” words borrowed from Latin and, less often, Greek. Here are three such examples:

mahra ‘sword’ was assumed to be borrowed from Gr. *makhaira* (Alb. *shpatë* is borrowed from Lat. *spatha*);

kausa ‘problem’ from Lat. *causa* (the Albanian word is *problem*, borrowed from modern European languages (ultimately from Greek), while the reflex of Lat. *causa* is *kafshë*, which means ‘thing’, just like the Romance reflexes of *causa*, e. g. Italian *cosa*, French *chose*);

testa ‘pot’ from Lat. *testa* (Alb. *tenxhere* is borrowed from Turkish *tencere* and, of course, Turkish loanwords were impossible in “Illyrian”).

As mentioned above, the phonological system of “Illyrian” is rather simple, as a courtesy to actors who had to learn to pronounce the words in an artificial, invented language. The vowels are essentially those that are found in Croatian (with a contrast in vowel length); Albanian has more vowels, but all of them have their equivalents in “Illyrian”:

i	u	i:	u:
e	o	e:	o:
a		a:	

The consonant system of “Illyrian” is much simpler than the systems of Albanian and Croatian; there is a voicing contrast in stops, fricatives and affricates, as well as a very simple set of resonants and glides:

stops:	fricatives and affricates:				
p	t	k	s	ts	h
b	d	g	dz		
resonants and glides:					
m	n	l	r	j	v

The accent is always on the penultimate syllable. This made it easy for the authors to learn how to pronounce the “Illyrian” words, but it is worth noting that at some stage in Proto-Albanian (before the apocope of the final syllables) the position of the accent was also on the penultimate syllable.

Illyrian morphology is simplified Proto-Indo-European, reflecting some sound changes and forms that can be assumed for Proto-Albanian. I took great care to make the use of the grammatical forms consistent in all of the dialogues in the film, so that the same form is always used in the same function, as it would have been in a real human language. The noun has five cases (Nominative, Accusative, Genitive, Dative/Locative and Ablative), three genders (masculine, feminine and neuter, as in Old Albanian), and two numbers (singular and plural). Here is a sample paradigm of the “Illyrian” noun *ulkas* ‘wolf’:

<i>Singular</i>	<i>Plural:</i>
Nom. <i>ulkas</i>	<i>ulkaj</i>
Acc. <i>ulkan</i>	<i>ulkōs</i>
Gen. <i>ulkās</i>	<i>ulkōn</i>
Dat./L <i>ulkaj</i>	<i>ulkavis</i>
Abl. <i>ulkā</i>	<i>ulkavis</i>

The verbal morphology is also rather simple: there are three synthetic tenses (present, imperfect and aorist), and the imperfect and aorist share the same set of personal endings (as they did in PIE). Imperfect is formed by adding the suffix *-va-* to the root. The future is formed periphrastically, with the auxiliary *bu-* ‘to be’ and the infinitive (in *-ani*). This is, of course, different from the future formation in Albanian, but, while Standard Albanian has no infinitive, Proto-Albanian certainly did, since the infinitive still exists in Gheg dialects. “Illyrian” also has three grammatical moods: the indicative, the imperative and the optative. The optative has the suffixes *-ais-* and *-sja-*, and the imperative is formed by adding *-e* (2sg.) *-te* (2pl.) to the verbal root.

While the verbal systems of PIE and Proto-Albanian were certainly much more complicated than the verbal system of my “Illyrian”, I thought that this would not present a problem to the majority of audiences (who are not experts in comparative-historical linguistics), and a simpler system

would certainly be helpful to the actors who had to learn the dialogues. Here is a sample of the verbal endings of “Illyrian”.

Present:	Imperfect, Aorist:
1 sg. <i>-u, -mi</i>	<i>-m</i>
2 sg. <i>-si</i>	<i>-s</i>
3 sg. <i>-ti</i>	<i>-t</i>
1 pl. <i>-meni</i>	<i>-me</i>
2 pl. <i>-teni</i>	<i>-te</i>
3 pl. <i>-nti</i>	<i>-n</i>

The syntax of “Illyrian” is rudimentary. The basic word order is Subject-Verb-Object or Subject-Object-Verb (SVO/SOV), the adjectives and pronouns precede the nouns they modify, and the language has prepositions (like Albanian, but unlike PIE, which probably had postpositions). The passive is formed with the auxiliary *bu-* ‘be’ and the actor argument of a passive sentence is in the Ablative case.

To illustrate the structure of “Illyrian” sentences, we can give two examples from the actual dialogues in the film:

Volsas apa nenās dzenesas Aruntijās gratōs tevi adzeti per udnijan
 V. from mother.Gsg clan A. thanks 2sg.dat gives for water
 “Volsus, from the mother's clan of Aruntia, thank you for water”

Avinas bus manā gentas
 ram will.be 1sg.Abl slain.pple
 “The ram will be slain by me”

5. Conclusion: was the effort worth it?

I was not present at the set of “Illyricum” and did not work with the actors myself, which means that they had to learn “Illyrian” on their own. However, the director asked me to record the dialogues for him on a digital sound recorder and pronounce the “Illyrian” words as I would like them to be pronounced. The actors then listened to the recording, which hopefully helped them in their pronunciation of the dialogues.

When I saw the film “Illyricum” on its premiere in Zagreb, in November 2022, I was very satisfied with the result. I must admit that, to my surprise,

the actors sounded very natural while uttering the dialogues in “Illyrian”, and I believe that the audiences also liked the effect produced by having the actors speak the language that had certainly never existed in the form that I created. However, I cannot exclude the possibility that, if any Illyrian had the opportunity to see the film, he or she would have been able to understand at least a few words of the language. I also hope that they would have liked the film, as I certainly did.

References:

- Anamali, Skënder. 2011. “Varreza e hershme mesjetare pranë Kalasë së Dalmacës, Koman (kërkime, probleme, rezultate)”, *Iliria* 35, 2011: 39-54.
- Beekes, Robert S. P. 1995. *Comparative Indo-European Linguistics*. Amsterdam/Atlanta: Rodopi.
- Katičić, Radoslav. 1976. *Ancient Languages of the Balkans*. The Hague: Mouton.
- Krahe, Hans. 1928. “Eine balkanillyrische Inschrift”, *Indogermanische Forschungen* 46: 23-48.
- Matasović, Ranko. 2010. *Kratka poredbenopovijesna gramatika latinskoga jezika*. Zagreb: Matica hrvatska [translated into Albanian as *Gramatikë e shkurtër historike krahasuese e gjuhës latine*. Përktheu nga gjuha kroate: Halim Haziraj. Prizren: Pena, 2017]
- Matasović, Ranko. 2012. *A Grammatical Sketch of Albanian for Students of Indo-European*. <http://www.ffzg.hr/~rmatasov>.
- Mayer, Anton. 1957. *Die Sprache der alten Illyrier*. Vienna: Österreichische Akademie der Wissenschaften.
- Rendić Miočević, Duje 1989. *Iliri i antički svijet*. Split: Književni krug.
- Stipčević, Aleksandar. 1989. *Iliri*. Zagreb: Školska knjiga.
- Wilkes, John. 1992. *The Illyrians*. Oxford: Blackwell Publishers.

Abbreviations:

Alb. = Albanian, Croat. = Croatian, Goth. = Gothic, Gr. = Greek, Lat. = Latin, Lith. = Lithuanian, PIE = Proto-Indo-European, Skt. = Sanskrit.

Stefano CANALIS

THE ROLE OF QUANTITY AND EPENTHESIS IN ALBANIAN WORD STRESS

1. Introduction

This paper discusses some aspects of Albanian word stress. Section 2 presents an account of word stress assignment in Albanian, while section 3 discusses some words that at first glance seem to contradict the generalization proposed in section 2, with a focus on a) stem-final stressed vowels, and b) unstressed syllables containing the sequences *-ull* and *-ur*, which will be argued to have an epenthetic vowel invisible to stress assignment.

2. Stress assignment in Albanian

In this section I will put forward an account of word stress assignment in Albanian, largely based on Canalis (2007), which aims to show that a) the domain of stress assignment is usually the stem, b) Albanian stress is quantity-sensitive, syllables that have either a long vowel or a coda being heavy, c) Albanian word stress is right-aligned and feet in Albanian are trochees: within a stem, stress falls on the syllable containing the penultimate mora.

2.1. Domain of stress

In Albanian, stress position is highly variable within words and apparently unpredictable. For instance, four-syllable words containing only open syllables can have stress on the first, second, third or fourth syllable (1).

- (1) *kúmbull-ave* ‘plum-dat.plur’
liqén-eve ‘lake-dat.plur’
fonetíkë ‘phonetics’
qytet-ar-í ‘citizenship’

However, this ostensible variability is largely epiphenomenal, as it depends to a large extent on the type of morpheme following the root. Some morphemes to the right of lexical roots are invisible to the stress assignment rule; they can never be stressed, and in no way affect stress position on previous syllables. In metrical phonology parlance, these morphemes exhibit the property of extrametricality: “[stress] rules analyze the form as if the extrametrical entity were not there” (Hayes 1995: 57). Typologically, extrametrical units are usually word-initial or word-final phonological elements (syllables, feet, consonants and so on), but extrametricality of morphological elements is not unheard of. For instance, in Isbukun Bunun (an Austronesian language spoken in Taiwan) inflectional suffixes are regularly extrametrical (Ouyang 2012), much like in Albanian.

Whether a morpheme is extrametrical or not in Albanian largely (although not entirely) depends on its morphological type. Lexical roots and most derivational morphemes are visible to stress assignment rules; on the contrary, clitics and most inflectional morphemes are extrametrical. There are only a few exceptions to these two generalizations. Some derivational morphemes (all creating adverbs: *-azi*, *-as*, *-thi*) cannot carry stress, and thus will be considered extrametrical. Conversely, some irregular plurals of nouns and adjectives show stress on the plural suffix (2).

(2)	<i>babá</i>	‘father’	<i>baballárë</i>	‘fathers’
	<i>lúmë</i>	‘river’	<i>luménj</i>	‘rivers’
	<i>i mádh</i>	‘big’	<i>të mëdhénj</i>	‘big-PL’

These exceptions aside, since roots and derivational morphemes are usually visible to stress assignment while inflectional morphemes are usually extrametrical, in the overwhelming majority of words the stress domain is the stem (a root plus any derivational morphemes). Therefore, for the sake of brevity I will hereafter call the stress domain in the examples below ‘stem’, even if it should be kept in mind that occasionally it may not be coextensive with a stem.

A consequence of the metrical invisibility of nearly all inflectional suffix is the ‘columnar’ nature of Albanian stress: stress falls on the same syllable

across the whole paradigm of a word (the paradigm of *liqén* ‘lake’ is shown in (3)).

(3)		Indefinite	Definite		
		Singular	Plural	Singular	Plural
	Nominative	<i>liqén</i>	<i>liqén-e</i>	<i>liqén-i</i>	<i>liqén-et</i>
	Accusative	<i>liqén</i>	<i>liqén-e</i>	<i>liqén-in</i>	<i>liqén-et</i>
	Dative		<i>liqén-i</i>	<i>liqén-eve</i>	<i>liqén-it</i> <i>liqén-evet</i>
	Ablative	<i>liqén-i</i>	<i>liqén-esh</i>	<i>liqén-it</i>	<i>liqén-evet</i>

Another consequence is that, far for being highly variable, stress position *within the stem* is very restricted: it is either on the final or the penultimate syllable, as the examples in (1), reproduced in (4) below adding angle brackets to mark extrametrical morphemes, show.

(4)	<i>kúmbull</i> <-ave>	‘plum-DAT.PLUR’
	<i>liqén</i> <-eve>	‘lake-DAT.PLUR’
	<i>fonetikë</i>	‘phonetics’
	<i>qytet-ar-í</i>	‘citizenship’

2.2. Quantity

The recognition that whatever follows the stem is ignored by stress assignment principles greatly simplifies the description of Albanian stress. However, it still leaves open the question whether stem-final and stem-penultimate stress are assigned by rule or are lexical. In the latter case, stress position within the stem would be unpredictable and minimal pairs would be possible. In the former case, stress position would be predictable from the phonological environment.

I will argue that stress position within stems is determined by syllable quantity. More specifically, if the final syllable of a stem is closed, it is stressed (5).

(5)	<i>endacák</i>	‘wanderer’
	<i>dembél</i>	‘lazy’
	<i>rrogóz</i>	‘mat’
	<i>bilbíl</i>	‘nightingale’
	<i>qytet-ár</i>	‘citizen’
	<i>pamúk</i>	‘cotton’
	<i>flamúr</i>	‘flag’

If the final syllable of a stem contains a diphthong, it is stressed (6).

(6) <i>gatúaj</i>	‘I prepare’
<i>pallúa</i>	‘peacock’
<i>arsýe</i>	‘reason’

In varieties of Albanian with a vowel length contrast (most Gheg dialects, for instance), if the final syllable of a stem contains a long vowel, it is stressed (7). Albanian varieties without a vowel length contrast generally have stress on the same syllable.

(7) <i>shtëpí</i>	‘house’
<i>barí</i>	‘sheperd’
<i>vëllá</i>	‘brother’
<i>apó</i>	‘or’
<i>ashtú</i>	‘so’
<i>atý</i>	‘there’
<i>tashmë</i>	‘already’

Otherwise, stress is on the penultimate syllable of the stem (8).

(8) <i>púnë</i>	‘work’
<i>lúle</i>	‘flower’
<i>rádio</i>	‘radio’
<i>bórë</i>	‘snow’
<i>yndýrë</i>	‘fat’
<i>anembánë</i>	‘everywhere’
<i>prápa</i>	‘behind’
<i>brénda</i>	‘inside’
<i>cíli</i>	‘who, which’
<i>gáti</i>	‘almost’

Taken together, these facts strongly suggest that Albanian stress is sensitive to syllable quantity; stress is right-aligned (in words such as *fonetíkë*, *qytet-ar-í* or *anembánë* stress is confined to one of the last two syllables), but it falls on the very last syllable of the stem only if that syllable is closed and/or contains a long vowel, that is, is ‘heavy’ or bimoraic. Otherwise, the penultimate syllable of the stem receives stress. Thus, stress assignment in Albanian can be formulated as in (9):

(9) Within a stem, word stress falls on the syllable containing the penultimate mora

In terms of foot typology, Albanian appears to have moraic trochees (i.e., foot types $[\acute{\sigma}_{\mu\mu} \sigma_{\mu}]$, $[\acute{\sigma}_{\mu} \sigma_{\mu}]$ and $[\acute{\sigma}_{\mu\mu}]$), with word stress falling on the rightmost foot of the stem.

3. Apparent exceptions

Stated this way, Albanian stress is highly regular, its position being correctly predicted in almost every word. I will not review here other accounts of Albanian stress and their arguments (see Canalis 2007 for some discussion); I will rather confine myself to a brief examination of two classes of *prima facie* exceptions, i.e. stress on final open syllables (as in *pará* ‘money’ in varieties without long vowels) and lack of stress on final closed syllables (as in *ëndërr* ‘dream’). I will argue that neither of them is a counterexample to the generalization in (9).

3.1. Stressed stem-final short vowels

In varieties of Albanian (including the standard form) without a vowel length contrast, stem-final short vowels can be stressed. This means that minimal pairs such as *pára* ‘in front of’ vs. *pará* ‘money’ can be observed, contrary to the prediction that a stem-final short vowel in an open syllable should be unstressed.

An option to analyse this data would be to say that the generalization in (9) is fully valid only for Albanian varieties with a vowel length contrast, while it has to be relaxed in varieties without such a contrast, as their stress would partially be lexical. In these varieties the rule in (9) would still be at work in stems without underlying stress (all the stems ending in a closed syllable or a diphthong, and some stems ending in an open syllable), but some final light syllable might carry idiosyncratic, lexical stress, which would block the application of (9).

I will only sketch an alternative analysis, based on a reconsideration of the relation between vowel length and syllable quantity, that would make (9) valid to all varieties of Albanian. It is standardly assumed that the relation between length and quantity is bi-univocal: long vowels are bimoraic

and bimoraic vowels are long, while short vowels are monomoraic and monomoraic vowels are short. However, it has been argued that some languages have short yet bimoraic vowels. In his analysis of stress in Malagasy (a language without a vowel length contrast), Erwin (1996) observes that sequences of two different vowels created by morpheme concatenation become diphthongs (for example /o-a/ becomes [oa]), which the language treats as heavy with respect to stress assignment. Sequences of two identical vowels become short vowels, since Malagasy does not allow long vowels (e.g., /a-a/ becomes [a]). Nevertheless, these vowels function as heavy with respect to stress assignment, leading Erwin to conclude that they are at the same time short and bimoraic.

A similar argument could be put forward for Albanian. It might be argued that all Albanian varieties have bimoraic vowels, but some do not have long vowels. Hence, in the latter varieties words such as *pará* would have a final heavy syllable (and consequently final stress), while words such as *pára* have a final light syllable (and consequently penultimate stress). It may be worth adding that this analysis is not purely circular, merely substituting unpredictable bimoraicity for unpredictable stress. Stem-final stressed vowels select different inflectional allomorphs than those selected by stem-final consonants or unstressed vowels, both in varieties with and in varieties without phonemic long vowels. For instance, usually the formative of the definite plural morpheme ends in [t] if the stem ends in a consonant or an unstressed vowel (10a), but is the syllable [tə] immediately after a stressed vowel (10b). This phonologically conditioned allomorphy suggests that not all vowels are prosodically equal, even in varieties without phonemic length. Therefore, the final vowel in *pará* should be underlyingly different from that in *pára* even if both are phonologically short.

(10a) nominative indefinite plural	nominative definite plural	
<i>bilbil-ë</i>	<i>bilbil-ët</i>	‘nightingale’
<i>tóp-a</i>	<i>tóp-at</i>	‘ball’
<i>rádio</i>	<i>rádio-t</i>	‘radio’
<i>lúle</i>	<i>lúle-t</i>	‘flower’
<i>shkóll-a</i>	<i>shkóll-at</i>	‘school’

(10b)	<i>shamí</i>	<i>shamí-të</i>	‘handkerchief’
	<i>kalá</i>	<i>kalá-të</i>	‘castle’
	<i>byró</i>	<i>byró-të</i>	‘bureau’

3.2. Schwa and [u] in unstressed final syllables

Apparently, the generalization in (9) is violated by stems ending in unstressed *-ull*, *-ur* or *-ë* plus any consonant (11). They have penultimate stress, which is expected when the final syllable is light, despite their final syllable being (commonly assumed to be) heavy.

(11)	<i>végël</i>	‘tool’
	<i>zémër</i>	‘heart’
	<i>ëndërr</i>	‘dream’
	<i>móllëz</i>	‘cheekbone’
	<i>shékull</i>	‘century’
	<i>vétull</i>	‘eyebrow’
	<i>flútur</i>	‘butterfly’
	<i>dáshur</i>	‘lovely’

In fact, the heaviness of these syllables can be questioned. With regard to unstressed schwa, it is in several respects unlike ‘normal’ vowels. At least one work considers it to be an “intrusive vowel glide [that] always occurs before syllabic [m, n, r, rr]” (Lowman 1932: 285) in the variety of Shkodër. Furthermore, when an inflectional vowel is added to these stems (for example to create their definite form), the schwa *d* is not present:

(12)	Indefinite singular nominative	Definite singular nominative
	<i>végël</i>	<i>végl-a</i>
	<i>lákën</i>	<i>lákñ-a</i>
	<i>ëndërr</i>	<i>ëndrr-a</i>

These facts suggest that this unstressed schwa is an epenthetic vowel not present underlyingly (perhaps an ‘intrusive’ vowel (Hall 2006), i.e. the acoustic transition that may be heard between two different consonantal gestures). If the schwa-like sound in (11) is epenthetic or intrusive, these words do not have a vowel nucleus and a coda, but a syllabic consonant /m/, /n/, /r/, /r/, /z/, /l/ or /ʃ/ and no coda – hence, a final open syllable. Intrusive vowels, being a by-product of phonetic implementation rather than

phonological objects, are systematically ignored by stress assignment (and phonological processes more generally). In some languages epenthetic vowels are visible to stress, but in many others stress is assigned as if the epenthetic vowel were not there (Hall 2011).

The same reasoning can be extended to stem-final unstressed *-ull* and *-ur*. They show several parallelisms with unstressed schwas. First, in colloquial speech in many cases there is the same vowel/zero alternation: *shekull/shekulli* [ʃekuʔ]/[ʃekki] ‘century/the century’, *lepur/lepuri* [ʎepuʔ]/[ʎep̥ri] ‘hare/the hare’, and so on. It is true the standard language and the orthographic norm preserve [u] when inflectional vowels follow the stem, but in actual use it is often absent. Second, there is some amount of free variation between [ə] and [u] in this context. Different speakers pronounce the same word either with the former or the latter vowel; for instance *hisëll* ‘nettle’ is the standard (written) form, but it can be heard both as [hisəʔ] and [hisuʔ].

As for why ‘intrusive’ [u] only occurs if followed by *-ll* or *-r*, at least the connection between the lateral and the vowel is quite straightforward. The sound spelled *ll* is a velarized dental lateral [ɬ̠], and velarized consonants have an obvious affinity with back vowels. Velarized laterals essentially combine the gesture of a coronal lateral and a back semi-vowel, making a transitional vowel [u] unsurprising in this context. In fact, Albanian velarized laterals are sometimes vocalised to [u] in running speech: Coretta *et al.* (2023: 1130) report one realization of /e hoʔʃi paʔtɔn/ ‘took off his cloak’ as [e hoʔʃi pauʔn].

On the other hand, it is less obvious why the syllabic consonant spelled *-r* should cause the appearance of an intrusive [u]. It is usually described as an alveolar flap (Bevington 1974, Dodi 2004), without the velarization characterizing *-ll*. However, acoustic data in a recent description of northern Tosk Albanian show that “[the sound spelled as] <r> was characterised by a great deal of allophonic variation [...]. Among the range of realisations for <r>, we found retroflex flaps [ɾ] and retroflex approximants [ɻ]. These seem to be in complementary distribution, with [ɻ] tending to appear in coda position, although for some speakers and in some words, word-initial /r/ was also realised as a retroflex approximant [ɻ] (Coretta *et al.* 2023:1130). Connections between retroflex consonants and back vowels are well-known. Articulatorily, “in order to move the tongue tip upwards in the post-alveolar region the tongue body has to stretch and pull back, which results in a retracted tongue back” (Hamann 2003: 36). Even when realized without a

significant articulatory retraction, retroflexes share acoustic properties with back vowels, mainly a low third formant (Hamann 2003: 92). Consequently, if the final consonant in words like *lépur* or *flútur* is a retroflex, the occurrence of an intrusive [u] would not be surprising.

4. Conclusions

In spite of the complex distribution of word stress in Albanian, we argued above that, once the role of quantity and extrametricality are considered, stress position is predictable: within a stem, word stress regularly falls on the syllable containing the penultimate mora.

This preliminary conclusion suggests two directions for further research: clarifying the characteristics of syllable quantity in Albanian varieties without phonemic long vowels, and the nature of pre-consonantal [ə] and [u] in unstressed stem-final syllables. The latter problem would in all likeness benefit from the analysis of acoustic and/or articulatory phonetic data.

References:

- Bevington, Gary Lloyd. 1974. *Albanian Phonology*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz.
- Buchholz, Oda & Wilfried Fiedler. 1987. *Albanische Grammatik*. Leipzig: VEB Verlag Enzyklopädie.
- Canalis, Stefano. 2007. To what extent is Albanian word stress predictable?. In A. Bisetto & F. Barbieri (eds), *Proceedings of the XXXIII Incontro di Grammatica Generativa*. Available at http://amsacta.cib.unibo.it/archive/00002397/01/PROCEEDINGS_IGG33.pdf.
- Coretta, Stefano, Josiane Riverin-Coutlée, Enkeleida Kapia & Stephen Nichols. 2023. Tosk Albanian. *Journal of the International Phonetic Association*: 53(3): 1122-1144.
- Dodi, Anastas. 2004. *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*. Tirana: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Erwin, Sean. 1996. Quantity and moras: an amicable separation. In Matthew Pearson & Ileana Paul (eds), *The structure of Malagasy. UCLA Occasional Papers in Linguistics 17*: 2-30. University of California, Los Angeles, Department of Linguistics.
- Hall, Nancy. 2006. Cross-linguistic patterns of vowel intrusion. *Phonology* 23: 387-429.
- Hall, Nancy. 2011. Vowel epenthesis. In Marc van Oostendorp, Colin J. Ewen, Elizabeth Hume and Keren Rice (eds), *The Blackwell Companion to Phonology*: 1576-1596. Oxford: Blackwell.
- Hamann, Silke. 2003. *The Phonetics and Phonology of Retroflexes*. LOT: Utrecht.
- Hayes, Bruce. 1995. *Metrical Stress Theory: Principles and Case Studies*. Chicago: Chicago University Press.
- Lowman, Guy Sumner. 1932. The Phonetics of Albanian. *Language* 8(4): 271-293.
- Ouyang, Iris Chuoying. 2012. Stress and suffixation in Isbukun Bunun. *Coyote Papers* 20: 100-108.

Shezai RROKAJ

SHQIPJA POTENCIALISHT OSE REALISHT GJUHË NË RREZIK (GJNR): RASTI I BULLGARISË, RUMANISË, TURQISË DHE UKRAINËS

1. Hyrje

Shqiptarët janë një komb i vendosur kryesisht në Gadishullin Ballkanik: në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut. Në vijimësi territoriale trevat shqipfolëse janë në Serbi e Mal të Zi, pastaj në disa shtete të ish-Jugosllavisë si: Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë e Slloveni. Në një shtrirje më të gjerë se këto treva areali shqipfolës gjendet në shtete, si: Rumania, Bullgaria, Ukraina dhe Turqia. Një vend të veçantë zënë entitet shqipfolëse të hershme dhe të reja në Greqi e Itali, si dhe në shumë shtete të tjera, si: Austri, Britani e Madhe, Francë, Gjermani, Suedi, Zvicër etj. Përtej kontinentit evropian areali shqipfolës shtrihet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada, Egjipt e Argjentinë. Në një shpërndarje me enklava më pak domethënëse nga pikëpamja gjuhësore, gjuha shqipe, në trajtat e saj arkaike a moderne, ndeshet edhe në shumë shtete të tjera. Gjithandej, kudo ku ndodhen, shqiptarët dhe gjuha e tyre shqipe me gjithë mozaikun e saj vlerësohen në rreth **13 milionë folës**, ku pjesa më rëndësishme ndodhet në Ballkan.

Qasja jonë për vëzhgimin e këtij areali shqipfolës merr **shtysë nga disa koncepte** gjuhësore që veprojnë brenda një larmie **faktorësh jashtëgjuhësorë historikë, gjeografikë, politikë, ekonomikë, socialë**, të cilët do t'i vëmë në dukje rast pas rasti. **Konceptet gjuhësore kryesore** nga jemi nisur për trajtimin e këtij areali shqipfolës janë: **politikë gjuhësore, planifikim gjuhësor, gjuhë e mbrojtur, gjuhë e pambrojtur** etj.

Punimi rreket të bëjë një klasifikim të kësaj pjese të arealit shqipfolës sipas tri koncepteve gjuhësore themelore: shqipja gjuhë zyrtare (kupto standarde), shqipja gjuhë pakice kombëtare dhe shqipja gjuhë në rrezik (GJNR). Në mënyrë të veçantë në këtë kumtesë **do të ndalemi vetëm te koncepti i tretë për të shqyrtuar këtë dukuri në rastet e shqiptarëve të Bullgarisë, Rumanisë, Turqisë dhe Ukrainës.** Pa pretenduar arritjen e një punimi shterues, gjë që i kapërcen synimet e kësaj kumtese, gjithsesi, **kjo përpjekje vlen të shërbejë për të nisur nga ky këndvështrim *studime më të thella dhe më gjithëpërfshirëse në vështrim të gjerë të arealit shqipfolës, me gjithë ‘kurthet’ që ngrihen në sipërmarrje të kësaj natyre prej larmisë së faktorëve, veçantisë së vendeve, mjegullisë së viteve dhe vetë ‘njeriut’, bartës i fjalës shqipe dhe endacak, në ngarendje, në sfidë me veten brenda territorit të tij dhe në përqasje me tjetrin, me gjuhë ndryshe, në territorin e vet.***

2. Politikë gjuhësore, planifikim gjuhësor

Fillimisht po **ndalemi në disa koncepte gjuhësore**, të cilat i përmendëm më lart. Me **politikë gjuhësore**, *kuptohen nisma politike, kryesisht të shteteve shumëgjuhëshe, me qëllim përdorimin, zhvillimin dhe zbatimin e gjuhëve të veçanta, si: njohja e gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve të punës në organizma ndërkombëtare ose akte normative për mësimin e gjuhës së nënës tek emigrantët (...), si dhe mësimi i gjuhëve të huaja dhe mësimi në disa gjuhë (Bussmann, 2008).*

Ndërsa **planifikimi gjuhësor** ka lidhje me nisma gjuhësore me *qëllim zgjidhjen e problemeve të komunikimit në një situatë gjuhësore njëgjuhëshe apo shumëgjuhëshe.* Fillimisht studimet në fushën e politikave gjuhësore dhe të planifikimeve *ad hoc* kanë synuar njësimin e ‘gjuhëve zyrtare’ shtetërore a kombëtare në vende me situata gjuhësore njëgjuhëshe, mandej studimet shkencore dhe ndërhyrjet shtetërore apo të organizmave ndërkombëtarë kanë vënë në qendër të vëmendjes gjuhët e pakicave kombëtare, dialektet përballë trysnisë së gjuhëve zyrtare, si dhe gjuhët në rrezik (GJNR).

Einar Haugen dallon **dy tipa planifikimi: a) planifikimi i statusit funksional të gjuhëve në shtetet shumëgjuhëshe** hedh bazat për zgjedhjen e gjuhës kombëtare, zhvillon strategji përtëritjeje gjuhësore ose përkundër rrezikut

të bjerrjes gjuhësore; **b) planifikimi i korpusit mbi të cilin ngrihen dhe zhvillohen normat e standardit, normat drejtshkrimore, normat gramatikore dhe fjalorët normativë**, me qëllim orientimin e shkrimtarëve dhe folësve në një bashkësi gjuhësore johomogjene (Haugen, 1968).

Në **shtete shumëgjuhëshe**, me politikat e tyre gjuhësore ato *mbështesin ose diskriminojnë gjuhët e pakicave, duke krijuar konflikte midis prestigjit të gjuhës zyrtare kombëtare a shtetërore dhe diskriminimin e gjuhëve të pakicave* (**Haarmann, 2001**). Përveç kuadrit ligjor gjuhësor të vendeve të veçanta, politikat gjuhësore në vende demokratike drejtohen nga institucione ndërkombëtare, si: **KE-ja, BE-ja, UNESCO-, OKB-ja etj.**, të cilat mbështesin jo vetëm gjuhët zyrtare të komunikimit brenda shtetit a ndërmjet shteteve, por edhe gjithë diversitetin tjetër gjuhësor e kulturor të gjuhëve të pakicave, të gjuhëve në rrezik, të dialekteve a të folmeve brenda bashkësisë shtetërore.

Në qasjen tonë ndaj arealit shqipfolës **mbështetemi në tri parime themelore: Së pari, parimi i të drejtës natyrore të qenies njerëzore** (e drejta natyrore e njeriut me gjuhën e vet) sepse, para se gjuha të jetë një e drejtë ligjore ajo është një e drejtë natyrore. Më së pari, sepse e drejta gjuhësore është në lidhje të ngushtë me idenë se *te qeniet njerëzore ekzistojnë karakteristika natyrore universale që burojnë nga një mekanizëm mendor i lindur i cili drejton procesin e përvetësimit të gjuhës amtare* (**Chomsky, Knowledge, 1986, Jackendoff, Linguaggio, 1999**). Ndërsa ligjet në një shoqëri i referohen qenies njerëzore, gjuha është vetëqenia e saj. **Së dyti, është parimi i reciprocitetit ndërshtetëror a ndëretnik** në qasjen e shteteve ndaj gjuhëve dhe kulturave të njëri-tjetrit. **Së treti, është parimi i emancipimit demokratik i shteteve dhe shoqërive tona**, *ku gjuhët dhe kulturat nuk shihen në mënyrë diskriminuese, por si vlerë e shtuar dhe përfitim i ndërsjellë i popullive në kontakt*.

Nga paraqitja e mësipërme **gjithë areali shqipfolës shpërfaqet brenda tri koncepteve gjuhësore: Së pari, shqipja gjuhë zyrtare**, që shtrihet Republikën e Shqipërisë, Republikën e Kosovës dhe *pjesërisht zyrtare* është Republikën e Maqedonisë së Veriut. **Së dyti, shqipja gjuhë pakice kombëtare**, ku përfshihen *katër komuna në Mal të Zi* (Ulqin, Tuz, Guçi e Plavë), *dhe tre komuna në Serbi* (Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë). Në këto dy shtete, në zbatim të Kartës Europiane mbi gjuhët rajonale ose minoritare,

gjuha shqipe është e mbrojtur me ligj në Serbi (2006) dhe Mal të Zi (2006). *Si gjuhë pakice kombëtare në këto shtete shqipja lidhet me trungun amë me vijimësi territoriale; folësit janë autoktonë dhe ajo është mbrojtur me ligj për sa i përket përdorimit të gjuhës dhe mësimit të saj në shkollë. Por këtu vlen të qartësohet më tej koncepti 'gjuhë e mbrojtur'. Ai nuk lidhet aq me faktin se shteti e mbështet dhe e mbron me politika gjuhësore si gjuhë pakice kombëtare, por pikësepari, sepse folësit si përdorues aktivë janë autoktonë dhe në vijimësi territoriale me trungun amë. Si të tillë, janë mbrojtës par excellence të saj. Mbrojtësi i gjuhës është vetë përdoruesi natyror i saj në territorin indigjen.*

Së treti, shqipja “gjuhë në rrezik”, ku përfshijmë arealin shqipfolës në *Bosnjë e Hercegovinë, Kroaci, Slloveni; arealin shqipfolës në Bullgari, Rumani, Turqi dhe Ukrainë; arealin shqipfolës në Greqi dhe Itali; arealin shqipfolës në SHBA, Kanada, Egjipt dhe Argjentinë. Më poshtë do të ndalemi vetëm në arealin shqipfolës në Bullgari, Rumani, Turqi dhe Ukrainë.*

3. Problematika e konceptit “gjuhë në rrezik”.

Shqipja potencialisht ose realisht gjuhë në rrezik (GJNR)

Siç u theksua më lart, koncepti ‘gjuhë e mbrojtur’ për shqipen përballet me konceptin ‘gjuhë në rrezik’, ose ‘potencialisht në rrezik’. Një gjuhë e rrezikuar është kur rrezikon të mos përdoret, pasi folësit e saj vdesin ose zhvendosen drejt një gjuhe tjetër. Humbja e plotë e gjuhës ndodh kur gjuha nuk ka më folës amënorë dhe bëhet një "gjuhë e vdekur". Një gjuhë e vdekur ende mund të studiohet përmes regjistrimeve ose shkrimeve, por është e vdekur ose e zhdukur nëse nuk ka folës të rrjedhshëm.

Zhvendosja e gjuhës më së shpeshti ndodh kur folësit kalojnë në një gjuhë të lidhur me pushtetin social ose ekonomik, në situata kolonializmi, globalizimi e nacionalizmi, sidomos aty ku trysnia antropofagjike dhe antropemike sjell pasoja fatale asimilimi etnik.

Faza e parë në vdekjen e gjuhës është rreziku potencial, që. **Faza e dytë** është kur një gjuhë ka arritur fazën e rrezikimit ndodh kur një gjuhë përballet me një trysni të fortë të jashtme, por ende ekzistojnë komunitete të folësve, të cilët e kalojnë gjuhën te fëmijët e tyre, pra ka vetëm disa folës të mbe-

tur dhe fëmijët të cilët, në pjesën më të madhe, duke kaluar te gjuha tjetër, nuk e mësojnë gjuhën amë. **Faza e tretë** e zhdukjes së gjuhës është kur një gjuhë nuk ka gjasa të mbijetojë edhe për një brez tjetër dhe së shpejti mund të zhduket. **Faza e katërt** është kur nuk ka më folës të rrjedhshëm.

Në përgjithësi, **ndër faktorët më të rëndësishëm që kanë ndikuar në arealin shqipfolës janë pushtimi osman, Lufta e Parë Botërore, Lufta e Dytë Botërore, ish-Jugosllavia, ish-komunizmi, globalizmi, lëvizja e lirë dhe emigracioni kryesisht ekonomik, por edhe pamjaftueshmëria e një kujdesi të vazhdueshëm të politikave prej shteteve amënore për mbrojtjen dhe arsimimin gjuhësor e kulturor të shqipfolësve në trevat ku shqipja ka marrë ose po merr statusin e GJNR-së.**

Siç e theksuam më lart, ne po ndalemi më poshtë vetëm tek areali shqipfolës në Bullgari, Rumani, Ukrainë, Turqi.

4. Areali shqipfolës në Bullgari, Rumani, Ukrainë, Turqi

Studiuesi Idriz Ajeti (Ajeti, Studime, 2017) shkruan se shqiptarët e Bullgarisë janë shpërngulur nga Korça, Ohri, Elbasani, Çermenika, Golloborda, diku nga shekulli XV deri në shekullin XIX, dhe pastaj një pjesë është zhvendosur edhe në Ukrainë. Mes shekullit XV dhe XVII grupe shqiptarësh nga të dyja besimet, si katolikë dhe ortodoksë, u vendosën në disa pjesë të Bullgarisë Veriore, dhe një pjesë në Trakinë Jugore. Disa nga ardhësit e parë shqiptarë në Bullgarinë moderne ishin minatorë në Kopilovtsi, një fshat në afërsi të një qendre të madhe minierash. Të dhënat bëjnë të ditur se 1500 prej tyre jetonin në afërsi të Tërnovës.

Vende të tjera në veri të Bullgarisë, ku prania shqiptare ka qenë fort e ndjeshme janë Chervena Voda afër Rouse, Poroishte afër Razgradit, Dobrina afër Provadias dhe Devnya afër Varnas.

Gjuha e përdorur prej tyre është shumë arkaike. Ndër studimet shkencore për shqiptarët në këto treva vlen të përmendet Bojka Sokolova (Bojka Sokolova, Die albanische Mundart von Mandrica, 1982). Një vend të veçantë zë fshati Mandricë, i cili u krijua më 1636 nga disa barinj ortodoksë shqiptarë që furnizonin ushtrinë otomane me produkte qumështi. Ata u lejuan të merrnin një copë tokë dhe të mos paguanin taksa. Në vitin 1873 Mandrica ishte një vendbanim me 250 shtëpi, me rreth 1100 banorë shqiptarë. Pjesa

më e madhe e shqiptarëve erdhën në Bullgari në shekullin XVIII nga rrethinat e Korçës dhe në shekullin XIX nga rajoni i Sulit. Në 1908 burime greke e regjistronin popullsinë prej 3500 banorësh, kurse Censusi i 2006-s ka regjistruar 75 shqiptarë të deklaruar.

Mirëpo shqiptarët dhe gjuha shqipe në Bullgari nuk përfshihet nën ombrellën 'pakicë kombëtare'. Madje as edhe Mandrica, e njohur nga censuset zyrtare si shqiptare nuk gëzon statusin e gjuhës së pakicës kombëtare. Më lart theksuam se një nga tri parimet që merren parasysh në qasjen ndaj gjuhëve, krahas atyre të së drejtës natyrore të qenies njerëzore dhe të emancipimit demokratik të shoqërive tona për vlerësimin e gjuhëve dhe të kulturave, është edhe parimi i reciprocitetit ndëretnik a ndërshtetëror. Kësisoj, ndërsa Republika e Shqipërisë e njeh në Ligjin për Pakicat (Nr.96/2017) pakicën bullgare si pakicë kombëtare, me gjithë problematikën, që trajtuam më lart, ky parim nuk zbatohet për pakicën kombëtare shqiptare në Republikën e Bullgarisë. **Për nga niveli i gjendjes gjuhësore shqipja këtu renditet midis fazës së dytë dhe të tretë të GJNR-ve.**

Sipas censusit të vitit 2002, në **Rumani** kishte 520 shtetas të deklaruar si shqiptarë dhe 484 deklaruan gjuhën shqipe si gjuhë amtare. Numri i tanishëm i shqiptarëve në Rumani llogaritet të jetë diku rreth 10,000 qytetarë. Shumica e anëtarëve të komunitetit shqiptar jetojnë në Bukuresht, kurse pjesa tjetër është e vendosur kryesisht në qendra të mëdha urbane, si: Temishvar, Jash, Konstancë dhe Kluzh-Napokë (**George, Grigore, 2007**).

Në vitin 1893, bashkësia shqiptare në Rumani numëronte rreth 30,000 banorë. Në vitin 1920, rreth 20 mijë shqiptarë jetonin në Bukuresht. Një valë e re e emigrimeve shqiptare, shumë syresh myslimanë ka shkuar nga ish-Jugosllavia, në prag të Luftës së Parë Botërore.

Bashkësia shqiptare ka qenë e trysnuar gjatë regjimit komunist në Rumani, duke filluar nga viti 1953, kur shoqatat kulturore shqiptare u mbyllën. Shumë të drejta shqiptarëve u janë rikthyer pas Revolucionit rumun të vitit 1989, por numri i qytetarëve që deklarohen shqiptarë ka rënë ndjeshëm mes viteve 1920 dhe 2002. Ashtu si dhe te rasti i Bosnjë e Hercegovinës, qytetarët e bashkësisë shqiptare janë përfshirë në kategorinë "të tjerët" gjatë censuseve të kryera ("Albanezi - Date demografice", 2008).

Shumica e familjeve janë ortodokse dhe e kanë prejardhjen nga trevat përreth Korçës. Shumë shqiptarë të tjerë të Rumanisë ndjekin fenë islame.

Sipas një artikulli të vitit 1999 nga studiuesi rumun George Grigore, rreth 3000 anëtarë të bashkësisë islame në Rumani mund të jenë shqiptarë (George, Grigore. 2007).

Edhe në Rumani gjendja e **gjuhës shqipe konsiderohet “gjuhë në rrezik” midis fazës së dytë dhe të tretë të GJNR-ve**, duke shkuar drejt asimilimit, sepse politika gjuhësore mbrojtëse nuk ndiqet nga një planifikim gjuhësor ad hoc dhe për më tepër procesi i asimilimit është i madh, pasi është ndërprerë vijimësia e ruajtjes së gjuhës nga prindërit te fëmijët, por edhe për shkak të largësisë relative gjeografike prej trungut amënor.

Shqiptarët e **Ukrainës** erdhën nga zona e Korçës, fill pas pushtimit turk dhe për rreth 200 vjet jetuan në Bullgari. Më pas një pjesë u zhvendosën në Ukrainë dhe kanë 300 vjet që jetojnë aty. Banorët janë toskë, të shpërngulur nga rajoni i Pogradecit dhe Korçës, si pasojë e përndjekjes osmane. Numri i shqiptarëve që jetojnë në Ukrainë, arrin në 5000 banorë.

Shqiptarët e Ukrainës fillimisht u vendosën në veri të Odesës, 220 km në fshatin Karakurt së bashku me bullgarët dhe gagauzët. Në fillim të vitit 1860 një pjesë e fshatit Karakurti (Zhovtnjovoje) u shpërngul në rajonin e brigjeve të detit Azov, ku u themeluan 3 fshatra: Taz (Devnenskoje), Tyshki (Gjeorgjevka), Xhandran (Gamovra), ku jetojnë edhe sot në tokën që ua dhuroi Katerina II e Ruisë.

Gjuha shqipe gjendet sot në këto katër fshatra, Karakurt (Zhovtnjovoje), Taz (Devneskoje), Tyshki (Gjeorgjevka) dhe Xhandran (Gamovra). Mirëpo statusi i saj në përdorim është një përzierje e shqipes toske me rusishten. Gjuha shqipe ka pësuar ndryshime si pasojë e kontakteve të përhershme me bullgarishten, gagauzishten, ukrainishten dhe rusishten. Shkrimi me alfabetin shqip mungon. Si alfabet ata përdorin kryesisht atë cirilik. Procesi i asimilimit gjuhësor dhe kulturor, për shkaqe historike dhe politike, bashkë me kushtet ekonomike, po e shpie **shqipen drejt asimilimit dhe është në fazën e tretë të klasifikimit të GJNR-ve**.

Në Republikën e **Turqisë** shqiptarët përbëjnë një pakicë kombëtare, e cila nuk është e njohur zyrtarisht. Kjo pakicë përbëhet nga shqiptarë të cilët erdhën në Turqi gjatë periudhës osmane, kryesisht shqiptarë nga Kosova, ish-Maqedonia, Çamëria, si dhe në numër më i vogël nga Shqipëria dhe Mali i Zi, të cilët emigruan si pasojë e persekutimit serb dhe grek pas fillimit të Luftërave Ballkanike (Geniş & Maynard. 2009). Numri i shqiptarëve në

Turqi llogaritet të jetë nga 500.000 deri në 1.3 milionë, ndërsa sipas disa burimeve tjera numri i qytetarëve me prejardhje shqiptare është rreth 5 milionë (**Cuneyt, Yenigun. 2009**).

Në censusin e vitit 1965, rreth 13 mijë shtetas të Turqisë flisnin shqipen si gjuhë amtare, që përbënte rreth 0.04% të popullsisë. Shumica ishin të vendosur në Bursa, Sakarja, Tokat dhe Stamboll. Rreth 390.000 të tjerë flisnin shqipen si gjuhë të dytë (1.28% e popullsisë). Gjithsej, numri i popullsisë shqipfolëse në Turqi në vitin 1965 ishte rreth 403.000 ose 1.3% e popullsisë së Turqisë. Por, për shkak të mungesës së regjistrimit të popullsisë sipas origjinës edhe numri i shtetasve turq me prejardhje shqiptare nuk mund të dihet saktësisht. Edhe Turqia paraqet një situatë shqipfolëse komplekse, që lidhet me Perandorinë Osmane nga njëra anë, por edhe me periudhën e ish-Jugosllavisë, ku shumë shqiptarë u shpërngulën për në Turqi nga Kosova, Mali i Zi, ish-Maqedonia, për arsye politike të situatës konfliktuale me serbët, por edhe për arsye ekonomike, shoqërore etj. Vetëm se politika turke në tërësi nuk i ka njohur shqiptarët si pakicë kombëtare, sepse i konsideron si pjesë integrale e ish-Perandorisë Osmane, duke përdorur si kriter identifikues fenë islame. Pra, gjuha shqipe dhe folësit e saj në Turqi janë në fazën e tretë dhe të katërt të GJNR-ve. Nuk ka folës të rrjedhshëm, nuk ka politikë gjuhësore dhe planifikim gjuhësor; gjuha shqipe nuk mbrohet dhe madje as nuk njihet si gjuhë pakice kombëtare. Disa përpjekje shtetërore dhe jo vetëm nga qeveria aktuale dhe shoqata të ndryshme për të nxitur mësimdhënien e gjuhës shqipe në institucione akademike e kulturore janë të pamjaftueshme për të ndryshuar gjendjen gjuhësore shqipfolëse në këtë shtet. **Edhe këtu, sipas kohës dhe krijimit të komuniteteve shqipfolëse, gjuha shqipe ndodhet në fazën e dytë për një pjesë të ardhur më vonë dhe në fazën e tretë për pjesën tjetër.**

5. Përfundime dhe rekomandime

Shumë projekte po synojnë për të parandaluar ose ngadalësuar bjerrjen a humbjen e gjuhëve, duke rivitalizuar gjuhët e rrezikuara, duke promovuar arsimimin dhe shkrim-leximin në gjuhët e pakicave, si dhe duke përfshirë në projekte të përbashkëta komunitete folëse dhe gjuhëtarë apo edhe mbrojtës nga shoqëria civile. Siç u vu re më lart, shumë vende kanë miratuar legjislacione

cion specifik që synon mbrojtjen dhe stabilizimin e gjuhës së komuniteteve të gjuhës origjinare që bartin folësit në një areal tjetër gjuhësor (pakica të ardhura nga larg) apo ata që flasin në shtetin si zgjatim territorial i gjuhës tjetër (minoritete).

Çështja e GJNR-ve ka marrë një zhvillim të madh pas viteve '90, si domos pas marrjes në mbrojtje prej UNESCO-s dhe projektit të Google 2, duke sjellë një larmi botimesh, ku gërshetohen shumë disiplina si drejtësia, shkencat shoqërore (Chrystal, David. 2000; Hagège, Claude. 2000; Nettle, Daniel. dhe Roumaine, Susanne. 2000; Evans, Nicholas. 2011). Shpesh kjo çështje është ngritur edhe emocionalisht si një zhdukje e programuar dhe e qëllimshme e një pasurie shpirtërore të njerëzimit (Harrison, K. David. 2007).

Në fakt, duke u distancuar prej qëndrimeve pasionante, gjuhëtarët mund dhe duhet të japin kontribute serioze që vijnë prej kërkimesh konkrete teorike e empirike. **Aroux mbron idenë se gjuhësia është një shkencë me observator, pra me mjete që bëjnë të mundur vëzhgimin e dukurive në terren konkretisht, me anketime dhe me pyetësorë për këto gjuhë (Aroux, Sylvain. 1998).** Vëzhgimi i tyre duhet të jetë i përhershëm për arsye se ato janë në ndryshim të pandërprerë.

Studiuesit deskriptivistë, sociolinguistët shprehen se GJNR është një observator më vete dhe se vetëm të dhënat e tyre që dalin prej GJNR-ve duhen marrë si bazë për përfundime teorike gjuhësore, por edhe si burim i sigurt ku duhet të mbështeten censuset dhe politikat gjuhësore shtetërore.

Në literaturën anglofone studimet për GJNR-në, kryesisht prej viteve 1990, (Grenoble, A Lenore & Whaley, J. Lindsay. 1998) kanë synuar fillimisht me krijimin e një vetëdijeje rreth termit "zhdukje" të shumë gjuhëve të botës, parë kjo si një shqetësim, madje edhe si reagim ndaj shkaqeve dhe faktorëve që ndikojnë në këtë proces në peizazhin gjuhësor botëror, qofshin ata politikë, ekonomikë, shoqërorë a thjesht gjuhësorë.

Nga ana tjetër, pyetësorin e vlerësimit të qenësisë së GJNR-ve, UNESCO e ka kthyer në një program për promovimin e gjuhëve si mjete për edukimin dhe kulturimin (Fishman, A. Joshua. l'EGIDS Extended Graded Intergenerational Disruption Scale), i cili u zhvillua më tej nga Lewis, Simons etj, (Lewis, P. Michael. Simons, F.Gary. Charles, D. Fennig. 2013). Gjithaq, njohja e plotë e tyre shërben për hipoteza teorike mbi invariantet

gjuhësore dhe njohjen e mëtejshme të diversitetit të tipologjive strukturore gjuhësore dhe prejardhjes gjenealogjike apo afrisë gjeografike të tyre (Rijkhoff, Jan. Bakker, Dik. 1998; Song, J. Jung. 2001).

Po kështu, një problem tjetër që është vënë në dukje nga studimet është ai i paragjykimit të folësve që flasin ende GJNR. Kjo do të thotë se, krahas rëndësisë për studime përshkruese dhe dokumentuese nga gjuhëtarët, duhen vëzhguar situatat e ndryshme ku ndodhen folësit e tyre, dhe këtu ekziston një larmi situatash sipas rasteve që paraqiten.

Jean Louis Calvet (Essais, 2004) thekson se këto qëndrime po ia ndryshojnë kahun gjuhësisë nga një gjuhësi e gjuhës së masës folëse (si sistem) në një gjuhësi të kumtimit të folësve konkretë, pra një ‘gjuhësi ndërvepruese’ të folësve gjatë ligjërimit. Gjithë kjo e kthen çështjen e folësve në qendër të vëmendjes. *Çdo politikë gjuhësore që ngurtësohet në respektimin e rregullave të vendosura ex cathedra, sikur rregullat t’i bënin politikëbërësit apo edhe vetë gjuhëtarët dhe jo përdoruesit natyrorë të gjuhës, rrezikon t’i nxjerrë rregullat e vendosura jashtë konteksteve jetësore të folësve (kryesisht gjuha e folur), duke krijuar realitete paralele me atë të zhvillimit natyror të gjuhës, sepse gjuha zyrtare, vetë dialektet brenda gjuhës kombëtare sikundër gjuha e pakicave apo GJNR-të, nuk mund të jenë një veshje e drunjtë, por një veshje që rri sipas shtatit të përdoruesit (Rrokaj Konf. 2020).*

Për më tepër, kur studiuesit shkojnë në terren në rastet e GJNR-ve, gjendja e zotërimit të kompetencave gjuhësore nga ana e folësve, në përkthim, shqiptim, ndërtime fjalish, kontekste ligjërimore të ndryshme është e variueshme (Newman, Paul. & Ratliff, Martha. 2010). Pra, nuk kemi të bëjmë me folës që e zotërojnë idiomën në të njëjtin nivel, që do të thotë se çështja e konceptit “folës” i një gjuhe në kësi rastesh vihet në pikëpyetje për sa i përket kompetencës ndaj GJNR-ve. Kjo larmi gjuhësore ka vënë në vështirësi studiuesit për përcaktimin e statusit të folësit në raport me zotërimin e GJNR, ku çdonjëri bëhet i çmuar nga pikëpamja studimore gjatë përdorimit vetjak. Në këtë drejtim studiuesit propozojnë disa tipologji folësish si: folës tradicionalë, gjysmë-folës, folës të rinj, folës fantazmë, folës të moshuar etj. (Bert, Michel. & Grinevald, Colette. 2010). Gjithsesi studimet në terren japin të dhëna mbi vitalitetin e GJNR-ve, duke vënë në diskutim konceptin se çdo të thotë të flasësh një gjuhë, gjë që na shpie drejt dy qasjesh: gjuha si

sistem ku përshkruhet funksionimi në rrafshet e ndryshme dhe gjuha si institucion sociopolitik që na shpie drejt politikash gjuhësore.

Në përmbyllje të kësaj qasjeje shtrajmë edhe njëherë pyetjen se çfarë kuptojmë me GJNR (përfshi dhe shqipen, në rastin tonë), sistemin që pëson ndryshime të rëndësishme prej rënies drastike të folësve që e përdorin? Apo statusi i gjuhës, i cili bie në të njëjtën kohë me humbjen e statusit të grupit me të cilin ajo lidhet? A duhet të mbetemi në politikën gjuhësore të gjuha si sistem, duke studiuar vetë rrafshet e saj apo duhet gjithashtu duhet të orientohemi te folësit dhe grupet shoqërore përkatëse, të cilët për shumë arsye (politike, ekonomike, shoqërore etj.) orientohen drejt zgjedhjeve ekzistenciale? I përmbahemi mendimit se të dyja këto qasje janë të nevojshme që të ndërthuren për një politikë dhe planifikim gjuhësor të dobishëm dhe sa më pranë realiteteve të folësve.

Nga ana tjetër, prirja e vetëdijshme e shumë gjuhëtarëve, mbrojtësve të pasurisë kulturore etj., për t'i ruajtur gjuhët me çdo kusht, deri në utopi, (De Swaan, Abram. 1999), shkon shpeshherë përkundër ndryshimeve gjuhësore që gjuhët pësojnë përgjatë historisë së tyre, dhe sidomos përkundër vullnetit të grupeve që vendosin me shumë ose me më pak liri, me ose pa kufizime për konservimin ose jo të përdorimit.

Sidoqoftë, siç u pohua më lart, për qasjet studimore dhe politikën gjuhësore ndaj çdo gjuhe, përfshirë dhe shqipen, duhen mbajtur parasysh tri parime kryesore: a) parimi i së drejtës natyrore, ku gjuha para se të jetë një e drejtë ligjore është pjesë e vetë ekzistencës identitare të qenies njerëzore; b) parimi i reciprocitetit ndërshtetëror, ipso facto ndëretnik; c) Emancipimi shoqëror demokratik ku, gjuhët, kulturat e etnive të tjera nuk janë burim konflikti, por një pasurim i ndërsjellë i vetë këtyre shoqërive. Prej këtyre parimeve dhe pas qasjeve shkencore të studiuesve duhet që shtetet shqiptare dhe shoqëritë tona të orientojnë vëmendjen e tyre, duke filluar më së pari nga evidentimi i gjendjes reale të arealit shqipfolës kudo ndodhet, dhe mbi këtë bazë ndërtimin e politikave gjuhësore dhe planifikimeve gjuhësore ad hoc.

Bibliografi:

- Ajeti, Idriz. Studime për gjuhën shqipe, Prishtinë, 2017.
- Alain, Ducelier. *Travaux et mémoires*. Bd. 3. L'Albanon et les Albanais au 16 siècle, Paris (Centre de recherches d'histoire et civilisation byzantine), 1968.
- “Langues menacées, savoirs en péril”, Revue internationale des sciences sociales 173, Mithun, Marianne, 1998.
- Anderson, Benedict. *Comunità immaginate. Origini e fortuna dei nazionalismi*, Manifestolibri, Roma, 2009.
- Sylvain, Auroux. *La raison, le langage et les normes*, Paris, Presses Universitaires de France, Austin, 1998.
- Austin et Sallabank, la ‘Cambridge Conference on Endangered Languages’, revistat Language Documentation and Description et Language Documentation and Conservation. Article published by EDP, 2011.
- Bert, Michel. & Grinevald, Colette. “Proposition de typologie des locuteurs de LED”, *Faits de langues* 35/36, 2010.
- Blackwood, Robert. & Tufi, Stefania. *The linguistic landscape of the mediterranean*, University of Liverpool, UK, 2015.
- Bojka, Sokolova. *Die albanische Mundart von Mandrica*, Berlin, 1982.
- Borin, Lars. «The why and how of measuring linguistic differences », Lars Borin & Anju Saxena (eds.), *Approaches to measuring linguistic differences*, Berlin, Mouton de Gruyter. Burling, Robbins, 1969. “Proto-Karen: A reanalysis”, *Occasional Papers of the Wolfenden Society on Tibeto-Burman Linguistics* 1, 2013.
- Bussmann, Hadumod. *Lexikon der sprachwissenschaft, digitalizuar*, 2008.
- Calvet, L. Jean. *Le Marché aux langues: les effets linguistiques de la mondialisation*, Paris, 2002.
- Chomsky, Noam. *Knowledge of language, Its nature, Origin and Use*, Praeger, New York, 1986.
- Claus, Haebler. *Grammatik der albanischen Mundart von Salamis*. Albanische Forschungen. Bd. 3. Wiesbaden (Harrassowitz). 1965.

- Costa, James. "New Speakers, New Language: On Being a Legitimate Speaker of a Minority Language in Provence", *International Journal of the Sociology of Language* 231, 2015.
- Crystal, David, *Language death*, Cambridge, Cambridge University Press, 2000.
- Cuneyt, Yenigun. *Balkan Multikulturalism: Example to itself & to the EU*, 2009.
- Dahl, Östen. "An exercise in a posteriori language sampling", *Sprachtypologie und Universalienforschung* 61, 2008.
- De Swaan, Abram. "Le sentimentalisme des langues. Les langues menacées et la sociolinguistique", 2007.
- Endangered Languages; Language Loss and Community Response*, Cambridge, Cambridge University Press, 2001.
- Evans, Nicholas. *Dying Words: Endangered Languages and What They Have to Tell Us*, Oxford, 2011.
- Gasquet, C. Médéric. "La 'mort' des langues: repères historiques, critiques et réflexions éthiques", 2010.
- Geniş & Maynard. "Taking a chronological perspective, the ethnic Albanians currently living in Turkey", 2009.
- Georg, Stadtmueller. *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte*. (Albanische Forschungen. Bd. 2). Wiesbaden (Otto Harrassowitz). 1966.
- George, Grigore. "Muslims in Romania" Arkivuar 26 shtator 2007 tek Wayback Machine, in *International Institute for the Study of Islam in the Modern World (ISIM) Newsletter* 3, July 1999; retrieved July 16, 2007.
- Grenoble A. Lenore & Lindsay J. Whaley, *Endangered Languages: Language Loss and Community Response*, 1998.
- Grenoble A. Lenore & Lindsay J. Whaley, *Saving Languages: An Introduction to Language Revitalization*. New York, Cambridge University Press. 2006.
- Haarmann, Harald. *Babylonian world. History and future of languages*. Frankfurt, New York: Campus, 2001.
- Hagège, Claude. *Les structures des langues*, Que sais-je? PUF, 2000.
- Hagège, Claude. *Halte à la mort des langues*, Paris, 2000.
- Haugen, Einar. *Language Conflict and Language Planning: The Case of Modern Norwegian*. Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 1966.

- Harrison, K. David. *When Languages Die: The Extinction of the World's Languages and the Erosion of Human Knowledge*, Oxford Univ. Press, 2007.
- Haugen, Einar. *Language Planning in Modern Norway*. De Cruyter Mouton, 1968.
- Hobsbawm, E.J. *Nazioni e nazionalismi dal 1870*, Einaudi, Torino, 1990.
- Inalcik, H. *Hicri 835 Tarihli Suret-i Defter-i Sancak-i Arvanid*. Ankara, 1945 dhe Puto, Arben.: *Histoire de le Albanie dès origines à nos jours*, Roan, 1974.
- Jackendoff, Ray. *Linguaggio e natura umana*, il Mulino, Bologna, 1999.
- Lewis, M. Paul. Gary, F. Simons. Charles, D. Fennig. *Ethnologue: Languages of Africa and Europe*, bot. XVII Hardcover, 2013.
- John, Wiley & Sons. Fishman, A. Joshua. *Reversing Language Shift: Theoretical and Empirical Foundations of Assistance to Threatened Languages*, Bristol, Multilingual Matters, 1991.
- Joseph, H. Greenberg. et al. (eds.), *Universals of Human Languages: method - theory*, vol. 1, Stanford, Stanford University Press 1963.
- Largimet shqiptare dhe ku janë shpërndarë: *albasoul.com*
- Médéric, C. Gasquet.- alicé Vittrant et Sylvie Voisin Greenberg, Joseph H., *Language in the Americas*, Stanford, Stanford University Press, 1987.
- Médéric, C. Gasquet. Alain, Giacomi. Yvonne, Touchard. Daniel Veronique. *Pour la (socio)linguistique*, Paris, L'Harmattan, 2010.
- Nettle, Daniel. & Romaine, Suzanne. *Vanishing, Voices. The Extinction of the World's Languages: The Extinction of the World's Languages*, Oxford, Oxford University Press, 2000.
- Newman, Paul. & Ratliff, Martha. *Linguistic Fieldwork*, Cambridge, Cambridge University Press, 2001.
- O'Rourke, Bernadette, Pujolar, Joan. & Ramallo, Fernando. "New Speakers of Minority Languages": The Challenging Opportunity, *International Journal of the Sociology of Language* 231, 2015.
- Profili i politikës arsimore gjuhësore, Shqipëria, departamenti i arsimit, Këshilli i Evropës, Strasburg. 2015-2017.
- Rijkhoff, Jan. & Bakker, Dik. "Language sampling", *Linguistic Typology* 2-3, 1998.

- Rijkhoff, Jan. Bakker, Dik. Hengeveld, Kees. & Kahrel, Peter. "A Method of Language Sampling", *Studies in Language* 17(1), 1993.
- Rrokaj, Shezai. Ligji për gjuhët në Maqedoninë e Veriut dhe gjuha shqipe, *Konf. Albanologjike, Tetovë*, 2019.
- Rrokaj, Shezai. Çështje të gjuhës shqipe 1, *Albatros*, 2007.
- Rrokaj, Shezai. Çështje të gjuhës shqipe 2, *Shkronjë pas shkronje*, 2009.
- Rrokaj, Shezai. Çështje të gjuhës shqipe 3, *Shkronjë pas shkronje*, 2014.
- Rrokaj, Shezai. Çështje të gjuhës shqipe 4, *Pegi*, 2018.
- Savoia, Leonardo. Aspekte ideologjike të nacionalizmit gjuhësor, *GjJ*, 1-2/, 2003.
- Song, J. Jung. *Linguistic Typology. Morphology and Syntax*, Harlow, Longman, 2001.

Ylli RUGOVA

ALFABETI I KODIKUT TË BERATIT, NDËRLIDHJA E MUNDSHME ME GRAVURËN E ARDENICËS DHE ANONIMIN E ELBASANIT


Abstrakt:

Alfabeti i Beratit, i njohur më parë edhe si alfabeti i Kostë Beratit për herë të parë është zbuluar në të ashtuquajturin *Kodik të Beratit* nga shekulli XVIII. Ky alfabet, që në këtë kodik ndeshet vetëm në tre rreshta tekst, duket të ketë veçori të përbashkëta me alfabete të përdorura në dy fragmente të tjera në shqip që vijnë nga periudha të ndryshme, njëri prej Elbasanit e tjetri prej Ardenicës pranë Fierit. Madje disa shkronja të këtij alfabeti, siç është vënë re rishtazi, janë përdorur edhe në mbishkrimin arumun të Ardenicës, duke e bërë këtë alfabet origjinal jo vetëm bazë për shkrimin shqip në një rreth më të gjerë gjeografik, por potencialisht edhe për një alfabet të parë origjinal për gjuhën arumune. Në këtë artikull do të ndjekim gjurmët e këtij alfabeti në dokumentet që kanë mbijetuar, duke dhënë edhe informata rrethore që flasin për të në këtë periudhë. Njëkohësisht do të shikojmë shtrirjen e alfabetit të Beratit kundruall alfabeteve të tjera origjinale të gjuhës shqipe nga ky mes kulturor.

Fjalë kyqe: *Kodiku i Beratit, alfabetet origjinale, dorëshkrime shqip, Gravura e Ardenicës, Anonimi i Elbasanit*

Një alfabet prej cuklave

Te fletorja e njohur me emrin *Kodiku i Beratit* që mbahet në fondin e dorëshkrimeve të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, qysh më kohë janë vënë re disa tekste nga periudha 1764 deri 1798 në gjuhën greke dhe në gjuhën shqipe me germa greke. Në mesin e tyre janë edhe tre radhë shqip me një alfabet origjinal dhe një pasqyrë me germat e tij. Më saktësisht ky kodik i përmban gjithsej 117 germa të këtij alfabeti origjinal, me të cilin janë shkruar në tërësi 16 fjalë. Natyrshëm, kjo është krejt pak kur krahasohet me, për shembull, qindra faqe të alfabetit të Todhrit që ruhen në Tiranë, Vjenë e në disa koleksione private. Vlera e alfabetit të Beratit magnifikohet nëse i shkojmë pas hipotezës së shtruar më parë nga Shuteriqi (1978), e më rishtaz nga Demiraj (2019), se i njëjti alfabet pjesërisht është vënë në përdorim edhe te *Gravura e Ardenicës*; një material me origjinë nga Fieri. Me çka data e përdorimit të tij përthellohet deri në vitin 1731. Përveç se do të sjellim argumente shtesë mbi këtë hipotezë, në këtë artikull do të synojmë të shkojmë edhe një hap tutje duke e zgjeruar edhe më shtrirjen gjeografike dhe kohore të alfabetit. Duket e mundshme se i njëjti alfabet (apo një variant i tij) është përdorur edhe te faqja e parë e *Anonimit të Elbasanit*. Ndërlidhja e alfabetit të Beratit me këtë fragment të Elbasanit nuk është studiuar dhe analizuar ndonjëherë. Megjithëse, qysh do ta shohim, edhe tentimet e Dimitër Shuteriqit për deshifrimin e këtij teksti, si duket, merrnin për bazë pikërisht këtë abece. Së këndejmi do të provojmë të argumentojmë se alfabeti origjinal që ndodhet në *Kodikun e Beratit* ka sinjale të ketë pasur shtrirje relativisht të gjerë e të gjatë në aspekt kohor veçanërisht te rrethet ortodokse të shqiptarëve (dhe mbase arumunëve). Në anën tjetër, të dhënat e reja që do të shpalojmë, hapin shtigje edhe për hipoteza të proshkëta rreth autorëve shpikës të mundshëm të këtyre alfabeteve të veçanta.



Ilustrimi 1: Tre rreshtat e tekstit shqip me alfabetin e Beratit në *Kodikun e Beratit* (f. 104). Përveç këtij fragmenti, është edhe një pasqyrë e alfabetit origjinal (f. 106), me vlerat fonetike të paraqitura përmes alfabetit grek. I tejshkruar me alfabet latin del kështu: “pë-rëndiliemea shpresë egjithë tëkështerëvet mbulljo erua[j] eshpëto ata kë shprenjënë mbëty.”

Kodiku i Beratit dhe alfabeti origjinal aty


Kodiku i Beratit është një fletore me 158 faqe që për herë të parë është bërë e njohur për rrokullinë shqiptare në vitin 1931, kur Sotir Kostea, drejtori i atëhershëm i Bibliotekës Kombëtare në Tiranë kishte njoftuar për të në vjetarin e institucionit që po udhëhiqte,

Biblëjoteka Kombëtare paty aty moti nga Berati një shkresëdore 152 faqesh (sic), e cila, si pas mënyrës’ që shënon të njgjarat’ të kohësë, duket’ të ket’ qen shkruarë nga fundi i shekullit’ të 18të. Vepëra e plotë ka qënë prej 154 faqesh, ndë formë 21x15, po sot i kanë mbe-tur’ vetëm 152, sepse janë shdukurë faqet’ 57 dhe 58. Trajta e të shkruaritë tregon se është shkruarë e tërë prej një dore. [...] Abeceja e posaqëm’, e shtruarë ndë faqet’ 104 dhe 106, s’piqet as me një nga abecet’ të njohura, pa nuk ka të bënë as me mënyrat’ t’ jera që dihet’ se ndë Jugë kan’ qënë përdorur’ për të shkruarë shqipen’ prej dy shekujsh e t-hu. Trajta e shkrojavet’ është e ngatërruarë, pra dhe, e vishtirë për çdo-kë që nuk’ u a ka dorënë. (Kolea 1931, 10–11)

Me fletoren e sapozbuluar të Beratit fillimisht qe marrë Ilo Mitkë Qafëzezi, i cili edhe ka identifikuar një Kostandin Leromonakun si autor të mu-

ndshëm. Pak a shumë në të njëjtën kohë me këtë temë është marrë edhe studiuesi tjetër Namik Ressuli, i cili ka sjellë edhe një pasqyrë të saktë të alfabetit në vitin 1938 pas një shkrimi paraprak (me ca lëshime serioze) një vit më parë. Për një kohë, duket se interesimi për këtë alfabet ishte venitur, ngase trajtimi i tij ngelet kryesisht në kuadër të teksteve shkollore. Krejt më vonë, pas Luftës së Dytë Botërore, Dhimitër Shuteriqi i rikthehet shkarazi kësaj teme duke bërë ca plotësime përmes shkrimeve kryesisht bibliografike. Është ky i fundit që duke folur për alfabetin e *Kodikut Beratas* nuk ngurron ta theksojë përkimin me llojet e shkrimeve të tjera, përfshirë disa shkronja origjinale të pavërejtura deri atëherë në *Gravurën e Ardenicës*. Më 1976 Shuteriqi shprehej se te kjo gravurë, “[I]nicialja V është identike me germën v të alfabetit origjinal të shqipes, që e gjejmë te K. Berati” (Shuteriqi 1976: 121). Por pa u thelluar më tutje në këtë problematikë. Një analizë më të esëllt mbi *Kodikun e Beratit* e gjejmë tek Armin Hetzer-i në vitin 1982 botuar në gjermanisht. Ky përveç që kritikon përgjithësisht studimet e mëparshme, është veçanërisht kritik ndaj Qafëzezit, të cilin, ndoshta pak me teprim, e fajëson për lëshime dhe ngatërresa në analizat rreth kodikut. Vetë Hetzer-i e përjashton një Kostandin si autor të dorëshkrimit dhe vëren të paktën dy duar të ndryshme të kenë shkruar në kodik në periudha të ndryshme. I pari, të cilin e shënon si A, sipas skemës që jep duhet të ketë qenë autor i pjesës deri në vitin 1785, kurse i dyti, të cilin e shënon si B, i pjesës deri në vitin 1798, por që s’është e thënë se renditja mes tyre është kronologjike. Për të komplikuar gjërat paksa, sipas Hetzer-it, autori A (më i vjetri) shkruan në fillim dhe në fund të fletores, kurse autori B (më i ri) kryesisht pjesën e mesit të fletores. Alfabetin origjinal, që është disi i vendosur si në mes të këtyre pjesëve, e sheh të shkruar nga autori B, i cili është autor edhe i kronikës që fillon nga viti 1764 deri në vitin 1798. Me fjalë të tjera data 1764 është edhe *terminus post quem* për alfabetin e Beratit. Sa i përket identitetit të autorëve, vëren emrin e një Thimi Nuni, që shënohet disa herë nëpër margjina, por të cilin nuk e njëson me asnjërin prej dy autorëve të mundshëm të kodikut. Për Hetzerin, Nuni duhet të ketë qenë një pronar i mëvonshëm i fletores. Ndërsa për autorin A dhe B nuk ka ndonjë emër. Vetë prejardhja e kodikut mbetet e panjohur. Rishtazi në vitin 2019 studiuesi Bardhyl Demiraj i është rikthyer fletores dhe kryesisht bazuar në studimin e

Hetzer-it ka përmirësuar lëshimet që mund të kenë mbetur nga analizat e hershme të këtij kodiku. Për më shumë, Demiraj po atë vit e sjell një vëzhgim me interes për temën tonë sa i përket alfabetit origjinal, ku e përforcon tutje hipotezën e Shuteriqit që e ndërlidh alfabein me ca germa nga *Gravura e Ardenicës*. Te Demiraj, përveç shkronjës “v” që përmendet te Shuteriqi, potencohet edhe një “c” e një “sh” te pjesa arumune e tekstit të kësaj gravure, për çka do të flasim prapë pas pak (Demiraj 2019, 109, 122–125). Pra bëhet fjalë përgjithësisht për shkronja që nuk i ndeshim në alfabetet greke e që gjuha arumune i ka.



Ilustrimi 2: Gravura e Ardenicës nga viti 1731. E njëjta ndodhet edhe në librin e Nektar Tërpos të botuar në Venedik në vitin 1732. Gravura ka katër mbishkrime të njëjta në gjuhë të ndryshme: arumanisht, shqip, greqisht dhe latinisht.

Gravura e Ardenicës


Një gravurë që mban datën 1731, e që vjen nga manastiri i Ardenicës afër Fierit, e njohur kështu si *Gravura e Ardenicës*, përmban një mbishkrim të njëjtë në katër gjuhë, arumanisht, shqip, latinisht dhe greqisht. Atë së pari e ka zbuluar si gravurë më vete arkitekti korçar Jovan Adhami, i cili ia ka shitur Arkivitet të Shtetit më 1950. Pas botimit të një analize preliminare për të prej Dhimitër Shuteriqit, dy vjet më vonë, ku përveç të tjerash zbuloi se e njëjta ishte botuar edhe në një libër të vitit 1732, gravura ka bërë jehonë ndërkombëtare, mbi të gjitha, për faktin se në të ndeshet mbishkrimi më i vjetër në gjuhën arumune (khs. Demiraj 2019, 102; Shuteriqi 1976, 107; Shuteriqi 2005, 249). Arumanishtja dhe shqipja të kjo gravurë janë shkruar me germa greke. Por disa shenja aty janë të pazakonta. Autori i gravurës (dhe i librit), Nektar Tërpo, është një voskopojar (ndoshta arumun-shqiptar) që njihet relativisht mirë. Në periudhën për të cilën po flasim, ka shërbyer dhe predikuar në rrethin e Fierit dhe Elbasanit, veçanërisht me thirrje kundër konvertimeve të shumta të ortodoksëve të atyshëm në islam. Gravura e Ardenicës që shpërndarë e shtypur në Shqipëri si ilustrim më vete. Por e njëjta është përdorur në librin *Πιστις* (Pistis) që Tërpo e ka botuar e shtypur në Venedik (dhe ndoshta e ka gdhendur enkas për të), pas migrimit të tij përfundimtar atje më 1732. Tërpo ka vdekur rreth vitit 1741 sipas të gjitha gjasave në Venedik (Giakoumis 2017, 212; Garitsis 2002, 69–70).



Ilustrimi 3: Germa sipas alfabetit të sotëm të shqipes; shenja me të njëjtën vlerë në Kodikun e Beratit; shenja me të njëjtën vlerë në Gravurën e Ardenicës.

Të paktën më 1976 Shuteriqi kishte vërejtur, qysh u tha tashmë, se shkronja ‘V’ të tekstit shqip i gravurës ishte i njëjtë me ‘v’ të alfabetit të Beratit, që, natyrisht, duke qenë se bëhet fjalë për vetëm një shenjë, nuk ka zgjuar ndonjë interesim të studiuesit në kohën kur është publikuar. Ndërsa Bardhyl Demiraj, rishtazi ka identifikuar edhe germa të tjera që përkojnë nga këto dy mbishkrime (Demiraj 2019, 121–124). Demiraj pas një analize të thukët të historisë së gravurës, e pastaj dhe teksteve në katër gjuhët e


ndryshme të saj, flet për kodin alfabetik ku përveç shkronjës ‘V’ te fragmenti shqip që përkon me atë të Beratit (për çka nuk ngurron t’i referohet gjetjes së mëparshme nga Shuteriqi), vëren edhe shkronjat ‘c’ e ‘sh’ të jenë të një ‘grafie të huaj’ te njëri prej teksteve. Çka është ndoshta fakti më interesant, këto dy të fundit i veçon te fragmenti arumun dhe jo tek ai shqiptar. Pamja e tyre grafike, forma e shkronjave, por edhe vlerat fonetike jenë të njëjta (apo shumë të ngjashme) me alfabetin e Beratit, qysh pohon edhe Demiraj (2019, 124). Nëse kjo qëndron, atëherë duket e mundur se Tërpo e kishte njohur, e mbase dhe përdorur, një variant të këtij alfabeti rreth vitit 1731. Kjo e bën atë alfabetin origjinal më të hershëm të datuar të shqipes. Për më shumë, shembulli i gravurës flet për ndonjë përdorim eventual të këtij alfabeti edhe për arumanishten.



Ilustrimi 4: Gravura në faqen 366 të librit të Tërpos (1732) dhe shenjat që përkojnë me alfabetin e Beratit në këndin e poshtëm në të djathtë.

Çka nuk është vërejtur as nga Shuteriqi e as nga Demiraj është se te ky libër i Nektar Tërpos është edhe një gravurë tjetër, në faqen 366, ku paraqitet një pemë me 12 frutet e shpirtit të shenjtë nga shën Pali (‘To αγιων

Βαπτισμα Οι Καρποι του Αγίου πεν ενματος’) me disa simbole që përkojnë me ato të alfabetit të Beratit. Edhe kjo gravurë mban nënshkrimin e vetë Tërpos, këtë herë realizuar nga fshati Grabovë e Shpatit: “Kjo pemë është krijuar për herë të parë në fshatin Grabovë, të provincës së Shpatit në Berat më 15 gusht 1731 nga Nektar Tërpo.” Aty shenjat e alfabetit të Beratit, më saktë 11 prej tyre, shfaqen pa ndonjë kuptim specifik të identifikueshëm. Sidoqoftë, ngjashmëria e tyre me shenjat e alfabetit të Beratit është gjithsesi për t’u vënë re. Nëse e pranojmë se ato janë të njëjtat me alfabetin e Beratit, atëherë plot 9 prej tyre janë lehtë të identifikueshme dhe përkojnë me këto vlera: ‘b’, ‘x’, ‘d’, ‘e’, ‘nj’, ‘h’, ‘sh’, ‘c’, ‘ç’ (shih ilustrimin 5). Çka lë vetëm dy prej simboleve pa shpjegim. Duke qenë se *Kodiku i Beratit* është i mëvonshëm, lehtësisht mund të imagjinohet se këto të dy shenja mund të kenë qenë forma më të hershme të këtij alfabeti.



Ilustrimi 5: Në rreshtin e parë germat sipas paraqitjes së tyre në Kodikun e Beratit; Në rreshtin e dytë simbolet e paraqitur në gravurën e faqes 366 të librit të Nektar Tërpos (1732); dhe, në rreshtin e tretë vlerat fonetike sipas alfabetit të sotëm të gjuhës shqipe.


Përderisa ngjashmëria mes shenjave është me shumë interes, arsyet e prezencës në këtë gravurë, dhe renditjes së pazakontë, do të kërkojnë shqyrtime të mëtutjeshme. Një shpjegim i parë mund të jetë se kemi të bëjmë me paraqitje të germave nga një alfabet origjinal, por që paraqet vetëm vlerat fonetike që nuk i ka greqishtja; të tilla që përdoren për shqipen dhe ndoshta për arumanishten. Po të hiqen germat që i ka edhe alfabeti grek, edhe në renditjen e këtyre shenjave të gravurës ka ngjashmëri me renditjen e tyre te *Kodiku i Beratit* (shih ilustrimin 5). Por megjithatë, ky shpjegim nuk arsyet-

on përfshirjen e tyre në këtë gravurë, ku konteksti me ‘12 frutet e shën Palit’ s’ngjan të ketë ndonjë lidhje me alfabetet lokale. Për dallim prej teksteve të gravurës së parë, ku vlerat fonetike të shenjave i dimë saktë, këtu, të paktën në formën aktuale, duket e vështirë të flasim për një deshifrim të tyre. Sidoqoftë, të paktën për nga aspekti i formës, përkimet me alfabetin e Beratit është vështirë të përjashtohen lehtësisht, edhe po të lihet mënjanë fakti shumë i rëndësishëm se disa shenja të tij përkojnë edhe te gravura e parë jo veç në formë, por edhe në vlera fonetike. Duke u pajtuar me këtë tregues dhe duke u mjaftuar përkohësisht me shpjegimin për prezencën e tyre, nëse shtohen edhe këto 9 shenja te gravura e dytë e librit, atëherë përforcohet tutje mëtimi se në të dy rastet (te libri i Tërpos dhe te Kodiku i Beratit) kemi të bëjmë me të njëjtin alfabet, ose të paktën për variacione të tij. Një përdorim eventual i këtij alfabeti nga Tërpo më 1731 dëshmon për shtrirjen e tij përveç Beratit edhe në rajonin e Shpatit mes Elbasanit, e mbase edhe të Voskopojës prej nga ishte ky autor. E megjithatë, prezenca e alfabetit origjinal të Beratit nuk ndalet vetëm me këtë shembull.

Alfabeti i ‘shkurtshkrimit’: një alfabet origjinal i shqipes pak i studiuar

Anonimi i Elbasanit është një dokument me rëndësi, që ka të shkruara 59 faqe me pjesë nga ungjilli e me predikime fetare të përkthyer shqip. I shkruar në format fare të vogël, afërsisht A6, pjesa kryesore e materialit, më konkretisht 58 faqe të tij, janë shqip me një alfabet krejtësisht origjinal të papërdorur ndokund tjetër. Është ky një alfabet i studiuar relativisht mirë që njihet si alfabeti i Elbasanit, që kohët e fundit madje është regjistruar në regjistrin ndërkombëtar të shenjave Unicode. Ndërkohë, më pak i njohur, në faqen e parë të dokumentit është edhe një tekst tjetër i shkurtër, që Shuteriqi e quan ‘shkurtshkrim’, ende i pazbërthyer tërësisht me një alfabet të dytë, njësoj origjinal. *Anonimi i Elbasanit* është zbuluar në ditët e para të vitit 1949, dhe pjesa kryesore e tij rëndom mëtohet të jetë vepër e Grigorit të Durrësit (v. 1772), tipografit e klerikut voskopojar. Mahir Domi është i pari që ka ngritur hipotezën se Grigori i Durrësit mund të ketë qenë autor i pjesëve të ungjillit në këtë fletore. Ndërkohë që Shuteriqi, bazuar në një emër nga faqja e parë e dorëshkrimit, e mëtonte fillimisht një Papa Totasi e më

vonë një Theodor Bogumilin si autor të mundshëm. Bazuar në hipotezën e Domit, sipas datimit përmes shënimeve të koleksionistit helen Georgio Zambiras (1744–1804), studiuesi kanadez Robert Elsie e konsideronte *Anonimin* si të vitit 1761 (Elsie 1995, 112–118). Datë që ka vazhduar të përdoret edhe nga studiues të tjerë, edhe pse çështja kryesisht pranohet të jetë e pazgjidhur. Për të komplikuar gjërat edhe më, disa dëshmi të fundit nuk e përjashtojnë mundësinë që *Anonimi* të jetë vepër e Kozmait të Durrësit (v. 1702), mitropolitit me seli në manastirin e Gjon Vladimirit ku dhe është gjetur fletorja në Elbasan (Rugova 2022a, 21–38). Kjo hipotezë e dytë e bën më të vjetër fletoren, duke e lokalizuar atë në dekadat e fundit të shekullit XVII - më afër me mëtimet e Dhimitër Shuteriqit (1949) e Injac Zamputit (1965).



Ilustrimi 6: ‘Shkurtshkresa’ e Anonimit të Elbasanit, apo faqja e parë. Alfabeti i panjohur në të bashkë me disa vizatime zbukuruese. Në rreshtin e parafundit lexohet me shkronja greke *πα πα το τα σι* ‘pa pa to ta si’ që në shkrimet e hershme të Shuteriqit është konsideruar si emri i autorit të dorëshkrimit.

Alfabeti te faqja e parë e *Anonimit të Elbasanit*, është ndër të rrallët prej alfabeve origjinale të gjuhës shqipe (nëse mund të konsiderohet i tillë) që mbetet kryesisht i patrajtuar. Është konsideruar alfabet më vete i padeshifruar nga shumica e autorëve që kanë folur për të, përfshirë Zamputin (1949, 1951), Osmanin (1987) dhe Elsie-n (2017). Dhimitër Shuteriqi është i vetmi që ka bërë përpjekje serioze për ta deshifruar në verën e vitit 1978 (khs. Shuteriqi 1979, 3–43). Por rezultatet e tij nuk janë plotësisht të pranuar në komunitetin shkencor. Se alfabeti i Beratit ka ndonjë ngjashmëri me alfabetin e dytë (atë të shkurtskrimit) të *Anonimit të Elbasanit* duhet ta ketë dyshuar qysh herët Shuteriqi, duke qenë se leximi i tij i shkurtskrimit duket se bazohet mjaft shumë në vlerat fonetike të alfabetit të Beratit. Por për këtë çështje ka folur qartazi vetëm njëherë, në vitin 2005, dhe atë vetëm për një-rën shkronjë, ku thotë se tek alfabeti origjinal i *Kodikut të Beratit* “germa “f” është e njëjta me atë të alfabetit origjinal të Theodhor Bogomilit. Tekste të tjera me alfabetin origjinal beratas nuk njohim” (Shuteriqi 2005: 294). Këtu “alfabeti origjinal i Theodhor Bogomilit” i referohet alfabetit në faqen e parë, apo shkurtskrimit të *Anonimit të Elbasanit*. Ky e nxjerr alfabetin e shkurtskrimit si të derivuar nga ai glagolitik; e sjell një pasqyrë të tij, ku sakaq nxjerr në tërësi 21 shenja, përfshirë katër nga alfabeti grek (Shuteriqi 1979, 14–18). Qysh do të shohim dhe në vijim, po të paraqesim këtë alfabet përkitazi me atë të Beratit dhe po të përjashtojmë rreshtin e emrit Papa Totasi, që qartazi është shkruar me alfabet grek, na dalin 20 shenja në këtë fletë dhe jo 21 sa thotë Shuteriqi. Në anën tjetër, çka është me interes për temën tonë, plot 14 nga 20 gjerat e këtij alfabeti të shkurtskrimit përkojnë gati plotësisht me ato të alfabetit beratas. Ndërkohë që edhe shenjat e mbetura kanë ngjashmëri.




Ilustrimi 7: Katërmbëdhjetë shenja të alfabetit të Beratit krahas atyre nga shkurtskrimi i Elbasanit. 1) Shenja nga Kodiku i Beratit në faqen 106; 2) Shenja në shkurtskrimin e Elbasanit; 3) Shenja nga Kodiku i Beratit në faqe 104. Si shenjë e pesëmbëdhjetë, në ilustrim është paraqitur edhe grafia e mundshme për germën ‘g’ e cila nuk figuron te *Kodiku i Beratit*.

Po të vendosen përballë njëra tjetrës shkronjat origjinale nga shkurtskresa dhe nga *Kodiku i Beratit*, është e vështirë të mos vërehen përkimet. Duke përdorur vlerat fonetike të alfabetit të Beratit në shkurtskresën e Elbasanit lexojmë këto fjalë:

[?]alpigo[?]s [?]almo[?][?]
 theodhoro[?]s
 bogomilo[?]s
 tholoro[?][?]
 egrigoro[?][?]
 glo[?]a[?][?]o
 kalamo[?]s
 o[?][?]igraf[?]
 papa totasi [me germa greke]
 oreo[?]skali


Sipas këtij transliterimi, të vërejtur janë kryesisht emra. Bien në sy, ‘Theodhor’, ‘Bogomil’ dhe ‘Grigor’. Jo të gjitha gerrat janë të identifikueshme përmes këtij alfabeti, ose të paktën jo lehtësisht të identifikueshme.

Germa ‘g’ që supozohet këtu, për shembull, nuk haset te *Kodiku i Beratit*. Në këtë kodik kjo germë nuk ka shenjë fare. Ndërkohë që në faqen e parë të *Anonimit të Elbasanit* në total nëntë radhët janë të shkruara në këtë mbi-shkrim me 20 shenja të ndryshme (nëse përjashtojmë rreshtin me germa greke). Përveç emrave ndonjë fjalë tjetër është vështirë e veçueshme. Nuk duhet përjashtuar mundësia që teksti në këtë faqe, me këtë alfabet, të jetë shkruar në ndonjë gjuhë tjetër, si arumanishtja për shembull.



Ilustrimi 8a: Alfabeti i shkurtshkrimit dhe vlerat fonetike sipas alfabetit të sotëm të shqipes me 20 shenja.

Disa prej shenjave janë identike me alfabetin e Beratit, e disa të tjera janë të ngjashme. Qysh mund të shihet edhe nga ilustrimi i mësipërm (nr. 8a), pesë shenjat për të cilat nuk jemi të sigurt, u kemi vënë numrat 9, 15, 16, 17 dhe 18. Prej tyre e 9-ta mund të jetë e lidhur me germën ‘ë’ tek alfabeti i Beratit, e 16-ta me germën ‘u’, kurse e 18-ta me ligaturën ‘io’. Numri 15, mund të jetë ‘ps’ qysh mendon edhe Shuteriqi, e që e ngjashme është edhe tek alfabeti i Beratit, kurse për numrin 17 nuk kemi ndonjë përputhje me këtë alfabet. Por, në përgjithësi, nuk duket fare e pamundur se kemi të bëjmë edhe këtu me një variant të këtij alfabeti, nga një kohë e panjohur që mund të ketë qenë mes fundit të shekullit XVII dhe përgjatë gjithë shekullit XVIII. Alfabeti i Beratit në faqen e parë të kësaj fletoreje mund të sjellë hipoteza të reja edhe për origjinën e alfabeteve origjinale të shqipes. Por edhe për mesin ku ato janë krijuar. Me këtë përkim alfabeti i Beratit, në kohë arrin deri në shekullin XVII, kurse gjeografikisht deri në Elbasan. Se ku ka qenë qendra e këtij alfabeti, nuk mund të thuhet ende me siguri, por tre-këndëshi Voskopojë-Elbasan-Berat duket një mes i mundshëm.




Ilustrimi 8b: Alfabeti i Kodikut të Beratit (në faqen 106) dhe vlerat fonetike sipas alfabetit grek që i ka sjellë vetë autori në kodik.

Shtigje të reja: hipoteza

Identifikimet e reja me alfabetin e Beratit jo vetëm zgjerojnë shtrirjen kohore dhe gjeografike të këtij alfabeti, por edhe e bëjnë më të dukshme ndërlidhjen mes alfabeteve dhe autorëve të alfabeteve origjinale në shekullin XVIII për gjuhën shqipe. Kjo na ndihmon të bëjmë edhe disa krehje të reja sa u përket autorëve të mëtuar të alfabeteve karshi materialeve dokumentare të gjetura. Së këndejmi, duhet të bëjmë një dallim mes alfabeteve origjinale të shqipes që janë të dëshmuara dhe atyre që përmenden në dokumente të kohës se janë krijuar nga njëri autor apo tjetri. Në grupin e parë (po të marrim alfabetin e Beratit si të njëjtin me ‘shkurt-shkresën’ e Elbasanit dhe me ato shenja në gravurat e Nektar Tërpos), atëherë këto na dalin alfabetet më të hershme të gjuhës shqipe: alfabeti i Elbasanit, alfabeti i Beratit dhe alfabeti i Todhrit. Të tria këto vijnë para vitit 1800 dhe janë të ruajtura në një formë apo tjetrën në dokumente arkivore. Të grupit të dytë i takojnë dëshmitë historike që ndodhen nëpër burime të ndryshme të kohës. Më e hershmja këtu është dëshmia nga Anastas Mihail Maqedonasi (c. 1675–1725), në vitin 1710 që flet për një alfabet origjinal të shqipes të përpiluar nga Kozmai i Durrësit, pastaj dëshmia e Zavirës e para vitit 1804 për Grigorin e Durrësit si përpilues të një alfabeti të shqipes dhe përkthyes i dhiatave në shqip. Dhe i fundit Hahn në vitin 1851 që flet për Theodhor Haxhifilipin (v. 1801) dhe alfabetin e tij origjinal në Elbasan nga fundi i shekullit XVIII.

Prej tyre me njëfarë sigurie (edhe pse jo me siguri absolute) sall Theodor Haxhifilipit mund t'i atribuohet alfabeti i Todhrit, që dhe mban emrin e tij. Dy autorët dhe dy alfabetet e tjera vetëm përmes provave tepër të pasigurta mund t'i drejtojmë në anë të caktuara: Alfabeti i Elbasanit mund të jetë i Kozmait të Durrësit, duke qenë se ky është i dëshmuar më mirë në manastirin e Gjon Vladimirit në Shijon pranë Elbasanit. Kjo e çon alfabetin dhe tekstin e *Anonimit* në vitet 1682-1702 kur Kozmai ka jetuar në Elbasan. Kurse alfabetin e Beratit në pamundësi për të identifikuar ndonjë emër tjetër (pos Tërpos), e duke qëndruar në ujëra të thella të spekulimit mund t'ia atribuojmë edhe Grigorit të Durrësit. Më shumë për shkak të prezencës së tij të gjatë në Voskopojë, prej nga ishte edhe Tërpo që duket se e ka njohur këtë alfabet. Kjo e bën përhapjen e alfabetit të shkurtshkrimit dhe vetë shkurtshkrimin t'i takojë periudhës rreth vitit 1730 dhe në vitet vijuese, kur Grigori ishte në kohën më aktive të tij. Në anën tjetër, analiza mes këtyre alfabeteve origjinale të kësaj kohe tregon dallime shumë të mëdha mes tyre. Por duhet vënë re se alfabeti i Todhrit, që duhet të jetë më i ri se ai i Beratit, mund të ketë pasur njëfarë influence prej të parit. Ngjashmëria më e madhe vërehet te përdorimi i germës 'd' e 'dh' te Berati në formë identike për të dhënë 'g' e 'gj' te Todhri. Pastaj 'c' te Berati jep 'sh' te Todhri. Në anën tjetër germa 'ë' mund të jetë e njëjtë te të dy (shih ilustrimin 9). Në përgjithësi, logjika e alfabetit të Beratit dhe të Todhrit kanë përafrime, përderisa alfabeti i Elbasanit është krejt i ndryshëm nga të dy. Në skenarin shumë hipotetik ku Grigori i Durrësit pranohet si autor i alfabetit të Beratit, këto ngjashmëri mes alfabetit të Beratit me atë të Todhrit mund të flasin për një influencim (më shumë në formë inspirimi, p.sh. të nxënësit nga mësuesi) të Theodor Haxhifilipit nga forma e alfabetit paraprak të cilin mund ta ketë njohur.



Ilustrimi 9: Lart, disa prej shenjave nga alfabeti i Beratit, ashtu siç paraqiten në *Kodikun e Beratit*; Poshtë, shenja të ngjashme në

alfabetin e Todhrit siç i paraqet Kostandin Kristoforidhi në një letër të tij të vitit 1853 (DPA, Fondi Kostandin Kristoforidhi, F29D1–6). Veçanërisht në rastin e formimit të “gj” nga “g” te Todhri vërehet ngjashmëria me alfabetin e Beratit, përkatësisht me formimin e “d” dhe “dh”. Duke qenë se në gjuhën greke ekziston shkronja “dh”, por jo “d”, është e natyrshme që tek alfabeti i Beratit “dh” e ka një hark, kurse “d” i ka dy, që është e kundërta te Todhri me shkronjat “g” dhe “gj” ku e para është e me një hark, kurse e dyta me dy.

Po të pranojmë autorë të mëtuar me alfabete të zbuluara, skema e re e thjeshtuar mund të duket kështu:

Autorë të cituar nga burime të kohës:	Alfabetet të zbuluar në dokumente të kohës:
Kozmai i Durrësit, Elbasan →	Alfabeti i Elbasanit, Elbasan*
Grigori i Durrësit, Voskopojë / Elbasan →	Alfabeti i Beratit, Berat / Elbasan*
Theodhor Haxhifilipi, Elbasan →	Alfabeti i Todhrit, Elbasan

* Vetëm supozim.

Ky është veç një skicim tepër hipotetik në bazë të disa të dhënave që u paraqitën këtu. Kjo temë vazhdon të mbetet ende larg prej të qenit e mbyllur. Natyrisht, në teori mbetet gjithnjë e mundur se alfabeti i Beratit, ai i Elbasanit dhe dy alfabetet që mëtohet se janë shpikur nga Kozmai i Durrësit e Grigori i Durrësit janë të gjitha veç e veç vepra më vete. Kur e shtojmë këtu edhe alfabetin e Todhrit do t’i binte se plot pesë alfabetet kanë qarkulluar në këtë mes në shekullin XVIII. Është edhe kjo një arsye pse skema e mësipërme, me tre alfabetet, duket të paktën për një grimë më e besueshme.

Përfundim

Alfabeti i Beratit megjithëse i dëshmuar në vetëm pak fjalë dhe në pak dokumente, është me rëndësi, sepse është më i hershmi i datuar deri më tash. Nëse pranohen dëshmitë e paraqitura së fundmi, bashkë me ato që u sollën këtu, data 1731 është më e vonshme kur ka mundur të sajohet ky alfabet. Ndërkohë, rëndësia e tij rritet edhe nga shtrirja gjeografike në gjithë trekëndëshin Berat, Elbasan dhe Voskopojë. Ky alfabet, sipas argumenteve

që kemi paraqitur, është përdorur në ndonjë formë të tij në *Kodikun e Beratit* nga shekulli XVIII, në dy gravura e voskopojarit Nektar Tërpo dhe në faqen e parë apo ‘shkurtshkresën’ tek *Anonimi i Elbasanit*. Alfabetet origjinale të gjuhës shqipe janë një fenomen karakteristik i historisë së kulturës shqiptare, ngase përfaqësojnë, sado me vonesë, nevojën për shprehje të veçantisë gjuhësore përmes alfabetit. Në një mes ku popujt identifikoheshin me alfabetet, shqiptarët duket se e kanë parë atë si çelës me rëndësi të formësimit të tyre identitar, madje edhe në kohën para formësimit modern të identiteteve kombëtare. Nuk është pa rëndësi një tekst nga mbarimi i shekullit XVII që në mënyrë përçmuese paraqet shqiptarët si popull pa alfabet, të detyruar kështu që të huazojnë shkronja nga popujt tjerë. Anekdota të tilla për alfabetin e shqiptarëve janë dëshmuar mirë edhe përgjatë shekullit XIX dhe mund të shihen si sinjale që çështja e alfabetit për shqiptarët ishte me shumë rëndësi. Me gjithë vështirësitë nga mungesa e dëshmive të qarta, në këtë artikull kemi tentuar përmes provave kontekstuale të ndërtojmë edhe një skemë që ndërlidh alfabetet origjinale të dëshmuara, me autorët e përmendur nëpërmjet shënimeve të kohës. Në këtë kuptim, përveç alfabetit të Todhrit që kuptueshëm duhet të jetë i Theodor Haxhifilipit, në dritën e asaj që është thënë këtu, kemi sjellë argumente pse Kozmai i Durrësit mund të jetë autor i *Anonimit të Elbasanit*, ndërkohë që Grigori i Durrësit mund të jetë autor i të ashtuquajturit alfabet të Beratit. Ravijëzim, sado hipotetik, që gjithsesi ndryshojnë ndjeshëm koordinatat kohore dhe gjeografike të historisë së alfabeveve origjinale të gjuhës shqipe.

Bibliografi:

- BISH (1948). Dokumenti Nr. 5093. Zbulim i njëj dorëshkrimi të vjetër shqip. Në *Buletini i Institutit të Shkencave*, Tiranë (2) 2-3, f. 79
- Cipranlis, Zakarias: Ζαχαρίας Ν. Τσιρπανλής (1996). Μορφές επικοινωνίας του Κυπριακού μοναχισμού με την Καθολική Δύση (17ος αι.). Në *Δωδώνη* (25), 121–145.
- Demiraj, Bardhyl (2019). Enigma e Gravurës së Ardenicës. Në *Shëjzat – Le Pleiadi*, (1-2), 101–129.
- (2019a). *Kodiku Beratash – O Mπερατινός κώδικας (me një botim kritik të pjesës shqip të përgatitur nga Bardhyl Demiraj)*. Tiranë: ASHSH.
- (2020). Dorëshkrimi shqip në Bibliotekën Ambrosiane të Milanos. Në *Studime*, Prishtinë (26), 43–104.
- Domi, Mahir (1965). Rreth autorit dhe kohës së dorëshkrimit elbasanas me shqipërim copash të ungjillit. Në *Konferenca e parë e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 170–7.
- (1968). Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit (14-22 nëndor, 1908). Në *Studime Filologjike*, Tiranë (4), 71–102.
- Elsie, Robert (1995). The Elbasan Gospel Manuscript (Anonimi i Elbasanit), 1761, and the struggle for an original Albanian alphabet. Në *Südost-Forschungen* (54), 105–159.
- (2017). *Albanian Alphabets: Borrowed and Invented*. Londër: Centre for Albanian Studies. (Kindle Edition)
- Floristán, José M. (2006). Profesión de fe de Cosme Maurudes, obispo de Citio (Chipre) [1674]. Në *Orientalia Christiana Periodica* (72), 349–381.
- Garitsis, Konstantinos: Κωνσταντίνος Γαρίτσης (2002). *Ο Νεκτάριος Τέρπος και το έργο του*. Athinë: Θεσβιτησ.
- Giakoumis, Konstantinos (2017). Textual Visuality & Visual Textuality in Texts Correlated with Artworks: Nektarios Terpos' Pistis and Last Judgement Scenes from Myzeqe, central Albania. Në E. Moutafov, J. Erdeljan (red.) *Τεκτομε Χαδνucu Οβραζυ Texts Inscriptions Images Art Readings Thematic annual peer-reviewed edition in Art Studies in two volumes 2016* (1), 203–244.

- (2023). Ο Κυτίου Κοσμάς Μαυρουδής (1643-1702) και η Πραγματιστική Εκκλησιαστική Πολιτική του Δράση. Në *Βότρυς* (3), 51–58.
- Hahn, Johann Georg (1850). Bemerkungen über das albanesische Alphabet. Në *Sitzungsberichte der Kaiserlichen akademie der Wissenschaften. Phil.-hist. Classe*, Vjenë, (5) 6–10, 841–867.
- Hetzer, Armin (1982). Der sogenannte Kodex von Berat. II: Untersuchungen zu einer anonymen griechisch-albanischen Handschrift vom Ende des 18. Jahrhunderts. Në *Südost-Forschungen*, 1 (1), 131–179.
- Kolea, Sotir (1931). *Vepërij e Biblejotekës Kombëtare gjatë vitit 1930*. Tiranë.
- Koliqi, Ernest / Ressuli, Namik (1941). *Shkrimtarët shqiptarë. Pjesa I (1462-1878)*. Tiranë: Ministria e Arsimit.
- Kurilla, Evlogji: Κουρίλας Ευλόγιος (1935). *Γρηγόριος ο Αργυροκαστρίτης ο μεταφραστής της Καινής Διαθήκης εις το Αλβανικόν: ήτοι αι βάσεις της αλβανικής φιλολογίας και γλώσσης*. Athinë: Φοίνικος.
- Legrand, Emile (1903). *Bibliographie Helenique, 17e siecle. Vëll V*. Paris: J. Maisonneuve et E. Guilmoto.
- Lloshi, Xhevat (2008). *Rreth alfabetit të shqipes: me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit*. Shkup: Logos-A.
- Misha, Piro (2020). *Thesare të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë*. Tiranë: BKSJ.
- Omari, Anila (2018). Tradita letrare e Elbasanit si pasojë e iluminizmit gjuhësor me rrezatim nga Voskopoja. Në *Qytetërimi i Voskopojes dhe shekulli i iluminizmit në Ballkan*, Konferencë shkencore ndërkombëtare, Tiranë, 278–293
- Osmani, Tomor (1987). *Histori e alfabetit të gjuhës shqipe*. Tiranë: Mihal Duri.
- Papadopulous, Hristosomos: Χρυσοστομος J. Παπαδοπουλας (1912). Ο Μητροπολιτην Κιτιου επι τοις εγκμνιοις του Παρθεναγωγειου Αενεσου. Në *Εκκλησιαστικοσ Κηρυξ*, (B). 23–26.
- Peyfuss, Max Demeter (2002). *Shtypshkronja e Voskopojes 1731–1769*. Tiranë: IDK.
- Qafëzezi, Ilo M (1938). Shkrimtarë shqipëtarë të qindjeteve XVII e XVIII Don Pjetër Budi - Gurrabardhi e Kostë Ieromonaku-Berati 1664-1764. Në *Leka* 10 (6–7), 291–5.

- Qirjazi, Dhori (2015). “Why Gypsies and Albanians Do Not Have Their Own Letters”. *Greek Attitudes Towards Neighbouring Languages During the 19th Century*. Në *Slavia Meridionalis* (15), 228–240.
- (2015a). Tri dokumente për shqipen dhe shqiptarët, të viteve 1850. Në *Studime në nderim të prof. Francesco Altimarit me rastin e 60-vjetorit të lindjes*, Tiranë, 555–71.
- Ressuli, Namik (1937). Historia e Alfabetit shqip. Në *Shkolla Kombtare*, Tiranë 1 (5), 10–12.
- (1938). Abecea e Dorëshkrimit Beratas dhe Abecea e Thodër Haxhi Filipit. Në *Leka*, 10 (4-5), 181–185.
- Rugova, Yll (2022). *Tipografia shqiptare 1555–1912*. Prishtinë: Varg Trembelat.
- (2022a). Dëshmi mbi një alfabet origjinal të shqipes nga shekulli XVII: Kozmai i Durrësit si shpikës i mundshëm i alfabetit të parë origjinal të shqipes. Në *Shëzjat pleiades* (2–3), 21–38.
- (2023). Katekizmi i Elbasanit me alfabetin e Todhrit nga mesi i shekullit XIX. Në *Studime Filologjike* (1–2), 119–136.
- Sinani, Shaban (2003). *Kodikët e Shqipërisë*. Tiranë: DPA.
- Shuteriqi, Dhimitër (1949). Anonimi i Elbasanit shkrimi shqip n’Elbasan në shekujt XVIII-XIX dhe Dhaskal Todhri. Në *Buletin i Institutit të Shkencave*, (3) 1, 33–54.
- (1965). Diskutim rreth kumtesës së prof. M. Domit. Në *Konferenca e parë e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 396–8.
- (1973). Dhaskal Todhri. Në *Nëpër shekujt letrarë: Studime*, Tiranë, 82–113.
- (1976). *Shkrimet shqipe në vitet 1332–1850*. Tiranë.
- (1979). Në kërkim të origjinave të shqipes së shkruar. Në *Mbi Barletin the shkrime të tjera*, Tiranë, 3–43.
- (1979a). Një alfabet i nëntë origjinal i gjuhës shqipe. Në *Rilindja*, 18 gusht (7325) 35, 14.
- (1987). Grigor Voskopojari — i quajtur i Durrësit. Në *Marin Beçikemi dhe shkrime të tjera*, Tiranë, 103–126.
- (2005). *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879–1800*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.

- Shuteriqi, Dh. / Bihiku, K. / Domi, M. (1959). *Historia e letërsisë shqipe*. Vëllimi I. Tiranë: Mihal Duri.
- Terpos, Nektarios: Τέρπος, Νεκτάριος (1732). *Βιβλιάριο καλούμενον Πίστις*. Venedik: Nikolao to Saros.
- di Venezia, Pietro-Antonio (1688). *Historia serafica, overo cronica della provincia di S. Antonio, detta anco di Venezia, de Min. Oss. Riformati*. Venedik: Francesco Valuasense.
- Vokshi, Hasan / Nimani, Elhami / Hatipi, Tajar (1954). *Antologji e letërsisë shqipe*. Prishtinë: Mustafa Bakija.
- Zamputi, Injac (1949). Disa shënime rreth alfabetit të dorëshkrimit të Anonimit Elbasanas. Në *Buletin i Institutit të Shkencave*, Tiranë (3) 1, 55–57.
- (1951). Dorëshkrimi i Anonimit t'Elbasanit: transliterim, transkriptim dhe koment. Në *Buletin i Institutit të Shkencave*, Tiranë (5) 3–4, 64–131.
- (1965). Diskutim rreth kumtesës së prof. M. Domit. Në *Konferenca e parë e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 399–400.

Adelajda BAFTIU

DIZAJNI I KORPUSIT TË FOLUR NË KOSOVË

1. Hyrje

Kosova ndodhet në Evropën Juglindore, përkatësisht në Gadishullin Ballkanik. Në veri e lindje kufizohet me Serbinë, në juglindje me Maqedoninë e Veriut, në jugperëndim me Shqipërinë dhe në perëndim me Malin e Zi. Popullsia që jeton në Kosovë, është me shumicë shqiptare, por jetojnë edhe bashkësi etnike të tjera. Sipas të dhënave të Entit Statistikor të Kosovës, 2011, popullsia e Kosovës përbëhet kryesisht nga bashkësia etnike shqiptare, që formon 88-92 për qind të banorëve; shqiptarët përbëjnë 88% të popullsisë, serbët janë bashkësia e dytë me 5.3%, të përcjellë nga turqit, boshnjakët, romët, ashkalinjtë, egjiptasit dhe goranët. Ka një sipërfaqe prej 10.880 km² dhe popullsi prej 1.9 milionë banorësh. Kosova i ka 38 komuna me 1.469 vendbanime.

Gjuhë zyrtare në Kosovë janë shqipja dhe serbishtja. Pas luftës së viteve 1998-99 dhe çlirimit të Kosovës, si gjuhë me status zyrtar kanë funksionuar anglishtja, shqipja dhe serbishtja. Kushtetuta e Republikës së Kosovës u garanton shqipes dhe serbishtes statusin e gjuhës zyrtare, ndërsa statusin e gjuhës së minoriteteve gjuhës boshnjake, turke dhe rome. Në Maqedoni gjuha shqipe e ka statusin e gjuhës zyrtare në bashkësitë ku folësit e shqipes përbëjnë 20% të popullatës, në Malin e Zi dhe në Luginën e Preshevës shqipja e ka statusin e gjuhës minoritare, në Italinë e Jugut statusin e gjuhës së grupit etnik sipas Kartës Europiane të Gjuhëve Minoritare, në Greqi dhe në Turqi statusin e gjuhës pa status, njëjtë si në pjesët e tjera të diasporës (Ismajli 2019: 323). Në tërësi, popullata shqiptare e sotme në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi, sipas prejardhjes fetare, ndahet në:

80% myslimanë, 12% ortodoksë dhe 8 % katolikë. Përpjesëtimi fetar i shqiptarëve në Kosovë është në përgjithësi 95 % shqiptarë myslimanë dhe 5% shqiptarë katolikë (Malcolm 2011: 49).

Shqipja sot flitet në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoni, në Mal të Zi, në Luginë të Preshevës, në Greqi, në Itali, në Zvicër, në Austri, në Gjermani, në Skandinavi, në Amerikë, në Turqi, etj. Ajo përbën një degë më vete në rrethin e gjuhëve indoeuropiane. Tekstet e para të shkruara në gjuhën shqipe i përkasin shek. XV. Zhvillimet brenda shqipes janë bërë historikisht ndërmjet dy dialekteve kryesore: gegnishtes në veri dhe toskërishtes në jug të lumit Shkumbin. Këto dialekte ndahen tutje në veri *gegnishtja jugore, gegnishtja qendrore, gegnishtja veriperëndimore/verilindore*; në jug –*toskërishtja veriore, labërishtja dhe çamërishtja* dhe më tej *arvanishtja* dhe *ar-bërishtja* (Ismajli 2019: 346-348). Gjuha letrare e njësuar e shqipes është mbështetur në variantin e toskërishtes me disa elemente nga gegnishtja në Kongresin e Drejtshkrimit, në vitin 1972.

Për shkak se shqipja është e shpërndarë në disa shtete të ndryshme, herë si gjuhë e parë, herë si gjuhë e dytë, edhe ndikimet gjuhësore vijnë nga gjuhë të ndryshme. P.sh. në Shqipëri folësit kanë kontakte më të shpeshta me italishten e greqishten, në Mal të Zi shqipfolësit janë në kontakt me malazezishten, folësit e Luginës së Preshevës dhe një pjesë e Kosovës me serbishten; shqipfolësit e Maqedonisë me maqedonishten, ndërkohë që në Shqipëri mungojnë kontaktet me këto gjuhë; pastaj janë kontaktet me turqishten, me gjermanishten të disa breza në Kosovë, në Maqedoni, në Preshevë, në Mal të Zi, të cilat po ashtu mungojnë në Shqipëri. Në Kosovë ka përhapje të anglishtes e gjermanishtes, ndërsa në Shqipëri të italishtes (Ismajli 2019: 41).

2. Objekti i studimit

Objekt i këtij studimi është krijimi i një aparature shkencore për përpilimin e korpusit të folur në Kosovë. Studimi është mbështetur në hipotezën se korpusi i mbledhur në këtë punim do të jetë përfaqësues i shqipes së folur në Kosovë dhe do të përfaqësojë varietetet rajonale dhe shoqërore të shqipes së folur në Kosovë. Këtë hipotezë jemi përpjekur ta vërtetojmë përmes metodës statistikore dhe përmes qasjeve kryesore që përdoren për krijimin e korpusit.

3. Metoda e studimit

Dy qasjet kryesore që përdoren në gjuhësinë e korpusit janë qasja e bazuar në korpus dhe qasja e drejtuar nga korpusi. Tognini-Bonelli (2001: 65-84) e bën këtë ndarje dhe thekson se korpusi mund të përdoret në disa mënyra që ta vërtetojë, ta ilustrojë apo ta ndërtojë një teori të gjuhës. Qasja e bazuar në korpus (*The corpus based approach*) i referohet metodologjisë që përfiton nga korpusi, kryesisht për t'i shpjeguar, për t'i testuar apo për t'i ilustruar teoritë dhe përshkrimet. Ndërsa, qasja e drejtuar nga korpusi (*The corpus driven approach*) e përdor korpusin për ta mbështetur argumentin gjuhësor ose për ta vërtetuar një qëndrim teorik. Në këtë studim do të përdoret qasja e bazuar në korpus, sepse shembujt që dalin nga korpusi synohen të jenë përfaqësues të shqipes së folur në Kosovë. Qëllimi i këtij studimi është mbledhja dhe përpilimi i korpusit të folur në Kosovë.

Fillimisht, përpara mbledhjes së intervistave, është kërkuar leja e subjekteve që të marrin pjesë në hulumtim dhe leja për publikimin e incizimeve të tyre, duke ua shpjeguar se do të integrohen në korpusin e folur të shqipes në Kosovë. Meqenëse korpusi synon të jetë përfaqësues i gjuhës së folur në Kosovë, në hulumtim janë përfshirë të gjitha komunat e Kosovës, përveç komunave me shumicë nga bashkësi të tjera etnike, si: Mitrovica Veriore, Leposaviqi, Zubin Potoku, Ranillugu, Klllokoti, Parteshi dhe Mamusha.

Ky korpus synon të ketë 500.000 fjalë, rreth 2.000 incizime/mostra, secila mostër përafërsisht të ketë 250 fjalë. Kohëzgjatja mesatare e incizimeve është 6 minuta. Numri i intervistave në secilin qytet është vendosur duke u bazuar në numrin e banorëve të asaj komune dhe në numrin e fshatrave, p.sh.: nëse Prishtina i ka 208.230 banorë dhe 42 fshatra, në këtë komunë është dashur të mbledhen afërsisht 200 intervista, 1 intervistë në 1000 banorë, pra në secilin fshat së paku nga 2-3 intervista. Ndërsa, te komunat me shumicë serbe nuk është marrë parasysh numri i përgjithshëm i banorëve, por janë marrë intervista vetëm në ato fshatra të banuara me shqiptarë, p.sh.: në Komunën e Graçanicës, nga dy fshatra të banuara me shqiptarë, janë marrë nga 5-6 intervista në secilin fshat. Mbledhja e intervistave ka filluar në vitin 2019 dhe ka përfunduar në vitin 2021. Korpusi përmban vetëm tekste të folura joformale nga komentime për ngjarje të ndryshme, biseda brenda familjes, bisedë ndërmjet folësve që e njohin njëri-tjetrin dhe ndërmjet atyre

që nuk e njohin fare njëri-tjetrin, biseda telefonike. Shumica e incizimeve janë kryer përmes intervistave joformale, me pyetje të përgatitura në varietetin e shqipes së folur në Kosovë, me qëllim që edhe folësit të përgjigjen në të njëjtin varietet. Në shumicën e incizimeve subjektet kanë rrëfyer ngjarje të rëndësishme të jetës së tyre, kanë treguar si e kalojnë një ditë të zakonshme pune dhe kanë folur për profesionet e tyre.

Mjedisi apo vendi ku janë kryer pjesa më e madhe e intervistave ka qenë nëpër shtëpi, shkolla, universitete, dyqane, sheshe, kafene, zyra etj. Zakonisht, gjatë intervistave ka pasur të pranishëm edhe pjesëmarrës të tjerë, përveç atij që është intervistuar, qoftë familjar apo ndonjë person i panjohur. Mjetet që janë përdorur për incizimin e intervistave janë: diktafoni, telefoni *Samsung* dhe *Iphone*. Pas intervistës, është plotësuar anketa nga subjektet me këto të dhëna: vendlindja, vendbanimi, mosha, gjinia, profesioni, shkollimi, gjuha amtare dhe gjuhët e huaja. Secila anketë pastaj është ruajtur edhe në format elektronik në *Word* me të njëjtin emërtim si incizimi, p.sh.: *Prishtinë, 1, Prishtinë, 2* etj. I njëjti emërtim është vendosur edhe te transkriptimet. Transkriptimi i regjistrimeve është bërë me programin *Partitur Editor*.

4. Gjuhësia e korpusit

Analiza e të dhënave gjuhësore, mbështetur në koleksione tekstesh të folura ose të shkruara që ruhen në format elektronik, njihet si gjuhësi korpusi. Disa autorë gjuhësinë e korpusit e konsiderojnë si disiplinë më vete, ndërsa disa të tjerë thjesht si metodologji. Sipas McEnery dhe Wilson (1996), gjuhësia e korpusit nuk është fushë e gjuhësisë e krahasueshme me sintaksën, semantikën, sociolinguistikën, sepse këto disiplina koncentrohen në përshkrimin e disa aspekteve të përdorimit të gjuhës, ndërsa gjuhësia e korpusit është më shumë metodologji. Të njëjtin mendim ndan edhe Kennedy (1998), megjithëse thekson se gjuhësia e korpusit shkon përtej përdorimit të saj si burim provash në përshkrimin gjuhësor. Në anën tjetër, Leech (1992) e definojnë si një qasje të re kërkimore e filozofike ndaj temës. Gjuhësinë e korpusit si disiplinë e shohin autorë si Tognini-Bonelli (2001), ajo thekson se gjuhësia e korpusit shkon përtej rolit të pastër metodologjik. Edhe McEnery dhe Hardie (2012) në studime të mëvonshme thonë se gjuhësia e

korpusit e ka potencialin për ta riorientuar tërë qasjen tonë për studimin e gjuhës dhe mund të rafinojë e të ripërcaktojë një varg teorish të gjuhës, pra është një fushë heterogjene. Baker (2010: 1) po ashtu thekson rëndësinë që ka pasur gjuhësia e korpusit në njëzet vitet e fundit si një qasje për studimin e gjuhës dhe pranimin si një mënyrë e rëndësishme dhe e dobishme e kërkimit gjuhësor. Pra, mund të pranohet se gjuhësia e korpusit shkon përtej rolit të saj si metodologji.

Kjo metodë e analizës bazuar në kërkimin e detajuar të fjalëve dhe të frazave në kontekste të ndryshme me sasi të mëdha tekstesh ka filluar në shekullin XIII, kur studiuesit biblikë në mënyrë manuale kanë hartuar fjalët e biblës rresht për rresht. Vitet 1195 – 1231 lidhen me konkordancën e parë anonime të biblës, e njohur si *Concordantiae Morales* (McCarthy dhe Anne O’Keefe 2010:3). Pra, përpara korpusit elektronik, kishte një traditë të konsiderueshme të analizave gjuhësore të bazuara në korpus.

Në vitin 1961 filloi planifikimi i korpusit elektronik për hulumtime gjuhësore. *Korpusi i Brownit* është korpusi i parë kompjuterik i përpiluar për qëllime gjuhësore nga Nelson Francis dhe Henry Kučera (1964). Ky korpus kishte për qëllim të shërbente si standard i krahasimeve për “studime dhe analiza të anglishtes së sotme” (Kennedy 1998: 23-26, Teubert 2004: 108, Baker 2010: 12, Tognini-Bonelli 2001: 52). Gjenerata e dytë e korpusit u përket viteve 1990 dhe *Korpusi Nacional Britanik (British National Corpus)* është shembulli prototip me 100 milionë fjalë. Gjenerata e tretë përfshin *Korpusin Internacional të Kembrijit (Cambridge International Corpus)* me një miliard fjalë në vitin 2007 (Baker 2010: 13).

Studimet në fushën e gjuhësisë së korpusit në gjuhën shqipe kanë nisur vonë, në krahasim me gjuhët me të cilat shqipja është në kontakt. Pas vitit 2000 jepen vërejtjet e para për nevojën e krijimit të një korpusi në gjuhën shqipe. Korpusi i parë me një milion fjalë në gjuhën shqipe është korpusi i përpiluar nga N. Caka dhe A. Caka në vitin 2006. Nga fundi i vitit 2011 filloi krijimi i *Korpusit Nacional të Shqipes* nga specialistët e Shën Peterburgut dhe Moskës. Në nëntorin e vitit 2012 është vendosur versioni online i korpusit të shqipes me 750 mijë fjalë dhe vazhdon të përditësohet, nga të dhënat e vitit 2013 del se përmban 16.8 milionë fjalë teksti. Në Seminarin XXXVI Kabashi (2017) paraqet korpusin AICo (Albanian [text and speech]

Corpus) me njëqind milionë fjalë. Ky korpus ka filluar të përpilohet në vitin 1997 dhe vazhdon ende të përpunohet.

5. Përfaqësimi dhe madhësia e korpusit

Varësisht prej pyetjes hulumtuese dhe fushës së cilës i përket ajo, dizajnohet edhe madhësia e korpusit. Për hulumtimet që janë krijuar për t'i kapur të gjitha domethëniet e një fjale të caktuar apo të një grupi fjalësh, siç është fjalori, atëherë korpusi duhet të jetë shumë i gjerë dhjetëra ose qindra miliona fjalësh. Reppen (2010: 32) vëren se madhësia e korpusit varet nga dy faktorë: përfaqësimi (a janë mbledhur mjaftueshëm tekste që përfaqësojnë tipin e gjuhës nën vëzhgim) dhe praktikabiliteti (kufizimet kohore). Në disa raste është e mundshme që të përfaqësohet e gjithë gjuha që studiohet, p.sh.: është e mundshme të mblidhet e gjithë puna e një autori të veçantë apo tekstet historike nga një periudhë e caktuar, tekstet nga një ngjarje e caktuar (p.sh.: emisionet në radio dhe në televizion dhe fjalimet politike). Në këto raste mund të arrihet përfaqësimi i plotë i gjuhës. Sidoqoftë, në shumicën e rasteve nuk është e mundur të arrihet përfaqësimi i plotë, dhe në këto raste madhësia e korpusit përcaktohet duke kapur mjaftueshëm gjuhë për saktësi përfaqësimi.

Kosova i ka 38 komuna me 1.469 vendbanime. Në tabelën e mëposhtme janë dhënë komunat e Kosovës dhe numri i intervistave në secilën komunë:

Tabela 1. Intervistat e realizuara nëpër komunat e Kosovës

Nr.	Komuna	Numri i banorëve	Numri i intervistave
1.	Deçan	40,019	114
2.	Gjakovë	94,556	113
3.	Glllogoc	58,531	18
4.	Gjilan	90,178	120
5.	Dragash	33,997	17
6.	Istog	39,289	25
7.	Kaçanik	33,409	47
8.	Klinë	38,496	10
9.	Fushë Kosovë	34,827	19
10.	Kamenicë	36,085	2
11.	Mitrovicë	84,235	163

12.	Mitrovicë e Veriut	29,460	-
13.	Leposaviq	13,773	-
14.	Lipjan	57,605	114
15.	Novobërdë	6,729	2
16.	Obiliq	21,549	20
17.	Rahovec	56,208	125
18.	Pejë	96,450	131
19.	Podujevë	88,499	133
20.	Prishtinë	198,897	122
21.	Prizren	177,781	35
22.	Skënderaj	50,858	22
23.	Shtime	27,324	93
24.	Shtërpçë	6,949	21
25.	Suharekë	59,722	28
26.	Ferizaj	108,610	117
27.	Viti	46,987	9
28.	Vushtrri	69,870	25
29.	Zubin Potok	6,616	-
30.	Zveçan	7,481	-
31.	Malishevë	54,613	113
32.	Junik	6,084	7
33.	Mamushë	5,507	-
34.	Han i Elezit	9,403	24
35.	Graçanicë	10,675	11
36.	Ranillug	3,866	-
37.	Partesh	1,787	-
38.	Klllokot	2,556	-
	Gjithsej	1,800,726	1800

Në gjithë Kosovën janë realizuar 1800 intervista. Numri i ndryshëm i intervistave nëpër komuna është bërë për shkak të madhësisë së ndryshme demografike, por edhe numrit të ndryshëm të vendbanimeve në kuadër të komunave. Në Komunën e Deçanit janë realizuar 114 intervista, në Komunën e Gjakovës 113, në Komunën e Glllogocit 18, në Komunën e Gjilanit

120, në Komunën e Dragashit 17, në Komunën e Istogut 25, në Komunën e Kaçanikut 47, në Komunën e Klinës 10, në Komunën e Fushë Kosovës 19, në Komunën e Kamenicës 2, në Komunën e Mitrovicës 163, në Komunën e Lipjanit 114, në Komunën e Novobërdës 2, në Komunën e Obiliqit 20, në Komunën e Rahovecit 125, në Komunën e Pejës 131, në Komunën e Podujevës 133, në Komunën e Prishtinës 122, në Komunën e Prizrenit 35, në Komunën e Skenderajt 22, në Komunën e Shtimes 93, në Komunën e Shtërpçës 21, në Komunën e Suharekës 28, në Komunën e Ferizajt 117, në Komunën e Vitisë 9, në Komunën e Vushtrrisë 25, në Komunën e Malishevës 113, në Komunën e Junikut 7, në Komunën e Hanit të Elezit 24 dhe në Komunën e Graçanicës 11 intervista. Nga 38 komuna, vetëm 8 nuk janë përfshirë në hulumtim, për shkak se popullsia në këto komuna është mbi 90% e banuar nga bashkësi të tjera etnike, si p.sh. Parteshi, Ranillugu, Zubin Potoku, Zveçani, Leposaviqi, Mitrovica e Veriut dhe Mamusha, në të cilat popullsia flet një gjuhë tjetër nga gjuha shqipe, dhe kjo del përtej objektit dhe qëllimit të hulumtimit.

Në tabelën e mëposhtme jepet një shembull nga një komunë e Kosovës për të parë se si janë përfaqësuar vendbanimet dhe numri i intervistave në secilin vendbanim:

Tabela 2. Numri i intervistave në vendbanimet e komunës së Gjakovës

Vendbanimet në Komunën e Gjakovës	VL	VB	Vendbanimet në Komunën e Gjakovës	VL	VB
Babaj i Bokës	3	3	Nivokaz	3	2
Bardhasan	2	2	Nec		1
Bardhaniq	1	1	Novosellë e Epërme	1	
Batushë	1	1	Novosellë e Poshtme		
Bec	2	3	Orize	3	3
Berjah	1	1	Osek Hilë	1	
Bishtazhin	2	2	Osek Pashë	1	1
Brekoc	1	1	Palabardhë	1	1
Brovinë			Pjetershtan	2	2
Cërmjan	1	1	Planqor	1	1
Damjan	1	1	Piskotë		1
Devë	3	3	Ponoshec	3	3
Doblibarë	4	2	Qerim	1	1

Dobrixhë		2	Qerret	1	1
Dujakë	1	1	Raçë	2	2
Duzhnjë		1	Radoniq	1	
Firzë	1		Rakoc	1	1
Gërçinë	2	2	Ramoc	3	3
Gërgoc	1	1	Rracaj	2	2
Gjakovë	17	19	Rogovë	2	1
Goden			Sheremet	1	1
Guskë	3	3	Shishman	2	2
Hereç	1	1	Skivjan	2	2
Jabllanicë			Smaçë		
Jahoc	1		Smolicë	2	1
Janosh			Stubell	1	1
Kodralli			Trakaniq	1	1
Korenice	1	1	Ujez	3	3
Koshare	1	2	Vogovë	1	1
Kralanë	2	1	Vraniq	1	1
Kushavec	1	1	Zhabel	1	1
Lipovec	1	1	Zhdrellë	1	1
Marmullë	3	3	Zhub	1	1
Meqe	1	1	Zidi Sadik Agës	3	3
Moglica	1	1	Zylfaj	1	1
Molliq	1				
Gjithsej	113				

Në Komunën e Gjakovës janë realizuar 113 intervista, në 58 vendbanime. Vendbanimet që janë përfshirë në hulumtim janë: Babaj i Bokës, Bardhasani, Bardhaniqi, Batusha, Beci, Berjahu, Bishtazhini, Brekoci, Cërmjani, Damjani, Deva, Doblilara, Nivokazi, Novosella e Epërme, Orize, Osek Hila, Osek Pasha, Palabardha, Pjetërshani, Planqori, Piskota, Ponoheci, Qerimi, Dujaka, Firza, Gërçina, Gërgoci, Guska, Hereçi, Jahoci, Korenica, Kosharja, Kralana, Kushavec, Lipoveci, Marmulla, Meqa, Moglica, Molliqi, Qerreti, Raça, Radoniqi, Rakoci, Ramoci, Rracaj, Rogova, Sheremeti, Shishmani, Skivjani, Smolica, Stublla, Trakaniqi, Ujza, Vogova, Vraniqi, Zhabeli, Zhdrella, Zhubi, Zidi i Sadik Agës dhe Zylfaj. Pesë subjekte banojnë jashtë Kosovës, në: SHBA, në Gjermani, në Francë, në Zvicër dhe

në Shqipëri. Nga 113 të intervistuar, 112 e kanë vendin e lindjes në Komunën e Gjakovës dhe një subjekt në Komunën e Prizrenit.

6. Moshë dhe gjinia e të anketuarve

Përveç vendlindjes, vendbanimit, shkollimit, profesionit, gjuhës amtare dhe gjuhës së dytë, të anketuarit të dhënat demografike kanë plotësuar edhe gjininë dhe moshën e tyre. Nga 1800 të anketuar, 787 subjekte i përkaasin grupmoshës së re (18-39 vjeç), 442 grupmoshës së mesme (40-59 vjeç), 434 grupmoshës së vjetër (60-79 vjeç) dhe 137 subjekte nuk e kanë deklaruar moshën e tyre. Nga 1800 të anketuar, 844 subjekte janë femra dhe 956 subjekte meshkuj.

7. Shkollimi i të anketuarve

Shkollimi është ndarë në shkollimin e ulët, të mesëm dhe të lartë. Nga 1800 të anketuar, të pashkolluar janë 19 subjekte, 265 të anketuar e kanë shkollimin e ulët, 505 të anketuar e kanë shkollimin e mesëm, 626 subjekte e kanë shkollimin e lartë dhe 132 nuk e kanë deklaruar profesionin e tyre.

8. Profesionet e të anketuarve

Nga 1800 të anketuar, 213 të anketuar janë të papunë, 232 janë studentë, 166 janë nxënës, 113 janë të pensionuar, 135 nuk e kanë deklaruar profesionin e tyre dhe 941 të anketuar kanë profesione, si: mësimdhënës, drejtorë/menaxherë, tregtarë, bujq, infermierë, ekonomistë, punëtorë krahu, zyrtarë administrate, hidraulikë, arkëtarë, teknikë, inxhinierë, etnologë, dizajnerë, juristë, poetë, elektrikistë, fermerë, blegtorë, kamerierë, mirëmbajtës, muzikantë, shoferë, shitës, neurologë, agjentë thirrjesh, futbollistë, rrobaqepës, kuzhinierë, stomatologë, pediatër, mekanikë, IT, biokimistë, agronomë, zdrukthëtarë, zjarrfikës, trajnerë, arkitektë, instruktorë, përkthyes, gjuhëtarë, biologë, gazetarë, gjeologë, historianë, veterinarë, policë, sociologë, minatorë, fizioterapistë, programerë, bibliotekistë, fotografë, matematikanë, sportistë, filozofë, sekretarë, profesorë, këpucarë, argjendarë, farmacistë, kimistë, psikologë, gjeografë, redaktorë, piktorë, politikanë dhe furrtarë.

9. Gjuhët e dyta të të anketuarve

Gjuhët e dyta që fliten në komunat e Kosovës ishin: anglishtja flitet nga 506 të anketuar, serbishtja nga 374 të anketuar, gjermanishtja nga 197 të anketuar, turqishtja nga 72 të anketuar, frëngjishtja nga 38 të anketuar, bosnishtja nga 29 të anketuar, maqedonishtja nga 16 të anketuar, spanjishtja nga 12 të anketuar, arabishtja nga 7 të anketuar, sllovenishtja nga 6 të anketuar, polonishtja nga 4 të anketuar, rusishtja nga 4 të anketuar, norvegjishtja nga 4 të anketuar dhe suedishtja nga 4 të anketuar. Përveç këtyre gjuhëve, janë edhe disa gjuhë të tjera që përdoren më pak, si gjuha hungareze, latinishtja, holandishtja, greqishtja dhe romishtja.

Përfundime

Në këtë punim është diskutuar për dizajnin e korpusit të folur në Kosovë. Të dhënat demografike që janë nxjerrë nga korpusi i folur janë: vendlindja, vendbanimi, mosha, gjinia, shkollimi, profesioni, gjuha amtare dhe gjuhët e dyta.

- Në gjithë Kosovën janë grumbulluar 1800 intervista. Numri i ndryshëm i intervistave nëpër komuna është përzgjedhur për shkak të madhësisë së ndryshme demografike, por edhe numrit të ndryshëm të vendbanimeve në kuadër të komunave. Nga 38 komuna, vetëm 8 nuk janë përfshirë në hulumtim, për shkak se popullsia në këto komuna është mbi 90% e banuar nga bashkësi të tjera etnike, si p.sh. Parteshi, Ranillugu, Zubin Potoku, Zveçani, Leposaviqi, Mitrovica e Veriut dhe komuna e Mamushës, në të cilat popullsia flet një gjuhë tjetër nga gjuha shqipe. Në komunat e Kosovës ka pasur edhe të anketuar, të cilët vendlindjen ose vendbanimin e kanë jashtë Kosovës. Më së shumti, 14 të anketuar, ka të anketuar që kanë lindur ose jetojnë në Gjermani, në Luginën e Preshevës, në Francë, në SHBA, në Zvicër, në Shqipëri, në Mal të Zi dhe në Maqedoni.
- Nga 1800 të anketuar, 787 subjekte i përkasin grupmoshës së re (18-39 vjeç), 442 të anketuar i përkasin grupmoshës së mesme (40-59 vjeç), 434 të anketuar i përkasin grupmoshës së vjetër (60-79 vjeç)

dhe 137 subjekte nuk e kanë deklaruar moshën e tyre. Nga 1800 të anketuar, 844 subjekte janë femra dhe 956 subjekte meshkuj.

- Nga 1800 të anketuar, të pashkolluar janë 19 subjekte, 265 të anketuar e kanë shkollimin e ulët, 505 të anketuar e kanë shkollimin e mesëm, 626 subjekte e kanë shkollimin e lartë dhe 132 nuk e kanë deklaruar profesionin e tyre.
- Nga 1800 të anketuar, 213 të anketuar janë të papunë, 232 janë studentë, 166 janë nxënës, 113 janë të pensionuar, 135 nuk e kanë deklaruar profesionin e tyre dhe 941 të anketuar kanë profesione të profileve të ndryshme.
- Te të gjithë të anketuarit gjuha amtare është gjuha shqipe.
- Gjuhët e dyta që fliten nëpër komunat e Kosovës ishin: anglishtja, gjermanishtja, serbishtja, kroatishtja, sllovenishtja, rusishtja, boshnjakishtja, maqedonishtja, polonishtja, bullgarishtja, turqishtja, frëngjishtja, arabishtja, spanjishtja, italishtja, suedishtja, latinishtja, holandishtja, norvegjishtja, rumanishtja, hungarishtja, gjuha rome dhe greqishtja.

Bibliografia:

1. Baker, Paul (2010). *Sociolinguistics and Corpus Linguistics*. Edinburgh: Edinburgh University Press.
2. Caka, Nebi-Caka, Ali (2012). Korpusi i gjuhës shqipe-Rezultatet e para, problemet dhe detyrat. *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*, Prishtinë: ASHAK.
3. Ismajli, Rexhep (2019). *Bashkësi gjuhësore, njësi, varietet*, ASHAK, Prishtinë.
4. Kabashi, Besim (2017). Një korpus tekstesh i gjuhës shqipe me njëqind milionë fjalë. *Seminari XXXVI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
5. Kennedy, Graeme (1998). *An Introduction to Corpus Linguistics*, London: Longman.
6. Lee, David Y,WW (2010). What corpora are available? *The Routledge Handbook of Corpus Linguistics*. London: Routledge (107-121).
7. Leech, Geoffrey (1992). Corpora and theories of linguistic performance. *Directions in Corpus Linguistics*. Berlin, New York: de Gruyter (105-122).
8. Malcolm, Noel (2011). *Kosova-Një histori e shkurtër*, KOHA, Prishtinë.
9. McEnery-Tony-Wilson, Andrew (1996). *Corpus Linguistics*. Edinburgh: Edinburg University Press.
10. Morozova, Maria- Rusakov, Aleksandër (2013). Korpusi elektronik i shqipes: përpunimi, përmbajtja dhe përdorimi. *Seminari XXXII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.
11. O’Keeffe, Anne-McCarthy, Michael (2010). What are corpora and how have they evolved? *The Routledge Handbook of Corpus Linguistics*. London: Routledge (3-13).
12. Reppen, Randi (2010). Building a corpus: what are the key considerations? *The Routledge Handbook of Corpus Linguistics*. London: Routledge (31-37).
13. Tognini-Bonelli, Elena (2001). *Corpus Linguistics at Work*. Amsterdam: John Benjamins.
14. Tognini-Bonelli, Elena (2010). Theoretical overview of the evolution of corpus. linguistics. *The Routledge Handbook of Corpus Linguistics*. London: Routledge (14-27).

Bahri KOSKOVIKU

KONCEPTI 'GJYMTYRË TË DYTA TË FJALISË' DHE PËRKUFIZIMI I TYRE NË GRAMATIKAT SHQIPE

Abstrakt:

Ky studim synon të vërë në pah disa pasaktësi bazike dhe kundërthënie logjike në përkufizimin e atyre njësive sintaksore të cilat në traditën gramatikore të shqipes përkufizohen si gjymtyrë të dyta të fjalisë, si: përcaktori, kundrinori dhe rrethanori. Ky punim bazohet në idenë se përkufizimi i njësive të tilla sintaksore si gjymtyrë të dyta të fjalisë është i gabuar, sepse këto të ashtuquajtura gjymtyrë të dyta nuk shpjegohen brenda konceptit të fjalisë, por brenda grupit të fjalëve, me përjashtim të rrethanorit, i cili ndërton raporte sintaksore jo drejtpërdrejt me foljen, por me fjalinë. Një çështje tjetër e ngritur është se jo të gjitha sintagmat parafjalore dhe ndajfoljore i përgjigjen konceptit të rrethanës, si element skajor me të dhëna periferike për fjalinë, sepse disa prej tyre janë elemente internale të sintagmës foljore (kushtëzojnë gramatikalitetin e fjalisë), janë në raport të drejtpërdrejtë me foljen (sipas teorisë gjenerative në lidhje motërie me kokën X), gramatikisht kanë statusin e komplementëve, në kundërvëniet me sintagmat parafjalore dhe ndajfoljore, të cilat kanë një rol fakultativ në fjali dhe kategorizohen tek adjunktët (në teorinë gjenerative dalin në nivelin X' (X-bar)). Për realizimin e këtij punimi është përdorur metoda e vëzhgimit të drejtpërdrejtë dhe metoda e shpjegimit. Si referencë për realizimin e hulumtimit janë disa prej gramatikave më përfaqësuese që përbëjnë strumbullarin teorik të asaj që në studimet sintaksore të shqipes njihet si drejtimi logjik-gramatikor: Gramatika e gjuhës shqipe 2 (Sintaksa) e njohur si gramatika e Akademisë, Sintaksa e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë) Vështrimi i ri teorik e

M. Çelikut, Sintaksa e gjuhës shqipe e Stefan Priftit, Sintaksa e gjuhës shqipe e Thoma Dhimës, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë e Bahri Becit.

Fjalët çelës: gjymtyrë, përbërës sintaksor, kundrinor, përcaktor, rrethanor.

1. Hyrje

1.1. Koncepti “gjymtyrë të dyta të fjalisë”

Pavarësisht nga shkollat e ndryshme teorike, një gjë nuk ka ndryshuar në teorinë e deritanishme sintaksore, një grup emëror në funksion të subjektit dhe një grup foljor në funksion të predikatit janë përbërësit e parë apo të drejtpërdrejtë të fjalisë (me përjashtim të teorisë verbcentriste të Tesnierit). Kështu e koncepton shkolla strukturale analizën e fjalisë (*analiza në përbërës të drejtpërdrejtë* e L. Bloomfield-it (1933)) e modifikuar më vonë si një teori e mirëfilltë sintaksore nga Chomsky në *Syntactic structure* (1957), e njohur si *teoria e strukturës së frazës* apo teoria e rishkrimit sipas së cilës fjalia rishkruhet si një NP (sintagmë emërore) dhe VP (sintagmë foljore). Edhe në fazat më të evoluara të gjuhësisë gjenerative, (sipas skemës X-Bar) një NP dhe një VP janë përbërësit e drejtpërdrejtë të fjalisë, të cilët janë në lidhje motërie (sisterhood) që dominohen nga infleksioni (nyja mëmë), veçse në vend të simbolit S (për fjalinë) kemi IP (Sintagma infleksionale). Në traditën gramatikore të shqipes kryefjala dhe kallëzuesi janë gjymtyrë kryesore të fjalisë (drejtimi logjik-gramatikor në gjuhësi). Pra kjo ecuri nuk ka ndryshuar edhe sot, kurse gjymtyrët që plotësojnë gjymtyrët kryesore, quhen gjymtyrë të dyta të fjalisë, ajo që ne e shohim si një kundërthënie bazike, si një gabim elementar, përkufizime që i karakterizon pothuajse të gjitha gramatikat shqipe të botuara deri më sot, edhe ato gramatika të botuara pas vitit 2000 me pretendime për një vështrim të ri teorik. Përcaktori dhe kundrinori janë funksione gramatikore që realizohen në nivel sintagmatik dhe jo në nivel të fjalisë, kurse rrethanori ka një pozicion të lirë në fjali, një funksion karakteristik për adjunktët. Në shembullin: *Nëna pastronte rrobat e djalit çdo ditë* sintagma emërore *rrobat e djalit* plotëson kuptimin e foljes *pastronte*, atëherë ky element në strukturën hierarkike të fjalisë është për-

bërës i sintagmës foljore *pastronte rrobat e djalit* dhe jo gjymtyrë e fjalisë, sikurse edhe sintagma gjenitivale *e djalit* e cila është përcaktor i sintagmën emërore *rrobat* në sintagmën emërore *rrobat e djalit* e jo gjymtyrë (e dytë) e fjalisë. Kurse *çdo ditë* nuk i referohet drejtpërdrejt një foljeje, por gjithë fjalisë, jep informacione shtesë në lidhje me fjalinë. L. Haegeman pohon se kur flasim për pjesët përbërëse të një fjalie në gjuhën angleze, gjëja e parë që na vjen ndërmend janë fjalët, por fjalët nuk janë përbërësit imediatë të fjalisë, ata janë përbërësit fundorë të fjalisë (ultimate constituents). Fjalët janë të organizuara në njësi më të mëdha që quhen sintagma (L.Haegeman, 1994:34). Thënë shkurt, vetëm kryefjala dhe kallëzuesi si funksione gramatikore e gëzojnë statusin e përbërësit të drejtpërdrejtë të fjalisë (immediate constituents), kurse përcaktori dhe kundrinori (edhe plotësi predikativ) janë pjesë e një përbërësi sintaksor të rangut më të ulët se fjalia.

Në mungesë të kriterëve të mirëfillta dhe duke mos e marrë në konsideratë fjalinë si një hierarki përbërësish për pasojë kemi kategorizime që përbëjnë anomali, për shembull *Ajo foli për ju me Petritin* të dy sintagmat parafjalore kategorizohen te kundrinorët (e zhdrejtë) me parafjalë, pa çka se ato përfaqësojnë pozicione të ndryshme në strukturën e fjalisë, i përkasin së njëjtës kategori sintagmatike, por kryejnë funksione të ndryshme gramatikore, e para është një objekt internal i sintagmës foljore (foli për ju) dhe del në funksion të një plotësori të detyrueshëm, kurse e dyta është një element eksternal që shënon një rrethanë dhe vendos raporte sintaksore me fjalinë (jo me foljen), në funksion të rrethanorit të shoqërimit. Në gramatikat shqipe të dy sintagmat parafjalore trajtohen si një lloj i veçantë i marrëdhënies kundrinore (kundrinori i zhdrejtë me parafjalë).

1.2. Përkufizimi i përcaktorit në gjuhën shqipe

Për Priftin përcaktori është një plotës emëror dhe cilësor (Prifti i quan gjymtyrët e dyta të fjalisë me një emër të përbashkët, plotës, sintaktikisht të padiferencuar) që prekin brendinë e sendeve apo tregojnë marrëdhënie midis sendeve, ndryshe nga plotësorët ndajfoljorë që nuk prekin brendinë e kuptimit të sendeve (S. Prifti, 1958:79). Dallimi përmbajtësor midis plotësit emëror dhe ndajfoljor, siç pohon L.S. Rugova, është i saktë, por Prifti këtu gabon kur e quan plotësorin emëror gjymtyrë të dytë të fjalisë si në shem-

bujt *syzet e diellit*, duke shtruar me të drejtë pyetjen si është e mundur që një plotës i thjeshtë pronor të konsiderohet gjymtyrë e dytë e fjalisë përderisa ky i ashtuquajtur i plotës është pjesë e një njësie më të ulët hierarkike se fjalia, është pjesë e një sintagme emërore dhe që bashkë me kokën *syzet* përbëjnë një gjymtyrë më vete në këtë fjali (L.S. Rugova, 2019:79). Më tej në shembujt e dhënë fjalët në të zeza janë përcaktorë, por nuk janë gjymtyrë të dyta të fjalisë. Gabimi qëndron pikërisht këtu. Këto fjalë janë përcaktorë të sintagmës emërore (L.S. Rugova: 2019:81).

Rrezet e fundit të diellit

Më mungon vetëm ajo shkolla **që ke ti**.

L.S. Rugova i kundërvihet konceptit të lidhjes së fjalëve: me përshtatje, drejtim dhe bashkim duke e konceptuar sintagmën si një varshmëri elementesh nga një element parësor (koka e sintagmës) (2019: 78). Përkufizimi i përcaktorit, në Gramatikën e Akademisë, në thelb, nuk ndryshon nga pohimi i Priftit, përveç dallimeve terminologjike plotësorët emërorë i quan përcaktorë dhe kundrinorë, kurse plotësorët ndajfoljorë, rrethonorë (L.S. Rugova: 2019:80). Edhe në gramatikën e Akademisë, në thelb është i njëjti përkufizim: *Përcaktori është gjymtyrë e dytë e fjalisë që është në marrëdhënie përcaktore me gjymtyrën prej së cilës varet e që bashkohet me të me lidhje përshtatjeje, drejtimi a bashkimi* (Gramatika e Akademisë, 2002:221). Gabimi elementar në shembujt e dhënë më sipër është se përcaktori hyn në marrëdhënie gramatikore me emrin dhe jo me fjalinë dhe funksioni gramatikor i tij shpjgohet brenda sintagmës emërore, jo brenda fjalisë.

Bahri Beci në gramatikën e tij *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë* të ashtuquajturat gjymtyrë të dyta i trajton në nivel të përbërësve sintaksorë dhe jo në nivel të fjalisë, duke i ndarë në dy grupe: funksione gramatikore që lidhen me emrin (përcaktorët) dhe funksione gramatikore që lidhen me foljen (kryefjalë, kundrinor dhe rrethonor). Beci përcaktorët i përkufizon si fjalë që shoqërojnë emrin (2010: 2004). Një ndarje e tillë pa dyshim e qartëson plotësisht rolin e përcaktorit dhe pozicionin e tij si një element brenda përbërësit emëror. Parë në këtë këndvështrim, gramatika e Becit përbën një avancim serioz në studimet sintaksore të shqipes. Thoma Dhima u përpoq që konceptet e teorisë gjenerative t'i inkorporojë në traditën gramatikore të

shqipes. Ai fillimisht i trajton përcaktorët si përbërës të sintagmës që lidhen me emrin dhe kanë funksion kufizues ndaj kokës leksikore (2005:87), një përkufizim pa dyshim i saktë, por në vijim në kundërshtim me këtë qëndrim, i klasifikon përcaktorët si gjymtyrë të dyta të fjalisë, madje duke u përpjekur që konceptin gjymtyrë të dyta ta ndërlihdh me pozicionin strukturor të tyre si nivel më i ulët hierarkik. *quhen gjymtyrë të dyta jo se përmbajnë informacion të parëndësishëm, por se nga ana strukturore janë në një lidhje hierarkike më të ulët në raport me gjymtyrët kryesore të fjalisë, janë pra në lidhje varësie ndaj tyre* (2005:87). Th. Dhima më tej pohon se gjymtyrët e fjalisë s'janë gjë tjetër veçse funksionet e përbërësve të fjalisë (2005:89), gjë që paraqet një ngatërrim konceptesh. E para gjymtyra dhe përbërësi, pa hyrë në shpjegime teorike, nuk janë materialisht të barabarta, për shembull në sintagmën foljore *takova mikun* kemi dy gjymtyrë, por një përbërës. Ky studiuës, duke u përpjekur të gërshetojë traditën me frymën e gjuhësisë moderne pashmangshëm vjen në përfundime kundërthënëse. Të njëjtat kundërthënie i hasim edhe te gramatika e M. Çelikut, ndonëse gramatika e tij *Sintaksa e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)* quhet një vështrim i ri teorik. Fillimisht e quan përcaktorin si një zgjerim i një përbërësi emëror (2012:197), gjë që është një përkufizim i saktë, por më pas bie në kundërthënie elementare duke pohuar se *përcaktori është gjymtyrë e dytë e fjalisë që vihet në marrëdhënie sintaksore me një përbërës emëror me të cilin bashkohet me lidhje përshtatje, drejtimi a bashkimi* (2012: 198). Edhe këtu sikurse te Th. Dhima kemi përpjekje për një gërshetim teorik midis teorisë së gjymtyrëve dhe përvojës strukturale, dy shkolla orientimisht të ndryshme në koncepte dhe metodologji.

2. Përkufizimi i kundrinorëve

Sa u përket kundrinorëve, fillimisht Prifti (1958) vuri kritere mjaft të sakta që janë aktuale dhe sot, *që folja të marrë si plotës të saj një kundrinë duhet të jetë e diatezës veprorë dhe transitive* (1958:104), si dhe për faktin se sintagmat parafjalore me kuptim mjeti, shoqërimi, kufizimi i kategorizon në radhën e plotësorëve ndajfoljorë (rrethanorë), nuk i përfshin te *farët e kundrinorëve*, gjë që edhe për kriteret që vuri, gramatika e tij del shumë më objektive sesa gramatikat pas viteve 70 përfshirë edhe gramatikën e Akade-

misë. Foljet intransitive në kuptimin absolut të tyre nuk mund të marrin kurrë kundrinë (1958:108), p.sh: *foljet: ndodh, ngjaj, shkoj, dal* etj. Ndaj një problematike të tillë gramatika e Akademisë përdor një qasje "korrigjuese" ...*në disa tekste gramatikore të disa gjuhëtarëve janë marrë e merren si rrethanorë, po kështu edhe në traditën tonë të mëparshme gramatikore gjeraty nga vitet 60'. Po këtu s'ka rrethana, raporte rrethanore. Në to kemi lloje të veçanta të raporteve kundrinore dhe është më e arsyeshme të vështrohen si kundrina me parafjalë* (Grup autorësh, 2002:2017). Megjithëkëtë, Prifti gaboi kur e përkufizoi kundrinorin si *gjymtyrë e varur e fjalisë së zgjeruar* (1958:104). Kundrinori është plotës i një foljeje kalimtare dhe jo plotës i fjalisë, i përket një niveli më të ulët hierarkik se fjalia, nivelit sintagmatik. Është interesante të theksohet që Prifti trajton edhe çështje që janë mjaft të debatueshme edhe sot në studimet sintaksore në përgjithësi, sikundër është karakteri i foljeve ditransitive me kundrinorë të dyfishtë, për të cilat jep një pikëpamje që në raport me zhvillimet e sotme mund të konsiderohen objektive. Me kallëzore (si kundrinor i drejtë) dhe dhanore (kundrinë e zhdrejtë) ndërtohen ato folje, veprimi i të cilave nga sendi i parë kalon në një të dytë, me fjalë të tjera, kundrina e drejtë e pranon e para veprimin e foljes, kurse e zhdrejta e pranon e dyta, siç janë foljet: *me dhanë, kalue, fal, drejtue, tregue* etj. (1958:111).


Beci i kategorizon kundrinorët në grupin e funksioneve gramatikore që lidhen me foljen. Kjo është objektive. Beci me një qasje mjaft praktike duket se përpiket t'i shmanget traditës logjiciste në gramatikat shqipe, por gabon kur i konsideron si kundrinorë (të zhdrejtë) me parafjalë sintagmat parafjalore në funksion mjete, shoqërimi etj. që nuk janë pjesë e strukturës argumentore të foljes. Për B. Beci në shembujt në vijim PPs janë kundrinorë me parafjalë

Ju e fituat ndeshjen me lojën tuaj.

Beci thotë se sintagma parafjalore *me lojën tuaj* është kundrinor (i zhdrejtë) me parafjalë, por nuk është plotës kryesor (v. jonë: nuk ka plotës kryesor, ka vetëm plotës), sepse folja në fjali mund të përdoret edhe pa të)). Kjo përbën një anomali që e hasim pothuajse te të gjithë autorët e gramatikave shqipe që është rezultat i mungesës së kritereve të mirëfillta për të përcak-

tuar pozicionin dhe funksionin gramatikor të një përbërësi në strukturën e fjalisë.

Më tej Beci pohon se kundrinori i zhdrejtë me parafjalë i ndërtuar nga një emër apo nga një emër dhe një përcaktor mund të zëvendësohet nga një përemër: *Atë natë unë po rrija me Benin, po bisedoja me të*. Dhe këtë fjali dëftore me kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë mund ta shndërrojmë në fjali pyetëse (2010:198-199): *Me kë po bisedoja?* Në të vërtetë, sintagmat parafjalore *me Benin* dhe *me të* në fjalinë dëftore dhe *me kë* në fjalinë pyetëse e transformuar nga fjalia dëftore janë rrethanorë shoqërimi dhe jo kundrinorë. Në një fjali pyetëse si kjo: *Për kë po bisedoja?*, atëherë *për kë* është kundrinor me parafjalë, sepse përbën objektin e brendshëm të një foljeje. Ajo për çfarë bisedohet është argumenti i brendshëm i foljes jo *me kë bisedohet?*. E para e kushtëzon gramatikalitetin e fjalisë dhe është argument i foljes, kurse e dyta përbën rrethana dhe vendos raporte fakultative me fjalinë. Zakonisht një PPs në funksion të kundrinorit në shqipen prihet nga parafjala *për*, për shembull *bisedoj për librin me mësuesin* PPs *për librin dhe me mësuesin* i përkasin së njëjtës kategori sintagmatike, janë sintagma parafjalore, por kanë pozicione të ndryshme në strukturën hierarkike të fjalisë, e para është komplement, kurse e dyta është një adjunkt. Ta paraqesim këtë sipas skemës X-bar ku pozicioni i komplementeve dhe adjunktëve është qartësisht i dallueshëm:



Sikundër shihet në diagram kundrinori i drejtë *ndeshjen tuaj* zë pozicionin e komplementit që është pozicioni gjenerues i tij, kurse PPs *me lojën tuaj* zë pozicionin e adjunktit dhe nuk mund të jetë kundrinor. Folja *fitoj* është veprorë kalimtare, por monotransitive, pra pranon vetëm një kundrinor të drejtë, kurse sintagma parafjalore *me lojën tuaj* është një element shtesor që nuk e kushtëzon gramatikalitetin e fjalisë, rrjedhimisht është rrethanor. Kurse gramatika e Th. Dhimës *Gjuha shqipe (Sintaksa)* megjithëse përfshin mbase për herë të parë në studimet sintaksore shqipe një numër konceptesh nga teoritë bashkëkohëse të gramatikave, si konceptet: përbërës, sintagmë, gramatikalitet, pranueshmëri, kompetencë etj. nuk arriti t'u shmanget në tërësi koncepteve logjiciste nga tradita sintaksore e shqipes. Th. Dhima e elaboron me saktësi të plotë natyrën e përbërësit sintaksor, si njësi që ka një qendër sintaksore në funksion të kokës, pastaj fut në përdorim konceptin e sintagmës, duke pranuar grupin parafjalor në mesin e kategorive sintagmatike, të cilat *karakterizohen nga një pjesë e caktuar, përkatësisht nga emri, folja, mbiemri, parafjala dhe ndajfolja. Kjo pjesë e ligjëratës karakteristike dhe themelore për përbërësit quhet kokë* (2005:28). Por është disi e habitshme që, siç pohon edhe L.S. Rugova, Th. Dhima nuk i shtyu konceptet e tij deri në fund dhe në analizën e tij nuk arrin të shkëputet nga konceptet e traditës sidomos kur flet për raportet semantike midis përbërësve të fjalisë, duke i spikatur sidomos raportet sintaksore kryefjalë-kallëzues të cilat nuk i sheh si përbërësit e parë të fjalisë, por si raport midis dy gjymtyrësh kryesore: *Një lloj i veçantë i marrëdhënieve kuptimore që vendosen midis përbërësve janë edhe marrëdhëniet kallëzuesore që vendosen midis atij që kryen veprimin dhe vetë veprimin të shprehur nga folja* (2005:30) (në gramatikën e Akademisë lidhja kallëzuesore kryefjalë-kallëzues)). Konceptet kryefjalë dhe kallëzues janë funksione gramatikore dhe jo gjymtyrë fjalie, në rrafshin e segmentimit, siç u tha më lart, janë përbërës sintaksorë të drejtpërdrejtë të fjalisë. Kur i përdorim këto koncepte si gjymtyrë fjalie sipas traditës sintaksore të shqipes dhe njëkohësisht përdorim termin përbërës për to, pashmangshëm do të kemi një ngatërrim të koncepteve. Nuk ka marrëdhënie kallëzuesore apo lidhje kallëzuesore kryefjalë-kallëzues, por përbërës të fjalisë. Pastaj sa u përket koncepteve të lidhjes së fjalëve, është po ai i që vjen nga shkolla e traditës sintaksore shqipe: lidhje me drejtim, me përshtatje dhe me bashkim. Disa nga konceptet e Th. Dhimës duket se mbesin në nivel të

teknikaliteteve dhe jo si frymë tërësore në gramatikën e tij, ai nuk arrin të shkëputet nga skemat logjiciste. Si rezultat i kësaj, përkufizimi i Th. Dhimes për kundrinorin, në thelb, është i njëjtë me përkufizimin që jepet në gramatikën e Akademisë: *kundrinori është gjymtyrë e dytë e fjalisë që vihet në marrëdhënie objektore dhe lidhet me drejtim me gjymtyrën prej së cilës varet (2005:107)*. Th. Dhima në shembujt në vijim i trajton si kundrinorë (të zhdrejtë) me parafjalë edhe shprehjet e theksuara në të zeza që, në të vërtetë, nuk janë fare kundrinorë: *Rrugët e shtruara me kalldrëm gjëmonin nga hapat e kalimtarëve*. PPs *me kalldrëm* është pjesë e një përbërësi emëror, pra është përcaktor, kurse **nga hapat e kalimtarëve** rrethanor shkaku. Përkufizim të ngjashëm ka edhe Çeliku: *Kundrinori është gjymtyrë e dytë e fjalisë që plotëson a kufizon kuptimin e një foljeje të një mbiemri a emri me natyrë foljore apo një fjale që shpreh gjendje* (M. Çeliku, 2012: 161), ndonëse gramatika e tij (*Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë) Vështrim i ri teorik*) vjen me premtimin e një vështrimi të ri teorik, e shkruar në ballinën e librit. Çeliku përdor me saktësi termin përbërës emëror kundrinor duke vënë në pah njëkohësisht markuesin e sintagmës dhe funksionin e tij gramatikor, por më pas pranon marrëdhënien kallëzuesore kryefjalë-kallëzues njësoj sikurse Th. Dhima. Kurse teorinë e përbërësve sintaksorë e modifikon sipas koncepteve të teorisë së togfjalëshit *si teori e lidhjeve të fjalëve emërtuese (2012:51)*, madje në vijim thotë kushti i parë që duhet të plotësojë një fjalë për të qenë përbërës është qenia e saj fjalë emërtuese (2012:53) që, në të vërtetë, ka të bëjë me gjymtyrën dhe jo me përbërësin dhe nuk i pranon ndërtimet me parafjalë. Çeliku në shembujt në vijim i trajton si kundrinorë (me parafjalë) sintagmat parafjalore që shprehin mjet, shoqërim, kufizim, veprim etj. njësoj sikurse në traditën sintaksore shqipe. *Zana shkoi në mal me ata djemtë e televizionit. Ata vazhduan të udhëtojnë me autobus. I mësuar me punë nuk i rrinin duart asnjë minutë* etj. Prandaj me të drejtë shtrohet pyetja a kemi vështrim të ri teorik në gramatikën e M. Çelikut, që figuron në ballinën e librit të tij. Te Çeliku sikurse edhe te Dhima e Beci vërehet qartazi një lloj përpjekje për të gërshtuar traditën me modernen jo vetëm në koncepte, por edhe në terminologji, duke përdorur herë njëherë herë tjetrën, duke mos ia arritur qëllimit.

3. Përkufizimi i rrethanorit

Për rrethanorin Prifti përdor termin plotës ndajfoljor, i cili në studimet e mëvonshme, pas viteve 70 artikullohet vetëm si rrethanor. *Plotësi ndajfoljor i rrethanës është gjymtyrë e dytë e fjalisë që tregon rrethanat si zhvillohet një veprim a një gjendje, raportet që shprehin plotësit ndajfoljorë të rrethanës quhen raporte rrethane* (S. Prifti, 1958:130). Në gramatikën e Akademisë jepet ky përkufizim: *Rrethanori është gjymtyrë e dytë e fjalisë që vihet në marrëdhënie rrethanore me gjymtyrën prej së cilës varet dhe lidhet me të me drejtim a bashkim (Grup autorësh, 2002:269)*. Sipas Mehmet Çelikut rrethanori është një përbërës i varur që vihet në marrëdhënie rrethanore me një përbërës ndajfoljor, sipas tij është semantika e foljes që përcakton nëse rrethanori është shoqërues i detyrueshëm ose jo i detyrueshëm (M. Çeliku, 2012:26). Sipas Mahir Domit në *Vepra 1- Studime sintaksore rrethanorët janë gjymtyrë të dyta që shënojnë raporte të ndryshme rrethanore, rrethanat në kuptim të gjerë në të cilat zhvillohet një veprim ose karakterizohet mënyra e shfaqjes së një veprimi ose gjendjeje* (M. Domi, 2013:222). Beci e përkufizon si funksion gramatikor që lidhet me foljen. Megjithëse përkufizimi i Thoma Dhimës është po ai i Akademisë, pothuajse i cituar, por në një analizë të mëtejme pohon se rrethanori jo gjithmonë i referohet një foljeje a mbiemri, në mjaft raste ai i referohet gjithë fjalisë (Th. Dhima, 2005:115), që është e vetmja analizë objektive nga të gjitha përkufizimet e cituara më lart. Në të vërtetë, jo të gjithë rrethanorët i përgjigjen përkufizimit të rrethanorit si koncept që vë në dukje rrethanat e kryerjes së një veprimi, pra si një element skajor me të dhëna periferike për fjalinë. Shembujt në vijim 1) dhe 2) sipas gramatikave shqipe kanë një status të njëjtë, trajtohen si rrethanor:

Vesa e takoi shokun e saj të fëmijërisë **përballë teatrit**.

Delvina vuri lulet **mbi tavolinë**

Në shembullin 1) sintagma parafjalore shënon rolin semantik të lokativit dhe semantikisht është i përputhshëm me konceptin e rrethanës, meqë jep një informacion leksikor shtesë në lidhje me fjalinë *Vesa e takoi shokun e saj të fëmijërisë*, por nuk mund të nxirret i njëjti përfundim për shembullin (2); sintagma parafjalore është e përfshirë drejtpërdrejt në veprimin e shpre-

hur nga folja; gramatikisht ka statusin e komplementit dhe rrjedhimisht nuk i përgjigjet konceptit të rrethanës (në shembullin 2, PPs nuk është rrethantor), kjo do të thotë se sintagma parafjalore *mbi tavolinë* ka një pozicion strukturor të ndryshëm nga sintagma parafjalore *përballë teatrit*. Në shembullin (1) sintagma parafjalore nuk e kushtëzon gramatikalitetin e fjalisë, sepse *përballë teatrit* nuk futet në raporte sintagmatike me foljen, por me fjalinë. Në planin strukturor dallimi midis komplementëve dhe adjunktëve në këtë rast më së miri e bën A. Carnie, përmes dy rregullave të thjeshta, kur një PPs lidhet me kokën X është komplement, kur një PPs lidhet me kokën X' (në lidhje motërie, sisterhood) është adjunkt (A. Carnie: 172). Sipas kësaj rregulle në shembujt mësipërm kemi dy struktura të ndryshme sintaksore, ndonëse në dukje të ngjashme. Një aspekt tjetër i këtij këndvështrimi ka të bëjë me faktin se rrethantorët (në kuptimin e mirëfilltë të përshkrimit të rrethanës) nuk ndërtojnë raporte të drejtpërdrejta me foljen, qofshin këto sintagma parafjalore ose ndajfoljore. Sintagmat ndajfoljore në funksion adjunkti dalin në pozicione të ndryshme në fjali. Ato nuk kanë një pozicion të caktuar në fjali apo një pozicion të bazës sikurse komplementët dhe janë potencialisht janë të pakufizuar në numër. Kjo është arsyeja pse rrethantori kategorizohet si adjunkt, një term i përdorur kudo në studimet e sintaksës bashkëkohore që përfshin jo vetëm rrethantorët, por edhe përcaktorët me funksion përshkrues, një klauzë etj. që në thelbin e tyre janë njësi strukturore me të dhëna periferike për fjalinë.

Përfundim

Fjalja nuk është thjesht një bashkim fjalësh, por një hierarki përbërësish sintaksorë. Secili përbërës ka një qendër sintaksore që shërben si kokë dhe etiketë e saj. Kjo është zakonisht një fjalë leksikore, informacioni leksikor i së cilës determinon natyrën dhe llojin e një përbërësi sintaksor. Këta përbërës kanë pozicione të caktuara në fjali, që në teorinë gjenerative quhet pozicioni i bazës, për shembull kundrinori i drejtë gjenerohet gjithnjë pas një foljeje kalimtare.

Kategoritë sintaksore: kryefjalë, kundrinor, përcaktor, komplement, adjunkt janë kategori relacionale, çka do të thotë se funksionet e tyre gramatikore përcaktohen nga lidhjet e tyre strukturore në fjali. Në mënyrë speci-

fike, përcaktorët dhe kundrinoret janë funksione gramatikore që gjenerohen në nivel të sintagmës, prandaj edhe funksioni i tyre gramatikor shpjegohet brenda domenit të sintagmës dhe jo në nivel të fjalisë. Përcaktori nuk është gjymtyrë e fjalisë, por përbërës i grupit emëror, sepse përcakton një emër, e përshkruan e modifikon kokën e një sintagme emërore. Kundrinori i drejtë është pjesë e strukturës argumentore të një foljeje, objekt i brendshëm i saj në pozicionin e temës (pësuesit). Kundrinori i zhdrejtë zakonisht del në pozicionin tematik të përfituesit (marrësit) apo përjetuesit të një gjendjeje psikologjike. Nuk janë kundrinorë sintagmat parafjalore që shprehin marrëdhënie shoqërimi, mjeti dhe kufizimi, sepse nuk e kushtëzojnë gramatikalitetin e fjalisë (term nga gjuhësia gjenerative), nuk janë pjesë e strukturës argumentore të foljes, semantikisht japin të dhëna periferike për fjalinë.

Rrethanori nuk është gjymtyrë e dytë e fjalisë, por as funksion gramatikor që lidhet me foljen (siç pohon Beci). Është element fakultativ në fjali; nuk i referohen drejtpërdrejt foljes, por fjalisë. Në këtë pikë vetëm Th. Dhima deri diku jep një përkufizim më objektiv kur thotë se rrethanori mund t'i referohet jo vetëm një elementi të fjalisë, por gjithë fjalisë. Mjaft problematike është fakti që disa sintagma parafjalore që kategorizohen te rrethanorët nuk i përgjigjen përkufizimit logjik për rrethanorin si element skajor që përshkruan rrethana në kuptim të gjerë siç pohon M. Domi. M. Çeliku duke e vërejtur këtë anomali pohon se është folja që vendos nëse rrethanori është shtesor apo i detyrueshëm. Por kjo nuk e zgjidh një anomali të dukshme, nëse një sintagmë parafjalore apo ndajfoljore është komplement, funksioni gramatikor nuk mund të jetë ai i rrethanorit. Sepse rrethanorët asnjëherë nuk janë komplementë, por një element fakultativ në fjali. E njëjta gjë vlen edhe për kundrinorët: një sintagmë emërore apo parafjalore në funksion të kundrinës është gjithnjë komplement, prandaj nuk janë të sakta pohimet duale se rrethanori njëherë është i detyrueshëm (komplement) e njëherë tjetër jo (adjunkt) (siç pohon Çeliku)), po ashtu kundrinori njëherë është plotës i detyrueshëm i foljes (komplement), e në një kontekst tjetër kuptimi i foljes është i realizueshëm edhe pa të (adjunkt). Rregullat e A. Carnie-t, të shpjguara më lart e zgjidhin qartësisht këtë problematikë.

Gjymtyra si fjalë leksikore kuptimplote është një koncept i ngushtë për të pasqyruar natyrën e një përbërësi sintaksor. Konceptet gjymtyrë dhe përbërës apo sintagmë janë koncepte të shkollave të ndryshme, e para ka të bëjë

me raportin logjik-semantik (që e karakterizon drejtimin logjik-gramatikor në gjuhësi), kurse e dyta me karakterin deskriptiv të gjuhës. Ato nuk mund të barazohen as vëllimisht; në grupin foljor *takova mikun* kemi dy gjymtyrë, por një përbërës. Prandaj për t'iu përgjigjur karakterit deskriptiv të gjuhës duhet larguar termi gjymtyrë, sepse nuk është i aftë të përshkruajë një segment të fjalisë dhe të zëvendësohet me termin përbërës, funksionet gramatikore të të cilëve janë pasqyrim i drejtpërdrejtë i lidhjeve të tyre strukturore e gramatikore në fjali.

Bibliografia:

- Beci, B. (2010). Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë. EDFA. Tiranë.
- Carnie, A. (2007). Syntax. A generative introduction (Second edition). Blackwell publishing.
- Chomsky, N. (1975). *Syntactic structure*. (1957). Mouton de Grynter. Berlin.
- Çeliku, M. (2012). *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)*. Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan. ShB "Ilar" Tiranë
- Domi, M. (2013). Vepra I. *Studime sintaksore*. ASHSH. Shtypshkronja "Krishtalina KH". Tiranë.
- Dhima, Th. (2005). *Gjuha shqipe (Sintaksa)*. Shtëpia Botuese e Librit Universitar. Tiranë
- Grup autorësh. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 1*. ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë. Tiranë.
- Grup autorësh (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe 2*. ASHSH. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.
- Haegeman, Liliane (1994). *Introduction to Government and Binding Theory*. Blackwell Publishers Inc 350 Main Street Maiden, Massachusetts 02148, USA
- Prifti, S. (1958). *Sintaksa e gjuhës shqipe*. ETMMK. Prishtinë.
- Rugova S. L. (2019). *Strukturë dhe funksion*. Prishtinë.

Flamur SHALA

PASKAJORJA E TIPIT “ME PUNUE” DHE LIDHORJA “TË PUNOJ” - PREJARDHJA, NGJASHMËRITË DHE DALLIMET

Abstrakt:

Zhvillimi sintagmatik i një gjuhe përcakton strukturën (tipologjinë) e asaj gjuhe. Përftimi në rrugë të ngjashme i paskajores së vjetër dhe i lidhores së shqipes, ka përcaktuar në një mënyrë format e sotme dhe funksionet e këtyre trajtave foljore.

Se lidhorja *të punoj* e mënjanoi paskajoren e shqipes *me punue* në dialektin jugor të shqipes, e thotë tashmë gjuhësia shqiptare. E thonë studiues shqiptarë dhe të huaj. Gjurmët e paskajores së vjetër i gjejmë në disa raste sporadike në dialektin jugor dhe në të folmen e arbëreshëve të Italisë.

Paskajorja u formua diku në shek. V, para formimit të mbiemrit të nyjshëm. Formimi i mbiemrit të nyjshëm, diku në shek. VII, "i hapi rrugë" formimit të lidhores, jo se kjo e fundit duhej të formohej, por sepse trajta e gatshme e ngjashme me të dëftores *punoj*, pas mbiemërorëzimit të pjesores, po bashkëngjitej me *të* në formën e një "kalku" *të punoj*, nën ndikimin e një gjuhe fqinje, greqishtes (Bokshi, 2014).

Trajta e paskajores dhe e lidhores kanë rrugë të ngjashme formimi. Paskajorja e lidhorja përftohen nga epitetizmi i pjesores atributive të substantivuar "*nisi me (të) punuem*" dhe "*nisi të punuarit*". Paskajorja gramatikalizohet në trajtën *me punue* para formimit të mbiemrit të nyjshëm, kurse lidhorja me trajtën *të punoj*, pas formimit të mbiemrit të nyjshëm. Pjesorja kryente funksionin edhe të mbiemrit pa *të*, kurse te lidhorja, mbiemri me *të* u substantivua dhe *të* "u shkëput" për t'u bashkëngjitur me trajtën e ngjashme me të dëftores në formën e një

“kalku” *të punoj*. Nën ndikim, me kalimin e kohës, trajta e lidhore *të punoj* u gramatikalizua.

Në këtë punim do të paraqesim rrugën e formimit të këtyre dy trajtave foljore, funksionin, ngjashmëritë dhe dallimet midis tyre.

Fjalët kryesore: *Paskajorje, lidhore, ngjashmëri, ndikim, funksion, dallime etj.*

Abstract:

The syntagmatic development of a language determines the structure (typology) of that language. The convergence in similar paths of the old infinitive and the Albanian participle has determined in a way the present forms and functions of these verbal forms.

Albanian linguistics and foreign researchers already state the conjunction ‘*të punoj*’ replaced the Albanian infinitive ‘*me punue*.’ Traces of the old auxiliary verb are found in some sporadic cases in the southern dialect and in the speech of the Arbëreshë people in Italy.

The infinitive was formed sometime in the c. V, before the formation of the nominative adjective. The formation of the nominative adjective, sometime in the c. VII, "paved the way" for the formation of the conjunction, not that the latter had to be formed, but because the ready form similar to the demonstrative ‘*punoj*’, after the adjective of the participle, was attached to it in the form of a calque ‘*të punoj*’, under the influence of a neighboring language, Greek (Bokshi, 2014).

The form of the infinitive and the subjunctive have similar paths of formation. The infinitive and the relative are derived from the epithetism of the substantivized attributive participle ‘*nisi me (të) punuem*’ and ‘*nisi të punuarit*’. The infinitive is grammaticalized in the active form *me punue*, before the formation of the nominative adjective, while the conjunction is in the active form *të punoj*, after the formation of the nominative adjective. The participle also performed the function of the adjective without ‘**të**’, while in conjunction, the adjective with ‘**të**’ became substantive and "detached" to be attached to the form similar to the demonstrative in the form of a calque ‘*të punoj*’. Under the influence, over time, the form of the conjunction ‘*të punoj*’ was grammaticalized.

In this paper, we will present the way of formation of these two verb forms, the function, similarities and differences between them.

Key words: *Infinitives, conjunctions, similarities, influence, function, differences, etc.*

Hyrje

Me u marrë me paskajoren *me punue* dhe lidhoren *të punoj* është me u marrë me prejardhjen e të ty trajtave foljore, ngjashmëritë në rrugën e formimit dhe dallimet eventuale funksionale ndërmjet tyre, si dhe për kohën e mënjanimi të paskajores dhe zëvendësimin me lidhore në toskërishte, si një nga dukuritë gjuhësore ballkanike.

Vështirësitë për gjetjen e rrugës së zhvillimit historik të gjuhës shqipe në përgjithësi dhe të ndryshimeve morfologjike të shqipes në veçanti, ndryshime që lidhen me dukuritë e përbashkëta të gjuhëve ballkanike, dalin edhe lidhur me formimin e këtyre dy trajtave foljore, sepse nuk dimë krejt si ishte shqipja në kohën kur nuk kemi shkrime për të.

Te Buzuku i gjejmë të konsoliduara të dy trajtat foljore, edhe paskajoren edhe lidhoren. Kjo tregon se ato u përdorën jo pak kohë përpara se të shkruhej *Meshari*, edhe në veri. Te Buzuku, në 43 ndërtime me foljen duhet, 32 herë del me paskajoren, 11 me lidhoren, dhe vetëm një herë me pjesoren (Demiraj, 1988:869; sipas Manskut, SF3, 1979:149 v.). E ardhmja *do+lidhore*, te i njëjti autor përdoret më pak krahasuar me të ardhmen *kam+paskajore* (Mansaku, 2012.).

Sot gjurmë të paskajores në toskërishte konsiderohet trajta e privativit *pa+pjesore* (*pa ba/bërë*) si opozitiv i komitativit *me+pjesore* (*me ba/bërë*) (Bokshi, Riza, Jokli etj.) dhe edhe përdorimi i trajtës *do+paskajore* (*do+me thënë - domethënë*). Gjurmë e paskajores konsiderohet edhe trajta *ba/bërë* në *duhet ba/bërë* (Bokshi, 1998:10.).

Mënjanimi i paskajores “*me punue*” nga lidhorja “*të punoj*” në toskërishte ka nxitur debatin shkencor prej kohësh.

Paskajorja sot përkufizohet si një nga format e pashtjelluara të foljes, e cila shpreh një veprim a një gjendje në mënyrë të përgjithshme, pa u lidhur me një kohë a vetë të caktuar. (FGJSSH, 1980.)

Mënyra lidhore: një nga mënyrat e zgjedhimit të foljeve në gjuhën shqipe, e cila tregon një veprim a një gjendje që mund, që dëshirohet ose duhet të kryhet a të ndodhë, pasi lidhet me një tjetër (FGJSSH, 1980.)

Në FGJSSH, përkufizimi si më lart ngjet të jetë për paskajoren në përgjithësi, i nënkuptuar si përkufizim për trajtën *për të punuar*.

Nëse bazohemi në këto dy përkufizime, nuk mund të dimë se këto dy trajta foljore kryejnë funksione të njëjta ose jo.

Në gramatikën e gjuhës shqipe (2002:339.) flitet për formën e pashtjelluar të tipit “për të larë” (ajo ka vlerë paskajoreje dhe në disa funksione themelore të paskajores, siç janë: funksioni kryefjalor e kundrinor, ka sot një përdorim të kufizuar”).

Në të njëjtën faqe të gramatikës së gjuhës shqipe (2002:339), në shënim, flitet për paskajoren e tipit “me punue”. Aty thuhet: Me të gjitha funksionet e paskajores përdoret forma analitike e tipit “me la”, e cila ndërtohet duke i paravënë pjesëzën *me* pjesores. Kaq.

Metoda

Metoda e analizës sintagmatike e “substancës” si “manifestim i formës në materie” gjuhësore (Dykro-Dodorov, 1984:43.) na shpie te rezultati, që vjen si rrjedhim i transformimit të substancës (realitetit semantik dhe tingullor) *si manifestim i formës në materie*. Analiza sintagmatike zbulon transformimet suksesive të formave të sistemit të gjuhës në zhvillimin e vet.

Nga transformimet suksesive të formave të sistemit, të rindërtuara në disa nivele sinkronike (Bokshi, 1980:15), sipas konceptit të Sosyrit, në “çdo gjuhë, në çdo moment të ekzistencës së vet, paraqitet një lloj forme organizimi” dhe se funksioni i ligjërimit sforcohet me rolin efektiv të veprimtarisë gjuhësore në zhvillimin e gjuhëve (Dykro-Todorov, 1984:34-36).

Përqasja me gjuhët e tjera, lidhur me kohën e mënjanimet të paskajores nga lidhja, në dialektin jugor të shqipes, jep sado pak rezultate.

Po ashtu, përqasja e funksionit foljor ndërmjet këtyre dy trajtave foljore, përveç funksioneve të njëjta, nxjerr në pah edhe dallimet ku njëra trajtë nuk e zëvendëson tjetrën.

Rezultatet

Manifestimi i formës në materie, i substancës së Sosyrit, ndodh edhe me paskajoren e tipit *me shkue* në formimin e saj. *Transferimi funksional i para-fjalës në pjesëz dhe pjesores atributive epitetike të substantivuar në infinitiv*, si manifestim i formës në materie, është konform teorisë glosematike, me metodën e analizës sintagmatike. Manifestimi i trajtës *me shkue*, ku *me*

është me funksion të pjesëzës së transferuar nga parafjala dhe pjesorja *shkue*, nga epitetizimi i pjesores atributive të substantivuar (*me llampë ndezun/të ndezun – me ndezun llambën*), përbën materien - substancën, me kuptim të ri gramatikor.

Lidhorja *të punoj* është formuar në të njëjtën rrugë transformimi sintagmatik nga *nisi të punuarit*, pas nyjzimit të mbiemrit, rrjedhimisht pas nyjzimit të pjesores dhe nominalizimit të saj, deri te bashkëngjitja e *të-së* me trajtat e ngjashme me të dëftores në *nisi të punojë*, me mjete gjuhësore të shqipes dhe nën ndikimin e një gjuhe fqinje (Shala, 2022, SNGJLKSH).

Paskajorja ka funksion foljor të përgjithësuar dhe herë-herë abstrakt, ndërsa lidhorja ka funksion të saktësuar në secilën vetë. Se në të shumtën shprehin të njëjtin funksion, i shohim nga analiza sintagmatike: në fazat e hershme, të dy format dalin në sintagmën foljore (SV) të paraprirra nga folja kryesore (drejtuese) në funksion të kokës së sintagmës dhe komplementit që shpreh paskajorja (*nisi me punue – nisi me (të) punuar(it) – nisi (me) punën*) dhe lidhorja (*nisi të punojë – nisi të punuarit - nisi punën*).

Dallimet funksionale dalin në disa raste, ku lidhorja është e paaftë që të shprehë funksionin e përgjithësuar deri në abstraksion të paskajores: *me ba, me ardhë, s'na lë rehat!* etj.

Rishikimi i literaturës

Deri te shqyrtimi i Bokshit për prejardhjen e paskajores, të tjerat mbeten shqyrtime të pashtjelluara deri në fund, ndoshta për shkaqe metode. Dominon mendimi se paskajorja është krijuar mbi bazën sintetike të pjesores.

Metoda e Bokshit ka një përkufizim: *analiza sintagmatike zbulon totalitetet sinkronike si transformime sukcesive të sistemit gjuhësor* (Bokshi, 1980:15). Relacionet heterosintagmatike të pjesores, nivelet sinkronike të këtyre relacioneve (Bokshi, 1998:81), u japin zgjidhje disa çështjeve që kanë të bëjnë me trajtat analitike foljore të shqipes, siç është përftimi i paskajorjes së shqipes të tipit *me punue* dhe trajtave të perfektit analitik *pasiv* dhe *aktiv*.

Substantivimi i pjesores epitetike atributive, para formimit të mbiemrit të nyjshëm, *me llambën (të) ndezun - me (të) ndezun llambën*, të çon te paskajorja *me ndezun*. Si e tillë pjesorja e nominalizuar (nominalizim kontekstual,

emër i pashquar) zuri vendin e emrit (llambë) (Bokshi, 1998:136). Pjesorja vinte prapa parafjalës, prapa një segmenti të sintagmës prepozicionale, në funksion të emrit dhe nga substantivimi kontekstual kaloi në emër veprimi. Kështu u formua paskajorja *me ndezun*.

Demiraj, (1986:963), Pedersen (IF (Anzeiger), 92), Çabej, 1955:55, thonë se paskajorja u përftua vetëm në dialektin verior.

Lidhur me prejardhjen e lidhores, prejardhja e markuesit “*të*” është çështja më e diskutuar (Shala, SNGJLKSH, 2022:234-242). Diskutimi ka filluar që herët dhe mendimet janë të ndryshme (Likaj 2015:30-31): se ka origjinë përemërore me origjinë i.e. si *to-tod* (G. Meyer, 1891:125.) ose ka “një lidhje të përafërt me gjermanishten, duke e krahasuar me dëftorin a me nyjën *dass* (das)” (W. Fiedler, 1987:62, sipas Ethem Likajt, 2015:30.).

Se ka origjinë përemërore nga i.e. **to*, shprehet edhe Bokshi (1998:162.). Nga neutraliteti duke qenë “indiferente” ndaj kuptimeve të trashëguara të lidhores së lashtë, që u bë lidhëz e funksioneve të kufizuara të fjalive të varura të kësaj mënyre, u bë pjesë e lidhores. Bokshi thotë se kjo *të* nuk ishte lidhëz që jepte kuptim qëllimor, siç thotë Sandfeldi (1930:175-176).

Pa e shpjeguar burimin e saj, studiues të tjerë thonë se *të* është pjesëz (Weigand-i dhe Domi, sipas Likaj. 30, Topalli). Çabej thotë se *të* është një lidhëz si e lituanishtes “*tai*” “*sikur*”, për të shprehur një supozim. (1963/3:76, sipas Likajt, 2015:30.), kurse më vonë, Çabej (1986:143.) shton se “doli nevoja e përfutimit të këtij elementi *të* që është një mbeturinë e një dëftori”.

Demiraj thotë se *të* ka burim lidhëzor dhe dikur ka qenë lidhëz nënrenditëse, që me vonë u bë pjesë e lidhores, duke u përdorur në fjali kryesore dhe të varura. Edhe Topalli (2011:808) thotë që në krye të herës të këtij qenë lidhëz.

Disa nga teoritë për mënjanimin e paskajores

Burimi te nëna e shqipes apo te një nga gjuhët e tjera të zhdukura del nga hipoteza e substratit, Mikloshiqi (1861) midis elementeve të vjetra vendëse nga gjiri i shqipe-ilirishtes; Weigandi (BA III.273) thotë se mënjanimi e ka burimin te trakoshqipja që ndikoi në greqishten; Gabinski (1967:46) shkon

tutje, se mënjanimi duhet kërkuar në ndonjë gjuhë të vjetër të pjesës juglindore të Ballkanit, në një varietet të trakishtes dhe *me ba* ka pasur vlerën e një gjerundi. E përbashkëta e kësaj është përpjekja për të shpjeguar humbjen e paskajores nga ndikimi i njërës prej gjuhëve të vjetra të Ballkanit (Demiraj, 2004:158-159). Burimi të greqishtja dhe përhapja të gjuhët e tjera të Ballkanit mbështetet nga disa studiues (Sandfeldi, 1930, Rohlsf 1958, Ivanescu, 1980:415, Banfi 1985:61, Feuillet, 1960:110, Bokshi, 2014:55.). Teoria e ndikimit të latinishtes sipas Reichenkron (1962:102-109), kritikohet nga Schaller (1975:159). Ka mendime se është përfutur në mënyrë të pavarrur. Dominon mendimi për ndikimin e greqishtes në mënjanimin e paskajores.

Lidhur me zëvendësimin nga lidhorja, Mansaku (2012:75) thotë se afërsia e greqishtes ka penguar shtrirjen e paskajores në toskërishte. Sipas tij paskajorja "është më afër tipologjisë së gjuhëve romane që e përdorin edhe paskajoren edhe lidhoren sesa me gjuhët ballkanike ku paskajorja është zëvendësuar me lidhoren" (2012:75-76). Në këtë kuadër, Mansaku përmend se "një nga faktorët që ka ndikuar në krijimin e përhapjen e ballkanizmave ka qenë romaniteti ballkanik".

Bokshi (2014:55) thotë se paskajorja e lidhorja kishin bashkëjetuar një kohë. Shprehur kështu, do ta ketë pasur fjalën për lidhoren me *të*, kur ngadalë po mënjanonte paskajoren.

Lidhur me mënjanimin e paskajores

Në greqishte lidhorja ka nisur që në gjuhën e ungjijve të shkruar greqisht, gjatë gjysmës së dytë të shek I të erës sonë (Sandfeld, 1930:177. Solta 1980:213; Banfi 1985:60 etj., sipas Demiraj, 2004:152). Përhapja e saj, duke u bërë dukuri e përgjithësuar, është bërë shumë më vonë, aty nga shek XI të erës sonë (Banfi, 1985:63). Gjurmë të paskajores ndeshen ende aty-këtu edhe në greqishten e sotme, pjesërisht në të folmet greke në Italinë e Jugut, si dhe në dialektin pontik në Azi të Vogël (Sanfeld: 1930:173, Demiraj, 2004:152). Mënjanimi i paskajores dhe zëvendësimi saj nga ndërtime me forma vetore të foljes, të prira nga pjesëza *da* është një dukuri e përhapur edhe në bullgarishte-maqedonishte e pjesërisht edhe në serbishten jugore (shek XI). Mënjanimi i paskajores së serbokroatishtes ndeshet te gjuhët në

kontakt me gjuhët ballkanike, në të folmet e Timok Prizrenit, dukuri e përgjithësuar, por jo edhe në kroatishte. Mënjanimi i paskajores në bullgarishte do të ketë nisur në shek XI-XII e.r. (Sanfeld, 1930:175; Rohlsf, 1958:734, Mirçev, 1950:161, sipas Demirajt, 2004:153).

Mënjanimi ka ndodhur edhe në rumanishte (Ivanescu, 1980), e cila në mjaft raste ka ndjekur një rrugë të ndryshme nga gjuhët romane-perëndimore (mënjanimi i paskajores nga lidhorja në rumanishte është përfutur pas pajisjes së lidhore me pjesëzën *sa*, e cila e ka burimin te lidhëza kushtore latine *si*. Përdorimi i kësaj fjalëze si pjesëz e lidhore ka nisur qysh në rumanishten primitive, d.m.th. midis shekujve VII-X (Ivanescu: 1980:343:416). Mënjanimi i paskajores ka ndodhur në dialektet dhe në të folmet rumune, sidomos arumanishtes, meglenishtes dhe dakorumanishtes jugore. Në Istro-rumanishte paskajorja është ruajtur (Sandfeld, 1930:174, Solta, 1980:211, Schaller, 1975:156.). Në të folmet veriore të dakorumanishtes, paskajorja nuk është mënjanuar fort nga përdorimi (Banfi, 1980: 62). Mënjanimi i paskajores në rumanishte ka nisur qysh në periudhën paralaterale të rumanishtes, para shek XVI (Ivanescu: 1980:343-416).

Pyetje që shtrohen

Cila është rruga e formimit të paskajores dhe lidhore, rrjedhimisht, a ka ngjashmëri në rrugën e formimit të paskajores *me shkue* dhe lidhore *të shkoj*?

Pse ka diçka që përkon në procesin e zhvillimit sintagmatik në përfitim të paskajores “me punue” me lidhoren “të punoj”?

Pse është e rëndësishme koha e mënjanimit të paskajores dhe zëvendësimi me lidhore, në toskërishte?

Ngjashmëria nga pikëpamja funksionale dhe ndërlidhja me kohën e mënjanimit, a çojnë te rruga e ngjashme e përfimit të dy formave foljore? A e ndihmon këtë edhe ajo se në formimin e këtyre formave foljore element kyç është folja kryesore: *shqetësohet me ndezun; filloi të punojë*.

A ka dallime funksionale ndërmjet paskajores dhe lidhore dhe si shihen ato?

Diskutim

Mënjanimi i paskajores “*me punue*” nga lidhorja “*të punoj*”, në toskërishte, është determinuesi kryesor që ka nxitur debatin shkencor prej kohësh lidhur me:

- prejardhjen, formimin e rrjedhimisht edhe gramatikalizimin e të dy trajtave foljore;
- vendin që zë formimi i tyre në kuadër të periodizimit të ndryshimeve morfologjike të shqipes;
- formimin e lidhores, si përcaktues (relativ) i kohës së mënjanimit të paskajores nga lidhorja;
- funksionet gramatikore të këtyre trajtave foljore - abstraksioni që shpreh paskajorja dhe
- lënien e paskajores jashtë standardit të gjuhës shqipe, sa çështje gjuhësore e po aq edhe e politikës gjuhësore.

Ndër të tjera, duhet pasur përpara se nga vjen *të* e bëhet pjesëz e lidhores; cila është rruga e përfutimit dhe si u bashkua me trajtat e njëjta (të ngjashme) me të dëftores dhe koha kur është përfutur. Koha e përfutimit të *të-së* thotë më shumë për kohën e mënjanimit të paskajores në toskërishte. Është e rëndësishme koha e mënjanimit edhe për të ditur lidhur me prejardhjen e *të-së*.

Është i rëndësishëm periodizimi i trajtave me pjesoren dhe rrjedhimisht edhe me lidhoren, i përfutimit të trajtës së pashtjelluar *me punue* dhe trajtës së shtjelluar *të punoj*, në rolin e plotësit, komplementit dhe formimit të së ardhmes me *kam+paskajore* (*kam me punue*), me *do+lidhore* (*do të punoj*), si dhe me *kam+lidhore* (*kam të punoj*). Sipas periodizimit këto trajta mund të renditen si vijon:

- Paskajorja *me punue*, u formua në shek V, afërsisht e njëkohshme me trajtën analitike *kam punue*, para nyjzimit të mbiemrit, (Bokshiti, 1998:83-85).
- *Kam me punue*, ka marrë formë në shek. V-VI (Bokshi, 2010:63; Rugova, 2019:12), kur zhvillimi sintagmatik kishte marrë udhën e vet, pas formimit të perfektit analitik vepror *kam punue*.

- Duke qenë *kam* transitive dhe *me punue* kundrinë, do të kishte kuptimin *kam (të) punuar-it*, kuptim ky i paskajores për të hyrë në relacion me foljen *kam* (Bokshi, 2010:64).
- Formimi i nyjës së mbiemrit të nyjshëm (nyjzimi i pjesores), në shek VI-VII.
- Formimi i lidhores *të punoj* në shqipen, në shek. VIII-IX, gradualisht ka mënjeluar paskajoren në toskërishte. Afërsisht në këtë fazë ndodh mënjanimi edhe në rumanishte. Në greqishte, ndonëse mënjanimi ka filluar që në shek. I e.r. (Sandfeld, 1930, 177, Solta, 1980:213, Demiraj, 2004:152), pas një procesi të gjatë të përdorimit, u bë dukuri e përgjithësuar në shek. XI e.s. (Banfi, 1985:63, sipas Demiraj, 2004:152).
- Trajta e futurit *do të punoj*, me foljen *dua*, u formua pas formimit të lidhores.
- Pas formimit të së ardhmes *do të punoj*, u formua e ardhmja *kam të punoj*, në shekujt XII-XIII (Bokshi, 2012:36, Rugova, 2019:12).
- Paskajorja *me punue* është përdorur pandërprerë në të gjitha format e përdorimit, siç përdoret edhe sot.

Një gjë dihet, mënjanimi i paskajores në disa gjuhë ballkanike u bë në kohë të ndryshme. Siç është thënë edhe herë tjetër, zëvendësimi u bë nga lidhja në të gjitha gjuhët “në fjalë”, siç thotë Sandfeldi, se “nuk është aq shumë mënjanimi i paskajores, sesa fakti që të gjitha gjuhët në fjalë e kanë zëvendësuar atë pikërisht në të njëjtën mënyrë” (sipas Demirajt, 2004:159.), me funksion të ngjashëm foljor. Lidhur me rrugën e ngjashme të formimit të lidhores me atë të paskajores, kam shprehur mendimin tim (SNGJLKSH, 2022).

Paskajorja është formuar në fund të shek. V. disa shekuj pas formimit të perfektit analitik jovepror nga grupi verbal me këpujën jam, me sintagmën adjektivale të realizuar nga pjesorja pësore e perfektit në funksion të mbiemrit të panyjzuar (Bokshi, 1998:136). Edhe perfektit analitik vepror (*kam hapur* (*kam shtëpinë (të) hapur*) me konstruksion transitiv, “me reksion të kundrinës” (Benveniste, 1975:150, 154-55, sipas Bokshit, 1998:83-85) është formuar sikurse paskajorja, para nyjzimit të mbiemrit, deri në fund të shek V, siç kishte ndodhur me gjuhët e tjera (Bokshi, 2010:45). Nyjzimi i mbiemrit dhe

rrjedhimisht edhe i pjesores, u bë diku në shek VI-VIII të e.r. (Bokshi, 2010, f. 82-85).

Ngjashmëri

Lidhorja e shqipes u formua nga një proces i zhvillimit sintagmatik të sistemit foljor pas nyjzimit të mbiemrit, i ngjashëm me procesin e formimit të paskajores. Nuk ishte e mundur që lidhorja të zëvendësojë paskajoren (mënjanimi i paskajores në toskërishte) pa një zhvillim sintagmatik të ngjashëm me të dhe me funksione përgjithësisht të njëjta.

Prejardhja e lidhores me *të* (*të punoj*) është e lidhur me prejardhjen, zhvillimin dhe formimin e ngjashëm sintagmatik, me funksion të paskajores të tipit *me punue*. Paskajorja është formuar para nyjzimit të mbiemrit, ndërsa në të njëjtën rrugë transformimi, pas nyjzimit të mbiemrit dhe të pjesores së nominalizuar, që kishte bërë tashmë rrugën e vet e të kalonte në emër veprimi (prejfoljor), u formua lidhorja analitike, funksionalisht e ngjashme me paskajoren *me shkue* në sintagmën foljore filloi *me punue - filloi të punojë*.

Ky evoluim i lidhores nga forma sintetike në analitike ndodh nga transformimi sintagmatik, kur nyja me origjinë përemërore, e transferuar në pjesëzën *të*, bashkëngjitet me trajtat e foljes, të ngjashme me të dëftores *punoj*, e cila formon trajtën *të punoj*, që del në funksion të “*plotësit të shtjelluar*” (Joseph, 2020). Ajo kishte filluar të kryente funksionin e plotësit të pashtjelluar, të paskajores *me punue*, jo në të gjitha rastet, për shkak të abstraksionit. P.sh. *Me i dalë zot atdheut është detyrë mbi detyra!*; *Me ba me ardhë, na qorton!*

Konsiderohet se trajta *thanë*, në *do thanë-duhet thanë*, është relik i trajtës së vjetër sintetike të paskajores me formë të pjesores, e cila si atributive dhe e epitetizuar, para nyjzimit të pjesores (të mbiemrit), me funksion mbiemëror, e nominalizuar, po zinte vendin e “argumentit” p.sh. *nisi me (të) ndezun llambën* nga *nisi me llambën (të) ndezun* dhe kaloi në paskajore *me ndezun*. Vendin e argumentit, komplementit me një rol tematik (Koskoviku, 2019:68), po e zinte edhe lidhorja *të punoj* në *Ai filloi të punojë*.

Të dy trajtat foljore nga aspekti gjenerativ i fjalisë janë me strukturë argumentore të një përbërësi të fjalisë, komplementë, janë klauza (fjali të

varura) kundrinore. Ato zënë vendin e një kundrinori të drejtë. Nga pikë-pamja gjenerative, “sintagma zakonisht përbëhet nga koka dhe komplementi i saj” dhe se “kjo është një rregull e përgjithshme e ngritur në *parim* me vlerë universale (Koskoviku, 2019:28-29).

Përdorimi me topikë të njëjtë me paskajore dhe lidhore, i trajtave të shkurtra: me **m**’marrë malli, vij!; të **më** marrësh, t’i thuash (Topalli, 2010:180). Buzuku, A ka si me **më** pasë ikë?

Dallime

Mënjanimi i paskajores nga lidhorja në toskërishte dhe mundësia e bashkëjetesës për një kohë të këtyre trajtave foljore, më shumë anon kah fakti se janë formuar në kohë të ndryshme. Formimi i lidhores në shqipen (VIII-IX) po kryhej në fazën përfundimtare të përgjithësimit të lidhores në greqishte, në shek XI (Banfi, 1985:63). Gegërishtja, me gjithë shtrirjen e ndikimit jugor të lidhores në përhapje, po e ruante paskajoren e vjetër.

Dihet, janë trajta të ndryshme me funksione të njëjta, jo gjithherë. Paskajorja ka fuqi shprehëse të përgjithësuar me fuqi shprehëse abstrakte: *me ba me ra shi, drithi na shkon posht; duhet me i grahë me punue*. Fjalitë që gramatika e shqipes i nxjerr si fjali me vetë të përgjithësuar (veta e dytë njëjës e shumës), zakonisht në fjalë të urta, nuk e kanë fuqinë e përgjithësimit e më pak të shprehjes me fuqi abstrakte, sa të paskajores.

Është i ndryshëm përdorimi i pjesës mohuese “mos” me paskajore (para) dhe me lidhore ndërmjet pjesëzës dhe trupit të foljes. (Topalli, 2010:181.); Dëshira ime është që (ti) *mos me gabue* ma. Dëshira ime është që *të mos gabosh* më. Te Buzuku e gjejmë edhe *mos me vëlizenë* për jetë të jetesë (XIa).

Paskajorja ka formë të pashtjelluar; lidhorja formë të shtjelluar me trajta sipas vetave.

Përfundime

- Ka mendime të ndryshme lidhur me prejardhjen dhe përftimin e trajtës së paskajores dhe të lidhores.
- Kanë rrugë të ngjashme të formimit; paskajorja para e lidhorja pas nyjzimit të mbiemrit.

- Këto dy trajta janë formuar me mjete të shqipes, në kohë të ndryshme; lidhorja, me mjete të shqipes, me gjasë nën ndikimin e një gjuhe fqinjë, greqishtes,
- Kryejnë funksione kryesisht të njëjta, jo në të gjitha përdorimet, veçohet karakteri përgjithësues dhe abstrakt i paskajores.
- Janë komplementë: i pashtjelluar - i shtjelluar të VP-sintagmës foljore: filloi me punue – filloi të punojë.
- Në sintagmat foljore të tipit *nisi me shkue* (me paskajore) dhe *nisi të shkonte* (me lidhore) paskajorja dhe lidhorja janë ekuivalente.
- Sot përdorimi i paskajores është gjithnjë e më i dendur. Lidhur me standardizimin e saj gjuhësia shqiptare duhet të merret me të, në të mirë të ruajtjes dhe pasurimit të standardit të përbashkët të shqipes.

Literatura:

Ajeti, I., 1998. *Vepra 3*, Prishtinë.

Bokshi, B., 1984. *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*, Prishtinë.

Bokshi, B., 1998. *Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik)*, Prishtinë.

Bokshi, B., 2005. *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, Prishtinë.

Bokshi, B., 2010. *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*, Prishtinë.

Bokshi, B., 2014. *Varia*, Prishtinë.

Çabej, E., 1986. *Studime gjuhësore VII*, Prishtinë.

Demiraj, B., 2012. *E ardhmja e tipit do + lidhore si dukuri mbarëgjuhësore, dialektore dhe ballkanike në shqipe*, në SHQIPJA dhe GJUHËT E BALLKANIT, Prishtinë.

Demiraj, Sh., 1988, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë.

Demiraj, Sh., 2015, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë.

Domi, M., 2016, *Vepra II Studime sintaksore*, Tiranë.

- Dykro-Todorov, 1984, *Fjalor i shkencave të ligjërit*, Prishtinë.
- Fiedler, W., 2004. *Das albanische verbalsystem in der sprache des Gjon Buzuku*, Prishtinë.
- Gr. autorësh., 2002. *Gramatika e gjuhës shqipe-1*, Tiranë.
- Gr. autorësh., 2002. *Gramatika e gjuhës shqipe-2*, Tiranë.
- Grup autorësh, 1985, *Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, Prishtinë.
- Ismajli, R., 2000. *Tekste të vjetra*, Pejë.
- Ismajli, R., 2012, *Shqipja dhe rumanishtja në SHQIPJA dhe GJUHËT E BALLKANIT*, Prishtinë.
- Ismajli, R., 2015. *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, Prishtinë.
- Joseph, B., 2020. *Vështrime albano-ballkanologjike*, Prishtinë.
- Komrie, B., 1985, *TENSE*, Cambridge University Press, London.
- Koskoviku, B., 2019, *Sintagma parafjalore në gjuhën shqipe*, Prishtinë.
- Likaj, E., 2015, *Zhvillime të mjeteve gramatikore të shqipes*, Tiranë.
- Luka, D., 2010. *Studime për historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë.
- Lyons, J., 2001, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Tiranë.
- Mansaku, S., 2012. *Tipologji romane dhe ballkanike në strukturën gramatikore të shqipes*, në SHQIPJA dhe GJUHËT E BALLKANIT, Prishtinë.
- Pedersen, H., 2003. *Studime për gjuhën shqipe*, Prishtinë.
- Riza, S., 1979, *Studime albanistike*, Prishtinë.
- Riza, S., 2002, *Vepra 3*, Prishtinë.
- Rugova, B. 2019, *E ardhmja në bast – futuri i shqipes*, Seminari Nërkkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 38/1, Prishtinë.
- Sandfeld, K., 1930. *Linguistique balkanique – Problemes et resultats*, Paris.
- Topalli, K., 2010, *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*, Tiranë.

Isa SULÇEVSI

DIMENSIONI SINTAKSOR I KONTAKTEVE TË TURQISHTES ME SHQIPEN

Abstrakt:

Historiografia dëshmon se turqit janë një popull me prejardhje nga Azia Qendrore. Pra edhe turqit e Ballkanit e kanë prejardhjen nga këto vise. Burimet historike kanë evidentuar në dy rrugë të ndara të lëvizjes së fiseve turke nga vatra e katragjyshërve të tyre drejt perëndimit: rruga veriore dhe ajo jugore. Rruga veriore ishte trase e fiseve nomade turke që lëviznin përtej stepave të Ukrainës, në drejtim të Ballkanit dhe Evropës Lindore dhe madje edhe asaj Qendrore. Këto lëvizje të fiseve turke fillojnë të ndodhin qysh në shekullin V., pra disa shekuj para Perandorisë Osmane. Këto fise duket së më shumë janë stacionuar përreth Danubit. Lëvizja e turqve në drejtim të Ballkanit përmes rrugës jugore, sipas burimeve historike supozohet të ketë filluar përgjatë viteve 1260. Këto fise besohet se kanë lëvizur nga Anadulli dhe se në fillim janë vendosur në verilindje të gadishullit ballkanik. Më vonë, me zgjerimin e Perandorisë Osmane në drejtim të Ballkanit, në qendra të ndryshme të trojeve shqiptare janë populluar familje turke, në fillim kryesisht pjesëtarë të administratës, e më vonë edhe zejtarë, tregtarë të ndryshëm. Turqishtja ballkanike, për nga struktura morfonologjike i përket turqishtes oguze.

Kontaktet e para të turqishtes me shqipen, me gjasë, kanë ngjarë para periudhës osmane, por se, në përjashtim të disa toponimeve, si: Kumanova, fusha e Komanit etj., nuk ka ndonjë dëshmi që dëshmon një vazhdimësi të këtyre kontakteve. Ndërsa kontaktet me turqishten oguze, respektivisht atë anadolliane, vazhdojnë edhe më tutje.

Huazimet turke në gjuhët ballkanike është një temë mjaft e lëvruar nga studiues të shumtë të gjuhëve ballkanike. Pra, ndikimi i turqishtes në gjuhët ballkanike, dhe në këtë kontekst në gjuhën shqipe, përmes huazimeve, ka qenë dhe është temë mjaft aktuale. Por ndikimi i gjuhëve ballkanike në turqishten e folur në Ballkan, nuk e ka zgjuar kureshtjen e studiuesve aq shumë.

Sipas ndarjes tipologjike, turqishtja u takon gjuhëve aglutinative (me përngjitje). Gjuhët e tjera me tipologji aglutinative konsiderohen edhe finlandishtja e japonishtja. Ndërsa sipas ndarjes gjenealogjike, turqishtja është gjuhë altaike. Në kontekst të këtij punimi përkatësia tipologjike është me rëndësi.

Burimet historike dëshmojnë se lëvizjet e para të fiseve turke në drejtim të gadishullit ballkanik, kanë filluar qysh në shekullin VII. Ardhja e fiseve turke vazhdon në shekujt në vijim. Në shekullin XI dhe XII nga ana veriore e detit të Zi, në gadishullin ballkanik, migrojnë fise turke që emërtohen Peçenek, Kuman (Kipçak) dhe Uz. Këto fise kanë arritur ta ruajnë identitetin e tyre komunitar deri në shekullin XV. Më vonë, në shekullin XIII fillon ardhja e fiseve turke nga Anadoli. Këto fise i takojnë krahut Oguz, pra krahut jugor, respektivisht jugperëndimor të dialekteve turke. Dialektet moderne të turqishtes që derivojnë nga oguzishtja janë: turqishtja e Turqisë, bashkë me variantet ballkanike, azerbejxhanishtja, turkmenishtja dhe gagauzishtja.

Lëvizjen e fiseve turke nga Azia Qendrore në drejtim të Ballkanit, e trajtojnë shumë studiues, ndër ta mund të veçojmë polakun Tadeusz Kowalsky-n. Si shumë të tjerë, edhe Kowalsky, pohon se fiset turke kanë lëvizur drejt Ballkanit duke kaluar dy rrugë: rruga veriore, që shtrihet në veri të liqenit Kaspik, stepave jugore të Rosisë dhe veriut të detit të Zi. Ndërsa rruga jugore kalon nëpër rrafshnaltat e Iranit, duke vazhduar nëpër Anadoll, e përfundon në Ballkan (Sülçevsi, 2023).

Turqishfolësit në Ballkanin Perëndimor, sipas disa veçorive dialektologjike, duket se e kanë trashëguar një variant të turqishtes së vjetër anadollia-

ne, që është një variant historik i oguzishtes. Për turqishten e folur në Kosovë, bazuar në gjetjet e deritanishme, nuk mund të paraqitet ndonjë gjurmë që dëshmon një kontinuitet gjuhësor me variantet e fiseve turke të turqishtes veriperëndimore, përkatësisht të fiseve që lëvizën rrugës veriore për të ardhur në Ballkan. Pra edhe pse mund të supozohet se kontakti i parë shqipës me turqishten mund të ketë ndodhur në kohërat paraosmane, ky kontakt nuk mund të konsiderohet një dukuri e vazhdueshme që shtrihet deri më sot. Ashtu që në pikëpamjen e vazhdimësisë gjuhësore kontakti i shqipës dhe i gjuhëve të tjera në Ballkanin Perëndimor me turqishten, duhet trajtuar si një dukuri që fillon me administratën osmane në rajon dhe vazhdon tutje.

Këto kontakte gjuhësore me turqishten, në gjuhët ballkanike kanë lënë një trashëgimi gjuhësore që quhen turqizma, e që janë bërë objekt i studimeve të shumta në Ballkan edhe më gjerë. Por nuk janë vetëm turqizmat produkt i kontakteve disashekullore gjuhësore, pasi turqishtja nuk ka pasur statusin e dominuesit absolut ndaj gjuhëve me të cilat ka qenë në kontakt. Dihet se edhe në gjuhën standarde turke përdoren shumë fjalë të huazuara nga gjuhët e popujve ballkanikë. Ta zëmë *plaçka* është huazuar nga shqipja, fjala *vişne* nga bullgarishtja fjala *domates* nga greqishtja, fjala *kral*, *kraliçe* nga serbishtja etj. Për shkak të shtrirjes së gjerë gjeografike, por edhe të faktorëve të tjerë që lidhen me historinë dhe kulturën e popullit turk, turqishtja ka qenë dhe është në kontakt me gjuhë të shumta aziatike, euroaziatike, evropiane. Si rezultat i këtyre kontakteve të shumta, në gjuhën turke ekziston një numër i madh i huazimeve nga arabishtja, persishtja, greqishtja, italishtja, frëngjishtja, anglishtja, rusishtja, armenishtja etj. Edhe këto huazime janë bërë objekt i studimeve të shumta të turkologjisë. Krahas këtyre janë bërë edhe studime të shumta për huazimet gramatikore nga persishtja e arabishtja. Shtytja kryesore për të studiuar huazimet leksikore dhe gramatikore nga persishtja, arabishtja, frëngjishtja, anglishtja etj. në gjuhën turke, natyrisht duhet të jetë faktori kuantitativ dhe ai kualitativ. Si faktor kuantitativ mund ta konsiderojmë numrin e fjalëve dhe morfemave të tjera të huazuara nga gjuhët e sipërpërmendura në gjuhën turke. Ndërsa si faktor kualitativ mund ta konsiderojmë shtrirjen sociolinguistike, pra përdorimi në gjuhën standarde dhe shtrirja dialektore, përfaqësimi në gjuhën letrare, përfshirja në terminologji ose zhargone profesionale, kalimi prej brezi në brez etj.

Sa u përket studimeve për ndikimet e gjuhëve të tjera mbi grupet më të vogla sociolinguistike të turqishtes, janë më të pakta në numër. Bile shumica e këtyre studimeve janë bërë nga studiues joturq. Këto studime bazohen në kontaktet gjuhësore të turqishtes me gjuhët e tjera, por me statusin e gjuhës së ndikuar. Ndër studiuesit që janë marrë me këto studime, mund të veçohen: Lars Johanson, Eva Csato, Astrid Menz, Gyula Nemeth, Süreyya Yusuf, Olivera Jashar, Sami Ibrahimij etj. Për tre të parët mund të thuhet se angazhimin kryesor shkencor e kanë të përqendruar pikërisht në kontaktet e turqishtes me gjuhët gjermane, sllave, hebraishte etj.

Pas këtij parashtrimi të shkurtër, t'i kthehemi temës bosht të këtij punimi. Sipas statistikave të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 në Kosovë, 18,737 veta janë deklaruar se i përkasin komunitetit turk, ndërsa 49,729 veta janë deklaruar se turqishten e kanë gjuhë joamtare. Bazuar në këto të dhëna të vitit 2011, në Kosovë janë më shumë se 68 mijë veta që e flasin turqishten. Po nga këto shifra shihet se raporti i turqishtfolësve burimorë me numrin total të turqishtfolësve, i bie të jetë përafërsisht 2/7, ose 27%. Ndërsa përqindja e turqishtfolësve burimorë në Kosovë është pak më shumë se 1%. Përqindja e të gjithë turqishtfolësve në raport me popullsinë e përgjithshme të Kosovës, i bie të jetë rreth 4%. Këto shifra na japin një pasqyrë lidhur me gjasat e komunikimit të një turqishtfolësi burimor kosovar jashtë banesës dhe vendbanimit të tij, në gjuhën e tij amtare. Gjasa që një turqishtfolës burimor kosovar të komunikojë në gjuhën e tij jashtë vendbanimit ku jeton, janë 1-4%. Kjo në praktikë medoemos nuk duhet të ndodhë kështu, por gjasa statistikore është kjo. Pra në shumicën e rasteve (rreth 96%), turqishtfolësit kosovarë i ekspozohen një gjuhe që nuk e kanë amtare (kryesisht shqipes), në të njëjtën kohë i ekspozohen edhe turqishtes së folur nga turqishtfolës joburimorë. Këto të dhëna statistikore na japin një pasqyrë lidhur me kontaktin e turqishtes në Kosovë, me shqipen por edhe me gjuhët të tjera.

Ky raport demografik i dhënë më lart, është një pasqyrë një sinkronie të vitit 2011 dhe nuk nënkupton se ka vlejtur gjatë gjithë kohës sa flitet turqishtja në Kosovë. Gjithashtu edhe statusi sociolinguistik i turqishtes ka ndryshuar nga gjuha ndikuese, për shkak të prestigjit dhe faktorëve të tjerë, në gjuhë të ndikuar. Prandaj edhe në kontekst të kontakteve gjuhësore shifrat demografike janë vetëm njëri prej faktorëve. Këtu duhet pasur parasysh ekzogamia, për të cilën nuk mund të identifikohet as periudha e fillimit e as

raporti me numrin e përgjithshëm të martesave. Një tjetër faktor i kontakteve gjuhësore është edhe jeta sociale në hapësirat publike. Këtu duhet përmendur që gjatë sundimit osman turqishtja ka qenë një lloj lingua franca; që ky status i ka pushuar pas përfundimit të sundimit osman.

Kontakti i turqishtes kosovare në masë të madhe ka ndodhur me gegërishten dhe me të folmet kosovsko-resavski dhe prizrensko-timočki të serbishtes. Ndërsa në komunikim zyrtar pas përfundimit të sundimit osman, turqishtfolësit kosovarë, krahas dialekteve të sipërpërmendura, i janë ekspozuar serbishtes standarde dhe i ekspozohen shqipes standarde.

Kontakti i turqishtes me shqipen dhe gjuhët e tjera në Kosovë, ka rezultuar me huazimin respektivisht kopjimin e shumë fjalëve dhe të disa formave gramatikore të shqipes në turqishten kosovare. Në këtë punim do të trajtohen kopjimi i ndërtimeve gramatikore, përkatësisht një formë morfo-sintaksore, nga gjuhët me të cilat është në kontakt turqishtja në Kosovë.

Siç u tha më lart, tipologjikisht turqishtja është gjuhë me përngjitje (aglutinative). Si karakteristikë themelore e gjuhëve aglutinative përmenden mosekzistimi i eptimit të brendshëm dhe formave analitike të zgjedhimit foljor. Në turqishten kosovare nuk vërehet ekzistimi i eptimit të brendshëm, por si rezultat i kontaktit gjuhësor, ajo ka zhvilluar forma analitike të zgjedhimit foljor.

Në gjuhën standarde turke të gjitha kategoritë foljore, ku bëjnë pjesë: koha, veta, numri dhe mënyra, diateza, modaliteti i mundësisë apo i pamundësisë, por edhe format mohore, pyetëse dhe mohore pyetëse ndërtohen me mbaresa (prapashtesa) të definuara në mënyrë të qartë. Për ilustrim të marrin një shembull:

Gül-dür-eme-dik-ler-imiz-den -siniz (Ju jeni prej atyre që nuk kemi mund t'i bëjmë të qeshin)

<i>gül</i>	<i>-dür</i>	<i>-eme</i>	<i>-dik</i>	<i>-ler</i>	<i>-imiz</i>	<i>den</i>	<i>-siniz</i>
folja	Diateza shkakore	forma e pamundësisë	pjesore	shumësi i pjesores	pronësia	rasa rrjedhore	veta II shumës e foljes -i (këpujë)

Është një shembull i cili e dëshmon aglutinacionin e turqishtes. Nëse do të provonim që këtë fjalë ta shprehim në turqishten kosovare, ajo do të pësonte ndryshime shumë të mëdha. Kjo fjalë, respektivisht fjali do të dukej si në vijim:

Sizsiniz onlardan ne cüldüremesik.

Në përkthimin brendagjuhësor (prej turqishtes standarde në atë kosovare), qartë vërehet ndryshimi sintaksor, prej një formë tejet sintetike, në një tjetër formë, që është mjaft analitike. Këtu vërehet tendenca për t'i përngjarë sintaksës indoevropiane. Kjo tendencë vërehet në disa raste ku në vend të formave sintetike, përdoren forma analitike duke ndërtuar togje ose lokucione foljore. Në këto ndërtime si gjymtyrë e dytë e togut ose e lokucionit përdoret mënyra dëshirore e turqishtes, por në formën e të folmeve turke në Kosovë (Sulçevsi & Turan, 2019). Ndërsa gjymtyrë e parë e togut mund të jenë folja e përbërë *edebil-* (*mund*) me vlerë modale, për të ndërtuar formën analitike të modalitetit të mundësisë, mbiemri *lazım* (*duhet*) në funksion të foljes modale për të ndërtuar mënyrën e domosdoshmërisë (necesitativit) dhe fjalët *var* (*kam*) dhe *yok* (*nuk kam*) më funksion të foljes ndihmëse, për të ndërtuar formën analitike të kohës së ardhme.

Mënyra e domosdoshmërisë në gjuhën standarde ndërtohet edhe në formë sintetike por edhe në formë perifrastike.

Gelmeliyim // gelmem gerek // gelmem lazım (duhet të vij)

Forma sintetike

<i>gel</i>	<i>meli</i>	<i>yım</i>
folja	mbaresa e domosdoshmërisë	veta I njëjës

Forma analitike / perifrastike

<i>gel</i>	<i>me</i>	<i>m</i>	<i>gerek</i>	/	<i>lazım</i>
folja	infinitivi	veta I njëjës	mbiemri me funksion modaliteti të domosdoshmërisë	/	mbiemri me funksion modaliteti të domosdoshmërisë

Në të folmet turke në Kosovë përdoret forma perifrastike me fjalën *lazım* por me radhitje të ndryshuar. Pra faja *lazım* vendosët në pozitën e parë, ndërsa në pozitën e dytë radhitet dëshirorja.

<i>Veta</i>	<i>Njëjës</i>	<i>Shumës</i>
1.	Łazım işleyeyim / işleyem	Łazım işleyelim / -yeħık, -yam / -yom / -yelok
2.	Łazım işleyesın / -yesi	Łazım işleyesınız
3.	Łazım işlesın	Łazım işlenlar / -sınle:

Ky ndërtim i këtij lloji haset edhe në të folmeve tjera perëndimore të turqishtes ballkanike.

Modaliteti i mundësisë në turqishten standarde ndërtohet me *folje + (y)ebil + veta*, duke iu përshtatur harmonisë së zanoreve.

Ndërsa në të folmet turke në Kosovë (në përjashtim të Prizrenit) përdoren edhe forma e sipërpërmendur, por edhe forma analitike *edebil + veta + dëshirorja (në të gjitha vetat)*.

Edebilirım kaldıraym / kaldırabilirım (mund ta ngre); edebilirsin kaldırasın, edebilir kaldırsın etj.

Ky modalitet përdoret për të shprehur aftësinë, por jo edhe gjasën dhe lejimin. Forma pyetëse *edebilir miyim* përdoret zakonisht për lejim (kërkesë për të bërë një veprim). Ndërsa gjasja shprehet me togun *olur çi + folja në aorist (në kohën e tashme me -er)*.

Për shembull, në turqishten standarde fjala *gidebilirim (mund të shkoj)*, varësisht nga konteksti, shpreh kuptimin e aftësisë, lejimit dhe të gjasës. Në të folmet turke të Kosovës, në kuptim të përdoret edhe forma sintetike *cidebilirım*, edhe forma *edebilirım cideym*. Ndërsa për të shprehur gjasën përdoret lokucioni *olur çi ciderım (ka mundësi që unë të shkoj)*.

Përdorime për këtë modalitet në të folmet e tjera të turqishtes ballkanike, nuk janë evidentuar në punimet e deritanishme.

Turqishtja kosovare, krahas formës sintetike të kohës së ardhme, ka zhvilluar edhe formën që ndërtohet me fjalët *var* dhe *yok*. Këto dy fjalë në gjuhën turke mbulojnë fushën kuptimore të foljes *kam*, por me funksion të mbiemrit (Polisi, 2009, f. 181).

Ders+im var / kam mësim

Ders+imiz var / kemi mësim

Ders-in var / ke mësim

Ders+iniz var / keni mësim

Ders+i var / mësim

Ders+i var / kanë mësim

Siç shihet nga ky shembull, fjala *var*, nuk i nënshtrohet zgjedhimit foljor; ndërsa emrit të paravendosur i janë shtuar mbaresat e pronësisë. Forma mohore e këtij shembulli ndërtohet me fjalën *yok*.

Ders+im yok / nuk kam mësim

Ders+imiz yok / nuk kemi mësim

Ders-in yok / nuk ke mësim

Ders+iniz yok / nuk keni mësim

Ders+i yok / nuk mësim

Ders+i yok / nuk kanë mësim

Koha e ardhme në gjuhën turke ndërtohet me prapashtesën $-(y)acak / -(y)ecek$, duke iu përshtatur harmonisë së zanoreve.

Për shembull:

<i>Alacağım</i> / do të marr //	<i>Alacağız</i> / do të marrim //
kam me marrë	kemi me marrë
<i>Alacaksın</i> / do të marrësh //	<i>Alacaksınız</i> / do të merrni //
ki me marrë	keni me marrë
<i>Alacak</i> / do të marrë //	<i>Alacaklar</i> / do të marrin //
ka me marrë	kanë me marrë

Forma mohore zgjedhohet si në vijim:

<i>Almayacağım</i> / nuk do të marr //	<i>Almayacağız</i> / nuk do të marrim //
nuk kam me marrë	nuk kemi me marrë
<i>Almayacaksın</i> / nuk do të marrësh //	<i>Almayacaksınız</i> / nuk do të merrni //
nuk ki me marrë	// nuk ken i me marrë
<i>Almayacak</i> / nuk do të marrë //	<i>Almayacaklar</i> / nuk do të marrin //
nuk ka me marrë	nuk kanë me marrë

Në turqishten kosovare përdoren dy forma të zgjedhimit: njëra është sintetike, që është e ngjashme me atë të gjuhës standarde turke; ndërsa forma tjetër është analitike, që ndërtohet me fjalët *var* dhe *yok*.

Forma sintetike	Forma analitike	Forma sintetike	Forma analitike
<i>Alacam</i>	<i>Var alaym</i>	<i>Alacaksık</i>	<i>Var alalım</i>
<i>Alacan</i>	<i>Var alasin</i>	<i>Alacaksınız</i>	<i>Var alasınız</i>
<i>Alacak</i>	<i>Var alsın</i>	<i>Alacaklar</i>	<i>Var alsınlar</i>

Forma mohore ndërtohet si në vijim:

Forma sintetike	Forma analitike	Forma sintetike	Forma analitike
<i>Almayacam</i>	<i>Yok alaym</i>	<i>Almayaacasık</i>	<i>Yok alalım</i>
<i>Almayaacan</i>	<i>Yok alasin</i>	<i>Almayacaksınız</i>	<i>Yok alasınız</i>
<i>Almayacak</i>	<i>Yok alsın</i>	<i>Almayacaklar</i>	<i>Yok alsınlar</i>

Ndërtimi analitik i kohës së ardhme në turqishten e Kosovës me fjalët *var* dhe *yok*, është një dukuri e shfaqur si rrjedhojë e kontaktit gjuhësor.

Siç theksohet nga Ismajli (2015, f.19), Demiraj (2004, f. 124), Camaj (1984, f. 152), Tomiq (2006, f. 611), shqipja veriore kohën e ardhme (futura) e ndërton me foljen *kam* + paskajorja. *Kam me punue*.

Ndërsa koha e ardhme e serbishtes ndërtohet me formën e shkurtër të foljes ndihmëse *hteti* (*dua*) + infinitivi ose infinitivi i shkurtuar + enklitiku prej foljes *hteti* (Stanojqi & Popoviq, 1992, f. 120-121, Klajn, 2006, f. 173, 174, Demiraj 2004, f. 120).

Ja ću pevati / Peva ću

Në fund mund të konkludohet se forma analitike e modalitetit të mundësisë *edebil* + *veta* + *dëshirorja* dhe forma analitike e kohës së ardhme me fjalët *var* dhe *yok* në të folmet turke në Kosovë, duhet të jetë një kopje kodi nga gegërishtja.

Referencat:

- Barkan, Ö. L. (2015). İstila Devirlerinin Kolonizatör Türk Dervişleri ve Zaviyeler. *İnsan&İnsan*, 5, 5-37.
- Camaj, M. (1984). *Albanian Grammar: With exercises, hcrestomathy and glossaries*. Otto Harrassowitz.
- Demiraj, S. (2004). *Gjuhësi ballkanike*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Ismajli, R. (2015). *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës.
- İnalçık, H. (2005). Türkler ve Balkanlar. *BAL-TAM Türklük Bilgisi*, 3, 20-44.
- İnalçık, H. (2017). *Devlet-i 'Aliyye, Osmanlı İmparatorluğu Üzerine Araştırmalar-I*. İstanbul: Türkiye İş Bankası Kültür Yayınları.
- Johanson, L. (2002). *Structural Factors in Turkic Language Contacts*. New York: Routledge.
- Klajn, I. (2006). *Gramatika Srpskog Jezika*. Zavod za udžbenike i nastavna sredstva.
- Polisi, M. (2002). *Gramatika e gjuhës turke*. Shkup: Logos-A.
- Stanojčić, Ž., & Popović, L. (1992). *Gramatika srpskog jezika za gimnazije i srednje škole*. Beograd: Zavod za udžbenike i nastavna sredstva.
- Sulçevsi, İ., & Turan, F. (2019). Kosova Türkçesinde İstek Kipi Biçimbirimlerinin Kullanım Özellikleri. *Türkiyat Mecmuası*, 29(1), 127-145. <https://doi.org/10.18345/iuturkiyat.560225>
- Sulçevsi, N. (2023). Tadeusz Kowalski, O Balkanskim Turcima: Kowalski, T. (1936). O Balkanskim Turcima. Knjiga o Balkanu I, Balkanski Institut, pp. 179-187. *Edeb Erkan*. <https://doi.org/10.59402/EE004202312>
- Tomić, O. M. (2006). *Balkan Sprachbund Morpho-syntactic Features*. Springer.

Hana RADONIQI

THEKSI I SHQIPES DHE VARIACIONET GJEOGRAFIKE

Abstrakt:

Kuptimi teknik i termit *aksent* lidhet me mënyrën e shqiptimit. Qëllim i këtij punimi është të përfshijë mënyrat e dallueshme të shqiptimit të fjalëve, veçanërisht të klasave të ndryshme sociale. Diskutimi për këtë çështje mëton t'i bëjë bashkë disiplinat fqinje: në njërën anë sociolinguistikën (aksenti i huaj/ lokal ndërmjet folësve) dhe, në tjetrën, fonetikën dhe fonologjinë (vendi i theksit gjatë shqyrtimit të rasteve kur hiqen tingujt/ rrokjet ose kur shtohen këto).

Së këndejmi, statistikatat e përmbledhura bëhen të krahasueshme, meqë ndërmjet folësve ekzistojnë ndryshoret sociologjike: vendlindja, mosha, arsimimi, marrëdhëniet e pushtetit dhe të ndikimit etj. Pra, trajtohen ndryshimet që janë relevante nga aspekti sociolinguistik: nëse folësi përdor aksentin e tij lokal, si mjet për afirmimin e identitetit dhe të besnikërisë ndaj grupeve lokale – variacioni gjeografik.

Të dhënat dhe transkriptimi: analiza e bisedës është incizuar në bazë të ndërveprimeve natyrale ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm, me qëllim të identifikimit të dukurisë së theksit në shqipen. Dallimi i ilustruar në transkriptë thekson rëndësinë e kontekstit shoqëror: është përdorur transkriptimi fonetik sipas simboleve të IPA-s.

Fjalët kyçe: theks, rrokje, gjuhë e folur, variacion.

Sfondi teorik

Sipas Suzanne Romaine-it (2001: 311), disa gjuhëtarë bëjnë dallimin e mëtejshëm midis aksentit dhe dialektit. Aksenti përbëhet nga shumëllojshmëria e mënyrës së shqiptimit. Një dialekt, megjithatë, varion njëkohësisht nga dialektet e tjera të së njëjtës gjuhë të paktën në tri nivelet e organizimit: shqiptim, gramatikë ose sintaksë dhe fjalor. Kurse, sipas Llamas-it, Mullan-y-it & Stockwell-it (2007: 205–230), aksenti nënkupton modelet karakteristike shqiptimore të varietetit të të folurit. Aksenti i folësit - që cilësohet nga fonemat dhe nga modelet e intonacionit - mund të identifikojë shpeshherë klasën e tij shoqërore, moshën, gjininë, prejardhjen gjeografike, përkatësinë etnike e, madje, edhe përkatësinë e tij politike. Nga ana tjetër, sipas tyre, theksi i referohet forcës artikulative mbi rrokje të caktuara, e cila i jep akseptit ritëm karakteristik. Me fjalë të tjera, sipas Coupland-it (2007: 5), aksenti u referohet aspekteve shqiptimore të dialektit, ndërkaq dialekti është term i përgjithshëm për variacionin e të folurit që ka të bëjë me anën shoqërore dhe gjeografike.

Pra, theksi i intereson një fonologu për mënyrën se si një rrokje e caktuar shquhet mbi të tjerat në fjalë. Një sociolinguist, në anën tjetër, hulumton dhe përshkruan mënyrën se si shqiptimi i tingujve në fjalë ndërlidh apo dallon grupet e caktuara të folësve (Ismajli et al. 2020: 340).

Më pas, Hudson-i (2002: 53) ka theksuar se, në përgjithësi, shqiptimi është më i ndjeshëm ndaj dallimeve krahinore dhe shoqërore, sesa gramatika dhe fjalori. Kështu që, theksi i referohet vetëm shqiptimit, dialekti i referohet çdo aspekti tjetër të gjuhës (morfologji, sintaksë, leksik).

Tutje, sipas Edwards-it, meqë është e qartë se ndryshimi në bazë shoqërore është implikuar edhe në dallueshmërinë rajonale: dallimet gjeografike, shoqërore ose klasore bashkërisht janë konsideruar si themelore (2013: 31).

Në anën tjetër, Ismajli ka shpjeguar se ndryshimet dialektore dhe vtrat e dinamizmit në dallimet lidhur me përshtatjen e vendit të theksit të huazimit e reja, qëndrojnë jo më në raportet gegërishte/ toskërishte, po shqipe në Shqipëri dhe shqipe në Kosovë ose, në hapësira të tjera, në Maqedoni dhe tek arbëreshët. Sipas tij, për këtë ndikojnë: skemat theksore brenda shqipes, modelet e gjuhëve prej nga huazohet, gjedhet e gjuhëve me ndikim më të madh në shqipen (siç është italishtja në Shqipëri), moda dhe fenomenet e

tjera të natyrës shoqërore etj.; p.sh., disa nga variacionet janë: Shqipëri – *ópera, kámara, kompjútër, bíznes, çiménto* etj.; Kosovë – *opérë, kamérë, kompjutér, biznés, çimént* etj. (2005: 178-179).

Në këto rrethana, me terma të përgjithshëm, në sociolinguistikë theksohen dy forca të ndryshme: mikro-sociolinguistika dhe makro-sociolinguistika. E para (Coulmas 1998, Holmes 2015) shqyrton mënyrën e ndikimit të strukturës shoqërore në atë se si njerëzit flasin dhe, po ashtu, lidhjen e varieteteve të gjuhës dhe të modeleve të përdorimit me atributet shoqërore, si klasa, gjinia dhe mosha; në anën tjetër, e dyta, studion mënyrën se si shoqëritë e përdorin gjuhën, d.m.th. qëndrimet dhe lidhjet e tyre që shpjegojnë përndarjen funksionale të formave të folurit në shoqëri, si ndryshimi i gjuhës, kujdesi për gjuhën dhe zëvendësimi i gjuhës - pra, caktimi i kufijve dhe ndërveprimi i bashkësive folëse.

Më pas (Topalli 1995a), studimet në shqipen kanë vërtetuar se kuantiteti (gjatësia) e zanoreve luan rol në realizimin e theksit e që shqipja priret t'i theksojë zanoret parafundore, duke krijuar fjalë me ritëm trokaik. Pra, sipas të dhënave (Topalli 1995b), karakteristikë për sistemin vokalik të shqipes është rënia e një zanoreje (edhe e një rrokjeje) që është jashtë theksit të fjalës, ku fjalët me ritëm daktilik janë kthyer në fjalë me ritëm trokaik (sidomos me rënien e zanores -ë- në fund fjale). Mirëpo, shpjegimi i theksit në kuadrin e këtij punimi, lidhet me gjeografinë dialektore, në të cilën **kuantiteti** varion ndërmjet dialekteve, por edhe nga faktorët sintaksorë a të sand'hit (bashkimi i dy fjalëve ose i formave të fjalës, duke rezultuar në ndryshimet sistematike fonologjike), meqë zhvillohet diskutim i gjerë ndërmjet folësve.

Në përputhje me këtë, mund të flitet edhe për variacionet stilistike në përdorimin e gjuhës, ku folësit ndryshojnë stilin e tyre të folurit – pra, gjuha e folësit ndikohet nga dëgjuesi dhe, po kështu, e ndikon dëgjuesin. Sipas Bell-it (2001: 141-148), thelbi i dizajnit të audiencës mund të përmbledhet sipas disa pikave, si rezultat i variacionit të ndërfolësit (inter-speaker). Stili nënkupton se si një folës i veçantë e përdor gjuhën në raport me njerëz të tjerë (lidhja e tipareve gjuhësore me grupe të caktuara shoqërore). Pra, në përgjithësi, dizajni i audiencës shfaqet kur folësi e ndryshon stilin e folurit, për të qenë më i ngjashëm me personin që është duke folur: kjo është “konvergjencia” sipas teorisë së akomodimit të komunikimit/ të folurit,

zhvilluar nga Howard Giles-i, Peter Powesland-i (1975) dhe Coupland-i et al. (1988). Ndërsa, divergjenca simbolizon dëshirën për ta pakësuar intimitetin/ kujdesi i vazhdueshëm gjatë të folurit: simbolizon dëshirën për ta reduktuar intimitetin që nënkupton asnjë variacion ose asnjë devijim nga mënyra e komunikimit (Coupland 2007: 62).

Rëndom, shoqëria sot karakterizohet nga nivele të larta të lëvizshmërisë (gjeografike dhe shoqërore). Karakteristikë e gjuhës janë ndryshimet, të cilat vijnë nga vala e vërshimeve e teknologjisë dhe kontakti me botën. Shkaqet e ndryshimeve gjuhësore janë: kontaktet gjuhësore (konstruktet e huazuara nga gjuhë të tjera), mediat elektronike (komunikimi dixhital), diferencimet sociale etj. Përmes ndërveprimeve të faktorëve ekonomiko-shoqërorë merren fjalë të reja, të cilat integrohen gjatë të folurit. Shquhen për ndryshime: leksiku, struktura e fjalisë dhe mënyra se si shqiptohet fjala. Studiues të globalizimit vënë në dukje se, pa gjuhë, nuk do të kishte globalizim; dhe, e kundërta, pa globalizim, nuk do të kishte gjuhë botërore (siç është tani përhapja dhe konsolidimi i shpejtë i anglishtes). Të tjerë, flasin për “gjenocid gjuhësor”, duke ia vënë gishtin globalizimit. E tërë kjo përfshin edhe këtë hulumentim, në të cilin shfaqen një mori fjalësh të huaja, në masë të madhe nga anglishtja e që për synim ka vendosjen e theksit në shqipen.

Megjithëkëtë, si formën kryesore të ndikimit të proceseve të globalizimit në shqipen, Munishi e sheh ndryshimin e diskurseve publike, të zhanreve dhe të stileve gjuhësore (2015: 28–31).

Për më tepër, meqë ky punim mbështetet te një material disaorësh në trajtë dialogu me karakter formal, është vënë në pah se varieteti i folur standard nuk i mënjanon varietetet e tjera gjuhësore, por është komplementar me ta. Analiza do të bazohet te takimi i dytë publik për vitin 2016 me qytetarët e Komunës së Gjakovës, i cili është mbajtur më 20. 12. 2016 në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Gjakovës. Mbledhja ka filluar në orën 13:00 dhe ka zgjatur më tepër se tri orë (pa ndërprerje). Moshë e pjesëmarrësve mund të ndahet në tri kategori: 23-40, 41-59, 60-77; në fakt, ka dominuar mosha e grupit të dytë.

Disa gjetje

Ekstrakti 1 është transkriptimi i një sekuence të vazhdueshme nga paraqitja e Kryetares së Gjakovës, 42 -vjeçare, e lindur në Gjakovë. Fillimisht, ajo ka shpalosur tërë programin e Komunës për vitin 2016, gjithashtu edhe planet e tjera të porealizuara që janë të planifikuara për vitin 2017. Në vijim, do të paraqiten karakteristikat thelbore përgjatë prezantimit të saj, ku siç është theksuar te trajtimi teorik, synim do të jetë rënia e shpeshtë e tingujve te format e pashtjelluara të foljes dhe theksi te leksiku i huaj terminologjik që në shumicën e rasteve lidhet me anën ekonomiko-shoqërore:

00:20	/ke·mi pa:s/ (× 12)
00:43	/tə ske:məs sə subventsiɔ·neve/
01:57	/ve·tem kă fi·tu:/ (× 2)
02:01	/lɔkatsiɔ·ni dʒiθastu:/
02:43	/mɔskɔnstitui·min ẽ kuve·ndit/
02:45	/efitʃie:ntsa ẽ enerdʒi:s/
03:25	/implementi·mi i kti·j prɔje·kti/
03:33	/impjia·nti i u·jrave tə ze·za/
05:45	/kă fpa:ɫ tende·rin/
07:04	/păr nə spenzi·m mă efitʃie:nt t·budʒe·tit/
08:43	/nă sɫa·jdin/
09:06	/mikrɔfɔ·n stati·k/ ləvɪ·zəs/
11:48	/ðẽ senzɔ·rve/
12:04	/diɔʒitalizi·min ẽ administra:təs/
13:37	/mẽ unitse·fin/
14:18	/mẽ paji·sjet dʒipi·s/
16:01	/ngă juendipi·ja/
18:16	/ja:n inkasu:/
19:50	/mamɔgra·fit stati·k/
19:53	/rɔtarja·nve int/ ndərkɔmta:r/
21:06	/he·ndikɔs/ se·jv ðẽ tʃi·ɫdrən/
30:42	/studi·m fizibilate·ti/
34:03	/ẽ tangɔ·jn setsi·lin tʃyteta:r tə kɔmu:nes sə dʒakɔ:ves/

Nga ekstrakti 1 vërehet se folësja ka përdorur një varietet më formal, sepse veprimtarisë intelektuale (niveli arsimor i saj në fushën e ekonomisë) ia ka përshtatur diskursin; jo pak, në një situatë të tillë formale, janë të pranishme edhe tiparet dialektore të ngjashme me gegërishten. Nuancimet drejt varietetit dialektor joformal/ lokal janë bërë jo se kishte ndërrim situatash a domenesh, por sepse shumica e qytetarëve kanë qenë nga rrethinat e Gjakovës. Në këtë rast, elementet karakteristike për varietetin verior të folëses, janë: rënia e zanores *-ë* fundore ka krijuar fjalë me rrokje të mbyllura (*kanë qenë* > *ka'n tʃe:n*), fjalët me katër rrokje kanë përfunduar në fjalë dyrrrokëshe (*në tërësinë* > *nə tər̩sɪ:n*). Më të shpeshta janë fjalët me theks fundor, si rezultat i rënies së shpeshtë qoftë të zanores së pashquar *-ë*, qoftë të rrokjes. Karakteristikë tjetër që është e theksuar më të shumtën e herëve është rënia e rrokjes fundore te format e pashtjelluara të foljes: përafërsisht 80% e rasteve të përdorimit të këtyre foljeve dëshmojnë se më i preferuar është ndërtimi pa *-ur* (pasur), *-ë* (qenë), *-er* (pëlqyer), *-ar* (punuar) dhe *-rë* (parë), duke i ekonomizuar këto konstrukte për të fituar kohë me rrjedhën e të folurit. Prandaj, edhe shumica e fjalëve njërrrokëshe ose me theks fundor si pjesë e këtij transkriptimi del si rrjedhojë e këtij fenomeni.

Tipar i spikatur është edhe përdorimi i fjalëve të huaja, qofshin ato emërtime të organizatave të huaja joqeveritare (zakonisht si shkurtesa), qofshin fjalë të leksikut të përditshëm e të përshtatura sipas gjedhes së shqipes: *nə stər̩jdɪn*, *senzər̩ve* (theksi në rrokjen e fundit të temës - 'sensər anglisht), *mamogrəfit* (në pjesën e fundit të temës - ma'mogrəfi anglisht), *ə tangəjn* (e prekin) etj.

Ekstrakti 2 është transkriptimi i folësit të dytë, qytetar i fshatit Lipovec të Gjakovës (fshat në regjionin e Hasit), 39 vjeçar, me arsim të lartë në fushën e ekonomisë. Folësi ka folur shpenguar, duke i zgjedhur dhe duke i shfaqur dukshëm trajtat e tij krahinore, psh.:

36:21 /m_ũ θɜmɜlu: nĩ komɪsjo'n pšr sfjyrti'min ž enkɜsəu
t_ɜmɜrti'mit t_ru:gve//

36:55 /ə ăft ɪ pertsektu'n dɜstini'mi i kty're mjetev n_nĩ proje'kt
t_vetʃe:nt//

37:15 /problɜ'mi mə drejto're t_ʃkó'čäv/

37:43 /t_ferbi'meɥ publi'ke/

Vërehen plotësisht tiparet dialektore: pjesoret e shkurtra që pakësojnë rrokje (për shkak se gjenden në rrokje të hapura, zanorja fundore është e gjatë), prirja për ndërftjen e “glajdit” -u (gjysmëzanore) në pozitë pas zanores të mbaresa në rasën gjinore, por edhe e kundërta: prirja për heqjen e zanores -e fundore si pjesë përbërëse e mbaresës në rasën gjinore. Qartazi, foljet dhe klasën emërore i karakterizon theksi fundor, duke mos munguar edhe fjalët me vetëm një rrokje, për shkakun se në ligjërimin e lidhur fjalët kanë hyrë në marrëdhënie të ngushta.

Ekstrakti 3 është transkriptimi i folësit të tretë, qytetar i fshatit Ramoc të Gjakovës, 70-vjeçar, mësues pensionist. Preokupimet e tij kanë qenë të lidhura me asfaltimin e rrugëve:

39:00 /i:fte fstru:e nã zavo:r/

39:06 /õ domtu:e fu:m/

39:45 /për m_ũ asfaltu:e/

40:05 /jo:n ndertu:e ru:g tje'ra/

42:30 /ã ðu:e ne've nũk nã tako'n nĩ pje:s ë aty'ne pa'rev/

Karakteristikë e tij ka qenë togu i zanoreve -ue te foljet, mungesa e nyjave të përparme te përemrat e pacaktuar; elementet dialektore janë vërejtur edhe te përdorimi i nyjës së pashquar *ni* dhe, së fundi, rënia e shpeshtë e tingujve ka bërë që shumica e fjalëve dyrrokëshe të përfundojnë si njërrrokëshe.

Ekstrakti 4 është transkriptimi i folësit të katërt, qytetar i fshatit Nivokaz të Gjakovës, 65 -vjeçar, me arsim të lartë, sekretar i një klubi të hendbollit. Për dallim nga folësit e mësipërm, i katërti shquhet për tipare të tjera të të folurit:

44:53 /dãdõ m3't3r ë shtru:m ë ru:gs//

45:18 /v:ft ë pabo'me tje' v:ft tu'rpi koso'vs/

45:27 /ru:g tje' ë kã furnizu: koso:ven dga't lu'fts më staðe:t pertfi'n t_arnati'mit/

48:08 /nũk mũj të lo: pã kalu: tãf'eðe të t_mi'rat/

49:26 /tje' v:ft pu:n ë jurvja/

Pra, në masën më të madhe, e dallon rënia e ë-së pastheksore, duke krijuar kështu grupe komplekse bashkëtingëlloresh në fund të fjalës, rrjedhi-

misht fjalë dyrrrokëshe: *koso·vs*, *džako·vs*, *evro·ps* etj. dhe futja e *v*-së pastheksore në vend të *a*-së te përemri pronor (plus kësaj, me një përpara, pavarësisht se është përemër i emërzuar që ndodhet përpara një emri në të pashquarën): *ë ju·vja*.

Ekstrakti 5 është transkriptimi i folësit të pestë, qytetar i fshatit Babaj i Bokës të Gjakovës, 58 -vjeçar, me arsim të mesëm – bujk me profesion:

50:35 /e·ðe u:ren ë kã demtu:e ujt//

50:54 /ke·m fú:m se·ne për pã bo:/

Është përdorur varieteti lokal dialektor, ndërsa baza e tij regjionale vërehet pëveç se te sistemi foljor, edhe tek ai emëror: *ujt*, *ba·baj bo:ks* etj.

Ekstrakti 6 është transkriptimi i folësit të gjashtë, qytetar i fshatit Xërxë të Rahovecit, 55 vjeçar, me arsim të mesëm – mjeshtër kopshti, i cili jeton në Zvicër:

52:47 /m_o:ft uzurpu: pro·na tšë tãf ë ðe:t vi·te//

Të folurit ka qenë më i përmbajtur (duke u gjendur para alternativave drejt formave dialektore/ standarde), por që nuk kanë munguar rëniet e tingujve, sidomos te pjesoret: *škaktu:*, *škru:*, *karku:*, *përdže·dž* etj.

Ekstrakti 7 është transkriptimi i folësit të shtatë, qytetar i Gjakovës, 77 -vjeçar, me arsim të lartë – stomatolog, pensionist:

54:32 /ën ke·t mle·ðje nũk kã mã fu:m tšyteta:r//

54:51 /nĩ evenime·nt ĩ ti:ł du·het respektu·ar/ e·ðe du·het tšmu·ar/ e·ðe du·het vlersu·ar//

Në të folurit e tij, është shfaqur përpjekja për një realizim të trajtave të standardit (edhe përdorimi i huazimit /*evenime·nt*/), porse edhe ndërrimi i stilit nuk ka munguar, duke dalë në sipërfaqe mjedisi gjeografik. Në pjesën tjetër të kohës janë shpërfaqur rëniet, si: /*meðzi·θse*/, /*ka·n kalu:*/, /*së sĩ më punu:*/, /*me·j bo:*/ (me i bo), /*je·mi matretu:*/, /*pãsa·jne*/ (shtesë tingujsh), /*rmu:j*/, /*ĩ informu·n*/, /*meðzi·θate*/ etj.

Ekstrakti 8 është transkriptimi i folësit të tetë, qytetar i fshatit Gërquinë të Gjakovës, 52 vjeçar, me arsim të mesëm – i papunë:

1:01:56 /psë n_·ffartin gertfi:n asni: me·ter asfa·łt nũk ä·ft ba://

Të folurit e tij është i afërt me gegërishten në tërë shqiptimin, fillimisht kur e ka zënë në gojë emrin e vendlindjes, por edhe në rastet kur *n*-ja paraqet vlerën e saj silabike, meqë është hequr zanorja *ë*: /n_{ff}artin/ (duke krijuar grupe fjalësh me një theks të vetëm).

Ekstrakti 9, në kuadër të përgjigjeve, është transkriptimi i kryesuesit të Kuvendit të Komunës, i lindur në Gjakovë, 55- vjeçar, me arsim të lartë – specialist i mjekësisë interne. Gjuha e folësit ka qenë e afërt me publikun: para së gjithash, të gjithë i përkasin dialektit gegë. Specifikat e dukurisë së theksit të fjalisë në kuadrin e fonetikës sintaksore, janë:

09:16 /ka'n tfe:n tə involvu'n e'ðe drejtori:a ě urbani'zmit//

09:24 /a'ft vendos li'sta definiti've nă kət asamble: komuna'le/ a'ft votu: nă mny:r unani'me/

10:36 /t_{tsi}'lat ja'n du'ke bo:fejzi'min ě ru:gve//

Po ashtu, si shumica e folësve të mëparshëm, foljet i karakterizon theksi fundor (/ke'mi trafegu:/, /a'ft perfundu:/, /ka'n tfe:n/, /a'ft vendos/, /ki'fa lu:t/, /ja'n du'ke bo:/ etj.), ndërsa edhe në klasën emërore theksi bie në rrokjen e fundit të temës (/tfeveri'sja ě kalur'ne/, /protse'si/, /li'sta definiti've/ etj.), por duke mos munguar edhe fjalët me vetëm një rrokje (/i dži'θ/, /nă kət/, /nă mny:r/, /ju'j/ etj.), për shkakun se në ligjërimin e lidhur fjalët kanë hyrë në marrëdhënie të ngushta.

Ekstrakti 10 është transkriptimi i folësit të dhjetë, qytetar i fshatit Koricë të Gjakovës, 45 -vjeçar, me arsim të lartë. Si i pari në rundin e dytë të pyetjeve e për dallim nga të tjerët, ky folës i kishte të shkruara në letër tërë kërkesat që kishte ndaj udhëheqësve komunalë. Si rrjedhojë e kësaj, të folurit ishte i kujdesshëm, i përmbajtur dhe, është vërejtur kujdes më i shtuar te trajtat foljore:

15:17 /ke'mi adresu'ar/

Ekstrakti 11 është transkriptimi i folësit të njëmbëdhjetë, qytetar i fshatit Gërçinë të Gjakovës, 70 -vjeçar, me arsim të ulët, mjeshtër i shtëpive – pensionist. Janë vënë në pah rregullisht trajtat dialektore edhe pse është ndodhur në situatë formale:

16:25 /ă ě ka'n hɛ'ner mi't/ ä ö ka'lb/ ä ku:r s_{der}pre'het//

Pra, kemi *mi·t* për minjtë, *o ka·lb* për është kalbur dhe *derpre·het* për ndërpritet.

Ekstrakti 12 është transkriptimi i folësit të dymbëdhjetë, qytetar i fshatit Cërmjan të Gjakovës, 33-vjeçar, me arsim të lartë, përfaqësues i Sindikatës së QKMF-së (Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare). Ai i është drejtuar kryetares me tri pyetje, për të cilat kishte mbajtur shënime. Në këtë mënyrë, të folurit e tij ka rezultuar me një dozë më të madhe të kujdesisë, por pa i anashkaluar edhe format dialektore:

17:57 /sĩ py·tje tã mi·ja/ domeθo:n n_kãt deba·t/ ĩ ka·m evidentu:
tri://

Ekstrakti 13 është transkriptimi i folësit të trembëdhjetë, qytetar i Gjakovës, 71 vjeçar, me arsim të lartë, pensionist:

21:13 /tri: mi·j ve:t mre·na di·tes/

Ekstrakti 14 është transkriptimi i folësit të katërbëdhjetë, qytetar i fshatit Kushavec të Gjakovës, 47 vjeçar, me arsim të mesëm:

22:21 /dy·/ a·ft tã·ftja ë u·mes/ zo·na kuyeta·ie/ n_ma·is/ dajto·li
m_kã telefonu: tã/ nã ú·i a·ft a·ið ñi·hm ðë pa·kua·hje ë
fãsakã·s//

Ekstrakti 15 është transkriptimi i folësit të pesëmbëdhjetë, qytetar i Gjakovës, 34 vjeçar, me arsim të mesëm. Për pyetjet kishte mbajtur shënime, andaj ka pasur përqendrim edhe në të folur:

24:30 /ki·fa da·ft/ na·fta/ m_ũ pa·dži·dž kuyeta·ija//

Ekstrakti 16 është transkriptimi i folësit të gjashtëmbëdhjetë, qytetar i Gjakovës (përfaqësues i komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas), 30 -vjeçar, me arsim të lartë. Ky ka shfaqur siguri në shqiptimin e tij, pra në përdorimin e një varieteti më standard, por edhe larmi rastesh të tjera:

25:58 /sã dõ t_jet ë gãtme/ komuna/ më mbãftert më la·nd
dje·gse//

Ekstrakti 17 është transkriptimi i folëses së shtatëmbëdhjetë, qytetare e Gjakovës (qytetare e komunitetit rom nga Lagjja Dardania në Piskotë), 72 - vjeçare, me arsim të ulët. Të folurit e saj është përcjellë me një varg elementesh dialektore:

27:02 /jũ luˈtna saħaˈt ẽ paˈua mẽ aˈũđ aty://

27:14 /eˈđe moˈ t̪etaˈf s̪ẽ jkã ũ boː/ eˈđe mã zi://

27:39 /ã uˈne jaˈm kã ẽ duː t̪eˈt ruːg//

28:18 /jaˈm rdzuː dyː triː heːu//

Është hasur gjatë gjithë kohës – si të gjithë moshatarët e saj në këtë debat – stili i varietetit joformal dialektor.

Ekstrakti 18 është transkriptimi i folëses së tetëmbëdhjetë, qytetare e Gjakovës, 23 vjeçare, me arsim të lartë. Është folësja me moshën më të re nga tërë pjesëmarrësit e tjerë:

29:32 /jaˈm d̪af̪mitaː.ɛ t̪ã kyˈ viˈt t̪ã p̪i loˈjim p̪ãs aˈft koːn mã i miˈ.i p̪ã.ɫiniːn ẽ d̪zakoˈves/

Pavarësisht se folësja ka dashur t'i kushtonte vëmendje diskursit, gjendja e saj e brendshme e ndikuar nga mjedisi përreth, ka ndikuar edhe në përzgjedhjen e fjalëve me disa tipare joformale.

Ekstrakti 19 është transkriptimi i folësit të nëntëmbëdhjetë, qytetar i fshatit Devë të Gjakovës, 29 -vjeçar, me arsim të lartë:

30:43 /mã keˈni t̪fuː ni p̪ard̪ziˈd̪ze p̪ar̪meˈs emaːjt̪it//

30:54 /kreˈjt koˈhen ũ pedaːt kjoˈ puːn//

31:18 /ã s̪keˈm uːj t̪vaːds/ ã s̪keˈm uːj t̪piˈjes/

31:58 /θmiːja voˈd̪zel/

Shqiptimi i fjalës nga anglishtja *ímejll*, te folësi ka dalë me theks në rrokjen e fundit të temës.

Ekstrakti 20 është transkriptimi i folësit të njëzetë, qytetar i fshatit Devë të Gjakovës, 37 vjeçar, me arsim të mesëm:

33:33 /p̪õr jaˈn eˈmrat ẽ atyˈne buˈrau//

Ekstrakti 21 është transkriptimi i folësit të njëzetënjëtë, qytetar i fshatit Hereq të Gjakovës, 50 -vjeçar, me arsim të mesëm:

35:00 /py:tja dy:t/ v'ft n' konte:st i tɔ:ks t' t'fytetɔ:rt/ ẽ ci:la n'ũk ka:
t' bɔ:j m'ẽ zy:ren ẽ privatizi'mit//

Sikurse për folësin nga Nivokazi, edhe për këtë ka qenë karakteristikë rënia e *ẽ-së* pastheksore, duke krijuar kështu fjalë me rrokje të mbyllur ose njërrrokëshe: /i tɔ:ks/. Pastaj, janë dy huazime /konte:st/ dhe /ẽ privatizi'mit/, me të cilat folësi është ambientuar, për shkak të nevojës për t'i përdorur dhe të ballafaqimit me vite.

Pastaj, **Ekstrakti 22**, në kuadër të përgjigjeve, është transkriptimi i Drejtorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, i lindur në Gjakovë, 58 vjeçar, me arsim të lartë – specialist i mjekësisë së përgjithshme. Në diskutimin e tij janë vërejtur përveç rëniat e tingujve, edhe shtesa të tyre të herëpashershme:

48:15 /pə.ɪve'f'kse:jne/

48:30 /ð'ẽ jũ jeni ko:n t'obligu:n t'f'ẽ n'kuar'de.ɪ t'ati'jne/ tende:ɪit/

Pra, në këtë shembull paraqitet epiteza si shtesë e një rrokjeje në fund të fjalës: /kse:jne/, /t'ati'jne/; po ashtu, veçori tjetër është emri i huazuar /tende:ɪit/, i cili i është përshtatur modelit të shqipes, duke bërë që të mos theksohet rrokja parafundore si në gjuhën angleze.

Ekstrakti 23 është transkriptimi i Drejtorit për Gjeodezi dhe Kadastër, i lindur në Gjakovë, 60 -vjeçar, me arsim të lartë – inxhinier. Si tipare të ngjashme më folësin paraprak është epiteza dhe përdorimi i fjalës së huazuar plot 6 herë:

50:18 /n'ã m'any:ɪ detsidi've/ (× 6)

D.m.th., përsëritja e shpeshtë e mbiemrit /detsidi've/ lidhet me statusin e tij shoqëror, sidomos me pozitën. Mbiemri është sipas gjedhes së shqipes, duke u theksuar prapashtesa ose rrokja fundore e temës.

Ekstrakti 24 është transkriptimi i fundit i Drejtorit për Shërbime Publike, i lindur në Gjakovë, 49 -vjeçar, me arsim të lartë – inxhinier. Si tipare të përafërta me folësit e tjerë, mund të merret reduktimi në masë i rrokjeve të foljet, të emrat më shumë sesa të mbiemrat (meqë edhe kanë dalë më shumë në numër) etj.:

58:04 /mi:po/ p'ã m'ẽ m'ẽ n'ã hu:p pa:et/

Përfundime

Në punim janë pasqyruar karakteristika gjuhësore ose variacionet ligjërimore si rezultat i faktorëve shoqërorë. Diversiteti i gjuhës vihet në dukje në dallimet gjeografike, se si flasin individët në situatë formale. Sasia më e madhe e vëmendjes që i është dhënë të folurit shfaqet te folësit punonjës të Kuvendit (5 të tillë), sesa nga folësit e qytetit (4), nga folësit e fshatrave (13) ose nga folësit e pakicave (2). Së këndejmi, të gjithë folësit kanë qenë të besimit mysliman, ka mbizotëruar gjinia mashkullore (21) në krahasim me atë femërore (3).

Më tej, pas shqyrtimit të teksteve të regjistruara, duke i përmbledhur variantet e çdo ndryshoreje, duhet theksuar se theksi në ligjërimin e lidhur nuk e ka të njëjtën vlerë sikur në fjalën e veçuar. Brenda përbërjes së fjalisë, parafjalët e thjeshta, lidhëzat e thjeshta, pjesëzat, trajtat e shkurtra, nyjat etj., kanë dalë në pozicion të patheksuar, prandaj tërësisht pesha e theksimit të fjalëve ka qenë tek objektet, veprimet a tiparet.

Për shkak se rrokja varet nga prania e zanoreve, këto kanë qenë më të prirura që të pësojnë rënie, duke krijuar tema njërrrokëshe nga tema trokaike që mbarojnë me zanoren *-ë* (/mi:r/, /tfe:n/, /ka'n/, /ðo:n/, /fu:m/, /dʒi:θ/, /a'ft/, /ku:r/) – 64%; pas këtyre, dukshëm më pak në numër, vijnë temat daktilike (me mbaresa /gra'nteve/, /fo'ndeve/, /u'jrave/) – 35%.

Rëniat e tingujve kanë qenë më të shprehura në fund të fjalës: /performa:nts/, /enerdʒi:s/, /ndarkomta:r/, /mjɛ'tev/, /pje:s/, /pa'rev/, /pɛrtʃi'n/, /i ti:t/, po kështu, edhe me qindra pjesore të tjera, te nyjat e përparme *tə* dhe *sə*, te mbiemrat, te trajtat e shkurtra të përemrave vetorë, te numërorët, te pjesëza *tə* e mënyrës lidhore; pastaj vijnë ato në mes: /marve'fja/, /tərsi:n/, /fitu'si/, /senzo'rve/, /vɛrjt/, /rotaria'nve/, /mundsu:/, /ru:gt/, /kty're/, /gu:rt/, /mða'j/, /lu:fts/, /mny:r/, /fejzi'min/, /mi't/, /dʒe'gse/ dhe, në fillim: /s_derpre'het/. Të gjitha këto fenomene i kanë përfshirë si folësit nga qyteti, edhe ata të fshatrave; kurse shtesat e tingujve ose ndër-këmbimi i tyre kanë qenë tipike për folësit e rrethinave.

Së këndejmi, ka pasur shfaqje edhe të dukurisë së haplologjisë, sidomos te pakësimi i numrit të rrokjeve të njëjta, si: *lutjeje*, *matjeje*, *nisjeje*,

thirrjeje etj. Paraqitja e tingullit *-j-* për ta shmangur hiatin është bërë e dukshme posaçërisht te përemri pronor femëror, psh.: /tə mi:ja/, /ě je'me/.

Nga ana tjetër, numërori karakteristik *një*, në zonat rurale në grupet numëror + emër, ka dalë me më shumë variante: *nji*, *ni*, *i* (/sod i vjet/), por edhe si numëror themelor *nja*; për më tepër, personat me status të lartë shoqëror e kanë përdorur *një*, por edhe *ni*, duke bashkekzistuar kështu dy variantet konkurruese në të njëjtën kohë. Sipas kësaj, variacioni i stilit mundësohet nga variacioni shoqëror.

ALBANIAN STRESS AND GEOGRAPHICAL VARIATIONS

Abstract:

The technical meaning of the term *accent* is related to the way it is pronounced. The purpose of this paper is to include distinct ways of pronouncing words, especially of different social classes. Discussion of this issue seeks to bring together close disciplines: on the one hand sociolinguistics (foreign/ local accent between speakers) and, on the other, phonetics and phonology (the place of stress when considering cases when sounds/ syllables are removed or added).

As a consequence, the summarized statistics become comparable, as there are sociological variables between the speakers: place of birth, age, education, power and influence relations, etc. Therefore, changes that are relevant from a sociolinguistic point of view are addressed: if the speaker uses his local accent as a tool of affirming identity and loyalty to local groups – geographical variation.

Data and transcription: the conversation analysis was recorded based on natural interactions between different participants, in order to identify the phenomenon of stress in Albanian. The difference illustrated in the transcripts emphasizes the importance of the social context: has been used phonetic transcription according to the IPA symbols.

Keywords: *stress, syllable, spoken language, variation.*

Bibliografia:

1. Bell, Allan (2001). Back in style: reworking audience design. *Style and Sociolinguistic Variation*. Cambridge University Press: Cambridge (139-169).
2. Coulmas, Florian (1998). Introduction. *The Handbook of Sociolinguistics*. Blackwell Publishing: Oxford.
3. Coupland, Nikolas (2007). *Style: language variation and identity*. Cambridge University Press: Cambridge.
4. Eades, Diana (2010). *Sociolinguistics and the Legal Process*. Multilingual Matters: Bristol.
5. Edwards, John (2013). *Sociolinguistics: A Very Short Introduction*. Oxford University Press: New York.
6. Holmes, Janet (2015). *Hyrje në sociolinguistikë*. Pegi: Tiranë.
7. Hudson, Richard A. (2002). *Sociolinguistika*. Dituria: Tiranë.
8. Ismajli, Rexhep (2005). *Drejtshkrimet e shqipes*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës: Prishtinë.
9. Ismajli, Rexhep, Rugova, Bardh & Munishi, Shkumbin (2020). *Leksikon i termave të sociolinguistikës*. ASHAK: Prishtinë.
10. Llamas, Carmen, Mullany, Louise & Stockwell, Peter (2007). *The Routledge Companion to Sociolinguistics*. Routledge: Abingdon.
11. Munishi, Shkumbin (2015). *Shqipja në epokën e globalizimit*. Zero Print: Prishtinë.
12. Romaine, Suzanne (2001). Dialect and Dialectology. *Concise encyclopedia of sociolinguistics*. Elsevier: Oxford (310–319).
13. Topalli, Kolec (1995a). *Theksi në gjuhën shqipe*. Shtëpia Botuese Enciklopedike: Tiranë.
14. Topalli, Kolec (1995b). Rënia e zanores së rrëguar fundore sipas të dhënave të “Mesharit” të Gjon Buzukut. *Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*. Eurorilindja: Tiranë (427-431).

Qëndresa JAKUPI

TOPIKË DHE FOKUS, DY KONCEPTE “TË PANJOHURA” PËR GRAMATIKAT E SHQIPES (KODIMI I TYRE NË GJUHËN SHQIPE)

Qysh në Qarkun Gjuhësor të Pragës u propozua se fjalitë në një gjuhë tregojnë një artikulum informativ të përbërë nga dy pjesë, njëra më pak informuese (topika/tema) dhe tjetra më shumë informuese (fokusi/remaja). Çdo tekst është i organizuar mbi këto dy nocione që quhen njësi informimi dhe ndarja e një fjalisë në topikë dhe fokus e nënkupton strukturën e informacionit. Termi *strukturë e informacionit*, ose siç njihet ndryshe *paketim i informacionit*, e përshkruan mënyrën në të cilën informacioni paketohet formalisht brenda një fjalisë (Lambrecht 1994). Ky term në gjuhësi u prezantua për herë të parë nga Halliday (1967), ndërsa vetë koncepti i ka rrënjët në antikitet dhe është përdorur për një numër dukurish të ndryshme. Por, në këtë punim përdorni i nocionit *strukturë informacioni* i referohet mënyrës se si paraqitet informacioni brenda një fjalisë dhe është në kontrast me vetë informacionin që përcillet.

Përveç emërtimeve *topikë dhe fokus* që i referohen ndarjes së fjalisë në njësi informative, në literaturën e gjuhësisë ekzistojnë edhe dikotomitë, si: *Temë-Remë*, *Topikë-Koment*, *Focus-Presupozim*, *Fokus-Propozim* i hapur ose *Fokus-Sfond* (Vallduví 1990). Këto dikotomi termash kanë dalë nga autorë dhe shkolla të ndryshme në mungesë të një konsensusi për emërtimin e këtyre dy nocioneve. Megjithëkëtë, të gjithë këta terma synojnë të përkojnë me nocionet topikë dhe fokus, dhe kanë për qëllim ta përshkruajnë mënyrën e përgjithshme në të cilën strukturohet informacioni i çfarëdo lloji qoftë, përmes veprimit topikë / fokus. Janë dy nocione që markohen dhe realizohet

gjuhësisht ndryshe, pasi gjuhët përdorin mekanizma të ndryshëm gjuhësorë, për ta strukturuar informacionin.

E, sa i përket markimit të topikës dhe fokusit në gjuhën shqipe, në grammatikat e shqipes të shekullit të kaluar është trajtuar shumë pak ose është anashkaluar fare. Ndërsa në shekullin e ri këto dy nocione janë trajtuar në grammatikat e shqipes në këndvështrime të ndryshme nga Rrokaj (2012); Rugova dhe Sejdiu-Rugova (2015), Koleci dhe Turano (2011). Prandaj, në këtë punim synohet të trajtohet më hollësisht markimi i topikës dhe fokusit në gjuhën shqipe, duke i vënë në pah karakteristikat sintaksore dhe diskursive të të dy nocioneve.

Për ta analizuar ndarjen e fjalisë në njësi informative në gjuhën shqipe ky punim mbështetet te konceptet *topikë dhe fokus* që mbrohen nga Shkolla e Pragës e cila përkufizimet e topikës dhe fokusit i ka formuluar në bazë të kufijve kontekstualë ose lirisë kontekstuale, me ç'rast elementi gjuhësor që lidhet me kontekstin supozohet të jetë më lehtë i qasshëm për dëgjuesin, pasi ai tashmë është i aktivizuar në kujtesën e folësit nga diskursi paraprak.

Kështu për ta nxjerrë në pah nocionin e topikës Casielle-Suarez (2004), duke u mbështetur në teoritë që janë zhvilluar nga Shkolla e Pragës i analizon karakteristikat tipike të topikave: që i ndan në dy grupe: ***karakterizimet diskursive dhe sintaksore*** të topikës.

Analiza e karakteristikave apo vetive tipike të topikave ***Karakterizimet diskursive të topikës***

Sa u përket karakterizimeve diskursive të shfaqjes së topikave, sipas Casielles- Suarez (2004), merren parasysh katër karakterizime të ndryshme të diskursit në të cilin shfaqen elementët topikë. Ata kanë të bëjnë me konceptet që do t'i trajtojmë më poshtë, si: *aboutness*, referencat diskursive, diskurs paraprak dhe lidhja kontekstuale.

Aboutness - një topikë zakonisht njihet si “ajo për të cilën flitet në fjali” dhe i referohet një diçkaje për të cilën folësi supozon se personi që e dëgjon atë ka disa njohuri paraprake për të. Një element mund të konsiderohet temë, nëse fjalia mund t'i përgjigjet pyetjes “Çfarë ndodhi me X-in?”, me ç'rast X është përbërës i topicalizuar. Për shembull:

Një top i rrezikshëm brenda zonës / Ø_[TopP] e ka larguar më pas Mërgim Mavraj. (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Referentët diskursivë - Një nocion tjetër i temës lidhet me elementin topik (topical element) të një referenti të diskursit. Megjithëse ka nocione të ndryshme të referencës së diskursit, në kontekstin e strukturës së informacionit, ai përdoret në përgjithësi për t'iu referuar etniteteve të diskursit (Casielles-Suarez ibid. 26). Referentët diskursivë gjithmonë janë topika. P.sh.: përemri projektton një referencë diskursi më vete, i cili kërkon një përbërës paraprak të përshtatshëm (Bott 2007). Për shembull:

Norvegjezi Haaland është vlerësuar se në tregun e transferimeve ka vlerë prej 101 milionë eurove. [Ai]_{TOPP} ka kontratë deri në vitin 2024...

Një nga karakteristikimet më të njohura të topikave që i barazon ato me informacionin e dhënë është vetia e **diskursit paraprak**. Në fakt topika përkufizohet si një përbërës diskursi që normalisht shpreh informacionin e dhënë të nënkuptueshëm nga diskursi e paraprak (Rizzi 1997: 285).

Po e marrim një shembull:

Kevinin e kam mik shumë të mirë...

[Ky miku im i mirë] _{TOPP} [u martua me Britney Spears vitin e kaluar]

FocP.

Në këtë rast [Ky miku im i mirë /_{TOPP}] është topikë që e përcjell një informacion të njohur, pasi e specifikon cili mik dhe, po ashtu, është përmendur më parë në diskurs.

Koncepti tjetër ka të bëjë me **lidhjen kontekstuale**. Sipas këtij koncepti, jo të gjithë elementet e diskursit paraprak janë topikë dhe jo të gjithë elementët topikë i përkasin diskursit paraprak. Në këtë teori, topikat nuk kufizohen si entitete diskursi. Në fakt, ato nuk kufizohen më saktësisht në elemente diskrete. Topika mund të përfshijë të gjithë elementet që lidhen me kontekstin, duke përfshirë edhe foljet. Për shembull, Sgall et al. (1986:57) thekson se në fjalinë *Kastorët ndërtojnë DIGA*, përgjigjja e pyetjes “Çfarë ndërtojnë kastorët?”, - “Kastorët ndërtojnë” do të konsiderohej si topikë, ndërkaq DIGA është fokusi.

Ka disa **kufizime sintaksore** mbi topikat. Krejt në fillim topikat janë barazuar me kryefjalët e fjalive; pastaj janë identifikuar me pikën fillestare të fjalisë dhe janë ndërlidhur me format përemërore.

Megjithatë qoftë për karakterizimet sintaksore qoftë edhe ato diskursive, ka mospajtime kjo ndoshta për faktin që secili gjuhëtar niset nga struktura e gjuhës së vet native.

Po, për një gjë janë të sigurt se *topika* është pjesa e fjalisë që lidhet kontekstualisht; ajo korrespondon me PËRBËRËSIT që folësi supozon se janë aktivizuar në kujtesën e dëgjuesit në një moment të caktuar kohe (Sgall et al. 1986:29).

Kodimi i topikës në gjuhën shqipe

Sintagma e topikës

Tema/topika fillimisht është përkufizuar si “një element i veçuar në mënyrë karakteristike nga pjesa tjetër e klauzës me një zbritje intonacioni dhe normalisht duke shprehur informacionin e dhënë disi të disponueshëm dhe të spikatur në diskursin e mëparshëm” (Rizzi 1997: 285; Frascarelli & Hinterhoelzl 2007; në klauzë që kanë një veçori [+ Top]. Po e japim më poshtë përmes Bianchi & Frascarelli 2010). Brenda një konfigurimi spec - kokë - komplement, koka e projeksonit funksional është një kokë *Top* (e realizuar haptazi në gjuhët natyrore të botës), sintagma e përparme është në pozicionin *spec* dhe komplementi përbën një koment/fokus për atë temë. Koka e temës (*Top*) tërheq ata elemente diagramit:

	TopP
XP	Top'
Top°	YP
XP= topikë	
YP= koment/fokus	

Për një gjuhë si shqipja së pari mund të propozohet një ndarje themelore për mënyrën se si realizohen sintagmat e topikës. Sintagmat e topikës në gjuhën shqipe mund të kodohen në disa mënyra: topika mund të kodohet brenda një sintagme boshe, pra që nuk shprehet fonetikisht dhe, po ashtu, të kodohet brenda një sintagme që shprehet fonetikisht, pra realizohet në strukturën sipërfaqësore.

Siç thamë, topika në gjuhën shqipe mund të realizohet nëpërmjet sintagmave apo përbërësve të tjerë sintaksorë që nuk shfaqen fare në strukturën sipërfaqësore, por në strukturën e thellë ata ekzistojnë. Zakonisht në këta përbërës të pashprehur sipërfaqësisht fshihet elementi topik, prandaj, pikërisht, ato kategori sintaksore që shtrihen në kufijtë e topikës mund të mos realizohen në strukturën sipërfaqësore (Rizzi 1982, Casielles – Suarez 2004, Frascarelli 2007). Meqë këta përbërës sintaksorë (sintagmat e topikës) janë aktivizuar më parë në diskurs, janë entitete të njohura për dëgjuesin dhe folësin, nuk përsëriten, por mbesin entitete të hesitura/të pathëna (silent), por që realizohen në strukturën e thellë. Në gjuhën shqipe janë vënë re këto këto kategori *boshe* përmes së cilave realizohet topika:

- a. *Genci nuk erdhi me ne. Ø Kishte shkuar më herët.* (kryefjalë me kategori boshe/null subject *pro*)
- b. *Mos e fto Gencin! Nuk i flas Ø.* (kundrinë me kategori boshe/null object *pro*)
- c. *Kur të paska humbur qeni? E pashë dje në oborrin tënd.* (kundrinë e realizuar përmes klitikut)

Për secilën prej këtyre rasteve flitet në nënkapitujt e ardhshëm.

1.5.2. Topika e realizuar me kryefjalë boshe (*null subject*)

Shqipja bën pjesë në grupin e gjuhëve ku vepron parametri i kryefjalës zero (null subject language), ku bëjnë pjesë edhe arabishtja, baskishtja, spanjishtja, italishtja etj. Sipas këtij parametri, në këto gjuhë, kryefjala nuk realizohet fonetakisht, por projektohet në mënyrë sintaksore, duke u plotësuar pozicioni i saj në strukturën e thellë nga një përemër zero (*pro*) (Chomsky 1981, Rizzi 1982, etj.). Sipas Rizzit (1986: 518-523), një përemër mund të mos shprehet fonetakisht, nëse:


- a. *Licencimi*

pro është markuar me fleksionin e X^0y , ku y është i parametrizuar.

- b. *Identifikimi*

pro i trashëgon vlerat e veçorive f (formale; TB) të X^0y (nëse ka veçori f ; nëse jo, *pro* merr një interpretim të paracaktuar, zakonisht arbitrar).

Për Rizzin një gjuhë e tillë si, për shembull shqipja, mund të zgjedhë INFL si licencues për *pro* në pozicionin subjekt dhe V për *pro* në pozicionin e kundrinës. Për sa i përket identifikimit, Rizzi argumentoi se *pro* si referent lejohet nëse INFL specifikohet për veçorinë e agrimentit, pra të vetës e të numrit. Në diagramin më poshtë tregohet se specifikuesi i INFL drejtohet nga INFL, dhe identifikohet pastaj nga specifikuesi i marrëveshjes (agrimetit), për ta fituar vetën e parë, *kam dashur*.



Pra, *pro* në pozicionin e specifikuesit të *Infl* është në funksion të kryefjalës, ndërsa për të qenë topikë duhet ta plotësojë kriterin e lidhjes me diskursin [+D-linking] (Rizzi 2005). Pra, ajo kryefjalë boshe e ngritur në pozicionin e specifikuesit, për të qenë topikë duhet të jetë aktivizuar më parë në mendjen e dëgjuesit në diskursin paraprak, pra ta ketë një referencë në klauzat e mëparshme. Prandaj, specifikuesi interpretohet si një argument i lidhur me diskursin, për të cilin pastaj bëhet një koment.

Për të parë sesi realizohet në gjuhën shqipe topika përmes kryefjalës zero, merren disa shembuj mostra nga korpusi i studimit:

1. S4: Ajo vrasje ka qenë në ditar në lajm / ajo te dikush osht trishtuse / $\emptyset_{[TopP]}$ te dikush osht si ni model.
2. S5: $\emptyset_{[TopP]}$ Osht e pashmangshme / \emptyset nuk munesh mos me raportu \emptyset (Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)
3. Norvegjezi Haaland është vlerësuar se në tregun e transferimeve ka vlerë prej 101 milionë eurove. Ai ka kontratë deri në vitin 2024, por $\emptyset_{[TopP]}$ nuk pritet të qëndrojë gjatë te Dortmundi. (Koha ditore, 23 mars 2020)
4. I lartë topi brenda zonës / $\emptyset_{[TopP]}$ i larguar menjëherë nga Xhaka. (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Në shembullin 1. dhe 2., SE (ajo vrasje) shërben si referencë për dy *pro*-të që realizohet nga S4 dhe S5, d.m.th. aktivizohet njëherë në klauzën e parë

nuk përsëritet fonetiki, pasi tashmë është përbërës i njohur për folësin. Edhe në shembullin 3., pothuajse është situatë e njëjtë, SE përsëritet dy herë në atë kontekst njëherë përmes përemrit anaforik *ai*, dhe pastaj në klauzën e tretë realizohet përmes një *pro*-je, pasi tashmë nga konteksti po dihet se tema për të cilën po bëhet fjalë është *Norvegjezi Haaland*. Në rastin 4., SE-ja si topikë nuk realizohet, por dihet se referencën e ka në klauzën e parë. Mbetet bosh në klauzën e dytë, ndoshta për atë që Chomsky (1981) e quan ekonomi gjuhësore, meqë është një lojë futbollit, komentatori shpejton për ta nxënë aksionin që po ndodh në fushë.

Strukturat që na propozon Rizzi (1986, 1997) supozojnë se tema ose topika është një kategori rekursive, domethënë, nuk ka kufi për numrin e temave, për shembull, brenda një fjalie mund të ketë më shumë se një temë si rasti i shembullit të dhënë më lart: *Ø nuk munesh mos me raportu Ø*, ku i kemi dy topika të realizuara, e para realizohet përmes kryefjalës me kategori boshe dhe e dyta realizohet përmes kundrinës me kategori boshe. Pra, topika në gjuhën shqipe mund të realizohet edhe me një kundrinë që nuk është e pranishme në strukturën sipërfaqësore.

1.5.3. Topika e realizuar me kundrinë boshe (*null object*)

Kundrinat e foljeve transitive sikurse në shumë gjuhë të botës edhe në gjuhën shqipe mund të mos shfaqen në strukturën sipërfaqësore, pra të mbesin të pashprehura fonetiki, por aktive dhe të projektuara në mënyrë sintaksore. Sipas Rizzit (1986), pozicionin e *pro* ka projektuar Parimi i Projeksionit, sipas tij, *null objects (pro)* licensohen nga sintagma verbale (VP), dhe pastaj identifikohet përmes koindeksimit dhe përshtatet në bazë të roleve θ (theta). Ai na jep dy struktura ku gjenerohet *pro* si komplement, nën a. në pozitë pas foljes dhe nën b. në pozitë paraverbale.

VP		b. VP	
V	NP	V	SC
<i>pro</i>		NP	Pred
		<i>pro</i>	

Mosekzistimin e kësaj *pro*-je në strukturën sipërfaqësore Mara Frascarelli (2007) e lidh me një lloj të veçantë teme. Sipas saj, mosrealizimi i kundrinës fonetiki lidhet me statusin e saj të topikës. Kur shtrihet brenda kufijve të topikës ajo nuk realizohet, sepse njihet nga diskursi paraprak. Një gjë e tillë dallohet edhe në gjuhë shqipe. Po i marrim disa shembuj nga korpusi:

5. S4: *Ajo vrasje ka qenë në ditat në lajm.*
6. S5: *Osht e pashmangshme/ Ø_[TopP] nuk munesh mos me raportu Ø_[TopP]* (Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)
7. IKSHPK-ja apel të moshuarve: Mos dilni nga shtëpia ... “*Na ndihmoni pak që t’iu ndihmojmë shumë, së bashku ne mundemi dhe ia dalim Ø_[TopP]”*, thuhet në njoftim. (*Koha ditore*, 30 mars 2020)
8. Një top i rrezikshëm brenda zonës / Ø_[TopP] e ka larguar më pas Mërgim Mavraj. (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Në shembullin e 6., SE-ja në funksion të kryefjalës është njësia që *pro* i referohet, por vetë realizohet si kundrinë pasi licensohet nga V dhe përshtatet me veçoritë e foljes, pra folja kërkon kundrinë. Në rastin e dytë, nga konteksti bëhet me dije që *pro* i referohet *koronavirusit* (IO), pasi është edhe topika e diskursit. Por ky *pro* realizohet si kundrinë pas kërkesave të foljes, pra u përshtatet tipareve morfo-sintaksore të foljes. Edhe rasti tjetër është i tillë, veçse këtu *pro* realizohet në pozicion para foljes.

1.5.4. Topika e realizuar me klitikë

Dyfishimi i kundrinës me klitik është një fenomen që ndodh kur përemri klitik dhe kundrina përkatëse XP shfaqen në të njëjtën klauzë, me ç’rast klitiku i kundrinës funksionon si marker i agrimentit, ndërsa kundrina (XP) i plotëson kushtet tematike dhe të rasës brenda vP (Gabriel dhe Rinke 2010: 58-59). Dyfishimi klitik e përfshin dyfishimin (ose "përsëritjen") e një përemri klitik të një argumenti foljor i cili “bashkëpunon” me klitikon brenda së njëjtës strukturë propozuese ose brenda të njëjtës klauzë (CP). Rolin “e bashkëpunëtorit” brenda argumentit foljor e luan një përemër, një shprehje referuese jopëremërore, si dhe një klauzë (CP). Kur argumenti foljor ose bashkëpunëtori është një përemër ose një DP, klitiku i bart të njëjtat tiparephi (φ) sikur përemri ose DP, ndërsa, kur argumenti është CP, klitiku është

një element i vetëm në akuzativ (Kallulli dhe Tasmoeški 2008: 1). Dyfishimi i kundrinave të drejta nuk është trajtuar vetëm si fenomen morfo-sintaksor, por edhe element që jep sinjale sa i përket strukturës së informacionit (Gabriel dhe Rinke 2010; Kallulli 2000; Fridman 2008; Kapia 2008). Është parë si “mekanizëm që e heq kundrinën nga komenti (fokusi) i fjalisë dhe bën atë pjesë të informacionit të dhënë (topikë) (Holton, Mackridge & Philippaki-Warburton 1997: 432). Pra, kundrina dhe klitiku e marrin statusin e topikës në fjali, pasi dyfishimi ndodh kur klitiku i referohet një referenti që tashmë është i pranishëm në diskurs. Domethënë, XP-ja prezantohet më parë në diskurs, duke u bërë kështu referent konkret i disponueshëm për përzgjedhje më vonë përmes mekanizmit të dyfishimit. Realizimi i topikës përmes klitikut mund të shihet më poshtë në shembujt e nxjerr nga korpusi i hulumtimit:

9. *Po ti mos um_[TopP] fol për repin n’ Amerik / po flasim për repin e Kosovës... / merre, dëgjoje_[TopP] ...* (Emisioni *Pressing*, 30 maj 2022)
10. *Ja_[TopP] vodhi kuletën pasi tërhoqi para nga bankomati, policia arreston të dyshuarin brenda ditës.* (*Koha ditore*, 18 prill 2022)
11. *E_[TopP] ka larguar (topin).* (Komentimi i ndeshjes Serbi-Shqipëri, 14.10.2014)

Në shembullin 9. topika po realizohet përmes klitikut *e* në pozicion enklitik, pra kjo *e* i referohet repit në Kosovë. Në klauzën e dytë nuk përsëritet më sintagma, por realizohet përmes klitikut. Në shembullin 10. topika si pikënisja e mesazhit realizohet përmes klitikut *i* që i referohet dikujt. Pra ai dikush është i panjohur për audiencën, por dihet që diçka i ka ndodhur dhe forma përemërore dikujt si topikë po kodohet përmes klitikut *i*. Edhe shembulli i fundit topika po kodohet përmes klitikut *e*.

2. Fokusi

Fokusi është diskutuar gjerësisht brenda gjuhësisë si një aspekt kyç i komunikimit (shih Chomsky 1971, Jackendoff 1972, Rooth 1985, 1986, 1992, Lambrecht 1994, Erteschik-Shir 1997, 2007). Sipas Gürer (2020), për t’u koduar domenet e fokusit, fushat prozodike, theksi i fjalisë, semantika, pragmatika dhe sintaksa ndërveprojnë me njëra-tjetrën.

Fokusi përgjithësisht priret të markohet duke u rreshtuar në mënyrë prozodike me skajin e djathtë ose të majtë të një domeni prozodik. Në rreshtimin e një përbërësi të fokusuar dhe një përbërësi prozodik, përfshihet edhe morfo-sintaksa, pasi skajet e përbërësve prozodikë shpesh bien në të njëjtën pikë me skajet e përbërësve sintaksorë (Fery 2013).

Një grup gjuhësh, si: anglishtja, italishtja, por edhe shqipja priren ta rreshtojnë fokusin me skajin e djathtë të një *ι*-frazë. Siç propozon edhe Samek-Lodovici (2005) që një përbërës i fokusuar gjendet në skajin e djathtë të një sintagme intonacionale si pasojë e një kufizimi STRESS-FOCUS, meqenëse në gjuhët që kanë rend kanonik SVO, theksi është caktuar në skajin e djathtë të një fraze *ι*, dhe fokusi është rreshtuar në mënyrë që theksi të bie në fokus. Si në rastin më poshtë:

(x) I

Konteksti: Çfarë ka bërë Drini?

(x) P

Drini [ka notuar]FocP

Për *t*'iu përgjigjur pyetjes më lart “Çfarë ka bërë Drini?”, fokusi prek një përbërës të vetëm në përgjigje, përkatësisht atë që korrespondon me pyetjen, të gjithë SF-në e përgjigjes përkatëse “ka notuar”. Kjo SF meqë tani e ka statusin e fokusit rreshtohet krejt djathtas, për *t*'u përshtatur me theksin. Pasi kufizimi SF penalizon ata konkurrentë që nuk arrijnë të theksojnë fokusin. Pra, fokusi krejt djathtas ndodh, sepse theksi kryesor supozohet të shtyhet më djathtas nga kufizimet prozodike dhe kjo nga ana tjetër e tërheq fokusin më së miri, për ta plotësuar kufizimin e fokusit STRESS-FOCUS. Dhe kjo është pozita in-situ e realizimit të fokusit.

Por në disa gjuhë sikur edhe në gjuhën shqipe jo gjithmonë fokusi rreshtohet djathtas për shkak të disa kufizimeve sintaksore dhe prozodike që mund ta bllokojnë.

1. //Kukeli e kthen [praapa] FocP tek Mavraj//

Në këtë shembull, ndajfolja është ajo që e bart theksin emfatik. Për shkak të këtij theksi ajo nuk realizohet bashkë me SF-në në një sintagmë ϕ .

Sepse forca e Stress-XP-së do që ndajfolja ta bartë informacionin e ri. Kushti që fokusi të theksohet kërkon që përbërësi i fokusuar dhe theksi kryesor të përputhen me njëri-tjetrin, duke e detyruar njërin ose tjetrin ta braktisë pozicionin e tij kanonik. Dhe kjo është pozita ex-situ e realizimit të fokusit.

Përfundimi

Në këtë artikull, diskutuam për konceptin e strukturës së informacionit, duke provuar t’i ndajmë “me thikë” njësitë e informacionit, pra topikën dhe fokusin në gjuhën shqipe. Edhe pse ka shumë dilema që ngjallin konfuzion. Megjithatë, gjithnjë është pranuar se fokusi dhe topika janë nocione strukturore të rëndësishme të informacionit gjuhësor, pasi ato pasqyrojnë kufizimet e paketimit të informacionit në realizimin formal të fjalive dhe që nëpër gjuhë të ndryshme kodohen ndryshe. E për ta hetuar kodimin e tyre, nevojitet njohja e karakterizimeve që i diskutuam më lart.

Së pari, ofruam një studim të shkurtër historik, i cili na tregoi disa nga përkufizimet e temës/topikës në literaturë. Pastaj, i shqyrtoam karakterizimet e ndryshme sintaksore dhe diskursive, si dhe motivimin që qëndron pas tyre. Duke e marrë parasysh rrethimin sintaktik, referencat diskursive, kontekstin, informacionin e njohur, kemi arritur ta përkufizojmë semantikisht dhe sintaksisht topikën dhe kodimin e saj në gjuhën shqipe. Në bazë të punës empirike topikën mund ta përkufizojmë në këto mënyra:


- Topika është pjesa e fjalisë që lidhet kontekstualisht; ajo korrespondon me artikujt që folësi supozon se janë aktivizuar në kujtesën e dëgjuesit në një moment të caktuar kohe (Sgall et al. 1986:29).
- Tema është ai informacion për të cilin folësi supozon të jetë tashmë i pranishëm në vetëdijen e adresuesit gjatë kohë kur flet. (informacioni i dhënë, Chafe 1974: 111)
- Një referent interpretohet si temë e një propozimi nëse në një situatë të caktuar propozimi është interpretuar si i lidhur me këtë referent, si shprehje e informacionit që është relevante dhe që rrit njohurinë e adresuesit për këtë referent (Lambrecht 1994: 131).

Ndërkaq, në bazë të analizave sintaksore e semantike, mund të konkludojmë se topika ose sintagma e topikës në shqipe realizohet në disa mënyra:

Për një gjuhë si shqipja mund së pari mund të propozohet një ndarje themelore për mënyrën se si realizohen sintagmat e topikës. Sintagmat e topikës në gjuhën shqipe mund të kodohet në mënyra: topika mund të kodohet brenda një sintagme boshe, pra që nuk shprehet fonetikisht dhe, po ashtu, të kodohet brenda një sintagme që shprehet fonetikisht, pra realizohet në strukturën sipërfaqësore. Topika mund të realizohet me kryefjalë boshe, me kundrinë boshe, me klitikë, përmes përemrave, përmes zhvendosjes djathtas ose majtas, dhe përmes sintagmave leksikore.

Sa i përket realizimit të topikës përmes sintagmave boshe (me kryefjalë dhe kundrinë boshe), kemi bërë edhe analizë statistikore, për të parë se në cilin zhanër të tekstit që kemi përzgjedhur për korpus po kodohet më shumë topika përmes sintagmës boshe. Siç mund të shohim në tabelën më poshtë, kodimi i topikës përmes sintagmave boshe në zhanrin gazetaresk (Gazeta *Koha ditore*) realizohet me një përqindje shumë më të vogël (23%) se në tipat e tjerë (Emisioni *Pressing* dhe ndeshja *Serbi-Shqipëri*) që e përbëjnë korpusin tonë. Kjo ndodh për disa arsye, e para, se në dy zhanret e tjera (Emisioni *Pressing* dhe ndeshja *Serbi-Shqipëri*) i përkasin gjuhës së folur, prandaj janë përplot referenca diskursive, dihet konteksti, njihet diskursi paraprak, prandaj edhe folësit në emision edhe komentatori shpejtojnë për ta nxënë diskutimin, për të cilin po diskutojnë dhe (komentatori) veprimet që po ndodhin në fushën e lojës.

Statistikat e nxjerra mund t'i shohim në tabelën më poshtë:



Ndërsa, fokusi mund të realizohet në pozicione të ndryshme, domethënë në *in-situ* ose *ex-situ*. Fokusi *in-situ* është një strategji fokusimi, e cila vë në

pah një element, pa e ndryshuar vendin ose pozicionin e tij në një fjali. Fokusi *ex-situ* në gjuhën shqipe është një strategji fokusimi që vendos rëndësinë e një elementi, duke ndryshuar vendin ose pozicionin e tij in-situ në një fjali dhe duke e vendosur përbërësin e fokusit të lëvizë nga pozita e zakonshme në pozitën ex-situ.

Bibliografia:

1. Agalliu, Fatmir – Angoni, Engjëll – Demiraj, Shaban – Dhrimo, Ali – Hysa, Enver – Lafe, Emil – Likaj, Ethem (2002). Gramatika e gjuhës së sotme shqipe II. ASHAsH. Tiranë.
2. Casielles-Suárez, E. (2004). The syntax-information structure interface: Evidence from Spanish and English. Routledge.
3. Chomsky, N. (1971). Deep structure, surface structure and semantic interpretation. *1971*, 193-216.
4. Cinque, G., & Rizzi, L. (2008). CISCL Working Papers.
5. Erteschik-Shir, N. (2007). Information structure: The syntax-discourse interface. Oxford: Oxford University Press.
6. Féry, C. (2013). Focus as prosodic alignment. *Natural Language & Linguistic Theory*, 31(3), 683-734.
7. Frascarelli, M. (2018). The interpretation of pro in consistent and partial null-subject languages. *Null subjects in Generative Grammar: A synchronic and diachronic perspective*, 211-239.
8. Frascarelli, M., & Hinterholzl, R. (2007). Types of topics in German and Italian. In *On information structure, meaning and form* (pp. 87-116). John Benjamins.
9. Gabriel, C., Rinke, E. (2010) Information packaging and the rise of clitic doubling in the history of panish. // *Diachronic studies on information structure. Language acquisition and change*, 63-86 p.
10. Gürer, A. (2020). Information Structure Within Interfaces: Consequences for the Phrase Structure. Berlin, Boston: De Gruyter Mouton.

11. Halliday, Michael (1967). *Introduction to Functional Grammar*. University of Birmingham. United Kingdom
12. Holton, D., Mackridge, P., Philippaki-Warbuton. (1997) *Greek: A comprehensive*
13. Jackendoff, R. S. (1972). *Semantic interpretation in generative grammar*.
14. Kallulli, Dalina & Liliane Tasmowski (2008). Clitic doubling in the Balkan Languages, 1–34.
15. Kapia, E. (2010). *The role of syntax and pragmatics in the structure and acquisition of clitic doubling in Albanian*. Boston University.
16. Koleci, F., & Turano, G. (2011). *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipës (Vol. 1)*. Shblu.
17. Lambrecht K. (1994). *Information structure and sentence form. Topic, focus, and the representation of mental referents in discourse*. Cambridge: Cambridge University Press.
18. Rizzi, L. (1997). The fine structure of the left periphery. In Liliane Haegeman (ed.), *Elements of grammar*, 281–337. Kluwer, Dordrecht.
19. Rizzi, L. (2005). On some properties of subjects and topics. In *Proceedings of the XXX Incontro di Grammatica Generativa* (pp. 203-224).
20. Rizzi, L. (2006). On the form of chains: Criterial positions and ECP effects. *Current studies in linguistics series*, 42, 97.
21. Rooth, M. (1996). On the interface principles for intonational focus. In *Semantics and Linguistic Theory* (Vol. 6, pp. 202-226).
22. Rugova B. (2006 dhe 2007) *Gjuha e sportit*. Filologji 14/15, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, pp 141 - 156.
23. Rugova B., Sejdiu - Rugova L. (2015). *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Trembelat. Prishtinë.
24. Rugova Bardh, Sejdiu - Rugova Linditë (2015). *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Trembelat. Prishtinë.
25. Samek-Lodovici, V. (2005), Prosody-syntax interaction in the expression of focus. *Natural Language and Linguistic Theory*, 23, 687-755.
26. Vallduví, E. (1990). *The informational component*. University of Pennsylvania.

Mensur VOKRRI

RRJEDHORJA E SHQUAR SHUMËS NË SHQIPEN E MESHARIT TË BUZUKUT

Abstrakt:

Me këtë punim mëtojmë ta pasqyrojmë rasën rrjedhore të trajtës së shquar numër shumë në shqipen e Mesharit të Buzukut. Pra, në këtë punim do të shihet natyra e rrjedhore së shquar shumë në gjuhën e autorit tonë, duke e dhënë formën e saj, përkatësisht mbaresën dhe mjetin tjetër gramatikor me të cilin përdoret kjo rasë, parafjalën. Do të jepet pasqyra e plotë e përdorimit të rrjedhore përkatëse si parafjalore dhe joparafjalore dhe do të bëhet klasifikimi i mëtejshëm i përdorimit të kësaj rase me parafjalët e përdorura. Forma e rrjedhore së shquar shumë dhe përdorimet e saj do të shpërfaqen përmes shembujve të nxjerrë drejtpërdrejt nga hulumtimi i gjithë tekstit të Mesharit (1555). Më pas, për rasën e përmendur do të jepen statistikat e sakta në formë tabele ose grafiku.

Sfondi kërkimor për këtë punim do të jetë vepra e Mesharit të Buzukut, e përgatitur nga E. Çabej me titullin *Meshari i Gjon Buzukut (1555) Botim kritik Pjesa e dytë Faksimile dhe transkribim fonetik* (1968).

Këtë punim do ta realizojmë me metodën e përshkrimit e analizës dhe me atë sasiore e cilësore, përmes së cilave do të përpiqemi ta japim pamjen e përgjithshme dhe të plotë të rrjedhore së shquar shumë siç del në librin e parë të shqipes së shkruar.

Nga ky punim priten rezultate konkrete, të sakta e të plota, përmes së cilave do të mundësohet shpjegimi, sqarimi dhe kuptimi i kësaj rase dhe natyrës së saj në shqipen e shek. XVI dhe veçantisë së saj ku-

ndruall rasave të tjera të sistemit rasor jo vetëm të shqipes së Buzukut, por edhe të shqipes së sotme

Fjalët çelës: *Rasë rrjedhore; trajtë e shquar; numër shumës; mbaresë, parafjalë; shqipe e shkruar; Meshari i Buzukut*

Hyrje

Dihet tashmë se rasa rrjedhore e trajtës së shquar të numrit shumës me mbaresën rasore *-shit* mungon krejtësisht në sistemin rasor të shqipes së sotme. Mirëpo, nuk është e njëjta gjendje me këtë formë rasore edhe në shqipen e hershme të shekullit XVI të dëshmuar me shkrim, sepse ky tip rrjedhoreje është i gjallë dhe me përdorim të rregullt qysh te libri i parë i shqipes së shkruar, pra te Meshari (1555) i Gj. Buzukut. Më pastaj, e njëjta rrjedhore e shquar shumës me formantin *-shit* përdoret edhe nga pasardhësit e Buzukut, pra nga L. Matrënga (1592), P. Budi (1618-1621), F. Bardhi (1635) e nga P. Bogdani (1685) në veprat e tyre, nga të cilët, vetëm i pari me origjinë dialektore toske (jugore), ndërsa të tjerët me origjinë dialektore gege (veriore), të njëjtë me Buzukun.

1. Sfondi teorik

Nga ajo që u pohua më lart shihet se rrjedhorja e shquar shumës më *-shit* kishte përdorim të përgjithshëm në mbarë shqipen e hershme, pra në të dyja dialektet e saj, pa dallim. Këtë pohim e vërtetojnë, në një anë, këta autorë veriorë të vjetër të shqipes e, në anën tjetër, edhe dëshmitë, përveç të Matrëngës me origjinë jugore nga kolonia arbëreshe në Itali, edhe dëshmitë e tjera nga kjo diasporë, si ajo e J. Varibobës dhe e J. De Radës, për të cilat na njofton E. Çabej (1988) në studimin e tij *Gjon Buzuku dhe gjuha e tij*.

Ndërsa, sa i përket pohimit dhe përcaktimit tonë që në hyrje të punimit se kjo formë rasore i mungon krejtësisht shqipes bashkëkohore, sidomos asaj të shkruar, vlen t'i kthehemi edhe një herë për shqipen e folur. Për shqipen e folur, sepse, sipas Çabejt, “mendimi që kjo formë rasore në të folët e Shqipërisë nuk u gjendka më, ka vleftë vetëm për pjesën e madhe të Gegërisë.” (E. Çabej 1988: 72). Sa për Toskëri, thekson Çabej (1988), vihet re se në pjesën jugore të këtij mes vendi, pra në një zonë periferike, është ruajtur

gjer më sot nga ndonjë gjurmë sporadike e kësaj mbarese, ashtu siç është mbajtur ndonjë formë fonetike e moçme. Këtu, Çabej (1988) sjell disa shembuj, duke thënë se në Gjirokastrë thonë, me kuptime të figuruara, *më dolli hundëshit; të iku balta këmbëshit*; në Liovan dhe në të tjera fshatra të Dangëllisë e të Shqerisë së Përmetit *pashëkëshit* “për pashkë, në kohë të pashkëve”, “*shajëshit* për rrëshaje, në kohë të rrëshajave”; gjetiu në Jugë *dhëmbëshit, dhëmballëshit*; e në një këngë dasme prej Korçe *Parë pas faqeshit, sumbulla pas gjinjëshit*. (Çabej, 1988: 72) I njëjti autor shton se edhe te Naim Frashëri gjen *bije qiejshit si lumë*, te Kristoforidhi *miqshit, zonjashit, nuseshit* etj.

Ndërkaq, lidhur me kronologjinë, Çabej (1988) thekson se kësaj forme rrjedhore nuk i dihet përhapja historike. Sipas tij, nuk mund të vendoset a ka pasur ajo në kohët e para një përdorim të përgjithshëm apo vetëm dialektor, duke shënuar se forma më *-shit* nuk i ka dalë nëpër tekstet e të folmeve shqiptare të Greqisë dhe se e njëjta formë mungon për Veri në Arbënesh të Dalmacisë.

Duke u ndërlidhur me shembujt e Çabejt (1988) nga N. Frashëri e sidomos nga Kristoforidhi, po shënojmë se S. Riza (1965; 2002) në studimin e tij *Emrat në shqipe: Sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit* pohon se të gjithë gramatikanët tanë nga S. Frashëri (1886) deri te K. Cipo (1949) pajtohen midis tyre se shqipes bashkëkohore i mungon numri shumë i rrjedhore së shquar të teksteve të vjetra në: *-shit* p.sh. “n etheshit së mëdhash” Buz. 72/2a; *fjalëshit Budi P. R + 5*; *ende deleshit së njefunah ha uku*” Bardhi 215; “prej urtishit” Bogdani parth. 16; u ngre së vdekurishit” Matr. 5. (S. Riza 1965: 50; 2002: 62) Edhe Riza (1965; 2002) e pranon se në gramatikën e tij të vitit 1882 Kristoforidhi edhe rrjedhoren e shquar p.sh. *qenshit* e ka paraqitur si ekzistuese në shqipen e kohës së tij, mirëpo, sipas Rizës, ai këtë trajtë pretendimisht ekzistuese e ka barazuar për nga kuptimi me trajtën pikërisht të pashquar *qensh* (fq.10., shënim 2) – barazim i gabuar ky, që dëshmon për pasigurinë e ndjenjës së tij gjuhësore në këtë mes; dhe pasiguri kjo që atij do t’i jetë shkaktuar nga një qëndrim jo mjaft kritik i teksteve të Budit dhe Bogdanit.

Për pasiguri nga ana e një autori të huaj, siç është Dozoni, i cili në paradigmën e gramatikës së tij rrjedhoren origjinarisht të pashquar më *-sh* e ka shënuar si për të pashquarën si për të shquarën, shprehet edhe F. Agalliu

(1986) në punimin e tij *Rrjedhore e shquar apo rrjedhore e pashquar?* Ndërkaq, sa i përket pasigurisë së ndjenjës gjuhësore të Kristoforidhit, Agalliu ka një mendim të kundërt me të Rizës.

Përkundrazi, në “Shkronjëtoen” e vet Samiu rrjedhoren e shquar me plot të drejtë nuk e ka bërë të figurojë as për numrin shumë as për njëjtesin; kurse Xhuvani si rrjedhore të shquar për numrin shumë ka paraqitur dhanooren përkatëse p.sh. (*prej*) *lisavet* fq. 32; - paraqitje e gabuar kjo, mendon Riza, që është karakteristike edhe për gramatikanët e mëpastajmë të shqipes bashkëkohore. (Riza 1965: 50; 2002: 62) Për pasaktësinë e kësaj paraqitjeje të Xhuvanit, Riza i jep argumentet gjuhësore në veprën e cituar më lart.

2. Pyetjet e hulumtimit

Ky studim synon t’u përgjigjet këtyre pyetjeve hulumtuese:

- a. A është rrjedhorja e shquar më *-shit* te Meshari i Buzukut rasë me formant të vetëmjaftueshëm ose të plotvlershëm, apo të pavetëmjaftueshëm ose jo të plotvlershëm?
- b. Formanti *-shit* i rrjedhores së shquar në shqipen e Buzukut paraqitet vetëm tek emrat apo edhe te pjesët e tjera të ligjëratës (mbiemrat, për-emrat, numërorët)?
- c. Në qoftë se rrjedhorja e shquar me formantin *-shit* te Buzuku del e pavetëmjaftueshme, atëherë ajo do të përdoret si rasë me parafjalë, apo me ndonjë mjet tjetër analitik gramatikor?
- d. Me cilat parafjalë e ndërton Buzuku rrjedhoren e shquar me formantin *-shit*?
- e. Cila prej parafjalëve të përdorura me rrjedhoren më *-shit* nga Buzuku përbën rregull dhe cilat parafjalë përbëjnë përjashtim?

2. Metodologjia

Për realizimin e këtij studimi do të përdoren: metoda e analizës, metoda sasiore (kuantitative) e të dhënave të mbledhura dhe metoda cilësore (kualitative) e interpretimit të të dhënave përkatëse, si dhe në disa raste edhe metoda e krahasimit.

Gjetjet dhe rezultatet që do të nxirren nga ky hulumtim në Mesharin e Buzukut do të jenë të mbështetura në analizën dhe interpretimin e të dhë-

nave të mbledhura për rrjedhoren e trajtës së shquar të numrit shumë me formantin *-shit*.

1. Mbledhja e të dhënave dhe analiza

Të dhënat lidhur me rrjedhoren e shquar shumë me formantin *-shit* i kemi nxjerrë nga korpusi ynë i hulumtimit, i cili për këtë punim ka qenë teksti i Mesharit të Buzukut, përgatitur nga E. Çabej dhe që bazohet pikërisht në botimin e veprës me titull: *Meshari i Gjon Buzukut (1555) Botim kritik Pjesa e dytë Faksimile dhe transkribim fonetik* (1968)

Edhe analiza e të dhënave bashkë me gjetjet dhe rezultatet e këtij hulumtimi mbështeten drejtpërdrejt në shembujt e nxjerrë nga i gjithë teksti i Mesharit të Buzukut në veprën e sipërpërmendur të Çabejt.

3. Rezultatet dhe diskutimet

1. Forma e rrjedhore së emrave të shquar shumë te Meshari i Buzukut

1. *Formanti -shit i rrjedhore së emrave të shquar shumë, zanorja anaptitike dhe nyja shquese*

Rasa rrjedhore e trajtës së shquar të emrave në numrin shumë te Buzuku del e formuar mbi bazën e trajtës së pashquar, po të numrit shumë me mbaresën rasore *-sh*, duke i shtuar kësaj, siç shprehet edhe Topalli (2009), nyjën *-t(ë)*, para së cilës shfaqet gjithmonë zanorja anaptitike *-i*, duke marrë kjo nyjë formën *-it*. Kjo mbaresë, sipas Topallit (2009), qëndron e pandryshueshme për të gjithë emrat, cilado qoftë përbërja e tyre rrokjesore.

Se anaptiksi ndërhyt gjithnjë tek emrat në rrjedhoren e shquar të shumësit, pavarësisht nga çdo faktor fonetik, e thotë shprehimisht para Topallit edhe S. Riza (1965; 2002), duke sjellë këta shembuj nga Buzuku: n së vdekunishit 48/2a, n trimashit 50/19, n etheshit 72/2a n grashit bis 64/1b etj. n qiellshit 75/1b, n pleqshit 74/2a, n duorshit 54/1b, n dhençit (nga dhendshit) 59/1b- (Riza 1965: 67; 2002; 79)

Tek emrat me theks jofundor, përgjithësisht tema trokaike, mbaresa *-it* ndodhet dy rrokje larg theksit të fjalës, p.sh., Buzuku: *ruoj shpirtinë tem n buzëshit së këqiash (X b) E me atë n Shenjtëshit së tish (XV/2a), Zot,*

liberomë në **kateshit** së *luksuriesë* (XVII b), *N viseshit* së *nthella thirra m tÿ Zot* (XVII/2b) (Topalli 2009: 314) Në disa emra të tjerë të kësaj rase që dalin me një grup bashkëtingëllor, është shtuar zanorja anaptitike meqenëse, sipas Topallit, me nyjën formohet një grup prej tri bashkëtingëlloresh (i vë-shtirë për t'u shqiptuar – *theximi ynë*), për të cilin rast ai sjell nga një shembull vetëm nga Bardhi: *Jashtë mendshit* e nga Bogdani: *âshtë zanë së prindshit pa mpkatit së lëm*, por jo edhe nga Buzuku. Nga Buzuku sjellim pikërisht shembullin me emrin **prind**, sikurse te Bogdani, si p.sh. *Mos të të bjerë ndë mend, Zot, për katetë tonë o në prindshit sinësh* (Meshari, 49/a), shembull të cilin e sjell edhe Riza në veprën e cituar.

Por, tek emrat që dalin me temë në zanore, për të cilët Topalli shprehet se përdorimi i këtij tingulli nuk është i përligjur, ai është shtrirë me rrugë analogjike, duke u marrë mbaresa *-shit* si mbaresë e kësaj forme për të gjithë emrat; p.sh., Buzuku: *U kam pasunë në Xhudhishit pesë herë tridhjetë e nandë të nvrana* (XL a), *e ndë lëkurë dhishit veshunë* (LXXXV/2b = CV/2b), *zhdo në grashit sonësh na banë me u çuditunë* (LXIV/2a = LXXIV/2a), *n këso së mëdhashit së pânash* (XL b). (Topalli 2009: 315) Në disa emra të tjerë, ku një zanore e tillë është përdorur edhe para mbaresës rasore, Topalli (2009) thekson se dalin dy zanore të tilla me karakter anaptitik, p.sh., Buzuku: *përse të jenë nderunë në njerëzishit* (XLII/2a).

2. A është rrjedhja e shquar shumë më *-shit* e Buzukut rasë me formant të pavetëmjaftueshëm?

Fillimisht, po i japim përcaktimet e dy koncepteve korrelative: rasë me formant të vetëmjaftueshëm dhe rasë me formant të pavetëmjaftueshëm të bërë nga Riza në veprën e cituar.

“Formanti i një rase është *i vetëmjaftueshëm* atëherë kur rasia është e përdorshme në mënyrë të mëvetësishme, d.m.th. në mungesë të çdo mjeti ndihmës, konkretisht të çdo parafjale, siç ndodh në shqipe me rasat *dhanore* e *kallëzore*. Anasjelltas, formanti i një rase është *i pavetëmjaftueshëm* atëherë kur rasia është e paplotë në mungesë të këtij apo atij mjeti ndihmës.” (Riza 1965: 80; 2002: 92) Më tej, Riza (1965; 2002) edhe vetë rasat me formante të pavetëmjaftueshëm i dallon më tutje në dy nënkategori të ndryshme, si: 1) në rasia me formante *absolutisht* të pavetëmjaftueshëm dhe 2) në rasia me formante *relativisht* të pavetëmjaftueshëm.

Sipas Rizës (1965: 81; 2002: 110), formanti i një rase është *absolutisht* i pavetëmjaftueshëm atëherë kur kjo rasë në mungesë të mjetit ndihmës, bëhet jo vetëm e paplotë, por edhe *e paqenë*; e për pasojë atëherë kur mjete ndihmës humb kryekëput çdo brendi leksikore vetjake për t'u shndërruar semantikisht në një komponent të thjeshtë të formantit të pavetëmjaftueshëm. Si rast për këtë nënkategori, Riza sjell gjindoren e re, siç e quan ai, (sot gjinore) jo vetëm të ditëve tona, por edhe teksteve të vjetra. Sipas tij, kjo rasë pushon së qeni e këtillë d.m.th. gjindore e re në mungesë të dëftorshit, siç e quan ai (sot nyjë e përparme e gjinore), të cilit i zhduket në këtë mes çdo brendi leksikore vetjake, d.m.th. çdo kuptim prej përemri dëftor.

Anasjelltas, formanti i një rase është *relativisht* i pavetëmjaftueshëm atëherë kur kjo rasë është vërtet e paplotë në mungesë të këtij apo atij mjete ndihmës konkretisht të kësaj apo asaj parafjale, por ku kjo parafjalë, në bashkëvajtje me këtë rasë, ruan prapëseprapë plotësisht brendinë leksikore vetjake. Për këtë nënkategori, Riza sjell si shembull në shqipen e teksteve të vjetra të kështuquajturën rasë “vendore” ose “parafjalore” (më drejt: kallëzore sekondare e lakimit të shquar, siç e quan Riza); sepse kjo rasë, sipas tij, është vërtet e paplotë në mosbashkëvajtje me parafjalët: ndë, me, për etj.; por këtyre parafjalëve në asnjë mënyrë nuk u cenohet kuptimi në bashkëvajtje me këtë rasë.

Në këtë kuptim, Riza edhe e shtron pyetjen: Në cilin nga tre llojet e sipërme të rasave hyn rrjedhorja e teksteve të vjetra në kuptimin e saj themelor të rrjedhjes d.m.th. të prejardhjes, si dhe në kuptimet analogë të shkëputjes ose shmangies, të lëndës përbërëse, të shkakut etj. Pastaj, pas paraqitjes së rrjedhës te Buzuku në kuptimet e cekura më lart në tri përdorime me shembujt përkatës: në bashkëvajtje kryesore me parafjalën *en*, të cilën Riza e tejshkruan *n*, dhe të cilën nuk e njeh shqipja e ditëve tona; në bashkëvajtje të kufizuar me parafjalën prej; dhe herë-herë në mosbashkëvajtje me ndonjë parafjalë, Riza (1965; 2002) nxjerr përfundimin se rrjedhorja te Buzuku si rregull është një rasë me formant të pavetëmjaftueshëm, duke u mbështetur në konceptet dhe kriteret e paraqitura në fillim të këtij nënkreu.

Në këtë kuadër, nga analiza dhe shqyrtimi i gjithë tekstit të Mesharit edhe neve na del se rrjedhorja e shqipes së Buzukut, e me theks të veçantë, rrjedhorja e shquar e shumësit më *-shit*, përbën një rasë me formant të pavetëmjaftueshëm. Këtë përcaktim e mbështesim në faktin se nga vjelja e gjithë

përdorimeve të rrjedhore së shquar të shumësit më *-shit* në Mesharin e Buzukut na dalin 370 raste përdorimi të emrave të shquar shumë me këtë mbaresë (dhe 2 raste të përemrave të pacaktuar), nga të cilat vetëm 1 rast është joparafjalor. Nga tërë ky numër shembujsh, statistikat janë si vijon: në 360 raste Buzuku këtë rrjedhore më *-shit* e përdor gjithmonë tek emrat (me përjashtim të një rasti me përemrin e pacaktuar *tjetër*, të cilin do ta japim në shembullin e fundit), të paraprirë me parafjalën *en*, siç e shkruan ai (ne e japim *ñ*, të transkriptuar sipas Çabejt në studimin *Meshari i Gjon Buzukut, Botim kritik, Faksimile dhe transkribim fonetik*); 7 raste na kanë dalë me paraf. *prej* + em. rrj. shq. sh.; 2 raste me paraf. *për* + em. rrj. shq. sh.; 1 rast me paraf. *mbas* + em. rrj. shq. sh.; dhe vetëm 1 rast *pa* paraf. + përem. *Pacacak. tjetër*, por prirë nga përemri i pacaktuar *ndonjë*, (si dhe nyja e përparme *së*, e cila shumë herë del edhe ndërmjet parafjalës *ñ* dhe emrit më *-shit*)

Pamjaftueshmërinë dhe vlerën jo të plotë të rrjedhore në shqipen e sotme e thekson edhe F. Agalliu në dy punimet e tij: *Rrjedhore e shquar apo rrjedhore e pashquar?* (1986/3) dhe *Rreth përdorimeve të rrjedhore në shqipen e sotme letrare* (1990/1), të botuara të dyja në revistën *Studime filologjike*. Te punimi i fundit i sipërpërmendur, pasi i jep përdorimet e rrjedhore në shqipen e sotme, Agalliu (1990) në përfundim të tij shprehet: “Siç del edhe nga parashtrimi, në këtë shkrim u përpoqëm të japim një pasqyrë mundësisht sa më të plotë të përdorimeve të rrjedhore si një rasë gjithsesi jo e plotvlershme në sistemin e lakimit në gjuhën shqipe.” (Agalliu 1990/1: 130)

3. Përdorimi parafjalor i rrjedhore së shquar shumë më *-shit*

Siç u pa edhe nga statistikat, përdorimi me parafjalë i rrjedhore së shquar shumë më *-shit* është i rregullt te Buzuku, duke përjashtuar një rast të vetëm. Edhe rrjedhorja e pashquar shumë më *-sh* te Buzuku del kryesisht parafjalore, por me disa raste përdorimi edhe si joparafjalore.

1. Përdorimi i parafjalës *ñ* me emër në rrjedhoren e shquar të shumësit

Emrit në rrjedhoren e shquar të shumësit më *-shit* i prin rregullisht parafjala buzukiane *ñ*, me përjashtim të atyre pak rasteve që u përmendëm më lart me tri parafjalët *prej*, *për*, *mbas* dhe një rasti joparafjalor me përemrin e pacaktuar *tjetër*.

Formulës **η + em. rrj. shq. sh.** i përgjigjet një numër i madh përdorimesh në tekstin e Mesharit të Buzukut, të cilat përbëjnë grup më vete, për të cilin, në pamundësi që t'i sjellim të gjitha rastet, po sjellim vetëm disa shembuj: **N viseshit** së *ñthella thira m ty, Zot* (Meshari, 47/b), *e ti qi liberove të dëlirënë Suzanë* **η dëshminjshit** së *rëshim* (Meshari, 75/a), *E porsi bie shiç e bdora* **η qiellshit** (Meshari, 125/b), **η qengjashit** e **η edhashit** *ju ta nxiri* (Meshari, 221/a), *erdhnë tue thashunë se ato panë një të pām* **η engjëjshit** (Meshari, 243/a), *e doktorëtë e ligjsë qi ardhunë ishnë* **η gjithë kështjelashit** së *Galilësë* (Meshari, 271/a), *pā aty një njeri qi nukë ish nveshunë* **η petëkashit** së *darsmëvet* (Meshari, 309/a).

Te përdorimi i rrjedhore së emrave të shquar shumë me mbaresën **-shit** edhe nga shembujt e sjellë, por edhe nga i gjithë vështrimi i tekstit, vërehet se në të gjitha rastet Buzuku atë e përdor të prirë nga parafjala **η** që shkon në reksion me këtë rasë (pra, e drejton emrin në rrjedhore) dhe që ndiqet pa ndërmjetshëm nga emri përkatës. Në përdorimin e përgjithësuar të rrjedhore së parafjalën *en (n)* Riza (1965; 2002) e sheh një shfaqje më shumë të ndërhyrjes normativizuese të Buzukut. Në disa raste, ndërmjet kësaj parafjale dhe emrit përkatës hyn nyja **së** që është pjesë përbërëse dhe karakteristike e disa emrave në këtë rasë dhe përemri i pacaktuar **gjithë**.

Nyja e përparme **së** është e pranishme ndërmjet parafjalës së thjeshtë buzukiane **η** dhe emrit në rrjedhoren e shquar shumë më **-shit** sa herë që e njëjta rrjedhore përdoret me emrat asnjandës prejmbiemërorë e prejppjesorë, të cilët janë të pajisur gjithherë me nyjë dhe të cilët te Buzuku nuk janë të paktë. Duke qenë se po flasim për emra prejmbiemërorë e prejfoljorë, dihet se origjinarisht këta emra formohen prej mbiemrash e pjesore foljesh (mbiemrat gjithmonë janë të nyjshëm, derisa edhe pjesoret, për t'u shndërruar në emra prejppjesorë, gjithherë marrin nyjën **-të** dhe prapashtesën **-it**) dhe përdoren si tillë duke u emëruar (substantivuar) përmes procesit gramatikor të emërzimit.

Ndërkaq, ndërfutja e përemrit të pacaktuar **gjithë** në këtë mes shihet si shprehje e tërësisë (totalitetit) së cilësive të emëtuara nga mbiemrat e emëruar. Kështu, përfundimisht formohet rrjedhorja e shquar e shumësit të këtyre mbiemrave e pjesoreve të substantivuara te Buzuku, duke marrë trajtën përkatëse nga formula **η + (gjithë) + së + mb. / pjesore**, pra sikurse në shembujt: **η (gjithë) së këqiashit** (shumë e përdorur nga Buzuku); **η së kujtu-**

omeshit etj. Këto fakte të gjetura në Mesharin e Buzukut për këtë çështje e provojnë praktikisht pohimin e bërë më lart dhe njëkohësisht përbëjnë dëshmi e argumente bindëse për përdorimin e shpeshtë në këto forma të kësaj rrjedhoreje nga Buzuku.

Lidhur me përdorimin e mbiemrave të emëruar në përgjithësi (jo vetëm në rrjedhoren e shquar ose të pashquar shumë), K. Ashta (2000) mendon se ruhet një gjendje e vjetër e gjuhës e një përdorim popullor. Sipas tij, në mungesë të emrave abstraktë, gjuha e folur nxjerr mbiemra të substantivuar. Kështu, Ashta (2000) sjell edhe disa shembuj nga Buzuku, si: të liruomitë LXXI (LXXXI), I; tëh mujtunë tëh madh XXX, I; të kujtuomitë e tyne XX, III; enbë të shkelët XL, II. Ky përdorim i shpeshtë si te ai, ashtu edhe tek pasardhësit e tij nisi të ngushtohet me kohë nga depërtimi i huazimeve e nga sajimi i neologjizmave të formuar sidomos me prapashtesat *-im* dhe *-je* (K. Ashta 2000: 203-204)

Edhe gjendja e vjetër e gjuhës edhe mungesa e emrave abstraktë për të cilat flet Ashta janë të vërejtshme në gjuhën e Buzukut dhe i kemi hetuar përgjatë studimit që i kemi bërë Mesharit të tij. Derisa edhe përdorimi i shpeshtë sidomos te Buzuku dhe ngushtimi i këtij përdorimi më pas nga huazimet e sidomos nga neologjizmat me prapashtesat *-im* dhe *-je* është i saktë, po të marrim parasysh mungesën (ose përdorimin e rrallë) e emrave abstraktë të veprimit me këto prapashtesa te Buzuku dhe, po të shihet prania e shpeshtë e këtyre neologjizmave, sidomos në shqipen e sotme.

2. Përdorimi i parafjalës prej me emër në rrjedhoren e shquar të shumësisë

Prirë me parafjalën *prej*, rrjedhorja më *-shit* e Buzukut, larg së përbëri rregull, përbën pothuajse përjashtim. Siç e tregon edhe numri i dhënë më lart, Buzuku këtë parafjalë e përdor shumë më pak krahasuar me parafjalën *ñ* si ekskluzive. Dihet se edhe parafjala *prej* drejton një emër ose përemër në rasën rrjedhore, mirëpo, derisa te Buzuku haset rrallë me rrjedhoren e shquar shumë (diçka më shpesh me rrjedhoren e pashquar e të shquar të njëjësit, si dhe te përemrat vetorë), e njëjta parafjalë përdoret rregullisht me të njëjtën rrjedhore në shqipen e sotme. Edhe nga ky grup po i sjellim disa shembuj përdorimi: *E i thirri engjëlli i Tinëzot prej qiellshit* (Meshari, 233/b), *Përse si zani i t falët saj prej veshëshit së mish erdh* (Meshari, 333/b),

kur *kā* me *u* kthym **prej darsmëshit** (Meshari, 375/a), e erdh një e madhe erë **prej malshit** së shkreta (Meshari, 385/b)

Nga vështrimi i gjithë tekstit të Mesharit kemi gjetur vetëm 7 raste të përdorimit të parafjalës *prej* me rrjedhoren e shquar të shumësit më *-shit*, duke e arsyetuar kështu përdorimin e kufizuar të kësaj parafjale.

3. Përdorimi i parafjalës *për* me emër në rrjedhoren e shquar të shumësit

Nga numrat e dhënë më sipër te statistikat u kuptua se me parafjalën ***për*** + *em.*, *rrj.*, *shq.*, *sh.* na kanë dalë vetëm dy përdorime. Ky numër i vogël, njëherësh edhe përjashtimor, e arsyeton edhe reksionin (drejtimin) jo të duhur parafjalor me emër në rrjedhoren e shquar shumë. Dihet se parafjala *për* e drejton përgjithësisht një emër në kallëzore, si dhe një emër në rrjedhoren e pashquar njëjës e shumë sidomos në shqipen e sotme, në shprehje si: *e kapi për krahu / e kapi për krahësh*. Meqë janë vetëm dy raste, këtë tip po e përfaqësojmë me të dy shembujt e gjetur: *U për gjithë enëshit jam ngjëruom me të idhunë* (Meshari, 165/b), e të të ngjëronjënë ***për*** gjithë ***enëshit***.

Vërehet se në të dyja rastet përemri i pacaktuar *gjithë* ka hyrë ndërmjet parafjalës *për* dhe emrit *enëshit* për ta shprehur tërësisë.

4. Përdorimi i parafjalës *mbas* me emër në rrjedhoren e shquar të shumësit

Përjashtimor te Buzuku del edhe përdorimi i parafjalës ***mbas*** + *em.* *rrj.* *shq.* *sh.*, ani pse në shqipen e sotme kjo parafjalë shkon në reksion me rrjedhoren, sikurse parafjalët e tjera të këtij lloji: *pas*, *prapa*, *para* (*përpara*), *rreth*, *drejt* e ndonjë tjetër. Ky është i vetmi rast i gjetur, i cili përfaqësohet përmes këtij shembulli: *e ju të mos ecëni **mbas zotashit** së uojsh për të keqet taj* (Meshari, 159/b).

Tabela 1. Përdorimi me parafjalë i rrjedhore së shquar të shumësit më -shit në Mesharin e Buzukut



4. Përdorimi joparafjalor i rrjedhore së shquar shumës

Rrjedhoren e shquar të shumësit më -shit pa parafjalë Buzuku nuk e përdor fare. Në disa raste pa parafjalë e përdor të pashquarën shumës më -sh.

1. Përdorimi joparafjalor i përemrit të pacaktuar tjetër

Nga hulumtimi i bërë në tekstin e Mesharit për këtë rrjedhore të shquar shumës, pa parafjalë e kemi gjetur vetëm një rast, përdorimin e të cilit po e japim me shembullin vijues:

E as ndonjë së tjerëshit s kish zemërë me ɥ afëruom tek ta. (Meshari, 349/b).


Ndërsa, sa i përket asaj që Topalli (2009) për këtë rrjedhore sjell dy raste të përdorimit joparafjalor me emra të Buzuku, ato nuk qëndrojnë, sepse të dy shembujt që i jep ai janë të përdorur pikërisht me parafjalën e zakonshme *n*. Pasi e kishim dhënë përcaktimin tonë bazuar në vjeljen e gjithë rasteve për këtë trajtë nga Meshari, hasëm në këta shembuj të Topallit në grupimin joparafjalor, dhe kjo na shtyri që këto raste t'i rishikojmë sa për verifikim në

botimin kritik të Mesharit, në pjesën e dytë Faksimile dhe transkribim fonetik nga Çabej, prej nga edhe janë dhënë shembujt. Në këtë grupim Topalli (2009) i sjell tre shembuj dhe vetëm i pari me rrjedhoren e pashquar qëndron i saktë, ndërsa dy të tjerët, për të cilët diskutuam më sipër, janë të pasaktë. Ja shembujt nga Topalli dhe pranë tyre me shenjën e barazimit shembujt në formën origjinale nga Meshari, sipas nesh: *nava ish mbëluom **valëshit** së detit* (IXL a = XXXIX) = *ashtu sã nava ish mbëluom **ñ valëshit** së detit* (Meshari, 105/a); *përse ata të jenë liruom **kateshit** së tynesh* (LXXXIX a = CIX a) = *përse ata të jenë liruom **ñ kateshit** së tynesh*. (Meshari, 381/a)

Tabela 2. Raporti i përdorimit paraafjalor dhe joparaafjalor të rrjedhores së shquar shumës më -shit në Mesharin e Buzukut

Përdorimi paraafjalor dhe joparaafjalor i rrjedhores së shquar shumës më -shit

■ Përdorimi paraafjalor ■ Përdorimi joparaafjalor



4. Përfundimet

Forma e rasës rrjedhore të shquar shumës, e cila përfaqësohet nga formanti *-shit*, në shqipen e Buzukut përbëhet nga mbaresa *-sh* e rrjedhores së pashquar gjithashtu shumës, pastaj nga tingulli anaptitik *-i* (tingull zanor për lehtëshqiptim) dhe nga nyja *-t* e shquarsisë së shumësit. Ky formant zërbëhet kështu nga ana formale, pra ndahet në morfemat përkatëse dhe anaptiksin, derisa në traditën gramatikore të shqipes e tërë forma merret si mbaresë rasore e rrjedhores së shquar të shumësit në shqipen e hershme të shekullit XVI, së cilës i prin Buzuku me veprën e vet Mesharin (1555). Ndonjë autor, si Riza, këtë formë ose mbaresë rasore e quan formant, duke qartësuar në këtë mes se nuk kemi të bëjmë vetëm me morfemë mbaresore, por edhe me elemente të tjera brenda trajtës përkatëse, të cilat i paraqitëm më sipër.

Rrjedhorja e shquar shumës me formantin *-shit* në shqipen e Mesharit të Buzukut, sikurse përgjithësisht rrjedhorja edhe në shqipen e sotme, përdoret si rasë me formant të pavetëmjaftueshëm ose si rasë me përdorim jo të plotvlershëm. Këtë përcaktim e provojmë me të gjeturat dhe rezultatet nga hulumtimi i tërë tekstit të Mesharit për këtë rasë e sidomos për rrjedhoren përkatëse. Gjetjet dhe rezultatet e vjela nga Meshari dëshmojnë se rrjedhorja e shquar shumës më *-shit* përdoret nga Buzuku rregullisht me një emër ose përemër prirë nga parafjala e zakonshme *η* dhe, rrjedhimisht, nuk përdoret e vetëmjaftueshme (pra, pa këtë parafjalë), përveç një rasti me përemrin e pacaktuar *tjetër*.

Siç del nga hulumtimi, veç parafjalës së zakonshme e të rregullt *η*, Buzuku rrjedhoren e shquar shumës më *-shit* e përdor edhe me tri parafjalë të tjera, si: *prej*, *për*, *mbas*. Derisa përdorimi i kësaj rrjedhoreje të Buzuku del i rregullt me parafjalën *η* në 90% të rasteve dhe që shkon në reksion me këtë rasë, e njëjta rrjedhore me parafjalët *prej* me 7% të përdorimit, e sidomos me parafjalët *për* me 2% dhe *mbas* me 1%, paraqitet në përdorim përjashtimor, për shkak të reksionit jo të duhur parafjalor dhe, si rezultat i kësaj, numrit shumë të kufizuar të përdorimeve përkatëse. Jo parafjalore kjo rrjedhore përdoret vetëm në 1% të rasteve.

Nga të gjitha statistikat e mbledhura në Mesharin e Buzukut, shumicën dërrmuese të përdorimeve të rrjedhores së shquar të shumësit më *-shit* e për-

bëjnë klasa e emrave (të mirëfilltë dhe mbiemrave e pjesoreve të emëruara) me 98% dhe shumë pak raste të rrjedhore përkatëse i përbën klasa e për-emrave (vetëm përemra të pacaktuar) me 2% të përdorimeve.

Referencat:

- Agalliu, F. (1986). *Rrjedhore e shquar apo rrjedhore e pashquar?* Në: “*Studime filologjike 3*”. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH - Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 205-208.
- Agalliu, F. (1990). *Rreth përdorimeve të rrjedhore në shqipen e sotme letrare*. Në: “*Studime filologjike 1*”. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 115-130.
- Çabej, E. (1988). *Studime gjuhësore VI (Gjon Buzuku dhe gjuha e tij)*. Prishtinë: Rilindja
- Demiraj, Sh. (2015). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. (botim i dytë i përmbledhur) Përgatitur për botim nga Bardhyl Demiraj. Tiranë: Fondacioni Fan Noli.
- Riza, S. (1965). *Emrat në shqipe: Sistemi i rasavet dhe tippet e lakimit* (Punim historik me dy shtojca kritike). Tiranë. Universiteti Shtetëror i Tiranës: Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë.
- Riza, S. (2002). *Vepra 3*. Botime të veçanta XLIV. Prishtinë: AShAK – Sekcioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Libri 19.
- Topalli, K. (2009). *Sistemi rasor i emrave të shqipes*. Tiranë: AShSh; Plejad.

Korpusi i hulumtimit

Meshari i Gjon Buzukut (1968). *Botim kritik. Pjesa e dytë. Faksimile dhe transkribim fonetik*. Tiranë. Universiteti shtetëror i Tiranës: Instituti i Historisë e i Gjuhësisë, përgatitur nga Eqrem Çabej

Rijetë SIMITÇIU-TURHANOĞLU

RREZIKU I SHQIPES NDËR SHEKUJ (XVI-XIX)

Abstrakt:

Përveç karakteristikave të veçanta të një gjuhe, faktorë të ndryshëm veçanërisht politika, historia, gjeografia dhe ekonomia bëjnë që një shoqëri të jetë shumëgjuhëshe. Këta faktorë janë rezultat i marrëdhënieve që zhvillohen brenda vetë shoqërisë dhe që kanë mundur të rezultojnë në shfaqjen e gjuhëve të përziera apo të rrezikimit të zhdukjes së njëres gjuhë. Folësi L_1 e ka gjuhën amtare, ndërsa L_2 e ka gjuhën e kulturës, të shoqërisë apo të prestigjit. Shqetësimi për gjuhën shqipe është po aq i vjetër sa dhe historia e shkrimit të saj. Turqishtja për një kohë të gjatë, në trevat shqiptare, është përdorur edhe si gjuhë prestigji bile në situata të caktuara thotë Bardh Rugova (2012) edhe si gjuhë e fshehtë.

Qëllimi i këtij punimi është të analizohet ndikimi i një gjuhe të fortë sociale B (si gjuhë prestigji) në një gjuhë më të dobët sociale A, përkatësisht të turqishtes në shqipe përgjatë shekujve XVI- XIX. Në këtë punim si burime gjuhësore janë përdorur tekstet e autorëve të vjetër shqiptarë. Hulumtimi ka treguar që edhe pse autorët e vjetër kanë qenë misionar kishtar dhe kanë botuar vepra për ruajtjen e krishterimit në tokat shqiptare nëpër tekstet e tyre kanë përdorur numër të konsiderueshëm të turqizmeve. Në gjuhën e shkruar të autorëve të vjetër shqiptarë numri i turqizmeve ka shkuar duke u rritur. Vlen të theksohet se në Fjalorin e Bardhit përdorëshin fjalë turke edhe në ato raste kur kishte fjalë shqipe. Kjo tregon se popullata shqiptare ishte familjarizuar me terminologjinë turke, fjala turke gati se e kishte zëvendësuar fjalën shqipe. Duke nisur nga fakti se tekstet të cilat i kemi

analizuar për qëllime të studimit kemi pritur se nuk do të gjejmë numër të madh të turqizimave, por rezultatet kanë treguar të kundërtën.

Fjalë kyçe: rreziku i shqipes, autorët e vjetër, gjuhë prestigji, turqishtja.

Abstract:

Aside from a language's own characteristics, various factors; especially politics, history, geography and economy affect and make a society multilingual. Interactions that develop within a society combined with these factors, results with the outcome of a mixed language or the disappearance of the language itself. The first language (L_1) is the native speaker's mother tongue, whereas the second language (L_2) is the language of culture, society or prestige. Concern for the Albanian language is as ancient as the history of its writing. For example, Turkish for a long time, has been used as a prestige language in the Albanian territories. In fact, it was even used as a secret language in certain situations says Bardh Rugova (2012).

This research, aims to analyse the impact of a strong social language B (as a prestige language) on a weaker social language A. More specifically, it examines how Turkish affected Albanian in between 16th and 19th centuries. In this paper, the texts of ancient Albanian authors were used as the linguistic sources. The study found out; despite the fact that the ancient authors were Christian missionaries who wrote works to preserve Christianity in Albanian areas, they also employed a significant amount of Turkic loanwords in their publications. The usage of Turkish loanwords had been on the rise during the above mentioned period when looked into the writings of ancient Albanian authors. It is worth noting that Turkish words were used in the Bardh's Dictionary even when there were Albanian words to use for explanation. This shows that the Albanian people was so familiar with the Turkish terminology to the extent that some of the Albanian words' Turkish synonymies had been used instead. Although at the beginning of this study it is assumed that a lesser number of Turkish words could be found throughout the sources, the result was on the contrary.

Key words: the danger Albanian language faced, ancient writers, prestigious language, Turkish.

1. Hyrje

Ardhja e osmanëve në tokat e Ballkanit dhe përhapja e islamizmit në këto anë i dha shkas përhapjes së turqishtes e të huazimeve turke, edhe pse në mënyrë jo të njëtrajtshme. Një tjetër çështje themelore, me rëndësi edhe për historinë e kulturës, është puna e përndarjes së këtyre huazimeve në sferat e ndryshme të jetës dhe fushat e veprimtarisë njerëzore. Aty hyjnë mënyra e banimit, të ngrënit, veshja, folklori, doket, zakonet, besimet popullore, jeta fetare, jeta sociale, administrata, ushtria etj.

Gjurmët e turqishtes në gjuhën shqipe, si gjuhë dominuese për nga aspekti shoqëror B, janë të shumta nga pikëpamja sasiore dhe të rëndësishme nga pikëpamja cilësore. Ato përbëjnë tipare gjuhësore (prapashtesat, parafjalët, ndajfoljet, lidhëzat, frazeologjizmat) që kanë ndikuar në gjuhën shqipe si gjuhë e dominuar A.

István Schüz (1986: 53) është i mendimit se ndikimet gjuhës turke në leksikun e gjuhës shqipe kanë filluar në kohën e mesjetës që përfshin shekujt X-XIV. Prandaj, për të identifikuar shkallën e depërtimit të huazimeve turke në leksikun e gjuhës shqipe nëpër shekuj, kemi marrë për studim tekstet e shkruara të autorëve të vjetër shqiptarë.

2. Huazimet turke në tekstet e autorëve të vjetër shqiptarë

Në këtë punim do ta trajtojmë ndikimin e gjuhës turke në leksikun e gjuhës shqipe përgjatë shekujve XVI- XIX, periudhën e autorëve të vjetër shqiptarë. Këtë periudhë më së miri e vërejmë në bazë të analizës diakronike të ndarjes kronologjike të turqizmeve në gjuhën shqipe. Gjuha shqipe është e vetmja gjuhë e Ballkanit, thotë Çabej (1975), që në rrethana të veçanta të dokumentimit paraqet një ndarje kronologjike të turqizmeve. Ai propozoi një periodizim në tri faza: faza e parë, para shekullit XV që dëshmohet vetëm me anë të fondit leksikor arbëresh; e dyta, nga shekulli XVI deri në gjysmën e dytë të shekullit XVIII. Kjo periudhë dokumentohet përmes veprave të Buzukut (1555), Budit (1618 e 1621), Bardhit (1635), Bogdanit (1685), Kuvendit të Arbënit (1709), Fjalorit (1702) dhe Gramatikës (1716) së Da Lecce-s, si edhe të veprave të tjera të mbetura në dorëshkrim; së fundi, faza që mbulon gjithë shekullin XIX deri në pavarësinë e Shqipërisë

(1912) e që nga pikëpamja e dëshimit me shkrim është pa dyshim më e pasura (Çabej 1976: 67).

Në veprën “Meshari” i Buzukut gjenden shumë pak huazime me burim nga turqishtja, por karakteristike për kohën (1555) e gjendjen e atëhershme, Buzuku ka përdorur këta turqizma: *akshand* (agu i ditës, mëngjes herët), *haramī* (cub, kusar, hajdut), *kallaus* (*spion*), *dollamë*, *tepsi*, *turk*, si dhe *pajë*. Lidhur me turqizmen *pajë* të hasur në leksikon e Buzukut, Budit e Bardhit kërkohet një trajtim pak më i gjerë thotë Omari (2016: 37) duke marrë për bazë studimin e fundit të Joachim Matzinger-it. Matzinger-i (2016: 50), këtë huazim e sheh si turqizëm dhe me kuptim “trashëgimi, pjesë” që e rendit ndër turqizmat e autorëve të vjetër. Pra, si një fjalë të vetme megjithëse te Çabej apo në FGJSSH që i hasim si dy fjalë me origjinë dhe kuptime të ndryshme. Kuptimi i parë i fjalës *pajë* I është: “*plaçkat që qon nusja në shtëpinë e dhëndrit kur martohet*” fjalë e mbarë shqipes, huazim prej lat. *pallia*. Ndërsa kuptimi i dytë i fjalës *pajë* II është: “*përkrahje e dikujt kur nuk ka të drejtë, anësi hatër*” fjalë e gegërishtes, huazim prej turqishtes: *pay*. Kuptimin e parë të fjalës “*pajë* I”, Meyer-i (2007: 366) e sheh si huazim latin *pallia* < *pallium* “*teshat që i jepen gruas si pajë*”. Omari (2016: 37) thotë se këto të dhëna tregojnë për një vjetërsi më të madhe të fjalës *pajë* I duke e ndarë atë fonetikiqisht nga *pajë* II, gjë që i jep të drejtë Çabejt që për nga kuptimi *pajë* I të mos ketë të bëjë me turqishten. Ndërsa sipas Karaağaç-it (2008: 680) ky huazim në gjuhët e tjera të Ballkanit (serb., bullg., greq.) nënkupton “*pjesë, trashëgimi*” ndërsa në gjuhën shqipe ka reflektuar me kuptimin “*pajë, dhuratë e dasmës*”. Po me të njëjtën kuptim e hasim edhe te Dilaver Berber-i (1964: 64) “*pa:ja e nuses âšt e bukur*”. Sipas fjalorit të TDK-ës (2011: 1902) kuptimi i fjalës *pajë* < T. *pay* përpos që jep kuptimin themelor “*trashëgimi, pjesë që i takon dikujt, ndarje e barabartë*” jep edhe kuptimin “*kardeş payı*” (hise, trashëgim ndërvëllazëror - ndarje e barabartë). Përderisa turqishtja nuk ka gjini, atëherë i bie që vajza kur të shkojë nuse të marrë me vete pjesën që i takon.

Në veprën e Matrëngës “E mbsuame e krështerë” e vitit 1592 nuk ka asnjë turqizëm. Në tri veprat e Pjetër Budit të botuara më 1618-1621 diku 10 leksema dalin si turqizma *me dërtunë* (vajtoj, ankohe) > T. *dert*, *-di* > Pers. *dert*; pastaj *hesap*, *-bi* (*hesa:bi*) < Ar. *hisāb* (llogari); *maskarí* > T. *maskara*; *pajë* (*hatër*) > T. *pay* (pjesë, porcion); *pajt* (hajde këtu) prej *pa*

hajde > T. *hayde*; *pazar*, *rakí*, *sengjír* (*zenxhir*) > T. *zincir* > Pers. *zencir*; *shend* (gëzim) > T. *şen*; *terezí* > T. *terazi*. Në Fjalorin e Frang Bardhit fjalorit dygjuhësh “*Dictionarium latino-epiroticum*” të vitit 1635 numri i turqizmave është më i madh, 47 njësi leksikore. Shumica e huazimeve turke të përdorura në veprën e Bogdanit, kryesisht terminologji fetare myslimane, gjenden në Fjalorin e sotëm të gjuhës shqipe. Vjelja e turqizmave nga ky fjalor është bërë prej Bardhyl Demirajt (2008).

Siç shihet në gjuhën e shkruar të autorëve të vjetër shqiptarë numri i turqizmave ka shkuar duke u rritur. Se turqizmat kishin filluar të zënë vend në leksikon e gjuhës shqipe tregojnë sqarimet e Fjalorit të Bardhit, gjatë trajtimit të fjalëve latine në vend të sqarimit në gjuhën shqipe jepen shembuj në gjuhën turke. Përdorimi i fjalëve turke në vend të përdorimit të sinonimeve të tyre në gjuhën shqipe tregon se popullata shqiptare e asaj kohe ishte mishëruar me fjalë të tilla. Përderisa fjalorët shkruhen për qëllime praktike përdorimi i këtyre fjalëve nga ana e Bardhit duhet të jetë bërë për lexueshmërinë e fjalorit nga shtresat e popullsisë. Disa nga fjalët latine të sqaruara me turqizma në këtë fjalor janë: *çauş*, për iudex: gjykues, *kadi*, *christanus*: i krishtenë, *giaur*, epirote: i arbneshtë, *Arnavut*. Bardhi po ashtu i jep emrat e fafënisë në katër gjuhë si latinisht, italisht, shqip e turqisht *filius*: *bīr*, *oglan*, *soror*: *sorella*, *motra*, *kiskardesch*; *sponsa*: *sposa*, *nuseja*, *gelin*. Numri i turqizmave dhe roli i turqishtes në këtë fjalor tregon për njohjen e kësaj gjuhe nga ana e autorit.

Kah fundi shekullit XVII turqishtja kishte depërtuar aq shumë sa që edhe në veprat letrare me përmbajtje fetare katolike kishte numër të madh të turqizmave. Në veprën e Pjetër Bogdanit janë përdorur 87 turqizma ku prej tyre 74 nuk janë përdorur nga Buzuku, Budi, e Bardhi. Faktet e tilla tregojnë se Bogdani ishte njohës i mirë i turqishtes, si dhe e fliste këtë gjuhë shumë mirë (Omari 2016: 36-38).

Turqizmat e përdorura në këtë periudhë prej autorëve të vjetër që në bazë të burimeve gojore e shkrimore njihen si pjesë e leksikut më të moçëm të huazuar prej turqishtes, e që janë, si: *çardak*, *hajjat*, *konak*, *odë/odá*, *oxhak*, *saraj*, *temel*; *hambar*, *sënduk*, *tepsi*, *zinxhir*; *biber*, *bilur*, *bojë/boja*, *raki*; *caruqe*, *cohë*, *çarap*, *çarçaf*, *çizme*, *dollamë*, *futë*, *gajtan*, *masur*, *tok-a*; *gjemi*, *hesap*, *okë*, *pazar*, *shinik*, *terezí*, *berber*, *kasap*, *terzi*, *zanat*, *amanet*, *bullë*, *hadum*, *hajn*, *haramí*, *jar/jaran*, *kallauz*, *sejmen*, *bajrak/bajraktar*,

haraç, pashë/pashá, raje, sanxhak, sulltan, vezir; davi/davis, kadi, kanun, kanun name, mehquemé, myhyr, testir, veqil, vergji, xhelat, zabiti; dervish, hoxhë, kurban, myfti, synet; bori/buri, daulle, dyftek, fitil, gargji, jeniçer, mejdan, top; manushaqe, nerënxë, selvi, zymbyl, asllan, deve, fil, majmun; Arnavutllar, Edrene, Misir, Selenik, Stamboll, Turk. Brenda këtij grupi do veçuar një shtresë me fjalët *bori, caruqe, cohë, çaraçaf, daulle, dollamë, dyfek, gajtan, haraç, haramí, hesap, jar, jeniçer, kadi, kallauz, maunshaqe, masur, nerënxë, pashá, raja, sanxhak, sënduk, sulltan, shinik, tepsi, tok-a.* Në bazë të dëshmimeve e burimeve gojore e shkrimore dhe në pajtim me rrethanat historike këto elemente të leksikut njihen si pjesë e leksikut më të moçëm të huazuar prej turqishtes.

Oliver Jens Schmitt (2012: 111) vëren se që nga shekulli XVII dukshëm më shumë shqiptarë kanë përqafuar islamin, gjë që ndikoi në depërtimin e një numri më të madh të turqizmeve në fusha të ndryshme të jetesës. Ndikimi i islamizimit në përhapjen e turqizmeve duket në numrin e vogël të turqizmeve në të folmet e arnbeshëve të Zarës në Dalmaci që kanë emigruar nga Shestani, Brisku e Livari (në veri të Ulqinit) të cilët nuk e kanë përqafuar islamin. Sot në këto të folme sipas studimit të Barançiq-it (2017) përdoren vetëm 12 turqizma: bubreg, bunar (Trg Tri Bunara në Zarë), qarapa, dugme, xhep, jastuk, krevet, majmun, papuçe, raki, sheqer e zanat (Rugova & Barançiq 2018: 260).

3. Roli i turqishtes në gjuhën shqipe

Përveç gjuhës, faktorë të ndryshëm veçanërisht politika, historia dhe fetë e vendit ku jetojnë, bëjnë që një shoqëri të jetë dygjuhëshe. Këta faktorë janë rezultat i marrëdhënieve që zhvillohen brenda vetë shoqërisë dhe që kanë mundur të rezultojnë në shfaqjen e gjuhëve të përziera si gjuhët pidgin, kreol, hibrid etj. Fishman-i (1965) dalloi dygjuhësinë individuale nga dygjuhësia sociale. Dygjuhësia sociale, sipas Fishman-it, i referohet shoqërive shumëgjuhëshe që mund të përbëhet nga individë dygjuhësh, si dhe individë njëgjuhësh.

Të folurit rrjedhshëm të dy gjuhëve me kontroll si ai i një folësi amtar referohet si dygjuhësi sipas Bloomfield-it ([1935] 1973). Soffieti (1960) me punimin e tij për herë të parë ka bërë të qartë se individët mund të jenë jo

vetëm dykulturore dhe dygjuhësore, por edhe dykulturore dhe njëgjuhësh, monokulturore dhe dygjuhësh, si dhe monokulturore dhe njëgjuhësh.

Një grup njerëzish janë dygjuhësh pa qenë dykulturore, si p.sh.: anëtarë të komuniteteve diglotike, banorë të vendeve me gjuhë “lingua franka” ose gjuhë të ndryshme shkollore, studiues të gjuhëve të huaja që më pas përdorin rregullisht gjuhën e tyre të dytë etj. Anasjelltas, disa njerëz janë bikulturore pa qenë dygjuhësh. Në këtë rast kemi të bëjmë me folësit, e një gjuhe që lëvizin në një vend tjetër që përdoret e njëjta gjuhë, apo, e anëtarëve të një kulture që nuk e dinë më gjuhën e pakicës, por që ruajnë tradita të kësaj kulture. Folësit e bilinguizmit monokulturore ndajnë në mes vete vetëm një kulturë. Në këtë situatë ata duhet të çaktivizojnë sa më mirë që është e mundur kulturat e tyre, se përndryshe ata do të jenë të njëjtë me bikulturore të tjerë që ndajnë kulturat e tyre. Kështu ata do të përdorin një kulturë bazë për të bashkëvepruar, si sjelljet, qëndrimet, besimet e huazimet një kulture të vetme (Grosjean 2015: 573-581).

Kryesisht, bilinguizmi është një opsion që zakonisht konsiderohet për folësin që vjen nga një familje që kanë migruar në një vend të ri apo me prindër që gjuhë amtare kanë gjuhë të ndryshme. Mirëpo me bilinguizmin monokulturore, familja e folësit nuk ka emigruar, ata jetojnë në tokën e tyre amë dhe janë monolingë. Folësi detyrohet të zgjedhë, varësisht prej rastit flet gjuhën amtare L_1 në shtëpi apo në shkollë, ndërsa në komunitet flet gjuhën e kulturës L_2 .

Bilinguizmi unikulturore apo monokulturore na orienton kah kultura, kah identiteti etnolinguistik që zhvillohet me anë të kontaktit gjuhësor të folësit. Identiteti kulturor është një aspekt i rëndësishëm i personalitetit. Studiuesit Hamers dhe Blanc ([1983] 2000: 239) në veprën e tyre lidhur me dygjuhësinë thonë që bilinguizmi zhvillon një identitet unik, të ndryshëm nga monolingvizmi, por i cili sidoqoftë mund të rregullohet në mënyrë harmonike nëse shoqëria e lejon. Ndërsa identiteti etnolinguistik i bilinguizmit formohet nga përvoja e tij dygjuhëshe, dygjuhësia e tij ndikohet nga identiteti i tij kulturor dhe lidhjet e tij psikologjike dhe afektive. Identiteti etnolinguistik aktivizohet dhe rregullohet përmes dinamikës së gjuhës dhe komunikimit (Gudykunst & Ting-Toomey, 1990). Mund të themi se kultura e një personi referohet si “identitet”. Identiteti dhe gjuha kanë një marrëdhënie jetike; ato ndërtojnë, përbëjnë dhe formojnë njëra-tjetrën. Po ashtu, përcaktojnë mënyrën se si

njeriu e shikon jetën dhe e percepton botën (Norton, 1995; Ricento, 2005; Su Kim, 2003; Watson-Gegeo, 2004). Me bilinguizm monokulturor kuptojmë që folësi L_1 e ka gjuhën amtare ndërsa L_2 e ka gjuhën e kulturës, shoqërisë, vendit ku jeton, vendësit e tij i përkasin të së njëjtës kulturë.

Për vendet e Ballkanit sidomos gjatë periudhës osmane, po në disa qytete edhe sot, edhe pse qytetet mund të numërohen me gishta, turqishtja është një gjuhë e kulturës për këto vende. Qytete që ende flitet turqishtja ku më shumë e ku më pak janë qyteti i Prizrenit, i Prishtinës, i Gjilanit, i Shkupit, i Tetovës, i Kërçovës, i Strugës etj. Ismajli (2020: 18) në veprën e tij “Gjuhë standarde dhe histori identitetesh” për qytetin e Prizrenit thotë se një shtresë e popullatës së këtij qyteti, pavarësisht nga përkatësia kombëtare, flasin turqishten vendëse, sigurisht me shumë regjime, por shpesh kjo gjuhë ishte gjuha universale e marrëveshjes. Bilingu i këtyre anëve si gjuhë të dytë L_2 ka turqishten ballkanike, ndërsa gjuhë të parë L_1 ka gjuhën amtare, gjuhën shqipe.

4. Turqishtja si gjuhë prestigji

Turqishtja nuk është një gjuhë ballkanike; është vetëm një gjuhë në Ballkan (Reinkowski 2002: 101). Apo siç thotë Friedman-i (1997: 233) turqishtja edhe pse jo një gjuhë ballkanike në kuptimin strukturor-areal, megjithatë është gjuhë e rëndësishme e Ballkanit si adstrat. Studimet për ndikimin e turqishtes në gjuhët ballkanike janë ndër të parat që lidhen me fushën e gjuhësisë ballkanike (Miklosich 1884). Për ballkanasit turqishtja ishte gjuha e komunikimit brenda Perandorisë Osmane. Jashari (1989), gjatë periudhës osmane turqishtja ishte gjuha e tregut dhe e administratës, si dhe e fshatrave të përziera dhe monoetnike. Për më tepër, ajo e ruajti statusin e saj në mesin e zejtarëve urbanë edhe në shekullin e njëzetë.

Gjurmët e turqishtes në gjuhën shqipe janë mjaft të thella thotë Çabej (1976: 66), ngase ato përfshijnë jetën shtëpiake, sociale e shtetërore. Duke u nisur nga ky këndvështrim ne e shohim se turqishtja në gjuhën shqipe ka gjetur vend si në vendbanim, mënyrën e banimit, orënditë e shtëpisë, kuzhinën, gjellët, veshjen e mbathjen. Jo vetëm kaq, por edhe folklorin, doket e zakonet si ato të lindjes, të martesës, të vdekjes, festat, dëfrimet popullore, muzikën, veglat muzikore, meloditë e këngëve, besimet popullore, figurat e

përrallave, jetën fetare me gjithë terminologjinë islamike, jetën sociale, administratën, ushtrinë e luftën. Me një fjalë, ndikimi i turqishtes ka rrokur gjithë jetën qytetare. Më të dobëta janë gjurmët në katund. Prandaj në fushë të gjuhës më të pakta janë gjurmët në fushën e bagëtisë e të bujqësisë, në emra të bimëve e të shtazëve. Kështu gjuha na vërteton koncentrimin e jetës turke-orientale nëpër qytete.

Kështu pas viteve 1912-1913 në Shqipëri nuk kishte më as kontakt gjuhësor të përcaktuar demografikisht midis shqipes dhe turqishtes. Sejdiu-Rugova (2017: 227) thotë se pas largimit të Perandorisë Osmane, pati një deklaratë pavarësie për shtetin shqiptar (1913), por disa nga territoret shqiptare mbetën nën sundimin e disa vendeve të tjera (Serbia, Mali i Zi, Maqedonia, Greqia). Në këtë periudhë kohore statuset përkatëse të shqipes dhe turqishtes u zhvendosën e u zëvendësuan midis dy gjuhëve, ky lloje transmetimi është trajtuar nga Beci (2002), Ismajli (2020) e Rugova (2012).

Turqishtja për një kohë të gjatë, në trevat shqiptare, është përdorur edhe si gjuhë prestigji bile në situata të caktuara thotë Bardh Rugova edhe si gjuhë e fshehtë. Gjuhë që e kanë përdorur dy folës për të mos u kuptuar nga të tjerët në një ambient të caktuar. Rugova në studimin e tij (2012) shton se humbja e prestigjit të turqishtes si gjuhë, në qytetin e Prishtinës, ka ndikuar në lindjen e një gjuhe të fshehtë të të rinjve të Prishtinës që është shfrytëzuar për qëllime pak a shumë të njëjta.

Qytetet më të prekura të asaj kohe nga përdorimi i turqishtes si gjuhë e qytetit kanë qenë qytetet Shkodra, Berati, Elbasani e Gjirokastra. Në Kosovë, turqishtja pos Prizrenit (Mamushë) është folur si shënues qytetarie në Pejë, Gjiilan (Miresh - Dobëroçan), Prishtinë, Vushtrri, - në vilajetin e Kosovës si dhe Preshevë. Në Maqedoni ndikimi i turqishtes shihet edhe në qytetet Kërçovë e Gostivar pastaj në Shkup, Ohër, Tetovë, Strugë e Dibër. Sipas studimeve të viteve 1950-1955 dhe raporteve të vitit 1991 në gazetën turke "Birlik" nga Shkupi, turqishtja thuhet se është përdorur vetëm brenda familjes në disa qytete si në Elbasan, Shkodër, Tiranë e Krujë (Friedman 2006).

Në Maqedoni nuk janë të rralla familjet që flasin dy apo më shumë gjuhë, e njëra nga ato gjuhë është turqishtja (Fraenkel & Kramer 1993). Në këtë mënyrë mjedisi i kontaktit gjuhësor të turqishtes ballkanike vazhdon të përsëritet pavarësisht ndryshimit të statusit të turqishtes nga gjuha e dominuar në gjuhë të dominuar (Friedman 2006: 30).

5. Purizmi në gjuhën shqipe

Në kulturën shqiptare kishte filluar një lëvizje për t'i zëvendësuar fjalët turke dhe huazimet e tjera me fjalët shqipe edhe pse nuk pati shumë sukses. Idetë puriste filluan në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare përkatësisht përgjatë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX. Shkrimtarët e Rilindjes u përpoqën të gjenin fjalë dhe shprehje të vetë shqipes, adekuate ose të afërta për nga kuptimi, por gjithashtu iu drejtuan krijimit të neologjizmave. Desnickaja (2006: 128) thotë se lufta ndaj turqizmeve ishte parulla e përhershme e politikës gjuhësore të Rilindjes shqiptare.

Falë politikës së këtyre të fundit nëpër shkolla mësimi filloi të mbahej në gjuhën shqipe. Kështu që turqishtja, në gjysmën e dytë të shekullit XX, mbi-jetoi vetëm në ligjërimin e folur. Revista "Gjuha shqipe" ka realizuar një projekt të titulluar "Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj" (2000: 3-4), qëllimi ishte jo vetëm të përdorej fjala dhe shprehja shqipe, por edhe të bëhen propozime të reja. Ky projekt kishte për qëllim pastrimin dhe pasurimin e mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe, përdorimin e fjalëve shqipe në vend të atyre të huazuara. Lindita Sejdiu-Rugova (2017: 227) në studimin e saj kush-tuar statusit formal dhe joformal të turqizmeve duke marrë si korpus këtë projekt vë theksin fjalëve të huazuara turke në gjuhën shqipe.

Në fund të Perandorisë Osmane kontakti në gjuhën turke-shqipe u ndërpre vetëm në Shqipëri sidomos në kohën e komunizmit me ndalimin e predikimit të fesë, në këtë rast të fesë islame. Në Shqipërinë komuniste rezultoi që fjalori i huazimeve turke me terminologji fetare të pësojë humbje. Në Shqipëri, riaktivizimi i fjalorit fetar ndodhi pas rënies së komunizmit, kjo arriti vetëm në qarqet predikuese (Jusufi & Pani 2016: 143). Ndërsa kontakti shqip-turqisht në ish-Jugosllavi ishte krejt ndryshe, veçanërisht në qendrat urbane. Pjesa e popullatës që e shohin vetën si pasardhës së elitës urbane nga periudha osmane, në Kosovë e Maqedoni, u shqiptarizuan në mënyrë rigoroz gjatë procesit të fortë të ndërtimit të kombit shqiptar.

5. Përfundimi

Në këtë punim të shkurtër pamë ndikimin e turqishtes, si gjuhë e fortë për nga aspekti social B (si gjuhë prestigji), për pesë shekuj me radhë i ka dhënë shqipes fjalë si gjuhë e dobët për nga aspekti social A. Periudha që ne prekëm pak më shumë në këtë punim janë shekujt XVI-XIX. Për të studiuar këtë periudhë kohore janë marrë për bazë tekstet e autorëve të vjetër shqiptarë. Këtë autorë edhe pse kanë qenë misionar kishtar e kanë botuar vepra për mbrojtjen e krishterimit në hapësira shqiptare, nëpër tekstet e tyre kanë përdorur numër të konsiderueshëm të turqizmave. Në veprat e shkruara të autorëve të vjetër shqiptarë vërehet se numri i turqizmave ka shkuar duke u rritur. Në atë kohë shihet se popullata shqiptare ishte familjarizuar disi me terminologjinë turke.

Depërtimi dhe përhapja e fjalës turke ka vazhduar edhe në shekujt në vazhdim në hapësirat shqiptare. Në Maqedoni, Kosovë, Mal të Zi e Serbi (fjala është për pjesët e banuara me shqiptarë) një numër i turqizmave në këto anë në gjuhën shqipe janë futur nën ndikimin e gjuhëve sllave. Fati i njëjtë e ka përcjellë edhe shqipen në Greqi, hyrja e turqizmave nëpërmes greqishtes, një gjë të tillë e vërejtëm edhe në të folmen e arbëreshëve të Italisë shekuj më parë. Ndërsa e folmja e shqiptarëve të Shqipërisë karakterizohet me numër më të vogël të turqizmave për shkak të rrethanave historike. Periudha e purizmit misioni i së cilës ishte pastrimi i gjuhës shqipe prej huazimeve filloi në periudhën e Rilindjes dhe vazhdoi deri në periudhën e Komunizmit. Një mision i tillë bëri që huazimet turke të zëvendësohen tani më me fjalën shqipe.

Literatura:

- BARANČIĆ, Maximiljana (2017). Udžbenik arbanaškoga govora s arbanaškohrvatskim i hrvatsko-arbanaškim glosarom. Zadar.
- BEČI, Bahri (2002). Probleme të lidhjeve të shqipes: me gjuhët e tjera ballkanike. Dukagjini.
- BERBERI, Dilaver (1964). Phonological and Morphological Adaptation of Turkish Loanwords in Contemporary Albanian Geg Dialect of Kruja: A Synchronic Analysis, Indiana University, (Disertacion i doktoratës).
- BLOOMFIELD, Leonard ([1935] 1973). Language. George Allen & Unwin Ltd. Museum Street. London.
- ÇABEJ, Eqrem (1975). *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke*. Studime filologjike (4), Tiranë.
- ÇABEJ, Eqrem (1976). Studime gjuhësore III. Rilindja. Prishtinë.
- DEMIRAJ, Bardhyl (2008). Dictionarium Latino-epiroticum (Romæ 1635) për R. D. Franciscum Blanchum. Botime Françeskane. Shkodër.
- DESNICKAJA, A. V. (2006). Mbi funksionin stilistik të turqizimeve në poezinë shqipe. Perla 2006/4. Tiranë.
- FISHMAN, J. A. (1965). Bilingualism intelligence and language learning. *Modern Language Journal*, 49.
- FRAENKEL, Eran. Christina E. Kramer (1993). *Language Contact: Language Conflict*. (Balkan Studies 1). Peter Lang Publishing Inc.
- FRIEDMAN, Victor (1997). Kontakti dhe Ndërgjegjia në Lidhje Gjuhësore Ballkanike. Studime (3). ASHAK. Prishtinë.
- FRIEDMAN, Victor (2006). *West Rumelian Turkish in Macedonia and adjacent areas*. In: Hendrik Boeschoten & Lars Johanson (Hrsg.). *Turkic Languages in Contact*. (Turcologica 61.). Wiesbaden.
- GROSJEAN, François (2015). *Bicultural bilinguals*. *International Journal of Bilingualism*. Vol. 19(5), p. 572–586.
- GUDYKUNST, W. B. & Ting-Toomey, S. (1990). Ethnic identity, language and communication breakdowns. In: H. Giles & W. P. Robinson (Eds), *Handbook of language and social psychology* (pp. 309-327). John Wiley & Sons.
- HAMERS, Josiane. F. & Michel H. A. Blanc (2000). *Bilinguality and Bilingualism*. Cambridge University Press. Cambridge.

- ISMAJLI, Rexhep (2020). Gjuhë standarde dhe histori identitetesh. ASHSH. Tiranë.
- JASHARI Olivera (1989), “Kontaktet e të folmeve maqedonase me të folmeve shqipe”, Prishtinë. GJA. Nr: 19.
- JUSUFI, Lumnije. Pandeli Pani (2016) *Dem Purismus zum Trotz: Das Überleben der Turzismen im Albanischen*. Mediterranean Language Review Vol. 23, pp. 127-161 (35 pages) Published By: Harrassowitz Verlag.
- KARAAĞAÇ, Günay (2008). Türkçe Verintiler Sözlüğü. TDK Yayınları. Ankara.
- MATZINGER, Joachim (2016). Die sekundären nominalen Wortbildungsmuster im Altalbanischen bei Gjon Buzuku. Ein Beitrag zur altalbanischen Lexikographie (Albanische Forschungen 38). Wiesbaden: Harrassowitz. Wiesbaden.
- MEYER, Gustav ([1891] 2007) Etymologisches Wörterbuch der albanischen Sprache, Strassburg (përkthimi në gj. sh. Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe. Botime Çabej. Tiranë. Përkthyer nga Anila Omari).
- MIKLOSICH, Franz (1884). Die Türkischen Elemente im den südost-und osteuropäischen Sprachen (Griechisch, Albanisch, Rumanisch, Bulgarisch, Serbisch, Klain Russisch, Grobrussisch, Polnisch). I. Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften, Philosophisch – historische Classe, XXXVII, Wien.
- NORTON, B. (1995). Social identity, investment, and language learning. TESOL Quarterly. 29(1), pp. 9-31.
- OMARI, Anila (2016). Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit. QSA. Tiranë.
- REINKOWSKI, Maurus (2002). Kulturerbe oder Erblast? Zum Status der Turzismen in den Staaten Südosteuropas, insbesondere des Bosnischen. Mediterranean language review 14. Wiesbaden: Harrassowitz Verlag.
- RICENTO, T. (2005). *Considerations of identity in L₂ learning*. In E. Hinkel (eds.). Handbook of research in second language teaching and learning (pp. 895-910). New Jersey: Lawrence Erlbaum Associates.
- RUGOVA, Bardh (2012). *Pozita dhe statusi i shqipes kundruall gjuhëve të tjera të Ballkanit*. Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit – konferencë shkencore. ASHAK. Prishtinë. pp 163-173.
- RUGOVA, Bardh. (2016). Rriçe Rome Itaçi, e Zakucati: përmbledhje punimesh për tekstin dhe gjuhën në shoqëri. Trembelat. Prishtine.
- RUGOVA, Bardh. Maximiljana Barančić (2018). Turcizmat në të folmen e arbeshëve të Zarës. Studime 24. ASHAK. Prishtinë.

- SCHMITT, Oliver Jens (2012). *Kosova: Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*. KOHA. Prishtinë.
- SCHÜZ, István (1986). *Gjurmë gjuhësh turke mesjetare në gjuhën shqipe*. Seminari Ndërkombëtarë për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. S: 11. Prishtinë.
- SEJDIU-RUGOVA, Lindita (2017). *The Formal and Informal Status of Turkish Loanwords in Albanian*. Edebiyat Fakültesi Dergisi. Trakya Üniversitesi. Edirne.
- SOFFIETI, James P. J. (1960). *Bilingualism and biculturalism*. The Modern Language Journal. 44, pp. 275–277.
- SU KIM, L. (2003). *Multiple identities in a multicultural world: A Malaysian perspective*. *Journal of Language, Identity and Education*. 2 (3), pp. 137-158.
- WATSON-GECEO, K. A. (2004). *Mind, language, and epistemology: Toward a languagesocialization paradigm for SLA*. The Modern Language Journal. 88 (3), 331-350.

Festime MEHDIU

ANGLICIZMAT NË GJUHËN SHQIPE - RAST STUDIMI LIGJI PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Abstrakt:

Të gjitha gjuhët evropiane kanë ndikuar njëra-tjetrën në një farë mënyre dhe disa prej tyre janë përhapur edhe në të gjithë globin. Anglishtja, duke qenë një nga gjuhët më të përdorura, flitet nga një masë e madhe prej një miliardë e gjysmë njerëzish në botë. Ndikimi i anglishtes sot është i pranishëm në të gjithë leksikon e shqipes dhe pothuajse në të gjitha fushat dhe stilet e përdorimit të saj. Gjuha shqipe, në mesin e huazimeve leksikore, ka edhe një shtresë të huazimeve angleze, sidomos të dekadave të fundit. Anglicizmat, të përcaktuara si fjalë të huazuara nga anglishtja në gjuhë të tjera të botës, sot hasen shpesh në gjuhën shqipe. Është e vërtetë që edhe gjuha angleze ka një fond të madh fjalësh që i ka huazuar nga gjuhët e tjera të botës si nga gjuha latine apo gjuha frënge, mirëpo me kalimin e kohës ato fjalë kanë fituar statusin e fjalëve angleze dhe si të tilla kanë depërtuar në gjuhën shqipe.

Periudha e administrimit ndërkombëtar në Kosovë, kontaktet e drejt-përdrejta të përditshme të anglishtes me gjuhën shqipe, kërkesa e tepëruar për përkthim të teksteve të shkruara dhe të folura, padyshim që i dhanë shtysë vendimtare ndikimeve të anglishtes në gjuhën shqipe. Sot duket sikur janë hequr të gjitha pengesat që ndalojnë depërtimin e fjalëve të huaja dhe ato kanë vërshuar gjithë truallin gjuhësor të shqipes, ku as Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë (2015) nuk bën përjashtim.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të hulumtojë përdorimin e anglicizmave në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë

(2015) duke dhënë kështu një pasqyrë të detajuar të anglicizmave të përdorura në këtë ligj dhe duke i klasifikuar ato edhe sipas klasave të fjalëve.

Krahasimi me anglicizmat e përdorur në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (2011) gjithashtu do të jetë pjesë integrale e këtij punimi.

Me interes të veçantë do të jetë edhe çështja e shpeshësisë së përdorimit të këtyre anglicizmave.

***Fjalë kyçe:** anglicizmat, huazim, shqipe, angleze, ligj, Shqipëri, Kosovë, krahasim.*

Abstract:

All European languages have influenced each other in a way and some of them spread also all over the globe. English, being one of the most widely used language, is spoken by a large mass of one and a half billion people in the world.

The influence of English today is present in the entire lexis of Albanian and, in almost all domains and styles of its use. Anglicisms, defined as words borrowed from English into other languages of the world, today are frequently encountered in the Albanian language.

The Albanian language, among the lexical borrowings, also has a layer of English borrowings, especially from the last decades. Anglicisms, defined as words borrowed from English into other languages of the world, today are frequently encountered in the Albanian language. It is true that the English language also has a large fund of words that it has borrowed from other languages of the world such as from Latin language or French language, but over time those words have acquired the status of English words and as such, they have entered in Albanian language.

The period of international administration in Kosovo, the direct daily contacts of English with Albanian language, the excessive demand for translation of written and spoken texts, undoubtedly gave the decisive impetus to the influences of English on the Albanian language. Today it seems as if all the obstacles that stop the penetration of foreign words have

been removed and they have flooded the entire linguistic troll of Albanian where the Law on Higher Education in the Republic of Albania (2015) is not an exception.

The main purpose of this paper is to research the use of anglicisms in the Law on Higher Education in the Republic of Albania (2015), thus giving a detailed overview of anglicisms used in this law, classifying them according to word classes as well.

The comparison with anglicisms used in the Law on Higher Education in the Republic of Kosovo (2011) will also be an integral part of this paper.

Of a particular interest will also be the issue of frequency of the use of these anglicisms.

Keywords: *anglicisms, borrowings, Albanian, English, law, Albania, Kosovo, comparison*

Anglicizmat në gjuhën shqipe

Pothuajse të gjitha gjuhët e Evropës ndikuan në njëra-tjetrën dhe disa prej tyre u përhapën në të gjithë globin. Holanda, Belgjika, Franca, Gjermania, Anglia të gjitha përhapën ndikimin e tyre dhe gjuhët e tyre në të gjithë botën. Në këto dy dekadat e fundit anglicizmat kanë hyrë në shumë gjuhë të botës. Sipas autorit Hoffer (2002: 10) situata e njëjtë qëndron edhe me internacionalizmat të cilat janë huazime që gjenden në gjuhët kryesore të botës.

Edhe pse me plot fjalë “të huaja”, anglishtja, jo vetëm që gjallon edhe sot e kësaj dite, por është më me ndikim se kurrë më parë. Anglishtja, posaçërisht varianti i saj amerikan, është bërë një gjuhë që shumë më tepër jep sesa merr. Gjuha angleze në vazhdimësi po krijon fjalë të reja me një ritëm që vështirë e kanë ta ndjekin gjuhët e tjera.

Kur bëhet fjalë për karakterin ndërkombëtar apo globalitetin e gjuhëve, Ulrich Ammon (Munishi, 2015: 39) thekson se disa nga treguesit më të mirë të karakterit ndërkombëtar apo të globalitetit të gjuhëve janë shkalla e mësimin të tyre si gjuhë të huaja, numri i madh i folësve burimorë që në të njëjtën kohë është edhe një faktor i rritjes së një gjuhe në rrafshin ndërkombëtar, statusi zyrtar në organizatat ndërkombëtare, përdorimi në arsim, si dhe faktorët e tjerë socio-ekonomikë, politikë, teknikë apo teknologjikë, komuniku-

es dhe psikologjikë. Duke marrë për bazë këta parametra, Ammon konstaton se nuk ka gjasa që ndonjë gjuhë tjetër do të mund ta heqë nga fronti gjuhën angleze si gjuhë mbizotëruese dhe në veçanti si një *lingua franca* në botë në një të ardhme të afërt.

Dukuria e globalizimit, e cila, në radhë të parë, është duke u përhapur si dukuri e shkëmbimeve ekonomike dhe kulturore në botë, ka krijuar terren të përshtatshëm për përhapjen e anglishtes në aktivitetet ekonomike evropiane. Sot, në Evropë, njohja e anglishtes, përveç tjerash, paraqet një përparësi për punësim. Në të gjitha vendet e Evropës mësimi i gjuhës angleze pothuajse është bërë i detyrueshëm dhe shihet si një përparësi për karrierën e individit (Munishi, 2015: 40).

Depërtimi i anglicizmave, padyshim, është duke lënë gjurmë në shumë gjuhë të botës, rrjedhimisht edhe në gjuhët evropiane. Në këtë, kuadër regjistrimi i këtyre ndikimeve të anglishtes në gjuhë të ndryshme evropiane është një qasje e dobishme. *Fjalori i Anglicizmave Evropianë* i Manfred Görlachut mund të konsiderohet si një dokumentim i dhënies aktuale leksikore të anglishtes për gjuhët evropiane, deri në fillimet e vitit 1995.

Shqipja ka qenë në kontakt të papërfillshëm me anglishten deri në vitet 1990, kohë e ndërrimeve të mëdha në Kosovë e Shqipëri. Kontaktet gjuhësore janë rritur fuqishëm pas vitit 1999 në Kosovë, ndërsa vazhdojnë me ritme të njëjta edhe në vitet e pas pavarësisë. Anglishtja është gjuhë e tretë zyrtare në Kosovë, pas shqipes, dhe krahas me serbishten. Një pjesë e madhe e ligjeve që ka miratuar Kuvendi i Republikës së Kosovës, sidomos i atyre me ndjeshmëri më të madhe politike dhe që prekin pakicat, janë shkruar fillimisht dhe tingëllojnë si origjinale në anglisht (Hamiti, 2013: 345).

Përmes fuqisë së hatashme të ShBA-së – ekonomike, politike, ushtarake, kulturore e shkencore – por edhe të internetit që fillimisht është mbizotëruar krejt nga anglishtja, kjo gjuhë ka marrë pushtet të madh në shumë gjuhë, qofshin pak, qofshin shumë të përpunuara. Në OKB dhe në Bashkimin Evropian, si gjuhë e parë në përdorim zyrtar, anglishtja ka marrë status supranacional. Në shqip, thekson autori Hamiti (2013, 345), dhe në gjuhë të tjera, përmes sistemit shkollor në vendet ku anglishtja bëhet gjuhë e dytë ose gjuhë e huaj kryesore, anglishtja ka hyrë thellë, në palcë: madje vetë emërtimet për nivelet e shkollimit universitar sipas sistemit të Bolonjës, Baçelor dhe Master, janë prej anglishtes.

Ndikimi i gjuhës angleze si gjuhë globale sot është i pranishëm në tërë strukturën e shqipes dhe, pothuaj, në të gjitha domenet e stilet e përdorimit të saj. Pikërisht ky ndikim i saj në gjuhën shqipe shfaqet në mënyra e rrafshe të ndryshme, kryesisht si ndikim kulturor e ideologjik, duke qenë se ditëve të sotme gjuha angleze, siç u tha më lart, është gjuhë e proceseve të globalizimit dhe gjuhë me përdorimin më të dendur në teknologjinë e informacionit. Anglicizmat, të përkufizuara si fjalë të huazuara nga gjuha angleze në gjuhë të tjera të botës, sot hasen dendur edhe në gjuhën shqipe. Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe varet nga konteksti sociokulturor e politik shqiptar dhe në bazë të këtij konteksti ndryshon edhe forma e përmbajtja e këtij ndikimi. Në fakt, për ta kuptuar sa më mirë këtë ndikim, fillimisht duhet të diskutohen pikërisht këto kontekste dhe si i diktojnë ato ndikimet e anglishtes (Munishi, 2015: 47). Anglishtja, pa dyshim, ka ndikuar në disa forma dhe ka hyrë nëpër disa rrugë të ndryshme. Kontaktet e drejtpërdrejta të përditshme të anglishtes me shqipen, kërkesa e shtuar tej mase për përkthim të teksteve të shkruara dhe të folura, nënkuptohet të teksteve joletrare, padyshim ia dha shtysën vendimtare ndikimeve të gjuhës angleze në gjuhën shqipe. Përballja e gjuhës shqipe me gjuhën angleze, me një gjuhë me leksik kaq të pasur, natyrisht nuk mund të zhvillohej pa pengesa të ndryshme e as pa vështirësi; rrjedhimisht nuk mund të mos linte gjurmë në sistemin gjuhësor të gjuhës sonë. Nëse e kuptojmë thënien e Jakobsonit se gjuhët dallojnë thelbësisht nga njëra-tjetra nga ato kuptime që duhet të bartin, e jo çka mund të bartin, është e qartë se shqipja u detyrua të bartte jo vetëm ato që duhej dhe mund të bartte, por edhe ato që nuk mund të bartte (Gërmizaj, 2008: 241-242).

Para fillimit të tranzicionit në vendin tonë, elementet e gjuhëve të huaja (pra edhe të anglishtes) hynin në shqipe kryesisht sipas mënyrës së të huazuarit kulturor ose të tërthortë. Prandaj edhe numri dhe denduria e tyre ishin shumë më të vogla. Në dekadat e fundit, ndryshoi mënyra e të huazuarit – nga mënyra e të huazuarit të tërthortë, kaloi në mënyrën e të huazuarit të drejtpërdrejtë. Kjo pasoi, ngase kontakti midis këtyre dy gjuhëve u bë i drejtpërdrejtë (Nuhiu, 2013: 128). Nga ana tjetër, me ndryshimin e sistemit politik, ekonomik dhe kulturor në vendin tonë, është paraqitur nevoja për emërtimin e shumë nocioneve të reja që nuk kanë ekzistuar më parë ndër ne. Ato duhej të emërtoheshin. Kurdo që nuk është gjetur në gjuhën shqipe si

gjuhë marrëse një term ose shprehje përkatëse për to, ato janë huazuar. Në rrethana të tilla, është e natyrshme që ndikimi i anglishtes ka qenë dhe vazhdon të jetë jashtëzakonisht i fuqishëm dhe intensiv.

Manfred Görlach, autori/redaktori i tre librave me peshë të madhe për huazimet angleze në rrafsh evropian, duke përfshirë edhe *A Dictionary of European Anglicisms*, OUP, 2001/2005, ka përkufizuar kështu anglicizmin:

“*An anglicism is a word or idiom that is recognizably English in its form (spelling, pronunciation, morphology or at least one of the three) but is accepted as an item in the vocabulary of the receptor language*”. Manfred Görlach. *English Words Abroad*. 2003, fq.1.”

[Anglicizmi është fjalë apo idiomë që njihet qartazi si angleze në formë (ortografi, shqiptim, morfologji, apo së paku në njërin prej këtyre tri- jave), por që pranohet si një njësi/zë në vokabularin e gjuhës pranuese.] (Hamiti, 2013: 346).

Mirëpo, anglicizmat në gjuhën shqipe nuk kanë munguar as në të kaluarën. Autori Thomai konstaton se anglicizmat kanë qenë të përfshira në të gjithë fjalorët e gjuhës shqipe që nga *Fjalori* i vitit 1954, në të cilin gjenden rreth 25 sosh, qysh atëherë të ngulitura në shqipe (*basketboll, biftek, boks boksier, buxhet, çek, futboll, gol* etj.). Më tej, *Fjalori* i vitit 1980 ka rreth 70 anglicizma nga fusha të ndryshme të veprimtarisë. Sipas Thomait (2013: 230) fjalorët e vitit 1984 dhe 2002 kanë përafërsisht numër të njëjtë të anglicizmave, ndërkaq *Fjalori* i vitit 2006 ka sjellë një shtim të lehtë të numrit të tyre, me huazime të mëvonshme nga fusha e informatikës, e biznesit, e financave, e politikës e kështu me radhë.

Pothuajse në secilën analizë të bërë deri më tani në lidhje me dukurinë e huazimit deri më sot tregon qartë që anglishtja është duke ndikuar pa përjashtim në të gjitha fushat dhe si rrjedhojë anglicizmat hasen dendur në të gjitha terminologjitë që mbulojnë fushat përkatëse. Teknologjia e informacionit, ekonomia, financat, politika, diplomacia, legjislacioni, kultura, sporti, kuzhina, moda etj. janë vetëm disa nga fushat apo sferat e gjuhës në të cilat fjalët e huazuara nga gjuha angleze (të quajtura anglicizma) janë duke depërtuar në masë të madhe. Sidomos në këto kohët e fundit vërehet qartë një domosdoshmëri e madhe që studimi i huazimeve nga anglishtja në shqipe të trajtohet me prioritet në studimet e kontakteve të shqipes me gjuhët e tjera, duke u përqendruar në fushat përkatëse, në të cilat janë duke depërtuar hua-

zimet. Këto studime, sipas autorit Munishi (2015, 56) me siguri që do të jepnin një ndihmesë të madhe, në pasqyrimin e gjendjes aktuale të depërimit të anglicizmave në shqipe.

Anglicizmat e përdorur në ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë në vitin 2015 – analizë dhe interpretim i rezultateve

Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë është një nga dokumentet apo materialet që kemi shqyrtuar dhe kemi vendosur ta hulumtojmë në punimin tonë i cili studion përdorimin e anglicizmave në gjuhën shqipe, veçanërisht përdorimin e anglicizmave në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky ligj besojmë se është i një rëndësie të veçantë për t'u hulumtuar, kjo pasi si i tillë është dokumenti në të cilin bazohet rregullimi i tërë sistemit të arsimit të lartë.

Ndër qëllimet tona kryesore në hulumtimin i cili është objekt i këtij punimi ka qenë të hulumtojmë anglicizmat që janë përdorur në Ligjin për AL në RSH. Për të realizuar këtë qëllim, kemi hulumtuar dokumentin me emërtim "*Ligj Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*" publikuar në web faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës respektivisht te Legjislacionet e publikuara nga ky Universitet.

Anglicizmat e përdorur në këtë ligj i cili ka qenë objekt i hulumtimit tonë, i kemi listuar në mënyrë kronologjike, duke filluar kështu hulumtimin e tyre nga faqja e parë e ligjit e duke vazhduar kështu deri në faqen e fundit. Në këtë hulumtim, së bashku me anglicizmat kemi paraqitur edhe barasvlerat e tyre në gjuhën shqipe.

Në studimin tonë kemi trajtuar edhe terma si p.sh. fjalët/shprehjet për akreditim, të cilat në gjuhën shqipe janë huazuar nga anglishtja dhe kanë ardhur gjithashtu së bashku me procesin që e bart ky term, apo edhe shembujt për lëndët me zgjedhje, etj.

Arsyeja pse termat e tilla i kemi cilësuar si anglicizma qëndron edhe në faktin se këto fjalë apo terma të përdorur në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe të vitit 1981, në shumicën e rasteve, i gjejmë me kuptim më të ngushtë

krahasuar me kuptimet që ato fjalë kanë marrë pas viteve nëntëdhjetë. Përveç zgjerimit të kuptimit të atij termi kemi raste të bollshme edhe të tjetërsimit të kuptimit për një fjalë të caktuar. Disa nga shembuj të cilët e dëshmojnë një zgjerim të tillë të kuptimit dhe rrjedhimisht dëshmojnë huazimin e përdorimit të kuptimit të atij termi nga gjuha angleze në gjuhën shqipe po i paraqesim në vijim:

Kurs - tërësia e mësimëve që jepen brenda një kohe të shkurtër

Kurs - Lëndë, lëndë e veçantë mësimore në nivelin universitar

Departament - degë a sesion në një ministri

Departament – degë në një fakultet

Edukim - vetitë shpirtërore e fizike (botëkuptimi, cilësitë morale, tiparet e karakterit e të vullnetit etj.) që fiton njeriu në shkollë, në familje, në shoqëri dhe nëpërmjet veprimtarisë së vet: edukata familjare; edukata e punës

Edukim - Arsimim dhe term i përdorur për emërtimin e Fakultetit të Edukimit

Trajner – Sportist i përgatitur e me përvojë, që ka për detyrë të stërvitë një skuadër futbollit, basketbollit, volejbollit, etj.

Trajner – person i aftësuar për të përgatitur të tjerët në një fushë apo lëmi të caktuar

Risk – fat, kësmet

Risk – rrezik

Brilliant – diamant pa ngjyrë

Brilliant – i shkëlqyer, madhështor, i ndritshëm

Gradim – sipas foljes gradoj – jap një gradë më të lartë nga ajo që mbanë në hierarkinë ushtarake

Gradim - notim

Në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë kemi gjetur të jenë përdorur gjithsej 51 anglicizma. Këto 51 anglicizma i gjejmë të jenë përdorur përbrenda një dokumenti prej 42 faqesh me gjithsej 25,137 fjalë, ku anglicizmin e parë e gjejmë të jetë përdorur në faqen 1, ndërsa të fundit në faqen 41 të këtij dokumenti. Anglicizmat e gjetur nuk janë përdorur vetëm një herë, por janë përsëritur disa herë brenda tekstit.

Krahas anglicizmit të gjetur në materialin e hulumtuar, kemi gjetur edhe barasvlerën e atij anglicizmi në gjuhën shqipe – kjo për të dëshmuar që ekziston një term në gjuhën shqipe për secilin anglicizëm të përdorur në ligjin e hulumtuar.

Në rastin e hulumtimit të anglicizmave të përdorur në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë kemi analizuar edhe shpeshësinë e përdorimit të këtyre anglicizmave. Në tabelën në vijim po paraqesim rezultatet sasiore, të diferencuara sipas shpeshësisë së shfaqjes së anglicizmave më të përdorur të gjetura në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë në vitin 2015. Krahas anglicizmit është dhënë edhe modeli në gjuhën burore si dhe shpeshësia e përdorimit të këtyre anglicizmave në ligjin e hulumtuar:

Tabela 2. Shpeshësia e përdorimit të anglicizmave në LAL në RSH

Anglicizmi	Modeli	Shpeshësia
Personel	Personnel	136
Bazë	Base	118
Cikël	Cycle	71
Bord	Board	64
Administrator	Administrator	54
Akreditim	Accreditation	49
Fond	Fund	40
Master	Master	39

Sikundër mund të shohim në tabelën e paraqitur si më lart, anglicizmat në këtë Ligj nuk janë përdorur vetëm një herë – por ato janë përsëritur disa herë brenda tekstit në tërësi duke e rritur kështu numrin e anglicizmave të përdorur në këtë dokument në 834 nga 25,137 fjalët që ngërthen në vete ky dokument.

Duke hulumtuar Ligjin, i cili në rastin tonë ka qenë objekt i këtij studimit, kemi arritur gjithashtu në përfundim se disa anglicizma në këtë ligj janë përdorur më shpesh krahasuar me të tjerët, shpeshësia e përdorimit të të cilëve ka qenë më e ulët.

Duke e paraqitur këtë pikë të studimit tonë në përqindje, konstatojmë se Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë në tërësinë e tij përmban 3 % anglicizma.



Grafiku 1. Vendi që anglicizmat zënë në LAL në RSH

Klasifikimi i anglicizmave të përdorur në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë në vitin 2015 sipas klasave të fjalëve

Njëra ndër analizat që u është bërë anglicizmave të gjetura në hulumtimin tonë është edhe klasifikimi i tyre sipas klasave të fjalëve.

Sa u përket klasave të fjalëve, mund të theksojmë se në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë klasa e emrave është huazuar më së shumti.

Anglicizmat e gjetur janë analizuar dhe klasifikuar sipas klasave të fjalëve të cilave ato u takojnë në gjuhën nga është huazuar fjala. Edhe te kjo pjesë e hulumtimit, kjo analizë është bërë duke marrë për bazë fjalën e cila ka qenë më e përafërta në gjuhën model e që në rastin e studimit tonë është gjuha angleze.

Nga hulumtimi ynë kemi ardhur në përfundimet si në vijim: nga 51 anglicizmat e përdorur në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, 38 prej tyre janë huazuar nga gjuha model si emra, 4 prej tyre si mbiemra, 8 si folje dhe 1 si ndajfolje.

Figura në vijim i paraqet këto statistika të ndara në përqindje.



Grafiku 2: Anglicizmat e përdorur sipas klasave të fjalëve

Këtu do theksuar fakti se në disa raste (të rralla) kur është huazuar fjala nga gjuha angleze në gjuhën shqipe ka ndryshuar edhe klasën e fjalëve, kështu, edhe nëse një anglicizëm i përdorur në gjuhën shqipe është huazuar nga trajta origjinale p.sh. si emër, gjatë përshtatjes në gjuhën shqipe ka ndryshuar klasë dhe është përshtatur dhe përdorur si mbiemër apo folje në gjuhën shqipe, mirëpo ne, në këtë studim, kemi marrë si model fjalën në gjuhën angleze e cila ka qenë më e përafërt me fjalën/anglicizmin e përdorur në gjuhën shqipe.

Raste të tilla kemi gjetur tek anglicizmat si në vijim:

- *Buxhetor* huazuar nga *budget* – n – plan financiar - Në gjuhën shqipe është përshtatur dhe modifikuar si **mbiemër**
- *Trajnues* huazuar nga *training* – n – përgatitje, stërvitje - Në gjuhën shqipe është përshtatur dhe modifikuar si **mbiemër**
- *I, e akorduar* huazuar nga *accorded* – v – merrem vesh, pajtohem - Në gjuhën shqipe është përshtatur dhe modifikuar si **mbiemër**

Ashtu siç mund të shihet më lart, është një numër relativisht i vogël i anglicizmave që kanë ndërruar klasën e fjalëve gjatë procesit të huazimit, më saktësisht i kemi vetëm 3 sosh.

Nga hulumtimi ynë kemi ardhur në përfundimin që nga 51 anglicizma të përdorur janë gjithsej 3 anglicizma që kanë ndryshuar klasën e fjalës gjatë huazimit. Këto modifikime kanë përfshirë gjithsej 2 emra të modifikuar në mbiemra dhe 1 folje të modifikuar në mbiemër.

Literatura:

- Ammon, Ulrich, 2001. *The Dominance of English as a Language of Science, Effects on Other Languages and Language Communities*. Berlin – New-York: Mouton de Gruyter
- Campbell, Lyle. 2004. *Historical linguistics: an introduction, 2nd edition*. Edinburgh University Press
- Çesku, Pavli. 2000. *Fjalor Anglisht – Shqip – 70.000 fjalë bazë e mbi 250.000 referenca*. Botimet EDFA Tiranë
- Filipovic, Rudolf. 1980. *Transmorphemization: Substitution on the morphological level reinterpreted*. Studia Romanica et Anglica Zaagrebiana 25
- Gërmizaj, Shykrane. 2008. *Kontaktet e anglishtes dhe shqipes – përparësitë dhe rreziqet*. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 27/1, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë
- Gërmizaj, Shykrane. 2012. *Përballja e shqipes me anglishten – begatim apo varfërim*. Kumtesat nga Konferenca vjetore e shkencës, “Java e Shkencës 2012”, Prishtinë
- Görlach, Manfred. 2005. *A Dictionary of European Anglicisms*, Oxford University Press
- Hamiti, Muhamet. (2013). *Venerime për anglicizmat në shqip*. Prishtinë: Studime, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
- Johanson, Lars. 2002. *Code copying*. Italian Journal of Linguistics
- Matras, Yaron. 2009. *Language Contact*. Cambridge University Press
- Munishi, Shkumbin. 2015. *Shqipja në epokën e globalizimit*. Zeroprint, Prishtinë,
- Nuhui, Vesel. 2013. *Ndikimi i Anglishtes në Gjuhën Shqipe*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
- Robins, Robert Henry. 2013. *General Linguistics*. Fourth edition, Routledge
- Sejdiu–Rugova, Linditë. 2013. *Përshtatja e trajtave foljore të gjuhës angleze në gjuhën Shqipe*. Studime, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Thomai, Jani. 2014. *Shqipja me gjuhë të tjera në leksikografi*. Albanologjia, International Journal of Albanology, Universiteti Shtetëror i Tetovës – Tetovë, 1 – 2

Thomai, Jani; Samara, Mico; Haxhillazi, Pavli; Shehu, Hajri; Feka, Thanas; Memisha, Valter; Goga Artan. 2006. *Fjalor i Gjuhës Shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë

Yule, George. 2010. *The Study of Language*. Cambridge University Press

Ligjet:

Ligji nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. (2015)

Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës. (2011)

Vaide KQIKU-HOXHA

NDËRRIMI I PARADIGMËS SË EMRAVE PERSONALË TË SHQIPTARËVE NË KOSOVË

Abstrakt:

Ky hulumtim mëton të përshkruajë dhe interpretojë trendët në vënie e emrave të fëmijëve në Kosovë. Derisa trendi i emrave që shpreh identitet shqiptar: emra me kuptim shqip, emra të personaliteteve të rëndësishme shqiptare, emra ilirë ose emra të toponimeve shqiptare kanë zënë hov duke kulmuar në vitet '70, '80 edhe '90, ky trend ka filluar të ndryshojë. Punimi mbështetet në hipotezën se vënia e emrave personalë manifeston qëndrime të caktuar ideologjike të atyre që i vënë emrat. Emrat me origjinë islame janë karakteristikë për periudhat më të hershme dhe rrethe konservatore tradicionale. Regjistrat e viteve të fundit tregojnë një trend në rritjen e emrave me origjinë religjioze islame, por me forma fonetike të tjera nga emrat tradicionalë. Për realizimin e këtij punimi janë përdorur këto metoda: përshkruese, shpjeguese, statistikore. Materiali është marrë nga listat e përgjithshme të emrave të njerëzve në Kosovë (lista e votuesve) dhe lista e Agjencisë për Regjistrim Civil (ARC). Kjo është krahasuar edhe me disa materiale të mëhershme (Caka, Caka 2010, 2020; Rugova 2013; Bekteshi 2002; Mëniku 2013) etj.

***Fjalët kyçe:** antroponim, ideologji, dinamikë e zhvillimit gjuhësor, fonetikë.*

1. Hyrje

Ky hulumtim mëton të përshkruajë dhe interpretojë trendët në vënien e emrave të fëmijëve në Kosovë. Emrat personalë apo antroponimet si parapëlqehet në qarqet akademike, janë të pranishme në çdo kulturë dhe, natyrisht, prej aty në çdo gjuhë. Prandaj, të trajtuarit e emrave personalë si objekt studimi në linguistikë përveç, si shtresë e veçantë leksikore brenda një gjuhe, do të mund të shtrohej në dy këndvështrime kryesore: 1. Sociolinguistike dhe 2. Diskursi - ideologjia.

Emrat vetjakë mund të shërbejnë për të pasqyruar kontekstin social të komunitetit, por, njëherazi, edhe për të krijuar narrativa, me të cilat krijohen rrethana të caktuara shoqërore dhe konstruktohen realitete. Kontekstet që kanë prodhuar modele emrash të njerëzve në Kosovë janë të lidhura me ngjarjet e ndryshme kulturore dhe politike të manifestuara në vënien e emrave të fëmijëve. Vënia e emrit të gjyshes apo të gjyshit të fëmijës flet për ideologji konservatore tradicionale, po ashtu edhe toponime të Shqipërisë në vitet '60, '70, '80, në Kosovë flasin për ideologji kombëtare, emrat ilirë për identitetin e lashtësisë, emrat **Qëndresë**, **Çlirim** të viteve '90 për ideologjinë e rezistencës apo emrat religjiozë të kthyer në kohën sotme për identitetin fetar. Po ashtu, disa emra lidhen me data dhe ngjarje të caktuara që kanë prodhuar emrat e fëmijëve, si: **Pajtesë** e **Pajtime** emra që lidhen me pajtimin e gjaqeve, pastaj emri **Flamur** ka të bëjë ngjarjet e viteve gjashtëdhjetë; në këtë frymë ishte edhe vënia e emrave ilirë si manifestim i një vetëdije kulturore të caktuar, por edhe emra me origjinë islame që paraqesin një periudhë të forcimit të identitetit religjioz.

Emrat më të shpeshtë të njerëzve në Kosovë janë emra brenda një periudhë të caktuar: emri **Vlorë** ose emri **Valon** janë shumë të shpeshtë në vitet '80 dhe '90; emri **Vlorë** në periudhën 1981 -1990, është përdorur 2696 herë, emri **Valon** në periudhën 1981-1990 është përdorur 3129 herë dhe 1990-1995 është përdorur 1345 herë, por nuk hasen në një periudhë tjetër që do të karakterizohet me emra të tjerë më të shpeshtë, p.sh: Në krahasim me shënimet e ARC -së në vitet 2019, 2020 dhe 2021 ka rënie të përdorimit më pak se dhjetë përdorime, emri **Valon** është përdorur vetëm 8 herë dhe emri **Vlorë** vetëm 9 herë. Emri **Liridon** 8 përdorime, **Liridona** 6, **Agron**, 13, **Alban** 22, **Arbër** 46 etj.

Studimet e deritashme për emrat e njerëzve në Kosovë kanë pasur për synim identifikimin e ndryshimin e paradigmave nga emrat orientale në emra shqip (Bekteshi 2002) dhe motivimin e vënies së emrave (Caka & Caka 2010, 2020). Kjo qasje bën pak hapa tutje leksikologjisë së zakonshme, duke prekur probleme të identitetit dhe të sociologjisë. Studime për emrat vetjakë kanë bërë Caka & Caka, 2010, 2021, Bekteshi 2002, Goçi 2010, Rugova 2013. Punimi më i plotë, më sistematik dhe më i mbështetur në kërkim praktik është Caka . N. & Caka, A. në dy vëllime (2010, 2021). Në të dy punimet (Caka & Caka, 2010, 2021) pasqyrojnë një numër të konsiderueshëm të emrave vetjakë në Kosovë. Punimi i vitit 2021 pasqyron listën me 100 emrat më të përdorur për të dy gjinitë të ndarë në 4 periudha: 1921-1945, 1946-1970, 1971-1995 dhe 1996-2020. Bekteshi ka analizuar 4 mijë emra vetjakë në katër zona: Kosovë, Shqipëri, Kosovë Lindore dhe Maqedoninë e Veriut, për një periudhën 45- vjeçare prej 1950 deri 1995. Ndonëse në plan të gjerë me metodologji precize nuk përfshin (përdor) aparaturë për hulumtimin dhe interpretimin e motivimit të ndryshimeve të paradigmes së emrave vetjakë. Ibrahim Goçi (2010) ka tentuar të sjellë një kontribut në këtë aspekt, por nuk gjejmë matje statistikore të këtyre emrave. Punimi i Goçit është i një natyre preskriptive me venerime të mbështetur në përshtypje, pa aparaturë të qartë studimore.

Rugova 2013, është përpjekja e parë për të diskutuar motivimin e emrave vetjakë. Punimi trajton toponimet e Shqipërisë të përdorura si emra vetjakë në Kosovë, duke i lidhur me periudhën e kufirit të mbyllur Kosovë - Shqipëri, si një shkëndijë identitare. Megjithatë, ka kufizimin vetëm në toponime dhe nuk përfshin emrat e tjerë.

Emrat personale - vetjakë janë të dobishëm në ndërtimin e marrëdhënieve, modernizimin dhe ndryshimet në vlerat e shoqërisë.

Përdorimi i emrave shqip te fëmijët filloi para viteve '30; emrat identifikues kombëtarë zanafillën e kanë shumë më të hershme me përdorime më të rralla. Listat e punimit të Caka & Caka dhe rezultatet e hulumtimit tregojnë që emrat orientale mbizotërojnë deri në vitet '70.

Para viteve '30 deri te vitet '70, 10 emrat më të përdorur orientale të gjinisë femërore janë: **Fatime, Emine, Ajshe, Sanije, Sabrije, Bajram, Ramadan, Ali, Rexhep** etj. Ndërprerjen e emrave orientale e kanë bërë përdorimi më i shpeshtë i emrave shqip **Agim, Afrim, dhe Fatmir** që janë

emrat më të shpeshtë me kuptim shqip të përdorimit në periudhën 1961-1970, dhe këtu filloi ndryshimi i trendit të vënies së emrave të fëmijëve në Kosovë. Ndryshimet kulturore dhe politike manifestuan në vënien e emrave të fëmijëve.

Krahas këtyre tre emrave në këtë periudhë që dominojnë në dhjetëshen më të shpeshtë të përdorimit, emrat orientalë janë: **Enver, Skender, Fadil, Fatime, Emine** etj. Emrat shqip janë përdorur shumë herët si: **Bekim** 1921, **Hana** 1926, **Arsim** 1922, **Shpresa** 1935, 1936, 1944, **Lirie** 1945, **Yllesha** 1950, **Faton** 1951, **Yll** 1934, **Gëzime** 1950, 1952, **Gëzim** 1954, **Vjollca** 1950, **Mërgime** 1950, **Valon** 1954, **Burbuqe** 1953, **Ilir** 1953, **Arben** 1956, **Valbonë** 1955, e kështu edhe shumë të tjerë.

Pas viteve '70 deri vitet 1999- 2000 emrat që dominojnë janë shqip, ilirë, toponime të Shqipërisë: **Merita, Luljeta, Shqipe, Vlorë, Valbona, Shpresa, Vjollca, Liridona, Egzona, Edona, Qëndresa, Abulena, Saranda, Ardiana**, e kështu me radhë sipas dendësisë së përdorimit për gjininë femërore, pastaj emrat mashkullorë: **Agim, Afrim, Fatmir, Bekim, Arben, Agron, Besim, Blerim, Bashkim, Flamur, Dardan, Valon, Burim, Liridon, Egzon, Ilir, Berat, Alban, Arbnor, Qëndrim**, etj. Kurse në krahasim me të dhënat e ARC-së kanë rënie të dukshme në vitet e fundit (2019, 2020, 2021). Pra në vitet e fundit ka ndryshuar vënia e emrave të fëmijëve, emrat shqip kanë rënie e sidomos emrat e periudhave të më hershme, siç janë cekur më lart, ndërsa emrat orientalë dhe ndërkombëtarë kanë ngritje. Emrat me origjinë islame dominojnë në përdorim, por me ndryshimet fonetike të tjera nga emrat tradicionale.

2. Përdorimi i emrave sipas periudhave

Emrin **Flamur** për herë të parë është regjistruar më 1945. Emrin **Flamur** e gjejmë me një përdorim më pak të theksuar para viteve '60 vetëm 13 përdorime, në vitet 1960-67 kemi 151 sosh, ndërsa në vitin 1968 ka ngritje dhe kemi 184 përdorime brenda viti, më 1969 kemi 223, më 1970 kemi 229 emra **Flamur**. Pra ngritja e përdorimit filloi më 1968, 1969, 1970 duke vazhduar më tutje. Emri **Flamur** është përdorur 2605 herë, ngritje të ndjeshme ka në periudhën 1980-1989 me 872, por edhe në periudhën 1990-1995 ka

përdorim më të shpeshtë 554 herë, ndërsa vitet t fundit ka rënie të theksuar, vetëm 8 përdorime (ARC, 2019, 2020, 2021).

Emri **Vlorë** për herë të parë në Kosovë është përdorur më 1958 me vetëm një përdorim, pastaj në vitet '60 filloi të shpeshtohet përdorimi, më 1960-1967 me 124 përdorime, në vitet 1968 me 153 dhe 1969 211 përdorime për të vazhduar në vitet '70 dhe në periudhën 1981-1990 hynë në rendin e dytë të përdorimit si emri më i përdorur në Kosovë me 2708 përdorime, ndërsa sipas ARC-së ka rënie të ndjeshme me 8 përdorime (ARC, 2019, 2020, 2021).

Emrin **Valon** që, statistikisht, vjen pas emrit **Flamur**, e kanë 5148 persona. Për dallim nga emri **Flamur**, trendi i zhvillimit është më ndryshe i emrit **Valon**. Për herë të parë është përdorur më 1954 me vetëm 1 përdorim, pastaj më 1963 po ashtu vetëm 1 përdorim, 1964 3 përdorime, 1967 5 përdorime, më 1969 7 përdorime, gjithsej 17 përdorime, ndërsa emri **Flamur** u përdor 800 herë brenda kësaj periudhe. Ndërsa në vitet '70 657 përdorime. Në periudhën 1981-90 me 3129 përdorime dhe zë vendin e parë në këtë periudhë ndër pesë emrat më të përdorur të gjinisë mashkullore dhe me 1456 në periudhën 1991-1995, ndërsa sipas ARC-së 8 përdorime (ARC, 2019, 2020, 2021).

Emri **Arbër** është regjistruar për herë të parë më 1957 në Kosovë, ndërsa në Shqipëri sipas Mënikut 2013, në vitin 1958 është përdorur për herë të parë. Emri **Arbër** në vitin 1968 ka 30 përdorime, pastaj ka ngritje në përdorim më 1969, kemi 63 përdorime dhe më 1970 kemi 102 përdorime. Pra vazhdoi parapëlqimi i emrit **Arbër** ndër vite dhe në periudhën pesëvjeçare 1991-95 arrin 608 sosh dhe kështu arrin ndërsa, në total përfshin 1623 përdorime, ndërsa sipas ARC-së 46 përdorime (ARC, 2019, 2020, 2021).

Emri **Ilir** zë një vend të madh të përdorimit më 4709 herë. Për herë të parë është përdorur në vitet '50. Më 1950 me 17 përdorime, 1951 me 16, etj., pastaj pëlqimi për këtë emër ndër vite rritet, në vitin 1960 ka 136 përdorime, pastaj në vitet '70, në vitet '80 dhe në periudhën 1990-1995 është emri i dytë më i përdorur më 2579 përdorime, periudhën 5- vjeçare. Ka rënie në sipas ARC-së dhe është përdorur vetëm 21 herë (ARC, 2019, 2020, 2021).

Emri **Pajtesa** është përdorur 190 herë gjithsej, nga 190 përdorime, 157 herë është përdorur në vitin 1990, pikërisht në vitin kur nisën pajtimet e gjaqeve. Për herë të parë është regjistruar në vitin 1989 (02.07.1989) me vetëm


një përdorim. Në vitin 1995 po ashtu është përdorur vetëm një herë, në 1994 dy herë, më 1993 katër herë, më 1992 tre herë, më 1991 22 herë, ndërsa sipas ARC-së vetëm **3** përdorime (2019, 2020, 2021).

Emri **Pajtime** është përdorur 150 herë gjithsej, për herë të parë është regjistruar në vitin 1981 me një përdorim, pastaj më 1989 po ashtu me një përdorim. Po ashtu sikurse emri **Pajtesa** edhe emri **Pajtime** është përdorur po në atë periudhë. Në përdorim më të shpeshtë e gjejmë në vitin 1990 më 122 përdorime nga gjithsej 150, më 1991 14 herë, 1992 tri herë, 1993 vetëm një herë, 1994 asnjë përdorim dhe në vitin 1995 dy herë, ndërsa sipas ARC-së nuk ka asnjë përdorim (ARC, 2019, 2020, 2021).

Emri **Pajtim** është përdorur 1096 gjithsej, për herë të parë në vitin 1958 vetëm një përdorim, pastaj 1970 vetëm një përdorim, 1974 po ashtu një herë dhe 1975 dy përdorime. Pastaj në vitet '80 kemi gjithsej 21 përdorime të emrit **Pajtim**. Emrin **Pajtim** në periudhën 1990-1995 e hasem 1070 përdorime. Në vitin 1990 emrin **Pajtim** është përdorur **914** herë, më 1991 95 herë, 1994 është 34, më 1993 është përdorur 15 herë, pastaj më 1994 vetëm 7 herë dhe më 1995 vetëm 5 herë, ndërsa sipas ARC-së vetëm **1** përdorim (ARC, 2019, 2020, 2021). Fakti që kanë rënie kaq të dukshme tregon se kanë qenë emra të prodhuar të asaj kohe dhe kanë prezantuar ngjarjet e zhvilluara dhe gjetiu.

Emrat **Liridonë** dhe **Liridon** kanë një përdorim tepër të shpeshtë, **afër 9 mijë** persona bartin këta emra në të dy gjinitë. Emri **Liridon** përdoret gjatë periudhës 1981-1990 me 2307 dhe më 1990-1995 me 1768, por në total shifra e përdorimit arrin 4290, ndërsa emri **Liridonë** në periudhën 1991-1995 më 2443. Sipas ARC-së emri **Liridon** ka vetëm 8 përdorime, **Liridona** 6 përdorime (ARC, 2019, 2020, 2021).

Deri në vitet '50 nga 100 emrat e parë 100 për qind janë me origjinë islame, pastaj bien në 98%, në vitet '60 kanë rënie 92%, ndërsa shkalla e ndryshimit ndodh në vitet '70, ka rënie drastike në 22%, emrat shqip arrijnë në 69%, 4% kemi ilirë, 2% ndërkombëtarë dhe 3% toponime.



Në grafikun kemi pasqyruar 100 emrat më të përdorur të ndarë në periudha dhjetëvjeçare duke i krahasuar me emrat e Agjencisë për Regjistrim Civil për vitet 2019, 2020 dhe 2021. Në grafikun e prezantuar shohim lëvizjen e emrave në ngritje e rënie sipas trendit të përdorimit. Në vitet e fundit ka ndryshuar vënia e emrave të fëmijëve, emrat shqip kanë rënie, ndërsa emrat orientale dhe ndërkombëtarë kanë ngritje. Emrat me origjinë islame dominojnë në përdorim, por me ndryshimet fonetike të tjera nga emrat tradicionalë, por edhe sipas ARC-së këta emra i kemi të regjistruar edhe në vitet e fundit, por me një përdorim më të rrallë si: **Fatime** 59, **Emine**, 14, **Ajshe** 23, **Bajram** 51, **Ramadan** 35, **Ali** 70, **Rexhep** 26 etj.

Në këtë periudhë emrat më të përdorur janë: **Ajla** 1024, **Alea** 802, **Dua** 734, **Inara** 652, **Hana** 559, **Bora** 558, **Asja** 558, **Amra**, 381, **Ajan** 968, **Tian** 784, **Amar** 759, **Noar** 748, **Jon** 684, **Omer** 654, **Aron** 618, **Nil** 558, **Anuar** 511, **Rejan** 462, **Reis** 363 etj.

Disa nga këta emra janë përdorur edhe më parë, para vitit 2000 dhe disa nuk i kemi të regjistruar. Emrin **Ajla** më të përdorur të kësaj periudhe të gjinisë femërore e kemi të regjistruar edhe para viteve '30 me pak përdorime, vetëm 3 herë, pastaj në vitet '50, në vitet '60 me përdorim më të theksuar 43 sosh, dhe në vite 70', '80, '90, kurse emrin **Alea**, **Inara**, nuk e kemi të regjistruar më parë. Emrat mashkullorë: **Ajan**, **Tian**, **Nil**, **Anuar** nuk i

kemi të regjistruar në përdorim më parë, ndërsa emrat: **Amar, Noar, Jon, Omer dhe Aron** i kemi të regjistruar në vitet e mëhershme. **Amar** është përdorur për herë të parë më 1978, pastaj në vitet '80 dhe '90, **Noar** më 1989 është regjistruar për herë të parë dhe pastaj vazhdoi në vitet 90. Pastaj emri **Jon** për herë të parë në vitet '70 3 përdorime, pastaj në vitet '80 dhe '90, **Omer** është përdorur shumë herët, para në vitet '30, 1928, **Aron** është regjistruar më 1977, 1978 etj., pastaj në vitet '80, '90.

3. Përfundim

Emrat vetjakë pasqyrojnë kontekstin social të komunitetit a të një shoqërie. Këto kontekste kanë prodhuar modele emrash të njerëzve në Kosovë që janë të lidhura me ngjarjet e ndryshme kulturore dhe politike të manifestuara në vënien e emrave të fëmijëve. Ky hulumtim dëshmon se vënia e emrave manifeston qëndrime të caktuar ideologjike të atyre që i vënë emrat. Siç është pasqyruar në këtë punim, bazuar edhe në të dhënat statistikore, sipas një renditjeje kronologjike kohore një pjesë e emrave në një kontekst të caktuar shoqëror manifestojnë ideologji konservatore tradicionale siç është trashëgimi i emrave, përkatësisht është vënia e emrit të gjyshes apo të gjyshit të fëmijës, pastaj një numër i konsiderueshëm i emrave përgjatë viteve '60, '70, '80, në Kosovë flasin për ideologji kombëtare, kjo pasqyrohet me vënien e emrave ilirë, p.sh: **Agron, Teuta** që flasin për identitetin e lashtësisë, apo emrat **Qëndresë, Çlirim** të viteve '90 për ideologjinë e rezistencës gjatë atyre viteve, ndonjëherë data dhe ngjarje të caktuara kanë prodhuar emrat e fëmijëve, si: **Pajtesë** e **Pajtime**, emra që lidhen me pajtimin e gjaqeve, pastaj emri **Flamur** ka të bëjë ngjarjet e viteve gjashtëdhjetë kur shqiptarëve iu dha e drejta e përdorimit të simboleve kombëtare; pastaj vënia e merave emra me origjinë islame që paraqesin një periudhë të forcimit të identitetit religjioz.

Bibliografia:

- Batalli, Q. dhe Hasani, H. 1990. *Si ta pagëzojmë fëmijën (Fjalor me emra njerësisht)*. Zëri i Rinisë. Prishtinë
- Bidollari, Çlirim, 2011. *Fjalori i patronimeve të shqiptarëve (Emra Familjesh, Mbiemra, Llagape)*. Qendra e Studimeve Albanologjike Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Tiranë.
- Castellvi M. T. Cabre. 2003. *Theories of terminology – Their description and explanation*. London: John Benjamins.
- Bekteshi, B. 2002. *Ndryshimi i emrave vetjakë*. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 20/1, R. Ismajli (ed.), 193–206. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
- Caka, N., and A. Caka. 2010. *Motivimi i emërtimit të fëmijëve në Kosovë 1912–2008*. AKTET – Revistë shkencore e Instituti Alb-Shkenca / Journal of Institute Alb-Shkenca, Vol. III, Nr. 4, 554–556. Alb-shkenca, Tiranë - Prishtinë - Shkup.
- Caka, Nebi-Caka, Ali 2012. *Korpusi i gjuhës shqipe-Rezultatet e para, problemet dhe detyrat*. Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, Prishtinë: ASHAK, Prishtinë.
- Dizdari, T (2005). *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*. AIITC, Tiranë.
- Goçi, I. 2006. *Emrat vetjakë në funksion të identitetit individual dhe kombëtar*. Prishtinë: Botim i autorit.
- Hudson R. 2002. *Sociolinguistika*. Dituria, Tiranë.
- Ismajli, R. 1970. *Si t'i shkruajmë disa emra të huaj*. Probleme të gjuhës letrare shqipe dhe të drejtshkrimit të saj. Tiranë.
- Ismajli, R. 1973. *Strukturalizmi dhe gjuhësia*. Buletini Fakultetit Filozofik. Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
- Ismajli, R. 1974. *F. de Sosyri dhe gjuhësia moderne*. Studia Humanistika. Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
- Ismajli, R. 1998. *Në gjuhë dhe për gjuhë*. Dukagjini, Pejë.
- Ismajli, R. 2002. *Standarde dhe identitete*. Dukagjini, Pejë. Malcolm, N. 1998. *Kosova – një histori e shkurtër*. KOHA, Prishtinë.

- Johnstone, B. 2008. *Discourse Analysis*. Bleckëell, Singapore.
- Lafe. E. 2011. *Rreth fjalëve me burim nga anglishtja në shqipen e sotme*. Albanologji, nr. 1/2010, vëll. II. Prishtinë.
- Mëniku, L. 2013. *Emrat e shqiptarë sot-vlera e tyre si dëshmi e vazhdimësisë*. Komunikimi ndëretnik në Ballkan, Universiteti i Tiranës, Tiranë.
- Munishi, Sh. 2007. *Drejtshtkrimi i emrave të huaj në gjuhën standarde shqipe*. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Prishtinë.
- Munishi, Sh. 2015. *Shqipja në epokën e globalizimit*. ZeroPrint. Prishtinë.
- Paçarizi, Rr. 2006. *Gjuha e mesengjerit*. Filologji /14. Prishtinë.
- Paçarizi, Rr. 2010. *Rruga e zhvillimit të shqipes standarde në raport me nevojat e komunikimit*. Shqipja në etapën e sotme: politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit (Aktet e konferencës shkencore – Durrës 15-17 dhjetor 2010), Qendra e Studimeve Albanologjike. Tiranë.
- Paçarizi, Rr. 2011. *Shqipja standarde në parametrat psikolinguistikë*. PEN Qendra e Kosovës. Prishtinë.
- Rugova, B. 2012. *Pozita dhe statusi i shqipes kundruall gjuhëve të tjera të Ballkanit*. Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, R. Ismajli (ed.), 163–173. ASHAK, Prishtinë.
- Rugova, Bardh, 2013. *Toponyms of Albania as personal names among Kosovo Albanians*.
- Rugova, B., Sejdiu, R. L. 2015. *Hyrje në gramatikën e tekstit në gjuhën shqipe*. Trembelat. Prishtinë.
- Rugova, Bardh. 2016. *Riçke rome itaçi e zakucati – përmbledhje punimesh për tekstin dhe gjuhën në shoqëri*, Trembelat. Prishtinë.
- Rugova, Bardh. 2019. *Leksikon i termave të fonetikës dhe të fonologjisë*. ASHAK, Prishtinë.
- Rugova, Bardh 2020. *Ideologjia e gabimit gjuhësor*. Prishtinë: ASHAK, Prishtinë.
- Saussure, De F. 2002, *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*. Dituria, Tiranë.
- Temmerman. R. 1997, *Questioning the univocity ideal. The difference between socio-cognitive, Terminology and traditional Terminology*.

HERMES-Journal of Language and Communication in Business, 51-90.

- Thomaj. J. 2002. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. SHBLU, Tiranë.
- Thomaj. J. 2006. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Toena, Tiranë.
- Weinrich H. 2005. *Linguistics of Lying and Other Essays*. Seattle: University of Washington Press.

LETËRSI

Lumnije JUSUFI

EQREM BASHA DHE “VARRË” SI ZË I FUQISHËM KUNDËR NDARJEVE DHE KUFIJVE

Hyrje

Romani “Varrë” (2012) i Eqrem Bashës tematizon kufirin mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së sotme (dikur Jugosllavisë), pikërisht në Dibër, në vendlindjen e autorit. Kufijtë rreth Shqipërisë dhe pasojat për zonat kufitare, të cilat shpesh janë shqiptare apo me shumicë shqiptare, nuk janë trajtuar fare në studimet shqiptare. Ka vetëm tre hulumtues joshqiptarë që janë marrë me jugun e Shqipërisë: Georgia Kretsi me një studim për Shqipërinë e Jugut (Kretsi 2007), Sarah Green me një studim për zonën kufitare shqiptaro-greke dhe Gilles de Rapper (2002, 2004, 2007, 2008) me disa artikuj, më shumë për jugun e Shqipërisë. Hulumtimi i Dibrës ka një traditë të gjatë dhe të pasur në studimet shqiptare, por pa trajtimin e kufirit. Tek vitin e kaluar mbarova në Universitetin e Humboldt në Berlin një studim për Dibrën nën ndikimin e kufirit si tezë habilitacioni (Jusufi 20024) dhe rreth këtij projekti të gjatë kanë dalë edhe disa artikuj, pa i përmendur këtu të gjithë.

Në vepra letrare ky boshllëk nuk është kaq absolut. Përveç Eqrem Bashës, kemi edhe një vepër tjetër nga Nuri Koleci (2012), po ashtu për Dibrën dhe nga Dibra, e cila mund të shihet si histori e treguar, thujse e kënduar e rajonit. Narratori shfaqet këtu më shumë si një informator, i cili më së shumti përdor këngë epike për të skicuar historinë e ndarjes në Dibër dhe pasojat e saj. Titulli “Ah, Kufiri...!” shpreh shumë saktë anën emocionale të përballjes me materialin. Për shkak të stilit të alternuar rrëfimtar mes prozës dhe poezisë (popullore), libri kalon kufirin edhe në aspektin letrar. Tingëllon

si një vajtim për rajonin e Dibrës nën pasojat e kufirit dhe të kujton vajtimet e Jeremisë për shkatërrimin e tempullit të Jerusalemit në 586 para Krishtit (Hunter 1996, Koenen 2006). Përtej Dibrës gjejmë vetëm një vepër letrare me kontekst kufitar shqiptar, romanin “Im atë donte Adolfin” nga Mehmet Kraja (2013) për Krajën, pra zonën kufitare shqiptaro-malazeze, ku çështja e kufirit trajtohet në skajet e personazhit kryesor. Edhe Kraja trajton vendlindjen e tij, si Basha dhe Koleci. Simbolikën e ndarjes shqiptare të tri veprat e shohim më shumë të viti i botimit të tyre në 100- vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë në 2012 (Basha dhe Koleci) ose një vit pas në 2013 (Kraja). Përndryshe Basha dhe Kraja nuk i përmendin rajonet, për të cilat shkruajnë, dhe të Koleci Dibra përmendet shumë pak. Me këtë veprat nuk e specifikojnë çështjen shqiptare dhe bëhen universale në lidhje me trajtimin e zoneve kufitare.

Në këtë grup mund të shtohen edhe tri vepra të tjera pa kontekst shqiptar, pa dashur ose mundur të kompletohen të gjithë veprat letrare botërore me kontekst kufitar. Alexa Wild (2014) trajton në romanin e saj “Re të zeza, duar të bardha” nëpërmjet një biografie të një druvari pa shtetësi për zonën kufitare austro-slllovene. Një libër tjetër, romani i shumë njohur “Rruga e skifterit” (2013) i një autori pak të njohur Jamil Ahmad, përshkruan në mënyrë mbresëlënëse se si nomadët në rajonin kufitar midis Pakistanit, Afganistanit dhe Iranit janë të kufizuar në lëvizjet e tyre. Ahmad-i rrëfen një skenë pikëlluese se si një fis ndalohej nga rojet kufitare gjatë lëvizjes së tyre të zakonshme. Kur udhëheqësi i fisit u kërkoi ushtarëve që të paktën të lejohen kopetë e tij (devetë dhe delet) deri te burimi, e cila ndodhet në një vend tjetër pothuaj brenda natës pas tërheqjes së kufirit, atij kjo i refuzohet. Por ky nuk e pranon ndaljen, se përndryshe i ngordhin kafshët për ujë. Si rezultat, të gjitha kafshët dhe një pjesë e madhe e fisit pushkatohen. Romani i Ahmad-it tregon se edhe rajonet e shkretëtirës thyhen me kufijtë shtetërorë. Një autor tjetër shumë i njohur merret me zonat malore nën ndikimin e kufijve shtetërorë. Bëhet fjalë për Reinhold Messner (2001), një malësor italian (Tiroli i Jugut), alpinist i famshëm dhe njëri nga ambasadorët më të zëshëm të rajoneve malore, ofron në një nga librat e tij të shumtë për një auditor më të gjerë një krahasim pothuajse të zymtë të shumë rajoneve malore në botë, të cilat, përveç dobësive strukturore të shkaktuara gjeografikisht, kanë edhe pasoja të rënda nga kufijtë shtetërorë.

“Varrë”

T’i kthehemi veprës, që është në fokus të artikullit, pra romanit “Varrë” nga Eqrem Basha. Romanin e kam trajtuar disa herë në kuadër të projektit tim për Dibërën, nga i cili rezultoi teza e habilitacionit tim: fillimisht në një recension (Jusufi 2014), pastaj në një artikull për auditor më të gjerë për lajmëtarët si aktorë kryesorë në kontekstin kufitar në Dibër (Jusufi 2020) dhe me recipim shumë të lartë të teza e habilitacionit të përmendur (Jusufi 2004). Ka qenë linja ruzhë e procesit të gjatë të shkrimit dhe studimit tim për Dibërën. Përndryshe nuk ka ende studime për këtë roman madhështor.

Në vijim u përqendrohem botimeve të mia. Dy kapitujt e parë “Titulli” dhe “Përmbajtja” kanë për bazë recensionin tim për “Varrë” (Jusufi 2014). Kapitulli “Komunikimi ndër-kufitar” ka për bazë artikullin tim për lajmëtarët (Jusufi 2020). Dhe kapitulli për gjuhën ka për bazë pjesë të tezës së habilitacionit tim (Jusufi 2024).

Titulli

Titulli “Varrë”, me poliseminë e tij të gjerë në gjuhën shqipe, përfaqëson gjithë problematikën e demarkacionit. Fillimisht ka kuptimin “vijë”, pra në kuptimin e kufijve si vija në harta, por edhe më shumë. Në libër, për shembull, kufiri përshkruhet në kohë të qeta si “vijë e padukshme dhe kishte qëllimin e vetëm të mos na lejonte të bashkoheshim” (f. 14). Pastaj fjala do të thotë edhe “plagë”, këtu në kuptimin e cenimit të unitetit kulturor e gjuhësor të një rajoni. Për shkak se autori nuk e specifikon atë në romanin e tij, ky kuptim nuk është në asnjë mënyrë në kontekst nacionalist. ‘Varrë’ në kuptimin e ‘plagës’ gjendet edhe te këngët kreshnike në kuptimin e një plage të pashërueshme të heroit kryesor të një kënge. Kufiri merr pra dimensione epike dhe njerëzore. Kufiri bëhet me këtë personazh kryesor i librit. Nga kjo rrjedh edhe kuptimi i varrës si ‘shenjë’, si pasojë e një lëndimi. Pra pasojat e kufirit shihen edhe pas heqjes së tij, rezultati kryesor i habilitacionit tim, por te Basha shprehet kjo në mënyrë të përsosur letrare vetëm me një fjalë. Për më tepër, fjala në shqip do të thotë edhe ‘hendek’ (f. 12) dhe kupton nga njëra anë hendekun e vërtetë që kishte ndërtuar sidomos Shqipëria komuniste rreth kufijve të saj, nga ana tjetër shpreh karakterin ndarës të një kufiri për rajonin dhe popullin vendas, si çarje të pakapërcyeshme. Por auto-

ri e shpërthen këtë polisemi të gjuhës shqipes dhe e zgjeron me shumë kup-time të tjera për ‚varrën‘: si varr, patkua (forma gjeografike e kufirit në Dibër), fije, gurë kufiri arbitrar, gjarpër, lumë i rrëmbyeshëm, djerrinë, karantinë, tela me gjemba, të cilat ishin të shumta dhe masive rreth kufijve të Shqipërisë, fundi i botës, toka e askujt dhe shumë e shumë të tjera.

Përmbajtja

Në romanin “Varrë” trajtohet pra kufiri shtetëror shqiptaro-jugosllav, tani maqedon në Dibër, i cili u vendos në vitin 1913. Është e tepërt të theksohet, se Dibra është vendlindja e autorit. Që bëhet fjalë për Dibrën, zbulohet vetëm tërthorazi, si vendlindja e autorit, por në libër nuk përmendet emri i qytetit – ai shkruhet vetëm me emrin “Qytet” me shkronjë të madhe, por nuk kemi të dhëna të zakonshme për krahina, kombe, fe, gjuhë, etj. Për asgjë nga këto nuk bëhet fjalë, por vetëm për njerëz nga një rajon kufitar që përballen me njëri-tjetrin në kampe fluide “pro-kufitare” dhe “anti-kufitare”. Bëhet fjalë shumë për “kufirin”. Sado personal që mund të duket libri, problematizimi i fenomenit të demarkacionit duke anonimizuar qëllimisht kufirin, rajonin dhe aktorët e përfshirë është universal. Libri tani është 11-vjeçar dhe jo aq aktual, por ai është tematikisht aktual, pasi trajton një temë shumë të spikatur në shkencë. Border Studies sot mund të gjenden në shumë universitete dhe qendra hulumtuese në Evropën Perëndimore. Tema është edhe politikisht më se aktuale, nëse shikojmë diskutimet në Ballkan për zhvendosje apo korigjime kufijsh.

Romani përbëhet nga gjithsej 20 kapituj, të cilët grupohen në tre pjesë të mëdha. Secila pjesë prezantohet me një seksion të veçantë në formën e një dialogu – p.sh. dialogu i një udhëtari (ose i arratisuri nga kufiri) i quajtur Iksi me një hanxhi, ose me një “zotëri” të rastësishëm ose thjesht si monolog. Të tre pjesët përmbajnë tri tema kryesore: pjesa e parë ka të bëjë me rajonin kufitar dhe aktorët e tij - rojat, atletët ose lajmëtarët, figurat e natës ose ilegalët, zhytësit dhe spiunët (p.sh. te kapitulli “Hunda”). Pjesa e dytë fokusohet në trajtimin emocional dhe psikologjik të kufirit – kokës, trurit, kujtesës, mallit, gjuhës, (këngëve të) vajtimit dhe të dasmës. Pjesa e fundit trajton pasojat e karakterit të zonës kufitare – manovrat, lufta, jetimët, sëmundja, burgu, despotizmi dhe uria. Pasoja kryesore e demarkacionit – arratisja apo shpërngulja – gjendet në fjalinë përmbyllëse të pjesës së fundit të romanit,

pothuaj si amanet, ku subjekti lirik vendos të arratiset ose të emigrojë, duke thënë "të shkoj e të shoh atje ku nuk ka kufi" (f. 150).

Loja me fjalët shihet edhe te emri "Iksi", i cili mund të interpretohet si 'filani', pra edhe një anonimizim tjetër, por kësaj radhe për popullsinë kufitare, të cilën Martínez (1994) e quan *borderlands milieu* apo *borderlander*, pra njerëz me identitet kufitar, jo vetëm me vendbanim në një zonë kufitare. Por "Iksi" mund të interpretohet edhe si 'ikës' nga zona kufitare dhe si simbol i një vendi të boshatisur nga emigracioni i rëndë, si në Dibër, dhe kjo tematizohet shpesh në roman, por është prezente edhe në të gjitha zonat kufitare, të cilat emigracionin e kanë si pasojë kryesore të kufirit. "Iksi" i referohet edhe romanit tjetër të autorit "Lakorja e Iksit", i botuar një vit më parë në 2011, si intertekstualitet i përsosur.

Sa për ilustrim, do të trajtohen këtu dy shembuj nga përmbajtja e romanit, edhe atë komunikimi ndërkufitar dhe gjuha.

Komunikimi ndërkufitar

Te "Varrë" komunikimi ndërkufitar qëndron në fokus, si p.sh. te kapitulli "Atletët", por jo vetëm. Me "Atletët" në roman kuptohen lajmëtarët e kanunit, por të cilët në këtë kontekst tejet të huaj për rajonin në fjalë marrin edhe dimensione të tjera në një sistem të ri komunikimi, siç do të shohim më tutje.

Lajmëtarët ekzistojnë që në fillim të historisë njerëzore. Shumë nga institucionet dhe teknikat komunikuese që ekzistojnë sot, rrjedhin nga ky rol i veçantë, i cili gjendet në çdo kulturë në botë. Për këtë dëshmojnë figura të shumta mitologjike në kulturat e lashta, si qukapiku dhe laraska te popujt gjermanikë, korbi dhe pëllumbi te hebrejtë dhe lajmëtari i perëndive Hermes te grekët. Engjujt e feve monoteiste shihen si lajmëtarë, dhe kështu fjala *engjëll*, e cila vjen nga fjala greke "angelos", nuk i referohet askujt tjetër veçse të dërguarit apo lajmëtarit.

Pra nevoja për të përcjellë lajme te njerëzit e tjerë është e lidhur ngushtë me historinë njerëzore. Nga roli bazë i lajmëtarit mund të rrjedhin edhe funksione të tjera, si ai i korrierit, i cili merrte edhe dorëzimin e objekteve, apo i lajmëtarit shtetëror, që përcillte mesazhe të rëndësishme sekrete me karakter politik. Ndëshkimi i transmetuesit të lajmeve të këqija apo të padëshiruara, i

ashtuquajturi lajm i keq, është i njohur moti. Thënia angleze “Don’t kill/shoot the messenger!” ndoshta këtë e shpreh më së miri, sepse ka ndodhur që bartësi i lajmit të keq të dënohet, qoftë edhe me vdekje. Me kalimin e kohës, veçanërisht si rezultat i shkrimit, funksioni social i lajmëtarit përfundimisht u shndërrua në punën e postierit ose postës si një institucion kaq qendror në kulturat moderne, sa që ishte në duart e shtetit për një kohë të gjatë, ose është pjesërisht kështu edhe sot. Një formë e veçantë shumë e zhvilluar e lajmëtarit politik, agjenti, është ngulitur në një rrjet të gjerë shërbimesh sekrete. Prandaj nuk është rastësi që një libër për Julian Assange titullohet “Don’t kill the messenger!” (Bröckers 2019).

Ndarja e rreptë e detyrave të të dërguarit nuk është një shpikje e shoqërive moderne. Në aspektin kulturor, gjithmonë është bërë dallimi mes atyre që japin mesazhe politike dhe atyre që përcjellin mesazhe private. Edhe midis lajmeve të mira dhe të këqija kishte një dallim aq të fortë sa që bartësve iu dhanë emra të ndryshëm. E drejta zakonore shqiptare, e njohur edhe si Kanuni, ka termin e përgjithshëm “lajmëtar” dhe në veri nuk gjen nëndarje të tjera, përveç rolit të “kasnecit”, bartësit të vendimeve të këshillit të pleqve, i quajtur “pleqësia”. (Gjeçovi 1999: 106-107).

E drejta zakonore shqiptare parashikon gjithashtu në shumë rregullore mbrojtjen e lajmëtarit pavarësisht nga përmbajtja e lajmit të tij. Këto rregullore përfshijnë gjithashtu hyrjen e lirshme në të gjitha rajonet e një fisi – pavarësisht se cilit fisi i përket lajmëtarit. Sipas së drejtës zakonore, mbrojtja e tij ishte një detyrim dhe nëse kjo shkelej, ndonjëherë mund të dënohej edhe me gjakmarrje nga fisi mbrojtës. Në zonat kompakte fisnore, sigurisht që mbrojtja e lajmëtarit garantohej më mirë se në rastet e segmenteve të shpërndara territoriale që quheshin “vllazni”. Këtu roli i lajmëtarit ishte më i rrezikshëm, por edhe më i rëndësishëm nga ana shoqërore, pasi ai mund të siguronte që unitetit i fisit (i zgjeruar apo derdhur) të ruhej edhe nga distanca. Në çdo rast, lajmëtarit duhej të ishte një burrë në gjendje të mirë fizike dhe mendore dhe gjithashtu të kishte një kujtesë veçanërisht të mirë, sepse lajmet transmetoheshin gojarisht. Megjithatë, lajmëtarit nuk mund të ishte i huaj apo fqinj, por duhej të vinte nga fisi përkatës. Roli i tij i bënte një nder të veçantë, pasi kur kishte lajme të mira, si lindja e një djali, merrte dhurata bujare nga marrësit e lajmit. I përzgjedhuri në fund ishte i detyruar të pranonte rolin e lajmëtarit, pavarësisht nga rasti, largësia, moti dhe situata

politike ose ekonomike. Vetëm shëndeti i tij i dobët mund ta lironte atë nga detyra e caktuar.

Në të drejtën zakonore të Dibrës ka një paragraf mjaft të detajuar për lajmëtarët, neni nr. 25, i ndarë në tri kategori: “grishsi” (për lajme të mira dhe ftues për raste të mira), “fjalori” (për lajme të këqija, si në raste vdekje) dhe një rol krejtësisht i ri, ai i *lujtsit të fjalës* (ndërmjetës në mosmarrëveshje) (Martini 2016: 378-383). Kjo rezulton nga përbërja tejet heterogjene fisnore e rajonit të Dibrës si pasojë e dyndjeve të popullatës malore drejt fushës në kohën e Gjylhanes, veçanërisht në Nënudhë. Roli i zgjeruar i lajmëtarit tregon rëndësinë e tij që kishte për mbajtjen e lidhjeve me fisin e origjinës në zonat malore të Nëntë Maleve të Dibrës, por edhe të Lurës dhe Mirditës.

Por në Dibër u shtua edhe faktori ndarës i kufirit. Heqja e kufirit kufizoi rëndë lëvizjet e lajmëtarëve dhe mundësitë për dërgimin e lajmeve u ndërlikuan gjithnjë e më shumë. Tani ishte e rëndësishme të përcillje me sukses një lajm. Zgjedhja e një lajmëtari varej edhe nga fakti nëse ai duhej të jepte lajmin e tij brenda territorit shtetëror apo nëse duhej të kalonte kufirin. Nëse do t’i duhej të përmbushte detyrën e tij brenda kufirit, ai përsëri u nënshtrohej rregullave të lartpërmendura. Nga ana tjetër, kalimi i kufirit shoqërohej me kërkesa të ndryshme dhe në përzgjedhjen e këtyre lajmëtarëve dallohen dy faza. Në fazën e parë, nga viti 1948, kur kufitarët shtetërorë vinin nga jashtë rajonit dhe nuk e njihnin mirë terrenin, përzgjidheshin të rinjtë sportistë që e njihnin terrenin për të kaluar natën përmes boshllëqeve kufirin e mbyllur hermetikisht. Këta lajmëtarë më pas sillnin lloj-lloj të rejash e lajmesh, ngjarje të rëndësishme, por edhe thashetheme. Këtë Eqrem Basha në “Varrë” e përshkruan si vijon:

“[...] nëse shkoje me mision lajmëtari, të ftoje në dasmë a të jepje kumtin e mortit, të vizitoje të afërmit e të lajmëroje krushqi, nuk mund të të pengonte kush [...]. Atletët e kufirit ishin posta jonë, kasnecët dhe lidhjet e mirëfillta. [...] Detyrat ishin të shumta dhe të ndryshme. Do të bëhej një urim a një ngushëllim, do të përcillej a do të merrej një nuse, do të çohej në vend një fjalë e dhënë, do të përmbushej një amanet [...]” (Basha 2012: 27-28)

“Ne kishim një sistem kasnecësh dhe njoftuesish për gjithë çka ndodhte me pjesën tjetër të familjes përtej kufirit. Ata pehlivanë të ushtruar që njihnin metodat e mashtrimit të rojave dhe mbanin gjallë ma-

rrëdhëniet tona me krahun andej, kishin detyrë, përveç të tjerave, të ruanin statistikat e familjeve të ndara, të lajmëronin lindjet, zgjerimin e fisit, fejesat, martesat, por edhe vdekjet.” (Basha 2012: 88).

Interesante në këto pjesë të romanit është, se Basha u jep lajmëtarëve kuptim politik duke i quajtur ata “kasnecë”, dimension ky jo i pranishëm në të drejtën zakonore dibrane. Sepse siç e pamë në pjesën më lart, kasnecët bartnin vendimet e pleqësisë dhe nuk përfaqësonin lajmëtarët në kuptimin më të ngushtë të fjalës.

Po ashtu interesante është vendi, ku autori flet për ftesa në festa familjare që janë befasuese duke pasur parasysh kufijtë e mbyllur. Megjithatë, sipas kuptimit të shoqërisë për lidhje familjare, ftesat duhej të vazhdonin të bëheshin, edhe nëse ishte e qartë për të gjithë, se askush nuk mund t’i pranonte ato. Citimi përmend edhe martesat përtej kufirit, të cilat ndoshta u bënë në fillim të mbylljes së kufirit. Më vonë as kjo nuk ishte më e mundur. Po ashtu shihet dimensionin kulturor rajonal të fjala “pehlivan” për “atlet”, dhe loja që bënin lajmëtarët me rojat kufitare për të kaluar kufirin.

Autoritetet kufitare vinin re se një lajmëtar kishte kaluar kufirin natën vetëm të nesërmen, kur një lajm i ri kishte marrë botën. Por atëherë lajmëtari kishte ikur. Kur autoritetet më në fund e panë këtë hile, rojet e huaja kufitare u zëvendësuan me njerëz nga rajoni që e njihnin mirë terrenin. Ndërmjet viteve 1955 dhe 1960 kufiri u bë praktikisht i pakalueshëm. Kjo kufizoi ndjeshëm komunikimin dhe vetëm disa lajme, kryesisht për vdekje, arrinin anën tjetër të kufirit.

Kërkesat për zgjedhjen e një lajmëtari ndryshuan përsëri dhe të gjitha rregullat e mëparshme të vlefshme nuk ishin më të zbatueshme, pasi fokusi ishte tani në dërgimin e lajmit me çdo kusht. Që atëherë, detyra iu dha një numri burrash të njohur në shoqëri, të urreyer dhe të frikësuar, të cilët ishin përzgjedhur nga regjimet e të dy shteteve dhe që ishin të vetmit që gëzonin ende lirinë e udhëtimit. Duke qenë se kalonin kufirin edhe pse nuk i lejohej askujt, dyshohej se ata duhet të ishin agjentë. Dhe këta njerëz kryesisht sillnin lajme të këqija për tentativa të dështuara për arratisje, kapje apo edhe vdekje në kufi. Çështjen e agjentëve dhe spiunëve Basha e trajton te kapitulli “Hunda”.

Gjuha

Para demarkacionit, areali gjuhësor i Dibrës kishte një ombrellë gjuhësore të gjatë dhe të qëndrueshme, karakterizuar fillimisht nga serbishtja dhe më pas me shekuj nga turqishtja. Në Dibër, megjithatë, të dyja mbetën të kufizuara në funksionin e gjuhës administrative, por u mundësua një transferim i madh nga *top-down* në fushën leksikore, veçanërisht nga turqishtja. Kufiri e hoqi këtë stabilitet dhe i hapi rrugën një vërshimi të vërtetë gjuhësh ombrellë, serbishtja, bullgarishtja, serbokroatishtja, maqedonishtja. Shqipja deri në vitin 2001 me Marrëveshjen e Ohrit nuk luante pothuajse fare rol, përveç në shkolla e familje. Me gjuhën e Bashës kjo tingëllon kështu:

“Sa herë ndërroheshin rojat, ndërrohej dhe gjuha që duhej të mësonim. S’pushonim t’i riktheheshim një procesi të vazhdueshëm të njohjeve të reja, elementare, të një gjuhe tjetër, sikur lindnim sërish, apo sikur viheshim për të satën herë në bankat e klasës së parë.” (Basha 2012: 79)

Basha ruajtjen e gjuhës e sheh në rol të ruajtjes së unitetit dibran pavarësisht nga ndarjet shtetërore, dhe shkruan:

“[...] ne e dinim se gjuha ishte ajo që na mbronte. Gjuha ishte ajo që na bashkonte me ata të përtej telave, që ishin ne, derisa këmbëngulej të bëheshim si këta të midis telave, të vënë aty vetëm për të na ndarë.” (Basha 2012: 80)

Këtu telat dhe rojet kufitare simbolizojnë jo vetëm ndarje familjare si të “atletët”, por edhe ndarje gjuhësore.

Përfundim

“Varrë” është prekës. Lexuesit i prezantohen njerëzit e rajonit kufitar në një larmi aspektesh, por në fund ai nuk e di se cilët janë ata. Ai mund të imagjinojë çdo banor kufitar në botë dhe ta shohë atë si fenomen universal. Hulumtimet e rajoneve kufitare kanë arritur prej kohësh në përfundim se rajonet kufitare në mbarë botën ndajnë të njëjtin fat. Eqrem Basha na e tregon dhe përshkruan këtë në mënyrë të përsosur letrare dhe ngre zërin kundër

ndarjeve dhe kufijve. Për botën joshqipfolëse mbetet vetëm shpresa, që “Varrë” të përkthehet ndonjëherë.

Temën bosht të Seminarit të vitit 2023 dhe të këtij vëllimit “Shqipja në rrezik” e shoh edhe në pasivitetin e Kosovës në promovimin e letërsisë së Kosovës, e cila lihet pas dore edhe në aspekte të tjera, sidomos nën hijen e letërsisë së Shqipërisë. Për këtë flet fakti, se Basha përkthehet shumë pak, romanet e tij aspak, dhe se nuk ka pothuaj fare studime për veprën e tij madhështore.

Literatura e cituar:

Ahmad, Jamil: *Der Weg des Falken*. Hamburg 2013.

Basha, Eqrem: *Lakorja e Iksit*. Prishtinë 2011.

Basha, Eqrem: *Varrë*. Prishtinë 2012.

Bröckers, Mathias: *Freiheit für Julian Assange! Don't kill the messenger!* Neu-Isenburg 2019.

De Rapper, Gilles: *Crossing Borders. Migration in an Albanian Frontier Zone*. Në: Karl Kaser / Robert Pichler / Stephanie Schwandner-Sievers (bot.): *Die weite Welt und das Dorf. Albanische Emigration am Ende des 20. Jahrhunderts*. Wien 2002. 83-106.

De Rapper, Gilles: ‘We are not Greek, but ...’. *Dealing with the Greek-Albanian Border among Albanian-Speaking Christians of Southern Albania*, *Journal of Southeast European and Black Sea Studies* 4/1 (2004). 162-174.

De Rapper, Gilles: *The Greek-Albanian Border and Its Impact on Local Populations*, *Cahiers Parisiens / Parisian Notebooks* 4 (2007). 566-575.

De Rapper, Gilles: *Looking for Europe on the Borders of Albania. Europe at, across and beyond the Borders*. Athen 2008, në:

<https://halshs.archives-ouvertes.fr/halshs-00343436/document>, 21.07.2023.

- Green, Sarah: Notes from the Balkans. Locating Marginality and Ambiguity on the Greek-Albanian Border. Princeton 2005.
- Gjeçovi, Shtjefën: Kanuni i Lekë Dukagjinit. Tiranë 1999.
- Hunter, Jannie: Faces of a Lamenting City. The Development and Coherence of the Book of Lamentations. Frankfurt am Main u. a. 1996.
- Jusufi, Lumnije: Eqrem Basha (2012): Varrë. Prishtinë. Në: Südosteuropa Mitteilungen 05-06, 2016. 174-176. (Recension)
- Jusufi, Lumnije: "Don't kill the messenger!" Eine Geschichte über Boten in Dibra. Në: DerStandard, Balkan-Blog. 26.06.2020, në:
<https://www.derstandard.de/story/2000118180241/dont-kill-the-messenger-eine-geschichte-ueber-boten-in-dibra>, edhe në shqip në Shtegu, <https://shtegu.com/archives/28933>.
- Jusufi, Lumnije: Die inneralbanische Mauer. Grenzen und Grenzüberwindungen im Raum Dibra/Debar. Botohet në 2024 te De Gruyter Oldenbourg.
- Koleci, Nuri, Ah, Kufiri ...! Dibër 2012.
- Koenen, Klaus: Klagelieder Jeremias, in: Michaela Bauks / Klaus Koenen / Stefan Alkier (bot.), Das wissenschaftliche Bibellexikon im Internet (WiBiLex). Stuttgart 2006, në:
<http://www.bibelwissenschaft.de/wibilex/das-bibellexikon/lexikon/sachwort/anzeigen/details/klagelieder-jeremias/ch/7adfe2b37c8e35fddc4379d596a83ec4/>.
- Kraja, Mehmet: Im atë donte Adolfin. Tiranë 2013.
- Kretsi, Georgia: Verfolgung und Gedächtnis in Albanien. Eine Analyse postsozialistischer Erinnerungsstrategien. Wiesbaden 2007.
- Martínez, Oscar Jáquez: Border People: Life and Society in the U.S.-Mexico Borderlands. Tucson 1994.
- Martini, Xhafer: Kanuni i Dibrës. Trashëgimi etnojuridike. Tiranë 2016.
- Messner, Reinhold: Bergvölker. Bilder und Begegnungen. München 2001.
- Wild, Alexa: Schwarze Nebel, weiße Hände. Die Lebensgeschichte des staatenlosen Holzfällers Luca Sekolovnik zwischen Österreich und Slowenien (1925 bis heute). Graz 2014.

Blerina SUTA

**MES INTRAKULTURALIZMIT
DHE INTERKULTURALIZMIT,
PËR NJË POETIKË KRAHASIMTARE
NË STUDIMET SHQIPE**

Vocërrakët në shkolla mësojnë historinë e popullit të vet. Në të ka shumë ngjarje, emra të shquar, zotërinj trima dhe zonja të bukura, shpesh të pabesa. Ata mësojnë e mësojnë shumë gjëra, gjersa një ditë kujtojnë se tharmi i kësaj historie, kripa e saj është “tjetri”.

Kadare, Historia e “Tjetrit”,
Ex Libris, 12 08.2023

Eseja e Kadaresë për historinë e “tjetrit”, e lashtë sa njeriu, fton për reflektim në lidhje me rrezikun që bart studimi i një objekti që ka ekzistuar gjithnjë edhe në letërsi: raporti me tjetrin.

“Krahasimi” në bazë të çdo arsyesimi kritik, përqsasja në vetvete, nuk është arsye e mjaftueshme për ekzistencën e një metode studimore krahasimtare - problematizon qysh në fund të viteve '50 Rene Étiemble në punimin *Comparaison n'est pas raison*.

Parashtrësë për çështje të metodës

Metoda krahasimtare nuk i ka munguar traditës së studimeve letrare të deritanishme në gjuhën shqipe.

Në fushën tradicionale të studimeve binare, duke privilegjuar ‘burimet’ apo ‘influencat’, përmendim studimet e imëta filologjike të Giuseppe Gradilone-s (Xhuzepe Gradilone), si ai për Virgjinin dhe Naim Frashërin.

Modele të shkëlqyera që mund të rimerren me sukses në studimet historiko-letrare dhe jo vetëm, janë studimet e Çabejt për romantizmin në Europën Lindore dhe Juglindore, studimet për De Radën, Nolin, Lasgushin apo Fishtë; studimet e Pipës për De Radën etj.

Ndonëse botimet kritiko-letrare të këtyre dhjetë viteve të fundit dëshmojnë për kontakt të studiuesve me teorinë krahasimtare bashkëkohore, ajo që ka munguar në rrafshin metodologjik është receptimi sistematik i kësaj fushe studimi.

Këndvështrimi mbinacional, evidentimi i elementeve origjinale të përkimit (prej receptimit në një mënyrë apo në një tjetër) me pasurinë letrare botërore, është një nga mënyrat më efikase për përqasjen e vlerave të letërsisë (dhe asaj shqipe, sigurisht) me atë ideal vlerash që Goethe (Gëte) e quajti *Weltliteratur*, ‘Letërsia e përbotshme’.

Duhet thënë se ‘Letërsia e krahasuar’ është një metodë qëndrimi dhe këndvështrimi ndaj objektit letrar, një ‘poetikë’, më shumë sesa një enë mbajtëse mjetesh konkrete për operim me tekstin letrar.

Vepra klasike e metodës së Yve Chevrel-it (Iv Shëvrel), ‘Letërsia e krahasuar’, kur shtron pyetjen: “drejt një poetike krahasimtare?”, e specifikon qartë këtë përmasë të qëndrimit të komparativistit si ‘poetikë’.

Vepra e Chevrel-it (përkthyer në shqip prej historianit të letërsisë Ali Xhiku), qëndron midis stinës franceze apo të ashtuquajtur ‘intrakulturore’ të studimit krahasimtar të letërsisë, e cila merrte në konsideratë raportet e dy a më shumë letërsive europaerëndimore dhe stinës aktuale interkulturore, që merr në konsideratë edhe sistemet kulturore-letrare joeuropaerëndimore, të ashtuquajturat ‘letërsi minore’, specifikisht sistemet letrare të ndërtuara nga gjuhët koloniale.

I transferuar në realitete europiane, të cilat në të kundërt, karakterizohen nga identitete gjuhësore dhe kulturore në formën e rrënjës unike, koncepti i

postkoloniales, lakohet si ushtrim vetëdekolonizimi i studiuesve evropianë nga kriteret e kanonit të tyre letrar (që parashikonin ndarjen qendër – periferi, ndikues – i ndikuar, i madh – i vogël), duke iu përgjigjur kështu nevojës për një qasje joeurocentriste ndaj realiteteve minore, të ashtuquajtura periferike, apo të prodhuara nga mërgimi.

Problemi kryesor që të ashtuquajturat ‘Cultural studies’ amerikane kanë përcjellë në Evropë (edhe në kurrikulat shkollore) është transformimi i teksteve letrare në thjesht dokumente, duke i humbur specificitetin e gjuhës polisense, “shumës” dhe ngjeshjen semantike.

Eric Auerbach, autor i *Mimesis*-it, e vetmja filozofi e historisë letrare që i ka mbijetuar epokave, kur arsyetoi mbi filologjinë e Weltliteratur-it (1952) (idealit goethean të letërsisë së përbotshme), i pati parashikuar vështirësitë në të cilat do të haste ky objekt ideal (“Botë”) i letërsisë së krahasuar, kur do të zhvendosej nga kultura europaerëndimore në hapësirën botërore.

Interpretimi i idesë romantike të Weltliteratur-it në bashkëkohësi, ka të bëjë, sipas Auerbach-ut, me “gjetjen e kuptimit të fenomeneve letrare në epokën e tyre dhe në rrafsh të tre mijë vjet letërsi që njohim.” (f. 296).

Fakti se sot termi *Weltliteratur*, nga domethënia që i dha Goethe në 1825, qarkullon i përkthyer anglisht si *world literature* (letërsi botërore), që nuk ka të njëjtin kuptim, tregon se pretendimi për universalitet i qasjes ndërkulturore rrezikon sot të shndërrohet në njëfarë “turizmi kulturor”.

Figura e komparativistit si studiues i letërsisë, me intuitën e tij për të gjetur dhe transmetuar “sintezën historike”, përputhet veçanërisht me nevojën e edukimit të të rinjve me kujtesën, në një realitet si ai i sotmi, karakterizuar nga mungesa e kufijve të botës së konsumit.

Rrafshi i domethënies është i vetmi që sendërtohet nga kërkimi filologjik në tekst dhe për tekstin, duke i kthyer lexuesit “idenë historiciste të objektivitetit prospektik (në perspektivë)”, siç e quan Auerbach-u, cilësinë e zhvilluar nga filologët gjatë shekullit XIX, cilësi e rëndësishme shkencës moderne të letërsisë dhe artit.

Karakterit *dinamiko-metodologjik* i metodës komparativiste, përftuar në sproven historiko-letrare si arsyesim i takimit me *tjetrin*, si përjasje mes koncepteve: *letërsi e krahasuar*, *letërsi e përgjithshme*, *e huaj*, *kombëtare*, *përkthim* (si mjet i pafund takimesh me një vepër, thënë ndryshe, me një

kulturë), imponon një filtrim përkatës për realitete si ai shqiptar, sa european aq dhe ballkanik.

Realiteti letrar shqiptar, periferik përkundrejt ‘kanunit’ europerëndimor, mund të realizojë procesin e vetëdekolonizimit nga kompleksi i “të voglit”, “periferikut”, dhe për pasojë nga dinamika e “imitimit” dhe “ndikimit”, vetëm nëse komparativizmi si qëndrim do të përputhet me kushtet e ekzistencës së letërsisë shqipe në komunitetet ndërletrare ballkanike.

Vepra e Chevrel-it, propozon “receptimin” në vend të “influcës”, teori ku do të bazohet propozimi i sllovakut Āurisin (Djurizhin) mbi “komunitet ndërletrare”, dhe “komunitet ndërletrare specifike”, të vlefshme për realitetet letrare të ashtuquajtura ‘minore’ dhe ‘joqendrore’ si ai shqiptar.

Me një koncept të ngjashëm si ai i “qarqeve letrare”, ardhur disa dhjetëvjeçarë më parë nga E Çabej, Āurisin shprehet se komunitetet letrare të kombeve mesdhetare, “nuk mund të analizohen pa analizuar në thellësi të gjithë tërësinë e çështjeve të ndryshme që ndriçojnë kategoritë e njësive historiko-letrare që i përkasin epokës para krijimit të letërsisë kombëtare”.

Për periudhën e romantizmit, letërsia shqipe ofron, me profilet e saj letrare, në kuadër të ‘rrjetit ndërletrar’ të Mesdheut, gjeometri të ndryshme të kontakteve me kulturat e tjera, të kushtëzuara nga bashkëjetesa në të njëjtat komunitete administrative ‘specifike’ siç është rasti i perandorive të mëdha në fazën para krijimit të shteteve kombëtare.

I aplikueshëm sidomos për traditën letrare para krijimit të shtetit kombëtar, koncepti i “qarqeve” të Çabejt, bart ndërgjegjësimin për karakterin unik e përbashkues të truallit në krijimin e kulturës/gjegjësisht letërsisë së qarkut, por njëkohësisht edhe karakterin shumë të prodhuar nga kontakti me kulturat ndërkufitare: mjafton të kujtohen këtu referimet për kahet centripete dhe centrifugale të qarkut kulturor të Veriut.

Qasja mbinacionale, si forma më e natyrshme e studimit të letërsisë, gjendet para dy realitetesh me “sfond historik të ndryshëm”:

1. Së pari, kur bëhet fjalë për letërsi të prodhuar gjatë romantizmit dhe fillimit të modernizmit, kur kultivohej një profilit unik i idesë për botën, mund të flitet për një “poetikë komparativiste” siç e quan Chevrel-i, qasjen krahasimtare ku konvergjon interpretimi, strukturimi i produktit letrar sipas karakterit të tij kompleks, me qëndrimin etiko-

politik të studiuësit, nevojës intelektuale për t'u pozicionuar nëpërmjet interpretimit.

2. Së dyti, përballë objektit letrar të krijuar në bashkëkohësi, karakterizuar nga një vizion "ahistorik" i botës siç do të shprehet Auerbach-u në "Filologjia e Weltliteratur", qasja komparativiste legjitimon qenien e saj vazhdimisht në krizë dhe studiuesi e ka më të vështirë të transmetojë nëpërmjet interpretimit, qëndrimin e tij për botën.

1. 'Romantizmi' shqiptar dhe historitë e letërsisë në këndvështrim krahasimtar

Për këtë periudhë kur kultivohej një profil unik i idesë mbi botën, studimet shqipe njohin dy shembuj trajtesash historiko-letrare të cilat bazohen në shkolla të ndryshme të komparativizmit: katër vëllimet e veprës *Historia e letërsisë romantike* të Rexhep Qoses 1982, (Prishtinë, Rilindja 1990) dhe *Sprovë për një tjetër histori të letërsisë shqipe (1555-1944)* të Ali Xhikut, (Tiranë, Albas, 2014), të cilat përcjellin në mënyrë të qartë idenë se, letërsia shqipe, relativisht e re, trashëgon nga pikëpamja historike vetëm një periudhë-rrymë homogjene, atë të romantizmit.

Vepra e Qoses, bazuar në qasjen komparativiste të Pichois e Rousseau (shkolla franceze e fundviteve '60 dhe fillimit të viteve '70), e vështron "stilin" e epokës duke u bazuar në "studimin e gërshetuar të dy rrafshëve: rrafshit diakronik dhe atij sinkronik" (f. 7): vlera e qasjes krahasimtare në bazë të metodës së Qoses është përpjekja për të ngelur brenda rrafshit të "poetikës strukturale historike" siç e quan ai (f. 9)- duke e ndërftuar romantizmin në suazën e lëvizjes ideologjike të Rilindjes.

Ideja e Qoses se "letërsia e romantizmit shqiptar ka përmbajtjen e Atdheut, por është krijuar dhe publikuar nëpër vende të huaja, para së gjithash nëpër kolonitë shqiptare" (f. 13), sjell sot një të vërtetë që jo shpesh mbahet në konsideratë, se letërsia shqipe e Rilindjes u krijua jashtë kufijve gjeografikë të Shqipërisë dhe se format e para artistike të letërsisë shqipe ishin rezultat i takimit me tjetrin, ishin bartëse të një vizioni ideal të Atdheut, krijuar nëpërmjet letërsisë, jashtë atdheut fizik.

Në hulli të 'strukturës' Qosja analizon rrafshin e substancës së shprehjes në përmasën e rrënjës së saj popullore dhe të kushtëzuar nga përpjekja ideo-

logjike për pastërti të shqipes, si dhe përshkon lëndën tematike duke i analizuar si shprehje të ‘miteve’ romantike.

Është kryesisht lënda tematike që merret në konsideratë në ndërtimin e kapitujve për *Tipologjinë e lirikës*, *Tipologjinë e liriko-epikës dhe epikës*, *Tipologjinë e prozës letrare-shkencore dhe e dramës*, por dhe ajo shprehëse në kapitujt për *Strukturën rrokjesore dhe ritmike të vargut*.

Më pranë vizionit tonë dhe fazës interkulturore të studimeve komparativiste është qasja e Ali Xhikut, i cili, në konceptin e tij për historishkrimin e letërsisë është bazuar në teoritë e Chevrel-it. Ai e konsideron, pikërisht si Chevrel-i, historinë e letërsisë, objektin kryesor të komparativistit, kur pohon, se “me vështrimet e tyre të shtrira në kohë dhe në hapësirë, studimet krahasuese kanë treguar se si takimet me tjetrin dhe ndikimet e lindura që këtej, i hapin rrugë rrymave të mëdha për të shkuar tej një letërsie e për të krijuar vizione artistike mbikombëtare”, (f. 9).

Në këndvështrimin e Xhikut, letërsia, në komunikim, krijon vizionin mbi botën (*Weltanschauung*), “me të cilin e gjithë jeta shpirtërore e një periudhe historike ngjizte unitete (njëjtësi) të dallueshme në pafundësinë e pashmangshme të diversiteteve (ndryshimeve) që e karakterizojnë” (f. 7).

Komunikimin me *tjetrin*, studiuesi e sheh si nevojë të lindur të letërsisë vetë, duke hulumtuar nën optikën e një poetike komparativiste nga shekujt XVI–XVII, periudhë kur *letërsia shqipe vjen si jehonë e humanizmit kristian; prurjeve lindore dhe poezisë së mjediseve myslimane; Lëvizjes kulturore-letrare ortodokse; që bartet gjatë Romantizmit me poezinë dhe poezinë epiko-lirike, lirikën, epikën, dramën; duke vijuar gjysmën e parë të shekullin XX me Fillimet e shpërbërjes së romantizmit dhe ardhjen e një letërsie tjetër; me kultivimin e lirikës (politiko-shoqërore; shoqërore; të mendimit; të dashurisë; të natyrës; erotike), si dhe në trajtimin e çështjeve të raporteve të poetit dhe poezisë, sa dhe hetimin e gjinive përndjekur në hulli të rrymës apo lëvizjes, si: epika, poema dramatike, satirika, proza (novela, tregimi, proza e shkurtër, romani); drama – të gjitha këta kapituj e çështje kyçe në përbërje të studimit.*

Xhiku është i bindur se vizioni mbinacional mund ta ruajë të paprekur prurjen e letërsisë shqipe në “detin e rrymave gjithëpërfshirëse europiane”. Teksa arsyeton për letërsinë kombëtare, ai ka parasysh parametrat dhe konkluzionet që Shoqata Ndërkombëtare e Letërsisë së Krahasuar ka parashtru-

ar në programin e *Historisë së krahasuar të letërsisë të gjuhëve evropiane*, modeli metodologjik që duhej të drejtonte ekipet e studiuesve në punën për krijimin e historisë së letërsisë shqipe.

Prurja më e rëndësishme e këtij manuali është konceptimi i historisë së letërsisë si një histori e gjinive, prerje që mëton, siç thotë autori ta shkëpusë letërsinë shqipe nga “izolacionizmi i pakuptimtë”.

A është e mundur një histori e letërsisë shqipe përmes gjinive? Vepra e A. Xhikut, në përputhje me problematikat që i dalin studiuesve që përdorin metodën krahasimtare, synon të gjejë në zhvillimin e secilës prej gjinive tiparet që dëshmojnë se vepra asnjëherë nuk përputhet me tiparet e gjinisë, se te thyerja qëndron legjitimiteti i veprës se një sërë veprash të letërsisë shqipe shfaqin ‘problematika’ në inkuadrimin e tyre brenda një gjinie të vetme dhe se letërsia shqipe e traditës është bartëse e gjinive, që sendërtojnë kuptime të ndryshme në epoka të ndryshme.

Një ndërmarrje e tillë historiko-letrare, nëpërmjet gjinive, e vendos autorin në një sprovë me disa dimensione që kanë të bëjnë me natyrën asnjëherë statike të gjinisë: vepra në këndvështrim të zhvillimit të gjinisë; gjinia dhe çështja e kanonit; vepra në këndvështrim të zhvillimit të personalitetit krijues të autorit; vepra në këndvështrim të studimit të temave dhe funksioni i tyre në historinë e gjinisë (në realitetin tonë kishte kuptim të flitej për lirikë atdhetare etj.).

2. ‘Llogaritë’ ende të hapura me metodën e “realizmit socialist”: sprova krahasimtare e Ali Xhikut

Me gjithë vështirësitë në pikëpamje të perspektivës historike, e nevojshme për metodën krahasimtare, historiani i letërsisë Ali Xhiku ka botuar së fundmi veprën *Një pasqyrë e Shqipërisë letrare 1945–1961*, vepër që mbart vështirësitë e dinamikave të artit të realizmit socialist, në funksion tautologjik të riprodhimit të ideologjisë për artin, siç shprehet vetë studiuesi, “duke u nisur prej vetes e duke mbetur po aty” (f.3).

I konceptuar në tri blloqe të rëndësishme, ky vëllim, botuar nga Akademia e Shkencave (Tiranë 2022), i qaset instalimit të realizmit socialist në tri këndvështrime: së pari si një rindërtim kronologjik dhe i problematizuar i

sektorëve skajshmërisht të polarizuar të raportit letërsi-ideologji; së dyti, si një trajtim i çështjeve më të përgjithshme teorike me të cilat u mor mendimi letrar shqiptar; dhe së fundmi, si historishkrim në formën e një boce historiko-letrare të zhvillimit të gjinive në këtë periudhë.

Perspektiva komparativiste e historishkrimit, tipar kryesor i kësaj vepre, është dhe veçantia që transmeton ajo në raport me vepra të tjera të vlefshme për instalimin e realizmit socialist, të botuara në këto vitet e fundit.

Duke ndjekur hullinë e metodologjisë kritiko-materialiste të konsoliduar edhe në sprovat e mëparshme, autori përvijon transformimin që “realizmi socialist” -jo rrymë, por “metodë”- kategori e turbullt lidhur me “parapëlqime intuitive”, i bëri prodhimin letrar në Shqipërinë e pasluftës, si në pikëpamje të ‘vizionit’ mbi botën, të “rrafshët dhe të thjeshtëzuar”, ashtu dhe në pikëpamje të zhvillimit gjinor, krahasuar me trashëgiminë e viteve 1930.

I bindur se analiza e “ndryshimit të mënyrave të jetësimit të një gjinie të dhënë” është rruga e duhur e historianit për të mënjanuar “trysnitë e politikës dhe të shijeve të kohës së tij”, autori rindërton, me mjetet e kritikës historiko-letrare, faktin e imponimit të një metode “letrare” që do t’i shërbente “pushtetit politik”, (f. 111).

Nuk mungojnë në këtë histori letërsie deklaratat metakritike për metodën e historishkrimit, që duhet të synojë domethënien e tekstit, si përgjigje ndaj prirjes bashkëkohore të lulëzimit të pamjeve strukturaliste, të papranueshëm kur vëzhgimet mbi stilin e poetit “kujtojnë se mund të abstraktojnë dhe kthejnë në skema teknikat e krijimit të së bukurës, duke kaluar shpejt dhe pa vëmendjen e duhur mbi fluksin e mendimeve dhe të ndjesive të tij [...*]” (f. 171).

Ky pohim shkon në të njëjtin rrafsh me parimin se historia e letërsisë mund të shkruhet duke u nisur vetëm nga një parim bazik pune që shkon nga “lënda” te “përfundimi”, përdorur në metodën krahasimtare të veprës *Sprovë për një tjetër histori të letërsisë shqipe (1555-1944)*.

I ndërgjegjshëm që një studim i tillë mund të marrë domethënie vetëm në formën e një “grykimi kritik”, autori zbulon haptazi, qysh në parathënie, sfidën dhe natyrën delikate të studimit të një epoke, që përcjell konflikt të fortë dhe ndjeshmëri në një vend si Shqipëria ku motivet politike “për të jetësuar një doktrinë, refuzonin prerazi çdo pikëpamje dhe çdo krijimtari tjetër” dhe imponoheshin si i vetmi qëndrim “vërtet shkencor”.

Rrafshi dokumentar dhe sistematizues i këtij vëllimi, sendërton hap pas hapi itinerarin e instalimit të realizmit socialist në Shqipëri.

Njohja e lexuesit të sotëm me përmasën që mori ashpërsia e censurës në raport me ndikimin që mund të kishin pasur “izmat” e letërsisë perëndimore tek autorët, qasje në thelb e ndryshme me atë të etërve të marksizmit- është një operacion i vazhdueshëm në këtë “pasqyrë” dhe njëherësh i nevojshëm.

Imitimi i prurjeve teorike të shkollës ruse, përndiqet nga Xhiku në radhë të parë në rrafsh të ‘gjuhës’ kritike, që shoqëroi vendosjen e metodës së realizmit socialist, semantika e të cilës zhvendoset nga kategoritë burimore marksiste (të Marksit edhe Engelsit) drejt skajeve ideologjike të modelit sovjetik, i cili i “mekanizon hapur” ato.

Evidentimi në mënyrë të saktë i 1947, viti kur u përdor termi “realizëm socialist”, i përkthyer prej termit rus si tregues i “një letërsie tjetër” (f. 37), shoqërohet me përshkrimin e tjetërsimit në përdorim të termit “romantizëm” apo “letërsi klasike universale”, në funksion të një “letërsie të standardizuar” e cila për Xhikun, “dëshmon qartë me vepra patetiko-entuziaste [...] dëmin që i bëhet cilësisë artistike të veprave”. (f. 44).

Materiali i pasur që shoqëron këtë historik, përfshin forumet dhe kongreset partiake, të cilat shoqëroheshin nga forume paralele dhe ndihmëse të organeve të krijuara për shkrimtarët.

Përdorimi i sloganeve të njohura të barazisë dhe lirisë, për të justifikuar instalimin e diktaturës së proletarietit, u ndryshuan kahun parimeve të realizmit dhe të vërtetës në art, duke mos qenë më në shërbim të natyrës së veçantë të artit.

Idetë e Hegelit për të bukurën në art, receptimi i tyre prej Engelesit, nuk penguan krerët e qeverisë të nisur prej pragmatizmit të “cenonin prirjen e natyrshme të letërsisë për t’u shfaqur dhe për të ekzistuar si realitet i së bukurës”. (f. 115).

Vendimet e *Konferencës III të Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë*, (1950) ku theksohet se “në qoftë se me gjithë përpjekjen t’onë, s’do mund të kuptojnë dhe, nënë këtë maskë, do përpiqen të pengojnë udhën t’onë, të jenë të sigurt se puna ose lufta jonë do t’i eliminojë”, (f. 28), shpërfaqin para lexuesit të sotëm përmasën e vërtetë të egërsisë që do të marrë pushteti, “shprehje e luftës së klasave”.

Lidhja e Shkrimtarëve, nga një organizatë gjithëpërfshirëse e autorëve më të mirë do shndërrohet në një organizatë vegël e pushtetit të Partisë, me përjashtimin nga radhët e saj si “demokratë progresistë”, të figurave si: V. Prenushi, E Haxhiademi, Dh Pasko.

Përshkrimi i klimës dyshuese, apo “kundërshtuese” ndaj pikëpamjeve partiake për letërsinë, duke iu referuar fatit të K. Trebeshinës, M. Ndojës dhe M. Myftiut, sqarojnë përfundimisht se ky i ashtuquajtur “grup i vogël”, i vënë në shënjestër të censurës dhe të organeve kontrolluese të partisë, nuk botoi asgjë nga pikëpamjet e tij (që me gjasa mund të gjendet në formë epistolarësh), duke mos mbërritur, në fakt, të jenë disidentë në kuptimin e vërtetë të kësaj fjale.

Rrafshi teoriko-estetik i kategorive të prekura nga metoda e realizmit socialist përfshijnë të vërtetën dhe të bukurën në art, kanonin e së shkuarës, përdorimin në funksion të ideologjisë të gjinive letrare, poezisë, prozës, romanit dhe dramës, deri te përdorimi i metrit të vargut të lirë si poetikë.

“Vullneti jashtëletrar” dhe “thjeshtëzimi i së bukurës”, janë dy çështje që plotësojnë njëra-tjetrën nga pikëpamja e evoluimit historik dhe teorik të mendimit letrar shqiptar ndër vitet 1945-1961, kur u ndalua dhe në mënyrë të pandërgjegjshme çdo prodhim tjetër letrar që nuk ndiqte normat e realizmit socialist.

Së pari, raporti me traditën në Shqipëri u thjeshtëzua dhe krejt ndryshe nga koncepti leninist i dy kulturave (në vlerësimin që Lenini i bëri veprës së Tolstoit, përfaqësues i shtresës fisnike), marrëdhëniet midis trashëgimisë dhe letërsisë së paskëtajme u bënë krejt politike.

Ndonëse e sipërfaqshme, rindërtohet panorama letrare para viteve '44, me aftësinë e saj receptuese të modeleve dhe llojeve letrare (ndonëse shpesh me “ndjesi gjysmë të pavetëdijshme e të pavërejtura më parë”), të poezisë subjektive, të prozës që shfaqte në pak kohë tipare të lexueshme kompozicionale dhe modele gjinore nga më të ndryshmet.

Tradita letrare me autorë, si Fishta e Konica, të vlerësuar deri në vitin 1945, filluan të përmbysen në '46, siç shënon një kronikë e “Botës së Re”, 1946, që i quan ata “tradhtarë”.

Poezia lirike shfaqet si më dinamikja në këtë panoramë. Kur studiuesi Xhiku, veç përfundimit, jo të lodhshëm sipas tij, “për të provuar se poezia shqipe e asaj kohe ishte gati-gati një kantatë patetike të rinjsh të ekzaltuar”,

hyn në specifika nënlojore të realizimit të saj, siç bëhet fjalë për parapëlqimin e metodës për poezinë rrëfyese (poemat epiko-lirike e baladat), ai, jo vetëm specifikon zhvillimin gjinor në funksion të receptimit evokativ të ndjesive të luftës, por përgatit edhe thyerjen e këtij modeli që do të prodhohet në kushtet e burgut dhe internimit.

Braktisja e nivelit të poezisë lirike të traditës (Naimi, Lasgushi, Migjeni) e largoi në mënyrë të pariparueshme poezinë shqipe prej ‘unit’ subjektiv, duke krijuar një lirike “të pazakontë” të kolektivitetit, të ekzaltimit të përdorimit të shumësit, me fjalor të ngushtuar e figura, si: apostrofi, simboli, hiperbola - shënjes të ideologjisë dhe moralit që po luftonte për një betejë tashmë të nisur.

Rasti i vargut të lirë, është rasti më ekstrem i atyre që Xhiku quan “paradigma të ideokracisë”: pamja politike e përqasjes midis vargjeve, pavarësisht nga shembulli i Majakovskit apo Migjenit, tregon qartë sa larg kishte shkuar paranoja e partisë në pushtet, në emër të frikës nga “kozropolitizmi që po kërcënonte thelbin kombëtar të poezisë shqipe.” (f. 93)

Interesante për brezat e rinj të lexuesve dhe studiuesve bëhet përfytyrimi i një realiteti ku lirika e dashurisë i kishte lënë vendin një poezie të “ngjitur” aq shumë pas politikës së ditës, sa u kujtua vetëm pas 8-9 vjetësh se që “mashkullorizuar” ca si tepër (f. 138): u desh të vijnë vitet ‘60 që poezisë shqipe t’i kthehet motivi i dashurisë me Kadarenë e të tjerë, vite që njohën gjithashtu edhe lirikën e unit meditativ.

Përshkrimi gjithashtu i dinamikës së debatit letrar të iniciuar nga politika për të disiplinuar konfliktin mes të vjetërve dhe të rinjve, na sjell pamje mjaft interesante të rrugës se si letërsia shqipe, pavarësisht nga diktatura, gjeti “drejtimin e pakthyeshëm të shtratit të saj të natyrshëm”, duke shfrytëzuar traditën migjeniane dhe modelin e Majakovskit (Kadare, Arapi, Agolli, Dh. Qiriaz), si dhe duke kultivuar figura të mendimit, si metafora, format moderne të poemës së thellë në mendim.

Rasti i poezisë shqipe është i rëndësishëm për të dëshmuar sesi fosilizimi dhe në funksion të vetë ideologjisë së partisë solli lindjen fill pas kësaj, të një letërsie që nuk i qëndronte raportit vasal letërsi-ideologji, tregues i vitalitetit të procesit letrar dhe gjallimit të saj jashtë grilave të natyrës jashtë-letrare.

Proza e shkurtër ashtu si ajo e gjatë u sakrifikuan, pavarësisht ndonjë fenomeni të veçantë, siç ishte proza moderne e Petro Markos.

Objekt i rëndësishëm i arsyetimit të Xhikut për gjininë rrëfimtare është kategoria krijuese e heroit ideal, “tipikes” në letërsi, kategori mjaft e debatuar dhe në kritikën letrare post-komuniste në Europë, si faktor që ngjyros tiparin letrar të veprës.

Kalimi nga letërsia e ‘angazhuar’ në letërsi ‘politike’ do të përfshijë, në radhë të parë, *personazhin*, të krijuar sipas një modeli moral e antropologjik të heroit të ri, model që synonte njësim të realitetit jashtë veprës me realitetin brenda saj, me pasojë dhunimin e natyrës së “veçanësishtme” të veprës.

Duke ndërhyrë në specifikën e letërsisë, *vërtetësia* (besueshmëria) e personazhit, siç dihet në përputhje me gjasën dhe nevojën brenda veprës, do të kërkohet jashtë saj, dhe specifikisht ‘tipi’ do të gjendet te sasia e shfaqjes së një tipi, duke dëmtuar rëndë fantazinë e shkrimtarit.

Pamundësia e dramës për të ngritur kokë për shkak të ndërhyrjeve arbitrare, mbyllin panoramën e pasqyrës letrare shqiptare në vitet ‘45-‘61, me përfundimin e rëndësishëm se në ato vite në Shqipëri ka munguar debati letrar publik, duke ftuar studiuesit të hulumtojnë arkivave të censurës (së shtëpive botuese dhe organeve partiake të kontrollit) për të kuptuar realisht panoramën e prodhimit letrar në atë periudhë, fenomen, jo vetëm shqiptar.

Qasje të tilla krahasimtare që çojnë në përfundimin se “ardhja e realizmit socialist ishte një proces jo fort i vështirë” për Shqipërinë, e cila pranoi menjëherë të kontrollohej nga diktatura e proletarietit, kanë dhe funksionin e analizës së historisë kulturore të Shqipërisë moderne dhe të shtresave të psikologjisë kolektive.

Rasti i Shqipërisë, unik, jashtë çdo modeli, rezulton si goditje *in extremis* e “letërsisë si vetëqenie” prej “kontrollit dhe direktivave partiake me udhëzime, orientime e vendime të posaçme” të zhdanovizmit.

Ndryshe nga ç’ndodhi me letërsinë ruse, së cilës iu deshën 20 vjet ose me atë jugosllave, që e shmangu zhdanovizmin brenda pak kohësh, koncept leninist i diktaturës së proletarietit si “autoritet i papenguar nga ligjet, absolutisht i pakufizuar nga çfarëdo rregulloreje dhe i mbështetur drejtpërdrejt në forcë” (Lenin, *Shteti dhe Revolucioni*, 1917), u pranua pa filtra dhe mëdyshje të shumta në realitetin shqiptar; së dyti, sërish, vetëm shqiptar është fenomeni i “kohëzgjatjes së madhe të ndikimit shtetëror mbi letërsinë”.

Mungesa e disidencës në Shqipëri, ofron në këtë pikëvështrim, një lëndë që mund të analizohet për kohën e gjatë të ngurtësimit të metodës së realizmit socialist, larg stinëve të ‘shkrirjes’ që vetë modeli rus (dhe ai i vendeve fqinjë si Jugosllavia) pati njohur.

3. Letërsia bashkëkohore shqipe dhe arqipelagu i *studies*

Është fakt se stina interkulturore kushtëzohet nga vështirësitë për të baratur një vështrim unik mbi tërësinë e botës letrare, në kushtet e fragmentarizimit, imponimit të vlerave të grupeve të vogla që më parë ishin minoritare dhe që i mbronin interesat e tyre në një qark të kufizuar kulturor dhe që sot kryhen nga subjekte kolektive, grupe, me programe specifike etnike, të gjinisë apo orientimit seksual (arqipelagu i *studies* pra, që merr në konsideratë ato periferi që kanoni tradicional historiko-letrar i kishte lënë në margjina apo i kishte fshirë).

Autorët shqiptarë kanë gjetur hapësira shprehëse në lidhje me këto problematika jashtë territorit fizik, kulturor dhe gjuhësor të truallit të tyre: rasti i tematikave *gender* të autorit të suksesshëm finlandezo-kosovar Pajtim Statovci, dëshmon dhe njëherë ‘vonesën’ e horizontit kulturor në vendin e origjinës.

Perspektiva post-koloniale, gjithashtu, kushtëzohet nga ‘modat’ e vendeve europiane ku gjenden dhe shkruajnë autorët e ‘mërgimit’.

Të kushtëzuar nga ‘horizonti i pritjes’ dhe politikat komerciale të shtëpi-ve botuese që i promovojnë, disa prej tyre flasin për antonimi gjuhë ‘më-më’/gjuhë ‘njerke’, në raportin e shqipes me gjuhët e vendeve pritëse duke e njëjtësuar rastin e shkrimtarit shqiptar të ‘mërgimit’ me atë të shkrimtarëve të ish vendeve të kolonizuara (p.sh. autorëve të ish-kolonive italiane në Afrikën e Veriut).

Analiza e rastit të disa shkrimtareve shqiptare që shkruajnë në italisht (trajtuar në vëllimin *Donne d’Albania*), na çon në arsyetimin se burimi interkulturore i letërsisë së diasporës moderne në Itali nuk mund të shkëputet nga historia e ndërmarrëdhënieve gjuhësore dhe kulturore me realitetin italian dhe kohën e gjatë të kontaktit/ ‘kolonizimit’ kulturor dhe gjuhësor, nëse do ta përdornim këtë term.

Për letërsitë bashkëkohore dygjuhëshe, të inkuadruara në letërsitë e mërgimit, koncepti i postkoloniales në rrafsh të shprehjes artistike e vendos kritikën letrare shqiptare përballë nevojës së një këndvështrimi të emancipuar: nga njëra anë duke u çliruar nga ‘moda’ e postkoloniales nga e cila vuajnë deklaratat poetike të disa shkrimtarëve shqiptare në gjuhë të huaj dhe nga ana tjetër, duke pranuar se ‘kontaminimi’/ apo kolonizimi gjuhësor nuk e prek origjinalitetin e vlerës artistike të artit të vërtetë.

Si përfundim

Nuk ka dyshim se studimi historiko-letrar nëpërmjet gjinive shfaqet si perspektivë komplekse e historisë sociale-alternative ndaj eseistikës letrare të tipit monografik, si urë lidhëse mes historisë së mendimit, formave e poetikave; gjinia si e tillë ndërlidh historinë e intelektualëve që propozon historia tradicionale e letërsisë me temat dhe format letrare. Qasje të tilla kanë privilegjin të zgjerojnë perspektivën e vazhdimësisë mbi kategori ngushtësisht filologjike ku të çojnë studimet binare.

Horizonti i këtyre historive krahasimtare të letërsive, bart veç qasjes praktike për vepra dhe autorë edhe vizionet përkatëse të autorëve për interpretimin e historisë.

Tekste të tilla mono-autoriale kanë, nga njëra anë, meritën se bartin qasjen unitare dhe koherencën e një dore, por nga ana tjetër vuajnë peshën e pamundësisë të përpunimit të një horizonti që e vë theksin te relativiteti dhe kompleksiteti që ofron një grup pune.

Vetëm me një grup pune mund të realizohet një tekst universitar, objekt institucional i historishkrimit të letërsisë, i aftë të përmbledhë interpretimin dhe kërkimin e një domethënieje të ngjarjeve letrare dhe zhvillimit të gjinisë. Gjinia përshkon format dhe poetikat duke luajtur rolin e një ure lidhëse të historisë së mendimit.

Mundësia e një studimi historiko-letrar si histori gjinish, është e mundshme në këto kushte, vetëm nëse ndërtohet si një shumësi perspektivash të gërshetuara mes tyre dhe të përqendruara në një konstrukt të vetëm interpretues që synon domethënien.

Vetëm synimi i domethënies parashikon të dyja rrafshet përbërëse të realizimit të veprës letrare (asaj të teknikës, nga njëra anë dhe të ideologjisë

nga ana tjetër), të cilat, vetëm të marra bashkë e lexojnë veprën në vlerën e saj polisense (të kuptimit shumë).

Për t'u kthyer te parashikimi i Auerbach-ut se do vinte një çast që koshienca historike do të mohohet apriori, varfërimi i kulturës humaniste ka sjellë në dhjetëvçarët e fundit një individualizëm dhe një mohim të përkatësisë, konsideruar nga brezi i ri tashmë të vdekur; të vdekura, për pasojë, edhe kانونet e konsoliduara nga historicizmi i fund-shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX.

Edhe pse letërsia shqipe bën pjesë në letërsinë europiane, ndërgjegjësimi për përmasën periferike që ajo ka për shkak të kriterëve komerciale të përkthimeve sporadike në gjuhët e mëdha europiane, duhet të shoqërohet me masa konkrete politikash kulturore për të përballuar hegjemoninë e ligjeve të tregtisë dhe kufijve të shënuar nga multikulturalizmi.

Edlira MACAJ

NË POETIKËN MJEDJANE

Vetëdija e lartë krijuese dhe poetika me “fytyrat” e saj (në shfaqje të tipareve moderne) janë konceptet kryesore rreth të cilave shtjellohet trajtesa e mëposhtme duke u përqendruar te tiparet më identifikuese në krijimtarisë letrare të poetit Ndre Mjedja. (Mjedja, si variant i saktë antroponimik) Kërkimi u jep përgjigje pyetjeve se pse nevojitet rileximi i këtij autori kanonik, edhe për lexuesin e ri sot (tejkalimi nga keqreceptimi tradicional gjatë periudhës ’45-90, problematikat); nga se buron dhe si shfaqet kompleksiteti i vlerave letrare në tekstet e tij, si edhe ku qëndron unikja e tij (afritë me kategorizimet e lirikës moderne, kryesisht te *Juvenilja*, por edhe në lirika të tjera botuar ndër periodikë.) Leximi kritik dhe analiza tekstore veçon këtu disa tipare poetike që lidhen me një dritë të re interpretimi (edhe semiotik.)

I. Çështje të receptimit

Në përmbledhjet letrare të llojit antologji apo vepra poetike, si edhe në ato studimore të llojit monografi apo kritika, të botuara para, përgjatë periudhës 1945-1990, por edhe në ribotimet e veprës së Mjedjes pas viteve ’90, jemi ndeshur me trajta identifikuese si: *Mjeda*, *Mjedia*, *Miedia*, *Mjedja*, por më së shumti *Mjeda*, trajtë e njohur gjerësisht në botimet përgjatë viteve “45-’90. Nevojitet kësisoj, këtu, që në krye të herës stabilizimi i formës së saktë të antroponimit të tij, i cili këtu e më poshtë do të jetë: (*Ndre*) *Mjedja* pasi kështu flasin *de jure* dokumentat zyrtare si ai: *i pagëzimit*, *pasaporta* (Andreas Miedia), *dokumentat shkollore*, *diplomat e doktoraturave* në teologji dhe në filozofi (*Andreas Mjedia*), titulli akademik. Së dyti, pasi kështu i nënshkruante ai krijimet e tij: *Miedia* në fazë të parë, *Mjedja* në të dytën. Së treti pasi kështu njihet edhe nga disa prej studiuesve të tij: M.Gurakuqi,

J. Kastrati, I. Zamputi, E. Koliqi, S. Hamiti, M.Ndoja, etj. Për sa i përket çështjes së leximit Mjedja duhet rilexuar për të kapërcyer idenë se është poet i “dëgjuar”, për të cilin flitet gjithnjë mirë lidhur me vlerat dhe mjeshtërinë e tij artistike, por konkretisht sot, pak i lexuar, sidomos nga brezi i ri. Mosleximi i tij lidhet me disa problematika:

1. *Aktualiteti*. Njohja e tij do të duhet të ishte sistematike në cikle të ndryshme shkollore. Por përfaqësimi i tij në sistemin shkollor AMU dhe AML në Shqipëri është gati i padukshëm. Studentët e letërsisë përballen me të në rimarrjet e pamjaftueshme të parashikuara në hapësirën e vogël kushtuar atij në ndonjë orë leksioni apo seminari.
2. *Periodiciteti*. Krijimtaria e tij në periudhat e njohura si: *Letërsia shqiptare e Rilindjes Kombëtare*; *Letërsia e Pavarësisë (1912-1939)*; *Letërsia mes dy luftërave*; apo njohja e tij si poet i *periudhës kalimtare* ose i *periudhës së pavarësisë*, kanë formësuar receptimin e tij si autor cilësor, jo sasior, gjë që kushtëzoi masën e rëndësisë që iu dha atij.
3. *Klasifikimi*. Komplikohet çështja kur duhet të identifikohet tipologjia e poezisë së tij, referuar rrymës letrare, pasi në historicitetin e letërsisë shqipe rrymat letrare dhe periudhat nuk përputhen. Pyetja nëse Mjedja është klasikist, romantik, realist nuk mund të ketë përgjigje shteruese për shkak se krijimtaria e tij i përket frymës së Rilindjes dhe shtrihet deri në vitet '30 të shekullit të kaluar, e kjo e fundit njihet si periudha më dinamike e krijimtarisë letrare. Studiuesi Hamiti e lokalizon Mjedjen si poet të periudha romantike. Të tjerë e shohin romantik me ndikim klasik, e në fazë të dytë artin e tij e lidhin me realizmin. Por Mjedja ka reflektuar neoklasikun, romantikun, realistin në krijime të ndryshme të tij e po aq edhe modernistin në mishërimin e disa kategorizimeve të lirikës moderne. Në periudha të ndryshme fuqizohen tipare të veçanta të poetikës së tij, ndaj rikuptimësimi përmes një riinterpretimi që bazë **ka tekstin dhe jo kontekstin** nuk e shkëput Mjedjen nga koha historike kur shkruan, e njëherazi nuk e nguroso poezinë e tij në këtë kohë me këtë karakterizim. Klima kulturore në Shqipërinë e viteve 1913-1944, në përgjithësi karakterizohet me tendencat e klimës kulturore evropiane, të cilën e sollën në Shqipëri studentët shqiptarë që studionin nëpër qendrat e njohura të Evropës. Kjo është periudha e shkrimit të letërsisë shqipe me tre karakteristika bazë: 1. *Përveçimin*

autorial - Mjedja ka provuar se është *rast specifk*, i papërsëritshëm; 2. *Stilin e ri* të të shkruarit- Mjedja ofron në poezinë e tij nivelin më të lartë të aftësisë retorike e stilistike; 3. *Shkrirjen e rrymave* - kjo periudhë njohu shprehjen e parë moderniste në letërsinë tonë.

4. *Interpretimi*. Mendimi kritik i cilësdo periudhë ka dhënë vlerësime të merituar rreth krijimtarisë mjedjane nga studiuesit brenda dhe jashtë vendit. Vetëm se kritika e periudhës '45-'90 e shekullit të shkuar, pra kritika e regjimit, i bëri lexim të cunguar dhe interpretim skematik kufizues, kështu që njëanshëm, duke i potencuar vetëm aspektin realist-si revoltë e poetit ndaj sistemit politik të viteve '20-'30. Duke u njohur vetëm si i tillë dhe si autor që përfaqëson letërsinë e këtyre viteve bashkë me Çajupin e Asdrenin, pra si autorë që shqetësohen për **problemet sociale** të periudhës që përfaqësojnë, Mjedjes arbitrarisht iu hoqën vlera të tjera të qëndrueshme e të qenësishme të artit të tij krijues, një prej të cilave: 1. **konstantja religjioze**, e cila i jep poezisë së tij dimensionin filozofik religjioz, por edhe e shfaq atë në një tjetër përmasë, atë të ri-krijuesit me përkthimet letrare dhe fetare; 2. **teknikat poetike** të cilat ai i përdori me vetëdije (dialektizmat, arkaizmat, "errësitë gjuhësore", moskordancat sintaksore duke kapërcyer kurthin e solecizmave dhe duke i aktivizuar me mjeshtëri si "liri poetike") për të cilat u kritikua nga kritika gjatë periudhës së regjimit dhe 3. **elementët modernistë**, referuar lirikës moderne.

Shpesh në botime, Mjedjes i është prekur teksti origjinal, elementët fetarë janë hequr fare, si p.sh. heqja e sonetit të dymbëdhjetë të poemës *Lissus* në botimin e vitit 1978, me shënimin se: në tingëllimën XII që nuk po e botojmë flitet për ëngjëjt që shpien shpirtin e heroit në qiell. Megjithëse në botimin e veprës së tij me dy vëllime (1.2) në vitin 1988, ky sonet botohet i plotë, edhe atëherë ka orientim shpjegimi sesi duhet të kuptohet. Rezultati i këtyre interpretimeve? Mjedja lexohet "i tjetërsuar": *I cunguar*, sepse hiqen pjesë nga tekstet e tij poetike. Redaktorët vendosnin cilat pjesë të futeshin e cilat jo. *Gati i përgjysmuar*, pasi lexuesi i kohës, edhe ky sot, vijon ende të jetë i panjohur me përkthimet e tij të poezive religjioze, por edhe ato hagografike (Mariologjike). *I përshtatur*, duke "e thjeshtuar", për shkak të "errësisë gjuhësore", dialektizmave dhe arkaizmave. Pas viteve '90 Mjedja

rimerret në studime të ndryshme për të stabilizuar dhe tejkaluar kufizimet e periudhës së mëparshme.

II. Çelësa rileximi

Ende sot lexuesi i ri e mban larg nëse nuk i komunikojmë atij disa çelësa leximi, të cilat nisin me rikonsiderimin e konceptit të poetikës, referuar tri referencave të rëndësishme: Burkes, Riceour, Eco, të cilët në trajtimet e tyre mbulojnë ndër të tjera specifikisht retorikën, interpretimin, semiotikën – rrafshet e poetikës, që aktivizojmë për të zbërthyer tekstin mjedjan. Për Keneth Burkes, - një nga fytyrat e poetikës nxjerr në pah lojën që realizohet mes metaforave, simboleve lëvizëse; Riceour flet për shumësi interpretimesh, por me kujdes për të mos rënë në “konfliktin e interpretimit”. Ai vlerëson mundësinë e një leximi dyfish të shenjës (arkeologjik, teleologjik- shpjegimi për funksionin për çfarë bëhet sesa nga çfarë u shkaktua). Në rrafshin retorik ai flet për ‘*metafora të gjalla*’ që lidhen me *efektin e sensit*, domethënies, pra për ta rritur efektin psiko-emocional, si edhe zbërthimin filozofik nga lexuesi- mishëruar në gjuhë të praktikitetit. Perspektiva hermeneutike e tij formohet nga metoda fenomenologjike dhe eksperiencia ekzistenciale të cilat përkrijnë me analizat e brendshme dhe refleksionet morale. Nga ana tjetër sipas Eco-s poetika *ka shumë fytyra*, e kësisoj si rindërtim i kuptimit përmes një leximi të ri mundëson një zbulim të aspekteve: *estetike, retorike, stilistike, hermeneutike, semiotike* e më gjerë. Të gjitha bashkë si qasje metodike risjellin në vëmendje artin mjedjan duke dritësuar funksionalitetin e disa dominanteve poetike përmes të cilave poeti ndërton “sendin” dhe “mënyrën e të shprehurit” poetik. Kjo praktikë analitike e zbërthen poetikën mjedjane me operacione konkrete si:

1. *Dritësimin mbi vetëdijen e tij krijuese moderne* (krijimtari dhe përkthimtari)
2. *Konstantet poetike në krijimtarinë e tij* (disa prej të cilave të afërta me kategoritë e lirikës moderne (përpunimi, “magjia gjuhësore nga retorika klasike në semiotikë, liritë e rrafshit gramatikor e sintaksor, kodi logjik etj.)
3. *Poetika e Andrrës....*

Vetëdija moderne

Për Mjedjen poezia është thirrje (talent) ndjenjë, përfytyrim (fantazi), konkretësi (send), dinamikë (ndryshime e përmirësime në gjuhë), teknikë (mjeshtëri, hollësi). Mjedja në poezi vlerëson harmoninë; metrin e shikon si kategori relative. Për të lënda ndërton sensin, të bukurën, lartësimin. Kështu poezia nuk është përshkrim, as njësim, as mimesis, por tërësi pikëpamjesh, mënyrë të shprehuri. Sipas tij që poezia të sjellë kënaqësi duhet të nisët nga ndjesi të ëmbla, hijshmëria, e shndritshmja për të arritur te e madhërishmja, e brendshmja, por që të jetë efektive, “të bindë”. Në konceptin mjedjan poezia do ishte e përcaktuar si shfaqje e bukurisë me një shprehje fantazie, herë herë me masë (por nuk duhet të bëhet kushtëzim) që të bindë e të emocionojë (mallëngjëjë). Të njëjtat parime krijuese Mjedja i konsideron edhe kur realizon përkthimet letrare, të cilat i përshtat për kontekstin e ri dhe i sjell si rikrijime, duke ruajtur frymën, vokacionin e tyre (*Vllavrasi, Mbreti i Tulës*, etj.). Në të gjitha rastet e përkthimeve letrare, por edhe të përkthimeve të lirikave fetare, ai kujdeset për të siguruar efektshmëri të lexuesi (në kontekstin e ri kulturor ku teksti shkon siç është ai shqiptar), ekspresivitet (regjistri mjeshtëror retorik), pragmatikë (synim për fjalë të qëlluara), shije, pra në fund të fundit një rikrijim që t’i ngjisë marrësit të ri. Parime këto që ndiqen edhe te përkthimet e tij hagiografike të cilat anojnë nga prakticiteti, pasi në secilin prej tyre kemi të bëjmë me ruajtjen e elementit homiletik (elementi identifikues i mësimëve lutëse) i cili lidhet me predikuesin (ai që transmeton porosinë divine) dhe audiencën.

Rasti i Mjedjes duhet shqyrtuar me kujdes, pasi poetika e tij ofron, “martesën” e veçantë të poetikës klasike me atë moderne duke sintetizuar poezinë e pastër (alla Mallarmé) dhe klasiken, pasi krijimet mjedjane rrisin sugjestionin dhe figurshmërinë me anë të ndërlikimeve të mekanizmave gjuhësorë. Në vijim të këtij konceptimi, pra rreth modernes e ndërlikimeve të mekanizmave gjuhësorë po vendosim disa shënime paraprake mbi modernen në letërsi, vijuar me kategoritë tipike të lirikës moderniste, asaj europiane, për t’u hedhur më pas te dominantet poetike dhe funksionalitetin e tyre sipas rasteve të marra në shqyrtim të Mjedja.

Ndryshe nga poetika, (retorikë, hermeneutikë, semiotikë, stilistikë etj) konceptit të modernes ose modernitetit në arte i vishen shumë diskutime dhe

debate. Calinescu te *Pesë fytyrat e modernitetit* e relativizon datimin e termit modernitet, për shkak të ndërlikimit të tij dhe mospajtimeve që ai has si koncept, pasi element thelbësor i tij është koha, që në vetvete është e pakthyeshme. Por, këtu, po mjaftohemi në disa pohime lidhur specifikisht me modernitetin në letërsi. Për studiuesin e legacisë së modernizmit në arte si letërsia, Andrzej Gašiorek, modernizmi vjen si një lëvizje ndërkombëtare dhe kozmopolite- produkt i rrymave të ndryshme artistike dhe intelektuale. Është rënë dakord gjerësisht që termi i referohet një grupi veprash novatore gjatë një periudhe të jashtëzakonshme kulturore, sociale, ekonomike dhe tharmimi politik.

Nga ana tjetër më specifik lidhur edhe me objektin tonë të kërkimit është koncepti dhe zberthimi i tipareve të përgjithshme e të qëndrueshme të lirikës moderne, nga Hugo Friedrich duke qartësuar më parë termin strukturë: në aktin letrar “struktura” (që pas Diltheit), nuk ka të bëjë me organizimin klasik të termit, por tregon një kompleks organik, një bashkësi tipologjike të së ndryshmes. Sipas Friedrich-ut, modernizmi është një rrugë e mesme që del nga prerja e së shkuarës me tendencat e së ardhmes. Romantizmi estetik i Baudelaire-it është atiromantizmi ose fillesa e shfaqjes së modernizmit. Kjo estetikë e lidh modernizmin me hallkat e fundit të romantizmit dhe hallkat e para të së ardhmes duke bërë **që poeti i kohës të jetë poeti i kontrasteve, dhimbjes, pasionit dhe shtigjeve të reja, sidomos atyre gjuhësore**. Referuar këtij ndikimi modern në letërsinë tonë studiuesi Qosja mendon se nuk ka shfaqje të kategorizimeve që bën H. Friedrich në studimin e tij, posaçërisht për poezinë lirike. Mund të jetë ndonjë vepër, por nuk ka prirje, por edhe te veprat dhe autorët ai nuk radhit Mjedjen, megjithëse pohon se *koha përcakton vlefshmërinë, e si rrjedhojë edhe modernitetin*.

III. Konstantet poetike

Friedrich-u, cituar më lart, e ka të lehtë të evidentojë në lirikën moderne: *fanatazinë* si kategori absolute; *bukurinë* që vjen nga paqartësia, jo më nga qartësia, pasi kjo poezi vjen si romantizëm i çromantizuar; *gjuhën personale*, autonome; predikatin më të lartë: *eufoninë, harmoninë; magjinë gjuhësore* që vjen prej aktivizimit të gjuhës së të përditshmes; *ngushtimin tematik; ripërpunimin; errësinë kuptimore* dhe *estetikën e së shëmtuarës; poezinë*

monologjike; fuqinë nga tingulli dhe figurat e mendimit si metafora, etj. Një poeti modern i duhen qartësuar ligjet stilistike, njësitë stilistike.... Pra, çdo poet identifikohet nga një set tiparësh në krijimtarinë e tij që lidhen me disa rrafshë të poetikës në përgjithësi, (por edhe krijimin si akt, apo procedetë teknike, tipare të stilit, e disa syresh kalojnë edhe në parapëlqime për t'i riaktivizuar e bërë të qëndrueshme, tipike.) Le të rrekemi të provojmë çfarë aktualizon estetikisht Mjedja nga këto kategori të *Juvenilja* e më tej, nisur me ato më të dukshme, teknike drejt atyre më në thellësi (nga retorika tradicionale - te semiotika)

1. **Ri/përpunimi** – procesi *Limae Labor*, ripunimi i *Juveniljes* në dekadë, variantet e shumta të poezive të tij, që me raste bëhen objekt diskutimi ndër studiues, dëshmojnë se Mjedja, sikurse romantikët e çromantizuar, pra poetët e parë modernë, kërkon gjithnjë perfeksionin, pasi ri/përpunimi shfaqet si një nga kategoritë e lirikës moderne, si një tipar, identifikues për poetët cilësorë e jo sasiorë. I tillë është edhe Mjedja. Në vijim të kësaj përkujdesjeje shpaloset një hartë e gjerë larmie rimike.
2. **Llojshmëria e skemave rimike** vjen si aftësi, përkujdesje e bëhet tregues i mjeshtërisë retorike. *Rimari*, hartuar prej Kolë Ashtës dritëson këtë aspekt, por në vrojtimin tonë veçojmë disa disa nga rimat më të përdoruara në poezitë e Mjedjes. Alternimi i disa syresh dhe brenda një poezie, apo soneti është një tregues i përkujdesjes ndaj fjalës, por edhe aftësisë për të krijuar një poezi auditive, për të ruajtur vijën melodike, gjë për të cilën sigurisht e ka ndihmuar edhe aftësia tjetër që kishte Mjedja, njohuria muzikore, pasi në Kolegjin Saverian ai ka lektuar edhe muzikologjinë. Efekti muzikor, tingullor e bën krejt të veçantë e harmonike poezinë e tij.
3. **Substrati i fortë retorik dhe liritë poetike** (të rrafshit gramatikor dhe stilistik) vijjnë si tregues të fortë të sigurisë së tij krijuese që rrugëton nga retorika klasike e identifikuar me figurat metrike (të cilat shërbejnë për të siguruar saktësinë metrike, masën si p.sh.: anafora, afereza, apokopa, sinkopa, sinalefa); me figurat gramatikore (të cilat vijjnë në shërbim të lirisë poetike), etj, të cilat vijjnë në funksion të rritjes së fuqisë shprehëse. Efekti shprehës ndihmohet nga: aliteracioni, elipsa, pleonazma, kiazma, hiperbati dhe anakoluti. (këto të fundit figura sin-

taksore), si edhe nga figura të stilit: apostrofa, antiteza, reticensa etj. Mjedja di të shpëtojë nga kurthi i solecizmave- agramatikalitetet jofunksionale- duke krijuar arealin e lirive të tij poetike pikërisht në rrafshin sintaksor. Poezia moderne jeton falë lirive poetike, të cilatdo rrafshi janë ato.

4. **Pasthirrma** - tipike e tij, për gjendje ekzaltimi apo dëshpërimi mban komunikimin esencial poetik që lidh intensitetin psikoemocional me komunikimin monologjik. (kujtojmë kategorinë e poezisë monologjike të lirika moderne). Përtej reagimit ato shënojnë thirrjen dhe përfundimin si i klasifikon edhe Blomfeld-i, por njëherazi ndërtojnë pra edhe esencën e komunikimit. Felix Ameka i klasifikon ato në primare ku futen fjalëzat që i shoqëron intonacioni rritës dhe sekondare në lidhjet me të tjera fjalë, duke i dhënë rol më të identifikueshëm.
5. **Riaktivizmi i fjalëve të rralla nëndialektore si shenjues ideolekti.** Te Mjedja, insistimi për riaktivizimin e tyre pasuron emërtime lidhur me elemente përbërëse të natyrës, për objekte praktike, gjendje ose veprim. Gjetjet e fjalëve arkaike, nuk kufizojnë, përkundrazi marrin disa përdorime, ngarkesa dhe si të panjohura krijojnë kureshti. Tejkalohehtë kështu vërejtja e R. Idrizit i cili përbërjen dialektore të tekstit të vëllimit poetik të Mjedjes e parashtron jo me paaftësi të poetit për të krijuar vargun, por të lidhur me bindjen e vetë poetit, duke e cilësuar bindje “të gabuar”. Edhe V. Bala pohon se *“gjuha poetike është shumë e pasur në fjalor dhe në ndërtimin elokuent të frazës, ndonëse mjaft e ngarkuar në solecizma dialektore që duhen shpjeguar e sqaruar”*. Këto qëndrime mbi leksikun dialektor, mbase ishin në një linjë me ideologjinë e kohës dhe parapëlqimin e njëanshëm të studiuesve, duke përkuar me atë që A. Vehbiu e quan “armiqësi të regjimit komunist të Tiranës ndaj kulturës gege” me justifikimin e standardizimit.
6. **“E Bukura” dhe loja e saj metaforike** -e cila fillimisht shenjohehtë nga metafora tradicionale, formësuar sipas konceptit klasik të figurës, te Mjedja, kthehet në multishenjë poetike, moderne. Ajo rrëshqet natyrisht nga metafora si trop retorike në sens/efekt në semiotikë, ose “të shprehur” dhe “sens” (Riceour) duke i dhënë leksis-it (bilbili, lejleku, jeta, vdekja, ëndrra) etj.) funksion pragmatik në semantikë dhe jetë në semiotikë.

Në shtrirje të metaforikës, mund të interpretohet edhe roli domethënës i *hipotipozës* që trupëzohet në retorikë, por merr jetë në semiotikë. (Eco) Me hipotipozën që ndërtohet me anë të teknikave të saj specifike: listimi, dëshmimi, detajimi, saktësia etj., imazhi metaforik sugjeron shumë përtej së thënës, duke i lënë dorë lexuesit një ndërtim të ri imazherik e duke i dhënë liri fantazisë së tij të përjetimit, si: përjetim i tragjikës, i nostalgjisë, i saktësisë, brenda së cilave lexuesi ta ndiejë veten pjesëmarrës etj.

- 7. Kodi logjik- “fjalët çelës”** Për të depërtuar në shpirtin e një poeti apo të shqetësimit të tij kryesor, thotë Baudelaire-i, le të kërkojmë në veprat e tij se cilët janë fjalët që përdoren më së shumti. E ky mendim thekson Friedrich-u është një princip i shkëlqyer për të nisur interpretimin. Te Mjedja rimerren me funksion poetik disa fjalë, të cilat figurojnë mëvetësisht kodin logjik. Veçojmë:

Drandofillen e cila e ruan kuptimin e saj metaforik të lidhur me aromën, rritjen, rininë, etj. si edhe mvishet me të reja në nivel përdorimi simbolik të lidhur me virtytet: mirësi, martirizim, idenë: perfeksion etj.; *Zymylat*- lule në ngjyrë e variacionit të blusë dhe së purpurtës, kolorit që është afër vjollcës, ngjyrë e preferuar nga Mjedja aktivizohet në lidhje me sensualitetin dhe idealen. Kjo lule në ngjyrë është e afërt edhe me manushaqen, sublimuar në domethënien e saj te poezia *Vjollcës*. Referuar Ferber-it, në konstatimin e simboleve letrare, kjo lule, (vjollca) përkatësisht në poezi, lidhet me elementet, si: sensualitet, erotikë, idealitet, shlodhje. (rimerret te *Prendvera* str. 1, *I tretuni, Vjollcës, Meyerling*, etj).

Bylbyli - Shpend i vogël me dramë të madhe dhe me karrierën më spektakolare në riaktivizimet e tij në letërsi. E shohim vajin e bylbylit në strukturalitetin e qëndrueshëm të vajtimit- lamentos, po të lidhur me poetikën delikate të simbolikës së bylbylit. Te *Vaji* ky bylbyl ka dy funksione: atë të ruajtjes së ngjyrave të vetmitarit dhe pakënaqësisë së tij si te poetët e romantizmit, megjithatë jo zbritje në mbyjtjet personale, por vendosje përballë kodit nacional. Këtu leximi është dykahesh: personalja- nacionalja. Sigurisht që tani tejkalohej leximi që e sheh bylbylin si poeti që përjeton krizën shpirtërore që buronte prej bindjes se nuk duhej jetuar siç ke jetuar deri tani, apo se nuk duhej lejuar më të ishin të varur, megjithëse nuk humbet leximi

kah personalja- nacionalja, por shkohet edhe më tej. Shenjuesit identifikues të bylbylit janë këngë /vaj, pranverë, melankoli dashuri, vetmi, personale.

Si këngë: kënga e bilbilit ka stil kreshendo më zë të larte fishkëllimë, natën dhe ditën; të kënduarit e tij më tipik është pas mesnate, një orë para agimit, ndaj në shumë gjuhë të botës emri i tij përmban rrënjën “natë”.

Identifikimi i bilbilit me motivin e dashurisë njihet prej poezisë arabe e perse ku bilbili i këndon trëndafilin (gruas) derisa (ajo) lulja të çelë. Mesjeta e sheh atë si emblemë të dashurisë. (Ronsard, Thomas Randolph) edhe romantikët po ashtu (Byron, Hugo). Kalimi i përdorimit të bilbilit në kuptim të figurshëm, si metaforë haset që te Hesiodi. Te trubadurët, ai fitoi identifikimin me vetë poetin. Shelley shkruan se një poet është një bilbil që rri në errësirë e këndon të zbusë vetminë e tij me tingujt e ëmbël.

Si vaj: tradita e dytë e perceptimit të bilbilit si simbol vaji e dhimbjeje, nis me legjendën e shtypjes së gjembit që ai ka në kraharor, në mënyrë që të qëndrojë zgjuar dhe t'i këndojë shqetësimit të tij. Ky motiv i vajit dhe jo i këngës, ka nisur në poezinë franceze të shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Në të gjithë kontekstet e përmendura bilbili ka një dominante të qëndrueshme: muzikën dhe melankolinë.

Mjedja e rimerr poetikën e këtij zogu në shumë poezi, e në secilin rast kënga a vaji i tij ka një kuptim të përcaktuar, p.sh: *Malli për atdhe* në vargun: *bylbyl tui këndue* v. 1 str. 4; *Vaji i bylbylit*, te I tretuni pj. 2 str. 3 v. 2 *Kur çilin bylbylat* dhe te str. 4 *Bylbyla, qi s'ndihni*; te: *Malli për atdhe* str.4, v. 3 *Mue, i mjerë bylbyli, po m'përgián mue*; te *Prendvera* str.1, v. 2 *Jé molis' i ziu bylbyl* ose str. 2, v. 4 *Rri, bylbyl, n'lulzim qi kthej*; te *Vjeshta* str.1, v. 2 *'Dhe ju po shkoni bylbyla kshtu*; te *Meyerling* str. 2, v. 1, etj.

Te Mjedja haset gjithashtu një rimarrje e shqypes. Mjedja realizon dy efekte emocionale të ndryshme. Sa i butë, i brishtë, vetmitar në përftimet poetike ku në qendër është bilbili, aq i fortë, pasionant e i ashpër me zërin e tij kur hapet vendi në varg për shqiponjën. Lidhja e shqiponjës me arealin shqiptar është më shumë se tregues gojëdhënash. Te Mjedja shqiponjën e hasim te Lissus IV, str. 2, v. 1 ku *shqypja ilire nëpër ajr dëfrehej*- ku pushtetit i shpendit tregohet i pacenuar, krenar në habitatin e tij. Po aty soneti IX-str.4, v. 4 luftime e gjaqe Shqytarët me shqype- ku shpendit poeti i referohet si totem frymëues, emblemë përfaqësimi. Pjesa X-str. 1, v. 4 për lulëzimin e atdheut *Shqypja kobplote*-vjen me ngarkesën poetike, mbartëse e dimens-

ionit tragjik. Pjesa XI- str.2, v. 4 *shqypen e ballit t'mbramen herë e ngjeshi*- si shenjë identifikuese e pandashme, simbol adhurimi e përkushtimi. Te *Scodra-I*- str.3, v. 3 *Ku t'ilir' si shqypet nëpër bjeshk'*, banoshin shenjohet simbioza socializimi historik banor-shqiponjë, për të treguar lidhjen e fortë të ilirëve me vendin. Pjesa IX- str. 1, v. 2, *banon me shqype, e ku, përte, e parthinit*- e përdor shqipen si, element ngjizës i vendit me banorët. Te *Liria-I*- *O shqype, o zogjt e maleve, kallzoni* –vjen si referim, tregues i bashkëlidhjes me shqiptarët. Te pjesa VI- str.4, v. 3- *me thoj t'harkuem Shqypeja arbënore*- si shpend me aftësi gatishmërie dhe vetëkontrolli. Në të gjitha këto rimarrje krahasimi mbështetet në karakteristikat thelbësore të tij. Pra, edhe te Mjedja shqip(onj)ja vjen me tërë madhështinë që e karakterizon këtë shpend në traditën e interpretimeve historike dhe etnologjike.

IV. Poetika e 'andrrës'

Fantazia (areali, përshkrimi, subjekti, jeta, ëndrra, tri gra); e bukura tragjike (dramaciteti agresiv), pasionet e kontrastet (dashuria/jeta/vdekja), magjia gjuhësore, gjuha personale e përditshmërisë, shenjat komunikuese retorike e semiotike- janë vetëm disa tregues të cilët formësojnë poemën *Andrra e jetës* dhe e afrojnë atë poetikisht me prosede moderne.

Trina, Zoga e Lokja janë tre jetë dhe tri andrra (tri andrra në një jetë). Brenda këtij plani dykahësh real e surreal zënë vend disa nivele duke filluar nga niveli faktik (përshkrues), niveli i kuptimeve analogjike, simbolike, filozofike etj. Kjo poemë flet për njeriun, lidhjen e tij me jetën dhe prehjen e tij te ëndrra. Duke ngritur për herë të parë poetikisht në letërsinë shqipe rëndësinë e ëndrrës dhe rendjes pas saj si një sfidë ndaj çdo përballjeje me jetën. Kjo qasje i jep kësaj poeme karakter sa personal aq social dhe universal për të artikuluar artistikisht disa nivele përfaqësimi: shpirtëror, mendor, religjioz, social, filozofik, antropologjik.

Andrra e jetës karakterizohet nga një dinamikë e brendshme në strukturën e së cilës janë stinë natyrore që paralelizojnë stinët njerëzore. Ky dinamizëm i bashkërenduar me historinë e një familjeje, që njeh vdekjen para jetës, apo që kapet pas ëndrrës së jetës nuk mjafton të përcaktojë se *Andrra* është një poemë realiste apo romantike. Trina, Zoga, Lokja janë personazhe-simbole që lidhen me pikat kryesore të jetës njerëzore. Duke mbështetur këtë

përcaktim, mendojmë se kuptimi i poemës *Andrra e jetës* ngushtohet nëse ajo kufizohet në diskutimet e natyrës sociale. Sigurisht që Zefi i variantit të parë zëvendësohet me dy vajza për të rritur efektin dramatik, brishtësinë e vajzës para djalit dhe se duhet të kishte patjetër edhe shpresë brenda, gjë që realizohet me Zogën. Efekti tronditës fillon që në vargjet e para ku metaforikisht janë *molla tkputuna* *nji deget... dy qershija lidhë n'nji rrfanë... rrinë* dy çika ma nji nanë. Cila do të peshojë më shumë artistikisht “kputja” “lidhja” a “pritja”?

Jeta është tragjike në kompleksitetin e saj. Tragjike është që Trina vdes pa e kuptuar, pa pasur mundësi zgjedhjeje. Zoga jepet pas ëndrrës duke u shkëputur nga realiteti dhe falë thurjes së ëndrrave vajzërore ajo fiton. Lokja pranon vdekjen pa kundërshtim, (por me peng që s'pati djalë). **“Dramaciteti agresiv”** për të cilin flet Friedrich-u, therr me ‘bujtjen’ e Trinës te Zoja e Zogën, ndihmon ndërrimin në tjetër jetë të Lokes, por dobësohet para Zogës të cilën e shpëton dashuria e një martesë që më tepër qëndrojnë në planin e ëndrrës sesa në atë real. Ky ‘dramacitet agresiv’ poetik, nuk tund ekuilibrin natyror “dy vdekje, dy jetë” (një mbijetesë, një lindje fëmije).

Poema *Andrra e jetës*, me titull emëror në të cilin emrat janë në funksion të njëri-tjetrit thuret rreth dualiteteve kontrastuese: *jetë-vdekje; jetë-ëndërr; jetë-dashuri*. A bëhet fjalë për ëndrrën e jetës ku nuk e dimë ende sesi është ajo jetë e si merr “jetë” në vargje? A është jeta një ëndërr? A kërkohet ëndrra te jeta? Apo vdekatarëve u zgjat jeta sa një ëndërr?

Në ëndrrën e Zogës kemi: *ngrimun n'ar mbi'j pullalië/ nën balkue nji beg kish dalë/ holle i giatë porsi selvië/ n'rrugë nen gardh ish dukë nji djalë*. Në zgjimin prej ëndrrës e nën ëndjen e riteve vajzërore (*tue sjellun krahnin këndote me vedi*) ëndrra kish pasur fuqi magjike, *pse.... e rruga e vjetër/ Nën shpië, mbas gardhit, por si një dritë / Shkote tui qitë. Nuk e kish vrumun kurr nder dit t'veta/ At rrugë n'balkue*. Zoga jeton brenda vetes së saj në dhe për një tjetër realitet. Ëndrra, ky përfytyrim i saj, përfitim trill emocional, dëshirë dhe vizion, modelon vetë realizimin e saj, nisur nga kjo dritë e brendshme. Kjo është një ëndërr me dritë dhe jeta e saj e prek dritën e kësaj ëndrre: *njajo flakë qi n'zembrë pate/ Do t'përcjellin tjetër-kund*. Në ëndrrat vajzërore jeta merr kuptimin dhe projektimin personal për Zogën. Ëndrra që çliron shpirtin, që ushqen shpresën drejt vizionit, ëndrra e bukur dhe e trish-

të si vuajtje dhe shpresë, e besimit në vlera dhe e vetë urtësisë bëhet identifikuesja e ëndërrimit mjedjan.

Ëndrra si strukturë përsëritëse. Sjellim ndërmend se poezia moderne në fillimet e saj ëndrën e lidh me fantazinë krijuese. Atje ëndrra vjen si shumësi e formave të brendësisë së poetit, kohës së brendshme, dëshirës për shmangie; ëndrës i njihet një superioritet mbi realen, kontrastit cilësor në favor të ëndrës midis pafundësisë që sugjeron ëndrra dhe kufizimeve, mungesave që jep realiteti. Ëndrra vjen si një kapacitet produktiv joperceptiv, që nuk është konfuz e arbitrar, por saktësisht me dashje. Në poemë ëndrra vjen si një mjet poetik për të shpëtuar një jetë, si për të dalë mbi vrazhdësinë e realitetit, ashtu si edhe për të lehtësuar kalimin në botën e përtejme. Poeti e veçon ëndrën si mjet kryesor me disa ngarkesa dhe e përdor për disa kohë të brendshme.

- Trina largohet nga kjo jetë brenda një ëndrre. Ndërrimi i jetës së saj për t'u ngritur te qiellorët, vjen me shenja paralajmëruese. Tjerrja, shtojzovallet që endin fatin e njeriut dhe shpellat me dragonj nuk janë vetëm tregues mitikë, por vijnë bashkë me konotacionin e tyre që në këtë rast e kanë tragjik. Po ashtu vjen edhe ndjesia e nënës që parandjen të keqen. Tjerrja e fijos që në dukje ka të bëjë me përhumbje dhe shkaputje momentale me realen, është si një paralajmërim ogurzi, si dhe lidhet me rritjen e tensionit të brendshëm të Lokes, teksa ajo parandien këputjen e këtij filli jete. Vdekja e Trinës "lehtësohet" mësuar prej pafajësisë së Zogës dhe stoicizmit të Lokes. Kontrasti natyror mes pjesës së parë të Trinës dhe pjesës së dytë të Lokes ilustronë madhërisht dy ekstreme. Vdekja e Lokes, nga ana tjetër paralajmërohet nga krizantemat si lule që rriten pranë varreve. Gjithë kohën kemi bashkëshoqërim të cikleve të natyrës me pjesë të jetëve të personazheve. Jeta e Lokes kalon si në ëndërr mes episodeve të dhimbshme dhe pengjeve. Vdekja e Lokes ndodh pakuptuar si në ëndërr, ndërsa ajo bilancon jetën e saj dhe vuan djalin e munguar e vatrën bosh. Biseda e Lokes me "mortjen" e vendos atë mes ëndrës dhe zhgjëndrës.

- Zoga dhe bota e saj e ëndrrave është në poemë si ëndrra brenda ëndrës së madhe, jetës; Ëndrra e "begut" me të gjithë variacionet / relativizimet e kohërave njihet si dëshira pothuaj e çdo vajze. Zoga e kërkon, e projekton dhe e dëshiron princin e saj në botën e dytë, në botën e natës, të ëndrës, aty ku askush nuk ia prek, ku të tjerët nuk kanë emër, ku ekziston vetëm ajo dhe

ai. Ky përjetim lidhet me shfaqjen e së bukurës. Ëndrra shërben për të krijuar, kërkuar një dashuri. Kjo dashuri e kërkuar-krijuar bëhet vetë shpëtimi i saj. Pas ëndrrës, mëngjesi i së nesërmes, nuk ia ofron më atë magjepsje. Por për të vijuar ende ëndrrën, Mjedja paralajmëron sërish me çiftin e dallëndy-sheve për çka do të ndodhë. E përjetuar kjo ëndërr-dashuri vetëm nga Zoga dhe jo nga djali, ajo vjen më e pastër dhe e vendosur. Kjo “përkujdesje” e poetit për të mos e materializuar dhe për të mos i dhënë një feedback me një personazh tjetër, e mban ëndërr-dashurinë e Zogës në plan ideal. Te Zoga ëndrra e dashurisë e tejkalon realitetin dramatik, e shpëton atë nga plani i errësimit. Ëndrra e Zogës ka dy plane bazë ndërtimi. Ajo vjen si projektim personal dhe vizion, brenda të cilave është fantazia, pasioni, erotizmi etj., pra shpëtimi nga gjendja e vetmisë dhe projektimi familjar. Në vijim të ngjeshjes kuptimore edhe këtu foshnja është shenja që tregon finalizimin dhe vijimësinë.

Efekti i parimit komunikativ - është karakteristikë tjetër e krijimtarisë mjedjane, e afërt me konceptin ‘meaning as use’ - të Wittgenstein-it. Përdorimi i fjalëve të gjuhës së përditshme realizohet përmes funksioneve pragmatike gjuhësore të cilat lidhen me lakonizmin, elipsën, përqendrimin gjuhësor. Thënë ndryshe shumë veprime në pak, shumë pak fjalë, në një sintetizim funksional, në një ekzekutim të parimit komunikativ. Ekzekutimi sipas parimit të bashkëveprimit (Grice, 1971) është i ndërtuar në bazë të katër maksimave: sasisë (aq sa duhet), cilësisë (atë të vërtetësisë), përkitshmërisë (lidhjes me folësin, bindjes), mënyrës (rregulli). Te Mjedja njësia gjuhësore vihet në funksion të efektit- duke konkorduar me efektin e sensit në retorikën e Riceour-it. *Andrra...* këtë deskription faktik e ka në të gjithë strukturën e saj P.sh.: te pjesa e dytë, vetëm strofa e parë jep disa veprime njëherësh: *U ndie një za te shtegu: /Cice! del se erdh murgjina /e mbrapa po vjen Trina /me’j qingj të sykes ngryk.* – elementë për t’u veçuar janë *zëri, shtegu, erdhi, Murgjina, qingji, sykja* nuk janë naivitete poetik, por elementë përmes të cilave zbulohet Trina, përtej një vogëlusheje e cila duhet të jetë vitale dhe e familjarizuar me bagëtinë se ato vijnë me emra, si njerëzit. Më përtej vijojnë shenjat tipike paralajmëruese për lexuesin: mbilodhja, që do të shfaqet në darkën e *psheshit me kollomoq*, të cilin s’e preku, se *...i dhimbte n’ijëe i kishte mollzat gjak.* Pas çdo treguesi veprimi, Mjedja kujdeset të procedojë

me lidhëzat: *por, veç...* për të sugjeruar një pasojë ose të papritur që nuk do vonojë të shfaqet.

Mallëgjimi si techné retorike - Magjia e transfertës së ndjenjave të lexuesit, vjen nga zotërimi i teknikave retorike. Përtej mjeshtërisë në rrafshin e elokutio-s, me liritë poetike, me metaforën si fakt (trop, retorikë) e efekt-sens (semiotikë), Mjedja ka shtrirje edhe në *inventio*, e cila hedh argumentin mbi material duke aktivizuar të folurit vetjak. Sipas Barthes-it dy janë elementët shtylla të saj me impakt të dëgjuesit: *bind/ mallëngjej*. Me “bind” dhe me “mallëngje” janë dy drejtime të *inventio*-s, të ndikosh të dëgjuesit furisht përmes arsyesimit, ku provat kanë forcën e tyre. Provat subjektive apo morale, që i përkasin *inventio*-s varen nga mallëgjimi. Kjo është zona e retorikës psikologjike që realizohet praktikisht përmes *ethè*-së (karakteret, tonet, pamjet) e *pathè*-së (pasionet, ndjenjat, afektet) ku *pathe* janë afektet e dëgjuesit, lexuesit. Psikologjia retorike duhet kuptuar nga e kundërta e psikologjisë reduktuese. *Mallëgjimi-animos impellere* ka të bëjë me të drejtuarit e ndjenjave që mbulon hyrjen dhe fundin që marrin karakter pasional, ndërsa bindja mbulon *narratio*-n dhe *confirmatio*-n, provat që janë mes i ligjëratës e marrin karakter demonstrativ. *Narratio* ka të bëjë me funksionalitetin: përgatitje për argumentim me të dhëna dhe përkthime në mënyrë të natyrshme. Mjedja, pjesët i ndërton eliptikisht, me gjuhën e përditshmërisë, duke i motivuar gjithnjë me fakte bindëse. Rritet kështu shkallë-shkallë efekti psikologjik të lexuesit. Lexuesit ose dëgjuesit i përjeton situatat, parapërgatitjet derisa arrijn të mallëgjimi. Ky mallëngjim të poema *Andrra e jetës* lidhet kryesisht me “mirëkuptimin” që poeti kërkon të vendosë me vdekjen. Ky është një tregues i interaktivitetit lexues-tekst dhe vjen si mishërim i kësaj teknike të përzgjedhur qëllimisht.

Ajo që ne e cilësuam të Mjedja si gjuha e përditshmërisë, përtej parimit komunikativ, të rikujton edhe filozofinë e Shën Agustinit- për të përcjellë me fjalë të thjeshta filozofinë e krishterë. Thjeshtësia (përlësia), e stilit biblik, sipas tij, ka për qëllim kuptimin nga të gjithë të fjalës së Zotit, ndërsa thellësia e përmbajtjeve dhe domethënive të errëta vënë në provë kapacitetin intelektual jo sipërfaqësor. Dialektika “thjeshtësi” e “madhësi” në raportin mes formës e përmbajtjes, mes stilit dhe domethënies, buron nga thelbi i vetë zbulësës: mishërimi i fjalës hyjnore, si shkallë ekstreme e madhësisë në përlësi. Kësisoj Shën Agustini rekomandon stilin e përlulur,

pasi vetëm me thjeshtësinë, gjuhën e përditshmëisë krijohet efekti, bindja dhe mallëngjimi. Ligjërimi i realizuar përmes ekspresivitetit dramatik, që imiton përdorimin e gjuhës së përditshmërisë, stimulon te dëgjuesi efektin psikologjik, mallëngjimin. P.sh.: poeti fillon të japë provat e vdekjes së Trinës e të Lokes me radhë në mënyrë që të përfshijë lexuesin me ndjeshmërinë e tij, duke qenë sa më pranë tij me gjuhën e përzgjedhur. Vdekja e Trinës parashtrahet në disa pika referimi: 1. Sinjalizimi *Molla t'kputuna një deget*; paqtia tokësore e në fund tronditja nga kënga e gjel kokotit shënjojnë treguesit çelës të pjesës së parë; 2. ... *paq i kthilltë prei Perendijet/ paq prei nierit e qetë* - Ç'është kjo qetësi, ky paqtim hyjnor? 3. ...*gjel kokoti.../ Ká m'u gjegjë se á tui ndërrue moti/ á tui çue një tjetrë ére* – ky është paralajmërimi për pjesën e dytë; 4.. *Ish lodh: I dhimte nd'ijë/ E kishte mollzat gjak* – vijojnë argumentet e *Trina s hangri gja (as Lokja, por tËrte)*; 5. *këneta, dragonjt, shtojzovallet...*- janë elementë që rëndohet parashtrimi i faktit me elementë përtej realë.; 6. *Ngrykas, si dy qellorë/ me krahë pa pupla, i gjet- fjalë që zëvendësojnë fëmijënëngjell, kalimi në përtej jetë.*; 7. *Tash á tui folë me Zojën apo e lumja zojë t'bërtet, apo Rri bij', se sunte Trinka / po shkon me bujtë te Zoja-* Kur lokja heshton Zogën, ka të bëjë me konceptin e besimit të paprekur, e ngjashme me formulën agustiniane “beso për të kuptuar”. Njohja e vetes përmes besimit dhe arsyes, ku besimi i pararend arsyes, (pra të besosh për të kuptuar) e bën praninë e Zotit të të lehtësojë çdo fakt, edhe vetë vdekjen.

Vdekja e Trinës dhe pranimi i saj ndërtohet mes dy pjesësh: “Bujtja” e Trinkës zbut në maksimum kuptimin e fjalës *vdekje*. Në këto raste kemi një zëvendësim të fjalës *vdekje* me dy struktura foljore. *Kuvendimi* dhe *bujtja* janë shoqërizime veprimesh të lehta për të zbutur vdekjen dhe për ta parë atë ndryshe. Ato identifikohen logjikisht me termat njohje (kuvendimi) dhe pranim. Pranimi i vdekjes në këtë formë urtësie vjen si risi në poezinë e kohës, por e njohur në filozofinë e krishterë tek *ars praedicandi* .

1. mbarimi i luleve në ballkon, shurdhëria e shtëpisë, ditët e vetmuara, dëshpërimi, mosrealizimet, e rilidhja me Trinën ndërtojnë parapërgatitjen e vdekjes së dytë me shprehjet: *E n'balkue mbaruene lulet:/ shurdh á vendi e shpija tytë.../ Vetun zbadh' e vetun erret... / E disprohet me vetvédi... /.. E disprohet ke i ve mëndja / Or'e çast te Trina e shkreta!*

2. Krizantema, lulja e varreve hap strofën e parë; veriu që cungon çdo gjë, i varfri dhe duhitë, bora, veriu, akulli, vajtimi i përnatshëm i Lokes, ndjellja e vdekjes, fryma mistike mjaftojnë për të kuptuar dhe ndjerë vdekjen e saj, sidomos nëse përqendrohemi te fjalët më goditëse, theksuese. ...*krisantemi.../ Vetun vorreve lulzon; Landët.../ Tui fry veri po i cungon- pra po ndodh. Bite bor.../...çue akull...renditen elementët; ...plaka/Rri gjith natën e vajton; E lerg morden tui kositun/ E kujton e pan' e thret.* Kjo vdekje që i rrotullohet Lokes *U ndie'j frymë perbrënda shpijet/ posi ërë që vjen pa shkas...*; Ulja e krahëve, shtrëngimi, puthja e vdekjes, të kujton sesi prania e Hyjit te njeriu është e përhershme e njëkohësisht misterioze.

Koncepti i pranimit të vdekjes përmes teknikave parapërgatitëse që vijnë me ndihmën e inventio-s, (bindjes përmes faktit) me ndihmën e gjuhës së përditshmërisë, krijojnë në vetvete mallëngjimin e çdo lexuesi të poezisë së Mjedjes. Paraqitet në një trajtë krejtësisht origjinale një pjesë e filozofisë së krishterë. Pjesë të kësaj filozofie, me gjuhën e përlësisë, Mjedja e shtrin edhe te cikli i poezive fetare. Tipike është poezia *T' thirrun me hii n' zemër t' krishtit* apo *Ankim dashnijet zembrës krishtit* e cila në thelb ka të bëjë me njohjen e vetes, pasi zemra në doktrinën kristiane mendohet se është pjesa njerëzore, e cila mbart të mirat e të këqijat dhe se aty ndërtohet shpirti.

Për sa trajtuam më sipër, mund të themi se, Mjedja është i vetëdijshëm në krijimtarinë e tij për të trupëzuar, figuruar estetikën moderne në elementë të cilët rrinë shumë mirë me elementët neoklasikë e romantikë të poezisë së tij. Është një poetikë shumëzërëshe ajo e tij, pasi mishëron një strukturalitet elementësh të cilët bëhen konstantë dhe identifikues të saj. Kjo poetikë shpalos kompetencat e tij letrare, gjuhësore, etiko-filozofike, historike etj. – duke na dhënë profilin e një eruditi, poeti të fuqishëm ndjenjash të holla e delikate, por edhe kontrastesh, fateve/fakteve tragjike, etj. Përpunimi deri në detaje i vargjeve, ndërtimi i një poezie mallëngjyese që shfrytëzon triket gjuhësore e retorike; funksionalizimi i elementeve poetikë të ndryshëm që nga riaktivizimi i fjalëve të rralla deri te liritë e rrafshit gramatikor e sintaksor, rimarrjet e fjalëve çelës të teksteve të tij, ‘rrjeta’ semiotike ku sendërtohet loja e metaforave transformuese që përmban koncepte, si: jeta, ëndrra, vdekja vetmia etj. e bëjnë atë ndër poetët më unikë të sistemit tonë letrar. Ndaj rileximi i veprës së tij cilësore me çelësa të rinj interpretimi fton në një komunikim të pashtershëm esencial letrar edhe lexuesin e ri sot.

Referenca:

- Ameka, Felix. (1992). "Interjections: the Universal yet Neglected Part of Speech". *Journal of Pragmatics*, nr.18.
- Bart, Rolan. (1987). *Aventura semiologjike*. Prishtinë: Rilindja.
- Bihiku, Koço. (1980) *Histoire de la literature Albanaise*. Tiranë: 8 Nëntori.
- Capparozzo, Giuseppe. (1851). *Poesie dell'abate Giuseppe Capparozzo*. Vicenza. Stabilimento tipo-litogra. Prov. Di g. LONGO.
- Çoba, L. (1964). "Një dokument tjetër mbi jetën e Mjedjes", *Mësuesi*, nr. 6, shkurt, f. 3
- Eco, Umberto. (2007). *Per letërsinë*. Tiranë: Dituria.
- Elsie, Robert. (2001). *Historia e letërsisë shqiptare*. Pejë: Dukagjini.
- Elsie, Robert. (2006). *Letërsia shqipe. Një histori e shkurtër*. Tiranë: Skanderbeg books, 2006.
- Ferber, Michael. (2007). *A dictionary of literary symbols*. 2-ed edit. Cambridge: Cambridge University Press.
- Friedrich, Hugo. (2002). *La struttura della lirica moderna*. Milano: Garzanti Editore.
- Gurakuqi, Mark (1964). *Juvenilia dhe vepra të tjera*. Tiranë: Ndërmarrja shtetërore e botimeve "Naim Frashëri".
- Gurakuqi, Mark. (1980). *Mbi veprën poetike të Ndre Mjedjes*. [parathënia nga V. Bala] Tiranë: Naim Frashëri.
- Hamiti, Sabri. (2002). *Vepra letrare 7 [Letërsia filobiblike. Letërsia romantike]*. Prishtinë: Faik Konica.
- Historia e letërsisë shqipe II*. (1959). Tiranë: USHT. IGJL.
- Historia e letërsisë shqiptare*. (1983). Tiranë: ASHSH.
- Krasniqi, Gazmend. (2013). *Nga Papa Gjon Pali i dytë te Nënë Tereza, Ndre Mjedja në Krakov*.
<https://gazmendkrasniqi.blogspot.com/2013/07/nga-papa-gjon-pali-ii-te-nene-tereza.html>

- Kryeziu, Resmije. (2008). *Nga lindja në perëndim: Aspekte të mendimit kritik shqiptar 1913-1944*. Prishtinë: IAP.
- Macaj, Edlira. (2015). *Botëkuptimi kristian, formante thelbësore e poetikës mjedjane*, në: Seminari XXXIV Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare: Letërsia dhe Religjioni, organizuar nga UP&UT, dt. 22-27 gusht 2015, Prishtinë, Kosovë.
- Macaj, Edlira. (2019). “Lojë andrimesh në katër modele ((Mjedja, Koliqi, Camaj, Zorba)”, *Revista/Journal* 38/ 2, f. 21-35
- Mjedja, Ndre. (1917). *Juvenilja*. Vjenë: GJ.M.Vernay.
- Mjedja, Ndre. (1928). *Juvenilja*. Shkodër: Shtypshkronja “Zoja e Papërlyeme”.
- Mjedja, Ndre. (1988). *Vepra poetike 2*. Tiranë: Naim Frashëri.
- Ndre Mjedja. (1978). *Poezi*. Tiranë: Naim Frashëri.
- Osja, Vjollca. (2014). *Aspekte të ligjërimit në poezinë e Mjedjes, Poradecit, Nolit dhe Migjenit*. Tiranë: Elve.
- Qosja, Rexhep. (2010). *Vepra X*. [Semantika e ndryshimeve historiko-letrare]. Prishtinë: Instituti Albanologjik.
- Vjersha dhe Poema*. (2006). Bot. i 2-të i zgjeruar. Tiranë: Pakti.

Evalda PACI

KULTURA EVROPIANE E LËVRIMIT LIBROR SI NJË ASPEKT FORMËSIMI NË VEPRAT E LETËRSISË SË VJETËR SHQIPE

Abstrakt:

Ndikimet e kulturës librore evropiane në çështje të përpilimit të librit të shtypur shqip përbëjnë një argument të gjerë në pikëpamje të shtjellimit të mundshëm analitik në një perspektivë aktuale, por dhe të një tradite gjurmimesh që ka ardhur e plotë dhe e arsyetuar në kohë, veçanërisht në dekadat e fundit. Vetë orientimi i studiuesve ndaj njohjes së historikut të veprave të caktuara të letërsisë së vjetër shqipe është i lidhur natyrshëm me konfigurimin e qerthujve kulturorë në shekujt XVI e më tej, bashkë me shkëmbimet e mundshme kulturore mes qendrash të zhvillimit të editorisë dhe praktikës së shtypjes së librave. Si një periudhë që u shoqërua me një sërë zhvillimesh në pikëpamje të përhapjes së librit kishtar, por dhe të traktateve shkencore që kanë të bëjnë me disiplinat më të trajtuara në kapërcyell të shekujve të përrurimit të shtypshkrimit, shekulli XVI e dekadat pasuese mbeten të karakterizuara nga ardhja e veprave që dëshmojnë përveç qenësisë tematike dhe aspekteve më të veçanta, edhe praninë e elementeve të një kulture evropiane, që reflektohet qartësisht në përmbajtjen dhe ndërtimin e mjaft veprave të kësaj kohe. Lidhje të mundshme mes autorësh e veprash përkatëse në gjuhën latine dhe në gjuhën shqipe përgjatë Pesëqindës janë ndër të tjera një tjetër orientim për të arritur në mënyrë konkrete në gjurmimin e këtyre ndikimeve.

Si një nga argumentet që shërbejnë për të introduktuar punimet e sprovat mbi historinë e shkrimit, të letërsisë sonë të shkruar e të një panorame të dëshimit me shkrim të shqipes sonë, çështja e qasjeve dhe e tipareve shkrimore në veprat e letërsisë së vjetër shqipe përbën përherë një argument kompleks për studiuesit e vetë historisë së kësaj tradite.

Falë zgjerimit të këndvështrimeve gjegjëse mbi një periudhë që ngërthen një sërë interesash kërkimore e që bën të mundur që disiplinat më të rëndësishme studimore të ndërthurin objektin e vëzhgimeve e të qasjeve, letërsia e vjetër shqipe ka ardhur konsiderueshëm në vëmendjen e studimeve albanologjike në dekadat e fundit.

Nënvizimi i rëndësisë së disponimit të teksteve përkatëse në variante të përafuara sa i përket tejshkrimit dhe interpretimeve grafematike që bëjnë të mundur një përballje më të lehtësuar me vetë pjesët e veprave, por dhe vetë ecuria e vështrimeve që i japin peshën e duhur orientimit të autorëve të kësaj periudhe janë prirje që lehtësisht mund t'i gjejmë të konkretizuara në studime, sprova, përpjekje për t'i kontekstualizuar këto të fundit dhe në punime e punë që reflektojnë për nga metodologjia e perspektiva një qasje komplekse ndaj një harku kohor për të cilin ka vend akoma të flitet e të shkruhet.

Tribunat shkencore të viteve të fundit kanë qenë një mundësi e mirë për të pasur në vëmendje autorë, iniciativa, revista shkencore, buletine, por dhe kolana botimesh të cilat dhe vite më parë u bënë vatër e reflektimit të rëndësisë që mbart për kulturën tonë dëshmimi shkrimor e tërësia e përpilimeve që i kemi emërtuar më së shumti nën përveçimin e letërsisë së vjetër shqipe. Edhe çështjet e dokumenteve fragmentare, të bëra në vijimësi objekt hulumtimi nga studiues të paleografisë e të historisë së shkrimeve të vjetra u trajtuan në të përkohshme që i dhanë zë një argumenti të tillë, për t'u reflektuar më tej në punime më të plota, siç paraqitet rasti i ndihmesave konkrete të Namik Resselit disa dekada më parë në lidhje me ato që ai vetë i emërton si *I più antichi testi albanesi* (Giappichelli editore, Torino, 1978).

Individualitete të letrave shqipe, të gjurmimeve albanologjike ditën të reflektojnë idetë e shprehura që në fillim të shekullit të kaluar mbi metodologjinë e sjelljes së teksteve të hershme shqipe në variante ekdotike, të cilat përveç një pune paraprake përherë për t'u orientuar ndaj kriteresh e parimesh të një discipline unike siç paraqitet filologjia e tekstit, janë një prej përafprimeve më të para me veprat e kësaj letërsie, qenësore sa i përket vetë

konceptimit të punimeve që marrin përsipër të trajtojnë periudhën, autorët dhe vetë brendinë e përpilimeve të tyre. Si arritje e përpjekje me një vlerë të qartë referenciale për vetë kohën në të cilën u realizuan, në përputhje me prirje të konkretizuara në objektivat e revistave shkencore të fillimit të shekullit të kaluar, por dhe të vlefshme në çdo fazë të mëvonë të rimarrjes në diskutim të së njëjtës tematikë apo problematikë, këta hapa të mëparshëm në arritjet e qasjeve filologjike rivijnë në vëmendjen e çdo studiuesi që ndërmerr ndër të tjera dhe parashtrimin e një panorame kontributesh të cilat kanë bërë të mundur rindërtimin e një ecurie të gjatë, me një sërë gurësh miliarë, si prova kujtese të një itinerari me veçori e veçanësi të shpjegueshme në disa vështrime.

Periudha në fjalë, e parë qoftë në vetë spektrin e përfshirjes së realizimit të disa veprave me tematikë të përafërt e me paracaktim që mund të interpretohet dhe si kushtëzuese ndaj normave të caktuara në të shkruarit e tyre, në vetvete mbart jo pak ndryshime, që të realizuara dhe në kohë të afërt e në hapësira të ngushta, pothuaj të njëpasnjëshme, e bën më interesante trajtimin e kësaj tërësie, që ngërthen shekujt e konsolidimit të veprimtarisë së enteve të shtypshkrimit, por në të njëjtën kohë dhe vetëdijesimin e rolit të mbikëqyrësve të përmbajtjes e të veprave të caktuara.

Periudha tipike që u shoqëruan me zhvillime vendimtare në çështje të doktrinës, kulturës së librit, gjuhëve në të cilat kjo e fundit paraqitej e afirmuar do të jetë e shënuar dhe nga lindja e mekanizmave që zënë fill pikërisht nga pikëpamje jo të njëjta në shkallë institucionesh në lidhje me këto të fundit, të evidentuara në një sërë tekstesh që në ditët e sotme kanë një rëndësi më të madhe në vështrim të kontekstualizimit të çdo ecurie e ndryshimi.

Disiplina të letërsisë, përpilime e traktate me orientim të qartë kah filozofia e mendimit njerëzor, por dhe prirjet krijuese në sjelljen e motiveve më të rëndësishme nga tekstet biblike u bënë objekt i indekseve të librave që emërtohen njëzëri me siglën *Index librorum prohibitorum*, ekzistues (duhet vënë në dukje) dhe në areale jashtë veprimit të ngushtë apo të drejtpërdrejtë të Selisë së Shenjtë. Si dëshmi përpjekjesh të përsëritura shekuj më parë në lidhje me prodhimtarinë librare, por dhe të veprave që iniciohen nga autorë që më vonë janë rikthyer në një vend të merituar në kuadër të hapësirës sociokulturore së cilës i përkisnin, të tilla indekse janë ndër të tjera një mjet i dobishëm në lidhje me një sërë evidencimesh: nga emrat e përveçëm dhe

ubikimet e mundshme gjeografike, përkatësia individuale dhe tematikat e veprave, por dhe një panoramë e shtrirjes dhe e mundshmërisë së njohjes dhe konsultimit të tyre në çështje të receptimit intelektual e kulturor.

Me kalimin e kohës, me thellimin e kërkimeve në veçanti pas mundësimit të konsultimit të arkivave të Kongregacionit mbi indekset, por dhe me përjasjet me të tjera indekse që kanë dalë nga të tjera areale, por janë pjesë e së njëjtës panoramë studimore, nevoja e konsultimit të burimeve të kësaj natyre shoqëron dhe vetë trajtesat konkrete të studiuesve të dekadave të fundit që dhe si përpilues korpusesh me përmbajtjen e këtyre indekseve, por dhe si parashtrues e shtjellues të kontekstit përkatës, mbeten zërat më autoritarë dhe në vështrim të evidentimit të dukurive që shoqërojnë vetë periudhën e shfaqjes së tyre, përfshirë mosaprovimet/reagimet jo të rralla apo një terminologji tipike që lidhet me kushtëzimin e lexueshmërisë së veprave të caktuara. Kjo e fundit përbën, në të vërtetë, një prej shtysave konkrete për ta brendësuar në mënyrë objektive klimën e receptimit të indekseve, të cilat janë instrumente të një kuadri të mirëfilltë që ka të bëjë me censurën kish-tare e me vetë rrjedhojat e vendosjes së saj në lidhje me prodhimtarinë librore të kohës.

Interpretimet mbi vlefshmërinë e mekanizmave të tillë, por dhe mbi efektet në lexueshmërinë apo qarkullimin e librave e të veprave me një autorësi të mirënjohur në qarqet e kulturës e të njohjes së disiplinave humane janë të ndryshme, madje paraqiten komplekse dhe nëse për më tepër vendosen në vështrime që marrin përsipër të konsiderojnë dhe receptimin e veprave me një inicim të qartë në kontekstet në të cilat gjeti hapësirë dhe frymëmarrje reforma e shumëpërmendur falë personaliteteve të kohës, ndër të cilat pa dyshim veçohet Luteri apo më tej, Erazmi (1469-1536), që mbeten më eminente për nga prirjet dhe pikëpamjet. Qasjet ndaj varianteve të konsideruara më autentike e mbi të cilat u mbështetën dhe për të përpiluar botime të plota të pjesëve biblike (veçojmë këtu pikërisht Testamentin e Ri të kujdesuar nga Erazmi), në të vërtetë, qenë shtysë për të zgjeruar një panoramë botimesh që paraqiten komplekse dhe për faktin e pranëvënies së teksteve në gjuhë të ndryshme, ndër të cilat përmendim si të trajtuar dhe në studime të posaçme rastin e greqishtes e të gjuhës latine, në botimin e vitit 1516 (Novum instrumentum omne) e më tej në vitin 1519 (Novum Testamentum) pikërisht nga ky i fundit.

Indekset e librave të cilat duheshin rishikuar, rikonceptuar, ndaluar, qar-kulluar pas një mbikëqyrjeje autoriale të këshilluar nga autoritete të përmendura në aktet e Koncilit Tridentin janë, në të vërtetë, një pasqyrë e mirëfilltë e një pasurie të pamatë botimesh, të cilat do t'i ofroheshin lexuesit, por dhe çdo autoriteti të kohës në një sasi më të madhe për nga numri i kopjeve qoftë falë teknologjisë së re që lejonte shumëfishimin e realizuar në një kohë të shpejtë, qoftë dhe interesit të shtuar për të ditur më shumë e më qartë mbi pikëpamje që ishin diskutuar gjerësisht e në rrethe të censurës kishtarë, por dhe në ato universitare ekzistuese.

Aktualisht, disponimi i përmbytjes së indekseve të tilla ofron mundësinë dhe për të njohur një larmi përpilimesh që për nga tematika paraqiten të përcaktuara deri në njëfarë mase, por njëkohësisht kur shoqërohen me emrin e autorit përbëjnë të dhëna me vlerë për zhvillimet e botës së lëvrimit të kulturës së librit në atë kohë.

Dallimet mes indekseve, në disa raste mjaft të afërta në kohë për arsye të vijimësisë së autoritetit pontifikal apo papnor janë një tjetër shenjë e rëndësishme për të nënkuptuar nevojën për rishikime dhe ndaj vetë rregullave që mbas përmbylljes së Koncilit Tridentin paraqiteshin të artikuluar në radhë dhe në botimet e mëvonshme të së njëjtës tematikë. Një sërë kongregatash do të shfaqen me emërtime të përveçme, duke bërë të nënkuptohet sërish shkalla e rëndësisë së vënies në dijeni dhe e analizimit të vëllimeve të veçanta, në mjaft raste të lidhura me emra autorësh që do të shënojnë më tej një fazë të re në zhvillimet e kulturës së librit kishtar, njohjes e qarkullimit të tij, por dhe në atë të veprave të orientuara nga shkencat e natyrës, po aq të ekspozuara ndaj vëmendjes së të njëjtës hierarki në shekullin XVII.

Koncilin tridentin (1545-1563) si ngjarje që zgjati jo pak vite e që bëri të mundur të rridhnin ndërkohë mjaft ujëra në kahet e Reformës dhe në atë të Kundërreformës do ta gjejmë të përmendur qartë në përpilimet e Pjetër Budit,¹ ndërkohë që figurat autoritare që lidhen për nga ofiqi dhe roli që u ishte

¹ Shih ndër të tjera dhe përmendjen e këtij koncili në faqet e teksteve hyrëse të botimit të vitit 1621 të Ritualit Romak (përkatesisht në faqen 7 e në faqen 11 prej vetë përpiluesit), në faqen e parë të të cilit do të gjejmë shprehimisht të nënvizuar punën prej shqipëruesi të Pjetër Budit, për të përkthyer në gjuhën tonë Ritualin, në kohë të pontifikatit të Gregorit XV. Me interes në këto të fundit paraqiten dhe pasazhet në të cilat bëhet fjalë për libra të veçantë (*breviarë, mesharë*), të bërë objekt i reformimit kishtar.

dhënë me vetë hierarkinë e miratimit të veprave për botim do të jenë të cilësuar në mënyrë të qartë në tekstet përkatëse të Dicionarit latinisht-shqip të Frang Bardhit, që botohet në Romë në vitin 1635 nën një përkujdesje të natyrës institucionale. Nuk është rastësore rëndësia që këtyre figurave u jepet në studimet më të fundit mbi censurën kishtarë dhe botimet e teksteve biblike në gjuhët vernakolare, ndër të cilat përmenden e cilësohen shprehimisht disa të tilla, një pjesë e mirë në një hapësirë gjeokulturore që rrok dhe viset më veriore të Evropës. Është më se e qartë që këto prirje të konkretizuara në dekretet që reflektohen në përmbyllje të Koncilit Tridentin dhe në një sërë rregullash që më tej do të marrin një profil më të përcaktuar, përfshijnë në pikëpamje gjeokulturore një sërë vendesh që lidhen si me traditën e besimit të krishterë e me kultivimin përkatës, ashtu dhe me ndryshimet që të shfaqura pashmangshmërisht të pakthyeshme, u dhanë shtysë zhvillimeve të mëtejme, që shënuan në të njëjtën kohë edhe botën e librit e kulturën e lëvritimit të tij. Por fakti që i gjejmë të bërë objekt cilësimi nga autorët e letërsisë sonë të shkruar të gjysmës së parë të shekullit XVII nënkupton mjaft dhe për njëkohjen e një ecurie aspak të lehtë, nëse kemi parasysh në sa vite u zgjat një koncil kishtar që gjithsesi paraprihej nga një tjetër i ngjashëm, siç mund të konsiderohet ai i Lateranit, i mbajtur në periudhën 1512-1517, që rrok sundimin e dy papëve të ndryshëm.

Një ecuri e tillë është e mundur të ndiqet në një sërë dokumentimesh shkrimore: kemi parasysh dhe elemente të veçanta tekstore të cilat më parë i kemi bërë objekt dhe në rasë të shqyrtimit të emërtesave të përdorura në lidhje me këto shkallë hierarkike në vëllimin e akteve të Kuvendit të parë të Arbënit, botuar së pari në vitin 1706, jo dhe aq shumë vjet mbas realizimit të përpilimeve që u cituan më sipër, të dala nga shtypi në rrethana që janë qartësuar më herët në studimet tona mbi shkrimin shqip dhe historikun e veprave të caktuara.

Përtej këtyre vërejtjeve të domosdoshme mbi kronologjinë e realizimit të përpilimeve që lidhen me dëshmimin shkrimor në gjuhën tonë e që reflektohen në punime dhe të kohëve të fundit, duhet vënë në dukje që pikërisht fundi i shekullit XVI e zhvillimet që do të pasojnë e bëhen konkrete përgjatë shekullit pasues përfshijnë dhe tekstet në gjuhën tonë, të cilat trajtohen në një sërë disiplinash me objekt vështrimet diakronike mbi gjuhën, letërsinë, shkrimin dhe kulturën tonë.

Në këtë panoramë të njohur për nga elementet që e përbëjnë, mbeten për t'u saktësuar të dhëna që dija mbi tipografitë aktive gjatë Pesëqindës dhe zhvillimet e teknologjisë së shtypshkrimit në këtë periudhë kohore do të mund t'i bëjë më konkrete dhe afër një konteksti që në lidhje me vepra të tjera të së njëjtës tematikë paraqitet më i zbërthyeshëm për një sërë arsyes. Një kulturë tipike që karakterizon një kuadër të lidhur si me shtypshkrimin si nocion e tërësi procesesh, si me veçantitë e arealeve gjeokulturore të Evropës e me vise të caktuara të saj, do të mund të përvijohet me anë vizatimesh panoramike, që paraqesin një klimë komplekse, sigurisht johomogjene, por dhe të tipizuar pikërisht nga të tilla dallime e elemente të përveçme.²

Në një diversitet të dhënash të disponueshme mbi vepra që i përbashkon një tematikë apo një sërë objektivash që në viset e Ballkanit u reflektuan dhe në botime në gjuhët e vendeve në të cilat ushtrohej ndikimi i kishës së Romës, qëmtimi i një kulture evropiane të shtypshkrimit gjurmohet në disa drejtime apo në disa elemente, ndër të cilat më së pari veçojmë ato që i përfaqësojnë veprat, më tej, dhe vetë cilësimet e tyre në regeste, buletine e dokumentime të kohës, por dhe në analiza të mëvona, në të cilat njohja e këtyre të fundit spikat në çështje të përmbajtjes dhe të reflektimit të prirjeve të kohës. Një kulturë e tillë, që maturohet në procese të një interesimi intelektual që kapërcen kufij të ngushtë të ndarjeve gjeografike, por që mbart dhe tipare të veçanësisë kulturore të viseve në të cilat gjeti strehën e parë, u konsolidua në kushte të ndeshjeve mes prirjeve më të fuqishme dhe aktive në mendësinë e njerëzve të letrave, duke ushtruar rol dhe në një aparat të fuqishëm administrativ që reflektoi në artikulime normash e rregullash një të-

² Në lidhje me qytetet italiane të cilat dhe në lidhje me veprat e letërsisë së shkruar shqipe të shekullit XVII ndërmenden në sprovat mbi historikun e tyre, mund të thuhet se dallohen dhe nga tipologjia e veprave që dalin në dritë të shtypit në një ndarje të tillë kohore. Venediku bëhet i njohur për vepra të karakterit juridik apo filozofik e shkencor, në Milano e Firenze mbizotërojnë vepra të karakterit fetar apo letrar, me autorë klasikë apo humanistë. Në Francë, në shekullin XV shtypshkrimi paraqitet i përqendruar kryesisht në Paris dhe në Lion, duke qenë se mund të flitet dhe për veprimtari të orientuar ndaj botimesh tematike nga letërsia humaniste. Ndër autorët latinë që përurohen në këtë periudhë në arealin francez të sipërcituar rezultojnë pikërisht Salusti, Ciceroni, Flori, Juvenali, por nuk duhet lënë pa përmendur dhe rimarrja e modeleve epistolare në gjuhën latine që bën të mundur të përfshihen në këto ndërmarrje editoriale vepra autorësh humanistë si p.sh., Gasparino Barzizza (1360-1431).

rësi nenesh mbi botimet, përhapjen e tyre, lejimin e moslejimin, si dhe kushtet e realizimit të tyre në areale të caktuara të lëvrimin të kulturës së përdorimit të librit.

Në kushtet e konkretizimit të veprave të tilla, ndryshimet në areale jo vetëm të lidhura me kulturën, por dhe me zhvillime thelbësore që shënuan shoqërinë evropiane për nga vendi e roli i hierarkisë administrative e fetare, vëmendja ndaj letërsisë së vjetër shqipe gjen grishje, përveç se pasurohet me të dhënat që së fundmi ofruan studiues të vetë periudhës, por dhe të tipologjisë së zhvillimeve që u aktualizuan në qendra *par excellence* të një kulture librore, me një sërë veçanësish që diktohen nga fuqia e hierarkut, aktiviteti gjegjës editorial e tipografik, aspekti ekonomik e komercial etj. Këto kontekste, me tipare dalluese për një sërë arsyes janë dhe burimet në vijim të hulumtimeve mbi libra të veçantë, por dhe mbi burime të mundshme mbi ekzemplarë që mund të paraqiten të ngjashëm, por dhe me dallime në ndërtim, apo në çështje të proceseve që paraprijnë e njëkohësisht mbështesin daljen në dritë të shtypit të veprave të caktuara.

Letërsia kishtarë shqipe, e konceptuar më së pari si periudhë më vete, më tej e bërë objekt nga disa këndvështrime, me domosdoshmëri dhe përmasën historiografike e të qëmtimit të elementeve të kulturës së shtypshkrimit që reflektohet në çdo përpilim që e përfaqëson këtë traditë letrare e shkrimore, ka grishur gjerësisht interesa studimore që paraqiten më bindëse në kushtet kur gjurmimet ndaj përmbajtjes së indekseve të librave të ndaluar përqendrohen në rimarrjen e tyre në momente të caktuara të rishikimit apo rikonceptimit, duke bërë të mundur dhe njohjen nga afër të tematikave që nga indeksi në indeks ndryshojnë në disa tipare. Indekset në vetvete janë pasqyrë e një skeme a skemash institucionale që kanë gjetur riorganizim apo konfirmim në një sërë mekanizmash që u gjallëruan pas Konkilit Tridentin, që për nga rëndësia, pavarësisht nga zgjatja në kohë, përbën një prej shtysave më qenësore në pikëpamje të avancimit të modeleve librore apo reformimit të librave të veçantë, me tematikë të përcaktuar e të lidhur me vetë prirjet e koncilin.

Zhvillimet që u parapërgatitën në dekada tipike të Mesjetës së vonë evropiane (e që për jo pak studiues konsiderohet dhe fillimi i një historie të modernitetit në Evropë), ndikuan në përcaktimin e një sërë rolesh, e një fakt i tillë përfshin gjerësisht hierarkitë e kohës: ato fetare, (ato që do të inicionin e bëheshin shtysë për reformat), por dhe ato administrative. Ndarjet mes tyre

nuk janë përfundimtare si në vështrimin sinkronik, si në vështrimet e mëvonave të studiuesve të periudhave që do të vlerësojnë ndër të tjera rëndësinë e një teknologjie (shtypshkrimit) në afirmimin më të vendosur të prirjeve më të rëndësishme, që sollën dhe nënvizimin më autoritar të këtyre hierarkive. Si mjete për ta nënvizuar një prani të tillë, por dhe për ta bërë në njëfarë mënyrë të jetë e konkretizuar në gjurmët e botimeve, librat e shtypur bartin në tipologjitë përkatëse, pa përjashtuar vetë tematikën që lidhet si me orientime të caktuara, ashtu dhe me iniciativa të arealeve të caktuara kulturore e gjeokulturore, dëshmitë e autoriteteve të tilla, që gjithsesi lidhen me mbikëqyrjen e botimit dhe me vetë fatin e secilit. Është e qartë që një problematikë e tillë ka një terminologji të vetën që e karakterizon që në elementet e veprave të kësaj periudhe, por dhe në vetë studimet specialistike që janë mbështetur gjerësisht në tipare të përvijimit të teksteve të këtyre botimeve, si dhe në emërtesa më të përveçme, që lidhen me vetë kuadrin e gjerë kulturor përkatës.³

Nuk është rastësi e as fakt periferik që në rasë të shtjellimit të proceseve të riprodhimit të librave, veprave, sprovave të caktuara, që në krye të herës, studiuesit e historisë së prodhimitarisë librare vërejnë e nënvizojnë praninë e një kolofoni apo pasthënieje, hollësitë që gjenden në të, apo që duhet të ishin konform praktikave të ndjekura në areale të caktuara që njiheshin për lëvrimin e kulturës librare në kushte të avancimit të teknologjive të shtypit. Jo rrallë, dhe vetë çështjet e autorësisë së veprave apo traktateve të caktuara janë parë të lidhura ngushtë me të tilla elemente, që jo vetëm mbeten qenësore në kuptimin e përfaqësimit të vetë veprës, por dhe në pikëpamje të përvijimit të një historiku përkatës, që mbetet unik si çdo përpilim duhet të jetë në vetvete. Në këtë vështrim, dhe vetë historiku i veprave të caktuara të letërsisë sonë të shekujve XVI-XVII, në veçanti në dritë të pasurimit me të dhëna të reja mbi profilet e veprimtaritë konkrete të tipografive të caktuara, mbetet një gurrë për t'u hulumtuar më tej e në orientime të disiplinave studimore mbi librin e shtypur në kontekst evropian.

³ Institucionalizimi i botimeve dhe i lejimit të tyre përbën një karakteristikë sa qenësore, aq dhe të rëndësishme në vështrim të vijimësisë së ekzistencës së hallkave përkatëse, që me gjithë ndryshimet që kanë pësuar në kohë të ndryshme, mbeten elemente të cilat çdo studiues i kërkon t'i njohë e t'i vlerësojë në kushtet e analizës së veprave të caktuara.

Bibliografi:

- Bainton R., *La riforma protestante*, Einaudi editore, Torino, 2000.
- Baldacchini L., *Lineamenti di bibliologia*, La Nuova Italia scientifica, Romë, 1992.
- Baldacchini L., *Il libro antico, (nuova ed. aggiornata)*, Carocci editore, Romë, 2001.
- Barbierato F., *La rovina di Venetia in materia de' libri prohibiti*, Letteratura universale; Albrizziana, 2007.
- Bellini G., *Storia della Tipografia del Seminario di Padova (1684-1939)*, Gregoriana editrice, 1938.
- Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shëjzat, Romë, 1960.
- Demiraj B., *Areali kulturor i Veriut në shekujt XVI-XIX*, Botime Onufri, Tiranë, 2017.
- Fragno F., *La censura ecclesiastica in Italia: volgarizzamenti biblici e letteratura all'Indice. Bilancio degli studi e prospettive di ricerca*, në *Reading and censorship in Early Modern Europe*, Barcelonë, 2010.
- Fragno G., *La Bibbia al rogo: la censura ecclesiastica e i volgarizzamenti della Scrittura: 1471-1605*, Il Mulino, Bologna, 2015.
- Jambrek S., *The Bible in the time of the Reformation*, në *Kairos, Evangelical Journal of Theology*, vol.IV, n.1, 2010.
- Omari A., *Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2016.
- Marchocchi M., Scarpati C., Acerbi A., Alberigo G., *Il Concilio di Trento: Istanze di Riforma e aspetti dottrinali*, Vita e pensiero, Milano, 1997.
- Paci E., *Rreth historisë së librit shqip dhe kulturës së njohjes së tij në një kontekst zhvillimesh evropiane (shekujt XVI-XVII)*, në *Studime filologjike*, n.1-2, 2021.
- Paci E., *Koncili i Trentit (1545-1563) në një panoramë vëzhgimesh mes historiografisë dhe studimeve letrare*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2022.

- Paci E., *Rreth një vështrimi sistemor mbi inicimin e lëvrimit të shkrimit shqip dhe reflektime të mundshme të zhvillimeve evropiane (shekujt XVI-XVII)*, në *Studime mbi autorë e vepra të patrajtuara në letërsinë shqipe*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2022.
- Ressuli N., *Il "Messale" di Giovanni Buzuku, riproduzione e trascrizione*, Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958.
- Ressuli N., *I più antichi albanesi*, Giappichelli editore, Torino, 1978.
- Rozzo U., *Biblioteche italiane del Cinquecento tra Riforma e Controriforma*, Udine, 1994.
- Rugova Y., *Tipografia shqiptare (1555-1912)*, Botime Varg e Berk, Prishtinë, 2022.
- Suta B., *Faqe të panjohura nga vepra e Pjetër Budit (1618-1622)*, Botime Onufri, Tiranë, 2016.

Ermir XHINDI

OBJEKTE TË KOMPETENCËS NDËRKULTURORE DHE PRAGMATIKA E RE E LEXIMIT: “AUTOMOBILI” NË LETËRSINË SHQIPE

Abstrakt:

Për arsye relativisht të njohura, të rrethanave të posaçme, letërsia shqipe ka zhvilluar një përmasë të domosdoshmërisë funksionale, zakonisht ideologjike. Struktura e teksteve është kryer në lexim përmes një rendi veprimesh, që ia nënshtronte pragmatikën e vet kësaj “domosdoshmërie”, çka nënkupton përvetësimin në kompetencë të çdo elementi në shërbim të një kuptimi, që zakonisht ka qenë edhe qëllim i teksteve, edhe vullnet i lexuesit - edhe paragjykim i leximit kritik. Në këtë esencjalizim të pashmangshëm kuptimor ideologjik e filozofik të teksteve, elementet e strukturës janë “përpunuar” nga kompetenca, varësisht atij kuptimi, shpesh duke e përligjur vetë ekzistencën e tyre me atë funksion të varësisë. Qëllimi i kësaj pune është rimarrja e këtij diskutimi mbi statusin funksional të këtyre elementeve të tekstit në kompetencën e lexuesit, përkatësisht të një “semiotike të automobilit” si objekt ndërkulturor - i ngjashëm funksionalisht me plot elemente të tjera në letërsinë shqipe - për të hedhur dritë mbi natyrën e zhvillimeve ndërkulturore në kompetencën e lexuesit në shqip mbi një klasë qartësisht të ndërmjetme objektesh mes kulturash të ndryshme. Për një lexues të krijuar mbi hibride kulturore të kompetencës – si lexuesi shqiptar - kjo përpjekje vlen për të qartësuar një rrafsh të krahasueshëm të kompetencës ndërkulturore, të zhvillimeve të saj të brendshme, prej viteve ’30 kur automobili hyn në letërsinë shqipe me Koliqin (“Bylbylat e Plepishtit”), në letërsinë e realizmit socialist e në letërsinë e sotme shqipe. Puna synon të caktojë tipologji leximi të

funksionit mbi vlerën semiotike të automobilin si objekt global, të vlerës së marrëdhënies që ai krijon në strukturë, duke sjellë, rrjedhimisht, edhe një pragmatikë të re të leximit (kritik), qoftë mbi disa aspekte të letërsisë së traditës, qoftë mbi letërsinë e sotme shqipe.

Fjalë çelës: *letërsi shqipe, kompetencë ndërkulturore, automobil, Koliqi, Kadare, Kongoli, semiotikë strukturore, identitet, pragmatikë leximi.*

Kjo ndërhyrje synon përpjekjen e shqiptimit të një pikëpamjeje mbi tipologjinë më të shpeshtë të një formanteje të ndërveprimit kulturor të shqiptarët, mandej për ndikimin e saj - si *kompetencë e lexuesit* – në marrëdhënie me letërsinë shqipe, duke përdorur si mjet takimin e kompetencës me një objekt ndërkulturor - *automobilin*, në periudha të caktuara në disa tekste të autorëve të caktuar, përkatësisht të Ernest Koliqit, Nasho Jorgaqit e Fatos Kongolit. Në lidhje me autorët e mësipërm, punimi paraqet njëllonj *synopsis-i* mbi një normë të mundshme të *kompetencës ndërkulturore* në letërsinë shqipe dhe të mënyrës se si kryhet leximi përmes saj.

Arsyet e përzgjedhjes së këtij objekti lidhen me veçori të formantes së mësipërme kulturore, po aq sa dhe mundësinë e mirë të krahasimit me përvoja të ngjashme, të zbulimit të disa elementeve në proces.

Parakusht i pashmangshëm në diskutimin mbi çështjen e ndërkulturalizmit në letërsinë shqipe është, si gjithmonë, përmbajtja e saj terminologjike në shqip, si konstrukt e si marrëdhënie semiotike, konceptuale e pragmatike, e mandej, në procesin e vet.

Si frymë e praktikë metodologjike, ndërkulturalizmi, nga pikëpamja e studimeve letrare sot, nuk mungon të shfaqet nën një dritë optimizmi, me gjithë një të ashtuquajtur krizë identiteti të këtyre të fundit, kryesisht për shkak të imitimit e dështimit në zbatim “të metodave utilitare e sasiore të shkencave shoqërore”, çka i ka kthyer studimet letrare në “njëlloj apendiksi të sociologjisë”.

Studimet letrare, sipas këtij qëndrimi optimist, te cilit i bashkohem: “janë në një pozicion të shkëlqyer për të mbështetur thelbësisht atë që duket se është një ‘paradigmë e re e dijes’, qoftë si këqyrje e ‘elementeve të poeti-

kës', qoftë të 'strategjive stilistike' (struktorore), të cilat janë *apo mund të jenë* mes "objekteve më joshëse në këtë proces" përfshirë këtu "krijimin e platformave të reja studimore", që shënojnë epokën globale.

Studimet ndërkulturore, si pikëprerje e disiplinave të ndryshme, përkatësisht të antropologjisë, historisë, etnografisë, sociologjisë, teorisë së letërsisë - jepen në një marrëdhënie e dialog, ku mund të zbulohen e formulohen parime të reja teorike e metodologjike komplekse e më të dobishme. Në këtë rast, studimet letrare, pa e humbur autonominë e tyre, do të ndërlidhen për ndërtimin e një pikëpamjeje për shqyrtimin e dialogut mes kulturave të ndryshme, jo vetëm "prej një pikështrimi lokal, nacional apo rajonal, por global". Me gjithë paqartësinë, pikëpamja mbetet joshëse.

Në një kontekst terminologjik, *interkulturalizmi* mund të pranëvendoset me termat 'multikulturalizëm' apo 'transkulturalizëm'. Nëse kultura, siç e quan Bronislaw Malinowski "jepet si ...mekanizëm, që i ndihmon njerëzit të përballen e të zgjidhin çështje të ekzistencës", si "bashkësi koherente praktikash, besimesh e shfaqjesh", që mund të studiohen shkencërisht, si "entitete sistemike të mbyllura", vërejmë se ndaj saj mbahen dy qëndrime themelore:

njëri, funksionalist, që e sheh kulturën si tërësi të tillë, shënjuese për një bashkësi të dhënë dhe të trashëgueshme brezi pas brezi; ndërsa një perspektivë tjetër, e sheh kulturën si "gjendje të qëndrueshme të përzierjes", si një-lloj "rrjeti domethëniesh", të ndërtuar nga shenja, praktika, në një kontekst dinamik receptimi në një bashkësi të dhënë.

Versioni i *rrjetit*, siç shihet, ka një kah postmodern. Prej këtu, ai prodhon disa implikime vërtet interesante. Debati mbi natyrën e mbyllur, apo marrëdhënëse (komunikuese) të kulturës, trajtës së saj të qëndrueshme ose dinamike, është ende i gjallë. P.sh., Antony Smith, Samuel Huntington apo lëvruet të tjerë të pikëpamjes esencialiste të mbylljes, janë kundërshtuar vazhdimisht e gjerësisht nga qëndrime mbi kulturën si sistem i lëvizshëm e i ndërlidhur.

Në një kontekst tjetër terminologjik, të shfaqur si '*inter*', '*trans*' apo '*multi*'-kulturë, apo edhe intrakulturalizëm, vetë prania e termave nënkupton një lloj gjendjeje të pastër fillestare të kulturës, e cila me kohë e ka humbur qartësinë e vet, për të shkuar drejt "mbarëkulturësisë" (transculturality), të kuptuar si "lëvizje e përzierje e kulturave në afërsi, një gjendje e trupëzimit

të shumësisë kulturore, të zhvilluar nga individë e bashkësi me origjina të ndryshme”, gjendja e të cilëve është më e përhapura sot, në erën globale.

Mund të flitet edhe për një alternativë të termit, në këtë rast për termin *mbarëkulturim* (transculturation), që shenjon një gjendje të takimit të përshtatjes, kundërshtimit e shkëmbimit mes grupesh të ndryshme kulturore, zakonisht për vendet në zhvillim, ku thelbësor shfaqet sërish nocioni i *kulturës dominante*, ose jo për grupet që ndërveprojnë.

Në anën tjetër, multikulturalizmi, shërben për të cilësuar shoqëritë “që zhvillojnë një shkallë të lartë të larmisë kulturore, përmes rrjedhave të migrimit dhe hapjes për këtë larmi”. Në mënyrë më të përshtatshme termi përdoret për të cilësuar politika të caktuara, për administrimin e shoqërive tashmë të ndërlikuara në botën e sotme të inustrializuar.

Për qëllimin tonë, me interes të veçantë ka qenë marrëdhënia mes termave *ndërkulturësi* (interculturalism) – *mbarëkulturësi* (transculturality).

I pari, zakonisht, pranohet si dukuria e *takimit*, e *marrëdhënies*, e *shkëmbimit*, mes kulturave të ndryshme, zakonisht mes atyre anësore (të marginalizuara) apo të vogla me ato zotëruese (dominante). Në literaturë, inter/ndërkulturalizmi përfshin edhe një semantikë të kundërvënies, të tensionit në marrëdhëniet mes kulturave.

Mbarëkulturësia (transculturality) përballë, cilësohet mbi "mungesën (përkatësisht) të kufijve të qartë kulturorë, të ndryshimit, të prirjes për kundërvënie, të cilat janë premisa të komentit tradicional, esencialist, të sipërpërmendur”. Çështje e diskutueshme këtu mbetet spekulimi mbi origjinën e grupeve kulturore, por për ne ka qenë me interes aspekti funksional i gjendjes.

Në këtë mënyrë mbarëkulturësia shenjon të përbashkëtën, ndërlidhjen, rrjedhën e ndërveprimeve përkatëse në kulturë, ku komunikimi a ndryshimi ndodhin krahas kundërvënies. Mbarëkulturësia, në premisën e vet, nuk mbështet dualitetin apo polarizimin mes njësisish thelbësisht të ndryshme apo mundësisht në kundërvënie.

Me të drejtë, theksohet se termi *interkulturalizëm* mbart disa implikime komplekse, sot, disa prej të cilave të natyrës politike, ideologjike, estetike e filozofike, të cilat e kanë tejkaluar me kohë semantikën fillestare të termit.

Pranimi i ndërkulturalizmit si çështje filozofike e estetike, e përfshin atë, në një program më të gjerë, të ngjashëm me postmodernizmin, siç e përkufi-

zon, Jean François Lyotard në *Postmodern Condition: A Report on Knowledge*, sipas tij, e dukshme është njëlloj krize e kategorizimit, që shpie në barasvlera e kjo, nga ana e saj, shpie në mungesë të një prirjeje cilësuese, kryesore, të një uniteti të dhënë kulturor. Sidoqoftë, edhe në kontekstin post-modern, ka një realitet të “elementeve të ndryshimit”, pavarësisht nga interpretimi mbi një filozofi të barazvlerës kulturore.

Interkulturalizmi pranohet si rubrikë e “përfshirjes, e ndërveprimit kulturor”, sidoqoftë, duke e theksuar “një element qendror, njëlloj sistemi të referencës të pandryshueshëm”, çka lidhet me mënyrën e mekanizmat sesi perceptohet e transmetohet kultura. Këtu ka njëlloj tradicionalizmi të ngulur në mënyrën e të menduarit, p.sh., me gjithë zhvillimin e madh industrial fjala vjen të SHBA-së apo Japonisë, mendimi teorik vijon të shqiptohet në Francë, Gjermani, Britani etj.

E parashtruar kështu dhe e lidhur edhe me një nga objektet tona të interesit, *kompetencën e lexuesit*, pyetja që shtrohet është: si ndërtohet kulturalisht vetë kompetenca e si i ndërton kjo e fundit objektet e veta në lexim, në rastin e letërsisë shqipe, me gjithë implikimet e mundshme?

Nën këtë dritë, a mund të kryhet një përshkrim i një gjendjeje të dhënë të ndërkulturalizmit në letërsinë shqipe? Natyrisht, taksonomia e këtyllë është dukuri relativisht e vonë dhe shenjon gjendje relativisht të reja, siç u vu re më sipër, por pyetja mbetet: çfarë e karakterizon drejtpërdrejt në këtë rreth hermeneutik kulturën shqiptare, pastaj, marrëdhënien e letërsisë shqipe me llojet e ndryshme të ndërveprimit kulturor? Siç shihet, problemi është i rendit epistemologjik.

Pikësëpari, letërsia shqipe, në vlerësimin tonë, për shkaqe me natyrë historike, ka pasur funksion aktiv në marrëdhënie me kulturën, ka pasur autoritetin - po t’i rikthehem termi - themelues e formulues për kulturën, ndaj dukuritë e tilla mund të përkufizohen paraprakisht brenda saj. Gjykojmë se shtrohet çështja e caktimit të kufijve a i një fizionomie të qartë të kufijve tanë (shqiptarë) kulturorë, çka shtron menjëherë çështjen e një marrëveshjeje mbi identitetin.

Natyrisht që sprova të përkufizimit mbi ndërkulturalizmin mund të ndërmerren edhe jashtë kësaj marrëveshjeje, por frymëzimi apo bindjet vetjake mbi një trup kulturor që përfaqëson subjekti i ndërmarrjes hulumtuese, mund të vihen lehtë në dyshim.

Shkalla e lartë e hibridizimit kulturor ndër shqiptarët, për arsye historike e fetare, e bën ndërkulturalizmin, një dukuri të brendshme të letërsisë shqipe, madje një dukuri ende në proces. Varet se ç'pikëvështrimi zgjidhet: një qëndrim i jashtëm mbi një korpus të qartë, apo një vështrim i brendshëm mbi proceset.

Mendoj se në rastin e letërsisë shqipe, përparësi duhet të marrë qëndrimi i dytë. Një qëndrim i jashtëm, mbi një korpus të përfunduar na duket i vështirë, p.sh., po t'i referohemi debatit të jashtëzakonshëm të 2006-ës mbi identitetin. Mendoj se më shumë se një korpus të qartë, ne kemi një spektër të pasur *transkulturor* e ndërkulturor, njëkohësisht. Meqë kjo ka një tingëllim arbitrar të kuptueshëm, theksojmë se disa prirje të romanit në fillimin e viteve '90, përkatësisht të "Ritet e Nishanes" i Kim Mehmetit, "Ulku dhe Uilli" i Vath Koreshit, "Droja e Kadiut" i Rexhep Zllatkut, "Koha e dhive" i Luan Starovës, "Lufta e Trojës" e Plasarit, apo "Të jetosh në ishull" e Blushit, janë të dhëna jo pa vlerë mbi këtë tezë.

Në njëfarë mënyre pyetja shtrohet: a e kemi (diku) një fizionomi të qartë identitare, për të shkuar mandej te mekanizmat e saj ndërkulturorë, si raporti i saj me të huajën, apo a mund të hulumtohen elemente të ndërkulturalizmit, të pranuar si të tillë, brenda saj, d.m.th., brenda letërsisë së shkruar në shqip (pra, një rend i pjesshëm elementesh)?

Në kuptimin historik, mendoj se është i nevojshëm një etapëzim i mishërimin të marrëdhënies së letërsisë shqipe me ndërkulturalizmin, që nis me:

a) Letërsinë e Rilindjes Kombëtare, kur shfaqen premisat e kësaj marrëdhënieje, kur nis një proces i njësimin kulturor dhe i kthjellimit të kufijve mes një identiteti kulturor të ri, me ato rrethues. Tekst klasik për rastin do të shquanim romanin në frëngjisht të Vaso Pashës "Bardha e Temalit". Theksojmë se, megjithatë kjo është periudhë e një lloji tjetër të *transkulturalizmit*, version iluminist, qendror, nacionalist e laik; b) vitet '20-'30 janë periudha e kthjellimit të dukshëm ndërkulturalist, e eksperimentimeve dhe e përvojave ndërkulturore të dendura dhe e shpërbërjes relative të *transkulturalizmit*. Koliqi mund të ishte shembulli klasik, por nga autorët e kohës, vështirë të gjesh ndonjë që nuk e vuan këtë tension ndërkulturor; c) gjysma e dytë e shek. XX shfaqet si periudhë e pezullimit ndërkulturor, përkatësisht të trajtës së tij klasike, me ndonjë përjashtim të zbehtë, fjala vjen në tekstet e Petro Markos. Ndodh që, paradoksalisht, ndërsa kryhet një formante e qartë

e identitetit, ndërkulturalizmi ndodh *in absentia*, si konstruksion mbi disa *cliche* me natyrë ideologjike, njëlloj rasti klasik i reifikimit ndërkulturalist; d) letërsia e sotme shqipe është duke pësuar njëkohësisht disa procese: një proces të brendshëm ndërkulturor, në kushtet e njëlloj ambiguiteti identitar (kujtojmë tekstet e Blushit); një proces të hapur, të qartë ndërkulturor, që ndodh në letërsinë e diasporës; ndërsa në proces i drejtpërdrejtë i vijimit të dukurive të nisura gjatë realizmit socialist, kësaj radhe si dekonstruksion i formantes ndërkulturore të krijuar aty, edhe si rikthim i transkulturalizmit.

Në tërësi, me gjithë shijen e pashmangshme pozitiviste, përmbledhtazi, kemi vërejtur se mbi këto dinamika është kryer edhe kompetenca e lexuesit, për të mbërritur sot në një tension mes *transkulturalizmit e interkulturalizmit*.

Kjo e bën, mbase, një kusht të detyruar metodologjik, në rastin tonë, përzgjedhjen e një objekti, (të automobilit), i cili mishëron transkulturalizmin (si gjendje), por marrëdhënia e të cilit me kompetencën nuk mund të mos jetë ndërkulturore në kuptimin e (1) ndërhyrjes së objektit në kompetencë, (2) të ndikimit në kompetencë përmes tekstit, (3) të ndryshimit të kompetencës, (4) të funksionit ndërtues të kompetencës, pra, të një procesi, që e shenjon dinamikën e një formanteje të ndërkulturalizmit në letërsinë shqipe deri në asimilimin e këtij objekti. Mbi këto segmente metodologjike jemi përpjekur të zbulojmë disa elemente të dinamikës së sjelljes së lexuesit në marrëdhënie me të, përkatësisht për tregimin e Koliqit “Bylbylat e Plepshit”, romanin e Nasho Jorgaqit “Mërgata e qyqeve” dhe romanin e Fatos Kongolit “Te Porta e Shën Pjetrit”.

Synopsis mbi “automobilin” sipas llojit të përvojës së zbatuar

Në rastin e tregimit të Koliqit, i cili e ka pasur njëlloj moto-je, tensionin mes *gjakut e kulturës*, është e dukshme se jemi në fazë relativisht të hershme të ndërtimit të kompetencës së lexuesit. Fill pas romantizmit, si lëvizje, në thelb, e shndërrimit nga marrëdhënie kulturore të transkulturës në ato të ndërkulturës, dinamikat e kompetencës së lexuesit, gjithashtu fituan njëlloj statusi ideologjik, të cilësuar nga konflikti mes një identiteti që priret të forcojë sistemin e vet dhe pashmangshmërisë së ndryshimit të tij. “Automobili”

si objekt i transkulturës shfaqet në një rrethanë tipikisht romantike, e cila nën moton e iluminizmit “do të duhet ta theksonte” forcën e tij shndërruese, por përkundrazi, ndeshet me një inerci të identitetit, të shfaqur si “horizont liberal leximi”. “Dominantja” imperialiste e automobilin nuk arrin t’i mbivendoset një kompetence “të sintezës”, të prirur për të asimiluar gjithçka të transkulturës.

Në këtë kuptim, transkultura jepet si lëndë e rendit iluminist, pra e “përvetësueshme” *a-priori*, pavarësisht nga statusi imperialist i “automobilin”. Si shenjë iluministe “automobilin” bëhet funksion tipik për kompetencën ndërkulturore të romantizmit – i gjithë tregimi i Koliqit ndërtohet mbi këtë keqkuptim në të kuptuarin e kompetencës për atë periudhë. Keqkuptimi kulturor mes “transkulturës” si dominante dhe “ndërkulturës” si rend i përvetësueshëm i përvojës, bëhet fabul e tregimit. Tregimi i Koliqit duket si një ekzemplar dekonstruksioni mbi kompetencën e lexuesit në fund të Rilindjes: “automobilin” bëhet shkak i përkufizimit të kompetencës!

“Mërgata e qyqeve” kryhet në një kontekst tjetër të kompetencës, përkatësisht të kontrollit e drejtimit të saj. Ndërsa mund të pranohet si e kryer, e përmbushur, ndërkulturësia e përkufizon “automobilin” si shenjë të së *huajës*, por në ndryshim nga tregimi i Koliqit, kompetenca ka prirjen e ekzorcizimit të asaj shenje, kësaj radhe në emër të mbrojtjes së ndërkulturalizmit. Sërish si dëshmi e transkulturës automobili “refuzohet” nga kompetenca, pikërisht për shkak të statusit “imperialist”, “dominant” të shenjës. Sidoqoftë, mund të arsyetohet për një proces më kompleks në këtë rast. Realizimi i tekstit e vendos kompetencën në një gjendje baraspeshimi mes pranimit të “automobilin”, si domosdoshmëri për vijimin e leximit, ndërsa në anën tjetër “të kundërvënies”. Ky element i dytë paraqet njëllor ngjashmërie me tregimin e Koliqit si sprovë për kompetencën, për gjendjen e saj të qëndrueshme. Hamendësojmë një proces dialektik të “përvetësim-kundërvënies”, përkatësisht një marrëdhënie ekuilibri mes transkulturësise e ndërkulturës në kompetencë.

Një gjendje të përmbysur, krejtësisht, kemi në rastin e romanit të Kongolit “Te porta e Shën Pjetrit”. Kompetenca ka, ndërkohë një status të paqartë identitar. Kujtojmë gjendjen e prozës sonë romanore në fillim të viteve ’90. Në kërkim të kufijve të vet, kompetenca zhvillon në tekst një marrëdhënie “të vetëpërcaktimit”, çka përkon me gjendje të transkulturësise: “au-

tomobili” si shenjë e “së huajës” së natyralizuar, me të cilën kompetenca përcakton një gjendje të re, bëhet tashmë pikëtakimi mes gjendjeve të ndryshme, tipologjive të ndryshme, të panjohura për kompetencën. Automobili e sundon kompetencën. Në këtë pikëpamje, kjo “shenjë” ka si domethënie një gjendje të caktuar të “transkulturës”, që kapet pas një shenje identitare “imperialiste”, “dominante”, për të shkuar drejt identitetit të vet. Shihet, pra, se një dinamikë e mundshme e funksioneve të shenjës së “automobilit” e shpie kompetencën drejt transkulturësisë, dukuri, që sipas mendimi tonë e karakterizon prozën e sotme shqipe.

Përfundime

Kemi mbërritur në përfundimin se *ndërkulturalizmi* në letërsinë shqipe, nga pikëpamja e kompetencës së lexuesit, ka zhvilluar një dominante të *ndërkulturalizmit* si proces i brendshëm, si konflikt e baraspeshim me një gjendje të huaj kulturore. Ne e përkufizojmë atë si një gjendje alienimi/tjetërsimi të qëndrueshme, që letërsia shqipe është munduar ta përmbajë e ta përvetësojë, pa iu kundërvënë, për të krijuar njëlloj hibridi transkulturore, por pa thellësi, pa trajta të qarta. Pragmatika e re e leximit është ndikuar prej kësaj: sa më shumë është shkuar drejt këtij ideali transkulturore me rrënjë në racionalizmin tonë historik, siç dëshmohet prej cilësive të shfaqura kryesisht në rendin poetik të teksteve, aq më shumë ato konstrukte e mënjanojnë lexuesin, për shkak të “vetëpërcaktimit” të tyre.

Në lexim, letërsia shqipe, gjithnjë e më shumë, i përngjet marrëdhënies së leximit me tekstet e përkthyer.

Referenca:

- A. Benessaieh, "Multiculturalism, Interculturality, Transculturality", *Amériques transculturelles - Transcultural Americas*, University of Ottawa Press, 2010.
- D. Chin, "Interculturalism, Postmodernism, Pluralism", *Performing Arts Journal*, 1989, Vol. 11/12, Vol. 11, no. 3 - Vol. 12, no. 1, The Interculturalism Issue (1989).
- E. Çabej, *Mbi gjenezën e literaturës shqipe*, MÇM, Tiranë 1994.
- E. Xhindi, *Lector faber*, Europrint, Vlorë 2009.
- F. Kongoli, *Te porta e Shën Pjetrit*, Toena, Tiranë 2005
- G. Eley, R. G. Suny, *Becoming National*, Oxford, Oxford University Press, 1996.
- J. F. Lyotard, *The Postmodern Condition: A Report on Knowledge*, University of Minnesota Press, 1984.
- Koliqi, *Bylbylat e Plepishtit*, Vepra 2, Faik Konica, Prishtinë 2003.
- M. I. Spariosu, "Intercultural Studies: A Local-Global Approach", *Remapping Knowledge: Intercultural Studies for a Global Age*, Berghahn Books, 2006
- N. Jorgaqi, *Mërgata e qyqeve*, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë 1978.
- P. Vasa, *Bardha e Temalit*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë 1987.
- U. Eco, *Lector in fabula*, *La cooperazione interpretativa nei testi narrativi*. Milano: Tascabili Bompiani, 2006.

Marius DOBRESCU

LETËRSIA SHQIPE E PËRKTHYER NË RUMANI NË GJYSËMSHEKULLIN E FUNDIT

Letërsia shqipe ka një traditë mbi 150-vjeçare në Rumani, sepse krijuesit e saj, pavarësisht nga cila anë e vendbanimeve shqiptare erdhën, gjetën në vendin tim një mjedis miqësor për zhvillim personal dhe komunitar. Duke filluar nga Naum Veqilharxhi, i cili përktheu në alfabetin e krijuar prej tij disa tekste shkollore dhe duke vazhduar me Dora d'Istrian, gruaja-dijetare e shekullit XIX, duke arritur te Naim Frashëri, i cili shumicën e veprave i botoi në Bukuresht dhe duke vazhduar me Mitrush Kutelin, Lasgush Poradecin dhe Asdrenin, krijuesit e letërsisë moderne shqipe, të gjithë kanë pasur mbështetjen dhe zemërgjerësinë e shoqërisë rumune. Duke ecur në gjurmët e akademikut Nicolae Iorga, i cili i ka konsideruar shqiptarët “kushërinj të të njëjtit gjak” me rumunët, mund të themi se Rumania e ka parë Shqipërinë si motrën e saj më të vogël, ndërsa shqiptarët, pavarësisht nga cila zonë vinin, janë trajtuar në tokën rumune me dashuri dhe zemërgjerësi. Kjo e vërtetë që po theksoj, në kohën e sotme, kujtohet vetëm në sesione shkencore dhe në përvjetorë.

Për sa u përket cilësisë së përkthimeve dhe të përkthyesve dua të bëj një parantezë të shkurtër. Si kudo në botë edhe në vendin tim ekzistojnë dy lloje përkthyesish: rumunë që njohin gjuhën shqipe dhe shqiptarë që njohin gjuhën rumune. Dihet se një përkthyes i mirë duhet të njohë në mënyrë të përkryer gjuhën në të cilën përkthen. Ta njohë aq mirë sa që teksti i përkthyer të duket sikur është shkruar në atë gjuhë. Në të kundërt, do t'i bënte një shërbim jo të mirë veprës dhe shkrimtarit që ai përkthen. Me fjalë të tjera, ai duhet të jetë formuar në “territorin” e gjuhës rumune.

Rrjedhimisht, do të ishte e vështirë për një shqiptar, të formuar në Tiranë, në Korçë, apo në Prishtinë të hyjë thellë në hollësitë e gjuhës rumune dhe të bëjë një përkthim shumë të mirë.

Gjatë 50 viteve të fundit në Rumani kanë ekzistuar të dy llojet e përkthyesve që përmendëm më lart. Mund të përmend shqiptarët, Kopi dhe Ardian Kyçyku (atë dhe bir) me revistën e tyre të rëndësishme “Haemus”, që botohet në Bukuresht, Luan Topçiu (me përkthime nga gjithë letërsia shqipe) dhe Baki Ymeri (me përkthime nga poezia shqipe nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia). Tre të parët janë lindur në Shqipëri, në kulturën shqiptare të viteve të diktaturës, i katërti në Maqedoni. Sigurisht secili rresht i përkthyer prej tyre është një përfitim real për letërsinë shqipe. Një rast të veçantë e përfaqëson Foqion Miçaço, shqiptar i lindur në Bukuresht, autori i përkthimit të parë, të përkryer, të romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, të Ismail Kadaresë, në vitin 1973. Nga përkthyesit rumunë të letërsisë shqipe mund të përmend Oana Mihaela Glasu dhe Cristian Besleaga, që kanë studiuar në Tiranë në vitet’90. E para ka përkthime me rëndësi: dy romane nga Thanasi Medi (Fjala e fundit e Sokrat Bubës, Markela dhe Hija e malkuar), ndërsa i dyti tre romane nga Bashkim Hoxha (Duke bërë shaka me vdekjen, Duartrokitesit dhe Misteri i kronikës së mjegullës). Këta dy përkthyes u bënë të njohur gjatë pesë viteve të fundit.

Nëse kthehem te përkthimet nga letërsia shqipe e viteve ’60-70 të shekullit të kaluar dua të ve në dukje kontributin e një dijetari të madh, Grigore Brâncuș, njëri nga të fundit albanologë të stilit të vjetër të Europës, për njohjen dhe propagandimin e letërsisë moderne shqipe në Rumani. Akademi-ku Brâncuș na ka lënë disa përkthime të bukura nga Migjeni, në vëllimin Fruti i ndaluar (viti 1967). Periudha 1960-1990 ka qenë shumë e varfër në përkthimet nga shqipja në rumanisht. Vetëm një shkrimtar është botuar dhe promovuar në Bukuresht: Ismail Kadare. Lidhur me këtë gjë, Ismail Kadare tregon në një tekst të shkurtër, të publikuar në vitin 2011, mbi vizitën e tij në kryeqytetin e Rumanisë, në vitin 1973. Kur ndodhej në zyrën e kryetarit të kohës të shkrimtarëve rumunë iu sollën paratë që i takonin si autor për botimin e romanit “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, i përkthyer nga Foqion Miçaço atë vit. Për çudinë e mikpritësve, Kadare e refuzoi zarfin dhe rekomandoi dërgimin e shumës në adresën e Bankës Kombëtare të Shqipërisë.

Në regjimin komunist, shkrimtarët shqiptarë nuk kishin të drejtë të shpërbleheshin për veprat e tyre.

Edhe diçka lidhur me këtë periudhë. Rreth datës 28 Nëntor, çdo vit në shtypin letrar të Rumanisë botoheshin përkthime nga poezia shqipe ku kam kontribuar edhe unë. Përveç kësaj, shtypi i përditshëm dhe revistat historike përshëndesnin me artikuj të rastit ditën e pavarësisë së Shqipërisë. Ishin shenjat e miqësisë që shtetet socialiste i dërgonin njëri-tjetrit një herë në vit.

Dhe tani një rast i veçantë. Vitin e kaluar doli në Bukuresht, nga shtëpia botuese e komunitetit shqiptar të Rumanisë, vëllimi “Historia e letërsisë shqipe” nga fillimet deri sot, i Luan Topçiu. Vëllimi, i duartrokatur në Shqipëri - edhe pse me siguri që askush atje nuk e kishte shfletuar, sepse është shkruar në gjuhën rumune - është një inventar artikujsh të shkruara në periudhën kur autori ka punuar si diplomat në ambasadën e Shqipërisë në Bukuresht. Luan Topçiu, i diplomuar në Universitetin e Tiranës, rimerr një pjesë të vlerësimeve me vlerë të disa kritikëve dhe historianëve letrarë profesionistë, duke arritur megjithatë t’u ofrojë lexuesve rumunë një tablo të gjerë të letërsisë shqipe, të vjetër dhe aktuale. Sigurisht është një punë e lavdërueshme. I njëjti autor ka përkthyer në gjuhën rumune në vitet 1995-2023 disa vepra letrare apo kujtime, të financuara nga autorët e tyre. Mes tyre është edhe libri “Kurbani” i kryeministrit Edi Rama, por edhe libra të autorëve të tjerë, më shumë apo më pak të njohur. Këto sjellin në Rumani një pjesë të letërsisë së sotme shqipe. Por Historia, duke mos pasur miratimin e një kolektivi me redaktorë profesionistë, të një shtëpie botuese të konsakruar, është e dyshimtë nga pikëpamja e cilësisë letrare dhe shkencore, sidomos atëherë kur autori ka një funksion në kuadër të komunitetit shqiptar, madje edhe i boton librat e veta pikërisht me paratë e komunitetit.

Rasti Kadare. Por shkrimtari shqiptar më i përkthyer në Rumani është, prej së largu, Ismail Kadare. Duke lënë mënjanë modestinë, mund të krenohem me botimin e më shumë se 30 vëllimeve, me rreth 50 vepra të këtij shkrimtari, në një nga shtëpitë botuese të mëdha rumune. Përkthime nga Kadare, tekste të shkurtra apo fragmente romanesh, kanë nënshkruar edhe përkthyes të tjerë nga Rumania. Përveç këtyre, në revistën “Drita”, të cilën e kam udhëhequr si kryeredaktor 20 vjet, kam përkthyer dhe kam promovuar në një tirazh prej 3.500 ekzemplarësh me poezi, prozë, kujtime, dramaturgji,

etnografi dhe folklor dhjetëra shkrimtarë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe nga diaspora shqiptare.

Duke u ndodhur në Prishtinë, dua të them se letërsia kosovare është pak e njohur në Rumani. Sigurisht se janë përkthyer, rastësisht, disa poetë të këtushëm, si Agim Vinca, Besim Bokshi, Sali Bashota, Ali Podrimja, Eqrem Basha, Esad Mekuli, Radije Hoxha dhe të tjerë në dy antologji me poezi shqipe ose disa proza më të shkurtra apo më të gjata. Por ende asgjë përfaqësuese për letërsinë e re kosovare. Një promovim më agresiv dhe më shumë evenimente, prezantime, tregje librash etj. me pjesëmarrjen e atyre prej përkthyesve që janë të interesuar, do të ishte mjaft e vlefshme për një shtet të ri, si Kosova, i cili promovon identitetin dhe identifikon miqtë e vet.

Si mik i shqiptarëve kosovarë, dua të them se jam gëzuar shumë për botimin e librit 24 Mars. Kronika e ferrit kosovar të Fehmi Ajvazit, në një nga shtëpitë botuese të mëdha të Bukureshtit. Vëllimi ka zgjuar interesin e publikut rumun dhe ka bërë të njihet mirë pozita e Kosovës në konfliktin e vitit 1999.

Jorida SOTIRI

KOLIQUI, KOZMOPOLIT I DIJES INTERKULTURORE, NË KËRKIM TË QYTETËRIMIT

[*A ka send ma të mrekullueshëm në këtë botë se me i sjell
qytetnim një kombi zhytë n' errsin e padijes?*]

ERNEST KOLIQUI

Abstrakt:

Koliqit i jep një frymëmarrje te re prozës shqipe, ajo mbetet novatore e shkëlqyer e fillimeve të modernitetit. Në këtë kuadër do të kuptojmë me modernitet, siç na e mëson Hegeli, një funksion historik, jo domosdoshmërisht të lidhur me një epokë historike, por me epokën në të cilën si individët, si komuniteti, zhvillojnë një vetëdije historike për vetveten dhe për veprimet e tyre; një vetëdije për vendin e vet në histori dhe për potencialin e vet për ta shndërruar në identitet kulturor. Pikërisht te proza e Koliqit shohim të zhvillohet një nga vetëdijet më të kthjellëta për funksionimin historik, kulturor, estetik të modernitetit. Proza e shkurtër që na prezanton Koliqi trajton një kolazh kulturor me endje qytetërimin. Koliqi dëshironte që arti i tij të ishte i *“tipit europian me brumin e koloritin e botës shqiptare”*. Koliqi depërton në psikikën e intelektualëve që janë shkolluar jashtë, por që janë të rikthyer në atdhe. Intelektuali shqiptar që jeton në Shqipëri, synon futjen e një kulture të re në mjediset shqiptare duke kërkuar braktisjen e disa zakoneve të *mbrapshta*, por pa mohuar anët më pozitive të traditës. Intelektuali që jeton në tokë të huaj, synon lartësimin dhe ruajtjen e traditave zakonore shqiptare nga asimilimi prej një kulture të huaj me të cilën janë në kontakt përditësor në mënyrë që të krijojnë identitetin e tyre kombëtar. Si i tillë, ky intelektual

mbart mendësitë shqiptare më autentike (Doda në novelën “Gjaku”). Në Shkodrën e Koliqit apo në novelat e tij parakalojnë një galeri e tërë personazhesh të cilët ngërthejnë në vete, ide, motive, e situata të ndërlikuara të cilat ishin të mbujtura në psikikën e autorit dhe si të tilla i serviren një publiku të gjerë siç është lexuesi shqiptar. Ndër të tjera, tematika që trajton Koliqi në krijimtarinë letrare të tij, përgjithësisht është edhe vështirësia me të cilën ballafaqohet individi në “luftë” kundër kolektivitetit, pamundësia e individit në ndërrimin e gjërave të cilat në psikikën e kolektivitetit ishin bërë norma. Stili koliqan shfaq qenësishëm me personazhin frymën e një “*artisti vetëm sa na hap dritaren për ta kundruar botën*”.

Fjalë çelës: *interkulturë, dije, qytetërim, modernizëm, identitet kulturor, european, origjinë.*

Abstract:

Koliq gives a new breath to Albanian prose, it remains an excellent innovator of the beginnings of modernity. In this context, we will understand by modernity, as Hegel teaches us, a historical function, not necessarily connected to a historical era, but to the era in which both individuals and the community develop a historical awareness of themselves and of their actions; an awareness of one's place in history and of one's potential to transform it into a cultural identity. Precisely in Koliq's prose, we see the development of one of the clearest awareness of the historical, cultural and aesthetic functioning of modernity. The short prose presented by Koliqi deals with a cultural collage woven with civilization. Koliqi wanted his art to be of the "European type with the dough and color of the Albanian world". Koliqi penetrates the psyche of intellectuals who have been educated abroad but who have returned to their homeland. The Albanian intellectual who lives in Albania aims to introduce a new culture in the Albanian environment by asking for the abandonment of some evil habits but without denying the more positive sides of the tradition. The intellectual who lives in a foreign land aims to elevate and preserve traditional Albanian traditions by assimilating a

foreign culture with which they are in daily contact in order to create their national identity. As such, this intellectual carries the most authentic Albanian mindset. (Doda in the novella "Blood"). In Koliq's Shkodra or in his novels, a whole gallery of characters pass by who embody ideas, motives, and complicated situations that were protected in the author's psyche and as such are served to a wide public such as the Albanian reader. Among other topics that Koliqi deals with in his literary creativity, it is generally the difficulty faced by the individual in the "war" against the collectivity, the impossibility of the individual in changing the things that had become the norm in the psyche of the collectivity. The Koliqi's style naturally shows the spirit of an "artist who only opens the window to see the world" with the character.

Keywords: *interculture, knowledge, civilization, modernism, cultural identity, European, origin.*

Urbanizimi (*nga lat. urbs "qytet"*) është reflektim në letërsi, është zhvillim i një qyteti të madh, me një psikikë të veçantë të jetës qytetare, të lindur dhe të formësuar nga mjedisi urban. Zhvillimi urban sjell krijimin e qyteteve në të cilat jetohet mirë, punohet mirë, ku njeriu është i plotësuar në gjithë tërësinë e tij. Ky dinjitet human sjell te personazhet mungesën e prehjes në etnitetin organik të quajtur qytet. Verhnar e sheh qytetin si vendin e degradimit të përbashkët ku personazhi ndjehet i humbur në mjedisin e tij.

Ai mbetet një nga elementët themelorë të projektimit dhe të identifikimit të lexuesve. Koncepti për personazhin, veçanërisht në modernitetin bashkëkohor është më i gjerë se ai që e kufizon vetëm te shëmbëlltyra e drejtpërdrejtë njerëzore.

Modernizmi kërkon personazhe me "*përgjegjësi qytetare dhe shoqërore*", në të cilën sipas Mishel Fukosë njeriu shihet "*si ndërgjegje epistemologjike e vetvetes.*"¹ Nën këtë ndikim ndodhet personazhi i cili ka sunduar

¹ BENJAMIN, Walter, "Mbi disa motive te Bodler", në *Illuminacione*, përkth. Afrim Koçi, Korbi, Tiranë, 1977, faqe 205.

mendimin perëndimor qysh nga fillimet e tij. “*Melankolia moderne*”² shfaq tensionin e papërballueshëm të kërkesave të shoqërisë në drejtime të ndryshme. Personazhet me termat e një utopie “*përtej jetës*” janë përherë në kërkim të një qytetërimi modern, të një lëvizjeje qytetëse.

Shëmbëlltyra të tilla në letërsinë shqipe janë personazhet e Koliqit, shkrimtar i formuar në Perëndim, me filtrin intelektual, nëpërmjet të cilit ai e kalonte realitetin njerëzor shqiptar, ishte filtri i një njeriu që kishte koncepte euro-perëndimore të qytetërimit dhe të zhvillimit.

Duke pasur parasysh idenë e “*pragut letrar*”³ që sipas Zherar Zhenetit, sjell konceptimin dhe rolin e personazhit, leximin e interpretimin e tij, funksionin dhe vlerat brenda tekstit letrar, mbështetur edhe në metodat e studimit të kritikës bashkëkohore, e cila mbështetet thelbësisht në studimin e eksperimenteve krahasimtare dhe figurave të tjera të prozës, do të rrekemi të evidentojmë rolin e kërkimit interkulturore në veprën e Koliqit.

Qyteti në letërsi vjen si mënyrë jetese si mënyrë komunikimi, si ideologji e filozofisë, si kulturë qytetërimi. Në prozën e këtij autori është futur personazhi letrar si një intelektual shqiptar, me formim perëndimor, si misionar dhe kritik ku autori sjell një koncept të ri të tipologjizimit të personazhit urban, mbartës të vlerave të ndryshme nga letërsia pararendëse. Personazhet koliqiane predikojnë në shoqërinë shqiptare nevojën dhe kërkesën për ndryshim, emancipim. Koliqi krijon një qytet dhe bëhet vetë banor i qytetit që krijon. Ai zbriti nga Malësia në qytet (me letërsi) nëpërmjet veprës *Hija e maleve*, në veprën *Tregtar flamujsh* hyn në zemrën e Shkodrës. Në tregimet e tij duken hapur pikëpamjet e çështjes së ndeshjes së projektit të ndriçimit kulturor. Jepet individi dhe pafuqia e tij për të ndryshuar në jetën kolektive.

Ai bëhet themeluesi i prozës modern shqipe si në aspektin tematik, ashtu edhe në atë stilistik. Në vëllimin “**Hija e maleve**” (1929) trajton tema që kanë rrënjë në moralin e malësisë që me tragjicitetin e vet përballen me jetën qytetëse. Në vëllimin “**Tregtar flamujsh**” (1935) trajtohet jeta e qytetit të Shkodrës, shpaloset mentaliteti i vendit, harmonia e jetës, përshkrimi i personazheve që përfaqësojnë shtresa dhe mentalitete të ndryshme shoqë-

² Melankolia e personazhit është një ndër tiparet kryesore të letërsisë moderne.

³ HAMITI, Sabri: *Letërsia moderne shqipe*, Maluka, Tiranë, 2009, faqe.417.

rore. Në prozën poetike **“Pasqyrat e Narçizit”** (1936) autori në shtatë variante shpalos shpirtin e tij. Koliqi në prozën e tij shenjëzon ide dhe teza të mëdha, këto i zhvillon nga sensi që kërkon shndërrime të domosdoshme të kohës dhe transformime esenciale në shpirtin shqiptar. Në dallim nga tipi i mëparshëm i shkrimit të prozës shqipe, proza e Koliqit shënon një kapërcim të dukshëm, si në zgjerimin e gamës tematike, ashtu dhe në aspektet e brendshme të organizimit stilistiko-tekstor, duke bërë avancim në plan të shtjellimit brenda studimit letrar. Kodifikimi dhe funksionalizimi i elementeve të reja poetike, prozës së tij i japin një dimension letrar specifik, duke ngritur në një shkallë të pranueshme në raport me letërsinë e zhvilluara të kohës. Koliqi i ndërton personazhet me një përshkrim të kujdesshëm psikologjik, psikoanalitik, antropologjik, ligjor, kanunor, social dhe letrar. Personazhet nuk mund të interpretohen, as nuk mund të kuptohen, pa këtë shtresë të personalitetit të tyre, që megjithëse nuk është vetëdije, edhe pse kohët kanë ndryshuar, gjendet ende në pavetëdije një formë primitive. Ai përfton vizionin artistik, nëpërmjet të cilit jeta shprehet e kuptohet në qenësinë e saj, pra ndaj duke e receiptuar këtë botë njeriu bëhet më i pasur shpirtërisht dhe më i vetëdijshëm për veprimin e vet.

Nga ky këndvështrim mund të themi se proza e Koliqit i jep një frymëmarrje të re prozës shqipe, ajo mbetet novatore e shkëlqyer e fillimeve të modernitetit

Do të kuptojmë me modernitet, siç na e mëson Hegeli, një funksion historik, jo domosdoshmërisht të lidhur me një epokë historike, por me epokën në të cilën si individët, si komuniteti, zhvillojnë një vetëdije historike për vetveten dhe për veprimet e tyre; një vetëdije për vendin e vet në histori dhe për potencialin e vet për ta shndërruar.

Dhe pikërisht te proza e Koliqit shohim të zhvillohet një nga vetëdijet më të kthjellëta për funksionimin historik dhe estetik të modernitetit. Proza e shkurtër që prezantoi Koliqi ishte krejt tjetër. Kjo prozë kishte individualitet krijues, i dukshëm ky në shfaqjet e dukurive të reja, thyerjen e traditës letrare e stilistike ekzistuese, duke u vënë re qartazi prurja e një stili të ri letrar.. Koliqi dëshironte që arti i tij të ishte i *“tipit europian me brumin e koloritin e botës shqiptare”*. Mendimi i Koliqit e ndjente dhe e njihte shumë mirë traditën shqiptare, qoftë si dijetar, qoftë si njeri që është rritur me frymën e kësaj tradite me të cilën ka ushqyer dijet moderne mbi jetën dhe letërsinë.

Fjalët e tij se: “*Kthjelltësia shpirtërore nuk arrihet tue iu shmangë frymës së dokeve stërgjyshore*” dhe se “*kemi tharme në gjak qi na drejtojnë në mënyrë urdhnues*”, pasqyrojnë jo vetëm me një dell nacionalkulturor, por edhe një doktrinë biologosi etnik.⁴ Koliqi mudohej ta bënte të lexueshëm realitetin shqiptar për sytë europianë; ai njihte kodin perëndimor të vlerësimit dhe e quante si njësinë më të përshtatshme, me të cilët matet një qytetërim i vërtetë. Me prozën e tij, problematikat e thella të individit në modernizim e sipër do të ndikojë në shfaqjen e personalitet kompleks, në dilema të thella, thuajse të pazgjydhshme në rrjetën e të cilave shpesh do të ngecin si viktimat.

Personazhi i Koliqit vjen nga një formim dhe kulturë perëndimore në Europë, dhe me këtë shembull, si orientim intelektual dhe shpirtëror synon ndryshime, reforma, metoda për zvillimin shoqërisë shqiptare, që në rrënjët e saj. Për të nxjerrë në pah veçoritë e identitetit kulturor për dimensionin e botës shpirtërore të personazhit, analizës së dilemave, brengave, mendimeve e ndjesive, në shkallën më të lartë artistike. Me të na shfaqet ndryshimi i hapësirës që na bën të reflektojmë dhe sot, intelektualë që në ballafaqim me realitetin e ambientit të vet kalojnë në mospajtim, gërtitje, mëri, pakënaqësi, me kërkesë që të bëhen ndryshime, por nuk gjejnë forcë të rebelojnë asnjëherë.

Intelektuali është i vetëdijshëm që ndryshimi duhet të ndodhë, por ai është i ndrydhur të veprojë, duke rënë në një “melankoli” përjetimi tipik i qytetarit modern përballë ikjes së një të djeshmje identitare, për individin, duke e futur në një proces jo thjesht konstatimi të mallit, por në një proces të thellë kërkimi, ristrukturimi mendor e ndiesor të asaj bote dhe të atij qyteti të dikurshëm që nuk mund të jetë më. “*Bëhet përshkrimi i interierit qytetës, përmes së cilit shenjohen prirjet dhe përkatësitë shoqërore, por edhe mendore të personazheve të tyre*”⁵.

Personazhet koliqian shfaqen përherë në lëvizje nga mbizotërimi i një tipari apo pasioni të fuqishëm ku demonstrojmë përplasjen me normat e përgjithshme, duke sjellë transferim në komunikim dhe sjellje jo të zakonshme. Trillimi artistik i personazheve është një komunikim i së vërtetës dhe i

⁴ RRAHMANI, Kujtim; “*Intertekstualiteti dhe oraliteti*”, Prishtinë, 2002, faqe 49.

⁵ SHEHRI, Dhurata: *Koliqi mes malit dhe detit*, Onufri, Tiranë, 2006, faqe 42.

dhunimit të saj. Duke na shfaqur në pasqyrën koliqiane një personazh që nuk gjen vend brenda botës së kuptimësisë, ai ka vend brenda vetmisë për të mos harruar kështu që ai nuk pajtohet me realitetin e megjithatë forca nuk mjafton për ta ndryshuar atë.

Mendësia është drejtuar nga qyteti, duke vënë në dukje “një qytet modern të madh që ka funksionin dhe vlerën e personazhit”⁶, të atij qyteti ku “mjedisi i personazhit, në veçanti shtëpia e tij, mund të shihet si shprehje metonimike, ose metaforike e karakterit të tij. Shtëpia është vazhdim i njeriut.”⁷

Intelektuali shqiptar që jeton në Shqipëri synon futjen e një kulture të re në mjediset shqiptare duke kërkuar braktisjen e disa zakoneve të mbrapshta, por pa mohuar anët më pozitive të traditës.

Intelektuali që jeton në tokë të huaj, synon lartësimin dhe ruajtjen e traditave, zakonore shqiptare nga asimilimi prej një kulturë të huaj me të cilën janë në kontakt përditësor në mënyrë që të krijojnë identitetin e tyre kombëtar. Në petkun intelektual me origjinë nga provinca, Doda nuk mund të dalë nga rrethi i një fati të pathënë, nga fryma e Kanunit, strukturon tashmë qytetarin modern: veprues, refuzues, estetizues dhe dekadent njëherësh. Doda kërkon qytetërim, kulturë, kërkon të nxjerrë njerëzit nga errësira. Sytë e tij janë përherë të drejtuar përtej detit, drejt horizontit të hapur. Heroi aludon për një emancipim të shoqërisë, por nuk arrin dot të kryejë misionin e tij.

Novela “**Gjaku**” është ndërtuar mbi bazën e kundërvënies së të menduarit dhe të jetuarit real brenda një etnie. Vetë Doda është një hero intelektual, por në subkoshiencën e tij rri përherë zgjuar kodi i nderit, thirrja kolektive për hakmarrje. Doda thotë: “*S’due me ikë*”, është krejt i vetëdijshëm për vrasjen që ka kryer. Ai tashmë është çliruar nga një gjendje e trazuar shpirtërore mendore. Vrasja e tij është e shumëfishtë, ai vret gjakësin, ndërgegjen e tij, vret ëndrrën e tij për ndryshim e emancipim. Ai vret atë kulturë që më-

⁶ KUÇUKU, Bashkim, “Qyteti-personazh, përftesë e modernitetit bashkëkohor”, në *Letërsia dhe qyteti*, akte të konferencës shkencore, Fakulteti Histori-Filologji, Tiranë, 2009, faqe 83.

⁷ WELLEK Rene & WARREN, Austin, *Teoria e letërsisë*, përkth. Abdurrahim Myftiu, Onufri, Tiranë, 2007, faqe 207.

soi në qytetin europian. Vrau atë që sot shumë të rinj mund të kenë fatin e tij.

Në novelën “Miku” në subkoshiencën e heroit rri zgjuar ndjenja për hakmarrje. Psikologjia personale e Ucit kërkon të qëllojë me pushkë gjakësin “*mu në lule të ballit*”.⁸

“Ucit i pikonte gjak plaga qi kish të pambyllme në zëmër. Gjaksin, qi kërkoj kot një vjet rresht nëpër vetmit e bjeshkve për t’i ra pushkë lules së ballit, qe, e kisht përpara.”

Zëri i etnisë nuk ia lejon Ucit këtë veprim. Zakoni e detyron atë ta respektojë, ta mirëpresë gjakësin në shtëpinë e tij.

*E zakoni e detyronte me e pritë e me bisedue me të si më të shtrënjtin dashamirë, mbasi i kishte rá mik t’u shtëpija!*⁹

Pra, kemi të bëjmë me dy situata:

1. Situata e parë ka të bëjë me psikologjinë personale të individit. (Individi jepet përballë një dileme dhe gjendje kaotike shpirtërore).
2. Situata e dytë ka të bëjë me ndikimin e etnopsikologjisë kolektive ndaj individit. (Individi do të veprojë, por zëri i Kanunit nuk e lejon, ai detyrohet të bëhet udhëtari i tij).

Koliqi me prozën e tij na solli ligjin kanunor, si një ndeshje kulturore që mbartet dhe sot (fenomeni i gjakmarrjes).

Në Shkodrën e Koliqit apo në novelat e tij parakalojnë një galeri e tërë personazhesh të cilët ngërthejnë në vete, ide, motive, e situata të ndërlikuara të cilat ishin të mbrujtura në psikikën e autorit dhe si të tilla i serviren një publiku të gjerë siç është lexuesi në këtë rast.

Ndër të tjera, tematika që trajton Koliqi në krijimtarinë letrare të tij, përgjithësisht është edhe vështirësia me të cilën ballafaqohet individi në “*luftë*” kundër kolektivitetit, pamundësia e individit në ndërrimin e gjërave të cilat në psikikën e kolektivitetit ishin bërë norma. Këtë do ta provojë, Diloca në novelën më të njëjtin titull. Protagonisti kryesor është vajza e cila ishte fejuar që kur ishte në djep. Fati apo fataliteti bën që ajo kur të vejë në moshën e martesës të dashurohet me një tjetër të ri malësor dhe të martohet me të.

⁸ KOLIQUI, Ernest: “Miku” në *Hija e maleve*, BUZUKU, Prishtinë, 2003, faqe 98.

⁹ Koliqi, Ernest; “Miku” në *Hija e maleve*, BUZUKU, Prishtinë, 2003, faqe 98.

Kjo do të ishte fatale për vajzën e cila kishte thyer doket e Malësisë dhe për këtë do duhej ndëshkuar sipas zakoneve të cilat mbretëronin në Malësi. Ajo humb dashurinë, sepse i dashuri i vritet, në të njëjtën kohë ka humbur edhe familjen dhe për këtë ajo do të përfundojë në jetimore. Krijimi i karaktereve të tipit të Dilocës, tregojnë se lufta e individit për të ndryshuar apo për të ndikuar në jetën kolektive ishte e pafuqishme, qoftë edhe nëse për një ideal të tillë do të ishte në gjendje të flijojë më sublimen. Detyrimisht duhet thënë se vlera e pakontestueshme që ngërthen në vete vepra letrare e Koliqit, flet për një euridit të rrëfimit artistik, flet për një mjeshtër të fjalës së shkruar, pa të cilin letërsia shqipe do të ishte shumë e zbehtë.

Hapësira e letërsisë për Koliqin është filozofia idiomatike dhe “*kozmpolite e dijes*” së saj, e cila duhet të vrojtohet nga “*hapja e dritares*”. Edhe teoritë më të reja të tanishme të ashtuquajtura post-strukturaliste dhe kundërmimetike luajnë me konceptet e asaj se “artisti vetëm sa na hap dritaren për ta kundruar botën”.¹⁰ Të asaj bote që sjell ç`përfytyrimin mendor, shpirtëror duke shfaqur modelin më të vuajtur nën dëshpërim ku Ernesto de Martino e sheh apokalipsin kulturor si: “*humbje e identitetit të vetes; humbja e nocionit të kohës së tashme, rendja e hutuar drejt një të ardhmeje të pa formë ; kthim mbrapa në pseudovlerat që një shoqëri bart nuk shpreh gjë tjetër veçse trishtim.*”¹¹.

Pikërisht në këtë identitet kulturor Koliqi gdhendi atë që Judith Schlan-ger do ta përforconte në perifrazimin patetik se “*Do të humbim shumë nëse do të vendosim se historia e kulturës në tërësi është e parëndësishme dhe se njerëzimi e ka kaluar kohën duke dëshmuar në lidhje me asgjë dhe për asgjë. Do të humbim shumë nëse do ta hidhdim prapa shpinës dimensionin e së kaluarës, e aq më tepër, do të humbim në themel, në atë që mendojmë... Çdo debat është edhe i vjetër edhe i ri; edhe atëherë kur ne mendojmë se i përket kohës së shkuar, ai vazhdon të qarkullojë me ne dhe brenda nesh për të thënë me zë se: duajeni kulturën, duajeni identitetin, duajeni kombin*”.

¹⁰ SHEHRI, Dhurata: *Koliqi mes malit dhe detit*, Onufri, Tiranë, 2006, faqe 33.

¹¹ GJERMENI, Eglantina & BREGU Majlinda: “*Sikur të isha djalë..Apokalipsi kulturor..vlerat dhe pseudovlerat e “moralit” tonë*, në Gaia II, Alb Paper, Tiranë, 2006, faqe.41.

Bibliografia:

1. ASLLANI, Pesida & SHEHRI, Dhurata: Hartimi i një antologjie të tregimit shqiptar në turqisht-problematika dhe parime, Universiteti Hana e plotë Beder, Tiranë.
2. BENJAMIN, Walter: “Mbi disa motive te Bodler”, në Iluminacione, përkth. Afrim Koçi, Korbi, Tiranë, 1997.
3. CALINESCU, Matei: “Bodleri dhe paradokset e modernitetit estetik”, në Pesë fytyra të modernitetit, përkth. . Gëzim Qëndro, Dituria, Tiranë.
4. Fenomeni i avanguardës në letërsinë shqipe, Tiranë, 2004.
5. GJERMENI, Eglantina & BREGU Majlinda: “Sikur të isha djalë..Apokalipsi kulturor..vlerat dhe pseudovlerat e “moralit” tonë, në Gaia II, Alb Paper, Tiranë, 2006.
6. HAMITI, Sabri: “Letërsia moderne shqipe”, UET-Press, Tiranë, 2009.
7. JORGO, Kristaq: “ Avangarda si provokim për historishkrimin e letërsisë shqiptare”, në
8. KUÇUKU, Bashkim: “Qyteti-personazh, përftesë e modernitetit bashkëkohor”, në Letërsia dhe qyteti, akte të konferencës shkencore, Fakulteti Histori-Filologji, Tiranë, 2009.
9. RRAHMANI, Kujtim: “Intertekstualiteti dhe oraliteti”, Prishtinë, 2002.
10. SHEHRI, Dhurata: Koliqi mes malit dhe detit, Onufri, Tiranë, 2006.
11. WELLEK Rene & WARREN, Austin: “ Teoria e letërsisë”, përkth. Abdurrahim Myftiu, Onufri, Tiranë, 2007.
12. ZHENET, Zherar: Figura, përkth. S.Hamiti, B.Kelmendi; Rilindja, Prishtinë, 1985.

Leonora HAJRA

NDËRVEPRIMET KULTURORE ORIENTALE NË ROMANIN E TEKI DERVISHIT, BEQIR MUSLIUT DHE MUSA RAMADANIT ("HEREZIA E DERVISH MALLUTËS", "VEGULLIA" DHE "ANTIPROCESIONI"

Letërsia shqipe shquhet për një opus të pasur letrar me autorë që kanë tipizuar periudha e fenomene specifike që i gjejmë edhe në letërsinë evropiane. Ndërveprimi i saj me letërsinë e huaja, kulturën e Orientit dhe Oksidentit është bërë substrat themelor prej nga ajo është ngritë në suaza të karakterit universal, duke tejkaluar provincializmin, lokalizmat. Në realizimin e saj nëpër periudha të caktuara kanë ndikuar faktorë historikë, gjeografikë. Ndërlikimi i saj me Orientin i ka fillësat pikërisht te këta faktorë, pra pushtimi otoman në një anë dhe gjerësisht pozita e favorshme gjeografike për të zhvilluar komunikime të drejtpërdrejta me popujt e Lindjes, në anën tjetër.

Letërsia e cila i takon decenieve të fundit, komunikon me kulturat e tjera, jo vetëm në nivel të komunikimit të grafemave dhe formës, por zgjerohet e i hap rrugë kondensimit diskursiv nëpër nivele semantike. Romani i Teki Dervishit, Musa Ramadanit dhe Beqir Musliut, provon ekzistimin e një relacioni të atillë të letërsisë shqipe me Orientin që sugjeron në struktura të thella të interpretimit. "Herezia e Dervish Mallutës", "Antiprocesioni" dhe "Vegullia" piketohen si romane me brumosje religjioze islamike kur vështrohen në dy plane: tematika dhe diskursi.

Zbulesa sufiste e islamiste

Orientalistika, në vija të trasha studion gjuhën, kulturën dhe letërsinë e popujve të Lindjes, prandaj edhe çdo përpjekje për të parë ndikimet e Orientit prek pikërisht tri këto segmente esenciale. Protagonistët e romaneve: gjakovari (dervishi), Mevlana Jusufi dhe Jozef K e Jozefina K ndërtojnë konturat e tyre përmes modelimit psikik religjuz me përsiatjet metafizike, që ndërlidhen me koekzistimin e botës tokësore dhe asaj të amshuar, me relacionin e trupit dhe shpirtit, metempsikozën, panteizmin, halvetin, mëkatin dhe fatumin. Pra, pikëprerja e parë e romaneve me Orientin realizohet në rifunksionalizimin semantik të motiveve religjioze.

Romanet karakterizohen me një psikonarracion metafizik që përqendrohet në përsiatjet intime të personazheve mbi kategoritë themelore të ekzistencës njerëzore. Protagonisti i “Herezia e Dervish Mallutës” e përkufizon ekzistencën e tij në një rrafsh sintagmatik. Gjithmonë sipas brumosjes sufiste, ai e sheh kufirin midis jetës dhe vdekjes si raport midis trupit dhe shpirtit. Në esencë, trupi te sufistët konsiderohet si burg i shpirtit, postulat themelor që gjenerohet edhe në filozofinë oksidentale me Platonin, andaj edhe dervishi, si figurë emblemë e këtij sekti, është i obliguar që t’i tejkalojë nevojat vetjake materiale, për t’iu nënshtruar kërkesave shpirtërore.

Personazhet e romaneve realizohen si personazhe introverte, andaj edhe depërtojnë te lexuesi përmes botës së tyre të brendshme. Gjithë gjendja e tyre gjenerohet përmes një narracioni psikik që e shpalos raportin e tyre intim me botën shpesh edhe në përmasa të absurdit. Pra, në një kontinualitet lexuesi ballafaqohet me personazhin që e përdor religjionin në sfera të absorbimit labil, që e kundërshton racionalitetin që e bart qenien në një izolim nga bota e jashtme e madje edhe në një botë të dytë (Agarta nëntokësore, te “Antiprocesioni”).

Midis këtyre romaneve, personazhi i Musliut shquhet me botën më të thellë psikologjike, që situon stilin monoton të rrëfimit me rimarrjen e vazhdueshme të gjendjes së njëjtë emocionale (faji dhe ndërgjegja) në një cikël. Mevlan Jusufit i shërben lidhja me religjionin islam si shpëtim, strehim në një realitet ku gjendja e tij reflekton përmes marrëdhënies intime që ndërton me Zotin. I gjithë teksti realizohet si komunikim i personazhit me transcendentalen përmes lutjeve dhe monologëve të fuqishme. Si kontekst historik

është periudha e sundimit osman, andaj edhe tema filozofike mbi fajin dhe ndërgjegjen në qeniet religjioze i shkon përshtat aq përzgjedhjes temporale e topologjike.

Paradoksi i romanit të Dervishit realizohet ekskluzivisht me personazhet me standarte të dyfishta, që përqendrohen në figurën e tyre, impaktin të masës dhe përfitimet materiale, ndaj edhe dimensionin shpirtëror e konsumojnë në këtë linjë. Modelimi sipas filozofisë sufiste i shërben romanit për të dhënë portretin e qenies së njeriut që përsiat mbi ekzistencën, ka pikëpyetjeve e veta, dhe rend pas paqes shpirtërore, por nuk plotësohet meqë përfundon si pre e ambientit destruktiv. Suka e Cërmjanit, teqja e Dervish Mallutës, përbëjnë hapësirën religjioze që pëson tranzicionin e parë në fushën e interpretimit, përmes modelimit utopik/distopik.

Sipas teorikut Martin Lings, *sufizmi synon vdekjen graduale të egos nëpërmjet heqjes së shtresave të harresës që pengojnë ndriçimin e plotë të potencialeve të pakufizuara të njeriut, për të realizuar shndërrimin e lëndës së psikës dhe trupit të tij, që përthithet përfundimisht të realiteti i shpirtit, përmes efektit të pranisë hyjnore që mbjell në zemër përngjitja ndaj Udhës, si dhe hirit të përcjellë nga Tradita.* (Lings, 2010, fq.12). Element sufist që përbashkon “Vegullinë” e Musliut dhe “Herezinë...” e Tekiut është motivi i flakës, përndezyes shpirtërore. Të dy protagonistët kalojnë në një ekstazë përmes flakës/ qiririt të ndezur, si simbolikë e shpirtit që digjet për krijuesin e tij. Në këtë linjë të dy romanet e strumbullojnë konceptimin e njeriut si libër përjetimesh, andaj edhe fokusohen në soditjen e shpirtit përmes përsiatjeve religjioze.

Romanet mund të veçohen duke i analizuar për nga filozofia religjioze që bartin: “Herezia...” e Tekiut gjeneron përmbajtjen nga botëkuptimin sufist, sekt islam që proklamonte shkrirjen e krijesës me krijuesin; ndërsa “Vegullia” dhe “Antiprocesioni” huazojnë motive nga misticizmi islam, duke dhënë kështu portretin e një periudhe historike (sundimit turk) dhe aktualitetit pervers e hipokrit.

Halveti në sektin sufist nënkupton izolimin e njeriut nga bota, tërheqja në vetmi për dyzet ditë, gjatë së cilës ai i kthehet Krijuesit dhe praktikon nënshtrimin e nevojave materiale, drejt ngritjes shpirtërore dhe adhurimin e Zotit përmes Ziqrit. Në romanin e Dervishit, protagonistin hyn në halvet në Sukën e Cërmjanit, ku ballafaqohet me vesin njerëzor, nënshtrimin ndaj

njeriut, marionetizimin, në rrugën e kthimit kah vetja dhe Krijuesi. Personazhi i Tekiut shquhet edhe për dimensionin ontologjik, ëndrrat dhe vizionet të cilat janë rrjedhë e gjendjes labile psikike, paplotësisë shpirtërore që e përndjek edhe në Sukë.

Vizionet janë karakteristike edhe për Mevlan Jusufin e Beqirit, i cili gjithashtu i nënshtrohet një halveti intim, mbyllja e tij në han është rrjedhojë e ndjenjës së mëkatit, intensitetit me të cilin ai e përjeton fajësinë për vëllanë, i cili ka shkuar në vend të tij nizam në Luftën e Selanikut:

Nëse nuk do të mundem të depërtoj përtej mureve, atëherë do të jenë muret dëshmitare për zhdukjen time dhe për atë pikë të zverdhur që ka mbetur në mure, e cila do të ringjallë lojën time me gishtërinj dhe hijen e pickuar nëpër dritën e bishtukut. (Musliu, 1979, fq.61)

Halveti i Mevlanit ndërton një narracion që me rimarrjen e vazhdueshme të gjendjes psikoemocionale asocion në mitin e Sizifit. Mevlani e krahason kontinualitetin e gjendjes së tij psikike me fajin dhe mëkatin, me përsërtijen e tespihëve, procesin e dhikrit. Parabola eksplicite me tespihët dhe parabola implicite me mitin e Sizifit flasin për ndërveprimin e romanit me orientin dhe oksidentin njëkohësisht.

Për dekada orientalistët kishin folur për Orientin, kishin përkthyer tekste, ata kishin shpjeguar qytetërimet, fetë, dinastitë, kulturat, botëkuptimet si objekte akademike, të përjashtuara nga Evropa nga virtyti i huajshmërisë së tyre të paimitueshme (Said, 1979, fq.222). Pikërisht virtuoiziteti i rrallë dhe mistrerioziteti me të cilën janë mbuluar kultura orientale është bërë impakt faktor që autorët tanë e përgjithësisht ata evropianë ta kthejnë vëmendjen nga Lindja. ("Antiprocioni" i Musa Ramadanit është tipologji e romanit eksperimental që e nxjerr temën nga tekstet religjioze dhe letrare orientale. Sipas strukturalistëve çdo tekst komunikon me një tekst tjetër në një mënyrë a në tjetrën, gjë që dëshmon se letërsia është një rrjet i pafund ndërthurjesh tekstesh paraekzistuese. Në postmodernizëm vepra letrare është dialogjike, pra në të vërehen gjurmë të teksteve të tjera. "Antiprocioni" i Ramadanit dëshmon se arti letrar tanimë është kombinim më tepër sesa krijim subtil.

Ndërveprimi orient-oksident shfaqet edhe në këtë roman ku centralizohet fati tragjik i njeriut përmes personazheve që janë hibrid i personazheve religjioze dhe letrare. Jozef, Josif e Jusuf K, dhe Jozefinë, Josifinë dhe Jusu-

finë K janë inkarnim i filozofisë së Kafkës mbi inferioritetin e individit para fatumit e pushteteve supreme dhe asaj islame ndaj Jusufit që gjithashtu shquhet me një fatum tragjik, si profet që kalon nëpër të gjitha ndjenjat njerëzore: tradhtia, dashuria, mëshira. I njëjti personazh shquhet me tre emra duke portretuar kështu edhe individin si qenie universale pavarësisht nga shtesimet, fytyra e individit tragjik është një.

“Antiprocesioni” që bart një titull sugjestiv, si kundërvënie ndaj realitetit objektiv, është pasthirmë e fuqishme e autorit mbi arealin ekzistues, fenomenet e përhershme jetësore. Ky roman përvetëson edhe filozofinë e metempsikozës. Në roman personazhet janë të brumosura me filozofinë religjioze islame në rrafshin e gërshetimit të personalitetit e fatit të tyre me figura tragjike. Teksti e përdor historinë religjioze si hipotekst për të ndërtuar një qasje kritike ndaj konditave morale e kufizimeve që vendosen ndaj njeriut “religjioz”. Pse? Romani është gërshetim i përsiatjeve të thella mbi shpirtin si përhershmëri, ndërsa trupin thjesht si burg, që e ngulfat njeriun:

Pa shqiptuar asnjë të vetmen fjalë, pa bërë asnjë lëvizje domethënëse, pa lëshuar as kurrfarë pasthirrme, me gjuhën e shpirtrave të vet u morën vesh t'i braktisnin trupat përgjithmonë në Agartë, ashtu siç flakin njerëzia veldadonet, fustanellat ose kostumet njëpjesëshe, të vjetruara, të zhbirosura e të leckosura në hedhurina. Së pari u liruan nga hijet besnike, pastaj nga rrobat mëkatore, e në fund nga trupat e martirizuar. (Ramadani, 1995, fq.105)

Personazhet Jozefin K. dhe Jozefina K janë esencë, materie e pazbërthueshme, pra udhëtimi i tyre drejt transecdentales, është rikthim në fillim, meqë shpirti është i përhershëm, kontinual dhe i pafund. *Musa Ramadani te “Antiprocesioni” hulumton në sferën metafizike të dashurisë si universalitet, ku ekzistenca e trupit relativizohet në raport me jetën e përhershme të shpirtit. (Krasniqi, 2016, fq.525).*

Të tri romanet shquhen për konsolidimin e personazheve që rendin pas një çlirimi, ekstaze shpirtërore dhe përftojnë kështu trajektoren drejt hyjnore. Ato ndërtohen në një hapësirë që i përgjigjet ndërveprimit me kulturën e orientit. Edhe pse përmendet hapësira reale e regjionit të Kosovës, si Gjakova, Gjilani dhe ajo mitike si bota nëntokësore e Agartës, autorët arrijnë që ta transponojnë hapësirën përmes përshkrimeve që i përngjasojnë botëkuptimit të misticizmit islam, vetë hapësirës së Lindjes. Ja një pasazh të Teki Dervishi:

Prandaj, unë nuk e di si e kam gjetur rrugën deri atje, në Sukë, kam ecur këmbë, kam kaluar stepa, vise parrajsore ekzotike, shkretëtira të gjera e të pafunda; kam fjetur nëpër oaza të ndryshme, asnjëherë pa e ditur qartë vendin se ku do të ndalem dhe për ç'arsye do të ndalem. (Dervishi, 1981, fq.26)

Teqet, xhamia, hanet janë vetëm disa nga vendet me ngjyrimë religjioze orientale që bëhen fushëveprim për protagonistët e romaneve. Ato gjenerohen si hapësira simbolike që shpalosin dhe arsyetojnë zhvillimet filozofike përbrenda diegesisit. Kushtimisht hapësira e mbyllur që pretendon një lidhje të njerëzores me hyjnoren bëhet provokim që të shpalosë lakueshmërinë e njeriut në kaosin e jetës, pamundësinë e tij që ta përvetësojë jetën shpirtërore si apriori, karshi trupores që e lufton dhe intensifikon përjetimin e të mirave të botës dhe e kundërshton parimin religjioz, purifikimin e qenies, shpirtit.

Mëkati përbën pikën konektive të tri romaneve që bëhet edhe faktor themelor i motivimit të personazheve. Te Dervishi mëkati lidhet me konceptimin sufist, është aspekt i botës materiale, e konsumon shpirtin andaj edhe duhet të largohet përmes vetëndëshkimit dhe agjërimit. Ndërsa te “Vegullia” e Musliut. Mëkati ndërlidhet me fajin e trashëguar, koncepti se mëkati trashëgohet dhe e keqja e ndjell të keqen, është derivim i literaturës dhe misticismit islam. Ramadani nga ana tjetër tek “Antiprocesioni” e lidh gjithashtu mëkatin me zanafillën, në këtë rast incestin, duke e ndërtuar atë si persistençë, çmitizon vetë nocionin e mëkatit dhe konceptimin religjioz, për ta shtruar ekzistencën e njeriut në rrafshë më sublimë, ndaj së cilës mëkati shuhet dhe vetë materia (shpirti) ngrihet dhe prek lapidarët e ekzistencës.

Simboli, parodia dhe pastishi

Tekstet religjioze shquhen për modelimin e tyre hermetik, për shtresimet semantike me simbolikën e alegorinë. Studiuesit e Kuranit pohojnë së ekzistojnë katër shkallë të leximit të Kuranit andaj edhe vetë interpretimi i tij do zhvilluar në një relacion më tepër subjektiv, meqë kërkon një përqendrim dhe kulturë specifike njohëse. Nga leximi i romaneve të Teki Dervishit, Musa Ramadani dhe Beqir Musliut hetohet impakti i modeleve orientale në

poetikën e ndërtimit të diskursit, fascinimi i autorëve me letërsinë e Lindjes, gjuhën patetike dhe kulturën e hershme të Orientit që i paraprin Oksidentit.

“Herezia e Dervish Mallutës” realizohet fundamentalisht si një roman që e gjeneron misticizmin sufist, diskursin religjioz si simbolikë të portretit jetësor ku shtresohet vesi dhe virtyti, njeriu si qenie universale. Suka e Cërmjanit, i ngjason një bote hermetike, shpesh protagonistin e quan edhe majë të botës, pra ajo është reprezentim i hollë i botës së jashtme, në të ka gjithçka që ndodhet edhe jashtë saj. Loja e cila ilustron si esencë e personazheve të romanit (Hamidi i Verdhë, Kardhiç Lojtari, Tri Dritat Motra, Lik Gushëholli e Reb Kishoti), është sinjifikim i përmasave të pasionit në njeriun, intensitetin e ekzistimit të veseve si: lakmia, epshi e egoizmi në të.

Emrat e personazheve të romaneve shquhen me motivimin e tyre simbolik që huazon nga sfera e misticizmit islam e sufist. Personazhi i “Vegullisë” Mevlana Jusufi, jo rastësisht ka emrin si ndërthurje të poetit të Lindjes, Rumiut dhe Jusufit, profetit, viktimë e xhelozisë së vëllezërve. Ky emërtim i personazheve që i përgjigjet natyrës së tyre komkordon me teorinë e hershme kratiliane. *Kjo është mënyra e të menduarit apo imagjinimit që parashtron se ndërmjet “fjalëve” e “sendeve” ekziston relacioni i analogjisë (imitimit), i cili e motivon do të thotë e arsyeton ekzistencën dhe zgjedhjen e mu asaj fjale.* (Hamiti, 2005, fq.92)

“Herezia e Dervish Mallutës” dhe “Vegullia” spikaten me një diskurs të pasur me orientalizma, që kanë gjenezë gjuhën turke, perse e arabe. Përdorimi i fjalëve orientale u shërben përpjekjeve të autorëve për të dhënë portretin e ambientit të një periudhe specifike, nizamërisë të Musliu dhe portretin e një ambienti mistik të Tekiu. Orientalizmat u takojnë dy burimeve: asimilimit religjioz dhe atij gjuhësor. Baba sheh, myhyb, ziqri, sureja, hafiz, abuzemzem, bedel, sexhade janë orientalizma të religjionit islam, ndërsa merhaba, zindan, sade, sēkēllidi, salep janë orientalizma me burim eksplisit gjuhësor. Autorët përdorin fjalë me prejardhje arabe, turke e perse. Studiuesi Emil Lafe ka realizuar një hulumtim emblemantik lidhur me vendin e persizmeve në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe. Në të mësohet shumë se si fjalët e përditshmërië shqipe janë, në të vërtetë, fjalë me burimësi nga gjuha perse. Romanet e autorëve kultivojnë ndjeshmërinë e njeriut shqiptar pikërisht përmes aplikimit të fjalëve të tilla të prejardhura që edhe bëhen gjurmë të kohës dhe shënuese të kontekstit socio-politik.

“Antiprocesioni” dhe “Vegullia” realizojnë një ndërkomunikim me Orientin edhe përmes dy modeleve stilistike: intertekstualitetit dhe pastishit. Te romani i Ramadanit janë specifikë kapitujt në të cilën autori ndërftoi citate nga shumë autorë të Lindjes për të provuar kështu teorinë se Orienti i paraprindit Oksidentit. Citatet kanë natyrë filozofike dhe përsiatin mbi ekzistencën njerëzore si dualitet e kozmosin si refleksion të gjendjes njerëzore.

“Vegullia” e Beqir Musliut është tip i romanit që përdor pastishin si mjet për të afirmuar modelet orientale përmes diskursit që përpiqet t’i ngjajë frymës së tyre. Lutjet, si mishërim i strehimit shpirtëror të krijesës te Krijuesi, katekizmi (përdorimi i vetës së dytë, në monologë të dialogjizuar) krijon portretin e diskursit islamik me hadithet e ajetet kuranore, pasazhet në hyrje të kapitujve që flasin për krijimin e botës për shtatë ditë janë të natyrës hermetike, stilit religjioz islam e biblik.

Kapitujt e romanit të Musliut nisin me moto nga autorë të Lindjes të cilët edhe sugjerojnë në përmbajtjen e thellë dhe të menduarit aktiv të protagonistit mbi çështjet metafizike. Këta janë autorë që kanë përsiatë mbi njeriun, mëkatet, virtutet, rikthimin e botën e përtejme. Ja një shembull:

*“Tokës prej së cilës jemi krijuar
të gjithë i kthehem i”
Abul Atahija*

*“Shpirti im të mban
përmes lëkurës dhe eshtrave”
Al-Halaxh*

(Musliu, 1979, fq.17, fq.49)

“Herezia e Dervish Mallutës” dhe “Antiprocesioni” janë romane me ngjyrimet e forta parodike që e ndërtojnë botën letrare duke e përdorur botën religjioze si model atipik destruktiv që e cenzuron njeriun dhe nxjerr në të një ekzistencë të dyfishtë. Të dy romanet japin portretin se si do të koekzistonte njeriu në gjendjet “hipotetike” religjioze: jeta, vdekja dhe pasvdekja. Në këtë pikë identiteti i personazheve përftohet në sfidën që hasin në këtë areal ekzistues. Çka është parodike në këto romane? Njerëzit religjiozë

marrin tiparet e njerëzve destruktivë, që bëhen vegël e po njeriut dhe jo shërbëtorë të Krijuesit siç pretendojnë, brumosja e vazhdueshme e tyre me elemente të absurdit i nxjerr ato si figura paradoksale, ndërsa ambientin religjioz si ambient ku vetëm hyjnorja s'ka vend, ndërsa kultivohen intensivisht veset njerëzore.

Uleshin e shkryheshin nëpër tokë, mbështetnin shpinën më muret e trasha të teqes, ndiznin zjarre, shpalonin bohqet e tyre dhe mbllaqitnin mishërat e kripura, ballëk pa hale, prej detit të ëmbël, pemë nga bota e largët, pemë të viseve ku s'ka bukuri që vret, viseve kah rrjedhin lumenjtë përtpjetë, vendeve ku peshqit fluturojnë, zogjtë rrëshqasin e gjarpërinjtë lexojnë Kuranin. (Dervishi, 1981, fq.30)

Te “Antiprocioni” personazhet e shohin religjionin si pengesë për realizimin e dashurisë, për çlirimin dhe arritjen të vetvetja, ndaj edhe ndërtohen si modele triadike, gjë që rrit qasjen parodike dhe ironizuese të autorit ndaj konditave religjioze e njerëzore duke ngarendë drejt idesë së çlirimit të njeriut nga norma.

Teksa “Herezia e Dervish Mallutës”, “Vegullia” e interferojnë Orientin si praktikë jetësore, model për ndërtimin e diegesisit, “Antiprocioni” realizohet më tepër si përsiatje mbi misticizmin e Orientit duke u strukturuar si linjë enciklopedike narrative. Fascinimi i autorëve me misticizmin e Lindjes, përkon me tendencën e tyre për të sjellë një frymë hermetike në letërsinë shqipe që e përshkallëzon ekzistencën e njeriut duke e vënë në përballje direkte me transcendentalen. Natyra e thellë filozofike, fokalizimi i brendshëm si aprior në ndërtimin e rrëfimit, i afron këto romane me botëkuptimin oriental, i cili e vështron njeriun si qendër të botës, shpirtëroren si trajektore që e bart atë në areale metafizike.

Bibliografia:

Dervishi Teki: *Herezia e Dervish Mallutës*, Rilindja, Prishtinë, 1981.

Musliu Beqir: *Vegullia*, Rilindja, Prishtinë, 1979.

Ramadani Musa: *Antiprocesioni*, Buzuku, Prishtinë, 1995.

Literatura:

Dizdari N. Tahir: *Persizmat në gjuhën shqipe dhe studimi i tyre*, Ideart, Tiranë, 2010.

Gashi Y. Agron: *Rrëfimet e Maestros*, Qendra Mutimedia, Prishtinë, 2014.

Hamiti Sabri: *Tematologjia*, ASHAK, Prishtinë, 2005.

Krasniqi Nysret: *Letërsia e Kosovës 1953-2000*, 99-AIKD, Prishtinë, 2016.

Lings Martin: *Ç'është sufizmi?*, Logos-A, Shkup, 2010.

Said Edward: *Orientalism*, Random House, United States of America, 1979.

Veron DOBROSHI

SHKRIRJA KULTURORE NË VARGJE: PASQYRIMI I INTERKULTURALIZMIT NË POEZINË E XHEVDET BAJRAJT

Abstrakt:

Interkulturalizmi manifestohet dendur në veprat letrare dhe është një pjesë thuajse e pandashme e letërsisë. Në traditën letrare shqipe tema e interkulturalizmit shfaqet në forma të ndryshme duke u pasqyruar brenda veprave letrare ku gërshetohen bashkëveprimi midis kulturave të ndryshme. Poezia e Xhevdet Bajrajt pasqyron më së miri këtë model shkrimi meqenëse krijimtaria e tij shtrihet midis dy kulturave, asaj të Kosovës dhe të Meksikës, ku dhe kishte vazhduar krijimtarinë e tij. Bajraj me vizionin e pasur artistik dhe me ndikimet e ndryshme nga të dyja kulturat në të cilat jeton dhe vepron, dëshmon për një kulturë të pasur poetike dhe vëllimet e tij me poezi kanë shërbyer që kultura dhe identiteti shqiptar të njihet edhe më gjerë. Kështu poezia e tij shënon një urë lidhëse jo vetëm ndërmjet këtyre dy kulturave, por edhe dy gjuhëve, asaj shqipe dhe spanjolle, meqenëse Bajraj ka shkruar poezi në të dyja gjuhët. Ky studim do të pasqyrojë dimensionet ndërkulturore në vargjet e Xhevdet Bajrajt, njërit prej poetëve të rëndësishëm bashkëkohorë të Kosovës dhe të mbarë letërsisë shqiptare në përgjithësi.

Një jetë midis dy kulturave

Xhevdet Bajraj u lind më 1960 dhe pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Rahovec deri në vitin 1999, kur bashkë me familjen e tij u largua nga Kosova për të shkuar drejt Meksikës, ku përmes Parlamentit Ndërkombëtar të Shkrimtarëve dhe programit të tyre për shkrimtarët e përndjekur, atij iu dha azil dhe një bursë në Meksikë. Vitet në vazhdim u bë ligjërues në Universitetin Autonom të Meksiko Sitit për lëndë të ndryshme mbi poezinë, shkrimin kreativ e letërsinë. Përveç poezisë, është i njohur edhe si përkthyes e dramaturg. Ka shkruar e botuar me dhjetëra vëllime me poezi, të botuara në gjuhë të ndryshme të botës; angleze, spanjolle, gjermane, turke, polake, hungareze, etj. Bajraj ka fituar çmime të ndryshme e mjaft të rëndësishme letrare në Kosovë, Shqipëri dhe jashtë vendit. Poezia e Bajrajt është bërë e njohur në mbarë globin falë përkthimit të veprave të tij, por edhe falë përfaqësimit të tij të dy gjuhëve dhe kulturave të ndryshme. Kjo ngaqë Bajraj pas mërgimit në Meksikë, shkruan paralelisht në gjuhën shqipe dhe atë spanjolle. Falë kësaj, poezitë e tij janë përfshirë edhe në antologji të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Bajraj në shtypin e jashtëm është konsideruar si një poet i cili në të njëjtën kohë përfaqëson dy kulturat, atë shqipe dhe meksikane. Është tejet e natyrshme për poetin Bajraj që kultura meksikane të jetë shndërruar në një formë identiteti të ri për të, së bashku me origjinën dhe gjuhën e tij amtare. Hibriditeti kulturor në poezinë e Bajrajt shfaqet në forma të ndryshme gjatë krijimit të tij. Pavarësisht se jeton larg atdheut, poezia është strehimi i tij kryesor prej nga merr forcë gjithë shpirti dhe dashuria që ka për vendlindjen e tij, siç shprehet vetë poeti në një intervistë të tij:

...Atdheun e mbart me vete kahdo që shkoj, si një udhëtar që shpëtoi nga anija e përmbytur të cilit atdheu iu ka kapur për një rën këmbë dhe tash jemi së bashku kudo, bashkë me të gjallët e me të vdekurit. Po ashtu vazhdojnë të vdesin aty njerëzit që i kam njohur dhe i kam dashur, lindin disa që kurrë nuk do t'i njoh. Jetoj në vendlindjen e realizmit magjik dhe i mbart të gjitha plagët e trojeve shqiptare brenda vetes e sidomos ato të Kosovës, dhe veçanërisht ato të Rahovecit. Nga ajo dhimbje lindin poezitë e mia. Nxjerrin kokë si bimët dhe çelin lule të dhembjes me fytyrë njeriu universal... (Exlibris, 2021).

Siç edhe do të shihet, Bajraj me vëllimet e tij poetike dëshmon kulturën e lartë artistike dhe dashurinë e pashtershme për vendlindjen e tij, për Kosovën që e kujton me poezi, por edhe e promovon në Meksikë me shumë përkushtim. Kosova dhe Meksika bashkëveprojnë në vazhdimësi në letërsinë e tij, qoftë si gjuhë krijuese e librave të tij, qoftë si temë, motiv dhe burim frymëzimi e cila manifestohet në trajta të ndryshme.

Interkulturalizmi letrar

Interkulturalizmi nënkupton bashkëveprimin midis kulturave të ndryshme, dhe kjo në letërsi manifestohet kur brenda një letërsie apo vepre letrare ndeshim ndërveprimin e një rrjeti të gjerë kulturor, pasqyrimi i personazheve brenda një apo shumë komuniteteve të caktuara, interkomunikimi mes identiteteve të ndryshme, çështja e migrimit dhe sfidat e personazheve në integrimin brenda një kulture dhe shoqërie të re. Siç shprehet një studiues:

Letërsia ndërkulturore shpesh portretizon formimin e një sinteze midis kulturave të shumta dhe praktikave kulturore. Si të tilla, sfidat e integritit shpesh dalin në plan të parë. Për shkak se "e huaja" dhe "e njohura" mund të ekzistojnë vetëm në kundërshtim me njëra-tjetrën, duke bërë të mundur tjetrën, angazhimi me të huajën nxit vetë-reflektim, si te lexuesi ashtu edhe te shkrimtari. Ndërkulturaliteti i letërsisë është i rëndësishëm si në nivelin e tekstit, ashtu edhe në atë të kontekstit sociokulturor... (von Zimmerman, 8).

Nëse vëzhgojmë letërsinë shqiptare, historikisht shihet që në krijimtarinë e autorëve dhe të periudhave të ndryshme, do të ndeshim shkëmbime përvojash të ndryshme kulturore ngaqë këto lidhen ngushtë me jetën dhe krijimtarinë jashtë vendit të shkrimtarëve të ndryshëm, në veprat e të cilëve trajtohen personazhe, motive nga jeta në mërgim, larg atdheut, te disa më shumë e te disa në formë më sporadike, por kultura, gjuha dhe identiteti shqiptar është gjithnjë në plan të parë. Në letërsinë bashkëkohore shqipe, Xhevdet Bajraj është një nga poetët që mund të merret si model i një letërsie interkulturore, ngaqë krijimtaria e tij më e madhe është shkruar në mërgim, në Meksikë, por poezia e tij është e pashkëputshme dhe madje e pakuptueshme pa vetë Kosovën dhe gjuhën shqipe. Dhe, me të vërtetë, ndërkultu-

raliteti në poezinë e Bajrajt është shumë i rëndësishëm, qoftë në nivelin tekstual, por edhe në atë sociokulturor.

Krijimtaria e ndarë midis shqipes dhe spanjishtes

Bajraj përveç shqipes, shkruan në spanjisht dhe përkthen poezitë e tij në shqip, i risjell ato te lexuesi shqiptar që të frymojnë dhe tingëllojnë shqip dhe më origjinale. Dihet se përkthimi letrar do përkushtim dhe një kulturë të gjerë të dijes, duke filluar nga njohja e kulturës dhe kompleksitetit gjuhësor të vendit prej nga vjen autori i veprës së përkthyer. Xhevdet Bajraj shërben si një urë lidhëse midis shqipes dhe spanjishtes dhe midis Kosovës dhe Meksikës, meqë poezia e tij bashkon dy kulturat dhe krijon një rrjet interkulturalizmi përmes poezisë dhe tematikave që lidhen me kulturën shqiptare dhe veçanërisht ngjarjet për luftën e Kosovës, motivin e lirisë, familjen dhe vendlindjen e poetit dhe në anën tjetër, zbërthen edhe kulturën meksikane përmes përvojave personale gjatë jetës së tij më shumë se dy dekada në Meksikë.

Shqipja dhe spanjishtja nuk janë uji e zjarri brenda meje, janë dy zjarre që bashkohen. Janë dy zogj në një distancë të shkurtër mes veti... (ExLibris, 2021)

Do të shprehet poeti në një intervistë të tij...

Në spanjisht Bajraj e sjell Rahovecin e tij me tiparet karakteristike të natyrës, historisë, identitetit, gjuhës, zakoneve dhe elementeve më të rëndësishme të cilat poeti i kujton në librat e tij. Xhevdet Bajraj është një nga poetët më prodhimtarë të letërsisë bashkëkohore me një volum të madh veprash poetike. Pjesa më e madhe e krijimtarisë së tij botohet pas largimit nga Kosova. Vepra e parë e tij titullohet “Nënë prej guri” botuar në Rilindje më 1988 dhe më pas vijjnë titujt e tjerë, si “Emblemë e vdekjes”, “Copë e humbur e parajsës”, “Ditë e zezë”, “Në hijen e kaktusit”, “Kur engjëjt qajnë”, “Liria e tmerit”, “Blues nën qiellin e indianëve”, “Ruego Albanes apo Përgjërimi shqiptar”, “Vitet që nuk e sollën pranverën”, “El tamaño del dolor apo Madhësia e dhimbjes”, libër i botuar në spanjisht që u prit shumë mirë nga lexuesi meksikan, “Copa ime e qiellit”, “Ca kokrra rrushi nga Rahoveci”, “Kur qajnë hardhitë”, “Lëngu i trëndafilave”, “Me zemër në qese najloni, kafe me nënën”, “Vrasja e mushkonjës”, një poemë e cila me kohë u

shndërrua në monodramë dhe në Kosovë fitoi çmimin për dramën më të mirë.

Kosova dhe Meksika si një ndërkulturore në poezinë e Bajrajt

Në vargjet e Bajrajt të dy hapësirat, Kosova dhe Meksika bashkëjetojnë dhe shkrihen brenda vargjeve plot figuracion të poetit. Kosova pasqyrohet si një dhimbje e përhershme, si mall, si një dashuri e zjarrtë që nuk shuhet dhe që shërben si shtyllë përbërëse e frymëzimit të tij poetik. Një rol kyç këtu luan kujtesa për luftën e Kosovës, në vitet kur edhe vetë poeti largohet nga Kosova për në Meksikë. Ajo është koha determinuese kur krijimtaria e poetit ndahet në dy pjesë dhe pjesa më e madhe dhe më e suksesshme e krijimtarisë së tij do të zhvillohet jashtë atdheut të tij, por motivet e viteve të luftës do të mbeten gjithnjë prezente në vargjet e tij. Poezitë si “Tablo luftë”, “Ca lule të kuqe”, “Fajtori”, “Hordhitë”, “Kafkat”, “Fëmijët e luftës”, “Guiso albanés” (Zierje shqiptare), e shumë të tjera trajtojnë dhimbjen e vuajtjen e thellë të popullit të pafajshëm në Kosovë, ku përmes stilistikës së pasur, poeti Bajraj shpalos tmerret e luftës dhe dhimbjen e tij për popullin e vet, për atdheun që siç shprehet në një poezi të tij të titulluar *Temporada de las flores tristes* apo në shqip “Stina e luleve të trishta”:

Se dikur kam humbur një atdhe

dhe tani jetoj këtu

me bark plot e me shpirt bosh...

(Bajraj, <http://lacomparenciainfinita.blogspot.com/2022/09/xhevdet-bajraj-temporada-de-flores.html>)

Vargje shumë të fuqishme që thonë shumë për simbolikën e luftës dhe ndarjen nga atdheu, duke u zhvendosur në një kontinent tjetër, ku sado që të kesh pasuri materiale, nuk mjafton për të qenë i lumtur shpirtërisht. Te vëllimi me poezi “El tamano del dolor” (Madhësia e dhimbjes), lexuesit spanjollë i ofrohet një pasqyrë shumë e qartë e luftës në Kosovë, realitetit dhe vdekjeve të shumta, të cilat vishen me një petk të pasur poetik, aty ku shfaqet identiteti i njeriut kosovar dhe kultura e vendit, aty ku shfaqet qartë fytyra e vërtetë e pushtuesit, i këndohet vendit si një himn, si një dokument, si dëshmi e asaj se çfarë ka përjetuar në të vërtetë kjo tokë. Brenda këtyre var-

gjeve, paralelizmi figurativ shpeshherë shërben si një ndërkulturore, duke e krahasuar të tashmen dhe jetën në Meksiko Siti dhe të kaluarën në Kosovë. Jeta larg atdheut i jep një motiv shtesë dhe e formëson imagjinatën krijuese të tij, bëhet objekti kryesor që shërben si fillesë e shumë poezive të tij, qoftë ato të shkruara në shqip, qoftë ato në spanjisht. Bajraj e trajton Kosovën në dy rrafshë, kohën e luftës, por edhe atë të pasluftës, kryesisht duke trajtuar situatën socio-politike dhe shpesh duke e kritikuar realitetin aktual edhe me një dozë humori e ironie. Poezia e Bajrajt shërben si një ambasadore letrare e Kosovës në Meksikë, sepse shpërfaq dendur dhe në formë eksplicite realitetet e luftës dhe të pasluftës në Kosovë. Te vëllimi me poezi “Kur qajnë hardhitë”, në shqip dhe spanjisht paralelisht pasqyrohen tmerret dhe gjenocidi serb në Kosovë, ku në plan të parë është tema e lirisë, një temë që e shoqëron poetin pothuajse gjatë gjithë krijimtarisë. Ja se si shprehet ai në poezinë që mban vetë titullin e librit “Kur qajnë hardhitë”:

*Dikur do ta kuptojnë të gjithë
sa e rëndë është jeta në Kosovë
sa lehtë është të vdiset atje
Dikur
të gjithë do ta kuptojnë
sa gjatë
sa dhimbshëm qan zemra
qajnë hardhitë
para se të thahen... (Bajraj, 2019)*

Ose në poezinë “Fajtori” ku dhimbja fiton një dimension universal dhe shpreh atë realitet që poetin e vret në shpirt vazhdimisht dhe nuk e lë të qetë as me mijëra kilometra larg atdheut.

*M'i morën të gjitha
dhe unë vazhdoja të isha fajtori
Tani në Parque Mexico i ushqej
zogjtë e gjymtuar që i shpik shpirti im
dhe herë pas here
në shtëpinë time të re
qaj me zë të latë
në gjumë. (Bajraj, 2019)*

Tema e mërgimit si përvojë interkulturore

Mërgimi historikisht ka zënë një pozitë shumë të rëndësishme në veprat letrare në mbarë historinë e letërsisë botërore dhe nuk ka munguar as në letërsinë shqipe, ku shkrimtarë të ndryshëm kanë pasqyruar jetën, vështirësitë, sfidat dhe mallin për atdheun e tyre gjatë qëndrimit larg saj, gjatë jetës në mërgim, në vende të ndryshme të globit. Ngjashëm ka ngjarë edhe me Xhevdet Bajrajn, i cili është prej poetëve të rrallë që jetën dhe veprimtarinë e ka vazhduar në një vend të largët si Meksika dhe ku ka kontribuar shumë në zhvillimin e poezisë shqipe bashkëkohore. Tema e mërgimit është e pashmangshme në poezinë e këtij poeti dhe ajo manifestohet në shumë prej vëllimeve të tij, ajo në fakt është e shkrirë në vargje dhe bën ndërlidhjen, paralelizmin mes dy vendeve, dy gjuhëve, dy kulturave të ndryshme të cilat bashkëjetojnë në identitetin e vetë poetit. Meksiko Siti del si një hapësirë ku uni poetik krijon një jetë të re, një realitet të ri, por që gjithnjë mbushet me remineshencat e së kaluarës, të viteve të fëmijërisë së poetit dhe rinisë së tij në Rahovecin që e kujton me shumë mall. Dy kultura gjejnë pikëtakime në vargje, kanë një emërues të përbashkët, vetë vargun, motivet, simbolikën dhe shtrihen në hapësirë të gjerë kohore, prej fëmijërisë në Kosovë e gjer në vitet e fundit gjatë jetës në mërgim. Me metaforat e shumta, poeti identitetin e vet e manifestohen përmes mallit dhe shqetësimit që ka për Kosovën dhe kombin e tij shqiptar në përgjithësi, duke e vënë në kontekstin e jetës në mërgim, duke u shprehur me gjuhën e një mërgimtari, trupi i të cilit është larg atdheut, por shpirti është po aty, në zemër të Rahovecit, rrushit, rakisë, familjarëve dhe miqve të tij, por edhe zhvillimeve që ngjajnë në Kosovë. “Dielli i mërgimit” është një poezi me vetëm një strofë, por që thotë shumë më tepër.

Liria që më rrethon

është një kafshë

që më kafshon

nën diellin e dy botëve (Bajraj 2017)

Këtu kuptimi semiotik është i qartë, jeta në mërgim mund të të sjellë lirinë, por jo lirinë për të cilin ka luftuar populli yt, aty ku është derdhur gjaku i vendit ku ke lindur e je rritur. Mërgimi si motiv shfaqet bukur edhe

në poezinë “Babait tim”, ku pasqyrohet dhimbja dhe jeta larg familjes, në poezinë “Shqiponja” ku poeti përmes personifikimit, bashkon dy kulturat brenda formimit të tij identitar. Ngjashëm me këtë poezi është edhe poezia “Shpikësi”, ku bashkëjetojnë të dy kulturat dhe hapësira integrale janë të dyja vendet, Kosova dhe Meksika.

Poezia e Xhevdet Bajrajt dëshmon lidhjen e ngushtë me vendin e vet, me Kosovën, me Rahovecin dhe me karakteristikat e vendit dhe kulturës prej nga vjen vetë ai, dhe jo vetëm që i ruan ato, por në valixhen e tij poetike e shpirtërore i mban përherë afër dhe në formë pasqyre ndaj shoqërisë dhe kulturës meksikane e spanjishtfolëse, duke i shfaqur haptazi dhe me plot krenari për Kosovën e tij të dashur. Me motivet e dashurisë për vendin, mërgimin, lirinë, dashurinë, gruan dhe motive të tjera poetike e universale, Bajraj meriton një vend shumë të rëndësishëm në letërsinë bashkëkohore shqipe. Duke shkruar në të dy gjuhët, ai dëshmon kulturën e gjerë, dëshirën për t’u shprehur në mënyrë sa më origjinale në të dyja gjuhët dhe me një figuracion shumë të pasur letrar, ka arritur t’i ofrojë lexuesit të të dyja kulturave vëllime cilësore me poezi, të cilat nuk duhen vështruar vetëm si sasi, por të lexohen me kujdes e të studiohen thellësisht, sepse lexuesi e studiuesi letrar do të përfitojë dhe zbulojë shumë nga pasuria poetike e Xhevdet Bajrajt.

Literatura:

Xhevdet Bajraj, Lëngu i trëndafilave, Koha, Prishtinë, 2017.

Xhevdet Bajraj, Kur qajne hardhitë, Armagedoni, Prishtinë, 2019.

Exlibris, Botime i Onufri, nr. 120/2021, Tiranë.

Von Zimmerman, Christian. “Kulturthema Migration und Interkulturelles Schreiben”. *recherches germaniques*. Ed. Christine Maillard. Revue Annuelle. Serie N°3, 2006. 7 – 25.

<http://lacomparenciainfinita.blogspot.com/2022/09/xhevdet-bajraj-temporada-de-flores.html>

Neli NAÇO

PËR NJË RITIPOLOGJIZIM TË RRËFIMEVE TË MITRUSH KUTELIT

Abstrakt:

Rrëfimi i Mitrush Kutelit pasuroi traditën e rrëfimit shqip duke i dhënë atij lirshmërinë e cila e ktheu në një vepër që të ofronte lirshëm atë që quhet “kënaqësia e tekstit”. Kjo vepër u çliroi gjuhën e paërpunuar rrëfimtare të prozës shqipe, duke shfrytëzuar karakteristika tipike të ligjëritimit popullor dhe duke krijuar iluzionin e një ligjëritimi “oral”. Vetë emërtimet që Kuteli përdor rrëfime dhe rrëfenja për tipin e tregimit të tij janë një shprehje e një artikulimi të vetëdijshëm për llojin e prozës që ai po krijon. Duke iu qasur rrëfimit të Mitrush Kutelit në një këndvështrim tjetër, dukë kërkuar në një marrëdhënie të prozës së tij me realitetin, me vërtetësinë dhe ngjashmërinë e rrëfimit me “ngjarjen” themeltare që është origjina e rrëfimit (ose rrëfenjës) të tij. Në dritën e këtij këndvështrimi ne kemi ndërtuar një tipologji të rrëfimit që lidhet me konceptin e ndërtimit bazik kulturor – antropologjik që Kuteli ka përdorur në strukturimin e rrëfimit. Kemi dalluar kështu atë rrëfim që mund të quhet “rrëfimi i fantastikës antropologjike” ose “fantastikja antropologjike” i cili përkon më së shumti me konceptin e rrëfenjës kuteliane. Mbi parimin e vërtetësisë dhe ngjashmërisë me realitetin kemi ndërtuar disa nënndarje të rrëfimit të Mitrush Kutelit në “realizmin antropologjik”, “fiksionalizmin antropologjik” dhe “kulturalizmin antropologjik”. Tipari “kulturor” është një tipar që mund të shërbejë për të karakterizuar të gjithë veprën e Kutelit, por në emërtimet tona ne kemi përdorur atë emërtim që i shkon rrëfimit për shkak të intensitetit që ka një tipar i caktuar “real” brenda rrëfimit. Njohja e kulturës lokale nga brenda saj na ka shërbyer për të bërë këtë lloj karakterizimi të rrëfimit të Kutelit. Ne kemi kështu disa

modele tregimesh të cilat mund të hedhin dritë mbi marrëdhënien elementare të asaj që Wolfgang Iser i ka quajtur “literary anthropology” dhe procesin e “fiksionalizimit” (fictionalizing) në letërsi.

***Fjalë çelës:** rrëfimi, fiksionalizimi letrar, antropologjia letrare, kulturalizmi antropologjik.*

Abstract:

Mitrush Kuteli's narration enriched the tradition of Albanian narration by gifting the freedom which turned it into a work that fluently offered what is called “the pleasure of text”. This work liberated the raw narrative language of Albanian prose, using typical features of popular discourse and creating the illusion of an “oral” discourse. The names that Kuteli uses for his stories, narration and magical narration are expressions of a conscious articulation of his prose. Approaching Mitrush Kuteli's narration from a different perspective, looking for a relationship between his prose and reality, we find the authenticity and similarity of narrative with fundamental “event” that is the origin of his narration (or magical narration). From this point of view, we have built a narration typology that is related to the concept of basic cultural-anthropological construction that Kuteli used in his narration structure. We have thus distinguished that narrative that can be called “narration of anthropological fantastic story” or “anthropological fantastic story” which coincides mostly with Kutelian narration concept. Based on the principle of authenticity and similarity to reality, we have built several subdivisions in Mitrush Kuteli's narration reflected as “anthropological realism”, “anthropological fictionalism” and “anthropological culturalism”. The “cultural” feature can serve to characterize all Kuteli's work, but we have used the designation that fits narration because of its intensity and a certain “real” feature within narration. Knowing the local culture from inside has served us to make this kind of characterization in Kuteli's narrative. We thus have several models of stories that can shed light on the elementary relationship of what Wolfgang Iser has called “literary anthropology” and the process of “fictionalizing” in literature.

***Keywords:** narration, literary fictionalizing, literary anthropology, anthropological culturalism.*

A ka një marrëdhënie të dukshme midis fikSIONIT dhe REALITETIT në veprën letrare? A ka vepra letrare ku mund të hulumtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë kjo marrëdhënie fikSION-REALITET? A mund të jetë marrëdhëna midis fikSIONIT dhe REALITETIT një marrëdhënie konstante në veprat e një shkrimtari? A ka shkrimtarë të cilët duan të realizojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë një vepër të tipit të drejtpërdrejtë antropologjik, për arsye të hedhjes dritë mbi një proces real, ku fikSIONIT nuk i jepet një rëndësi e dorës së parë?

Na ka shtyrë ky interes që t'i qasemi me një botëkuptim antropologjik veprës letrare të Kutelit e cila duket sikur në tërësinë e saj përmban mjaft material me interes në këtë drejtim. Në dritën e këtij këndvështrimi ne kemi ndërtuar një tipologji të rrëfimit që lidhet me konceptin e ndërtimit bazik kulturor – antropologjik që Kuteli ka përdorur në strukturimin e rrëfimit. Kemi dalluar kështu atë rrëfim që mund të quhet “rrëfimi i fantastikës antropologjike” ose “fantastikja antropologjike” i cili përkon më së shumti me konceptin e rrëfenjës kuteliane. Mbi parimin e vërtetësisë dhe ngjashmërisë me realitetin kemi ndërtuar disa nënndarje të rrëfimit të Mitrush Kutelit në “realizmin antropologjik”, “fiksionalizmin antropologjik” dhe “kulturalizmin antropologjik”. Tipari “kulturor” është një tipar që mund të shërbejë për të karakterizuar të gjithë veprën e Kutelit, por në emërtimet tona ne kemi përdorur atë emërtim që i shkon rrëfimit për shkak të intensitetit që ka një tipar i caktuar “real” brenda rrëfimit. Njohja e disa tipareve të kulturës lokale, nga brenda, na ka shërbyer për të bërë këtë lloj karakterizimi të rrëfimit të Kutelit. Ne kemi kështu disa modele tregimesh të cilat mund të hedhin dritë mbi marrëdhënien elementare të asaj që Wolfgang Iser i ka quajtur “literary anthropology” dhe procesin e “fiksionalizimit” (fictionalizing) në letërsi.

Rrëfimi i Mitrush Kutelit pasuroi traditën e rrëfimit shqip duke i dhënë atij lirshmërinë e cila e ktheu në një vepër që të ofronte lirshëm atë që quhet “kënaqësia e tekstit”. Kjo vepër e çliroi gjuhën e papërpunuar rrëfimtare të prozës shqipe, duke shfrytëzuar karakteristika tipike të ligjëritimit popullor dhe duke krijuar iluzionin e një ligjëritimi “oral”. Vetë emërtimet që Kuteli përdor rrëfime dhe rrëfenja për tipin e tregimit të tij janë një shprehje e një artikulimi të vetëdijshëm për llojin e prozës që ai po krijon. Duke iu qasur rrëfimit të Mitrush Kutelit në një këndvështrim tjetër, duke kërkuar në një marrëdhënie të prozës së tij me realitetin, me vërtetësinë dhe ngjashmërinë e rrëfimit me “ngjarjen” themeltare që është origjina e rrëfimit (ose rrëfenjës)

të tij, arrijmë në disa përfundime të ndryshme nga ato që janë marrë si bazi-ke për rrëfimtarinë e Kutelit.

Letërsia e Mitrush Kutelit; rrëfimtaria e tij me emërtimin rrëfime dhe rrëfenja; tiparet e saj të sendërtuara në frymën e letërsisë popullore dhe me një lidhje gjenetike-kulturore me letërsinë rumune (aty ku Kuteli u formua natyrshëm dhe ndërtoi një letërsi që i përkiste një matrice kulturore me shkrimtarë të njohur rumunë); fryma e kësaj letërsie dhe marrëdhënia me kulturën popullore: oraliteti – tipar domethënës i kësaj matrice letrare dhe shumë detaje të tjera janë kthyer në fokusin e studimeve letrare ndonjëherë duke krijuar edhe një sasi të madhe artikulimesh të tepërta që shpeshherë përsërisin ide të studimeve paraardhëse.

Ndarja që ka mbetur në formën e një binomi është ajo që Kuteli e ka përdorur në botimet e veta “Rrëfime dhe rrëfenja”. Nasho Jorgaqi shprehet për këtë çështje: “Ndarja e tyre në rrëfime dhe rrëfenja është përcaktuar sa nga tematika, aq dhe nga fryma që ngërthejnë. Në qoftë se në të parat zotërojnë tema patriotike-sociale, në të dytat trajtohen motive folklorike dhe mitologjike.” (Nasho Jorgaqi, 1990, faqe 19).

Ndarja rrëfime dhe rrëfenja është, siç thamë, e artikuluar prej Kutelit, por e papërkufizuar nga ai, ka mbetur e pandryshueshme, duke iu bërë një përkufizim dituror, por i marrë dhe ai i mirëqenë dhe i padiskutuar. Sipas këtij koncepti rrëfimi dhe rrëfenja ndahen, diferencohen më së shumti prej motiveve që ato bartin. Nga një pikëpamje më teknike fjala “rrëfim” e markon dukshëm fjalën “rrëfenjë” dhe se “rrëfenja” nuk mund të jetë veçse një lloj i veçantë “rrëfimi”. Nëse do ta shihnim më në thellësi, rrëfenja do të dallohej prej rrëfimit sipas nesh në një pikë interesante që ka të bëjë me motivin. Në rrëfenjë sasia e fiksjonalizimit letrar të bartur që prej kohës së lashtë është shumë më e madhe sesa sasia e fiksjonalizimit të sjellë prej autorit në rrëfim. “Sasia e fiksjonalizimit” është një nga konceptet çelës që na ka ndihmuar që të shohim rrëfimin e Kutelit në një dritë të re së bashku me disa koncepte që kanë të bëjnë kryesisht me kulturën dhe antropologjinë e jetës në rrëfim.

Realizmi antropologjik

Ideja për gjetjen e një vepre e cila ndërtohet edhe si letërsi edhe si e vërtetë kulturore-antropologjike në një masë, le të themi të barabartë, më ka shpënë te vepra *Pengu i kaçakëve* rrëfim i Gjerasim Qiriazit. Nuk kam gjetur ndonjë vepër të ndërtuar në një mënyrë të tillë që të rrëfej të vërtetën në një raport mirëfilli antropologjik dhe të mbajë cilësinë e veprës letrare romantike. Si një vepër e tillë ajo mban një status unik në letrat shqipe dhe duhet të rivendoset në fondin e letërsisë romantike (duke e konsideruar si një vepër që ka pasur peripecitë e veta deri në mbërritjen në duart e lexuesit).

Kam shkruar disa rreshta për këtë vepër duke u përpjekur për të vënë në dukje disa tipare të saj:

“Le të kthehemi për një moment në gjithë historinë interesante që autori tregon në një formë skenari në veprën *Pengu i Kaçakëve*. Historia nisur nga ngjarja përfaqëson një vlerë kuazi-fotografike të një pjese të jetës shqiptare. Ajo përfaqëson një tregim të rëndësishëm të realitetit të cilin, me sa duket, nga stili i autorit, metoda e shkrimore e përdorur, ndodhia që përputhet me strukturën e rrëfimit dhe që e përcakton atë, autori e tregon me një saktësi antropologjike. Kjo metodë e rrëfimit të drejtpërdrejtë do të përdoret edhe në antropologjinë kulturore si mënyrë e regjistrimit të ngjarjeve. Është një vepër që ka një lloj ekspresioni, por antropologjikisht besnike, nëse do të mund ta quanim kështu. Në këtë pikëpamje *Pengu i Kaçakëve* përbën një shkrim unik. Ajo përbën një realitet, një vlerësim real i një fragmenti të shoqërisë shqiptare. Ajo rrëfen atë që është.” (Neli Naço 2017, faqe 54).

Kjo vepër ruan një marrëdhënie me realitetin që e ruajnë gjithashtu disa rrëfime të Kutelit. Nuk po i përjasim veprat si vepra të të njëjtit nivel artistik, dhe as po vëmë në dyshim aftësitë e larta të Kutelit në rrëfimet e tij. Por po shohim një intencion të njëjtë në rrëfimin e ngjarjeve dhe të vërtetës. Meqenëse e kemi përkufizuar më sipër e cila “rrëfen atë që është” ose që “rrëfen atë që ndodhi” kuptohet me një vërtetësi të lartë dhe shkallë fiksi-onalizimi të ulët kemi ndërtuar nisur prej këtu dhe këtij parimi grupimin e

tregimeve të quajtura si “realizmi antropologjik”. Kemi vërejtur në këto tregime disa tipare që kanë të bëjnë më një raport të veçantë të ngjarjes reale me ngjarjen e rrëfyer. Mund të shpreheshim që ngjarja reale është e njëjtë me ngjarjen e rrëfyer; përshkrimi i hapësirës është i verifikueshëm, lexuesi mund të kontrollojë vendndodhjen e personazheve dhe të kuptojë vërtetësinë e ngjarjeve. Shkalla e asaj që është e trilluar nga autori është pothuajse e papërfillshme. Verifikimi dhe saktësia e ngjarjeve rituale është dhënë në mënyrë të saktë, në përputhje me ritualet e përshkruara në librat etnografikë. Rrëfimet janë tejet personale dhe vendet e memorjes personale apo kolektive janë me emrat e tyre të vërtetë. Ka një dëshirë të brendshme që personaja të bëhet e rëndësishme dhe të sakralizohet, të bëhet e shenjtë, jo nëpërmjet të jashtëzakonshmes, por nëpërmjet vetë aktit të rrëfimit. Dy nga rrëfimet që mund të përmendim padyshim këtu janë: “Fije nga Jeta e Theofil Kostorit” dhe “Të vdekurit”. Për shkak të relacioneve të forta realitet - vepër ndodh që emri kryesor i rrëfimit të jepet i transformuar me siguri për arsye etike. Kuteli krijon një simbolikë të thjeshtë emrash në këtë rast duke u përpjekur të krijojë një simbolikë deri diku të lexueshme. Rrëfime të tjera që do t’i përkisnin kësaj kategorie janë edhe “Rusa-Papusa”, “Babalja”, “Për Kumbulla”, “Hanet e Karvanet”, “Papu Tira”.

Një tipar i këtyre rrëfimeve është lidhja e pakëputur që kanë rrëfimet me personazhe nostalgjike të rrëfimtarisë së autorit, me memorjen individuale të autorit dhe pikëlidhjet që ka memorja individuale e autorit me memorjen kolektive ose memorjen kulturore të bashkësisë. Thuajse në të gjitha rrëfimet e kësaj kategorie rrëfimtari është në botën e fëmijërisë dhe e sakralizon atë si një kronotop të shenjtë. Kronotopia e rrëfimit mbi fëmijërinë është në të njëjtën kohë hapësirë abstrakte e së shenjtës. Kjo sepse fëmijëria jonë është e shenjtë dhe vetë kultura ka vendin e shenjtë brenda fëmijërisë. Madje qenia dhe vetë gjuha strehohen në zonën më të pastër të qenies fëmijërore, në kulturën e bashkësisë në fëmijëri, sepse kultura në format e saj më të pastra na vjen në ngjarjet e fëmijërisë. Mjafton të kujtojmë këtu rrëfimin e e titulluar “Të vdekurit” i cili është një nga rrëfimet ku ky realizëm antropologjik është kaq i kthjellët sa na ka dhënë një vizatim të përpiktë kronotopik mbushur me ndjesi delikate personale. Mbase ky rrëfim është dhe më përfaqësuesi i këtij grupi rrëfimesh.

Kulturalizmi Antropologjik

Një grup rrëfimesh që lidhen me rindërtime kulturore identitare, sipas konceptit të vetë grupimit kulturor ne e kemi quajtur kulturalizmi antropologjik. Ky koncept i kulturalizmit antropologjik është i lidhur ngushtë më atë tipar identitar që grupimi kulturor e shfaq si tiparin përfaqësues të tij pavarësisht se dikush tjetër mund të mendojë ndryshe.

Mitrush Kutelit është shkrimtari që i përdor këto dallime dhe njësime kulturore për të realizuar një përfshirje letrare të lexuesit në një plan interesant: lexuesi ndihet i përfshirë kulturalisht në receptim. Nganjëherë me një shprehje gjuhësore Kuteli në disa prej rrëfimeve të tij realizon përfshirjen kulturore të lexuesit (edhe ky anëtar i bashkësisë) në receptim. Këto shprehje gjuhësore fraza shpallin kryesisht si *Kulturë* atë që mendon rrëfimtari se është e njëjtë dhe unifikuese. Dimensioni *Kulturë* shpallet si zotërues dhe unifikues i entitetit, dimensionet e tjera nuk kanë rëndësi. Nocioni i fshatit është dhënë shpeshherë si nocion i një minikulture. Çdo aspekt minikulturor zhvillohet si një aspekt kulturor dhe mbi atë aspekt shpallet kultura e minigrupit (fshatit).

Rrëfimi që përfaqëson këtë lloj tipologjie të grupimit që lidhen më kulturalizmin antropologjik, është “Fshati ynë e pi rakinë”.

“Në këtë rrëfim është diferencuar njësia kulturore (fshati) nga çdo njësi tjetër kulturore, çdo fshat tjetër rreth e rrotull, në veri a në jug, gegë apo toskë. Dallimi kulturor është më i rëndësishëm se dallimi gjenealogjik, racial apo krahinor. Ky dallim kulturor, në fakt, bëhet baza që personi i dallueshëm të dallohet prej të tjerëve edhe nga pikëpamja e origjinës dhe fisit. I gjithë dallimi kulturor është shndërruar kështu në një lojë e cila i dallon qeniet sipas një zhvillimi kulturor, gjendja e tjetrit pranë natyrës, pa tiparin kulturor dallues, pa atë që e njëjtëson me grupin (pirjen e rakisë dhe prodhimin e saj) është shenjë prapambetjeje, mungese civilizimi, qenësi në një grup tjetër më të ulët kulturalisht.” (Neli Naço 2021, faqe 48).

Aq shumë është i përfshirë në këtë rrëfim secili individ dhe secili minirëfimtari në shpalljen e identitetit kulturor të grupit sa i gjithë rrëfimi nuk

është gjë tjetër veçse një minirrëfim që përpiqet të shpallë sa më mirë këtë identitet kulturor. Ne e dimë që kemi të bëjmë me shpalljen e një identiteti kulturor në gjithë veprën e Kutelit, por gjithnjë po flasim për kategori ku njëri nga tiparet është dominant ndaj të tjerëve. Ky tipar dominues na jep mundësinë që ne të emërojmë tipin e rrëfimit të Mitrush Kutelit me një saktësi më të madhe, në mënyrë që të realizohet dhe diferencimi nga tipat e tjerë të rrëfimeve.

Fiksionalizmi antropologjik

Këtë kategori të rrëfimeve të Mitrush Kutelit e kemi emëtruar mbi bazën e një tipari i cili është emërton vetë gjininë e prozës: fikzioni.

Fiksionalizmi antropologjik është një shkëputje e letërsisë që bën Kuteli duke i qëndruar besnik pjesës së memorjes individuale. Fiksionalizmi antropologjik është i lidhur, por edhe i shkëputur me ngjarjen antropologjike. Kemi aty një bërthamë ngjarjeje dhe materiali antropologjik, por kemi njëkohësisht edhe përpunimin e ngjarjes reale me të njëjtën frymë antropologjike si atë të grupimit kulturor. Kemi identifikuar disa rrëfime të tilla që kanë një bazament historik antropologjik. Do të rendisim këtu rrëfimet madhore të Kutelit “Si e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit”, “Xha Brahua i Shkumbanores”, “Vjeshta e Xheladin beut”, “Qetësi përpara fërtymme”, “Më Kot”, “Si u takua Ndoni me Zallorët”, “Natë vjeshte të tretë”, “Natë muaji Shëmbitër”, “Hekuri dhe Çeliku” e të tjerë.

Ngjarja kulturore është këtu vetëm shkaku fillestar i rrëfimit, letërsia e Kutelit e fiton vlerën e fikSIONALES përmes rritjes së imagjinatives. Ngjarja fillestare mund të transformohet, fikzioni vepron mbi ngjarjen kulturore, por pa u shkëputur nga kultura. Ai krijon një vepër fikSIONALE në përputhje me ngjarjen kulturore fillestare. Fikzioni në këtë rast është më i afërt kulturalsht me receptuesin edhe se vetë ngjarja. Imagjinativija krijuese është një rast i vërtetë i Kutelit krijues. Mbi bazën e një produkti kulturor prodhon një produkt të ri kulturor që është i njëjtë me kulturën e lexuesit. Ai prodhon një fikSION të ri, të pashkëputur nga kultura dhe e riaktualizon atë. Aq shumë e riaktualizon rrëfimin sa rrëfimi fikSIONAL bëhet një përfaqësues kultural i pamohueshëm. Tipik do të mbetet në këtë rast rrëfimi “Vjeshta e Xheladin beut”.

Kjo pjesë e rrëfimitarisë së Kutelit është më e rëndësishmja; kanë dalë prej aty disa rrëfime të rëndësishme të krijimtarisë së Kutelit që çuditërisht ndonjëherë keqinterpretohen, sepse lexuesi përpiqet të gjejë interpretime alternative që janë mjaft larg interpretimeve të duhura, sepse lënë mënjanë lidhjen që ka kjo lloj letërsie me kulturën.

Fantastikja antropologjike

Rrëfime që shfaqin në mënyrë më të madhe imagjnativen janë rrëfimet që ne i kemi quajtur si fantastikja antropologjike. Janë rrëfime që kanë bazë mirëfilli të fantastikës. Procesi i fiksjonalizimit në disa raste është statik dhe i bartur, ndërsa zhdërvjelltësia e rrëfimit të Kutelit i bën që ato të kenë fluiditetin që ka fryma rrëfimtare e rrëfimit siç e ka të shtrirë në gjithë krijimtarinë. Tipike këtu do të ishin rrëfimet “Rinë Katerinëza”, “Lugetërit e fshatit tonë” kryesisht ritregimet e krijimtarisë folklorike në prozë. “E madhe është gjëma e mëkatit” do të mbetet pjesa më e çmuar e llojit të fantastikës antropologjike meqenëse Kuteli ia ka nënshtuar atë një procesi të detajuar fiksjonalizimi duke na dhënë një vepër ku fiksjonalizon dhe mbush me imagjinatë një vepër folklorike, duke na dhënë një metaforë letrare që na e ofron vetë letërsia moderne.

Bibliografia:

- Mitrush Kuteli (1944), *Netë shqipëtare*, Tiranë.
- Mitrush Kuteli (1944), *Kapedan Gardani me shokë*, shtypshkronja Luarasi, Tiranë.
- Mitrush Kuteli (1944), *Kapllan Aga i Shaban Shpatës*, Tiranë.
- Mitrush Kuteli (1943), *Ago Jakupi e të tjera rrëfime*, Tiranë.
- Mitrush Kuteli (2006), *E madhe është gjëma e mëkatit*, Botimet Grand Prind, Tiranë.
- Mitrush Kuteli (1990), *Vepra 2*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë.
- Mitrush Kuteli (1990), *Vepra 2*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë.
- Nasho Jorgaqi (1990), “Parathënie” në Mitrush Kuteli, *Vepra 1*, Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë.
- Neli Naço (2017), Konferencë Shkencore Mbarëshqiptare, 130 vjet *Mësonjëtorja e Parë Shqipe – vatër e arsimimit dhe ngritjes së vetëdijes kombëtare të shqiptarëve*, “Krestomacia e Gjerasim Qiriazit si tekst didaktik”, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Korçë, 6 Mars 2017.
- Neli Naço (2021), *Antropologjia e Jetës Shqiptare në Rrëfimet e Mitrush Kutelit*, (Disertacion), Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë.

Erenestina GJERGJI (HALILI)
Kastriot GJIKA

DRAMA DHE TEATRI - URA INTERKULTURALE E GJINIVE LETRARE, ARTIT DHE KULTURËS

Hyrje

Marrëdhëniet midis gjinive e zhanreve letrare, përmes folësit ndërkulturor, në kontekstin e letërsisë, rezonojnë problematika që lidhen domosdo me ndërkulturën, e cila nga ana e saj shprehet dhe rijetësohet në tablo individuale e kolektive, në mënyrë tipike përmes procesit të dramatizimit.

Ky proces, si një akt mirëfilli letrar e më pas edhe artistik, pedagogjik, didaktik, vepron si akt komunikues, si ndërmjetës kultural, duke siguruar kushtet bazike jo vetëm të edukimit me bashkëjetesën e kulturave të ndryshme, por edhe aspekte të tjera të jetës komunitare, brenda mureve të një komuniteti arsimor e jashtë tij, në formate të ndryshme shoqërore.

Në këtë rast, dramatizimi, si proces i shndërrimit të një teksti jodramatik në tekst të gjinisë dramatike, merr pozitën e mediumit eksplorues të vëzhgimit, analizës dhe raporteve kulturore, etnografike, sociale etj., por në të njëjtën kohë, jep mundësinë e vëzhgimit të lëvizjes brenda letërsisë të teksteve fikzionale dhe jofikzionale, si dhe përfaqësimin e tyre. *Dramatizimi është “shfaqja”: krijimi i skenave që vendosen në një vend të caktuar, në një kohë të caktuar dhe në të cilat ndodhin gjërat. Ndërsa lexuesit përjetojnë një skenë me ne, ata përdorin të gjitha shqisat, përdorin mendjet e tyre.[...]Ata munden të sjellin imagjinatën e tyre në proces dhe - kjo është e rëndësishme – tërheqin përfundime për ato që po tregohen.*

Përmes procesit teatralizues, dinamikat e ndryshme të paraqitura në pretekstin e mëparshëm, riaktualizohen dhe shërbehen për një tjetër publik, me

personazhe (arketipa) që riformatohen në situata tashmë dramatike (prej gjinisë) dhe rikontekstualizohen përmes mjeteve e teknikave teatrore, duke siguruar jo vetëm shije të reja estetike, por edhe përhapje e njohje të vetë letërsisë, në një tjetër formë, duke bashkëvepruar mes tipologjive të ndryshme letrare, por edhe traditës letrare të vetë tekstit me bashkëkohësinë, apo duke nxjerrë në pah prerje të ndryshme mes ndikimeve brenda vetë letërsisë. *Drama arsimore, me teknikat e saj dhe vetë procesi i dramatizimit konsiderohen tashmë jetike në edukim, në kushtet e një shoqërie gjithnjë në lëvizje të vazhdueshme jo vetëm demografike, por rrjedhimisht edhe kulturore, arsimore, religjioze, estetike etj.*

Përmes aspekteve të tij të analizës lëndore tekstuale dhe mjeteve të zbërthimit përmbajtësor, strukturor dhe tekstor, ky proces dramatizues nxjerr në plan të parë disa elemente të interkulturalitetit, të cilët i japin vetë atij vetinë e një procesi unik transmetues dhe unifikues:

Eksplorimi ndërkulturor: Përmes tij, arrihet analiza diakronike dhe sinkronike e periudhës kohore, konteksteve sociale e kulturore të vetë fabulës dramatike, si dhe krijohen e zhvillohen aftësitë e analizës së ngjashmërive e dallimeve, duke kontribuar në ndërgjegjësimin e lexuesit e të shikuesit (publikut), në rastin tonë të nxënësit, studentit.

Empatia, si thelb i katarsës dramatike, përmes së cilës rritet vlera potenciale artistike dhe edukuese.

Stereotipet dhe klisjetë: Përmes thelbit të trajtimit të fabulës dramatike të përfutur nga vetë teksti letrar, apo joletrar, ky proces priret e përfton sfidimin e klisheve shoqërore, psikologjike dhe elementeve të tjerë të mospranimit e të paragjyqimit kulturor, religjioz etj.

Shkëmbimi kulturor, si dhe vetë gjuha dhe komunikimi i japin procesit verbal dhe joverbal të realizimit dramatik, pranim të kuptimeve të ndryshme. Ai bazohet mbi komunikimin e gjuhës së artit, si një gjuhë emocionale, trupore, mimike etj. që siguron zhvillim të kapaciteteve të fshehura, apo të pavërejtura brenda individit e më gjerë. *Dramatizimi është po aq (i vlefshëm) sa teatralizimi (...), d.m.th., arrin të japë strukturë dramatike, të krijojë një strukturë teatrore nga një poezi, tregim, fragment narrativ, deri dhe nga njoftime për lajme etj. duke modifikuar formën organike të këtyre teksteve primare dhe duke iu përshtatur veçorive të skemës dramatike.*

Një aspekt mjaft i veçantë mbetet angazhimi i audiencës, advokimi i ideve të mira për njeriun e shoqërinë, pranimi i diversitetit kulturor dhe zgjidhjet e konflikteve të vetë tekstit mbi parime të ndryshme, që rrjedhin prej ideve të gjeneruara individuale e të vetë grupit, klasës, auditorit etj.

Kompetenca ndërkulturore (KNK)

Përkufizimi i kompetencës duket se është një nocion i komplikuar, mbi të cilin nuk ka një dakordësi të plotë mes studiuesve. Sipas një modeli tre-planësh, që shfaqet shpesh në letërsi, ajo përbëhet nga njohuritë e përgjithshme, njohuritë për të bërë dhe njohuritë për të qenë.

Në fakt, siç nënvizon F. Cambi, kurrikula *“është një nocion kufitar, i cili ka një stemë të brendshme dialektike, që merr vlerë pasi integrohet (dhe nuk ndahet) me nocione të tjera të ndryshme dhe të afërta (si p.sh.: njohuritë, aftësia, refleksiviteti, kritika)”*.

Në koherencë me nocionin e kompetencës, edhe kompetenca ndërkulturore duket komplekse dhe jo e përcaktuar në mënyrë unike nga studiuesit. Ekziston një literaturë e gjerë ndërkombëtare për të, pak e përkthyer në shqip.

Siç vë në dukje A. Fantini, *“ndonëse termi përdoret gjithnjë e më shumë, nuk ka një konsensus të vërtetë për atë çka ai përfaqëson. Disa e theksojnë si njohuri globale, të tjerë si ndjeshmëri [sensitivity], të tjerë si aftësi a shprehje. Megjithatë, këto veçori sugjerojnë se kompetenca ndërkulturore është më komplekse”*. Fantini vë në dukje katër dimensionet brenda kompetencës ndërkulturore: *“njohuri, aftësi, qëndrim dhe vetëdije”*.

Në realitet, modeli nënkupton edhe aspekte të tjera interpretuese dhe përcakton kompetencën ndërkulturore sipas "komponentëve" të ndryshëm, duke përfshirë: karakteristika ose tipare (si fleksibiliteti, çiltërsia, interesi, kurioziteti, etj.); katër dimensionet: njohuri, qëndrime (pozitive), aftësi, vetëdije; kompetenca e komunikimit në një gjuhë tjetër. Zhvillimi i kompetencës ndërkulturore nënkupton një proces të gjatë në kohë dhe të vazhdueshëm, për të cilin, megjithatë, mund të identifikohen disa faza ose stadi të ndryshme të njëpasnjëshme. Për Fantinin, pra, niveli i kompetencës që kërkohet nga një "edukator shtegtar" (si p.sh. një student apo një stazhier), nga një mësues ose nga një specialist i trajnimit ndërkulturor, është i ndryshëm.

Kjo pikë e fundit është jashtëzakonisht interesante, nëse konceptin e kompetencës e paramendojmë si një nocion situativ, d.m.th. të lidhur pa zgjidhshmërisht me kontekstin në të cilin zhvillohet. Në të vërtetë, mund të jetë e vështirë të përcaktohet saktësisht se cila është përmbajtja e kompetencës ndërkulturore pa specifikuar kontekstet në të cilat ajo duhet të kryhet; situatat janë potencialisht të pafundme dhe, siç vëren Fantini, ajo që mund të vëzhgohet (dhe për rrjedhojë të studiohet) është performanca e saj, e jo vetë kompetenca.

Në çdo rast, integrimi i qëndrimit [attitude] në konceptin e kompetencës është një pikë kritike dhe e diskutueshme. Triandis argumenton se "*attitudes are learned*", prirjet/qëndrimet mësohen, dhe sigurisht jo nëpërmjet edukimit formal tradicional. Nëse e pranojmë këtë hipotezë, ndoshta mund të besojmë se kompetencat përbëhen në një masë të caktuar nga të mësuarit e nënkuptuar që qëndron në themel të mësimit të formalizuar institucional dhe që nuk mund të mos e marrim parasysht në fushën e edukimit.

Procesdrama dhe drama gjuhësore (glottodrama)

Në praktikat moderne të mësimit të gjuhës e të letërsisë, mësuesit kanë në dispozicion edhe dy metodologji të dallueshme të cilat përdorin dramatizimin: procesdramën dhe glottodramën. Në të dyja ato ka një shkrirje mes teatrit dhe mësimit të gjuhës, me përdorimin e teknikave të dramatizimit për qëllime edukative e arsimore. Këto qasje janë relativisht të reja dhe jo shumë të njohura në fushën e mësimit të gjuhës e letërsisë shqipe, por ato përmbajnë, siç do ta shohim, potencial dhe përparësi të shumta, të cilat do të përshkruhen në vijim.

Procesdrama

Në botën anglo-saksone, midis viteve 60 dhe 70, lindi një ndjeshmëri e ripërtërirë kundrejt teatrit të funksionalizuar ndaj didaktikës, dramës në edukim apo procesdramës. Në veçanti, anglezi Peter Slade ishte një pionier në shqyrtimin e teknikave të aktrimit si një mjet për të zhvilluar kreativitetin dhe rritjen personale (Slade, 1954; 1995). Në vitet në vijim, kërkimi dhe zbatimi praktik (Stinson, 2008, fq. 193-212), e bën metodologjinë gjithnjë e më të besueshme dhe të strukturuar me teknika të konsoliduara: duke e çuar

në ekstrem identitetin fiktiv të pjesëmarrësit, i cili jeton rolin e tij dhe kontekstin e ri nga i cili lind motivimi për të përdorur gjuhën.

Një pikë kyçe është për t'u identifikuar në figurën e mësuesit, i cili ka rolin e "mësuesit në lojë" (Pirola, 2011, f. 465), në terma teknikë *teacher in role* (mësuesi në rol), duke e identifikuar veten me një ose më shumë personazhe të skenarit që do të marrë jetë në klasë. Nga ky këndvështrim, mësuesi lëshon atë që përkufizohet si një "stimul fillestar" (Piazzola, 2012, f. 136), ose sinjali krijues (një imazh, një tekst, një këngë, një film, etj.). Më pas, mësuesi merr pjesë në ndërtimin e kontekstit me synimin për të zgjeruar idetë dhe aftësitë gjuhësore të nxënësve. *Teacher in role* e ka në mendje skicën e tij, por nxënësit padyshim nuk e dinë se çfarë pritet prej tyre dhe janë të lirë të veprojnë dhe t'u përgjigjen shtysave të ndryshme, siç ata i shohin më të përshtatshme. Nëpërmjet ndërtimit të përbashkët të këtij konteksti, nxënësit përjetojnë e eksplorojnë fuqinë krijuese të gjuhës dhe mësojnë ta manipulojnë atë për t'u dhënë jetë njerëzve, vendeve dhe ngjarjeve, sigurisht me më shumë pjesëmarrje sesa në çdo lojë me role të tipit tradicional.

Për të arritur këtë qëllim, procesdrama përdor veprimtari të llojeve të ndryshme (Neelands & Goode, 2000; Pezza, 2011):

- individuale, në të cilat nxënësi krijon personazhin e tij (ose të saj);
- në grup, ku nxënësit hyjnë në ndërveprim me njëri-tjetrin;
- dhe kolektive, të cilat kërkojnë marrjen e këndvështrimit të një personazhi të caktuar për interpretimin e kësaj figure kyçe.

Llojet e aktiviteteve sipas tipologjive të mësipërme janë përshkruar shkurtimisht më poshtë:

- *Thought Tracking* (Ndjekja e mendimit): mësuesi ngrin skenën në mes të veprimit dhe personazhet zbulojnë se cilat janë mendimet e opinionet e tyre në atë moment të historisë.
- *Role reversal* (ndërkëmbimi i roleve): në një moment të caktuar të veprimit rolet ndryshojnë, secili merr rolin e partnerit të tij. Kjo u lejon nxënësve të përjetojnë këndvështrime të ndryshme për të njëjtën histori.
- *Role circle* (Rrethi me role): grupi qëndron në një rreth dhe secili merr një rol të lidhur me situatën. Çdonjëri nga personazhet di një fakt për

situatën dhe me anë të një fjalie secili ndërton një informacion të ri të rëndësishëm për rrjedhën e tregimit.

- *Hot-seating* (karrikja e nxehtë): klasa (ose grupet e ndryshme në të cilat ndahet klasa) interviston njërin prej personazheve për të marrë informacionin e nevojshëm për të përmbushur një detyrë të caktuar.
- *Role on the wall* (Roli në mur): klasa bashkëpunon në përvijimin e figurës së një personazhi kyç. Secili jep ndihmesën e tij, duke sugjeruar karakteristika të personazhit, të cilat paraqiten e përmbledhen në dërrasën e zezë.
- *Multiple Role Circle* (Rrethi me role të shumëfishta): në të cilin një personazh (përgjithësisht mësuesi) i bën pyetje një personazhi kolektiv, duke intervistuar individualisht secilin prej studentëve: secili syresh duhet të japë një përgjigje koherente me ato që kanë thënë të tjerët.
- *Voicers in the head* (Zërat në kokë): grupi shpreh me zë të lartë mendimet që shfaqen në mendjen e njërit prej tyre në rolin e protagonistit, në një moment kulmor, në të cilin duhet të hedhë një hap të rëndësishëm për fatin e ndodhisë. Në variantin **coscience alley rrugicë e ndërgjegjes**, grupi krijon një lloj tuneli, edhe fizikisht, nëpër të cilin protagonistin duhet të kalojë për të mbërritur në vendimin e tij.
- *If I were you* (Sikur të isha unë në vendin tënd): i ngjashëm me aktivitetin e mëparshëm, por me synime të ndryshme për zhvillimin e komplotit, grupi jep mendimin e tij për një temë, ndërsa një personazh kalon midis dy kraheve të nxënësve.
- *The mantel of the expert* (Manteli i ekspertit): ky është emërtimi që Dorothy Heathcote, profesoreshë në Universitetin e Newcastle upon Tyne, i dha në vitet '80 (por e shtjelloi duke filluar nga vitet '60) qasjes që ajo zhvilloi gjatë karrierës së saj të mësimdhënies mbi të cilën libra të tërë (Heathcote & Bolton, 1995; Wagner, 1976) dhe artikuj (Sayers, 2011) i ka shkruar. Këtu do të kufizohemi vetëm në përshkrimin e veçorive të spikatura. Gjatë përdorimit të mantelit të ekspertit, studentët shihen si një potencial aktiv, duke përmbysur kështu qasjen tradicionale. Bazohet në metodën e kërkimit, duke i lejuar secilit të sendërtojë kohën e tij të të mësuarit përmes një aktiviteti krijues. Studentët janë kanalet kryesore të komunikimit dhe zotërojnë informacionin, gjë që i bën ata ekspertë në atë moment.

Përveç përdorimit të dukshëm të aftësive e talenteve të aktrimit, rëndësi e madhe i jepet në veprimtaritë e procesdramës edhe *disputatio-s*, si një sfidë retorike mes dy grupeve të studentëve që pa një skenar të paracaktuar, trajtojnë tema të ndryshme, të propozuara nga një person i tretë. Në mënyrë të ngjashme, mësuesi "ndërton" një situatë dhe për të dalë nga kjo, nxënësit duhet të përdorin njohuritë e tyre paraprake gjuhësore, stilistikore, kulturore etj. Një pikë e rëndësishme e kësaj metode është aftësia për të shpërndarë e edukuar përmbajtje ndërkulturore, çka dhe i intereson qasjes sonë.

Sipas llojit të metodologjisë teatrore (objektivave të ndryshëm, organizimit, kontekstit, rolit, ndërveprimeve në klasë, funksionit të mësuesit), dallojmë metodologjitë që prodhojnë komunikim të kontrolluar, komunikim gjysmë të kontrolluar dhe komunikim të hapur (komunikim i hapur) (Kao & O' Neill, 1998, f. 6).




Figura 1. Veprimtaritë që lidhen me shkallën e lirisë/kontrollit të komunikimit.

Në figurë, zona e ngjyrosur e shigjetës përfaqëson shkallën e lirisë në të folur: sa më e vogël të jetë shtrirja, aq më pak liri dhe anasjelltas. Pra, në shkallë të parë kemi dramën gjuhësore, me komunikim të kontrolluar. Ndërsa në skajin tjetër janë aktivitetet e hapura të komunikimit, si procesdrama, me shkallën më të lartë të lirisë. Në qendër gjejmë lojën me role dhe aktivitetet për zgjidhjen e problemeve, me një shkallë të ndërmjetme spontaniteti. Jashtë këtij diagrami – praktikisht shkalla zero e lirisë - gjejmë ato veprimtari didaktike të bazuara në dramatizimin e një teksti të caktuar ose në lojëra rolesh të strukturuar në mënyrë shumë më të ngurtë.

Duke ndjekur skemën (Figura 1), dallimi midis glotodramës dhe dramës së procesit është evident: të dy metodologjitë pozicionohen në dy pika të kundërta. E para, glotodrama, është një teknikë e komunikimit të kontrolluar (jo totalisht e mbyllur, në fakt, dramatizimi rrit aftësitë e komunikimit të nxënësve, gjuhësore dhe paragjuhësore, si shprehja vokale, shprehjet e fytyrës, qëndrimi i trupit, gjesti, heshtja, pauzat, etj.), pasi ndërmjetësohet nga një skenar dhe nga mësuesi-regjisor, si dhe fokusohet te saktësia leksikore. Më saktësisht, pozicioni në këtë grafik të dramës gjuhësore i referohet shfaqjes përfundimtare; por, në fakt, aktivitetet (krijimtaria e udhëhequr nga mësuesit) çojnë në një komunikim gjysmë të kontrolluar dhe në disa raste (improvizim, inpute të pastra situative) kufizohen edhe në komunikim krejtësisht të lirë. E dyta, procesdrama, përkundrazi, bazohet në komunikimin spontan, ku rolet janë të negociueshme dhe mësuesi në rol vendos paraprakisht për temat që do të trajtojnë, por nuk e di paraprakisht se kush duhet të flasë, kur dhe çfarë do të thuhet. Dhe ai nuk bën pyetje përgjigjja e të cilave dihet qysh më parë. Prandaj, ndërveprimi i krijuar pasqyron karakteristikat e gasjes së hapur komunikuese dhe fokusohet në prodhimin spontan oral.

Origjinat e procesdramës

Origjinat e kësaj metodologjie na çojnë në vitet 60, paralelisht me ngritjen e psikologjisë humaniste. Në veçanti, anglezi Peter Slade është edukatori i parë teatror që teknikat e recitimit i konsideroi jo vetëm si një mjet për formimin e aktorëve, por edhe si një instrument për zhvillimin krijues e formimin personal. Kolegut të tij, Brian Way, në 1959, i njihet merita e zbatimit për herë të parë të flozofisë së Slade në mësimdhënien në shkollat angleze. Në vitet 70, Gavin Bolton e çon më përpara këtë traditë dhe e konceptuali-

zon atë në një traktat, duke e përcaktuar këtë qasje si drama në edukim (ose drama në arsimim). Bolton formon, së bashku me edukatoren Dorothy Heathcote, një metodë të një prerjeje konstruktiviste të bazuar mbi improvizimin, përmes të cilit mësuesi fut në lojë të gjithë sa janë pjesëmarrës në laboratorin e tij. Që nga ajo kohë, rreth 30 vjet kërkimesh e zbatimesh e bën këtë metodë të ligjëruar, si në disiplinat shkencore, ashtu edhe në ato humanistike, brenda kontekstit anglosakson. Në nisje të viteve 90 Cecily O'Neill, një eksponente e respektuar e kësaj metodologjie, bëri lidhjen e shprehjes procesdrama si sinonim i dramës në edukim. O'Neill, në bashkëpunim me gjuhëtaren Shi-Mei Kao, zhvilluan në vitet 92-92 një studim empirik përmes të cilit zbatuan, për herë të parë, procesdramën në glotodidaktikë. Studimi, i kryer në universitetin Cheng Kung të Taipeiit (Taivan), zbuloi që kjo metodë ndikon pozitivisht në motivimin, duke zhvilluar një vetëdijë për regjistrat gjuhësorë e jo vetëm, në përshtatje me kontekste të ndryshëm. Këto rezultate inkurajuan kërkues e studiues të tjerë që të eksperimentojnë një shkrimje sinergjike mes procesdramës dhe glotodidaktikës, duke i dhënë jetë edhe studimeve të ndryshme.

Procesdrama dhe vetëdija ndërkulturore

Një ndër këto studiuese është edhe italianja Erica Piazzoli, e cila zhvilloi projektin e saj kërkimor në Griffith University (Australia, 2008). Objektivi i studimit ishte pikërisht identifikimi i strategjive për rritjen e kompetencës interkulturore duke përdorur metodologjinë procesdrama. Përkufizimi i kompetencës ndërkulturore nga ku niset Piazzoli, rimerr modelin e Mike Byram (1997), sipas të cilit KIK mund të identifikohet si *“ai vetëdijesim në ballafaqimin me tjetrin, nëpërmjet një procesi që nuk bazohet vetëm mbi përvojën, por edhe mbi reflektimin, mbi analizën dhe veprimin që çon në një përthyerje të modeleve vetjake kulturore dhe në një shndërrim të vetëdijes”*. Duke u nisur nga ky koncept, studiuesja ka kërkuar të nxjerrë në pah strategji konkrete për ta transformuar këtë model teorik në një zbatim praktik, duke shfrytëzuar një tezë të Fleming-ut, që struktura e procesdramës priret veçanërisht nga edukimi ndërkulturore (1998, 2003).

Struktura e procesdramës

Procesdrama përdor teknika të recitimit e interpretimit teatror për qëllime didaktike, por nuk synon krijimin e ndonjë skenari apo spektakli përfundimtar. Përkundrazi, fokusohet te procesi, i karakterizuar nga një sërë veprimtarish të ndërlidhura mes tyre që zhvillohen e veçohen sipas një rrugetimi didaktik të mirëpërcaktuar, ku si mësuesi, ashtu edhe studentët, futen në lojë për krijimin e një konteksti imagjinar. Edhe pse procesdrama bazohet në parimin e improvizimit teatror, ajo diferencohet nga ky i fundit nga fakti se nuk parashikon veprimtari të shkurtra të palidhura me njëra-tjetrën, por shfrytëzon një gamë të gjerë veprimtarish që i takojnë kësaj metodologjie dhe që organizohen posaçërisht në tri faza kryesore:

Në fazën *nistore* paraqitet një pikënisje, një stimul, ose një pretekst, çka mund të jetë një foto, një tekst, një këngë apo diçka tjetër e që do të shërbejë si orientim për rrugëtimin imagjinar që do të përshkohet.

Në fazën *e dytë*, të përvojës (eksperiencës), pjesëmarrësi/t do të zhyten në botën e pretekstit për të jetuar e zgjeruar atë realitet përmes skenash, episodesh, të lidhura njëra me tjetrën me kapërcime hapësinore-kohore imagjinare, duke nxitur kësaj refleksione sipas logjikës shkak-pasojë.

Në fazën *fundore*, të tretën nga radha, një veprimtari përmbledhëse diskutimesh dhe/ose shkrimesh krijuese, orientohet pjesëmarrësi që të analizojë proceset e përjetuara në mënyrë personale. Autorja e studimit, duke u nisur nga një *casus* konkret (intgrimi kulturor i romëve), ka përshkruar edhe disa strategji të procesdramës të përdorura për të krijuar apo manipuluar, sipas rastit, empati dhe/ose distancim nga personazhi i krijuar apo nga situata e krijuar. Duke e konceptualizuar distancën si një continuum, studiuesja propozon që, duke ndryshuar shkallët e distancës mes nxënësit dhe personazhit të interpretuar, bëhet e mundur të manipulohet edhe shkalla e identifikimit, që nga ana e vet, ka ndikuar në nxitjen e pjesëmarrësve për një vetëdije interkulturore.

Distancimi

Një tjetër strategji për rritjen e KIK është edhe distancimi (distancing), i përdorur si nocion së pari nga Heathcote e Bolton në një konferencë në Universitetin e Durham-it, në 1998. Sipas kësaj strategjie pedagogjike, pjesëmarrësit ekspozohen ndaj një modeli të tretë kulturor, që nuk është as ai tyri, as ai i tjetrit, por që favorizon një shpërqendrim të kodeve të veta kulturore. Përmes kësaj strategjie bëhet e mundur që të shfaqen dukshëm perceptimet kulturore të studentit kundrejt kulturës së tij të origjinës, si dhe roli i tij si ndërmjetës kulturor mes saj dhe kulturës së shënjestruar (e tjetrit), duke favorizuar atë që Byram e përkufizon si *kompetenca komunikative ndërkulturore* (1997). Studiuesja në fjalë, Piazzoli, propozon një model të rritjes ndërkulturore që, duke nisur nga dekonstruktimi i modeleve vetjake kulturore, i ka çuar pjesëmarrësit e projektit të saj kërkimor në ripërjetimin e përvojave me tjetrin, duke lejuar kështu, një rritje të vetëdijes ndërkulturore. Modeli i propozuar e interpreton tërë këtë proces si një rrugëtim të rritjes graduale, zhvillimi i së cilës është subjektiv dhe ngushtësisht i lidhur me motivimin personal.

Prodhim spontan

Studimi pohon, veç të tjerash, që procesdrama ndikon pozitivisht mbi motivimin e nxënësit, duke e përfshirë ndërveprimin social dhe marrëdhënien në një kontekst nxitës si në rrafshin njohës, ashtu edhe emocional, duke mundësuar një produkt më se spontan. Studimi gjithashtu sugjeron që kjo metodologji është e efektshme për të reduktuar filtrat afektivë të nxënësve dhe për të ridimensionuar hierarkinë mësues-nxënës, duke krijuar kushte për sigurimin e një sinergjie kulturore mes mësuesve dhe studentëve, që është themeli i edukimit ndërkulturor. Mbi këto premisa, rezultatet e studimit pohojnë rëndësinë e rolit, kontekstit dhe tensionit dramatik për zhvillimin e lirshmërive në sjelljen komunikative. Rezultatet e studimit identifikojnë një faktor themelor që mësuesi i letërsisë, i cili nuk e ka përvojën në fushën e teatrit, duhet ta mbajë parasysh kur e zbaton teknikën e procesdramës: çka është *tensioni dramatik*? Ai duhet kuptuar sikurse ajo kureshtja elektrizuese që e shtyn një lexues ta lexojë një libër me një frymë, ta shohë skenën e një filmi apo, në rastin e didaktikës teatrale, të përfshihet tërësisht në një vepërimtari, duke u kredhur në një kontekst imagjinar.

Arta SULA

LETËRSIA KLASIKE *NUTRIMENTUM SPIRITUS* I LETËRSISË SHQIPTARE NDËR SHEKUJ

Ndikimi i botës klasike në letërsinë shqiptare, qysh prej fillesave të saj, do të jetë në qendër të këtij punimi, ku mëtojmë të ndalemi në disa periudha dhe autorë, pjesë e një kulture të gjerë evropiane.

Qysh herët, M. Sufflay shprehej se nuk ka zonë më interesante për studim sesa bregdeti ynë jugor i Adriatikut. Këtu janë themelet më të shumëllojshme dhe më të ndërlikuara politike dhe kulturore, të cilat prodhuan ngjarje dhe formuan tipa të cilave, për sa u përket interesit dhe origjinalitetit, rrallë mund t'u gjendet shoqja në histori. Në bregun e Adriatikut gjendeshin vendbanime të moçme. Platoni përmendte Apolloninë si qytet ligjesh të mira (πόλις εύνομωτάτη), ndërsa Ciceroni e quante qytet të madh dhe të rëndësishëm (*magna urbs et gravis*). Përkundrazi, Durrësi qytet i afërm i saj, qysh në kohët e vjetra ishte qytet ndërkombëtar i detarëve dhe i tregtarëve. Poeti romak Katuli e quante këtë qytet “taverna e Adriatikut” (*Durachium Adriae taberna*) ku qeveris hyjnesha Venus. Më tej, dy qytete kryesore ilire, *Skodra e Dioklea*, zhvillohen e bëhen qytete të mëdha romake.

Qytetet arbërore zinin një vend të rëndësishëm edhe në rrethin e qyteteve mesjetare të Adriatikut. Kështu, në Mesjetën e hershme, Durrësi ishte një qytet i madh me një bërthamë antike në të cilin elementi latin ruante drejtpeshimin me atë bizantin, nëpërmjet gjurmëve helenike të lidhura me të, ku takoheshin tre gjuhët e shkruara të Europës: latinishtja, greqishtja dhe sllavishtja. I gjithë Adriatiku mesjetar formonte një njësi kulturore të lidhur nga deti dhe nga qytetet e të dyja brigjeve.

Dy herë, nën petkun helen dhe mandej nën atë bizantin, u përshkua këndej Lindja për në truallin italian, aty ku dikur pati qenë *Magna Graecia* (Itali e Jugut) pushteti bizantin zgjati më shumë, derisa Otranto ra pastaj përkohësisht (1481) në duart e sunduesve turq të Kostandinopojës.

Për bizantizimin e Italisë së Jugut, sipas Zef Skiroit Junior, kontributin më të madh e dhanë manastiret, shprehja më karakterizuese dhe historike e greqizmit dhe, mund të pohojmë se ndikimi i tyre religjioz, ekonomik dhe politiko-kulturor ishte shumë i madh. Jemi të mendimit se e njëjta gjë ka ndodhur edhe në arealin shqiptar, që do të thotë se në përhapjen e bizantinizimit rolin më të madh e patën urdhrat e murgjve, sikurse vërtetohet prej burimeve të pakta mesjetare.

Historia e manastireve ortodokse të Shqipërisë së Mesme e Jugore ka mbetur gjer më sot e pastudiuar, përkundrazi, për kuvendet katolike të Veriut studimet kanë shkuar mjaft përpara, sikurse e vëren shumë herët E. Çabej.

Pothuajse të gjitha kishat me kalimin e kohërave janë zhdukur e humbur, manastiret e shkatërruar janë mbuluar me ndërtesa të reja, të pakta janë rrënojat prej ndërtesave antike: ndërsa dorëshkrimet ekzistojnë, edhe pse të shpërndarë në arkiva e biblioteka të ndryshme, brenda e jashtë vendit. Dorëshkrimet janë dëshmitarë të gjallë të një jete shpirtërore dhe qytetare të zhdukur tashmë dhe mbrojtës besnikë të një kulture së cilës shpesh vazhdojmë t'i referohemi.

Arti kaligrafik ushtrohej në manastire për t'iu përgjigjur kërkesave të caktuara dhe për mësimdhënie, por gjithashtu edhe si ushtrim durimi, instrument disiplinor, mjet për të arritur një nivel gjithmonë e më të lartë përsosmërie. Por kishte edhe shkrues privatë, priftërinj, sikurse duket, por jo murgj, për të cilët, të shkruarit ishte mjet për të siguruar jetesën, por pa përjashtuar gjithsesi interesat kulturore.

Kopjoheshin dhe studioheshin jo vetëm libra liturgjikë të çdo tipi dhe traktate të teologjisë, por edhe të filozofisë, matematikës dhe vepra historike.

Urdhrat e murgjve dhe asketizmi, edhe pse brenda normave institucionale të përcaktuara, nuk i mbyllte murgjit dhe heremitët brenda mureve të qelave apo të shpellave, por mundësonin që ata të cilët kishin përvojë dhe formim të lartë doktrinal të shkonin në vende të shenjta, të vizitonin dhe të jetonin njëkohësisht mes komuniteteve të huaja, të çonin në vende të largëta

mesazhin e dijeve të tyre asketike, kontributin e veprës së tyre nën frymën e idealeve shpirtërore bizantine.

Në bazë të studimeve, mendohet se ka ekzistuar një shkollë vendëse e shkrimeve të shenjta në hapësirën protoshqiptare. Në anën tjetër vërtetohet historikisht se Shën Gjon Gojarti në fillimin e shek. V (403) ishte një murg i internuar në Epir.

Po kështu, vërtetohen lëvizje të murgjve si p. sh. Elia di Enna (823-903) u vendos në Jeruzalem, në Sinai, në Aleksandri dhe pas kthimit në Itali, shkoi në Peloponez, në Epir, në Butrint, në Korfuz.

Kjo dëshmon se ka pasur lidhje religjioze-kulturore mes arealit shqiptar dhe zonës së *Magna Grecias* (Itali e Jugut) dhe murgj që kanë lëvizur mes dy hapësirave, shqiptare dhe italiane, me shumë gjasa bashkë me dorëshkrime.

Në “Fondin 488”, në AQSH, kemi “Kodikun e 41-të të Beratit”, i cili në bazë të figurave në miniaturë, bën të supozojmë që duhet të jetë porositur në Perëndim, në shek. XIV, prej princit shqiptar Karl Topia, i cili ishte katolik, ose duhet të jetë porositur prej princërve Balshaj, të cilët kishin nën varësinë e tyre në atë kohë dhe Beratin.

Themi se kodiku ka karakter perëndimor, sepse për sa u përket miniaturave është me të vërtetë një vepër arti, sepse latinët e konsideronin librin një vepër arti. Por kjo nuk do të thotë që grekët nuk e praktikonin miniaturën: librat e psalmeve dhe ungjijve e dëshmojnë këtë. Megjithatë, te latinët dhe në kulturën perëndimore miniatura e dorëshkrimeve shndrit me një bukuri të gjallë, minierë e pashtershme për studiuesit dhe të apasionuarit e artit, sikurse vëren A. Dain.

Po kështu, shkrimi i “Kodikut të 4-t të Beratit” ka vlera të rralla kaligrafike, është një model ku shkrimi bëhet mjeshtëri krijuese. Grafia e tekstit mund të thuhet se do të jetë marrë nga kaligrafët më të shquar, në artin e kaligrafisë bizantine, është grafi e dorës së parë nga çdo aspekt.

Padyshim, me gjithë pushtimet, deti Adriatik mbeti një det bizantin dhe kontaktet mes Pulias dhe Shqipërisë, Dalmacisë, Greqisë dhe Konstandinopojës ishin të shpeshta. Kjo shpjegon edhe arsyen pse tradita e shkrimeve të krishtera në Shqipëri zgjati, të paktën, për 15 shekuj, që prej fillimeve të krishtërit deri në shekullin XIX.

Aq e vërtetë është kjo sa R. Sabbadini në studimin e tij mbi “Zbulimet e kodikëve grekë dhe latinë në shek. XIV dhe XV” shkruan se kërkuesit e dorëshkrimeve greke të shek. XV nuk i kërkonin ato në Italinë Jugore, por drejtpërdrejt në vendet ballkanike, natyrisht, duke preferuar ato nën sundimin venecian, në veçanti arealin shqiptar.

Duke nisur prej periudhës së Antikitetit të vonë, duhet pranuar një qarullim i teksteve klasike dhe post-klasike në territoret e *Magna Grecia-s* antike dhe më gjerë.

Në Shqipëri vështirë të mendohet se mund të ketë pasur një elitë lexuesish dhe porositëse e dorëshkrimeve greqisht që përmbanin tekste letrare, por kjo nuk përjashton që të ketë pasur të interesuar për të lexuar a kopjuar tekste klasike dhe, që kohërat, pushtimet a mjegullat kombëtare mesjetare në Adriatik, sikurse i quante M. Sufflay, kanë çuar në humbjen apo zhdukjen e këtyre kodikëve.

Padyshim, shkruesit bizantinë e njohin shumë pak historinë romake, aspak atë greke, e gjithë kanceleria, e gjithë bota qoftë intelektuale, qoftë politike jetonte duke pasur si model Biblën dhe ky ishte referimi kulturor konstant i kulturës bizantine.

Por, duket se shkëputet tërësisht nga kjo panoramë një manastir i Salentos, Shën. Nicola di Ca+sole pranë Otrantos, i cili karakterizohet gjatë gjithë historisë së tij, qysh prej themelimit, me ndihmën e sunduesve normanë, rreth vitit 1089-99, deri në shkatërrimin e tij prej turqve në vitin 1480, si qendër intensive e jetës kulturore, e mbajtur gjallë prej një lidhjeje të drejtpërdrejtë me autorët klasikë dhe prej një pjesëmarrjeje aktive të tij ndaj problemeve religjioze dhe politike të kohës. Për këtë, sigurisht, kanë kontribuar raportet e gjalla me realitetin kulturor afër tyre, pra me greqizmin ballkanik, me Epirin dhe me vetë Konstandinopojën.

Pikërisht në këtë manastir është ruajtur, në një dorëshkrim të Bibliotekës së Universitetit të Torinos, i dëmtuar shumë rëndë prej zjarrit të vitit 1903, një listë e kodikëve që janë dhënë hua personave të huaj jashtë mureve të manastirit, lista i përket shek. XII. Janë rreth 70 shënimet e huave, zakonisht, përfituesit ishin njerëz të kishës, por ka edhe laikë, bie në sy se vetëm në Brindisi janë dhënë hua 26 dorëshkrime dhe veprat që jepeshin hua janë, sikurse është e natyrshme, në pjesën më të madhe tekste liturgjike, një meshtar, por ka edhe shkrime profane, dhe mes tyre hasim ato të karakterit gju-

hësor-gramatikor, vepra të karakterit didaktiko-shkencor, një fjalor dhe vepra të autorëve klasikë, si veprat e Homerit, Hesiodit, komedi të Aristofanit, nga Aristoteli, dorëshkrime të muzikës bizantine.

Në manastir jeta meditativo-shpirtërore, bashkë me disiplinën e *regula-s*, alternohej me veprimtarinë kulturore e cila, përmes kopjimit të dorëshkrimeve të autorëve dhe të veprave të karakterit kryesisht të shenjtë dhe, në të njëjtën kohë vepra të karakterit laik, i mundësoi Casole-s dhe laboratorit të tij kopjues të bëhet një qendër e rëndësishme e kulturës dhe e përhapjes së dijeve, qoftë në Lindjen bizantine qoftë në Perëndimin e krishterë. Shënimet në dorëshkrim paraqesin vështirësi për të gjetur gjeografikisht vendin se ku janë dhënë hua kodikët, pra, vendndodhja gjeografike e këtyre personave huamarrës, e cila nuk mundëson por edhe as nuk përjashton që të hame-ndësojmë për huamarrës prej arealit shqiptar.

Nga ana tjetër, duhet të pranojmë se në pamje të parë, duket se shqiptarët kanë qenë shumë larg qendrave kulturore dhe shumë të zënë me pushkët e tyre në luftërat mes fiseve, apo kundër pushtuesve, për të mos u interesuar për çështjet religjioze dhe aq më pak për qytetërimin bizantin.

Por padyshim, vendi ynë ishte pjesë e këtij qytetërimi, sikurse dëshmohet edhe në studimet e Dh. Shuteriqit, ku peshkopata e Arbërit njihet së pari më 1166, kur nuk kemi vetëm një peshkop, “Lazaro Arbanansi”, por edhe një “Andrea prior Arbanensis”. Priori ishte qeveritari bizantin i një qyteti dhe i krahinës përreth. Sipas një dëshmie të vonë, vendi i Arbërit quhej herët “Bazilikanë”, d.m.th. me një qeveritar që përfaqësonte bazileun, perandorin e Bizantit. Më 1426, kisha e Sh. Aleksandrit në Mirditë, mbante ende emrin “*S. Alexandri in Basilicano Arbanensi diocesis*”.

Megjithatë, sipas Skiroit Junior, përtej ngjarjeve politike që karakterizojnë shekujt XI-XIV, mund të themi se në Italinë e Jugut dhe matanë detit protagonistët ishin dy: qytetërimi latin dhe ai grek, si njëra dhe tjetra rrezatime të Romës së Vjetër dhe të Re, prej të cilave po frymëzohej Humanizmi rilindës, kur edhe shkëmbimet kulturore kishin kufij të padukshëm.

In primis, do të ndalemi te figura e Marin Barletit si “autori i parë i letërsisë sonë me veprën e parë të historiografisë shqiptare”. Formimi i tij në ambientin humanist të Venedikut ndikoi thellësisht në veprimtarinë e tij letrare dhe këtë e dëftojnë ndryshimet në konceptimin e artit dhe në *labor limae* të tekstit, mes dorëshkrimit nr. 6163 që ruhet në Bibliotekën Kombëtare të

Francës, *Libërth fort-i-shkurtër i Luftës së Shkodrës* (dorëshkrim i cili sipas studiuesve L. Nadin dhe A. Plasari është hartuar nga Barleti vite më parë se botimi i hamendësuar më 1503 i *Panegjirikut* të Beçikemit dhe, më saktësisht, mes dyvjetëshit 1498-1499 dhe 1501-shit) dhe veprës së tij *Rrethimi i Shkodrës*, botuar në Venedik në vitin 1504.

Vepra *Rrethimi i Shkodrës* (*De obsidione scodrensi*), versioni i ri i përditësuar i atij që kishte qenë në fillim dorëshkrim, *Libërth fort-i-shkurtër i Luftës së Shkodrës* (*De Bello Scodrensi brevissimus libellus*), shpreh sesi ndryshimi i kushteve kulturore dhe politike, në prag të hapjes së konfliktit të ri turko-venedikas, të filluar zyrtarisht më 1499, arsimimi i tij në mjedisin humanist të Republikës, mandej studimeve në mjedisin kishtar në Padovë, ku Barleti rezulton i përfshirë në një ndërthurje marrëdhëniesh edhe me botën laike të Universitetit të Padovës, ndikuan në mënyrën se si ai e shkruan historinë në veprën e botuar, *Rrethimi i Shkodrës*: më larg kronikës dhe më afër dokumentimit shkencor, historik dhe politik, sidomos shqetësimi i tij për rregullat retorike dhe stilistike të gjuhës latine.

Qysh në fillim, te *Libri i Parë*, ka ndryshime mes dorëshkrimit dhe botimit. Në dorëshkrim Barleti thotë se ka pasur në dorë fragmente ose kronika të shkruara në “gjuhë të vendit” (*vernacula lingua*) për ç’i përket prejardhjes së hershme të qytetit të Shkodrës dhe themelueseve Roza dhe Fa. Në tekstin e botuar Barleti i quan fragmente më shumë se vjetarë të vërtetë, e ruan shprehjen “të shkruara në gjuhë të vendit”, duke shtuar që regjistrojnë kujtesën e “të parëve tanë” (*Attavorum nostrorum*).

Sipas studiuesve Nadin dhe Plasari, kjo mbështet edhe tezën mbi ekzistencën e dorëshkrimeve profane dhe, për më tepër, në gjuhën e vendit, në të folmen e vendit. Mjafton të mbahen parasysh vajtje-ardhjet e klerikëve dhe tregtarëve nga Shkodra në Venedik dhe anasjelltas, ose përbërja e ekuipazheve të anijeve, në të cilat, përveç krahëve të thjeshtë të lundrimit, kishte edhe shkruer, noterë, kapedanë të bordit, etj., të cilët regjistronin gjithçka.

Nëse do të ndaleshim në mënyrë të detajuar ka edhe ndryshime në përzgjedhjen e fjalëve, sikurse shtesa dhe heqje në përqasje mes dorëshkrimit dhe botimit të veprës, p.sh. te dorëshkrimi përdor për termin *Unde Castrum Rosapha appellabatur* – prandaj fortesa quhet Rozafa, ndërsa te botimi kemi *Unde eius Arx Rosapha appellabatur* – prandaj fortesa e saj quhej Rozafa, por fjala *Arx*, e përdorur në botim, nuk do të thotë thjesht *fortesë* sikurse

castrum, por ka edhe kuptimin e pozicionit gjeografik të një qyteze të fortifikuar që gjendet në lartësi, në të vërtetë, gjendej mbi një kodër krejt shkëmb.

Ka edhe kalesa të tjera që dëshmojnë ndryshime të dukshme, që padyshim shprehin edhe qëndrim të Barletit në lidhje me pozitën e Venedikut për luftën e Shkodrës.

Pa mëdyshje, Marin Barletit (rr. 1460 - 1512/1513) duhet parë jo vetëm si i pari autor i letërsisë shqiptare në latinisht dhe të veprës së tij *Rrethimi i Shkodrës* si e para vepër e historiografisë shqiptare, por tanimë është pranuar edhe kontributi i tij në lëvizjen e humanizmit evropian, si përfaqësues i kulturës italo-arbërore, duke pasur parasysh se kishin kaluar rreth një njëzetvjetësh mes mbërritjes së tij në tokat e Republikës në fillim të viteve '80 të shek. XV dhe shkrimit të veprave që sot njohim, sikurse nënvizon M. Mandala.

Ndërkohë, shkrimtarët e letërsisë së vjetër shqipe, përtej mbizotërimit të kulturës ekleziaste, patën një qasje fort personale dhe një vizion të qartë ndaj traditës kulturore greko-latine dhe asaj mesjetare. Studimi i letërsisë klasike ishte për këta autorë *nutrimentum spiritus*, ushqim shpirtëror, përmes së cilit ata krijuan e shprehën vetveten dhe vizionin e tyre.

Në këtë pikëvështrim një vend të rëndësishëm zë Frang Bardhi, i cili shkruan latinisht *Apologjinë për Skënderbeun* dhe *Fjalorin latinisht-shqip*, si vepër e parë origjinale, e rëndësishme për leksikografinë dhe gjuhën.

Sipas M. Roques, fakti që në *Dictionarium latino-epiroticum* (1635), Bardhi u ka shtuar zërave latine një ekuivalent italisht, glosave të tij në shqipe një ekuivalent turk, të shtyn të mendosh që ai ka pasur ndër mend të bënte një fjalor katërgjuhësh. Një model do ta ketë dhënë në shtojcat e tij për emrat e farefisnisë dhe për numrat themelorë e, duke u kufizuar në tre gjuhë, latine, italiane, shqipe, për emrat e përveçëm, ose latinë, shqiptarë, turq, për disa ndajfolje dhe disa proverba. Mund të mendohet se Bardhi ka përgatitur, të paktën për disa kategori fjalësh, një fjalor në tre ose katër gjuhë, elementet e të cilit do t'i ketë shpërndarë në fjalorin e vet pa ndryshuar përpilimin e tij. Qëllimi i F. Bardhit ishte të hartonte një fjalor praktik që t'u shërbente edhe atyre që nuk kishin njohuri gjuhësore, në përshtatje me nivelin e ulët kulturor të priftërinjve që, *as nukë marrënë vesht gjish thonë e gjish xgjedhënë*.

Pjetër Bogdani, në veçanti, paraqet në veprën e tij, “Cuneus Prophetarum” (1685), një qasje edhe më personale me botën klasike. Përveç përkthimeve të civateve që sjell në vargjet e Psalmeve të Biblës, të cilat i sjell në formë citati jashtë tërësisë së vargjeve, Bogdani në mënyrë të veçantë sjell disa pjesë, strofa nga poezia e Homerit, Virgjilit, Juvenalit dhe Plinit dhe, në këto përkthime është mjeshtër i mirë i përkthimit ku shihet aftësia e tij absorbuese e transponuese.

Sipas I. Rugovës, edhe në këto përkthime shihet gjuha e tij e formuar poetike, liria kreative e përkthimit dhe kujdesi i madh për kuptimin e poezisë në gjuhën e përkthyer, që të jetë sa më shumë në frymën e asaj gjuhe, në mënyrë që të ushtrojë efektin e vet artistik e poetik.

Në studimin e tij “La letteratura albanese e il mondo classico”, G. Gradi-lone, vëren se edhe në një vështrim të shpejtë, mund të gjenden në veprën e Bogdanit, Shën. Pauli, Shën. Jeronimi, Shën. Ambroxhi, Shën. Agostini, bashkë me Homerin, Sokratin, Platonin, Aristotelin, Virgjilin, Propercin, Horacin, Ovidin, Senekën dhe Marcialin. Për më tepër shfaqet vizioni i tij i qartë për traditën kulturore greko-latine dhe atë mesjetare.

Kjo traditë klasike zë një vend të rëndësishëm edhe në krijimtarinë letrare të N. Frashërit, por e sjell në një optikë që ngërthen magjepsjen për antikitetin klasik, dashurinë për vendin e tij bashkë me besimin në Perëndi, e ndërthurur me traditën evropiane dhe zbulimin prej tij të bukurisë së poezisë persiane.

Sikurse dëshmojnë studime më të hershme, vepra e tij “Bagëti e Bujqësi” ndjek traditën e poemës didaskalike me karakter artistik, veçanërisht poemën “Gjeorgjikat” e Virgjilit. Por mes vargjeve të Naimit nuk lexojmë vetëm Virgjilin, i cili dinte të këndonte notave të shpirtit aq natyrshëm dhe me vërtetësi, por gjejmë edhe Homerin, edhe Safon, Anakreontin, Ibikun, Alkmanin, Katulin dhe Lukrecin.

Në këtë këndvështrim, edhe poema e tij “Dashuria” (“O eros”) nis si celebrim i lirikës arkaike greke për të shprehur doktrinën e tij poetike, duke lënë pas edhe Homerin, për të mbërritur nën frymën e romantizmit evropian tek A. de Lamartine, J. Keats dhe A. Manzoni, ku dashurisë i bashkohen pa-fundësia, gjithësia për të mbërritur te Krijuesi, te Perëndia.

Poetika e Naimit shkon drejt një reflektimi filozofiko-intelektual, si *poeta doctus* ai shpreh edhe idetë e tij mbi karakterin dhe domethënien e poezisë.

G. Gradilone nënvizonte për Naimin se: “Nëse prej botës klasike mbërrinin tek ai forma dhe motive shpirtërore, bota persiane i jepte gjithë frymëzimin e doktrinëve mistike prej së cilës ushqehet konceptimi i tij i jetës, përtej mënyrave shprehëse. Këto dy eksperiencë, perëndimore dhe orientale, për të përdorur dy terma më të gjerë, bashkë me fermentet e kohës së tij të romantizmit, përbëjnë një materie që, e ndërthurur me jetën e tij, përcakton theksin e këngës së tij”.

Jemi të mendimit se edhe në rastin e Naimit mund të përdorim termin e Gëtes poezi universale, duke besuar se nocioni letërsi universale ka edhe këtë kuptim.

Duke u ndalur në këto raste, pa përmendur edhe ndikimin në letërsinë arbëreshe, i qëndrojmë idesë se bota klasike ishte ushqim shpirtëror edhe për letërsinë shqiptare, ishte fryma që i dha një domethënie të re traditës letrare dhe nis që në fillesat e saj për të vazhduar shekuj me radhë.

Esmā DODAJ

KULTURA DHE IDENTITETI NË ROMANIN “LA MANO CHE NON MORDI” TË ORNELA VORPSIT, NJË PËRVOJË ÇORIENTIMI DHE TRANSFORMIMI PREJ (RI)KTHIMIT NË (RI)ZBULIM

Abstrakt:

Ornela Vorpsi është një autore shqiptare, që jo vetëm i ka kapërcyer kufijtë gjeografikë e kulturorë të Shqipërisë, por edhe më tej, duke e shndërruar kulturën në plurikulturalizëm dhe duke krijuar një identitet, që nuk është as i atdheut e as i tokës së huaj, po është i një “tjetërkundi”. Ne do ta shohim këtë specifikisht në romanin “La mano che non mordi”, ku gjithçka fillon me një udhëtim në Sarajevë, një zhytje në zemër të Ballkanit, duke analizuar sesi nëpërmjet tij, autorja Vorpsi na jep një shëmbëlltje mbi gjendjen njerëzore, e cila ndryshe nga sa duan të besojnë ideologjitë e identitetit, është një gjendje e vazhdueshme çorientimi, tranzicioni, transformimi, ku çdo përvojë e re është një pasurim, jo një tradhti apo humbje identiteti. Ne do të ndalemi në interpretimin e tri motiveve të romanit: udhëtimi, identiteti dhe kultura, të cilat lidhen me tri tope: vendlindja, hapësira e zbrazët e udhëtimit për gjetkë dhe vendi i mbërritjes. Periudhat kohore gjegjëse janë: e shkuara, emigrimi dhe integrimi. Kështu, do të shohim sesi ikja dhe ardhja shkrihen në krijimin letrar, vendi dhe koha bëhen letërsi, identiteti një transformim dhe kultura një sintezë, e këto dy të fundit së bashku mbeten në proces, vazhdojnë të formësohen.

***Fjalë kyçe:** kulturë, identitet, udhëtim, transformim, zbulim*

Një takim i parë me autoren, veprën dhe letërsinë ndërkulturore

Ornela Vorpsi ka lindur në Tiranë në vitin 1968. Ajo ka studiuar arte figurative në Shqipëri dhe më pas nga viti 1991 ka studiuar në Akademinë Brera në Itali. Që nga viti 1997, jeton në Paris. Ajo është fotografe, piktores dhe video-artiste. Ornela është edhe një autore librash e suksesshme, që i tregon historitë e saj duke përdorur dy nga gjuhët e saj “të adoptuara”, italishten dhe frëngjishten, si për të kërkuar një distancë kritike nga toka e saj, nga e kaluara e saj, nga një fat i vuajtur prej vitesh, si dhe nga vetë vetja e saj.

Kemi disa autorë shqiptarë, që kanë hyrë në botën letrare duke shkruar në gjuhë të huaj. Autorët shqiptarë të këtyre 25 vjetëve nuk janë detyruar të jetojnë në “ekzil”, përkundrazi, “ekzili” është zgjedhje e tyre, shkrimi në gjuhë të huaj gjithashtu. Secili nga këta autorë ka një përvojë krejt të vetën se përse zgjedh t’ia dhurojë disa nga veprat e tij letërsive të tjera.

Vorpsi konfirmohet si një nga zërat më interesantë të rrëfimit të ri bashkëkohor, natyrshëm dhe jo qëllimisht e prirur drejt romanit global. Fakti që ka zgjedhur të shkruajë në italisht dhe frëngjisht është shkak për optimizëm, sepse mënyra për ta forcuar një letërsi është ta hapësh atë për këdo që dëshiron “ta përdorë” dhe jo ta mbyllësh “në mbrojtje” të identitetit. Kjo është edhe letërsia ndërkulturore, e cila shkruhet nga autorë, këndvështrimet dhe/ose lënda e të cilëve ndikohen nga hapësira të shumta kulturore. Gjithashtu, tekstet e letërsisë ndërkulturore qarkullojnë dhe janë të rëndësishme për më shumë se një hapësirë kulturore, ato u adresohen etnive të shumta. Termi ndërkulturore, i mbushur siç është me konotacione shkëmbimi dhe dialogu, si mbiemër që përshkruan letërsinë, nënkupton se ajo është një letërsi që mund t’i shërbejë një qëllimi ndërmjetësues ose ambasador, qoftë me dashje, qoftë pa dashje. Megjithatë, letërsia ndërkulturore është shumë më tepër sesa thjesht ofrimi i përshkrimeve të përvojave “të tjera” kulturore; ajo nuk pasqyron thjesht përvojat e emigrimit, kërkimit të azilit dhe riatdhësimet. Në vend që thjesht të pasqyrohet, letërsia ndërkulturore angazhohet, duke qenë e vendosur brenda dhe duke qenë aktive në krijimin e identitetit, më shumë sesa në zbulimin e tij.

Këtë do ta shohim specifikisht në romanin “La mano che non mordi” të Ornela Vorpsit, ku gjithçka fillon me një udhëtim në Sarajevë, aq e ngjashme me Shqipërinë e pluhurosur me dëshirë në kujtimet e autores narratore.

Historia tregohet në vetën e parë nga një rrëfimtare omnishente, e cila është edhe vetë pjesë e historive që tregon. Romani vjen i strukturuar me copëza tregimesh, të cilat mund të ishin fare mirë fletë ditari të narratores, që është vetë Vorpsi, të shkruara jo në rend kronologjik. Është pikërisht udhëtimi, ai që i mundëson Ornelës që nëpërmjet vetes, Mirsadit dhe personazheve të tjerë të romanit të saj, të na e paraqesë kulturën dhe identitetin si një përvojë çorientimi dhe transformimi që (ri)zbulohet në çdo (ri)kthim, si e tillë një përvojë që gjithnjë plotësohet. Kjo është edhe përvoja e shumëkujt si ata. Krijimi i një identiteti, zbulimi i një identiteti a të ruajturit e një identiteti, ka qenë një rrugë e vështirë për të gjithë ata, zhdukja e kufijve (krijueses), gjithashtu.

Në romanin “La mano che non mordi” kemi të bëjmë me një udhëtim të veçantë, të ndryshëm nga ai i zakonshmi tek autorët emigrantë, i cili në më të shumtën e rasteve është nostalgjik, romantik a melankolik. Këtu, personazhi kryesor, një shqiptare e emigruar në Paris, e cila merr funksionin e narratores, kthehet në Ballkan për të takuar e ndihmuar mikun e saj, Mirsadin, i cili është në një gjendje të rënduar emocionale e psikologjike, sepse duke dashur të ishte perëndimor dhe t’i largohej vendit të origjinës, gjatë një udhëtimi duke lexuar romanin “Portreti i Dorian Greit” vetëdijësohet se ka mbetur në hapësirën e zbrazët midis të dyjave, me një krizë të fortë identiteti gati ekzistenciale, dhe kjo bëhet shkas për të reflektuar mbi identitetin (e tij dhe/ose të saj) që është dhe bërthama e dytë tematike e romanit.

Udhëtimi-kthimi

“Shtylla kurrizore” e këtij romani është udhëtimi Paris-Sarajevë, Sarajevë-Paris dhe në këtë shtyllë autorja “ka varur” disa histori: tregime të vogla, reflektime, kujtime, që duket se janë gjëja më e rëndësishme për pasqyrimin e qenies në botë para, gjatë dhe pas një udhëtim-kthimi.

Ornela shkon në Sarajevë për të ndihmuar Mirsadin, një mik që është duke vuajtur shumë, është në një gjendje të rëndë, e cila është e dukshme dhe serioze, pasi është psikologjike, ekzistenciale, aq edhe sociale. Prandaj,

kjo histori udhëtimi është një shëmbëlltyrë mbi gjendjen njerëzore, e cila ndryshe nga sa duan të besojnë ideologjitë e identitetit, është një kusht transformimi, tranzicioni, çorientimi, përplotësimi. Ky kthim i Ornelës e fut në krizë konceptin e kthimit në një vend të ngjashëm me atdheun, sepse njeriu kthehet në një vend të cilit ndien se i përket disi. Ornela, përkundrazi, ndihet krejt e huaj dhe trajtohet si krejt e huaj në qëndrimin e saj të shkurtër në Sarajevë.

Nëpërmjet këtij udhëtimi, Ornela del si një shqiptare që jeton në Paris, por nuk i përket asnjë vendi, i përket askundit: kudo që të jetë, ajo është një “e huaj perfekte”. Çdo përvojë e re është një pasurim për të, jo një tradhti apo humbje identiteti. Kthimi në Ballkan, në Sarajevë (një qytet simbol i kozmopolitizmit nën sulm), do të thotë kthim në gjuhën amtare, në zakonet e kaluar, por nuk bëhet fjalë për kthim të rrënjët, domethënë të diçka që është e qëndrueshme, por pikërisht për një vetëdijësim, reflektim, (ri)zbulim të vetes në raport me të ngjashmin dhe “të huajin”.

Para se të nisej për Francë, Ornela blen një byrek, i cili e përmbush pa-dyshim funksionin e tij si një madeleine proustiane. Megjithatë, ky rievokim nuk shkakton një kërkim për kohën e humbur: Ornela është immune ndaj nostalgjisë, ndaj retorikës së kthimit në shtëpi, ndaj nostos, e cila në një kuptim është një ndjenjë pak maskiliste (ajo parashikon një Penelopë, e cila pret me besnikëri dhe një vend që mbetet i pandryshuar, në mënyrë që heroi t’i gjejë të paprekura shijet e rinisë kur të jetë i lodhur nga aventura dhe të kthehet).

Ornela shprehet se është një e huaj perfekte. “*Ormai sono una perfetta straniera. Quando si è così stranieri, si guarda il tutto in modo diverso da uno che fa parte del dentro. A volte, essere condannati a guardare dal di fuori suscita una grande melanconia. E come recarsi a una cena di famiglia e non poter partecipare; si frappono una gelida finestra. Di un vetro bello spesso, antiproiettile, anti-incontro: loro ti scrutano, ti riconoscono, ti fanno dei segni perché tu entri e li raggiunga, pure tu li vedi e rispondi con gli stessi gesti, ma la cena si consuma qui, si consuma così. Dopo poco tempo smettono di invitarti, si stancano, il pollo arrosto gli sorride, il pollo arrosto sforato al momento giusto è una vera consolazione. Le loro parole sono inudibili. Il loro calore lontano. Tu rimani spettatore.*” (“Kur je kaq i huaj, e shikon të tërën ndryshe nga dikush që është pjesë e së brendshmes. Ndonjëherë, të qenit i dënuar për të parë nga jashtë ngjall melankoli të

madhe. Është si të shkosh në një darkë familjare dhe të mos jesh në gjendje të marrësh pjesë; një dritare e akullt qëndron në rrugë. Me një xham të trashë, antiplumb, kundër përplasjes: të kontrollojnë, të njohin, të japin shenja që të hysh e të bashkohesh me ta, edhe ti i sheh dhe përgjigjesh me të njëjtat gjeste, por darka konsumohet këtu, është konsumuar kështu. Pas një kohe të shkurtër pushojnë së ftuari, lodhen, pula e pjekur u buzëqesh, pula e pjekur e dalë nga furra në kohën e duhur është një ngushëllim i vërtetë. Fjalët e tyre janë të padëgjueshme. Ngrohtësia e tyre është e largët. Ti mbetesh spektator”.)

Në një udhëtim si ai i Ornelës, tri janë mënyrat e përjetimit të kthimit: duke e ditur se çfarë dinë të tjerët për ty dhe të kaluarën tënde, nuk merresh fare me çfarë dinë ata, madje përforcon më kot gjërat që ata dinë. Mundësia tjetër është ajo "skandaliste", e cila, në radhë të parë, duket se dëshiron t'i shkundë besimet e tyre përmes një ekzagjerimi të historive të treguara. Ka edhe një mënyrë të tretë, që kalon përmes "sentimentalizimit" të së shkuarës. Edhe në këtë rast bashkëbiseduesi ngushëllohet duke luajtur me telat e sentimentalitetit që ka sjellë gjithmonë me vete ideja e emigrimit. Kurse Ornela nuk bën asnjëherë, ajo duket sikur është e thirrur për një përballje me veten, e cila sigurisht që është në çdo rast edhe përballje me të kaluarën. Dhe në këtë përballje ajo e (ri)zbulon më mirë ndriçimin e realitetit të jetuar, pa rënë në asnjë nga "grackat" e përmendura më lart, një rrugë shumë e mundimshme.

Ky udhëtim e rrotullon dhe e kthen me fytyrë nga personazhi gruan në kopertinën e librit, të paraqitur të kthyer me kurriz, të mbështetur pas një muri. Në fund të librit, kur personazhi të kthehet, lexuesi do ta shohë e do ta njohë në fizionomi dhe në gjithçka tjetër.

Identiteti

“La mano che non mordi” e (ri)zbulon të kaluarën përmes personazheve, të cilët distilojnë në vete shumë metafora ekzistenciale dhe na bëjnë të zbulojmë gjithçka që na intereson të zbulojmë dhe lexojmë në të kaluarën e tyre. Forca e romanit qëndron edhe në vlerën universale të këtyre metaforave. “Pa hequr dorë nga konkretësia e jetës shqiptare të kohës, Vorpsi fut në tregimet e saj personazhe, që janë po aq mënyra për të qenë/ekzistuar në botë,

po aq mënyra për t'i rezistuar shkretëtirës së totalitarizmit, për të ëndërruar një jetë tjetër, për të ndierë me ironi dhe shkëputje dhe shpeshherë me dhembje gjendjen e tyre ose nënshtrimin ndaj kësaj gjendjeje.”

Nëse ka një zgjedhje të fortë për një shkrimtar, kur është e mundur të zgjedhësh, ajo është edhe zgjedhja e gjuhës. Në rastin e Vorpsit me këtë roman, të mos shkruash shqip do të thotë në një farë mënyre, të heqësh dorë nga e kaluara. Por kjo duhet kuptuar më shumë në kuptimin aktiv të refuzimit dhe të të qenit i refuzuar njëkohësisht, sesa në atë më pasiv të braktisjes. Besoj se një pjesë të mirë të zgjedhjes e "imponuan" edhe temat që ajo do të trajtonte. Ndoshta Vorpsi nuk do ta kishte gjetur distancën e duhur nga e cila do të mund të fliste për të kaluarën, nëse nuk do ta kishte futur italishten mes saj dhe së kaluarës së saj. Dhe është pikërisht gjuha e huaj, një zgjedhje organike, që i tregon autores narratore se mund të shkruajë, që ia ofron asaj këtë rrugë të të treguarit. Kështu, si gjuhë e letërsisë ajo është si një sintezë e shumë kulturave, e shumë gjuhëve të përziera së bashku.

Kjo zgjedhje e gjuhës lidhet edhe me letërsinë ndërkulturore, e cila shpesh portretizon formimin e një sinteze midis kulturave të shumta dhe praktikave kulturore. "E huaja" dhe "e njohura" nuk mund të ekzistojnë vetëm në kundërshtim midis tyre, por edhe në pajtim e duke bërë të mundur njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë, angazhimi me "të huajin" nxit një vetëreflektim si te lexuesi ashtu edhe tek autori. Ndërkulturaliteti i letërsisë është i rëndësishëm si në nivelin e tekstit, ashtu edhe në atë të kontekstit sociokulturor.

Duke lehtësuar dhe siguruar një vend për shkëmbim ndërmjet kulturave dhe shqyrtimin e "së huajës" dhe "së njohurës", letërsia ndërkulturore shpesh shërben si një mjet për zhvillimin e identiteteve personale dhe grupore. Dallimet kulturore dhe proceset e formimit të identitetit vihen në skenë në letërsi dhe kështu mund të eksperimentohen. Si rezultat, kufijtë ndryshojnë dhe shpërbëhen dhe rolet kulturore ndryshojnë gjithashtu. Shkrimi ndërkulturor, natyrisht, mund të përfshijë një përzierje të më shumë se dy këndvështrimeve kulturore e sistemeve të njohurive dhe manifestohet si në nivelin letrar, ashtu edhe në atë jashtëletrar. Pika kryesore është se shkëmbimi zhvillohet në nivele të shumëfishta dhe rezulton në njohuri në lidhje me formimin e identitetit.

Prandaj, italishtja dhe të shkruarit letërsi në italisht, bëhet instrumenti optik përmes të cilit Vorpsi pajtohet me të kaluarën e saj të dhembshme dhe personazhet e saj groteskë. Ka një ripërpunim (të vetëdijshëm apo të pavetëdijshëm nuk ka shumë rëndësi) të së shkuarës përmes një gjuhe të re të vendit që Vorpsi zgjodhi për t'iu larguar vendit të vet. Ky ripërpunim është një akt i domosdoshëm, sepse përgjatë jetës, njeriut do t'i duhet "të japë llogari", të flasë, ta kujtojë dhe t'ua paraqesë atë të kaluar njerëzve të rinj, që do ta rrethojnë në çdo shtëpi të re të mundshme, në çdo realitet të ri, por mbi të gjitha në veten e tij, në ato dhomat e errëta të mbyllura me çelës. Askush prej atyre që përballen me një largim të rëndësishëm, një largim, që e zhvendos njeriun në një moshë shumë aktive nga një vend në tjetrin, nuk mund t'i shpëtojë një ripërpunimi të tillë, që kalon përmes një thjeshtimi të fortë të vetes.

Po ashtu, në raport me identitetin, udhëtimi merr një karakter shumë pozitiv, pasi na lejon të shpresojmë për më të mirën për të ardhmen; ai bëhet një mjet efektiv për të mbushur një zbrazëti të caktuar, për të gjetur atë që është e paarrtshme në realitetin në të cilin je, veçanërisht nëse është shumë shtypës dhe mbytës. Udhëtimi e bën individin më të hapur, bën që disa faktorë kufizues të zhduken. Në romanin "La mano che non morde", udhëtimi na paraqet edhe lirinë që ofron lëvizja. Duke u larguar nga vendlindja, Vorpsi mundi të njihte një botë krejtësisht ndryshe nga ajo në Shqipëri, nisi një etapë të re në rrugën e saj të jetës. Romani nuk denoncon padrejtësinë e të qenit i detyruar për të emigruar, as nevojën për t'u larguar, por e sjell të natyrshëm udhëtimin, e trajton atë si pjesë përbërëse të jetës dhe vë në dukje aftësinë e njeriut për t'u përshtatur në përmasa të ndryshme.

Kthimi i Ornelës në Ballkan është edhe një lloj pelegrinazhi. Ajo mbërrin në Sarajevë, në një tokë të ngjashme me atë të të parëve të saj, me dëshirën e "pretendimin" që të zgjojë vullnetin për të jetuar te miku i saj, Mirsadi, që ndodhet në një situatë problematike ekzistenciale. Vendimi për t'u përballur me realitetin nga i cili u arratis një ditë, na e përthyen identitetin në dy pamje: të Mirsadit dhe të Ornelës, si dhe e shpërhap si dritë nëpër gjithë personazhet e romanit.

Para mbërritjes në Sarajevë, identiteti i Ornelës mund të përcaktohej lehtësisht. Nisur nga origjina e saj shqiptare, ajo e konsideron veten të huaj në Paris dhe kështu e konsiderojnë edhe të tjerët. Kur mbërrin në Sarajevë, ajo

nuk e ka aspak ndjenjën e përkatësisë. Kjo nuk është e mundur, pasi për të tjerët është e tepërt, e ndryshme, shumë e largët. Ndihet më e huaj atje se në Paris. Edhe ajo vetë e kupton se sa shumë është larguar nga mentaliteti ballkanas, nga stili i jetesës së banorëve të tij.

Nëpërmjet udhëtimit, autorja narratore kupton se bota e brendshme është një proces i vazhdueshëm i ndikuar nga faktorë të ndryshëm. Identiteti i saj rezulton të jetë po i së njëjtës natyrë: i ndikuar nga përvojat e jetës, i aftë për ta (ri)ndërtuar veten, për të ndryshuar.

Autorja kalon vetë nëpër këtë “terapi” udhëtimi, që është ikje e kthim, por edhe modelon personazhe mbi atë përvojë, duke ndërtuar histori të ndryshme gjatë të cilave evoluon nocioni i vendit. Kështu, ka të paktën tri vende në roman: vendlindja, hapësira e zbrazët e udhëtimit për gjetkë, vendi i mbërritjes. Koha që iu korrespondon është e shkuara-emigrimi, mbërritja dhe përfundimisht integrimi në botën e re. Ideja e kohës dhe vendit bëhet një dhe përzihet në një nocion topologjik, që është sa kronologjik aq dhe i përpiktë: është një fill që zërthehet nga e tashmja në projeksionin utopik, por është gjithashtu një pikë fikse për çdo moment, i një përvoje fillestare të fituar tashmë. “Vendi” rritet dhe formësohet së bashku me protagonistët e narratoren dhe bëhet i qartë në kujtesë, subjektiv dhe objektiv, simbolik dhe real.

Kultura

Udhëtimi është “drejtëza” kryesore e veprës, e cila në raport me identitetin jep rezultanten e kulturës. Ikja dhe kthimi, zbulimi dhe rizbulimi, njohja dhe rinjohja, shkrihen në krijim. E shkuara nuk është një vend i përpiktë, i gdhendur në kujtesë dhe i kufizuar në të kaluarën; ikja dhe kthimi e thyejnë këtë perde. Pasi ka kaluar humnerën e detit ose të qiellit, të zbrazëtirës që lë pas njeriu kur largohet, koha bëhet një varg momentesh, secili i projektuar në një vend të ndryshëm, secili në një vend të ndryshëm. Prandaj, vendi bëhet kronologjik. Vorpsi është një fëmijë, më pas një e re dhe në fund e rritur, është në Ballkan, në Milano, në Paris, në Romë. Vendi kronologjik është ai vend, që merr formë dhe bëhet i përpiktë vetëm pasi është përjetuar, jetuar, ndryshuar ashtu si është dhe njeriu në metamorfozë përgjatë gjithë jetës së tij. Vendi kronologjik është kultura si një proces gjithnjë në ndërtim e sipër,

në progres, ku e vjetra dhe e reja nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, por bashkëjetojnë duke dominuar njëra mbi tjetrën.

Kultura gjithashtu lidhet me krijimin, me shkrimin. Është kërkimi artistik, krijues, përtej nostalgjisë apo katarsisit të përballjes me të kaluarën. Për Vorpsin, është gjendja hibride e "të qenit mes gjuhëve". Kështu, vetë arti letrar bëhet një vend dhe vend për të emigruar. Vendi fizik nuk ka më rëndësi në vetvete, sepse bëhet udhëtim, lëvizje. Përtej të gjitha skemave historike dhe ideologjike, në të vërtetë, në kundërshtim të qartë me to, Ornela dhe personazhet e saj na tregojnë edhe një herë se sa ngjajmë dhe se sa afër jemi me njëri-tjetrin, sa vuajtjet tona janë edhe vuajtjet e fqinjëve tanë dhe sa i ngjashëm është hutimi dhe çorientimi i emigrantit në procesin e (ri)kthimit në të shkuarën dhe (ri)zbulimit të vetes në raport me të.

Ky çorientim paraqitet më së miri nga Mirsadi. Ai e paraqet më mirë se çdo personazh një lloj pezullie, një ndjenjë tjetërsimi dhe gati paaftësie për të qenë në një realitet të ri të huaj, për t'u shkrirë e për t'u bërë përnjëmend pjesë e tij. Ai shfaqet si i huaj për veten e tij, i pafuqishëm në raport me botën që ka lënë pas, të cilën nuk e pranon, si shprehje e synimit për t'u identifikuar me vlerat e Perëndimit. Edhe dëshiron edhe s'dëshiron të jetë perëndimor; edhe dëshiron edhe s'dëshiron t'ia përcaktojë jetën origjina e tij.

"Një nga imazhet më të veçanta dhe për mendimin tim më të suksesshme në "La mano che non mordi", është përshkrimi i manifestimit fiziologjik të efektit të tjetërsimit të shkaktuar nga përvoja e çrrënjësjes së emigrantëve të kthyer. Në libër, ky tjetërsim manifestohet në ngjyrosjen e fytyrave të personazheve që popullojnë tekstin, të cilët e gjejnë veten dukshëm të lyer me ngjyrë të gjelbër, një ngjyrë që tradhton një nostalgji të ndrydhur keq për një të kaluar me një "unë" më të paprekur, të zbërthyer më vonë, për shkak të mbivendosjes së mëvonshme prej kalimit të vendeve dhe gjuhëve të ndryshme mbi identitetin individual."

Ndonëse Ornela është mikja e tij emigrante, ajo mishëron Perëndimin, sepse jeton atje, por kur e takon e kupton që ajo është e gjelbër nga migrimi dhe se ajo nuk mund ta ndihmojë. Është bërë e gjelbër, e gjelbra e kequshqyerjes, ajo tipikja e atyre që i kanë rrënjët në ajër. Por Ornela e ka gjetur identitetin e saj midis vendeve, midis gjuhëve, e lidhur krejt pak me të shkuarën e saj. Bima që i ka rrënjët ngushtë në vazo, zgjeron degët.

Mirsadi është minimalisht alteregoja e autores narratore. Është alteregoja e saj kur ai flet për ekspozimin e tepërt të tij ndaj botës, për prekjen krejt lehtësisht nga ajo botë jashtë, për ndikimin e madh nga ai realitet.

Kur mbërriti në Sarajevë, e ndikuar nga kujtimet e kulturës së vendit të origjinës, Ornela u bë një vëzhguese e aftë dhe zbuloi disa gjëra shumë të rëndësishme, për të cilat ajo nuk ishte plotësisht në dijeni më parë, të qenësishme si në jetën e saj, ashtu edhe në atë të njerëzve që takonte. Vështrimi i saj duket se është i tillë si i Perëndimit që shikon dhe vlerëson, por në të njëjtën kohë, Perëndimi i mishëruar prej saj i nënshtrohet gjykimit të Ballkanit.

Përmes reflektimeve mbi personat që takon, ndërtohet një urë midis vetëdijes së saj, vetëperceptimit dhe gjendjes së saj, asaj të një gruaje emigrante, që është larguar nga Shqipëria. Nëpërmjet udhëtimit ajo afrohet me jetën e jetuar, me të kaluarën që ringjallet automatikisht, po aq sa edhe largohet, ndihet ndryshe, ndihet tjetër.

Situata e Vorpsit rezulton të jetë e pazakontë. Megjithëse nuk ka shkuar në vendin e origjinës, por në Sarajevë, duke pasur parasysh afërsinë gjeografike, historike dhe kulturore të Sarajevës me Shqipërinë, ajo duhet të ndihej si në shtëpinë e saj atje. Çuditërisht, ajo nuk është në gjendje ta përjetojë këtë ndjenjë, ajo arrin vetëm të vëzhgojë, të gjykojë dhe të zhytet në reflektime. Ajo ndihet e huaj atje dhe kjo ndjenjë e saj zgjohet nga pamundësia për t'u integruar në shoqërinë pritëse, nuk i kupton anëtarët e saj, mënyrën e tyre të arsyetimit dhe të perceptimit të dukurive të ndryshme dhe ata gjithashtu, duhet thënë, demonstrojnë një qëndrim të ngjashëm ndaj saj. E kaluara e tyre disi e përbashkët, pra përvojat e jetuara në kohë të vështira, e lidhin atë me Ballkanin, por kjo ka mbetur pas në të shkuarën, koha i ka ndryshuar gjërat dhe e ka modifikuar totalisht këtë marrëdhënie duke e bërë të shkuarën më pak domethënëse, se ajo është vetëm një pamje e qenies, krejt e vogël në raport me pamje të tjera të mëvonshme.

“Sarajevo non è l'Albania, ma sento che pago perché non mi vedano come un'occidentale. Quando dico che vivo a Parigi, Parigi confonde tutto, fa alzare dal petto un soffio d'ammirazione, un Ah! di dolore che per me vuol dire è finita, sono colpevole! Sto troppo bene.

I dodici anni trascorsi tra Milano e Parigi manipolano la mia immagine. Inutile spiegare cosa possono essere Parigi e Milano, vano descrivere come

possono divorarti. Come fai a bombardare un sogno? Come fare a estirpare questi sogni che fanno solo del male? Che invadono il corpo con metastasi di false speranze?" (Sarajeva nuk është Shqipëria, por ndiej se po paguaj që të mos më shohin si perëndimore. Kur them se jetoj në Paris, Parisi ngatërron gjithçka, bën të dalë nga gjoksi një psherëtimë admirimi, një Ah! dhembjeje, që për mua do të thotë se mbaroi, jam fajtores! Unë jam shumë mirë. Dymbëdhjetë vitet e kaluara mes Milanit dhe Parisit manipulojnë imazhin tim. Është e panevojshme të shpjegohet se çfarë mund të jenë Parisi dhe Milani, e kotë të përshkruhet se si munden të të gllabërojnë. Si ta bombardosh një ëndërr? Si t'i zhdukësh këto ëndrra, që bëjnë vetëm keq? Që e pushtojnë trupin me metastaza shpresash të rreme?)

Megjithatë, koha e kaluar përtej kufijve të vendit të tyre të lindjes, në një mjedis kulturor krejtësisht të ndryshëm, ndryshon perceptimin e personazheve për botën, por nuk i pengon ata të distancohen plotësisht nga e kaluara.

Siç e kemi përmendur, qëllimi i udhëtimit që narratori ndërmerr për në Sarajevë është të vizitojë një mik të sëmurë, i cili pesë muajt e fundit ka jetuar në izolim total duke shmangur çdo kontakt me botën e jashtme, duke refuzuar edhe të hajë. Ky episod i një problemi neurotik, i përshkruar si një udhëtim i ngadalshëm dhe vetëshkatërrues, që sugjeron një vetëvrasje të mundshme, rezulton të jetë provokuar nga leximi i "Portretit të Dorian Greit" të Oscar Wilde-it. Pra, estetika ndërpret realitetin, duke futur një shtesë alternative, e cila e destabilizon dhe e tjetëron subjektin.

Siç thotë Emma Bond, momentet në "La mano che non morde" në të cilat perceptohet një ndjenjë tjetërsimi manifestohen përmes një filtri estetik, përmes një takimi me pamjen ose përmes një lidhjeje me imazhin, të cilat e destabilizojnë perceptimin e "realitetit" të subjektit. Edhe përmes lidhjes që krijon midis takimit me estetikën, artin, që krijon një botë fiktive dhe promovon heqjen e realitetit personal, diçka që mund të rezultojë shkatërruese për stabilitetin psikologjik të individit. Takimi me estetikën, përfundimisht çon në një vetënjohje më të thellë, pasi arti kontribuon në njohjen e vetvetes përmes procesit të Erfahrung (transformimit), për të përdorur termat e Hans-Georg Gadamer.

Përfundime

E thatë si tingulli i një shuplake, e mprehtë si një dhembje, e sinqertë si vështrimi i një fëmije, e lehtë si një shaka për vdekjen, pena e Vorpsit gjurmon një brazdë dashurie-urrejtjeje midis autores dhe atdheut të saj, Shqipërisë mbytëse, traditave të saj dhe vendos në mes një det, atë të ikjes dhe emigrimit, e vë atë mes vetë vetes së saj dhe gjuhës amtare, historisë, fëmijërisë së saj. Vorpsi e vëzhgon vendlindjen dhe kulturën e saj njëkohësisht nga brenda dhe jashtë, si autore dhe individ, si udhëtare dhe vendase, si e ngjashme dhe e huaj.

Këtu, identiteti i personazheve është ndërtuar (ose dekonstruktuar) nga vetëdijesimi për veten, të ngjashmin, “të huajin”, si dhe nga njohuritë jokonvencionale, atyre që përjetojnë në jetën e përditshme, të marra në mjedise të ndryshme të Shqipërisë dhe vendeve të tjera të vizituara. Megjithatë, rezultati është një identitet i dhembshëm dhe i çorientuar, i copëzuar e mandej mbledhur e rikompozuar, që e bën forcë mungesën e rrënjëve dhe e shndërron çorientimin në një orientim të ri letrar, estetik.

Në këtë mënyrë, identiteti na del si një koncept fluid, ai pëson modifikime. Identiteti i emigrantit, i cili është kthyer në vendin e tij të origjinës, thuhet në kontakt me realitetin e tij, me individë të cilët e konsiderojnë atë “të huaj” dhe e shprehin në mënyrë eksplicite. Protagonistja e romanit nga njëra anë ushqehet me kujtimet e Shqipërisë, të kulturës së saj, së cilës i qëndron besnike duke bërë sehir, të mentalitetit, të familjes, duke theksuar rëndësinë e tyre në jetën e dikujt, nga ana tjetër kupton se është krejt “e huaj”. Ajo e zbulon këtë përmes një udhëtimit që papritur i lejon asaj ta njohë më mirë veten, të kuptojë gjendjen e çdo migranti të pezulluar mes dy ose më shumë hapësirave jetike, pa mundësinë që t’i përkasë plotësisht asnjërës prej tyre. Në Vorpsin paraqitet zhvendosja e largimit prej vendit tënd, të cilit nuk ke ndjerë se i përket kurrë drejt një vendi që ndoshta nuk do të arrish t’i përkasësh kurrë, nga dy këndvështrime të ndryshme; nga njëra anë bëhet një lloj dënimi, që e bën atë “të gjelbër”, nga ana tjetër, është e vetmja mënyrë për ta shpenguar veten nga kufijtë e vendosur.

Duket se nëpërmjet këtij libri autorja na thotë se përkatësia identitare, kushtëzohet nga marrëdhëniet që krijojmë me të tjerët, por edhe me brendësinë tonë. Për të qenë të vetëdijshëm se kush jemi fillimisht duhet të kuptoj-

më gjendjen e dikujt. Vorpsi vë në mënyrë eksplicite lehtësim se sa të jetosh përtej kufijve të atdheut, si me detyrim, ashtu edhe kur bëhet fjalë për të e një zgjedhje të lirë, bën që individi të përjetojë shpesh probleme identiteti dhe të dështojë të identifikohet me bashkatdhetarët e tij duke u bërë qytetar i botës.

Bibliografi:

1. Barnett R., "How Images Think. Cambridge, USA: Massachusetts Institute of Technology", 2004
2. Baroni Nicola, "Ornela Vorpsi: L'Europa è un sogno da toccare, l'Italia è blu e l'Albania è il paese in cui non si muore mai", aksesuar në <https://alb-spirit.com/2020/06/08/ornela-vorpsi-leuropa-e-un-sogno-da-toccare-litalia-e-blu-e-lalbania-e-il-paese-in-cui-non-si-muore-mai/>
3. Benedetti Carla, "A Gamba Tesa: a proposito di Ornela Vorpsi", "L'Espresso", n.3, 2006
4. Bond Emma, "'Verde di migrazione'. L'estetica perturbante dello straniamento ne "La mano che non morde" di Ornela Vorpsi", aksesuar në <https://journals.openedition.org/italies/3360>
5. Bons Emma, Burns Jennifer e Mauceri Maria Cristina, "Intervista inedita a Ornela Vorpsi", "Il confine liquid, a cura di Bond Emma e Comberiat Daniele", Besa Editrice, Nardò Lecce 2013
6. Brons L.L., "Othering, an analysis. Transcience, a Journal of Global Studies", 2015, aksesuar në https://www.researchgate.net/publication/273450968_Othering_An_Analysis
7. Comberiat Daniele, "La produzione italoфона dell'Europa orientale attraverso l'opera di Ornela Vorpsi" in Id., "Scrivere nella lingua dell'altro. La letteratura degli immigrati in Italia (1989-2007)", Peter Lang, Bruxelles 2010
8. Dyserinck Hugo, "Imagology and the Problem of Ethnic Identity", In: Intercultural Studies, no.1, 2003. Op: <http://www.intercultural-studies.org/ICS1/Dyserinck.shtml>. 11 September 2007.

9. Federici Anna, "Autopsia dell'animo: la migrazione nei romanzi di Elvira Dones, Ornella Vorpsi e Anilda Ibrahim", in «Linea@editoriale» n. 3, 2011
10. <http://www.aetnanet.org/modules.php?name=News&file=print&sid=10386>
11. Jacquet Marie Thérèse, "Ornella Vorpsi: viaggiare in punta d'inchiostro", in Av. Vv., "Letteratura adriatica. Le donne e la scrittura di viaggio", Atti del II Convegno Internazionale, a cura di Carriero Eleonora e Scianatico Giovanna, Edizioni del CISVA, 2011
12. Perrone Domenica, "Il lungo viaggio di Gabriella Ghermandi, Cristina Ali Farah, Igiaba Scego e Ornella Vorpsi", in Av. Vv., "Leggere la lontananza. Immagini dell'altro nella letteratura di viaggio della contemporaneità", a cura di Camillotti Silvia, Crotti Ilaria e Ricorda Ricciarda, Edizioni Ca' Foscari, Venezia 2015
13. Pezzani Antonia, "Lo spaesamento, l'esperienza del perdersi che deriva dall'aver attraversato il confine, e del ritrovarsi. Con le parole della leggerezza. Un'intervista a Ornella Vorpsi", aksesuar në <https://www.balcanicaucaso.org/aree/Albania/Un-oceano-di-distanza-36549>
14. Vorpsi Ornella, "La mano che non morde", "Einaudi", Torino, 2007

Vebi BEHXHETI

ASPEKTE INTERKULTURORE SHQIPTARE NË VARGJET POETIKE TË PËRMBLEDHJES “TRIMDITA”, TË ZEF SKIRO DI MAXHOS

Zef Skiro Di Maxho në gjithë shtrirjen e krijimtarisë së tij, në qendër të interesimit i kishte arbëreshët, madje, që nga koha e ngulmimeve në jugun e Italisë, mënyrën e jetesës në kushte të reja dhe mbijetesën, e deri në ditët e sotme, që në mënyrë metaforike poeti e krahason me zhvillimet brenda një dite, nga mëngjesi, deri në mbrëmje, që i përgjigjet edhe titullit të përmbledhjes poetike dygjuhësore *Trimdita* (2009). Ky libër lirikash dygjuhësore shqip-italisht, përbëhet nga këto cikle poezish: “Trimdita”, “Me të vërtet Morea”, “Vjersha të verëshme dhe vëllazërie”, “Anije me Ulqin” dhe “Kazallot”. Në poezitë e kësaj përmbledhjeje, si duket, poeti ndërton një model krijues ndryshe, me tendencë të një mbylljeje, por pa e dëmtuar idenë dhe mesazhin e vargut të tij, drejtuar arbëreshëve dhe shqiptarëve në përgjithësi, ku nuk mungojnë edhe poezi me tema universale. Titulli i veprës deshifrohet që në poezitë e para, kur arbëreshi si i mençur që është, nxjerr nga kutia mëngjesin që do i shërbejë tërë ditës, metaforë kjo e fillimit të mbarë të jetës së tyre dhe përshtatjes në ambientin e ri, gjithsesi falë zgjuarsisë së tyre: *Arbëreshi/ “me mendje aq shumë pjellore”nxjerr nga mbështella kuti/ menatën dhe e vesh* (Arbëreshi). Këtë lojë fjalësh, që e prodhon edhe titullin e veprës e gjejmë edhe te vargu ku përmendet Afërdita, perëndesha romake e dashurisë, e njohur edhe si planeti “Venus”, e paraqitur në skulpturë, që njëherësh është edhe togfjalëshi “afër dita”, me kuptimin se dita është shumë afër, kjo ditë trime, që si titull del “Trimdita”, emërtim më tepër poetik, mbase gjuhësisht duhej të ishte “Trimedita”: *Afër ditës, Afërdita rri g dhe-*

ndur/ te kristali i kaltër që merr shëmbër/ nga kristalet e Muranos aq duket vepër/ specialistësh (Afër ditës).

Jeta e arbëreshit, që në fillimet e vendosjes në tokën e huaj, krahasohet me humnerën e natës, shpresën e sheh te dita, ardhmërinë dhe përballjen me një botë tjetër, ku nuk do ta ketë lehtë të ndahet nga kanuni i vjetër, për t'iu përshtatur një shoqërie të re: ...*Qytetërim/ është të mbajturit e zemërimit në gardhin shoqëror. Thuaj modernitet (Rimerr). Poeti shpeshherë kur bën fjallë për arbëreshët, që i lanë vatrat e tyre, kthehet atje, tek etërit, duke ua kujtuar arbëreshëve të rinj varret pa gjelbërim, e të lëna shkretë: O të rreptë Etër Arbëreshë/ nga bindjet tuaja të përjetshme/ atje te varri u grisën nani degat (Gjithë retë papritur). Në vargun e këtyre poezive shpeshherë shkëlqen edhe figura e gruas arbëreshe me veshjen e saj karakteristike, mbi trupin e bukur sikur të jetë pikturë e Rafaelit. Shumë poetike tingëllojnë vargjet me të cilat poeti e konsideron të bekuar kostumin, që nget lëkurën e saj, si edhe kurorën e qëndisur të nënës së vajzës nuse, kësaj bukurie të vjetër e të re. Vargu: *bekuar ai kostum që nget lëkurën tënde*, ngjason me atë të poezisë së bukur “Veshja arbëreshe”, të Martin Camajt, ku edhe ai, duke e vlerësuar aq lart veshjen e grave arbëreshe, vargut të vet i jep edhe ngjyrim erotik: ...*linja –erëmirë/ e ngime me gjë vashë*. Këtë nuse arbëreshe, me tërë pushtetin tërheqës të bukurisë, bashkë me stolitë, që e begatojnë, poeti e krahason me një rrufe çasti: *Bukuri arbëreshe në ka ndonjë kuptim të thuhet/ madhështia dhe rrufetë e çastit që stolitë e tua hedhin*. Para tërë kësaj bukurie, sipas poetit, nuk mund të mendohet se arbëreshët kohëve të fundit me të madhe i nënshtrohen asimilimit: ... *Në ka/ ndonjë kuptimtë thuhet/ se para kaq dukurie madhështore arbëreshe/ rri një zbrazëti arbëreshe*. (Rafaeli të pikturoi).*

Përveç bukurisë magjepsëse të gruas arbëreshe, që me sytë e saj dhe “fuqi sensualiteti” i vë në lëvizje: ajrin, ujët, tokën dhe zjarrin vendës, poeti Skiro Di Maxho, e vlerëson lart edhe për meritën e saj në lindjen e arbëreshëve të rinj, që do ta mbajë gjallë këtë pjesë të kombit:

Ajo mblen. Ajo tërheq.

Kur më s’do të ndienjë dashuri për lirinë

do të lindë bij të bukur arbëreshë

kontributi i saj

në mbajtjen e gjenisë.

(Ajo mblen)

Arbëreshët e vazhduan traditën artistike edhe në tokën e re. Teatri në natyrë për to ishte gjithmonë i hapur: *nga çelja e parë e pëlhurës mëngjesore/ tek ulja e perdes së madhe të natës*. Brenda kësaj skenografie u luajtën partiturat. Edhe në vargjet e kësaj poezie, poeti në mënyrë figurative flet për aftësinë e arbëreshëve për t'iu përshtatur rrethanave të reja, për të krijuar ngjashmëri me vendin e etërve të tyre: *Interpretojnë një varg o njëkohësisht/ thithë partiturat./ Mund të krijojnë dheun e Zanafillës* (Këtu teatër i hapur).

Laerti, një personazh lirik, aq shumë i përmendur në vargjet e këtij poeti, ashtu si edhe i biri, Odiseu, shërben si pikë reference për ta kujtuar të kaluarën, Itakën e tij, gjithmonë, në shërbim të arit poetik. Ky personazh, në poezinë "Një herë" paraqitet si gjithmonë; i heshtur dhe në pritje të vazhdueshme për të birin. Kësaj historie të njohur, poeti i mvësh petkun artistik, ndërsa personazhin historik e shndërron në burim frymëzimi për këto vargje, që e shqetësojnë emocionalisht. Laertin, këtë burim frymëzimi, e të shoqëruar me pritjen e gjatë, ndonjëherë, ashtu të ndrojtur e gjejmë edhe te Fusha e Zonjave, toponim ky që flet mjaft për kulturën arbërore, vendin dhe respektin e gruas (zonjës) në shoqëri.

Brenda ciklit "Trimdita", që njëherësh është titulli i kësaj përmbledhjeje poetike, përveç poezive të mbyllura e me kuptime metaforike, që kërkojnë edhe qasje për zberthime nëntekstuale, përfshihen edhe poezi më të hapura dhe më konkrete, si në përmbajtje, ashtu dhe në formën e saj. Një poezi e këtitillë është edhe ajo me titull "Në qendrën e botës", kushtuar vendlindjes së tij, Horës arbëreshe, që poeti e konsideron si qendër të botës. Ardhmëria e këtij vendbanimi më të madh arbëresh është rinia, shpresa se Hora do mbi-jetojë, duke i rezistuar ndikimit të huaj. Me vajzat e bukura dhe moshatarët e saj, që e zbukurojnë Rrugën "8 Marsi", nën blirët e mbjellë shumë vjet më parë, bashkë me dritat e mbrëmjes kjo qytezë reflekton jetë e gjallëri.

E tërë kjo pamje që hap perspektivë për jetë të lumtur në këtë mjedis arbëresh, është edhe shpresë për gjithë arbëreshët dhe gjithsesi dëshirë e poetit, që bashkëvendësit e tij të mos marrin rrugë të reja, për në vende të reja: *Në qendrën e botës/ të paktën t'asaj tënës/ pa ironi/ rrjedh arteria rinore plot të ardhme*. Poeti kur i këndon bukurisë së Horës, nuk ndalet vetëm tek ajo tokësorja, por shikimin e derdh edhe drejt qiellit me "hënën faqellore" e të "tepruar në bardhësinë e saj", që dallon nga ajo e "poetëve sqimatarë", të cilët bëjnë dritë mbi liqen, e që është vetëm pjellë e fantazisë së tyre: *I dukej*

banal krahasimi pikërisht/ me hënën e poetëve sqimatarë te liqeni (Dje mbrëma vërente hënën). Përmes lirikës së peizazhit të vendlindjes, ku përmend edhe toponimet: Kazallo, Horë e Purtelja, poeti me vargun e vet sjell edhe pamje me mot të vështirë, me furtunë, erë e shi. Era që vërsulet nga Purtelja drejt kodrave të Kazallotit, për të zbritur në gropën e Horës, me tërë ashpërsinë e vet, duke mbledhur erëmirën e spartavet, bashkë me gurët, që shëmbëlajnë me pamje njerëzish, paraqet një peizazh me plot figura stilistike, duke e zbukuruar këtë mjedis edhe në kushte të vështira klimatike, mbase vendlindja nuk është e bukur vetëm kur dielli shkëlqen, e hëna ndriçon në qiellin e kaltër: *Era në gatishmëri furtune/ vërsulet nga Purtelja* (Era në gatishmëri furtune).

Edhe në ciklin e dytë të këtij libri poezish, me titull “Me të vërtetë Morea”, poeti sjell poezi me temë nga Morea dhe disa të tjetra, ku trajton raporte mes arbëreshëve dhe shqiptarëve emigrantë në Itali. Takimi i shqiptares së re me arbëreshët e tjetër qytetërimi: *qytetërimi ynë Arbëreshësh bij dialektore t’Italisë*, ishte i zakonshëm, edhe pse emigrantja nga Shqipëria fliste ndryshe, ashtu si edhe arbëreshja siciliane, por “me të njëjtën sintoni zëri ashtu që ndërvënë fjalë dialektore siciliane me natyrshmërinë tonë”. Sipas vargjeve që na sjell poeti, nostalgjia për Morenë nuk mban, sepse tani më Morea janë shqiptarët arbëreshë dhe ata të trungut të vendit mëmë. Në vargjet e kësaj poezie, përveç këtij takimi vëllazëror, spikat edhe çështja e migrimit të shqiptarëve:

Jemi pikë referimi të qytetërimit mundësor.

Përralla e Moresë plot nostalgji nuk mban më:

Morea jemi ne e Bukur kështu

megjithëse është e çuditshme të jemi në botë imigrimi

kur emigrantët tanë nisen drejt një cilitdo Veri.

(Qytetërim mundësor)

Një takim të ngjashëm, mes një plake arbëreshe dhe një shqiptareje, poeti e sjell edhe në poezinë “Nga dy More të largëta”. Dy personazhet lirike, motra të një gjaku, për poetin Skiro Di Maxho janë dy fatet, që vijnë nga dy Moretë, nga ajo e vërteta, që mbeti vetëm një kujtim i përcjellë nga stërgjyshërit dhe Shqipëria, e zbuluar vonë nga arbëreshët: *Kushedi në kanë ndërgjegje/ se ritakohem pa mbarim/ nga dy More të largëta çdoherë/ mëma*

o bija/ motra o dama shoqërimi. Dhe sërish shqiptarja të cilën poeti e përshkruan me tërë elegancën, e të zbukuruar "në të veshur e në të ecur", shqiptarja emigrante, e cila e adhuron ahengun e një feste, ashtu si edhe punën, që e konsideron gjithashtu. Kjo temë vazhdon të trajtohet edhe te poezia "Martesa", ku gjithashtu poeti mbetet te dhembja e vjetër e ndarjes dhe e gjakut të shprishur, me dëshirën që në kushte të reja, shqiptarët të takohen me njëri-tjetrin, ndonëse pjesa më e madhe e tyre, morën rrugën e detit për në Itali e vende e tjera perëndimore. Përmes këtyre takimeve të arbëreshëve me shqiptarët e shtetit amë, qofshin edhe emigrantë, poeti dëshiron ta spikasë edhe fenomenin e ikjes nga Shqipëria, që kohëve të fundit po merr përmasë të fikshme. Në vargjet e kësaj poezie takimin e dy të rinjve, poeti e realizon përmes martesës së një arbëreshi me nusen shqiptare elbasanase. Nusja e dhëndri, ashtu si do t'i përshkruante vargu popullor, janë të bukur. Vargjet: *Ajo/ me emër të pazakontë këtu na bie/ detet e pamposhtura nga hijeshia e saj,* tingëllojnë më tepër se një varg i zakonshëm poetik. Me emrin e pazakonshëm të nuses elbasanase, poeti sikur e ironizon fenomenin e emërimeve, që nuk kanë të bëjnë me gjuhën shqipe, e as me identitetin kombëtar, por që: *bie dete të pamposhtura nga hijeshia e saj.* Dhëndri arbëresh në këtë poezi vjen me tiparet e një dashnori, "zbulues i dashurive, që nga shekujt e tij". Komunikimin mes veti të këtij çifti të ri, poeti e sheh si të lehtë, edhe pse përmes dy të folmeve shqipe, asaj arbëreshe, "të thatë të maleve tona të lodhura" dhe "shqiptimit të këndshëm të Elbasanit". Këtë akt martesor, poeti e ngrit në një nivel më të lartë se një martesë të zakonshme, meqë e konsideron si ngjarje historike, që i bashkon shqiptarët e dy brigjeve të detit, këtij kufiri ndarës pesëqindvjeçar:

Të pranishëm vëllezër e motra të gjithë:

si thoni "bukë"? E "verë"?

Ushqyer nga të njëjtat fjalë.

I sigurt ankorimi tani

nga brigjet e bashkuara të pesëqind deteve

e sigurt e ardhmja si akt besimi.

(Martesa)

Preokupimi i poetit me Morenë është i përhershëm, prandaj ky vend nostalgjie për arbëreshët, është i pranishëm në të gjitha përmbledhjet poetike të tij: *Me të vërtetë Morea jeton ende/ dhe nostalgjia e saj. Morea, nuk do vdes kurrë*, janë vargjet e para të poezisë "Me të vërtetë Morea", që është edhe titulli i ciklit të veprës poetike "Trimdita". Edhe në vargjet e kësaj poezie ku në qendër të vëmendjes është Morea, sërish vargje për emigrantët shqiptarë të cilët qëndrojnë në kënde të caktuar, mbështetur në muret e shtëpive të vjetra arbëreshe. Gjithsesi këto vargje prekin edhe fatin, apo fatkeqësinë e tyre: ... *duken anijembytur/ që shënojnë prani/ anijes More mbërthim shpëtues/ të ndjenjave...* Bashkë me përshkrimin e bukur të ambientit të ri dhe fatit të këtyre emigrantëve, poeti i përmend edhe disa qytete të Shqipërisë, kur i përshkruan ngjyrat e qiejve të Krujës, Korçës, e Beratit, vendet prej nga kishin ardhur ata: ... *Do të shpëtohen/ në këtë mbrëmje kushedi në e ngjashme/ me ngjyrat e qiejve të Krujës/ të Korçës o të Beratit.*

Poeti Zef Skiro Di Maxho, duke qenë i lidhur me rrënjët e të parëve të tij, si: Morea, Shqipëria, Kosova dhe rajonet e tjera shqiptare, nuk i la pa i përfshirë në poezinë e vet edhe shqiptarët e këtyre rajoneve, bashkë me fatin e tyre brenda sistemesh e shtetesh të ndryshme. Edhe kur vargu poetik i tij vjen nga Shteti shqiptar, ai në njëfarë mënyre prek edhe sistemin totalitar të Shqipërisë së mbyllur. Kjo më së miri shihet te poezia "Këtu kalimthi" ku personazhet lirikë janë gratë shqiptare, të sapodala nga sistemi i egër i Partisë së Punës, të vuajtura e të lodhura, por të lumtura se e përjetuan demokracinë, duke u orientuar në profesione të ndryshme, ashtu sipas dëshirës dhe ngritjes profesionale. Ato tani janë ndërmarrëse të suksesshme dhe drejtuese të kompanive të ndryshme, udhëheqin shtëpi botuese, televizione e shumë institucione të tjera. Ato, sipas vargjeve të kësaj poezie, kishin punuar gjithmonë nën komandë, e gjithmonë "të etshme për modernitet": *Mori grash rreth katërdhjetave/ në karrierë në gazeta/ shtëpi botuese tv/ të vendosura/ symprehtë/ të mësuar në komandë/ të uritura për modernitet.*

Në ciklin "Vjersha të verëshme dhe vëllazërie", poeti i ka përfshirë poezitë e frymëzuara në hapësirat shqiptare të Maqedonisë së Veriut dhe të Malit të Zi. Nga vetë titulli i këtij cikli poezish, kuptojmë se bëhet fjalë për vargje të shkruara gjatë verës, kur ai shpeshherë i vizitonte vendbanimet e vëllezërve të tij të gjakut e të gjuhës, si pjesëmarrës nëpër aktivitete të ndryshme shkencore e kulturore, në Tetovë Shkup, Ulqin e Strugë. Takimin më

vëllezërit shqiptarë, të ndarë me shekuj, e përjetonte me gëzimin më të madh, por edhe me dhembje për vitet e shekujt, që na ndanë deri në harrim të njëri-tjetrit. Përmes këtyre lirikave, ai shpreh mallin e pashuar, që e kishte prekur shpirtërisht, por edhe kënaqësinë për fatin, që e sollti koha, për t'u takuar sërish. Ai si poet që gjithmonë ishte në kërkim të rrënjëve dhe degëve identitare, nuk pushoi kurrë së kërkuari të vërtetën historike për njerëzit e gjakut e të gjuhës, jashtë shtetit amë, për vlerat shpirtërore, që e mbajtën gjallë atë, edhe pse të ndarë në shumë shtete, e sisteme denigruese politike, gjithmonë nën kompleksin e të qenit pakicë, mes kombesh të privilegjuar, të cilët për të realizuar qëllimet e tyre asimiluese, e keqpërdornin edhe fenë, bashkë me antroponimet me kuptime të huaj gjuhësore. Këtë fenomen, autori Zef Di Maxho më së miri e trajton me gjuhën e artit poetik, në vargjet e poezisë "Emra", i frymëzuar në Tetovë, në takimin me profesorët e Universitetit të Evropës Juglindore. Kjo ndarje gjeografike, gjithsesi ndikoi edhe në mënyrën e jetesës, mentalitetit tjetërfare të njëri-tjetrit, madje edhe në gjuhë e kulturë. Poeti Zef Di Maxho me kohë i kishte kuptuar pasojat e këtij izolimi e mbylljeje në vete, pa fajin e shqiptarëve, prandaj takimet me shqiptarët e këndej detit, e në rastin konkret me këta të Tetovës, i konsideron edhe historike, sepse në këtë rast, në një tavolinë u gjendën bashkë arbëreshët e krishterë të ritit bizantin dhe shqiptarët myslimanë, të cilët i lidh indi i ndjenjës së përbashkët kombëtare, sado që historia u tregua e padrejtë në vazhdimësi, realitet ky, që poeti e shpjegon më së miri me gjuhën e poezisë kur shprehet: *Të habitur nga shekujt që na tretën/ të gëzuar se jemi të gjallë/ tani e këtu*. Vetëm intuita poetike e një poeti siç është Zef Skiro Di Maxho, mund të ndërtojë varg aq të fuqishëm, që e sfidon historinë e padrejtë, madje përmes emrave të një grupi intelektualësh arbëreshë dhe një grupi tjetër shqiptarësh të cilët koha i takoi sërish, për t'i treguar njëri-tjetrit se mbetën po ata të para shprishjes së madhe:

Biem emra që tregojnë

plisat dhe ndërtimet

e historisë sonë.

Gjejmë emra që tregojnë

plisat dhe ndërtimet

e historisë suaj.

Francesko Xhani Vincenci Matedo Gjyzepe

Abdulmenafi Zeqiri Vebiu Hamiti Mustafai.

Të habitur nga shekujt që na tretën

Të gëzuar se gjendemi të gjallë

Tani e këtu.

Takimin me vëllezërit e këndeje detit në një qytet shqiptarësh, siç është Tetova, ai e përjeton me ndjenja të fuqishme që ngjallin emocione e frymëzim poetik. Në këtë mjedis mes vëllezërish aq sa është i lumtur, është edhe i pikëlluar për të kaluarën: *Tani që jemi bashkë por/ sa shkuam dete sa shkuam dete*. Në një atmosferë të këthillë e të ngrohtë vëllazërore, ku cakërrohen gotat, ai nuk dehet nga vera por nga dashuria vëllazërore e lëngut të komunitetit dhe xixat sa yjet që shkëlqejnë: ... *por këto gota vetjake/ që marrin lëng nga shishja komunitet/ sonte kanë xixa sa yjet/ që mbi qelqet ndërtojnë/ për-vijime të reja*. Edhe në poezinë "Darka aty në Tetovë", ai vjen me tërë emocionet dhe dashurinë, që i fal këtij mjedisi, ku shishja me verë, sërish është në qendër të vëmendjes, ndërsa në "gotën e qelqtë rrinin sy të miqve pritës, sy të miqve të ardhur". Përmes metaforës së vargjeve, kushtuar verës së kuqe tetovare, shtruar për miqtë arbëreshë, ai sërish e prek plagën e ndarjes, shprishjen e gjakut: *rubinin ua jep dhuratë gotave/ kush mund t'i mbajë regëtimat/ e çdo pike vere/ e çdo pike gjaku?*. Figura poetike e verës dhe e vreshtës, që aq shpesh poeti i përmend në këtë poezi, reflektojnë kuptime më të thella sesa duken. Vargu: *Të ushqyer nga e njëjta vreshtë*, si duket, është dashuria e shqiptarëve për gjuhën dhe kombin, kudo që ndodhet, ndërsa me vargjet: *Kush lëvroi vreshtën e dinte/ se punonte për miqësi/ për frymëzimin e poetëve*, poeti na përkujton vargjet e Naimit, Omar Khajamit dhe të shumë poetëve të tjerë, që vargjet e tyre poetike i stërpikën me këtë ujë të bekuar. Poezia e radhës, që gjithashtu ia kushtoi qytetit rrëzë maleve të Sharrit është ajo me titullin "Tetova". Edhe kur i këndon këtij qyteti, bukurisë magjike, me kurorën e maleve mbi kokë dhe me rrafshin e Pollogut nënë këmbë, ai mendon edhe për Horën e tij, të ngjashme, me fusha, male e dete, prandaj edhe do të shprehej:

Duket sikurse ia vutë ju mbi kokë

këtë kurorë kodra-malesh kësaj nuse Tetovë

si duket se ia vumë ne mbi kokë

*atë rreth malesh kurorë atyre katundeve
andidherash.*

(Tetova)

Poeti, si në shumë vendbanime të tjera shqiptare, edhe në Tetovë e gjen burimin e frymëzimit poetik, magjinë e vargut të vet, me gjithë fuqinë e liri-zmit të theksuar me shpjegim të figurshëm. Ai në këto mjedise ndjehet si në vendlindjen e vet: *Kudo shkeli këtë truall/ ndiej njerëzi të mirë/ njerëzore duke qenë trevat tona*. Pozita gjeografike e Tetovës, ambienti i ngrohtë vëllazëror, gjuha dhe çdo gjë tjetër shqiptare, ngjasojnë me tokën arbëreshe: *Prandaj këto lartësi toke më janë të njohura/ andej detit përkëtej detit*. Edhe në poezinë "Ngremë dolli", sërisht në mjedise tetovare, mes miqsh duke ngritur dolli për djalërinë tani, e pleqërinë nesër. Këta momente për poetin janë të një rëndësie historike, prandaj nuk do që të ikin shpejt: *E megjithëse ne kërkojmë/ të lidhim me pranga këta minuta/ të bashkimit të rrallë nga treva/ të ndryshme të ngjashme/ ata rendin drejt së shkuarës*. Dhe sërisht dolli, për takimin dhe momentet, që kushedi nëse do të përsëriten. Edhe në këtë rast me "shishen komunitet", poeti e metaforizon kënaqësinë e takimit dhe dehjen, jo nga alkooli, por nga dashuria e çmallja mes shqiptarësh, që të tjerët i kishin ndarë e përçarë. Poeti, i vetëdijshëm për ndarjen e nesërme, dhe shijen e hidhur të ndarjeve, dëshiron që ta shijojë të sotmen me këngën arbëreshe dhe shijen e verës tetovare.

*...por gatuajmë me shpirtin e hollë
të verës tetovare këngët arbëreshe
përzierje gëzimi të mbledhjes
përzierje ankthi të ndarjes
që në sipërfaqe nuk duket
por është shija që mbetet e hidhët.*

(Ngremë dolli)

Poezia e radhës e këtij cikli për Tetovën dhe qëndrimin e poetit në këtë qytet, është ajo me titull "Poeti i Tetovës", që ia kushton poetit Shaip Emurllahu, drejtorit të Festivalit tradicional "Ditët e Naimit", që mbahet në Këtë qytet. Poeti Zef Di Maxho, si pjesëmarrës i kësaj ngjarjeje kulturore-poetike, që çdo vit mbledh poetë nga të gjitha anët e botës letrare, ndjehet shumë

i emocionuar para shtatores së poetit tonë kombëtar, Naim Frashërit, që qëndron krenar në parkun e Qendrës për kulturë, pranë sheshit të qytetit. Zefi si poet i kërkimeve të gjurmëve të kulturës shqiptare, gjatë qëndrimit në këto mjedise, i rrethuar me miq poetë, ndjehet tepër i privilegjuar dhe me fat, që si përfaqësues i poetëve arbëreshë gjendet në qytetin e poezisë. Ashtu si zakonisht për kësisoj takimesh, e veçmas në këto ku jehon zëri i poezisë, sërish kupat e tejdukshme ngjyrë flamuri, ku pihet: *për shëndëtin e Arbërit/ që ngaherë bashkohet ku ne jemi/ e me ne ndodhet dhe ecën.*

Zef Skio Di Maxho në këtë qytet përmes vargjesh e shpreh edhe qëndrimin e vet për çështje fetare. Besimin islam e trajton përmes poezisë, madje edhe myezinin me “zërin e shenjtë” të ezanit në kufirin kohor ku ndahet nata me ditën, e quan poet. Për poetin arbëresh të një mjedisi, ku nuk dëgjohet thirrja për namaz, madje edhe kur e pranon realitetin historik se shkak për largim nga trojet e të parëve, përveç të tjerash, ishte edhe çështja fetare, zërin e myezinit nuk e konsideron si diçka që e pengon, përkundrazi, në një mjedis shqiptar, siç është Tetova edhe këtë thirrje mëngjesore e konsideron si poezi, sepse i këndon Zotit të paanshëm:

Çudi arbëreshe

të ikur-si thuhet-për fenë.

E dëgjove në mëngjes?

Po.

Si të pyesësh të frymëzoi

Zoti i paanshëm?

(Poezi në Tetovë)

Tetovën mikpritëse, të qeshur, me sytë si rubini në gotë e zjarr dashurie që ndez zemra, poeti do ta ketë gjithmonë në zemër me mesazhet që ngazëllojnë. Kjo lidhje me Tetovën dhe bukën e saj për poetin janë gazi i bukur, që do të jetojë gjithmonë: *Buka e tokës tetovare/ vera e tokës tetovare/ festojnë dasma* (Tetova ime di të qeshë).

Edhe Struga, ky qytet i bukur buzë liqenit të Ohrit, i ndarë m’dysh nga Drini i Zi, e bëri për vete poetin Zef Di Maxho, e frymëzoi dhe e nxiti atë t’i shkruajë poezitë “Strugës” dhe Blada e Sallatës së Nuses”. Në poezinë e parë ai e përshkruan bukurinë e këtij qyteti, madje duke e quajtur edhe nuse, metaforë e bukurisë, me të cilën do edhe të martohej: *Unë të martoja moj*

nuse *Strugë/ që sensuale më prite me pamjet e tua*. Në vargjet në vijim, ai vazhdon me përshkrimin e kësaj bukurie të rrallë, duke e përshkruar profilin e trupin të saj, “mbështjellë nga mëndafshi i qiellit dhe ujit”. Ai shpreh kënaqësinë që gjendet brenda kësaj mrekuillie, prandaj dëshiron që ta mbështesë kokën midis kodrave përreth, ndërsa flokët t’ia lëmojnë ujërat e kristaltë. Lidhja e poetit me Strugën është e fuqishme madje me rrënjë historike: ... *ndjej lidhur zemrën time ritmike/ me ritmin e zemrës sate përvëluese/ nga ajo e vjetër dashuri arbëreshe*. Poezia për sallatën e nuses” është frymëzim momenti i poetit, kur objekt trajtimi artistik e bën sallatën, një gatim të zakonshëm që nxiti emocione, nga të cilat lindi kjo poezi. Ashtu si në shumë raste të tjera të frymëzimit të fuqishëm poetik, edhe përmes këtyre vargjeve, kushtuar sallatës, që duket se nuk paraqesin ndonjë lidhje kuptimore mes veti, poeti vjen te qëllimi, që është portreti i nuses, me tërë bukurinë e saj dhe të ngjyrave të veshjes së nusërisë, që poeti i gjen në kaltërsisë e liqenit e qiellit, në të kuqtë e trëndafilin dhe në të gjelbrën e barit të mëngjesit me vesë. Figura e nuses me tërë shkëlqimin dhe buzëqeshjen, di të falë vetëm dashuri: ... *Nuse e kuqe/ si fjalë e dalë/ nga ferri i buzëve/ që mot e monë shpirtin tim djeg*. Nga kjo poezi, që lindi nga sallata me ngjyra perimesh, poeti ndërton vargje që reflektojnë përpëlitje erotike: ... *unë të them/ se cilat mollëza/ që do të ha/ sapo ti mbyll/ bebzat prani/ Fillon të kaltërit/ fërtele qielli/ në përpëlitje/ urim parajse*. Vallja si veprim dhe nusja si personazhe lirike, ndërliidhen mirë mes veti, duke prodhuar metaforën e të bukurës dhe të jetës të një familjeje të re. Siç kuptojmë nga këto vargje, poeti është mjeshër në harmonizimin dhe ndërliidhjen e pjesëve më të vogla me tërësi më të mëdha, që do të thotë se nga ngjyrat e sallatës, krijon një tërësi kuptimore që mbaron me ndjenja mbytëse të dashurisë. Edhe pas këtyre vargjeve që spikasën dashuri, sërish e kuqja e verës në shishen e komunitetit, metafora e dehjes nga dashuria mes vëllezërish: *Bekon e kuqja/ që tani u mbyll/ aty në shishen-/ -komunitet/ që na mbush venat/ kur flij’ dhurohet/ e na lidh neve/ hardhi të shenjtja*.

Gjatë vizitave që Zef Skiro Di Maxho i bënte Maqedonisë, gjithsesi të parin qytet që e vizitonte, ishte kryeqyteti, Shkupi, ky vendbanim i lashtë me histori të njohur, së pari si kryeqendër e Dardanisë, kryeqendër e Vila-jetit të Kosovës e së fundi edhe kryeqytet i shtetit të Maqedonisë, tani Maqedonia e Veriut, ku jetojnë numër i madh shqiptarësh. Poeti nga të gjitha

përmendoret e ngritura në qendrën e këtij qyteti, zgjodhi vetëm dy monumente, për t'i bërë pjesë të vargut poetik, përmendoren e Skënderbeut dhe atë të Lekës së Madh, që e quan me variantin e emërimit arbëresh, Lishëndri. Poeti tërë historinë e këtij qyteti e paraqet përmes dhjetë vargjeve të poezisë “Në Shkup”. Përmendorja e parë që i bëri përshtypje, madje që i fali edhe emocione të fuqishme, ishte shtatorja e Skënderbeut hipur në kalë, e vendosur pikërisht në sheshin me të njëjtin emër. Përmes kalit të tij, që: ... *ngre/ dhe ul natyrshëm/ putrat përpara e të prapme*, ai e paraqet edhe madhështinë e kryeherit të kombit, që qëndron ashtu krenar e me dinjitet.

Përveç Tetovës, që si vendbanim me shumicë shqiptare u bë pjesë e shtatë poezive të ciklit “Vjersha të verëshme dhe vëllazërie” dhe Shkupit, të përfaqësuar vetëm me një poezi të kësaj përmbledhjeje, ishte edhe qyteti bregdetar i Malit të Zi, Ulqini, të cilit, poeti i kushtoi gjashtë poezi, të përfshira në ciklin e posaçëm “Anija ime Ulqin”. Ky vendbanim i vjetër shqiptar, i shtrirë buzë detit Adriatik në Mal të Zi dhe me histori të njohur, jorastësisht u bë burim frymëzimi për poetin Zef Skiro Di Maxho i cili për detin, anijet dhe udhëtimet nëpër det shkruajti edhe në shumë vepra të tjera poetike. Kur ai i këndon detit dhe Ulqinit, e ka parasysh edhe shkëputjen e padrejtë të shqiptarëve nga shteti amë, prandaj udhëtimin me anije drejt Ulqinit e preferon më tepër, ngase nuk ka ndonjë pikë kufitare mes rrugës. Në poezinë, me të njëjtin titull me atë të këtij cikli, ai e përshkruan bukurinë e qytetit, bashkë me banorët bregdetarë, e sidomos pamjen e vajzave, disa nga të cilat me minifunda, por disa edhe të mbuluara me vel. Këtë laramani të veshjes e krahason me “grumbuj rruzullakë yjesh”. Ndarjen me kufij të Ulqinit me Shkodrën dhe jo vetëm, poeti e konsideron si absurd, prandaj e shtron namën:

I mallkuar

kush shpiku kufijtë. E humb durimin

dhe e marr me Evropën që nuk nxitohet

a më keq e marr me dy popuj

deri dje vëllezër e sot me një kufi në mes ku

duhet vula: pesë orë e më pritjeje të kalosh

të nëmur kufi...

“Anija ime Ulqin”

Krahasimi i peshkatarëve me poetët, është i veçantë dhe me shumë domethënie, i Zefit, mbase, ashtu si peshkatari me llambën në ballë, për ta gjetur peshkun në terrin e natës, edhe poetët nuk e kane lehtë ta gjejnë fjalën poetike, që do prodhonte shumëkuptimësi nëntekstuale: *Llambara është Ulqini/ që natën thërret detin/ sytë u zbyll poetëve/ që peshkojnë poezi* (Llambara është Ulqini). Lidhjen e poetëve më këtë perlë shqiptare e gjejmë edhe në poezinë “Me shtëpitë e larta”, ku poeti e përshkruan bukurinë e shtëpive kulla, brenda mureve të kalasë së vjetër, që flet sa vetë historia. Këtë qytet, që detin e sheh si në shuplakë të dorës, poeti e konsideron si vend të poezisë dhe detarëve, hapësirë e kërkimit të frymëzimit poetik dhe e peshkatarëve, që lundrojnë mes dy kaltërsive në kërkim të gjahut të tyre:

*Brenda sëndukut det
poezitë e mbyllura në pritje:
mjafton me radhë
në peshkim të zhytesh
e t'i hapësh
me një kyç vargu fillestar.
Të vjetër detarë poetët duken
që lundruar kanë
përgjatë vjershave t
të kohëve të gjitha.*

(Me shtëpitë e larta)

Pozita gjeografike buzë deti dhe lulet e plasave shkëmbore me aromë parfumi, këtij qyteti i shtojnë edhe më tepër bukurinë. Ai si gjithmonë, ashtu krenar për historinë e vet, qëndron i palëkundshëm në përballje me erërat dhe stuhitë detare: *Ulqini është qytezë që nuk druan/ as erërat e as detin./Edhe ne/ andidetesh/ andidherash* (Lulja ulqinake). Ky det me ngjyrë blu, e i zbukuruar me kordele shkëmbinjsh, që krijojnë laramani ngjyrash dhe shtëpitë e vjetra me të kuqen shqiptare e karakterizojnë këtë vend paradisë, por një gjë e shqetëson poetin tonë, blerja e tokës shqiptare nga rusët e pasur dhe ndërtimi i vilave në këto prona, që na i rikujton vargjet e këngës ”Bulku” të poemës së tij dhe namët, që ua drejton pemëve, që të mos bëjnë asnjë kokërr fryti, pasi i kishte blerë bujku lëtir.

Vizitën e poetit, që i bëri këtij qyteti të lashtë shqiptar, me rastin e një takimi poetik dhe kënaqësinë për pamjet e mrekullueshme ulqinake, sikur e vrau shpirtërisht fenomenin e depërtimit të familjeve ruse në tokat shqiptare:

*Në barkën e mbushur me poetë
që Kalimerja sivjet mbledh
dikush më pëshpërit
në brambullimën e motorit:
“toka shqiptare të huajve nuk u shitet.”
Fjalë ngjyrë
e kuqe shqiptare.*

(Det i Ulqinit)

Gushti si muaji i bredhjeve të poetit dhe i frymëzimit të tij poetik, që i ngjallte emocione dhe nxitje për ta shprehur lirizmin e fuqishëm përmes vargut, i tillë ishte edhe në këtë vizitë Ulqinit. Ky ishte muaji, që më së shumti e zburonte këtë qytet, prandaj poetit as që i interesonte se si do dukej kjo parajsë gushtore në dhjetor apo shkurt: Ky është gushti ulqinak,/ flamuri çdo gjëje plot jetë/ dhe vdekja është larg/ dhe s'ma ka ënda të di/ për dhjetorin tënd o për tëndin shkurt (Ky është gushti ulqinak).

Përmbledhja poetike dygjuhëshe mbyllet me poezinë “Kazallot” që njëherësh është edhe cikël në vete, e që nuk ka të bëjë me Ulqinin. Këtë emërtim të vjetër të Horës së Arbëreshëve, poeti e bëri titull të poezisë, i frymëzuar nga historia e vjetër, e kohës kur edhe të parët e tij u vendosën në këtë vend, para se të quhet me emrin e ri. Sidoqoftë, edhe pse poezia trajton një temë krejtësisht tjetër, të frymëzuar nga një zarf me librat e dërguara nga poeti i madh, e miku i tij, Ali Podrimja, ajo që e gëzoi më tepër, e që i la përshtypje të veçantë, ishte emërtimi i plotë i Kosovës: ... Por/ nën adresën e tij për të parën herë/ me natyrshmëri shoh shkruar/ REPUBLIKA E KOSOVËS. Hare/ krejt normale thua?

Siç shihet, poezia e poetit Zef Skiro Di Maxho për nga shtrirja hapësinore e frymëzimit poetik, përveç krahinave arbëreshe, Shqipërisë dhe Kosovës, përfshin edhe vendbanime shqiptare të Maqedonisë së Veriut dhe të Malit të Zi. Interesimi i poetit, që në vargjet e tij, t'i përfshijë edhe këto hapësira, e dëshmon edhe njëherë se ky poet, frymëzimin e gjen gjithandej, ku

jetojnë shqiptarët. Me rreth 20 përmbledhje poetike, një pjesë nga të cilat dygjuhësore, arbërisht/shqip dhe italisht, me tema nga më të ndryshmet, me 20 vepra dramatike, shumë libra me poezi të zgjedhura, të botuara ndër arbëreshë, Shqipëri dhe Kosovë, më tepër spikat brenga për fatin e arbëreshëve, që nga ngulmimet e para të tyre në Italinë Jugore e deri më sot. Përmes tërë kësaj krijimtarie, poeti Zef Skiro Di Maxho u ngrit në majat e letërsisë së sotme arbëreshe dhe si një ndër më të suksesshmit e poezisë mbarëkombëtare.

Literatura:

1. Zef Skiro Di Maxho, Trimdita (poezi dygjuhëshe) Giorneroe (poezia bilingue), Palermo 2009.
2. Zef Valentini, Vargje të një poeti të ri arbëresh (GUIZEPPE SCHIRO di MAGGIO, Shejzat, X-1966-3-4 Romë.
3. Matteo Mandala, Parathënia e veprës “Atje kam” e Zef Skiro Di Mxhos- (vjersha dygjuhëshe)- La mia Morea (versi bilingui), Tipografia Lusografika di Caltanissetta, Hora e Arbëreshëve, 2004.
4. Francesco Altimari, Vëzhgime gjuhësore dhe letrare arbëreshe, Prishtinë 2002.
5. Anton Nikë Berisha, Interpretime të letërsisë së arbëreshëve të Italisë, Kozencë 2008.
6. Vebi Bexheti, Sudime arbëreshe, Tetovë 2020.

Mimoza HASANI PLLANA

LETËRSIA SHQIPE NË GJUHËT BALLKANIKE

Abstrakt:

Në vendet e Ballkanit, si në Bullgari, Rumani, Greqi, Kroaci, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi, letërsia shqipe ka depërtuar përmes përkthimit letrar dhe dygjuhësisë. Depërtimi përmes përkthimit letrar përfshin një proces që u zhvillua krahas procesit të dygjuhësisë, megjithëse, për ta bërë të mundur qarkullimin e teksteve letrare, përkthimi ka qenë i lidhur ngushtë me traditën popullore, historinë, kulturën dhe artin e popujve të përfshirë në komunikimin letrar. Nëse e ilustrojmë këtë proces me fjalët e Umberto Eco (Uberto Eco), mund të themi se *nuk është e mundur të përkthehet vepra e romancierit dhe poetit irlandez, Gjejmë Gjojs (James Joyce) pa e ndjerë stilin dhe mendimin irlandez*. Rrjedhimisht, në procesin e komunikimit mes popujve të vendeve të Ballkanit, vetëm me përfshirjen e kulturës në përgjithësi arrijmë transmetimin e vlerave estetike letrare nga një gjuhë në tjetrën. Prandaj, në këtë punim analizojmë depërtimin e letërsisë shqipe në letërsinë e popujve ballkanikë, nëpërmjet përkthimit dhe dygjuhësisë.

Fjalë kyçe: *Letërsi shqipe, interkulturalizëm, përkthim letrar, dygjuhësi, gjuhët ballkanike.*

Abstract:

In Balkan countries, such as Bulgaria, Romania, Greece, Croatia, North Macedonia, and Montenegro, Albanian literature has diffused through literary translation and bilingualism. Diffusion through literary translation includes a process which has developed alongside the process of bilingualism, although to make possible the circulation of literary texts, translation has been closely linked with the tradition, history, culture, and art of the peoples involved in literary communication. If we illustrate this process with the words of Umberto Eco, we conclude that *it is not possible to translate the work of novelist and Irish poet James Joyce without feeling the style and the Irish way of thinking*. Thus, in the process of communication between different peoples of the Balkans, only with the involvement of culture in general we can manage the transmission of literary aesthetic values from one language to another. In this article we analyze the diffusion of Albanian literature in the literature of Balkan countries, through translation and bilingualism.

Keywords: *Albanian literature, interculturalism, literary translation, bilingualism, Balkan languages.*

Ndërtimi i urave përmes fjalëve

Ndërlidhjet kulturore midis kombeve janë lehtësuar ndjeshëm përmes letërsisë, e cila ka shërbyer si platformë për shkëmbimin e diskursit letrar nëpërmjet procesit të përkthimit dhe dygjuhësisë. Brenda fushës së përkthimit, korpusi letrar shqiptar shfaqet si një thesar që pret një njohje më të gjerë globale, megjithëse, letërsia shqipe tashmë ka arritur të prezantohet për lexuesit në shumë gjuhë të botës.

Nga ky këndvështrim, veprat e përkthyer jo vetëm që bartin vlera letrare, por nxisin dhe mundësojnë një kuptim më të gjerë të shoqërisë shqiptare në përgjithësi, derisa çdo vepër merr rolin e një lidhjeje kulturore, duke kapërcyer në mënyrë efektive paragjykimet dhe duke i shtyrë lexuesit të ni-

sin një udhëtim kërkimi shkencor apo edhe ndriçimi kulturor të panjohur më parë. Rrjedhimisht, depërtimi i letërsisë shqipe në skenën letrare ndërkom-bëtare jo vetëm që pasuron peizazhin letrar botëror, por edhe forcon lidhjet e mirëkuptimit dhe vlerësimit.

Interkulturalizmi si koncept që shërben për ta përshkruar procesin e shkëmbimit dhe mirëkuptimit ndërmjet popujve mbulon fusha dhe çështje të ndryshme, por si ndërlidhet me përkthimin letrar? Cili është roli i përkthimit letrar në promovimin e ndërkulturalizmit? Përkthimi mundëson komunikimin efektiv ndërmjet njerëzve. Është një proces i cili vihet në funksion të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe transmetimit të përmbajtjeve letrare në shoqëri shumëgjuhësore, rrjedhimisht ndihmon në zhvillimin e komunikimit mes lexuesve të grupeve caktuara shoqërore. Sipas fjalorit të Oxford-it, interkulturalizmi si term përshkruet, i referohet lidhjes që ndodh midis kulturave të ndryshme. Kështu, autori përmes përkthimit të veprës apo dygjuhësisë, i mundëson lexuesve të huaj të kuptojnë më mirë kulturën e tyre dhe kulturat e të tjerëve. Nëpërmjet këtij funksioni, marrëdhëniet kulturore mes grupeve mund të forcohen. Sipas këtij përkufizimi, kjo kumtesë synon ta sqarojë mënyrën se si letërsia shqipe ka depërtuar te lexuesi i dy shteteve ballkanike, Bullgarisë dhe Rumanisë.

Depërtimi i letërsisë shqipe në gjuhët ballkanike

Siç u tha më lart, ky studim shqyrton dy raste studimore: së pari, depërtimin e letërsisë shqipe në gjuhët ballkanike nëpërmjet dygjuhësisë dhe përkthimit autorial, dhe së dyti, depërtimin e saj nëpërmjet përkthimit letrar, lehtësuar nga një përkthyes. Procesi i fundit, që përfshin përkthimin e veprave letrare, është më i zhvilluar krahasuar me dygjuhësinë. Megjithatë, lehtësimi i qarkullimit të teksteve të tilla ka paraqitur sfida të mëdha të qenësishme për ndërmarrjen e përkthimit. Umberto Eco, te libri *“Të thuash gati të njëjtën gjë”*, shpjegon kompleksitetin e përkthimit, duke pohuar se, nëse përkthimi do të kishte të bënte vetëm me marrëdhëniet mes dy sistemeve gjuhësore, atëherë sipas atyre që kanë mbështetur idenë se një gjuhë natyrore e detyron folësin të ketë një këndvështrim të vetin për botën, do të thoshim se këto këndvështrime për botën janë ndërsjellshmërisht të pamatshme dhe se, për këtë arsye, të përkthesh nga një gjuhë në një gjuhë tjetër do

të thotë të kesh pengesa e vështirësi të pashmangshme (Eco, U.: 20023, 39). Këto janë hendeqet fillestare të përkthimit të letërsisë në përgjithësi, derisa letërsisë shqipe i shtohen edhe sfidat e tjera për faktin se për dekada me radhë ishte e izoluar brenda hapësirës ballkanike.

Rezultate të shumta nga studime të përkthimit arrijnë në përfundime se përkthimi letrar si proces është ende sfidues, si praktikisht ashtu edhe teori-kisht, por kur një përkthim funksionon mirë, provon që përvojat mund të mos jenë gjithmonë të hidhura, derisa në ditët e sotme, thuajse gjithë letërsia botërore zhvillohet falë përkthimeve, “*duke krijuar një lloj sistemi global ku blihen dhe shiten identitetet, përfaqësohen si në restorante etnike, ku ushqimi përfaqëson kulturën e vendit*” (Kiséry, A. Komáromy, Z. Varga, Z.: 2016, 3).

Prandaj, pavarësisht nga sfidat e qenësishme në përkthim, komunikimi efektiv midis popujve të Ballkanit kërkon integrimin e elementeve kulturore përmes letërsisë. Ky integrim është vendimtar për transmetimin e vlerave estetike letrare dhe kulturore nga një gjuhë në tjetrën.

Si ilustrim i dygjuhësisë, marrim rastin e shkrimtarit Thoma Kacori, i cili karrierën e tij letrare e zhvilloi në Bullgari, duke shkruar e botuar vepra si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë bullgare, pra udhëtimi i tij letrar në zhanrin e prozës dhe poezisë, eci në dy trajektore: përkthimi dhe dygjuhësia.

Në komunitetin shqiptar të Sofjes, Kacori nderohet si një figurë e shquar, e njohur për kontributin e tij në prozën shqipe, duke përfshirë tregime dhe romane. Tregimet janë zhanri më voluminoz i krijimtarisë së tij i shkruar për një gjysmë shekulli dhe i përmbledhur në katër libra: *Jetë me brenga* (1957), *Ditë që s'harrohen* (1958), *Tregime të Jugut* (1971), *Tregime të moçme shqiptare* (2005), ndërsa romanet më të njohura janë: *Për mëmëdhenë* (1961, 1963), *Bijtë e shtrëngatës* (1989), *Kryetrimi i Arbërisë Skënderbeu* (2005).

Tregimet e Kacorit janë të realizuara në forma të shkurtra, me tema nga realiteti shqiptar i pjesës jugore të Shqipërisë dhe realiteti shqiptar në Bullgari, përfshirë kryeqytetin Sofje dhe vendbanimet shqiptare, fshatrat e njohura Mandrica dhe Arbanasi. Tregimet nga këto përmbledhje karakterizohen nga ngjarjet dinamike të zhvilluara brenda disa ditësh dhe nga personazhet aktive të vëna në funksion të dinamikës së jetës brenda tregimit. Personazhet funksionojnë për të prezantuar tema nacionale, përfshirë të kaluarën histo-

rike të shqiptarëve dhe tema sociale, si jeta e përditshme në fshatrat dhe qytet e Shqipërisë.

Tregimet e Jugut (1971) është një përmbledhje më tipike lidhur me depërtimin e kulturës shqiptare te lexuesi bullgar, derisa njëzet e dy tregimet e përmbledhjes janë të ndërtuara me tema, ngjarje dhe personazhe tipike të kulturës shqiptare. Titulli përcakton se elementet themelore të tregimeve, siç janë tema, personazhet, ngjarja dhe gjuha tregimtare, gjeografikisht dhe kulturalisht u përkasin vendbanimeve shqiptare të Jugut, zonës në të cilën u lind dhe kaloi vitet e fëmijërisë shkrimtari Thoma Kacori. Specifikisht she-njat kulturore të regjionit nisin e dalin në secilin titull tregimi, si: *Kau, Dordoleci, Shpresa e lakrave, Guri Ulkonja, Maroja i le shëndet fshatit, Kanira, Republika e babai, Cfrati, Etje për tokë, Pramartari, Zisua e hoqi këmbën zvarrë, Nëna, Brenga djaloshare, Brenga pranverore, Pandoja, Kontrata, Traktatet, Statuja e magjistarit, Dy beteja, Mitreja dhe i biri, Nuse e bukur, Hakmarrje*. Ndonëse tregimet janë shkruar në mjedise bullgare, autori mban afër lidhjen kulturore me Shqipërinë, ndaj, përveç përfshirjes së kulturës në secilin tregim, kujdeset që libri të botohet edhe në Prishtinë, Kosovë.

Tregimet janë të realizuara si me një frymë. Secili realizim përshkohet si një rrahje zemre si rezultat i lidhjes kronologjike të ngjarjeve dhe zgjidhjes së konfliktit, ndërsa dallohet harmonizimi i ngjarjes me mjedisin, me zhvillimin e intrigës për krijimin e komplotit dhe zgjidhjen e konfliktit brenda një kohe të shkurtër, siç e përcakton teoria e zhanrit prozaik. Ndërsa, në romanet *Për mëmëdhenë* dhe *Bijtë e shtrëngatës*, Kacori lë gjurmë si një prozator që zgjedh të kujtojë temën e lavdisë së Skënderbeut dhe të Pavarësisë së Shqipërisë, duke krijuar emrin e një prozatori që gjurmon rrënjët kombëtare për të ruajtur kujtimet kolektive të popullit shqiptar, përmes veprës në prozë të shkruar në Sofje. Në vitin 1959 botoi pjesën e parë të romanit *Për mëmëdhenë* në numrin e gjashtë të revistës letrare, artistike, shoqërore e politike *Nëndori*, e njohur si organi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë. Në paraqitjen e parë me prozë të gjatë autori evidentohet për trajtimin e fatit të njeriut/ shqiptarit nga zona jugore e Shqipërisë, prej nga vinte vetë ai. Toponimia vendase fillon në këtë pjesë dhe ruhet në dy pjesët vijuese të romanit të botuar në numrin shtatë dhe tetë të revistës në vitin 1962 (Hasani Pllana, M.: 2022, 61-74.

Tregimet që nuk janë shkruar në gjuhën bullgare, janë përkthyer në bullgarisht nga bashkëshortja e tij Violeta, një soprano e njohur bullgare dhe njohëse e mirë e gjuhës shqipe.

Në dinamikat e interkulturalizimit, Kacori ka kontribut të çmuar edhe për hartimin e fjalorit bullgarisht- shqip dhe anasjelltas, meqenëse fjalori dygjuhësh konsiderohet si mjet i domosdoshëm për komunikimin ndërkulturor, derisa shërben për të lehtësuar shkëmbimin e fjalëve, ideve, koncepteve dhe shprehjeve ndërmjet folësve të gjuhëve të ndryshme.



Në kohën e botimit rëndësia e fjalorit nuk kufizohej vetëm në përkthimin e një fjale nga bullgarishtja në shqip dhe anasjelltas, por shtrihej edhe në çështjet gramatikore të gjuhës shqipe dhe bullgare. Si i tillë, fjalori gjeti përdorim nga të huajt për mësimin e gjuhës shqipe nga bullgarishtja dhe gjuhës bullgare nga shqipja, në universitetet bullgare dhe organet e tjera arsimore. Gjatë mësimin të gjuhës shqipe në universitet, fjalori ishte një nga burimet kryesore që u përdor nga studentët edhe për të rritur aftësitë e tyre të të

shkruarit dhe të folurit në gjuhën shqipe. Hartimi i një fjalori me rreth 25.000 fjalë, mund të konsiderohet i vonuar krahasuar me komunikimin ndërkulturor në mes të bullgarëve dhe shqiptarëve, megjithëse një vonesë e tillë arsyetohet pas njohjes së kontekstit social dhe nivelit të arsimimit të shqiptarëve që jetonin në Bullgari para brezit të intelektualëve, anëtarëve të grupit punues të sapopërmendur. Pamundësia e bashkëpunimit në këtë nivel theksohet edhe në parathënien e fjalorit, bashkë me disa arsye që dëshmojnë komunikimet kulturore ndërbrezore (Hasani Pllana, M.: 2022, 34-35).

Fjalori bullgarisht-shqip, është një nga kontributet më të rëndësishme për promovimin dhe mësimin e gjuhës shqipe në shtetin bullgar. Hartimi i fjalorit zgjati 5 vjet (1954-1959). Në vitin 1954, profesor Thoma Kacori, së bashku me autorët T. Tartani, L. Dusha, S. Pasko dhe L. Grabocka dhe me redaktorët bullgarë, akademik V. L. Gjeorgjiev dhe R. Mutafiçiev, nisën punimet për hartimin e një fjalori bullgarisht-shqip, ndërsa e publikuan më 1959. Grupi i autorëve dhe redaktorëve shqiptarë e bullgarë u mbështet nga Instituti i Gjuhës Bullgare pranë Akademisë së Shkencave të Bullgarisë, Instituti i Shkencave të RPSH-së për forcimin e lidhjeve dhe miqësisë ndërmjet dy popujve të Ballkanit, popullit bullgar dhe shqiptar dhe Instituti i Shkencave në Tiranë) Th. Kacori, T. Tartani, L. Dusha, S. Pasko dhe L. Grabocka: 1959).

Këtë kontribut akademik të Kcorit, e shohim brenda këtij studimi për faktin se fjalorët dygjuhësh shërbejnë si katalizatorë për kultivimin e kompetencës ndërkulturore.

Me shembullin e shkrimtarit, përkthyesit, profesorit Thoma Kacori, kuptojmë se si letërsia ka rol themelor në procesin e interkulturalizmit për faktin e shkëmbimit dhe integritit të kulturave, derisa tregimet, personazhet dhe temat i tejkalojnë kufijtë gjeografikë dhe shoqërorë, meqenëse shkrimi i tregimeve në dy gjuhë (si në këtë rast) shërbeu si një mjet jetik që një shkrimtar të prezantojë vlerat kulturore të vendit të tij të një komb tjetër. Nëpërmjet tregimeve dygjuhëshe, Kacori veprroi si ambasador kulturor shqiptar.

Përveç në rrafshin letrar dhe gjuhësor, Thoma Kacorin është i njohur në procesin e interkulturalizimit edhe duke u përfshirë në aktivitete të shoqërive kulturore shqiptare në Soje. Pas vitit 1945, Kolonia Shqiptare e Sofjes u organizua dhe formoi një organizatë të përbashkët që u quajt "Fronti Demokratik i Shqiptarëve në Bullgari". Nga kjo organizatë u zgjodh një këshill prej shtatë vetash, i kryesuar nga veterani Thoma Sotiri, me sekretar Leonid

Grabockën dhe me katër këshilltarë: Jordanka Grabova, Thoma Kacori, Jani Veriga dhe Petro Falli. Këshilli u njoh prej qeverisë së vendit, vuri simbolet kombëtare shqiptare dhe funksionoi si i tillë. Thoma Kacori nisi kontributin e tij për mësimin e gjuhës shqipe për fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë në Sofje. Përveç mëimit të gjuhës shqipe, ai mbante edhe kumtesa për historinë, letërsinë dhe të kaluarën shqiptare (Bejleri, R. Bejleri, L. 2022: 42-43).

Rumania, një vend mik dhe vatër e zhvillimit të kulturës dhe letërsisë shqiptare që nga shekulli XIX, e ka integruar letërsinë shqipe në kulturën e saj kryesisht nëpërmjet përkthimit. Për këtë punim veçoj veprën produktive të përkthyesit Marius Dobrescu, përkthyesit të më shumë se tridhjetë veprave të shkrimtarit të njohur shqiptar Ismail Kadare. A është rastësi kjo lidhje kulturore sipas tij? Sigurisht që jo. Për të arsytuar këtë mendim, citoj përkthyesin Dobrescu nga një intervistë e vitit 2019 kur thotë: unë vij nga një qytet buzë Danubit, qyteti i Naum Veqilharxhit: Brăila. Është qytet më një histori mesjetare osmane, me shumë pakica kombëtare dhe me folklor qytetar shumë të pasur. Këtu kanë lindur dy nga tregimtarët rumunë më të mëdhenj: “francezi” Panait Istrati dhe Fanush Neagu. Arti i të treguarit është bërë traditë te ne. Unë jam rritur në këtë atmosferë përrallore, ku çdo familje, çdo rrugë dhe çdo shtëpi ka historinë e vet. Pastaj Danubi, lumi Danub është i mrekullueshëm dhe ai vetë ka legjendat e tij. Sa i përket procesit të përkthimit, sipas Dobrescos një vepër letrare e cila vjen nga një letërsi tjetër duhet të plotësojë, në radhë të parë, kërkesën e cilësisë stilistike dhe gjuhësore, sepse duke hyrë në një hapësirë linguistike tjetër, me gjithë filozofinë që përcjell, ajo bëhet pjesë e asaj letërsie ku po hynë. P. sh. romani “*Gjenerali i ushtrisë së vdekur*” i shkrimtarit Ismail Kadare, pasi përkthehet në gjuhën rumune, duhet të tingëllojë rumanisht, të duket se është shkruar direkt në atë gjuhë (Hasani Pllana, M.: 2019).

Përveç Kadaresë, Dobresku ka lehtësuar depërtimin e veprës letrare shqipe në Rumani duke përkthyer veprën e autorëve, Agim Vinca, Ali Podrimja, Esad Mekuli, Eqrem Basha, pastaj antologjinë e poezisë shqipe të sotme me titullin “*Misteri i lutjeve*”, me poetë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe diaspora shqiptare. Nga intervista e gjatë me përkthyesin rumun, Marius Dobrescu, veçoj një nga kujtimet e tij se ai njohu Prishtinën pikërisht nëpërmjet pjesëmarrjes në Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, në vitin 1975.

Përfundime

Si përfundim, letërsia shërben si një dritare për të kuptuar kulturat e ndryshme, duke ofruar njohuri për traditat dhe vlerat e tyre. Teksti letrar u ofron lexuesve pamje të reja të jetës së individëve me prejardhje të ndryshme, gjithashtu ka potencial për të sfiduar stereotipat dhe paragjykimet. Autorët si Thoma Kacori dhe përkthyesit si Marius Dobresku dëshmuar se mund të thyejnë stereotipat duke i inkurajuar lexuesit të krijojnë mendim kritik mbi supozimet e ndryshme dhe të pranojnë diversitetin kulturor. Nëpërmjet punës së tyre, shkrimtarët dhe përkthyesit kontribuojnë në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimive kulturore, duke nxitur një shoqëri më gjithëpërfshirëse. Vlen të përmendet se depërtimi i letërsisë të lexuesi nëpërmjet dygjuhësisë është më pak i zakonshëm, se ai përmes përkthimit. Në fund të fundit, letërsia dhe interkulturalizmi janë të ndërlidhura, meqenëse lehtësojnë dialogun dhe shkëmbimin kulturor ndërmjet popujve, për të pasur një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe më pak paragjykuese.

Bibliografia:

- Bejleri, Rusana. Bejleri, Liljana (2022). Shkrimtari shqiptar Thoma Kacori në Bullgari, jeta dhe vepra, Sofia University St Kliment Ohridski, Sofie, 42 – 43.
- Eco, Umberto (2003). Të thuash gati të neëjtën gjë, Dituria, Tiranë, 39.
- Kiséry, András. Komáromy, Zsolt. Varga, Zsuzsanna (2016). Worlds of Hungarian Writing: National Literature as Intercultural Exchange, Fairleigh Dickinson University Press. 3.
- Kacori, Th. Tartani, T. Dusha, L. Pasko, S. Grabocka, L. (1959). Fjalor bullgarisht-shqip, Akademia e Shkencave e Bullgarisë, Sofje.
- Hasani Pllana, Mimoza (2019). Maruis Dobresku: Kam përkthyer në rumanisht gati 30 libra të Kadaresë, <https://alb-spirit.com/2019/06/07>
- Hasani Pllana, Mimoza (2022). Ndriçime për Thoma Kacorin, Olymp, Prishtinë, 34-35, 61-74.

Eraldo HATIJA

**VËZHGIME MBI SHFAQJEN
E INTERKULTURALITETIT NË ROMANET
E ISMAIL KADARESË
“DIMRI I VETMISË SË MADHE”
DHE “KONCERT NË FUND TË DIMRIT”**

Vepra e Ismail Kadaresë përbën një dukuri unike dhe jashtëzakonisht të ndërlikuar në pikëpamje të pasurisë strukturore e sistemore. Këtij gjykimi të pranuar relativisht nga kritika dhe të vërtetuar në leximin në publik i duhet shtuar përpjekja për të dëshmuar drejtpërdrejt faktet që e provojnë. Në punimin tonë do të përpiqemi të trajtojmë një aspekt në dy vepra të veçanta, por që sipas nesh takohen në një emërues të përbashkët: interkulturalitetin në letërsi. Veprat janë pjesë e triptikut të përealizuar *Koha e grindjeve: Dimri i vetmisë së madhe* dhe *Koncert në fund të dimrit*. Në veprat e përmendura, Shqipëria shihet në një situatë kritike dhe të paqetë në marrëdhëniet e saj me aleatët e jashtëm, përkatësisht me Bashkimin Sovjetik të *Dimri* dhe me Kinën të *Koncerti*. Më tej do të kuptojmë qasjen e autorit, nëpërmjet shkrimeve, në të dyja ngjarjet e mëdha: mënyra e pritjes dhe trajtimit të lajmeve, manifestimit të tij në vepra, si dhe dialektika e ngritur nga ai vetë. A është e njëjtë ajo në të dyja veprat? Nëse jo, çfarë i dallon? Çfarë kishte ngjizur në përshtypjet e popullit dhe, për pasojë, shkrimtarit të njohur, miqësia me këto dy vende? Synimi ynë është zbulimi në rrafshin poetik e kulturor i gjendjeve të dukshme e të padukshme strukturore në tekstet e Kadaresë, duke pranuar se vepra e Kadaresë është një pikë pajtimi, ekuilibri mes zhvillimeve të jashtme historiko - letrare, po edhe e prurjeve të brendshme organike mes letërsisë shqipe në tërësi në synojmë hulumtimin mbi *shndërrimet* apo simbo-

let poetike të gjendjeve kulturore në prozën e Kadaresë e po ashtu dialektikën e mundshme. Pra, çfarë e prodhon *faktin* fikcional, çfarë fshihet pas tij dhe cila është dialektika e kësaj marrëdhënieje? Besojmë se përmes dekonstruksionit, mjeteve që ofron kjo metodë, jo vetëm që një përpjekje e tillë është e mundur, por, para së gjithash, është e domosdoshme dhe e dobishme. Kadareja e zhvillon si mekanizëm poetik groteskun, për të vënë në lëvizje bashkëjetesën dhe kundërvënien e një përmase asketike psiko-morale në kulturën shqiptare, me atë të bashkësisë, që shfaqet si domosdoshmëri apo si fatalitet.

Fjalë kyçe: Kadare, dekonstruksion, interkulturalitet, tjetri, gjendje kulturore.

Projekti i triptikut “Koha e grindjes”, i shkrimtarit Ismail Kadare, çuditërisht përbëhet vetëm nga dy vepra: e para është “Dimri i vetmisë së madhe”, ndërsa e dyta vepër është romani “Koncert në fund të dimrit”. Paradoksalisht, mungon ajo vepër që pritej ta çelte siparin e triptikut të pasosur, vepër që do të pasqyroste, sikurse flitet nga studiues e kritikë të ndryshëm, çastet kritike të marrëdhënies së Shqipërisë me Jugosllavinë fqinje.

“Dimri i vetmisë së madhe” pasqyron marrëdhëniet në zbehje e më pas në thyerje të Shqipërisë me aleatin e madh lindor, Bashkimin Sovjetik, ndërsa “Koncert në fund të dimrit” i vendos ngjarjet e tij në kohën e shuarjes së marrëdhënieve të vendit tonë me Kinën socialiste.

Të dyja veprat na grishin t’u analizojmë anatominë e shenjave nga të cilat përbëhen, për të arritur në një kuptim të hamendësuar mbi një lexim të mundshëm të mënyrës së shfaqjes së interkulturalizmit në këto dy vepra. E gjitha do të bëhet duke u mbështetur në parimin e vlerës së letërsisë si dokument shoqëror dhe në dialektikën që autori vendos, për të pasqyruar zhvillimet psiko-morale dhe kulturore të kohës, në vendosje përballë tjetrit.

Në të gjitha rrjedhat kohore, letërsia shqipe, e ka synuar identifikimin e vetes si një njësi të ndryshme nga tjetri. Duke u nisur nga letërsia gojore dhe krijimtaria popullore, vërehet se e ka ndjerë përherë nevojën për ta pasur tjetrin përballë vetes si një domosdoshmëri për të nxjerrë në raport me ta

elemente dalluese të vetes: tjetri si kërcënim, tjetri si rrezik, tjetri si religjion, tjetri si papajtueshmëri.

Mund të themi se marrëdhënia me tjetrin e jashtëm e të huaj është nga shfaqjet më të shpeshta të Kadaresë: imperializmi, Perandoria Osmane, tjetri iluzion shpëtimi, si rasti me sovjetikët (kthyer prapë në armik), tjetri armik, si ngjarjet me kinezët etj. Vërehet se te Kadareja ky mit i “tjetrit” ndërron ndër vepra, duke lindur nevojën e studiuesve për ndarjen e tyre fillimisht në dy periudha krijimtare: gjatë dhe pas realizmit socialist, ku tjetri mori përmasa të tjera: i ndryshëm nga vetja, por jo domosdoshmërisht i keqi. Në periudhën e realizmit socialist, periudhë në të cilën shkruhen veprat në fjalë, tjetrin e shohim si një reminishencë e ngritjes dhe përjetimit të marrëdhënieve dhe lidhjeve psiko-morale dhe kulturore të Shqipërisë me vendet e tjera. Edhe në rastin e “Dimrit” dhe të “Koncertit”, ky “tjetër” shfaqet herë si demon, herë si rrezik, herë si kërcënim, herë si iluzioni i një dore për ndihmë e shpresë për më shumë.

Për romanet “Dimri i vetmisë së madhe” dhe “Koncert në fund të dimrit”, studiuesi Eric Faye shprehet se *janë vepra që kanë shumë pika të përbashkëta, pa qenë, megjithatë, binjakë* (Faye, 2021). Gjykuar nga rrethanat historike të ngjashme dhe duke marrë parasysh faktin se subjektet e tyre afrojnë në atë që marrin përsipër të përcjellin, mund ta marrim të mirëqenë shfaqjen e njëjtë të tjetrit për të dyja veprat. Për më tepër, edhe narrativa e përgjithshme, si dhe struktura poetike e veprave, e ngjashme, na paralajmërojnë për këtë. Sidoqoftë, me gjithë përbashkësitë e sipërpërmendura, dinamika e rrëfimit në secilën vepër paralajmëron dallime.

Studiuesja Julia Kristeva thotë se për ta hetuar statusin e fjalës, na duhet të studiojmë artikulet e saj. Pra brenda tekstit duhet të zbulojmë funksionet e vetë fjalës dhe lidhjen e saj në një kuptim të mundshëm personal.

Po t’i referohemi parafrazimit të mësipërm, do të shohim që te Kadareja vërehet një qasje jo e njëjlojtë, kur bëhet fjalë për trajtimin e dy subjekteve. Nga njëra anë tragjizmi i madh, mendimi se po afron fundi dhe requiemet e njëpasnjëshme (Dimri i vetmisë së madhe), nga ana tjetër parodia e madhe e asaj që erdhi si orvatja e fundit e krijimit të një lidhjeje përpara mbylljes së madhe të Shqipërisë, e cila u trajtua si një rrëzim i iluzioneve dhe frikë e madhe për të ardhmen e vendit në fund të “aventurës” shqiptare. (Koncert në fund të dimrit),

Dimri i vetmisë së madhe

Studiuesi Shaban Sinani na thotë se dikur romani “Dimri i vetmisë së madhe” është akuzuar për ngjashmëri me “Pavijonini e kancerozëve” të Sollzhenicinit për frikë dhe ankth ekzistencial. Ndërsa studiuesja Nina Smirova thotë se Kadareja qëllimisht e perëndimorëson vendin e tij, sidomos Tiranën (Sinani, 2016), duke i dhënë pamjen e një kryeqyteti europian, për ta përdorur Bashkimin Sovjetik si një pasqyrë dallimi prej tjetrit. Mirëpo pavarësisht nga satanizimi i shumë figurave të Bashkimit Sovjetik dhe sublimitit të heroit komunist, sërish marrëdhënia e të ndryshmit nga vetja, këtë herë e gjigantit të madh lindor, të ndryshëm nga figura e lëmuar e Tiranës perëndimore, është jo e njëjtë.

Me gjithë përpjekjet për t’u dukur perëndimore, në thelb ajo çfarë ndodh me Tiranën e atyre viteve është një tronditje e shkaktuar nga vetëdijesimi që shqiptarët nuk janë të njëjtë dhe as që u përkasin të njëjtave ideale me ata që deri atëherë i konsideronin si aleatin e madh, duke bërë që nga njëra anë të rrëfëhet për krisjen e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik dhe nga ana tjetër të dëshmohet për krizën që shkaktoi kjo krisje jo vetëm nga ana materiale, por edhe nga ajo ekzistenciale.

Tronditja e madhe shoqërore ndihet qysh në titullin e pjesës së parë, që hapet me një “Requiem për verën e shkuar”. Requiem nuk shkruhet për të gjallin, pa diskutim, por për të ikurin. Një ritual përkujtimeje për të ikurit nga kjo botë, i cili paralajmëron një mort që do të shpalojë më vonë se ku qëndron. Në vijim të leximit, do të dallohet njëfarë keqardhjeje për situatën e nderë dhe për zbehjen me Bashkimin Sovjetik. Në bisedat e njerëzve, diskutimet dhe rrëmihjet e gazetarëve për të mësuar rreth mungesës së papritur të eksportit nga BS-ja, si dhe shenjat jo të mira të shfaqura (mungesa e grurit dhe blerja në Francë e jo në BS) do të vërehet nostalgji për atë që ishte dhe nuk është më. Ose që paralajmëron të mos jetë për shumë gjatë. E teksa të gjithë gjenden nën etheet e së ardhmes, ka nga ata që u kujtohet e shkuara e afërt: përballja me armiqtë shqiptarë të Shqipërisë komuniste: zogistët, aristokratët, ballistët dhe të gjithë “zengjinët” që ishin rreziku i shqiptarëve komunistë në daljet jashtë vendit në konferencat e komunistëve të botës perëndimore. Mund të përmendet rasti i ish-zv. ministres, që në takim me gazetarin francez nuk i del nga mendja koha kur në Itali i përndiqnin zonjat aristokrate, të cilat kërkonin llogari për pronat e grabitura në Shqipëri, ose

përplasja në shesh, ku u desh ndërhyrja e armatosur rojës së tyre, partizanit veteran.

Sikur kjo të mos mjaftonte, do të na shfaqet me një mërzi të madhe diktatori Hoxha. *“Diçka midis brengës, një spikamë vetmie, mezi dallohej në mesin e ballit, ndante si humnerë sytë, zbriste te mollëzat, te buza e poshtme, ngrinte atje si plumb.”* (Kadare, 2008) Përshkrimi lë të kuptohet që trishtimi i individëve, dyshimet e gazetarit francez apo edhe probleme të tjera nuk janë të shkëputura nga problemi kryesor, në dukje thjesht si problemi politik i radhës: ftohja me BS-në aleate. Shenjat, me gjithë narracionin apo dialogët, sjellin një problem madhor, në raportin e ndarjes me tjetrin (në këtë rast Bashkimin Sovjetik dhe kulturës së huaj): ndjenja e humbjes së madhe dhe e të mbeturit vetëm. E gjithë vepra përshkohet nga imazhe dhe individë të zymtë, të cilët përpiqen që pak gëzim ta gjejnë vetëm në arratisjen nëpër kujtime.

Enver Hoxha përplaslet me Hrushovin dhe duket se beteja e krenarisë dhe idealit e nxjerr Shqipërinë ballëlart nga kjo betejë: *“Por ne e kemi ndër-gjegjen të qetë përpara historisë.”* (Kadare, 2008).

Mirëpo dikujt tjetër i kushton më shtrenjtë përplasja: përkthyesit Besnik Struga. I bëhej se mbante në vete peshën më të madhe në botë dhe ndër-gjegjen të ngarkuar me një mijë mëkate nga gabimi i bërë në përkthimin e debatit Hrushov - Hoxha. Me sa lexojmë më vonë, ky trishtim i madh i kushton edhe humbjen e fejesës me Zanën, vajzën e zv. ministrit.

E gjitha prej prishjes së aleancës Shqipëri – Bashkim Sovjetik.

Si një përvojë e paharrueshme e Kadaresë me kohën e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik, kjo e fundit nuk mëton të shfaqet as te “Koncerti”, kur në pah dalin përplasjet Kinë - BS *“Madje duke shtuar se kërkesat kineze për territoret sovjetike ishin shoviniste”*, duke mos vonuar të vendosë shenjën e mosbarazimit edhe këtu.

Në këtë lexim të shenjave, vërejmë se shfaqja e tjetrit te Bashkimi Sovjetik nuk vjen vetëm si i ndryshmi që e bën Shqipërinë të dallojë nga të vetat, por edhe si një krah për t’u mbështetur, shpresa e fundit për shpëtimin e popullit shqiptar, ndërsa ndarja e tyre përjetohet nga të gjithë, në mos si armagedoni, si një tragjedi, si një ndarje që e ka hak një requiem. Mënyra se si njoftohet kumti i Koncertit, jepet si ato kodet stilistike të letërsisë orientale, ku autori e përmend identitetin e vet krijues në fund të tekstit. (Xhindi, 2019)

Koncert në fund të dimrit

Te romani “Koncert në fund të dimrit” situata paraqitet ndryshe: marrëdhënia shqiptaro - kineze paraqitet si një iluzion (realitet) onirik. Subjekti nis në kohën e ftohjes së marrëdhënies me Kinën socialiste për të njëjtat arsye parimore: komunizmin. Mirëpo askush nuk ndihet i humbur apo i vetmuar.

Rrëfimi polifonik që mungon te Dimri i vetmisë së madhe, shfaqet rëndom këtu, për ta qartësuar situatën e për ta zbuluar qysh në fillim se problemi nuk është Shqipëria, dhe se miqësia nuk kishte qenë kurrë e sinqertë, por një plan uzurpimi nga pala tjetër, një hapësirë të konsiderueshme e zë kryetari i shtetit kinez, Mao Ce Duni. Ky i fundit gëzon jo vetëm një hapësirë të konsiderueshme ku flitet për të, por edhe një hapësirë ku rrëfimin e kalon në vetën e parë, e ku është guxuar t’i hyhet deri në mendime. Madje, arrihet të kalohet deri në zbulimin se ndërhyrjet e kulturës kineze solli aq dëm dhe ndikim të keq, sa edhe në vetë shqiptarët solli përçarje (heterogjeni), si rasti me zv. ministrin e mbrojtjes në një kanosje me tank godinës së Kryeministrit.

Përkundër “Dimrit”, ku situata është e nderë dhe gati-gati tragjike për atë që paralajmërohet të ndodhë e që pashmangshëm ndodh në fund, këtu ndryshon. E madje edhe prania e kulturës dhe popullsisë kineze në vendin tonë bëhet dysh: si e sheh Mao Ce Duni dhe planet e tij, dhe si i shohin shqiptarët Kinën dhe kinezët.

E gjitha sa u përmend më sipër, ishte Shqipëria nën optikën e Maos, ndërsa zhvillimet në Shqipëri nuk premtojnë shumë tragjizëm. Madje as seriozitet. Situatat këtu, përveçse janë të zbrazura nga të gjitha ndjesitë e trishta apo sublime, janë gati-gati parodizime të një situatë normale që do të mund të pritej nga dy aleatë. As në çastet kur do duhej të kishte seriozitet, nuk gjendet kund, si në rastin e pezullimit nga puna të Viktor Hilës. Ajo që duhej të ishte një ngjarje serioze, lëndimi me dashje, kthehet në një pjesë gazmore e së gjithës, këmba e kinezit Ping. Dialektika e ngritur nga autori në këtë roman është thujse e tillë: ftohje qesharake, parodizime situatash që do të duhej të ishin tejet serioze dhe injorim i shenjave që në një situatë normale do të duhej të ishin alarmante, sikurse në rastin e planit të robërimit të Shqipërisë nga Mao Ce Duni. E për ta përmbledhur të gjithën sa më shkurt,

sintetizimin e përgjithshëm e jep mbyllja e romanit me fjalët: “*Ndërsa mbyllte derën, kushedi pse asaj iu kujtuan fjalët e plakës Hasije: kinezët? S’ka pasur kinezë këtu. Veç në i keni parë në ëndërr*” (Kadare, 2008), duke shpërfaqur, të gjithë dialektikën e veprës dhe reagimin përballë kulturës së imponuar kineze.

Përfundime

Ajo çfarë vërehet nga leximi i të dyja veprave është qasja jo e njëlojtë e autorit në marrëdhëniet e shqiptarëve me Bashkimin Sovjetik dhe me Kinën. Në marrëdhënie me sovjetikët gjithçka përshkohet nga një tis topitjeje dhe frike për ekzistencën e mëvonshme të Shqipërisë. Frika e izolimit, tronditja e madhe e ndarjes përfundimtare dhe ankthi për të ardhmen e pasigurt është ajo që autori servir për lexuesin. Ndërkohë, asgjë e tillë nuk ndodh në romanin “Koncert në fund të dimrit”. Situata e nderë dhe parodizimi i situatave më serioze, si rasti i këmbës së kinezit Ping reflektojnë faktin që gjithçka prodhoi kultura kineze ishte tejet e largët dhe se Kina dhe Shqipëria ishin dy realitete krejt të ndryshme. Kësisoj, nuk mund dot të pretendohet për ndjenjë përkatësie.

Pavarësisht nga shenjat e ndryshme të interkulturalitetit, ajo çfarë vërehet si e njëjtë në fund të të dy romaneve është prirja drejt kalimit nga interkulturaliteti dhe përpjekja për ndërthyerje kulturore, te kultura kombëtare dhe përpjekjet për kristalizimin e kësaj të fundit.

Bibliografia:

- Kadare, Ismail, “Dimri i vetmisë së madhe”, Vepra 5, Onufri, 2008.
 Kadare, Ismail, “Koncert në fund të dimrit”, Vepra 6, Onufri, 2008.
 Kriseva, Julia, “Word, dialogue, and novel” në “Desire in Language”, fq 64-91, Columbia University Press, 1941.
 Sinani, Shaban, “Mite dhe demonë në veprën e Kadaresë”, shtëpia botuese “Naimi”, Tiranë 2016.

Loreta LOLI

LES LETTRES ALBANAISES – REVISTA QË PËRÇOI LETËRSINË SHQIPE NË KULTURËN FRANKOFONE GJATË VITEVE 1970-1990

Abstrakt:

“Les Lettres Albanaises”, revista letrare-artistike shqiptare, organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, e bëri debutimin në vjeshtën e vitit 1978, ndërsa numrin e fundit e pati në pranverën e vitit 1991. Me një jetëgjatësi afro 13-vjeçare ajo është vlerësuar nga kritika si një nga revistat më të mira e më të suksesshme të kohës. E shkruar në gjuhën frënge, u projektua që në fillim për publikun e huaj, tek i cili përcolli, përmes rubrikave të larmishme, pasurinë shpirtërore të kombit shqiptar. Edhe pse lindi si fryt i institucioneve zyrtare të Shqipërisë komuniste, për pasojë, *de jure*, do të duhej të ishte përçuese e frymës së këtij regjimi për të promovuar vlerat e realizmit socialist, *de facto*, ajo e tejkaloi këtë mision utilitar, madje, duke e sfiduar me finesë. Në pesëdhjetë numrat e njëpasnjëshëm u prezantua për publikun e huaj kultura shqiptare si sistem kombëtar, me vlerat më të qenësishme të së kaluarës, të traditës e bashkëkohësisë.

Objekt i analizës në kumtesën tonë do të jenë shfaqjet e letërsisë shqipe në këtë periodik, duke evidentuar përfaqësimet guximtare, qoftë në aspektin e gjeografisë së shkrimit shqip (prezantohen për lexuesin frankofon autorët nga Kosova, arbëreshët e Italisë etj.), qoftë në aspektin e poetikave moderne letrare, të cilat jo vetëm që nuk përputheshin me metodën e realizmit socialist, por i binin ndesh atij.

Fjalët kyçe: *Revistë letrare, Les Lettres Albanaises, censura, realizëm socialist, letërsi shqipe, moderne etj.*

Abstract:

“Les Lettres Albanaises”, the Albanian literary-artistic magazine, the product of the League of Writers and Artists of Albania, made its debut in autumn of 1978, while the last edition was in the spring of 1991. With longevity of nearly 13 years, it has been considered by critics as one of the most successful magazines of time. Written in French, the magazine was designed from the beginning to reach the foreign public, to whom it conveyed the spiritual wealth of the Albanian nation. Although it was born as the output of the official institutions of communist Albania state, so, *de jure* it should have been the promoter of the spirit of this regime and of the values of socialist realism method, *de facto*, it exceeded this utilitarian mission, even challenging it with finesse. In successive fifty issues of the publication Albanian culture is presented to the foreign public at the level of the national system, with the most inherent values of its past, tradition and present.

The object of our analysis in this paperwork will be the performances of Albanian literature in this periodical, highlighting the strong representations, whether in terms of the geography of Albanian writing (authors from Kosovo, Arberesh of Italy etc., are presented for the francophone reader), either in terms of modern literary poetics, which not only didn't agree with the method of socialist realism, but contradicted it.

Key words: Literary magazine, Les Lettres Albanaises, censorship, socialist realism, modern Albanian literature etc.

Në Shqipërinë komuniste, fundvitet '70 e pesëvjeçari i parë i viteve '80 të shekullit të kaluar ishin të mbushura me mbledhje, kongrese, konferenca, simpoziume shkencore, raportime periodike shumë të detajuara ndërinsticionale etj. mbi zbatimet e direktivave të lëshuara nga Partia Shtet dhe problematikat që shfaqeshin kur këto nuk ndiqeshin me seriozitet nga organet përkatëse. Pjesë e këtij zinxhiri vëzhgimesh e kontrollesh qe dhe arti shqiptar me të gjitha format e gjinitë e veta. Madje, siç tregohet nga zbardhja e dokumentacioneve të shumta që u janë bërë vitet e fundit arshivave zyrtare të kësaj periudhe, që na i vë në dukje veçanërisht vëllimi IV i kolanës *Dokumente mbi indoktrinimin komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit* (përgatitur nga studiuesit B. Meta, A. Krasniqi, H. Bello), arti dhe letërsia,

të konsideruara si mjetet më efikase të propagandimit e indoktrinimit komunist jo vetëm që ishin nën mbikëqyrjen e posaçme të pushtetit, por i nënshtroheshin një sistemi kapilar ndërvarësish e detyrimesh, që e mbante të mbërthyer nën peshën e një realizmi socialist nga më të ngurtët e skematikët. Jo rastësisht periudha në fjalë, që përkon me izolimin e thellë të Shqipërisë, të ndërprerjes së raporteve politike të saj me fuqitë e kohës dhe ecjes përpara me “forcat e veta”, dallohet për indoktrinimin e thellë, si dhe nga përpjekja e regjimit për të mbajtur nën kontroll dhe në censurë të rreptë çdo veprimtari publike e private, përfshirë veprimtaritë krijuese.

E krijuar në një atmosferë të tillë, nën direktiva politike nga më të zymtat, synimi i revistës letrare-kulturore “Les Lettres Albanaises” ishte që të propagandonte te lexuesi i huaj arritjet më të mira të letërsisë dhe arteve shqiptare bashkëkohore të krijuara nën metodën e realizmit socialist si dhe të përçonte njohje mbi sistemin letrar kombëtar në përgjithësi, që nga nisja e tij me letërsinë e vjetër, deri tek ajo e traditës me përfaqësuesit kryesorë që shkruan në secilën periudhë. Sidoqoftë, asgjë nuk i pengoi, së paku censorët ideologjikë e estetikë të saj, të mbanin jashtë këtij sistemi të “rishpikur” letrar një pjesë të rëndësishme të autorëve të traditës apo të modernitetit shqiptar, të konsideruar të dëmshëm e armiq si ideologjikisht, ashtu edhe letrarisht e estetikisht (Gjergj Fishta, Lumo Skëndo, Zef Skiroi, Ernest Koliqi, Anton Harapi, Musine Kokalari etj.).

“Les Lettres Albanaises” qe organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë dhe u botua në frëngjisht me periodicitet katër herë në vit (revistë tremujore). Numri i parë doli në vitin 1978, ndërsa i fundit në 1991, vitin e përmbysjeve të mëdha. “Les Lettres Albanaises” është e para e këtij lloji që shfaqet në Shqipëri. Siç pohojnë përgatitësit e revistës në parathënien që prin numrin e parë, nisma të tilla nuk kanë munguar gjatë gjithë historisë së gjatë të kulturës sonë. Shkrimtarët, artistët dhe patriotët shqiptarë shpesh kanë ndërmarrë veprime të frytshme dhe energjike për të shpalosur para botës letërsinë dhe artin e popullit tonë (sa për të sjellë vetëm një shembull, Faik Konica dhe “Albania” e tij, e cila faqet e fundit i kishte me materiale dhe tekste të ndryshme në frëngjisht), megjithatë turbullirat e kohës e dramat e njëpasnjëshme që ka përjetuar kombi e kanë ndërprerë shpesh këtë vepër. Për rrjedhojë, letrat dhe artet shqiptare janë ende pak të njohura jashtë vendit, - përfundon redaksia. Në përmbushjen e këtij qëllimi

revista mblodhi rreth vetes emrat më të spikatur të letërsisë, kritikës dhe fushave të tjera të artit shqiptar. Kryeredaktori i parë është Ismail Kadare, që do ta prijë rrugën editoriale për 12 vjet, nga nr.1/1978 deri në numrin 3/1990, ndërsa grupi redaksional nismëtar përbëhet nga dhjetë personalitete: Jakov Xoxa, Llazar Siliqi, Dalan Shaplllo, Shefqet Musaraj, Fatos Arapi, Kujtim Buza, Kristaq Rama, Çesk Zadeja, Violeta Manushi dhe Viktor Gjika. Me largimin e Ismail Kadaresë vendin e tij e zë Diana Çuli, e cila do të drejtojë vetëm 2 numra, sepse në vitin 1991 revista do të pushojë së daluri (nr. 4/1990 dhe nr.1/1991).

Nëse detyra e revistës ishte që të përcillte te lexuesit e huaj arritjet e letrave dhe të artit shqiptar të realizmit socialist bashkë me propagandën e regjimit, që këto të bëheshin të njohura dhe të intesifikoheshin me anë të rrjetit të shpërndarjes së botimeve, i cili, të paktën deri në maj të 1979-ës për këtë revistë nuk kishte rezultuar efikas, sipas informacionit zyrtar që i përcillte Sekretari i Komitetit të Partisë Tiranë, Xhelil Gjoni, Komitetit Qendror të PPSH-së, ku, ndër të tjera, përmendte, se nga tirazhi i madh prej 4,000 kopjesh qenë shitur vetëm 15-16 numra të revistës, kjo e fundit, qoftë nga shkrimet me natyrë politike, qoftë nga ato letrare, kritikë letrare apo thjesht reportazhe, kronikat e njoftimet e shkurtra mbi zhvillimet shoqërore dhe kulturore që ndodhnin në vend, kohëtoret e veprave letrare dhe të prodhimit kinematografik të realizuar brenda një viti, informacionin mbi artet figurative dhe ekspozitat e mbajtura apo mbledhjet e kongreset e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë, raportimet politike nga aktorë politikë të kohës etj., mund të thuhet se këtë detyrë të parë e përmbushi me sukses. Por edhe e tejkaloi, gjithashtu. Pranë emrave të afirmuar të artit dhe kritikës së realizmit socialist, si: Dalan Shaplllo, Andrea Varfi, Llazar Siliqi, Adriatik Kallulli, Shefqet Musaraj, Dilaver Dilaveri, Sterjo Spasse etj., poezitë, prozat dhe shkrimet kritike të të cilëve i dedikohen socializmit e simboleve të tij që në titull (poezi nga Aleks Çaçi, Luan Qafëzezi, Spiro Dede, Adem Istrefi etj., tregime nga Dalan Shaplllo, Anastas Kondo, Dhimitër Shuteriqi etj., kritikë nga Adriatik Kallulli, Ymer Jaka, Dalan Shaplllo, Razi Brahim, Nasho Jorgaqi, Fatmir Gjata, Ismail Kadare etj., krijime me figurën e partizanit, të heroit pozitiv nga Mark Gurakuqi, Dritëro Agolli, Dhimitër Shuteriqi etj.) qëndrojnë po ashtu tekste dhe autorë që ndryshojnë e veçohen nga letërsia e realizmit socialist. Që në vitin 1979 e në vazhdim sillen

disa proza të shkurtra të zhanrit të tregimit të autorit Dritëro Agolli të shkëputura nga vëllimi “famëkeq” *Zhurma e erërave të dikurshme* (epitetin e ka përdorur vetë Agolli në një parathënie që i ka bërë veprës në vitin 2006), ku përmendim: “Përballë bukurisë”, “Sonata nr. 8” etj., poezitë e liqerit nga liriku i madh Lasgush Poradeci: “Gjeniu i anijes”, “Dimri”, “Pogradeci” etj., poezitë e revoltës intime të Migjenit: “Kanga e të burgosunit”, “Kanga skandaloze”, “Rezignata” etj., proza rrëfimtare e Mitrush Kutelit: “Vjeshta e Xheladin Beut” (në 1980, 1985), poezi lirike të Fatos Arapit (1980), Drago Siliqit (1981), të Sulejman Matos (1981), tregimi i Faik Ballancës “Mbama pak pallton, çun” (1979), novela “Dasma e Sakos” e Vath Koreshit (1981) etj., sikundërse në gjininë e pikturës sillen krijime fshehtazi moderne të piktorëve Zef Kolombi: “Autoportret”, “Natyre e vdekur”, “Peizazhe” etj., (1980) të Simon Rrotës: “Natyre e vdekur” (1982), Sali Shijakut, Abdurrahim Buzës, Bashkim Ahmetit etj. Gjithashtu revista sjell që nga fillimi i saj e në vazhdimësi poezi nga autorët arbëreshë Vorea Ujko: “Muzikë”, “Poezi”, “Moment arbëresh” etj., Zef Serembe: “Autoportret”, “Nostalgji”, “Këngë nostalgjie” etj., Giuseppe Schiró di Maggio etj., ku direkt mund të veçohet lirizmi dhe metafora e gjuhës. Nuk mungojnë as tregimet poetike, poezitë dhe prozat e gjata të autorëve nga Kosova, ku shquajnë tre emra së pari, për shkak të modernitetit që e përfaqëson veprën e tyre: Anton Pashku me tregimin “Anija e dehur” (1982), Ali Podrimja dhe Sabri Hamiti me disa poezi (1981,1983), për të vazhduar me të tjerë, si: Esat Mekuli (1979), Azem Shkreli (1980), Din Mehmeti (1981), Agim Vinca (1981), Adem Demaçi (1981), Rexhep Qosja me “Danjollin e Sherkes” (1986) etj.

Viti 1985, që përkon edhe me vdekjen e diktatorit Enver Hoxha do të sjellë një numër të revistës kushtuar plotësisht atij. E pritshme! Por, pas kësaj gjërat do të ndryshojnë. Për vetë prurjet e shtuara të produktit letrar të disa autorëve modernë që do të ketë revista në pesë vitet e ardhshme, 1985-a do të shërbejë si vijë ndarëse. Duke filluar nga nr.2 i vitit 1986 do të sillen për lexuesin më shumë poezi dhe krijime letrare në prozë nga Mitrush Kuteli dhe nga autorët nga Kosova, si: Ali Podrimja, Sabri Hamiti e Eqrem Basha të cilët shkëlqen edhe më fort ligjërimi modern. Në nr.2/1986 Kuteli do të zërë të gjithë rubrikën “Letërsia e së shkuarës” me plot 5 rrëfime, ndërsa poetët S. Hamiti dhe A. Podrimja, përkatësisht në rubrikën “Poezi”, nr.1 dhe 2 i vitit 1987 do të përfaqësohen me nga 11 poezi secili.

Sakaq A. Podrimja në vitin 1988 do të rivijë me 20 poezi të tjera, kurse poeti Eqrem Basha këtë vit do të trokasë për herë të parë në revistë me 13 poezi. Sabri Hamiti do të na prezantohet, këtë radhë, nga profili i studiuesit të letërsisë shqipe që operon me nocione dhe terma letrarë sipas metodave moderne të studimit të letërsisë që nuk kanë të bëjnë me ato të realizmit socialist, për të mbërritur te një tjetër profil i rëndësishëm i studimeve letrare shqiptare - Ibrahim Rugova, që vjen pas dy vitesh (1990) me monografinë mbi Bogdanin. Viti 1990 do të rikthejë poezinë e Eqrem Bashës me 22 krijime të tjera. Kësaj periudhe do t'i bashkëngjiten edhe shkrimet kritike mbi vepra të caktuara letrare, si për shembull për romanin e Mehmet Krajës (1989) apo informacionet e zgjeruara për veprimtaritë intelektuale të personaliteteve të kulturës shqiptare në Kosovë, siç është rasti i intervistës së Ali Aliut dhe Milazim Krasniqit dhënë gazetës kroate "Danas" (1989) etj.

Sa u takon poetëve shqiptarë të Shqipërisë zyrtare viti 1987 do të sjellë ndjeshmëri e frymëmarrje të re, parathënie për një kohë tjetër që po trokiste dhe do të vinte më në fund edhe këtu. Ardhja e poetes së talentuar Mimoza Ahmeti, e cila pas viteve '90 do të kulmojë me poetikat e saj moderne e postmoderne, ishte një ogur i mbarë i ndryshimit, e bashkë me të mund të përmendim krijimet e Preç Zogajt, Natasha Lakos e Rudolf Markut. Viti 1990 në gjininë e pikturës sjell Lumturi Blloshmin e cila përfaqësohet me 8 punime.

Thuhet, me të drejtë, se një revistë që lind është një vendtakim i ri, është një dritare më shumë, një rrugë më e gjerë, një fushë për të përtëritur kulturën e format e saj shprehëse, për t'i bërë pyetje vetes e të tjerëve, për të kërkuar përgjigje, për të përhapur tendenca, mënyra për të nxitur krijimtarinë. Natyrshëm revista "Les Lettres Albanaises" u kthye në një pasaportë kulturore që e përcolli letërsinë, artet dhe një pjesë të identitetit shqiptar jo përmes një rruge të ngushtë njëkalimëshe, por në një rrugë të gjerë, ku autorët, historianët, kritikët e artit, kineastët, studiuesit e folklorit, muzikantët, por më së shumti poetët dhe piktorët ecën përmes artit të tyre modern për të shpërfaqur edhe një tjetër dimension të artit mbarëkombëtar bashkëkohor në sytë e lexuesit frankofon.

Pyetja që mund të ngrihet këtu, se ç'përshtypje mund t'i jepnin këtij lexuesi veprat e krijuara sipas metodave shterpë të një doktrine marksiste si ajo e realizmit socialist, që vazhdonte të përdorej ende në vendin tonë si një

rast i veçuar eksperimental, një metodë në një atdhe-epruvet, kur në vitet '70 e '80 ky lexues ishte në dialogim me poetikat postmoderne dhe poststrukturaliste që shpartalluan përfytyrimet pozitiviste mbi natyrën e marrëdhënieve shoqërore dhe të dijes njerëzore, mbetet e hapur për kërkime. Nuk dimë të themi sa efikasitet të matshëm pati revista (sa ishte shpërndarja te lexuesi i huaj, sa kopje të saj mundën të qarkullojnë, cila ishte kategoria e lexuesit që shfaqte më shumë interes për të etj.,) por, të paktën, parë nga ana e botës shqiptare, pra, nga ana e dërguesit, mund të themi se përfshirja në mozaikun letrar kombëtar e teksteve dhe autorëve që nuk përfaqësonin vetëm metodën zyrtare të realizmit socialist ishte një arritje që duhet vënë në dukje.

Në suksesin e një periodiku rol të dorës së parë luan veçanërisht kryeredaktori i cili ka vizionin dhe përgjegjësinë për rrugën dhe frymën që do të marrë revista/gazeta që do të dalë në dritë. Siç shprehej Kadareja, diku në rreshtat e parë të revistës, se “Lumturia e saj ishte të merrte vlerësimet dhe sugjerimet e lexuesve të huaj”, duke e konsideruar vendosjen e një kontakti të tillë si plotësim të misionit të saj, ndërsa ne, në përfundim të këtij udhëtimi të shkurtër në 13 vitet e “Letrave shqiptare në gjuhën frënge”, mund të shtojmë se ky Mision u tejkalua shumë më mirë se kaq. Fati i mbarë i revistës lidhet me kapitenin e saj, Ismail Kadarenë, i cili, si njohës i mirë i erërave të kulturës perëndimore diti që ta drejtonte anijen e vogël të letrave shqipe në det të hapur, të trazuar mes dallgëve të Lindjes dhe Perëndimit, të sigurtë dhe të hijshme.

Bibliografia:

1. “Les Lettres Albanaises”, vitet 1978 -1991.
2. Meta, Beqir; Krasniqi, Afrim; Bello, Hasan. (2021) *Dokumente mbi indoktrinimin komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit – Dokumente historike (1977-1984)*. “ASA”, Tiranë, 2021.
3. Tahiri, Brunilda; Loli, Loreta. (2022) *Les Lettres Albanaises- Bibliografi: 1978-1991*. “BKSH”, Tiranë.

KULTURË
dhe
HISTORI

Nikollë LOKA

LËVIZJET KONKURUESE NACIONALISTE DHE PËRPPJEKJET PËR HAPJEN E SHKOLLAVE SHQIPE NË MAQEDONI

Abstrakt:

Maqedonia ishte një mozaik popujsh, ku shumicën e popullsisë e përbënin bullgaro-maqedonasit dhe shqiptarët, por kishte dhe pakica të tjera etnike: serbë, turq dhe grekë. Në periudhën e zhvillimit të nacionalizmave dhe të formimit të identiteteve kombëtare, lindën lëvizje konkurruese nacionaliste, të cilat synonin të legjitimonin si të tyre territore sa më të gjera të Maqedonisë. Duke qenë se identitetet fetare ishin të konsoliduara prej kohësh, në skenë kishin dalë rivalitetet fetare midis ortodoksëve: Patrikanës së Stambollit si mbrojtëse e greqizmit, Ekzarkatit bullgar dhe Kishës serbe. Identitetet dhe besnikëria e popullsisë ortodokse ishin të papërcaktuara, maqedonasit vendas të besimit ortodoks mund të konsideroheshin grekë nëse ndiqnin një kishë greke, por bullgarë ose serbë nëse flisnin një gjuhë sllave. Në lojë ishte dhe shteti osman, i cili kreu reforma të rëndësishme arsimore gjatë periudhës së Tanzimatit. Pavarësisht nga pozita e disfavorshme e shqiptarëve si etni pa shtet të vetin, ata hapën shkolla shqipe në territoret shqiptare në Maqedoni aty ku mundën dhe e kthyen Manastirin, kryeqendrën e Maqedonisë në qendër të lëvizjes kombëtare për shkollën shqipe.

***Fjalë kyçe:** milet, Patriarkanë, arsim fetar, arsim laik*

Nga Ballkani i përbashkët osman te vetidentifikimi entonacionalist

Megjithëse termi *millet* përfshinte idenë e "kombit" në gjuhën turke, ai ndante pak me konceptin e Evropës Perëndimore. *Milletet* osmane i identifikonin njerëzit vetëm në bazë të fesë. Duke eliminuar të gjitha konsideratat e përkatësisë etnike, identifikimit si pjesë e një mileti i mungonte plotësisht kuptimi territorial, i lidhur me konceptin evropianoperëndimor të kombit. Ky fakt çoi gjithnjë e më shumë në popullsi të përzier etnike në të gjithë Ballkanin. Shoqëria osmane u organizua në traditën *zimmi* (dhimmah). Nuk kishte asnjë koncept osman të shtetësisë, derisa ligji për shtetësinë osmane u miratua në vitet 1860. Grekët dhe sllavët, falë përdorimit të gjuhëve greke dhe sllave në ceremonitë fetare dhe në të gjitha entitetet ortodokse, kishin arritur të mbrojnë pjesët bazë të kulturës së tyre me mjetin më të rëndësishëm, gjuhën. Sistemi mori pak kohë për t'u zhvilluar dhe milete të tjerë u krijuan më vonë, veçanërisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe derisa mileti pas revolucionit xhonturk, u bë sinonim i kombësisë.

Mileti i parë që u institucionalizua ishte ai ortodoks. Bota ballkanike në këtë kohë ishte një botë ortodokse jokombëtare dhe politika ballkanike konceptohej dhe shprehej në terma ortodoksë jokombëtarë. Deri në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, territoret ballkanike ishin nën autoritetin e tri kishave të njohura autoqefale nga autoritetet osmane. Juridiksioni i Patriarkanës së Stambollit fillimisht ishte i kufizuar në zona të përcaktuara mirë të Ballkanit dhe Anadollit. Shumë pjesë të Ballkanit në Bosnjën e sotme, Serbinë, Maqedoninë e Veriut, Greqinë e Veriut dhe Shqipërinë e Jugut ishin nën juridiksionin e Patriarkanës serbe të Pejës ose Kryepeshkopatës autoqefale bullgare të Ohrit. Ndërsa Patriarkët e Pejës ishin serbë, shumë kryepeshkopë të Ohrit ishin bullgarë, vllah ose shqipfolës, shpesh nga Himara ose Voskopoja.

Shfuqizimi i kishave autoqefale serbe dhe bullgare e forcoi procesin e greqizimit të popullsisë së etnive të ndryshme. Nëpërmjet miletit ortodoks, gjuha greke u bë gjuha e Ballkanit osman jomysliman dhe kultura fetare greke u nxit pothuajse në çdo qendër kishtarë ortodoksë nën kontrollin e Patriarkanës së Stambollit. Fanariotët kishin një interes të madh për të ruajtur shoqërinë osmane siç ishte. Ata kontrolluan miletin ortodoks, dominuan

çështjet ekonomike dhe të jashtme të Perandorisë dhe monopolizuan sundimin në të dy principatat rumune. Të gjitha postet e rëndësishme administrative të milletit ishin në duart e tyre. Kur fanariotët tradicionalë e përforcuan ndjenjën e ekzistuese të epërsisë kulturore greke ndaj anëtarëve jogrekë, kryesisht sllavë, të milletit ortodoks, ky akt ushqeui një reagim të thellë etnik antigrek, i cili u shndërrua në armiqësi të plotë ndaj tyre. Njohja e dallimeve etnike të përcaktuara gjuhësisht midis ortodoksëve ballkanikë tregon se shqiptarët, vllehtë dhe bullgarët u vendosën në rrugën e njohjes dhe vetëpërkufizimit si kategori kolektive për shkak të veçorive të tyre gjuhësore.

Epoka e teokracisë për jomyslimanët karakterizohej nga ndikimi gjithëpërfshirës i kishës.

Shpërbërja në sistemin e milletit filloi me Tanzimatin, në mesin e shekullit XIX, si një çështje prioritare, kur ata që sunduan shtetin osman, hynë në një përpjekje për të krijuar një komb të ri osman, i cili u bë një nga elementët bazë që përcaktoi sistemin arsimor osman në shekullin XIX. Me njohjen që i bëri sulltani Ekzarkatit dhe milletit bullgar në vitin 1870, ortodoksët e Ballkanit u perçanë në "patriarkistë" dhe në "ekzarkistë". Po atë vit, autoritetet osmane do të njihnin milletin vllah (arumun). Megjithatë, pavarësisht nga shtimi i mileteve, siç ka vërejtur Maria Todorova, para së gjithash, "Perandoria Osmane ishte një shtet islamik me hierarki të rreptë fetare ku jomyslimanët zinin vendet e pasme.

Elementi ortodoks i krahut perendimor të Gadishullit Ballkanik përmblihte shqiptarë, grekë, arumunë, sllavë dhe ciganë. Në vitet 1766- 1767, kur u mbyllën Patriarkana e Pejës dhe Argjipeshkvia e Ohrit, të gjithë u lidhën shpirtërisht me Patriarkanën e Stambollit dhe hierarkinë e saj. Duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit XIX, krijimi i shteteve të para ballkanike (Serbi, Greqi, principatat rumune) dhe rritja e "nacionalizmave ortodoksë" çuan në krijimin e rrjeteve rivale që mbështeteshin te hierarki të dallueshme nga njëra-tjetra dhe te përdorimi i gjuhëve liturgjike (dhe te shkollimit) të ndryshme.

Deri në vitet 1870, me ardhjen e agjitacionit nacionalist bullgar, grek dhe serb, banorët e Maqedonisë mbanin identitetin fetar si të krishterë, ndërsa etniciteti specifik i përcaktuar gjuhësisht do të thoshte pak për ta; mjaftonte që shumica flisnin sllavisht dhe ishin ortodoksë, gjë që i dallonte nga fqinjët myslimanë. Ata iu nënshtruan planeve imperialiste të institucioneve

fetare dhe arsimore greke, bullgare dhe serbe në Maqedoni, të cilat u përpoqën të rrënjosnin mbi ta një kombësi greke, bullgare dhe serbe në mes të kaosit të një mjedisi të përkeqësuar ekonomik, social dhe politik brenda shtetit osman.

Në fakt, në këtë periudhë, maqedonasit sllavë kishin një ndjenjë të vaktë të përkatësisë. Në shkrimet e tij nga viti 1906 -1907, Cvijic pohoi se "sllavët maqedonas" ishin një masë "amorfe" dhe "e luhatshme", pa vetëdije kombëtare. Sipas tij "ata ishin të predispozuar të bëhen serbë ose bullgarë në varësi të shtetit që i anekson. Disa vëzhgues madje besonin se maqedonasit ishin një "komb pa kombësi dhe ndërgjegje kombëtare. Etnia e subjekteve maqedonase nuk kishte asnjë pasojë për osmanët. Osmanët dëshmuuan se ishin të aftë të vendosnin një komunitet kundër një tjetri me qëllim të zgjatjes së pranisë së tyre në atë rajon.

Etnonacionalistët ballkanas në betejën për Maqedoninë

Maqedonia e shekullit të nëntëmbëdhjetë ishte një rajon takimi etnik ku popuj të ndryshëm, kryesisht shqiptarët, bullgarët, grekët, serbët dhe turqit jetonin në afërsi dhe shpesh të përzier. Për të penguar shkëputjen e popujve ballkanikë nga shteti, në periudhën pas kryengritjeve të grekëve, bullgarëve, serbëve dhe vllëve, atyre iu njohën disa veçori kulturore. Njëra prej tyre ishte edhe shkollimi në gjuhën amtare. Në realitet popujt jomyslimanë edhe më përpara e kishin shkollimin në gjuhët e tyre, ndërsa në këtë periudhë ata filluan ta shfrytëzonin këtë të drejtë për formësim kulturor dhe identitar. Parë në këtë këndvështrim, shqiptarët kishin mbetur prapa, në krahasim me popujt e tjerë të Ballkanit. Aq më keq për shqiptarët se në tokat e tyre po hapeshin edhe shkolla greke, serbe dhe bullgare, sepse dekreti perandorak osman i quajtur Hatti-Humaiun ua lejonte ato.

E perceptuar politikisht si nënkuptim i kombësisë, përkatësia kishtare nënkuptonte gabimisht një lidhje me shtetin përkatës kombëtar. Për shembull, kur bullgarët dhe serbët themeluan kishat e tyre (si dhe kishën rumune, që synonin vllëtë), u njohën milletet e rinj dhe papritmas u shfaqën 'kombësi' të reja në Maqedoni. Grekët ishin të vetëdijshëm se shumica e sllavëve maqedonas do t'i bashkoheshin një kisha ortodokse kulturore sllave, gjuha

letrare-liturgjike e së cilës i ngjante shumë gjuhës së tyre amtare. Serbët, të preokupuar me Bosnjë-Hercegovinën në vitet 1870, fillimisht e injoruan kërcënimin e mundshëm të Ekzarkatit për zgjerimin e ardhshëm të Serbisë. Bullgarët pro Ekzarkatit e përshkuan Maqedoninë duke u bërë prozelit midis sllavëve. Grekët pro patriarkanës, të cilët nuk donin të humbnin monopolin e miletit, u kundërpërgjigjën me përpjekje të ngjashme. Fushata e nxehtë fetare-kombëtare shpejt degjeneroi në terrorizëm dhe gjakderdhje. Bandat e organizuara të ekzarkatistëve dhe patriarkatistëve i frikësuan fshatarët sllavë dhe shpesh u përplasën midis tyre. Kisha bullgare u bë instrumenti kryesor për promovimin e pretendimeve kombëtare bullgare në Maqedoni në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Për ta kundërshtuar këtë, peshkopët grekë të zonës morën qëndrime gjithnjë e më militante nacionaliste, deri në atë pikë sa që betejat kombëtare në Maqedoni u zhvilluan kryesisht për kontrollin e kishave dhe juridiksioneve kishtarë. Tablosë komplekse do t'i shtoheshin së shpejti prelatët shqiptarë, pasi ata morën drejtimin e lëvizjes nacionaliste shqiptare.

Rivaliteti i madh midis Serbisë, Greqisë dhe Bullgarisë filloi me përplasjet fetare midis patriarkut grek të Stambollit dhe ekzarkatit bullgar gjatë viteve 1894-1896. Në vitin 1895 qeveria e Sofjes i kërkoi Stambollit të emëronte pesë peshkopë bullgarë në tokat shqiptare dhe maqedonase. Fillimisht kishat e shteteve ballkanike dërguan peshkopë dhe priftërinj në qytetet e Maqedonisë dhe kërkuan të rekrutonin priftërinj nga popullsia vendase në mënyrë që të zgjeronin praninë e tyre kishtarë nëpër vendbanime të ndryshme. Nëpërmjet shkollave në Maqedoni, ata mund të përdornin në mënyrë strategjike numrin dhe vendndodhjen e tyre si dëshmi që përputhet me aspiratat e tyre territoriale. Deri në vitin 1876, në Maqedoni kishte 350 shkolla bullgare. Para Luftërave Ballkanike të viteve 1912-1913, shkollat bullgare arritën kulmin e tyre: 1141 shkolla me 1884 mësues dhe 65 474 nxënës. Por edhe grekët vazhdonin t'i ndiqnin, duke mos hequr dorë nga aspiratat e tyre. Deri në vitin 1894, në Maqedoni kishte rreth 907 shkolla greke me 1245 mësues dhe 53633 nxënës.

Gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë, një lëvizje relativisht e vogël arsimore serbe u zhvillua në rivalitet me bullgarët. Në vitin 1887, Ministria e Arsimit e Serbisë kishte hapur një departament të posaçëm për shkollat dhe kishat jashtë vendit. Duke punuar përmes konsujve serbë në Maqedoni, Departa-

menti i Propagandës në Ministrinë e Arsimit u përpoq të hapte shkolla serbe për djem dhe vajza në Maqedoni, kudo që ishte e mundur.

Bullgarët, grekët dhe serbët ishin konkurrentët kryesorë në garën e arsimit për Maqedoninë, por gara nxori palë të tjera, të cilat ose nuk funksionuan në shkallën e "trashës së madhe" ose u ballafaquan me pakicat specifike. Rumania kultivoi arsimin në gjuhën rumune për popullin vllah në jug dhe në perëndim të Maqedonisë. Edhe me njohjen e milletit (kombësisë) vllahe, në Turqi, më 1905, njohje e marrë si rezultat i lobimit politik rumun në Stamboll, u krijua vetëm një kishë rumune e vllëve (jashtë juridiksionit të Patriarkanës), por duke qenë se nuk kishte peshkopë vllëh, ajo nuk u shugurua kurrë. Qeveria rumune kurrë nuk mbajti seriozisht ndonjë ambicie territoriale në Maqedoni. Sipas historianit rumun, Arginteanu "në vitin 1899 në Maqedoni kishte gjithsej 34 shkolla rumune". Stavrianos pohon se "në vitin 1912 shkollat e vllëve numëronin më shumë se 30, me rreth 2000 nxënës vllëh". Në burimet e historianëve modernë si Douglas Dakin del se në vitin 1902, "vetëm në Maqedoni kishte rreth 1000 shkolla greke me rreth 70,000 nxënës dhe 781 shkolla bullgare me 39973 nxënës".

Ajo që e bëri lëvizjen nacionaliste arsimore komplekse, ishte fakti se identitetet dhe besnikëria e popullsisë ortodokse në Maqedoni ishin të papërcaktuara. Për shembull, maqedonasit vendas të besimit ortodoks mund të konsiderohen grekë nëse ndjekin një kishë greke, por bullgarë ose serbë nëse flasin një gjuhë sllave. Disa flisnin më shumë se një gjuhë dhe shpesh u treguan të gatshëm të manipulonin rrethanat në favor të tyre duke ndryshuar kisha ose shkolla nëse ofrohej një marrëveshje më e mirë. Kështu konkurrenca u intensifikua pasi palët rivale u përpoqën të konsolidonin dhe legjitimonin praninë e tyre, duke ndërtuar kisha dhe shkolla, të cilat gjithashtu shërbyen për të vërtetuar pretendimet e tyre ndaj Fuqive të Mëdha. Ndërsa është e diskutueshme se sa tërheqje masive patën realisht lëvizjet kombëtare konkurruese, përpjekjet e tyre pedagogjike konkurruese sollën gjenerata të reja të arsimuara.

Shqiptarët dhe rivalitetet arsimore ballkanike në Maqedoni

Në epokën e pas-Tanzimatit, vendet ballkanike u mblodhën rreth strukturave të një boshti etnik. Kjo ishte një aleancë midis trojeve dhe njerëzve të ndryshëm, bazuar në gjuhën, alfabetin, arsimin dhe ndërgjegjen e tyre kombëtare. Duke marrë parasysh strukturën e boshtit etnik të formuar në rajon, krahasuar me fqinjët e tyre, shqiptarët mbetën prapa në aspektin e gjuhës, alfabetit, arsimit dhe ndërgjegjes kombëtare, duke u vonuar në themelimin e shtetit të tyre kombëtar. Megjithatë duhet theksuar se sistemi i miletit ndikoi në nacionalizmin shqiptar në zhvillimin dhe mënyrën e veprimit të tij, duke e ndarë nacionalizmin shqiptar nga nacionalizmat e tjerë ballkanikë.

Në përpjekjet e para dhe të brishta për formimin e ndërgjegjes kombëtare, gjendja e shqiptarëve brenda sistemit të miletit vë në dukje raportin paradoksal midis fesë dhe nacionalizmit, sepse, në thelb, për shqiptarët “qëndrueshmëria e traditave të tyre ishte prioritet dhe ndarja fetare nuk u perceptua si problem”. Aktivizimi i nacionalizmit bullgar, pas atij të grekëve dhe serbëve, nxiti zhvillimin e lëvizjes kombëtare shqiptare, e cila nuk u mor parasysh nga projektet e Bullgarisë së Madhe, Greqisë së Madhe apo të Serbisë së Madhe.

Shqiptarët nga ana e tyre nuk ishin plotësisht të imunizuar ndaj zhvillimit formues etnonacional. Shumë shqiptarë, ndër ta dhe shqiptarë të Maqedonisë kishin ikur në emigracion, ku u përfshinë në komunitete, anëtarët e të cilave përfundimisht përvetësuan konceptet kombëtare perëndimore dhe zhvilluan një identitet etno-kombëtar shqiptar. Në Maqedoni përveç popullatës së besimit mysliman, apo siç i quanin të huajt muhamedanët, jetonin edhe një pjesë e popullatës shqiptare të besimit ortodoks, që përfshin një rajon bukur të madh që quhet Reka e Epërme që i takonte sanxhakut të Dibrës. Brenda 10-15 vjetësh, gjegjësisht prej vitit 1831-1845 do të ndërtohen 7 kisha në Rekën e Epërme ku, sipas dëshmimeve, në të gjitha kishat liturgjia deri në vitin 1840 zhvillohej në gjuhën shqipe.

Zhvillimet arsimore u ndikuan nga vendimet e Lidhjes së Prizrenit. Idetë dhe platforma arsimore e Lidhjes u bënë pjesë e përbërëse e shumë veprave, artikujve dhe fjalimeve të ideologëve të shquar të Rilindjes Kombëtare. Shqiptarët u përplasën me bullgarët, grekët dhe serbët, duke luftuar për të

hapur shkolla shqipe, edhe pse veprimtaria e tyre arsimore konsiderohej e paligjshme. Me lejen e sulltanit Ekzarkia bullgare hapi shumë shkolla edhe në vendbanimet shqiptare, pa marrë parasysh kombësinë e popullatës: në Shkup, Kumanovë, Velesh, Manastir, Dibër, Kërçovë, Gostivar, Rekë e Epërme ku popullata ishte kryesisht shqipfolëse. Po të njëjtën politikë asimiluese udhëhiqte edhe Serbia, e cila hapi 49 shkolla, së pari në Ohër, Velesh, Dibër, Gostivar, Tetovë, Kërçovë dhe më vonë në disa fshatra shqiptare si në: Premkë, Shutovë, Zajaz, duke dërguar mësues të cilët dinë të flasin mirë gjuhën shqipe.

Pas kushtetutës së vitit 1846, dhe si rrjedhojë e dekretit sulltanor, lejohej hapja e shkollave laike shtetërore, çka i hapte dyert fillimit të lëvizjeve për arsim e kulturë. Por, duke qenë se për pjesën myslimane lejohej vetëm përdorimi i alfabetit arab, intelektualët shqiptarë myslimanë të kohës u munduan që edhe përmes këtij alfabeti të përhapnin mësimin e gjuhës shqipe, si mjete i përparimit dhe i ngritjes kulturore”.

Sulltani mohonte kombësinë shqiptare dhe me këmbëngulje dhe në çdo mënyrë përpiqej të fuste përçarje fetare e krahinore te shqiptarët. Duke u mbështetur në ideologjinë fetare islame, ai nuk çante kokën për shkollat në gjuhën amtare shqipe, por vazhdonte që të hapte edhe më tej shkolla turko-arabe. Në fakt, Abdulhamidi ndoqi një politikë arsimore dhe kulturore që synonte dobësimin e ndjenjave të nacionalizmit, veçanërisht në mesin e elementëve myslimanë me origjinë të ndryshme etnike. Qëllimi kryesor i kësaj politike, e cila u përgatit në përputhje me politikën e islamizmit, ishte futja e vlerave islame dhe besnikëria ndaj Kalifit, i cili ishte faktori më i rëndësishëm që mund ta mbante gjallë Perandorinë. Po kështu, turqishtja, gjuha e administrimit dhe edukimit të shtetit, ishte e një rëndësie kritike për unitetin dhe integritetin e myslimanëve, të cilët konsideroheshin elementë thelbësorë të Perandorisë. U bënë përpjekje për nxitjen e turqishtes përmes shkollave shtetërore, të cilat u munduan të përhapeshin veçanërisht në mesin e amavutëve. Nga ana tjetër, u morën të gjitha llojet e masave për të penguar arsimin në gjuhën shqipe në shkolla. Në zhvillimin e këtij qëndrimi, ka luajtur rol fakti që ishte një nga çështjet për të cilën këmbëngulën më shumë ithtarët e pavarësisë, si dhe shqetësimi për humbjen e komunikimit mes qendrës dhe krahinave. Mendohej se brezat e rinj që u rritën me arsimin shqip do të shkëputeshin nga ideali osman me nacionalizmin shqiptar. Për më tepër,

presionet për ndalimin e botimeve në gjuhën shqipe kishin për qëllim parandalimin e përhapjes së ideve nacionaliste dhe separatiste kundër dominimit osman... Mësimi i gjuhës shqipe filloi të organizohej edhe fshehurazi. Njëri ndër të parët që ndërmori një hap të tillë, diku aty kah viti 1885 ishte Gjerasim Qiriazhi, që kishte hapur një shkollë private shqipe në Manastir për djem dhe vajza.

Forcimi i lidhjeve midis "identitetit ortodoks" dhe "identitetit grek", që po ndodhte në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, i vendosur nën autoritetin shpirtëror të Patriarkanës së Stambollit, do t'i shtynte disa veprimtarë të shqiptarizmit që të ndërtonin një "ortodoksi shqiptare", në të njëjtën mënyrë siç ishte krijuar "ortodoksia bullgare" me formimin e Ekzarkatit. Nuk bëhet fjalë për të denoncuar ndarjet fetare, as fetë si të tilla, por për të luftuar kundër përdorimit që i bënin fesë hierarkitë "jokombëtare". Krahas përpjekjeve të tyre për të konceptuar një komb shumëbesimësh, veprimtarët ortodoks, kundërshtarë të helenizmit, përpiqeshin të provonin se helenizmi ishte i papajtueshëm me shqiptarizmin.

Për zhvillimin e arsimit dhe të shkollës shqipe në Maqedoni, ndihmesë të madhe kanë dhënë klerikët shqiptarë të besimit katolik. Njëri që dha kontribut të madh, është Matej Krasniqi, i cili në fillim të shekullit XIX, hapi në Shkup ku mësimet fetare, ku së pari u shpjegonte nxënësve në gjuhën shqipe e pastaj në gjuhën latine. Arsytimi i këtij mësuesi të fesë ishte se nxënësit që e ndjekin shkollën, nuk e kuptojnë gjuhën latine dhe se së pari u duhet shpjeguar në gjuhën amtare e pastaj edhe në gjuhën latine. Në këtë shkollë në vitin 1835, për mësues vjen murgu uniat, Pavle Horvat. Ky murg nuk erdh nga Manastiri i Hilandarit, por nga Manastiri i Jovanit Mbigur. Me hapjen e kësaj shkolle, për herë të parë kemi ndarjen e shkollave kishtare greke dhe hapjen e një shkolle kishtare në gjuhët amtare, ku për nxënësit shqiptarë kishte përpjekje që në kishë të përdoret edhe gjuha shqipe.

Nevoja për masa të frytshme e konkrete në fushën e arsimit në gjuhën shqipe ishte bërë veçanërisht e theksuar në vitet '40, me shtimin e numrit të shkollave të huaja. Sipas artikullit të botuar në gazetën "Shkupi", në vitin 1911, shqiptarët ortodoksë të Rekës ia bënin me dije Patrikanës së Stambollit se në katundet e tyre nuk do ta lejonin mësimin e gjuhës së huaj dhe as nuk do t'i pranonin priftërinjtë që nuk e dinin gjuhën shqipe. Në Rekën e Epërme në shumë fshatra me ndërtimin e kishave e sidomos me vetë kontri-

butin e fshatarëve e sidomos të qehasë, Gjorgji Kokale, shqiptar nga Reka e Vogël u dha mundësia që në disa fshatra të kësaj zone të hapen pranë kishave edhe shkolla të tipit "qelie" aty rreth viteve 1835- 1840. Një shkollë e tipit "qelie" në vitin 1840 u hap në fshatin Duf. Mësuesi, që e nisi punën arsimore të këtij lloji ishte Kosta Llazareviqi. Pas një ndërprerjeje kjo shkollë përsëri do të fillojë të punojë, por tani mësuesin vendas nga fshati, Ilija Trifuni (viqi) i cili mësimin do ta zhvillojë në gjuhën amtare, gjegjësisht në gjuhën shqipe.

Më 1895, një shkollë shqipe u hap në Ohër nga Hamdi bej Ohëri. Pas një kohe të shkurtër këtë pishtar të arsimit shqip osmanët e burgosin në burgun e Manastirit. Po ky nuk ndenji rehat as në burg, pasi të burgosurve shqiptarë ua mësonte shkrim-leximin shqip. Pas daljes nga burgu, ai bashkë me të shoqen Zejnepe Qokun, më 1899 hapin në shtëpinë e tyre shkollën për djem dhe vajza në Ohër. Në vitin 1903, autoritetet osmane e burgosin përsëri dhe me akuzën se "merret me punë të ndyta", e dërgojnë për vuajtjen e dënimit në Diarbakir të Anadollit. Në vitin 1903, autoritetet osmane e burgosin përsëri dhe me akuzën se "merret me punë të ndyta", e dërgojnë për vuajtjen e dënimit në Diarbakir të Anadollit. Një shkollë shqipe hapi Said Najdeni (Hoxhë Voka), më vitin 1888 në Dibër, që llogaritet si shkolla e parë laike në gjuhën shqipe. Kur e diktojnë organet e pushtetit, atë e mbyllin, por rihapet më 1893, si dhe më 1900. Kjo shkollë punonte me abetare të shkruara në gegërisht nga vetë mësuesi. Një numër i madh i rekasve që punonin në Rumanë, kishin bindur priftin Olimbia Savo, që në kishën e Vërbenit më 1899, të hapë një shkollë ku do të mësoheshin shkronjat shqipe.

Përhapja e shkollës shqipe në territorin e Maqedonisë mori hov të madh pas Kongresit të gjuhës shqipe në Manastir më 1908, ku dita ditës interesi për shkollimin shqip po shtohej. Kështu, disa klube filluan të hapin shkolla në gjuhën amtare, si në: Dibër, Rekë, Shkup, Manastir, Kërçovë, Tetovë, Gostivar, Kumanovë e gjetiu. Vlen të përmendim se veprimtarë për shkolla shqipe, të shquar në këto qytete ishin: në Kërçovë: Jusuf Turabi - Kërçova, Rexhep Fasku - Greshnica, Ali Drogomishti; në Strugë shquhen Dervish Hima e Ibrahim Temo; në Dibër: Kadri Fishta e Said Najdeni; në Gostivar: hoxha Afiz Lila; në Patishka Rekë: hoxha i fshatit; në Shkup: Rrok Berisha, Bedri Pejani; në Rekë: prifti Todor e Josif Bageri; në Kumanovë: Jashar Erbara e Anastas Albanski e shumë të tjerë.

Në politikën e ndarjes, me dallimet që ndiqte Porta, bashkëvepronte dhe Patrikana e Stambollit. Ajo i kundërvijehj gjuhës dhe arsimit shqip për ortodoksët, sepse kjo donte të thoshte humbje e ndikimit të saj, që do të shkonte ndoshta deri në krijimin e një kishe shqiptare të pavarur. Patrikana punonte me këmbëngulje për hapjen e shkollave greke, deri në fshatrat më të largëta, duke ia kaluar edhe shtetit. Një nga lëshimet e Portës së Lartë, me natyrë kulturore, ishte dhënia e lejes për botimin e një organit periodik. Këtë leje nuk ua dha shqiptarëve myslimanë, të cilët i konsideronte turq, por shqiptarëve ortodoksë, me qëllim që te këta të fundit të mos ndikonte propaganda greke. Leja u lëshua në emrin e Petro Pogës Erindasi, njërit prej anëtarëve të kryesisë së Shoqërisë së shqiptarëve të Stambollit.

Në trevat shqiptare të Maqedonisë dhe në qendrat kryesore: Manastir, Shkup, Ohër, Dibër, Tetovë etj. u zhvilluan disa nga veprimtaritë më të rëndësishme në favor të përhapjes së arsimit shqip. Rilindasit shqiptarë preferuan ta zhvillojnë betejën për arsimin në zonat kufitare me popujt e tjerë për të pohuar edhe vendosmërinë e tyre për t'i mbrojtur ato territore. Në nëntor të vitit 1905 u themelua Komiteti sekret "Për lirinë e Shqipërisë" në qytetin e Manastirit, që shënoi fillimin e një organizimi më të gjerë kombëtar, i cili u ndikua nga veprimtaritë e komiteteve të tilla që krijun grekët dhe bullgarët në të njëjtin territor. Edhe pse zakonisht injorohet nga pretendentët kryesorë, ata përfundimisht u bashkuan me anarkinë endemike të Maqedonisë, duke kundërshtuar militantisht si autoritetet lokale osmane, ashtu edhe bandat e armatosura të protagonistëve nacionalistë. Në një raport të vitit 1909 për të krishterët shqiptarë, u sugjerua që t'u hapej rruga që të kryenin ritualet në gjuhën e tyre, në përputhje me lirinë e sekteve të parashikuara nga Kanun-i Esasi. Kështu, të krishterët shqiptarë mund të shpëtonin nga indoktrinimi grek. Kjo do të krijonte një "disfatë të përjetshme" në ambiciet e Greqisë për Shqipërinë e Jugut.

Përhapja e shkollës shqipe në territorin e Maqedonisë hov të madh mori pas Kongresit të gjuhës shqipe në Manastir më 1908 ku dita ditës interesi shtohet. Kështu, disa klube filluan të hapin shkolla në gjuhën amtare. Shkolla në gjuhën shqipe u hapën në: Dibër, Rekë, Shkup, Manastir, Kërçovë, Tetovë, Gostivar, Kumanovë e gjetiu. Qytet shqiptare në Maqedoni: Manastiri, Ohri, Dibra, Kërçova u bënë qendra të rëndësishme e shpërndarjes së librave dhe gazetave shqipe që vinin nga shoqëritë atdhetare shqiptare në

Rumani dhe Bullgari. Vlen të përmendim se veprimtarë të shquar për shkollat shqipe ishin: në Kërçovë: Jusuf Turabi - Kërçova, Rexhep Fasku – Greshnica, Ali Drogomishti; në Strugë shquhen Dervish Hima e Ibrahim Temo; në Dibër: Kadri Fishta e Said Najdeni; në Gostivar: hoxha Afiz Lila; në Patishka Rekë: hoxha i fshatit; në Shkup: Rok Berisha, Bedri Pejani; në Rekë: prifti Todor e Josif Bageri; në Kumanovë: Jashar Erbara e Anastas Albanski e shumë të tjerë.

Sukseset e arritura nga zhvillimi legal i arsimit kombëtar në Shqipëri i shqetësoi së tepërmi turqit e rinj, të cilët përdorën kundër arsimit shqip çdo mjet, që nga shfrytëzimi i ndjenjave fetare dhe intrigat e deri te dhuna e drejtpërdrejtë, që u ushtrua në të gjitha qendrat e arsimit shqip. Në maj 1909 u arrestuan 17 veta nga Struga, Pogradeci dhe Ohri, të akuzuar si agjentë të Sulltan Hamitit. Midis të arrestuarve nga Ohri ishin: Hamdi Bej Ohri, Xheladin Beu, kryetar i klubit dhe Mehmet Beu. Në vitin 1910 masat xhonturke u ashpërsuan; në Shkup u arrestua kryetari i klubit të atjeshëm Beqir Efendiu dhe mësuesi i gjuhës shqipe, Bedri Pejani; në Manastir u arrestuan Fehim Zavalani dhe vëllezërit Kristo e Dhimitër Qirjazi etj.

Vetëm pas kryengritjes së madhe shqiptare të vitit 1912, u arrit marrëveshja midis shqiptarëve dhe qeverisë xhonturke, ku u lejua shkollimi shqip. Me këtë rast u rihapën për pak kohë shkollat shqipe në Maqedoni, të cilat u mbyllën sapo shpërthyen Luftërat Ballkanike.

Përfundime

Duke qenë se shoqëria vazhdonte të ishte e ndarë në bazë të sistemit të mileteve, lëvizjet konkurruese nacionaliste u zhvilluan brenda secilit millet, që për Maqedoninë i takon brenda milletit mysliman midis shqiptarëve dhe shtetit osman, si dhe në brendësi të sistemit ortodoks të mileteve nga grekë, bullgarë, serbë, por edhe shqiptarë e vllleh. Ndarja e milletit ortodoks në milete më të vogla bëri që lëvizja konkurruese nacionaliste për shkollën të zhvillohej mbi të krishterët e Maqedonisë, që kishin vetëdije të ulët kombëtare dhe e konsideronin ende fenë si burimin e parë të vetidentifikimit. Në shikim të parë me karakter fetar dhe arsimor, këto lëvizje synonin qëllime të qarta politike, për të zotëruar sa më shumë territore, popullsia e të cilit do të deklarohet në favor të njërit apo tjetrit millet ortodoks.

Në këtë skenë përplasjesh u përfshi dhe lëvizja nacionaliste shqiptare. Vendimi që Manastiri të bëhej qendra kombëtare e lëvizjes për arsimin shqip duhet parë në kuadrin e përplasjes së nacionalizmit shqiptar me nacionalizmat e tjerë dhe të përpjekjeve për afirmimin e pretendimeve të shqiptarëve mbi trojet e tyre etnike në Maqedoni. Edhe mësuesit shqiptarë po punonin për rritjen e vetëdijes kombëtare të bashkëkombasit e atyre anëve, të cilët ishin të rrezikuar trefish: nga bullgarët, serbët dhe grekët. Lëvizjet nacionaliste dhe përplasia midis nacionalizmave ballkanikë në fushën e arsimin ishte e ashpër në Maqedoni dhe u parapriu formave të tjera të përplasjeve që kulmuan me luftërat ballkanike të vitit 1913.

Conclusions

Since the society continued to be divided based on the system of millets, competing nationalist movements developed within each millet, which for Macedonia belongs within the Muslim millet between the Albanians and the Ottoman state, as well as within the orthodox system of milesets from Greeks, Bulgarians, Serbs, but also Albanians and Vlachs. The division of the orthodox millet into smaller millets caused the competing nationalist movement for the school to develop on Macedonian Christians, who had low national consciousness and still considered religion as the first source of self-identification. At first glance, with a religious and educational character, these movements aimed at clear political goals, to possess as much territory as possible, the population of which would be declared in favor of one or the other orthodox millet. In this clash scene was involved and the Albanian nationalist movement.

The decision to make the Monastery the national center of the movement for Albanian education should be seen in the context of the clash of Albanian nationalism with other nationalisms and efforts to assert the claims of Albanians on their ethnic lands in Macedonia. Albanian teachers were working to increase the national consciousness of the compatriots of those countries, who were threatened three times: by the Bulgarians, the Serbs and the Greeks. The nationalist movements and clash between Balkan nationalisms in the field of education was fierce in Macedonia and preceded other forms of conflict that culminated in the Balkan Wars of 1913.

Literatura:

- Amfiteatrov, Aleksandr. Strana razdora, St. Petersburg: I.V. Rayskoy, 1903.
- Anastasovski, Nick. Contestation over Macedonian Identity, 1870–1912, thesis, Victoria University, 2005.
- Arpalier Seçkin, Hamzaj Ireida. “Analysing from a systematic perspective the Albanian nationalism in the Ottoman Empire”, Acta Humana, 2020.
- Dakin, Douglas. “The Greek Struggle in Macedonia, 1897-1913”, Thessaloniki: Museum of the Macedonian Struggle, 1993, 2015.
- Doja, Albert. “Ecclesiastical Pressures and Language Politics: The Boundary Work of Albanian Language in the 17th-18th Centuries, Ecclesiastical Pressures and Language Politics”: Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity, 2022, 50 (4).
- Clayer, Nathalie. Në origjinë të nacionalizmit shqiptar, lindja e një kombi me shumicë myslimane në Europë, botimi shqip “Përpejka”, Tiranë 2012.
- Dolani Viola, Mero Belinda. “Hulumtim mbi kontributin e atdhetarëve të Rilindjes në shkollën shqipe”, Konferencë Shkencore Mbarëshqiptare: 130 vjet Mësonjëtorja e Parë Shqipe - vatër e arsimimit, emancipimit dhe ngritjes së vetëdijes kombëtare (përmbledhje dokumentesh), Korçë 6 mars 2017.
- Fotić, Aleksandar. "Serbian Orthodox Church". Encyclopedia of the Ottoman Empire. New York: Infobase Publishing, 2008.
- Gençoğlu, Mustafa. Osmanlı Devleti'nin Şkodra Vilayeti'ndeki Eğitim Politikası (1876 - 1908).
- Historia e Arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar, vëllimi I, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë 2003.
- Hoti Dani, Esmeralda. Le istituzioni educative in Albania dal 1878 al 1913, (dissertazione), Università degli Studi di Macerata, 2014
- Hupchick, Dennis P. The Balkans from Constantinople to Communism, Palgrave Macmillan 2002.
- Jelavich, Barbara. “History of the Balkans, 18th and 19th Centuries”, Cambridge 1983, vol. 1.

- Kitromilides, Paschalis M. "Imagined Communities' and the Origins of the National Question in the Balkans", *European History Quarterly* 1989, 19.
- Marinov, Tchavdar. "Famous Macedonia, the Land of Alexander: Macedonian Identity at the Crossroads of Greek, Bulgarian and Serbian Nationalism", *Entangled Histories of the Balkans, Volume One: National Ideologies and Language Policies* Edited by Roumen Daskalov and Tchavdar Marinov, Brill, 2013.
- Milena B. Methodieva, *Between Empire and Nation Muslim Reform in the Balkans*, Stanford University Press, Stanford, California 2021.
- Mustafa, Avzi. "Përpyjekjet e shqiptarëve në Maqedoni për arsim kombëtar në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX", <https://merbraha.com/perpjekjet-e-shqiptareve-ne-maqedoni-per-arsim-kombetar-ne-fund-te-shekullit-xix-dhe-ne-fillim-te-shekullit-xx/>
- Myzyri, Hysni. *Arsimi kombëtar shqiptar (1908-1912)*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, 1996.
- Özcan, Tuğrul "Abdulhamid Doneminde Gayrimuslim okullarının idari isleyisine dair birdegerlendirme", *Uluslararası multidisipliner çalışmaları sempozyumu*, (18-21 Mayıs 2017, Roma, İtalya).
- Ozturk, Fatih. "The Ottoman Millet System", 7, <https://dergipark.org.tr/en/download/article-file/12937>
- Puto, Artan. (Dissertation) *The idea of Nation during the Albanian National Movement, (1878-1912)*, European University Institute, Florence 2012.
- Roudometof, Victor. *Collective Memory, National Identity, and Ethnic Conflict, Greece, Bulgaria, and the Macedonian Question*, Praeger Publishers 2002.
- Stavrianos, Leften Stavros. "Antecedents to the Balkan Revolutions of the Nineteenth Century", *Journal of Modern History*, Vol. 29, No. 4 (Dec., 1957).
- Yücedağ, İsmail, Koç Nurgün. "Kërkesat e shqiptarëve për shkollimin në gjuhën amtare", *Dituria islame* 354, maj 2020.

Butrint BALAJ

PEIZAZHE GJUHËSORE NË PRIZREN

Hyrja

Gjuha kryen funksione të ndryshme në shoqëri. Komunikimi përmes gjuhës përfshin edhe shenjat e ndryshme gjuhësore (etiketa), nëpër hapësira të ndryshme, urbane dhe rurale. Ky lloj komunikimi është pjesë e asaj që quhet *peizazh gjuhësor*. Seba e kundron studimin e peizazhit gjuhësor si një ndërlidhje të disiplinave (linguistike dhe jashtëlinguistike), pra të: sociolinguistikës, sociologjisë, psikologjisë sociale, gjeografisë e medieve (2010, ff. 73-76). Më tutje, përkufizimi më i pranuar i konceptit *peizazh gjuhësor*, është ky: “Gjuha e shenjave publike të rrugëve, tabelat e mëdha reklamuese, emrat e rrugëve, emrat e vendeve, shenjat e dyqaneve tregtare dhe shenjat publike në objektet qeveritare, kombinohen për të formësuar trajtën e peizazhit gjuhësor të një territori, të një regjioni a të një zone urbane të caktuar” (Landry dhe Bourhis, 1997, f. 25).

Hapësirat ku shtrihen peizazhet gjuhësore, mund jenë prona publike, por edhe private, të cilat Ben-Rafel et al. (2006, ff. 7-30) i ndan në *top-down* (në shq. *lart-poshtë*, shenjat e autoritetit qeveritar) dhe *bottom-up* (shq. *poshtë-lart*, pra shenjat komerciale). Vendimmarrës për etiketat publike është autoriteti shtetëror, ndërkaq te njësitë e peizazhit të hapësirave private, autoritetin shtetëror mund ta quajmë si një *regjistër të vullnetit komercial*. Kësisoj, Demaj thotë, se autoriteti shtetëror dikton përdorimin e gjuhës në hapësirën publike dhe në hapësirën private (2016, f. 2). Dallimin e etiketave publike dhe private i ka bërë Backhaus (2006, siç citohet te Munishi, 2015, f. 130), ndërkaq Calvet (2006, siç citohet te Munishi, 2015, f. 130), këto lloj shenjash të peizazhit gjuhësor i ka quajtur *in vitro* (shenjat nga gjuha zyrtare) dhe *in vivo* (gjuhët që i përdorin njerëzit, për të shënuar në hapësirat pri-

vate). Njësitë që evidentohen si peizazhe gjuhësore, paraqesin edhe një kontekst tjetër, atë sociolinguistik, të gjallë dhe të larmishëm, siç e kanë përshkruar edhe Cenoz dhe Gurter (2006, siç citohet te Munishi, 2015).

Në lidhje me peizazhet gjuhësore në Kosovë dhe në hapësirat e tjera shqipfolëse kemi disa studime: Demaj e Vandenbroucke (2016) të cilët kanë bërë studime *mbi peizazhet gjuhësore të pasluftës së vitit 1999 në Kosovë dhe natyrën e ndërlikuar të tyre, të formësuar pas shpalljes së Pavarësisë*. Po kështu, Demaj (2022a) vëren rolin e gjuhës në ndërtimin e identitetit kombëtar dhe të krijimit të hapësirave etnocentrike, identitetin simbolik të tyre etj., duke përdorur dëshmitë historike gjuhësore, përmes ndryshimeve të vrojuara të objekteve historike, në qendër të Prishtinës. Një studim tjetër është bërë nga Munishi (2015), në lidhje me *shqipen dhe anglishten në peizazhin linguistik të Prishtinës, raportet e gjuhëve nëpër hapësira publike dhe private, si dhe politikat gjuhësore*. Po ashtu, për peizazhin linguistik të Tiranës, ka folur Skënderi-Rakipllari (2023). Në vazhden e punimeve të tilla, vjen edhe ky që ju e keni në dorë sot. Prizreni, si qytet ku gërshetohen kulturat e ku ka veçori të dygjuhësisë, njësitë e peizazhit gjuhësorë dalin të larmishme. Perceptimi i kësaj larmishmie vërehet kudo, në hapësirat publike dhe private. Gjithsej kemi evidentuar 373 etiketa të peizazhit gjuhësor. Në kuadër të këtij konteksti sociolinguistik, hulumtimi ynë është ndarë në dy kategori themelore: *në etiketat e njësisive të hapësirave publike dhe në etiketat e hapësirës private*.

Etiketat janë një element komunikimi që shfaqen midis vetë etiketës e audiencës (publikut). Njësitë private kanë etiketa të përzgjedhura për llojin e veprimtarisë; ato mund të jenë të ndryshme, të bëhen kastile, për të tërhequr vëmendjen dhe njerëzit, si klientë potencialë. Në bazë të modelit të Allan Bell-it (i përshtatur tek analiza jonë), e kemi paraqitur dizajnimin e audiencës, për disa etiketa biznesesh. Në bazë të asaj që e ka kornizuar Bell (1984, 2001), dizajnimi i audiencës, është modeli i cili e ndjek një folës, për ta përshtatur fjalimin për audiencën, të cilën e ka përpara; shikuar nga perspektiva e etiketave, një etiketë biznesi mund të synojë të ketë “komunikim” të tillë me audiencën, për të cilën është i interesuar.

Qëllimi i punimit

Qëllimi i këtij punimi është të pasqyrojë peizazhin gjuhësor të qytetit të Prizrenit. Synohet të shikohet përdorimi i gjuhës në kuadër të panoramës gjuhësore të Prizrenit; punimi përpiqet t’u përgjigjet pyetjeve të ndryshme, p.sh. si është gjendja e peizazheve gjuhësore në qytet dhe lagje të caktuara, si përdoret gjuha në kuadër të etiketave në prona publike dhe si ato në prona private, a ka një trend të ri të përdorimit të gjuhës në këto hapësira në raport me të kaluarën, sa përdoren kontekstet sociolinguistike për të prodhuar etiketa gjuhësore, të cilat janë kreative dhe unike, sidomos te bizneset private. Etiketat e hapësirës private a janë krijuar me synim të caktuar ose jo. Punimi nxjerr në pah etiketa e hapësirës private, sipas dizajnit të audiencës, pra, nëse kemi të bëjmë me etiketa të drejtuar, kastile për një komunitet a klientelë të caktuar. Të gjitha këto pritje, mund t’i shtrojmë përmes disa hipotezave.

- A përdoren në të gjitha rastet njëherësh *gjuhët zyrtare* në etiketat e njësisve të peizazhit gjuhësor në kategorinë e “publikes” dhe “të private”?
- A është përdorimi i anglishtes më i dendur në krahasim me shqipen, tek etiketat në hapësirat private?
- A mungon përdorimi i gjuhës serbe në etiketat e bizneseve private?
- A mungojnë etiketa sipas modelit të dizajnit të audiencës, në hapësirat private?

Metodat e përdorura për këtë punim janë hulumtimi, përshkrimi dhe intervistimi. Meqë më përpara janë marrë me këtë temë, pjesërisht jemi mbështetur te Munishi (2015), te Demaj dhe Vandembroucke (2016), si dhe Demaj (2022a, 2022b). Hulumtimi ynë ka përshkuar itinerarin e rrugëve që të çojnë në qendër, por ka ndaluar edhe në lagje të caktuara. Përgjatë këtij itinerari, kemi shënuar etiketat, gati në të gjithë hapësirat, ku kemi njësi publike e private. Një njësi mund të ketë dy e më tepër etiketa (p.sh. një biznes mund të ketë dy a më shumë tabela me mbishkrim të ndryshëm). Me marrëveshje e kemi lënë që: *etiketa = emri + përcaktori*, p.sh. në hapësirën private *Gatsby (emri) - Eat & Drinks (përcaktori)*, kështu edhe etiketa te hapësira publike: *rr./ul./sk. = përcaktori dhe emri = Remzi Ademaj*. Nëse në tërësinë e etiketës marrin pjesë dy a më shumë gjuhë, kjo etiketë llogaritet

në gjuhët zyrtare (shqip, serbisht, turqisht, boshnjakisht e anglisht), nëse aty marrin pjesë shqipja dhe anglishtja, atëherë etiketa llogaritet shqip-anglisht, kur kemi pesë e më shumë gjuhë, pas gjuhës së pestë vihet shenja +. Sa i përket evidentimit, janë marrë të gjitha ato njësi të peizazhit, të cilat kanë pasur mbishkrime në xhama ose pllaka të ndryshme; i kemi lënë objektet fetare, në të cilat nuk ka pasur mbishkrime, por edhe kur ka pasur të tilla, kemi qenë të kufizuar, sepse kërkohej leje e posaçme për t'i vizituar. Në mungesë të lejes, i kemi shfrytëzuar broshurat, librat historikë, guidat turistike dhe format e tjera ligjore indirekte. Të gjitha shënimet i kemi vënë në një tabelë, si bazë të dhënash, nga ku kemi operuar për t'i nxjerrë rezultatet, si dhe në një dosje ku i kemi ruajtur fotografitë. Baza e shënimeve është bërë me softuerin *MS Excel*, i cili përmban 8 kolona dhe 374 rreshta. Meqë teknologjia ka lehtësuar punë, kemi shfrytëzuar edhe shërbimet e aplikacionit *Google Maps*, si dhe shërbimet e faqes *gjirafa.biz*, për t'u orientuar dhe për të marrë informacione shtesë. Në kreun e dizajnit të audiencës (për etiketat) janë evidentuar njësi përkatëse, pastaj kemi intervistuar persona, i kemi dhënë bisedat në formë të interpretimi, si edhe kemi tentuar t'i ikim “paradoksit të intervistueses”.

1. Peizazhet gjuhësore në hapësirat publike

Në aspektin sociolinguistik, sidomos të perspektivës së peizazhit gjuhësor, hapësirat publike paraqesin një lloj uniformiteti etiketash. Autoriteti, në këtë rast, i vë etiketat sipas kornizave ligjore, rregullave dhe vendimeve, që dalin nga një hierarki institucionale e cila dikton, p.sh. etiketat e rrugëve, të shesheve, të shkollave dhe të institucioneve të tjera, vihen sipas një rregulli të caktuar ose vendimi të caktuar të institucioneve shtetërore.

Qyteti i Prizrenit tashmë ka pesë gjuhë zyrtare, të cilat nuk përdoren njësoj në hapësirat publike; varësisht nga prania e njërit komunitet dhe përkatësia e tyre, përdoret edhe gjuha. Në hapësirat publike hyjnë: rrugët, sheshet, dikasteret komunale, objekte të institucioneve shëndetësore (qendra mjekësore, ordianca, spitali etj.), objekte të tjera arsimore, kulturore e sportive; organizatat dhe institucionet të huaja; hapësira publike ku shkruhen murale, si dhe objektet fetare etj. Të gjitha njësitë mund t'i ndajmë në dy grupe të mëdha: në institucionet të administratës shtetërore dhe në institucione fe-

tare. Këto dy grupe përfshijnë edhe nëngrupet e tjera, p.sh. tek institucionet e administratës shtetërore: shërbimet komunale, institucionet arsimore, kulturore e sportive; shëndetësia, pastaj rrugët, sheshet dhe hapësira të tjera. Në korpusin tonë kemi vërejtur 75 etiketa të njësive publike. Gjendja e etiketave për këto njësi është dhënë në tabela, që ndahen në një, dy, tri dhe më shumë gjuhë. Ashtu edhe siç pritej, gjuhët zyrtare kanë një dominim të pjesa e hapësirave publike.



Më poshtë e kemi dhënë tabelën e përgjithshme të gjendjes së etiketave në hapësirën publike:

Tabela nr. 1: Gjithëpërfshirëse në hapësirat publike				
<i>Në një gjuhë</i>				
Gjuhët	Shqip	Anglisht	Turqisht	Serbisht
Nr. i etiketave	15	4	2	1
Përqindja (%)	20%	5,33 %	2,66 %	1,33 %
<i>Në dy gjuhë</i>				
Gjuhët	Shq.-Ang.	Shq.-Tr.	Shq.-Srb.	Shq.-Lat.
Nr. i etiketave	10	2	2	1
Përqindja (%)	13,33 %	2,66 %	2,66 %	1,33 %
<i>Në tri e më shumë gjuhë</i>				
Gjuhët	Zyrtare	Shq.-Srb.-Ang	Shq.-Tr.-Boshnj.	Shq.-Tr.-Boshnj. (+)
Nr. i etiketave	30	3	2	3
Përqindja (%)	40 %	4 %	2,66 %	4 %

1.1. Disa veçori të përdorimit të gjuhës në hapësirat publike

Autoriteti shtetëror është përgjegjës i përdorimit të gjuhës në hapësira publike. Edhe pse në hapësirat publike ka një lloj uniformiteti të etiketave që përdoren, prapë mund të gjenden fakte, se nuk ka konsistencë përdorimi i gjuhës. Në Prizren mund të hasim, që nga autoriteti shtetëror nuk përdoren në mënyrë uniforme të gjitha gjuhët zyrtare, p.sh. në etiketën e të dy drejtorive, të *Drejtorisë për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik* dhe të *Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa* gjuhët zyrtare nuk përdoren në mënyrë të njëjtë, po kështu e kemi rastin edhe te *Kuvendi komunal*, ku në etiketa përdoren herë 4 gjuhë, e herë 3 gjuhë zyrtare.



Në hapësirat publike kemi dallime edhe te shkrimi i etiketave në tabelat e rrugëve, shesheve, vendbanimeve, shkollave, objekteve fetare etj. Dallimi i përdorimit të gjuhës a gjuhëve është i shumanshëm. Në disa raste, gjuha në hapësirat publike përdoret sipas pjesëmarrjes së komunitetit (p.sh. tek objektet fetare dhe te shkollat), kurse në raste të tjera vërehet qëndrimi mohues (forma e mospranimit) ndaj një gjuhe në një etiketë (etiketat fshihen me qëllim, duke e refuzuar gjuhën në të cilën është shkruar, p.sh. emrat e rrugëve, emrat e vendbanimeve etj.). Arsyet e këtyre dallimeve mund të jenë të ndryshme, por ne i kemi grumbulluar në arsye, si pragmatiste, rationale, historike dhe ideologjike. Se si përdoret gjuha në këto etiketa, mund ta shohim përmes kolazhit të fotografive të përgatitura. Kështu duken disa tabela rrugësh:




Kemi gjetur etiketa, siç janë rrugët “Vesli Klark” (Wesley Clark), “Villiam Voker” (William Walker), “Aleksandër Flemingu” (Alexander Fle-

ming), si dhe emra të tjerë personalitetesh të huaja, që janë përshtatur sipas standardit të shqipes, për shkrimin e emrave të huaj. Kjo gjë nuk ka ndodhur në rrugë të tjera, si “Turgut Özal”, “Çanakkale”, “Faik Şamli” dhe ndonjë tjetër, të cilat janë shkruar me grafema turke. Te pjesë të caktuar e gjejmë edhe qëndrimin mohues të komuniteteve ose banorëve në lidhje me një emër të caktuar në etiketë, p.sh. në tabelën e fshatit *Prianë*, e shohim të fshirë emrin në gjuhën serbe, tabela tjetër e fshatit *Malësi e Re* është e shkruar dy herë në gjuhën shqipe, duke refuzuar shkrimin në një gjuhë tjetër, pastaj i është fshirë emri tabelës në lagjen Kurila (rr. “Ilir Hoxha”). Arsyet pse mund të kenë ndodhur këto janë të karakterit historik, politik, ideologjike etj., gjithsesi raste të tilla mund të ketë e mund të gjenden rëndom në Republikën e Kosovës.



Në lidhje me gjuhën e përdorur sipas komunitetit pjesëmarrës, nënkuptojmë gjuhët të cilat përdoren për të shënuar etiketa për komunitete të caktuara, siç ndodh tek institucionet fetare. P.sh. në xhamia mund të vërejmë mbishkrim në gjuhën shqipe, turke e boshnjake, po më pak në gjuhën angleze dhe fare në gjuhën serbe. Po kështu, te rasti i kishave ortodokse, gjenden të shkruara etiketa në gjuhën serbe, por jo në gjuhën shqipe etj. Në raste të caktuara, siç është p.sh. *Shoqata e të burgosurve politikë* është e shkruar në dy gjuhë, në shqip dhe anglisht, por s’do të ishte racionale të shkruhej edhe në gjuhën serbe. Le t’i ilustrojmë përmes fotografive:



2. Peizazhet gjuhësore në hapësirat private

Peizazhet gjuhësore në hapësirën private përfshijnë numër më të madh se në atë publike. Llojet e veprimtarive të biznesit i kemi ndarë në *mallra e shërbime*. Brenda këtyre dy grupeve i kemi vendosur kategori (me nënkategori) për fushat gjegjëse. Këto janë kategoritë: *arsimi kultura e sporti; shëndetësia; financa; hoteleria, gastronomia e turizmi; marketet e dyqanet; posta e teknologjia dhe moda*. Gjithsej janë evidentuar 298 njësi të peizazhit gjuhësor, të cilat i kemi kategorizuar sipas fushave përkatëse. Le ta shohim tabelën përmbledhëse me të dhëna, për secilën gjuhë:


Tabela nr. 2: Gjithëpërfshirëse në hapësirat private			
<i>Në një gjuhë</i>			
Gjuhët	Shqip	Anglisht	Turqisht
Nr. i etiketave	108	78	1
Përqindja (%)	36,24 %	26,17 %	0,33 %
<i>Në një gjuhë</i>			
Gjuhët	Gjermanisht	Italisht	Frëngjisht
Nr. i etiketave	1	6	2
Përqindja (%)	0,33 %	2,01 %	0,67 %
<i>Në dy gjuhë</i>			
Gjuhët	Shq.-Ang.	Shq.-Gjer.	Shq.-Tr.
Nr. i etiketave	85	5	3
Përqindja (%)	28,52 %	1,67 %	1,00 %
<i>Në dy gjuhë</i>			
Gjuhët	Ang.-Fr.	Ang.-Gjer.	Ang.-Tr.
Nr. i etiketave	1	1	2
Përqindja (%)	0,33 %	0,33 %	0,67 %
<i>Në tri dhe katër gjuhë</i>			
Gjuhët	Shq.-Ang.-Tr.	Shq.-Ang.- Boshnj.	Shq.-Ang.-Tr.- Gjer.
Nr. i etiketave	2	2	1
Përqindja (%)	0,67 %	0,67 %	0,33 %

Në një gjuhë të vetme prin shqipja nëpër etiketat private, sipas mostrave të marra. Në dy gjuhë është shqip-anglishtja që ka një përhapje më të madhe, kurse në dy dhe tri gjuhë kemi një lloj barazie (shq.-ang.-tr. = shq.-ang.-boshnj.), pra etiketat janë në numër shumë të vogël.

2.1. Disa veçori të përdorimit të gjuhës në hapësirat private


Etiketat në hapësirën private kanë gjuhë më kreative, sesa etiketat në hapësirën publike. Zhdërvjelltësia e përdorimit të emrave kreativë dhe stilizimi i tyre është liria e përdorimit të vetë gjuhës. Gjuha, duke mos u kornizuar, sjell larmishmi të përdorimit, dhe kjo vërehet te disa njësi të hapësirës private.

Në tërësinë e etiketave të gjetura, vërejmë një denduri të përdorimit të anglishtes, sidomos në kategorinë e kurseve të ndryshme, shkollave, palestrave sportive, klubeve sportive private, pastaj në modë dhe teknologji etj. Gjithsesi, kjo përhapje shoqërohet po me “ndërmjetësimin” e shqipes dhe kemi simbiozën shqip-anglisht, që ka një trend të ri përdorimi dhe përhapjeje. Kështu, kurset e baletit dhe të vallëzimit, palestrat sportive (fitneset) duken që në fillim se janë të ndikuara nga anglishtja, e këtu s’përjashtohet as kategoria e shëndetësisë (ordinanca, barnatore etj.). Një pjesë të pasqyrë së evidentuar, mund ta shohim përmes këtij kolazhi:



Meqë kategoria e *hotelerisë, gastronomisë e turizmit* ka një numër më të madh të etiketave të evidentuar, mund t'i veçojmë disa karakteristika. Gjuhësisht, përcaktori *hotel/ hostel/ motel* vendoset herë para e herë prapa, varësisht nga emri ose titulli i etiketës. P.sh., *hotel Antika, hotel Theranda, hotel Classic, hostel M99*, e kanë të vendosur përcaktorin përpara, kurse *Triumf hotel, Monarc Boutique Hotel, Rio hotel, Mint hotel* etj., e kanë të vendosur prapa përcaktorin. Në gastronomi, etiketat e restoranteve dalin herë *restaurant*, po më pak në trajtën *restaurant*. Në këtë kuadër kemi evidentuar edhe një mori etiketash për lokalet e kafeneve dhe ëmbëltoreve; këto i shkruajnë në gjuhë të huaja përcaktorët, p.sh. *caffè, coffe, café, sweet, house of cake, dries fruits* etj. Nënkategori tjetër janë *agjencitë e udhëtimit*, ku vërehet dendur përdorimi i trajtave kryesisht në gjuhë të huaj, si *travel, gудie, visa, work and travel, tours* e ndonjë tjetër. Disa biznese, për shkak edhe të traditës, i kanë ruajtur emrat-titujt dhe pranë kanë vënë vitin e fillimit të veprimtarisë, duke i shtuar parafjalën *since* (vërehet një trend në rritje i përdorimit të kësaj parafjale; për të treguar prestigj në një fushë të caktuar të biznesit).

Përdorim të dendur ka emri *furrë*, zakonisht në trajtën e shquar (*furra*), ndërkaq sa i përket emrit *picë*, haset në të shkruar në origjinal *pizza* dhe *pizzeria* (kur bëhet fjalë për vendin ku bëhen picat). Edhe dyqanet e modës kanë etiketa të ndryshme, rasti si në fotografi, tregon se emri është në gjuhën frënge dhe tjetra në gjuhën angleze, pra titulli *Le Notre* (frëngjisht), *Suits & Boutique, since* dhe *hand crafted* (anglisht).



3. Dizenjimi i audiencës dhe peizazhi gjuhësor

Termi “dizenjimi i audiencës”, ka të bëjë me komunikimin e folësit me audiencën e tij. Ky dizajn është model sociolinguistik, i cili tregon se folësit e bëjnë përshtatjen e fjalimit të tyre, për një audiencë të caktuar. Modeli është përshkruar nga sociolinguisti Allan Bell, i cili tregon se midis atij që i drejtohet audiencës dhe asaj, mund të ketë marrëdhënie të ndryshme në komunikim. Bell (1984, siç citohet te Coupland dhe Jaworski, 1997, ff. 242-250) ka theksuar, se fjalimi i përshtatur për audiencën bëhet për të treguar afërsi, solidaritet e largësi me të. Folësi e audiencia mund ta gjejnë ose jo gjuhën e përbashkët në një hapësirë të caktuar komunikimi. Rugova dhe Sejdiu-Rugova thonë se, kjo përshtatje, sipas audiencës ka shumë rëndësi edhe në fushën e studimit të medimeve (2015, siç citohen tek Ismajli, Rugova dhe Munishi, 2020, f. 82).

3.1. Dizajni i audiencës dhe peizazhi gjuhësor

Peizazhet gjuhësore paraqesin një lloj tabloje, se si përdoret gjuha në rangun e shenjave dhe çdo gjë (etiketat) e shkruar në hapësirat publike dhe private. Analiza e peizazhit gjuhësor, po ashtu mund të tregojë edhe për statusin dhe pozitën e një gjuhe brenda një territori të caktuar (Ismajli et al. 2020, f. 262). Pasi çdo etiketë e peizazhit tregon një të dhënë gjuhësore, në aspektin e interpretimit, bëhet shkas për t’u përshkruar në përputhje me modelin e Bell-it. Etiketat e hapësirave private, mund të vrojtohen si kreativitet gjuhësor, sidomos në prizmin e dizajnit të audiencës, sepse ato u drejtohen audiencës, komunikojnë me audiencën.

3.2. Etiketat te hapësirat private

Gjatë evidentimit të njërive të peizazheve gjuhësore, vërejtëm një larmishmi të etiketave. Tek etiketat e evidentuara, për bizneset private, vërejmë emërtime të reja dhe të vjetra. Disa biznese, për shkak edhe të traditës, i kanë ruajtur emrat-titujt dhe pranë kanë vënë vitin e fillimit të veprimtarisë (ang. *since*). Siç u fol në fillim të kreut, dizajnimi i audiencës, vërehet edhe tek etiketat private (janë vërejtur në tri njësi). Kategorive, të cilat u takojnë këto njësi, janë dy të gastronomisë dhe një e ordinancës stomatologjike. Ka-

fenetë janë të tipit *kafe e tifozëve të futbollit*. Kështu, është i mirënjohur rivaliteti midis klubeve të futbollit turk, *Fenerbahçe*, *Galatasaray* (Galatasaraj), *Beşiktaş* (Beshiktash) etj., gjë që pasqyrohet edhe te tifozët në Prizren, të cilët i kanë të ndarë edhe lokacionet ku mbledhen për ta përkrahur ekipin e zemrës. Një tjetër etiketë, që edhe për nga mënyra e të shkruarit i jep karakteristikat e “dizajnimet të audiencës”, është ordinanca stomatologjike *Grubetgjija dent*. E shkruar sipas të folmes, ajo tregon për synimin që ka etiketa, pra fton me njëfarë mënyre mërgimtarët në këtë ordinancë. Në raport me gjuhën e shkruar dhe standardin e shqipes, kjo do të quhej shkelje e normës, gjithsesi në aspektin sociolinguistik dhe posaçërisht në peizazhet gjuhësore, do ta quanim si një etiketë të veçantë. T’i shohim përmes kolazhit të fotove rastet e përmendura:



3.2.1. Përshkrimi për disa etiketa private të veçanta

Etiketat vijnë si pjesë e kreativitetit të ndërmarrësve privatë, të cilët garojnë edhe në këtë aspekt, në tregun e lirë. Kemi përzgjedhur disa njësi dhe etiketat e tyre për t’i përshkruar:

- **“Kafja Jeme”** (“kafja ime”) duket si një etiketë që i fton klientët, për produktin si në shtëpi, pra kërkon të krijojë afërsi me atë që pritet të hyjë aty. Gjithsesi, kjo etiketë del një alternativim nga një komedi serike të njohur në Kosovë, “Kafeneja Jonë”.

- **Kafe “te Kinezi”** është një prej etiketave që duket interesante, në një vend ku nuk ka kinezë rezidentë pothuajse fare. Në këtë lokal, historia lidhet me biznesin e njohur, të një kinezi, i cili shiste gjëra të lira, para shumë kohësh. Ky lokal kishte ngelur si pikë orientimi: “te Kinezi”; më vonë u përdor nga ky si etiketë, meqë vendndodhja dihej tashmë, nga një pjesë e mirë e banorëve.
- **“Kafiç”** është tipik një përdorim regjistri në Kosovë, por që është vënë si etiketë. Edhe kjo etiketë duket e veçantë kundrejt të tjerave, sepse është përdorur për një kohë të gjatë dhe është pothuajse i familjarizuar me komunitetin.
- **“Pezull”**, dyqan i modës, që merret me punime dore të çantave, është një lloj dyqani artizanal. Etiketa “pezull” tregon se çanta kur vihet në krah, është në njëfarë lartësie nga toka. Gjetja e kësaj etikete, del kreative dhe me shumë stil, sepse tregon një veçori tipike për çantat dhe gjuhësisht është etiketa e vetme si ndajfolje, të cilën e kemi pikasur.
- **“Syrrush liquor - Art & Spirits”**: një lokal që ofron pije alkoolike nga vreshtat e Rahovecit. Qysh në fillim kompozita “sy (si) rrush”, krijon ndjesi pozitive dhe lidh gjuhësisht vendin nga vjen produkti dhe pronaren e këtij biznesi. Aq sa kuptuam, pronarja (Brikena Gashi – piktoresh), ishte vreshtarja e parë femër nga Rahoveci, e cila menaxhon 2 hektarë vreshta. Në pikëpamje gjuhësore, përveç një kompozite, tregon edhe atë që e kemi hasur dendur, përdorimin e përcaktorit në anglishte *liquor* “liker”, edhe *Art & Spirtis* “art dhe shpirt”.
- **Ordinanca “Rrite me dashni”**: veprimtari këshillimore për prindërit dhe fëmijët. Kjo etiketë e përbërë nga një sintagmë, duket e qëlluar për funksionin që ka. Fjala *dashni* është ruajtur në trajtën dialektore. Veprimtaria këshilluese e kësaj ordinance e dënon dhunën ndaj fëmijëve dhe etiketa, më shumë është mesazh ndërjegjësimi.
- **“N’Traffic”** është një etiketë kreative e një kioske e evidentuar në qendër të qytetit. Kioska, si sinonim ka etiketën *trafikë*; ajo vendoset kryesisht buzë rrugës, ose ku ka lëvizje (trafik) dhe shërben si dyqan që nuk zë shumë vend. Kjo etiketë del si “slang”, sidomos kur vërejmë

parafjalën e përdorur të shqipes, përpara një emri në anglisht, por që ndërlidhet me etiketën në të folmen.

- “N’Fermë” (dyqan bulmeti). Etiketa tregon afërsi me natyrën dhe produktet e saj. Përdorimi i parafjalës *n’* (në), i jep atributet e një shënjesi të veçantë, një lloj slang-u, i cili del edhe tek etiketa të tjera (n’bahçe, n’park, si n’katund, si n’shpi etj.) dhe që ka një trend të ri përdorimi nga ana e bizneseve.

4. Përfundimi

Peizazhet gjuhësore dhe studimi i tyre, u trajtuan përmes hulumtimit, përshkrimit dhe intervistimit. Njësitë e peizazheve gjuhësore që u evidentuan, treguan larmishmi të përdorimit të gjuhës në etiketa. Duke e ditur se në Prizren kemi veçorinë e dygjuhësisë, vrojtimi i njërive të peizazhit gjuhësor, sipas perspektives sociolinguistike, paraqiti mundësi të studimit, qoftë në sferën private, qoftë në atë publike.

Evidentimi i etiketave në hapësirat publike e private, solli rezultat të dukshëm, sa i përket përdorimit të gjuhës. Nga 373 etiketa të njërive, të peizazhit publike, janë 75 njësi dhe të privates janë 298 njësi. Nga të gjitha njësitë (publike e private), vetëm në një gjuhë kemi këtë rezultat: në shqipe 123 etiketa, në anglisht 82, në turqisht 3, në serbishte 1, në italisht 6, në frëngjisht 2, në gjermanisht 1 etj. Etiketat në dy gjuhë janë më shumë në shqip-anglisht, me 85 etiketa, ndërsa në tri e më tepër gjuhë prijnë gjuhët zyrtare (shqipja, serbishtja, turqishtja, boshnjakishtja dhe anglishtja) me 30 etiketa.

Gjuhët zyrtare në hapësirat publike në Prizren, sipas mostrave të marra, shkruhen në 40 % të etiketave; gjetja tregon, se gjuhët në këtë hapësirë përdoren kryesisht sipas pjesëmarrjes së komunitetit. Në sferën publike, kur merren përdorimet e gjuhëve veç e veç, shqipja ka një përdorim më të gjerë sesa serbishtja, turqishtja dhe anglishtja. Në hapësirën private kemi vërejtur përdorim konkurrues të shqipes dhe të anglishtes, por sipas mostrave të marra, hipoteza se anglishtja prin në etiketat e njërive private rrëzohet, rrjedhimisht, shqipja prin dhe konkurrohet nga anglishtja, në etiketat e njërive private, gjithashtu shihet një prirje e bashkimit shqip-anglisht, madje edhe një trend në rritje të vazhdueshëm. Po në sferën private, nuk kemi evidentuar asnjë etiketë në gjuhën serbe. Në anën tjetër, shqipja standarde, përdoret

rregullisht në etiketat e institucioneve publike, por edhe në etiketat private (këtu kemi edhe përdorimin e regjistrave të ndryshëm etj.).

Etiketat private të modeluara, sipas “dizajnit të audiencës”, i kemi hasur në 3 njësi, çka e rrëzon hipotezën se në Prizren nuk ka etiketa të tilla. Gjithsesi, në kuadrin e dizajnit të audiencës, kemi ndërfutur disa pika diskutimi, të cilat e përshkruajnë në formë interpretimi krijimin e etiketave të bizneseve të ndryshme.

Referenca:

- Backhaus, Peter (2006). Multilingualism in Tokyo: A Look into the Linguistic Landscape. *Linguistic Landscape. A New Approach to Multilingualism*. Në Munishi, Sh. (2015). *Shqipja dhe anglishtja në peizazhin lingvistik të Prishtinës. Seminari XXXIV ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*. Prishtinë
- Bell, A. (1984) *Language Style as Audience Design*. Në Coupland, N. dhe Jaworski, A. (1997, eds.). *Sociolinguistics: a Reader and Coursebook*. St Martin's Press Inc. New York.
- Bell, A. (2001). *Back in style: Reworking Audience Design*. Në Eckert, P. dhe Rickford J.R. (2001). *Style and Sociolinguistic Variation*. Cambridge.
- Ben-Rafael, E., Shohamy, E., Amara, M., Trumper-Hecht, N. (2006). Linguistic Landscape as Symbolic Construction of the Public Space: The Case of Israel. *International Journal of Multilingualism*. 3. 7-30. 10.1080/14790710608668383.
- Birch, E. (2010). Public and Private Space in Urban Areas: House, Neighborhood, and City. 10.1007/978-0-387-32933-8_8. Në internet: https://www.researchgate.net/publication/226509332_Public_and_Private_Space_in_Urban_Areas_House_Neighborhood_and_City
- Blommaert, J., Maly, I. (2014). Ethnographic Linguistic Landscape Analysis and social change: A case study. *Tilburg Papers in Culture Studies*, paper 100. Në internet: https://www.researchgate.net/publication/264992781_Ethnographic_Linguistic_Landscape_Analysis_and_social_change_A_case_study
- Cenoz, J. and Gorter, D. (2006). Linguistic Landscape and Minority Languages. *Linguistic Landscape. A New Approach to Multilingualism*. Në Munishi,

- Sh. (2015). Shqipja dhe anglishtja në peizazhin lingvistik të Prishtinës. *Seminari XXXIV ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*. Prishtinë.
- Demaj, U., dhe Vandembroucke, M. (2016). Post-war Kosovo landscapes in Pristina: Discrepancies between language policy and urban reality. *Nationalities Papers*, 44(5), 804-825. doi:10.1080/00905992.2016.1187592
- Demaj, U. (2022a). Symbolic identity building, ethnic nationalism and the linguistic reconfiguration of the urban spaces of the capital of Pristina, Kosovo. *Ethnicities*, 0(0). Në internet: <https://doi.org/10.1177/14687968221097810>
- Demaj, U. (2022b). Constructing national identity in the public space. The discursive transformations of the semiotic-linguistic landscapes of Pristina, Kosovo. *National identities*. Në internet: <https://doi.org/10.1080/14608944.2022.2089643>
- Ismajli, R., Rugova, B., Munishi, Sh. (2020). Leksikon i termave të sociolingvistikës. AShAK. Prishtinë.
- Landry, R., Bourhis R. (1997). Linguistic Landscape and Ethnolinguistic Vitality. *Journal of Language and Social Psychology* 16 (1): 23–49.
- Munishi, Sh. (2014). Zhdukja e dygjuhësisë shqip-serbisht në Kosovë. *Seminari XXXIV ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*. Prishtinë.
- Munishi, Sh. (2015). Shqipja dhe anglishtja në peizazhin lingvistik të Prishtinës. *Seminari XXXIII ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*. Prishtinë.
- Munishi, Sh. (2020). Projektion i zhvillimeve sociolingvistike: rasti i bilingvizmit shqip – serbisht në Kosovë. Zeroprint. Prishtinë.
- Skënderi-Rakiplari, E. (2023). Peizazhi lingvistik i Tiranës. Albas. Tiranë.
- Rugova, B. (2011). Pozita dhe statusi i shqipes kundruall gjuhëve të tjera të Ballkanit. *Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*. Prishtinë.
- Sebba, M. (2010). Review of Linguistic Landscapes: A Comparative Study of Urban Multilingualism in Tokyo. *Writing Systems Research* 2. Në internet: https://www.researchgate.net/publication/240593121_Linguistic_Landscapes_A_Comparative_Study_of_Urban_Multilingualism_in_TokyoPeter_Backhaus
- Shukriu, E. (2012). Kisha e Shën Prendës. MASHT. Prishtinë.
- Shukriu, M. (2001). Prizreni i lashtë: morfologjia e ecurive për ruajtjen e kulturës materiale. Kosova. Prizren.
- Verena, K., Warrander, G. (2017). Kosovo. Bradt Travel Guides. Chalfont St. Peter.

Dhurata LAMÇJA

SFIDA TË MËSIMDHËNIES SË LËNDËVE GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI NË KLASAT E ARSIMIT TË MESËMTË LARTË

Abstrakt:

Mësimdhënia është konsideruar sfidë e përditshme, e përhershme, por njëherazi që mban gjallë kërshërinë profesionale të vënies në provë të vetes si mësimdhënës dhe të nxënësve në brezin e vet, të aftësisë së përsosjes dhe latimit gjuhësor duke pasur në mendje vizionin e përgatitjes për një profesionist të së ardhmes. A mat prova e Maturës Shtetërore saktësisht dhe cilësisht arritjet, aftësitë dhe zotërimin gjuhësor amtare? Nëse e kemi provuar në vite këtë mungesë në bazë të të cilëve prej modelesh ndërkombëtare do ta standardizojmë këtë provë dhe sa është gati terreni shqiptar për të. Hapësirat e përdorimit të gjuhës në Kurrikulën e AML dhe të të shkruarit si kompetencë më vete e përbushin nevojën për t'iu përshtatur nevojave të tregut të punës në këtë terren global dhe në profesione që nuk mundemi t'i dimë, drejt të cilëve do të gjenden nxënësit tanë të sotëm.

Përmes një hulumtimi cilësor, përmes përfundimeve të arritura pas vitesh vëzhgime dhe analiza marrim guximin t'iu shqiptojmë këto sfida dhe të tentojmë të shtrojmë për përgjigje disa pyetje të cilat e duan shpejt një përgjigje. Një tezë për gjuhën shqipe dhe letërsinë e mbështetur vetëm në tekste shqip do ta orientonte dhe mësimdhënien dhe programet drejt një njohjeje më të thellë, qëmtimi më të hollë dhe pa dyshim drejt një qasjeje me kulturën amë me më shumë empati, pranueshmëri dhe forcim të ndërgjegjësimit për identitet kombëtar.

***Fjalët kyçe:** gjuhë shqipe, nxënës, shkollë, mësimdhënie, letërsi shqipe*

1. Hyrje

Qytetërimi, teknologjitë dhe shkencat e botës po evoluojnë me shpejtësi. Shkolla, si institucion arsimor, është përballur me vështirësitë më të mëdha të shekullit (Lubchenco, 1998). Shumë komponentë të shkollës duhet të ndryshohen, duke përfshirë kurrikulat, mësimdhënien, taktikat dhe metodologjitë e të nxëniet. Mësimdhënia moderne duhet të përdorë një sërë taktikash për të rritur mjedisin mësimor dhe të ofrojë modele të ndryshme për të ndër-tuar kurrikulat e përshtatshme për të gjitha disiplinat, fushat e studimit dhe nivelet. Mësimdhënia është një profesion dinamik dhe gjithnjë në zhvillim që paraqet sfida të përditshme (Palvia et al., 2018). Megjithatë, këto sfida sjellin me vete edhe mundësi për rritje dhe zhvillim, si për mësuesit ashtu edhe për studentët. Mësimi i gjuhës dhe letërsisë shqipe në Arsimin e Mesëm paraqet sfida të përditshme për pedagogët. Kërkon vetëpërmirësim dhe përshtatje të vazhdueshme për të përmbushur nevojat e brezit të ardhshëm të profesionistëve.

Si mësues, kërkimi për përmirësim bëhet pjesë e brendshme e profesionit. Çdo ditë në klasë, profesorët përballen me skenarë dhe nevoja të ndryshme të nxënësve, duke i shtyrë ata të kërkojnë metoda, strategji dhe burime inovative të mësimdhënies (Mukminin et al., 2017). Dëshira për të qenë një mësues më i mirë nxit rritjen profesionale. Mësimi i gjuhës dhe letërsisë shqipe kërkon një nivel të lartë njohjeje gjuhësore nga pedagogët. Për të mësuar në mënyrë efektive aftësitë gjuhësore, mësuesit duhet të jenë të aftë në gramatikën, fjalorin dhe përdorimin e gjuhës. Ndërsa udhëzojnë nxënësit në përmirësimin e aftësive të tyre gjuhësore, vetë mësuesit rritin aftësitë e tyre gjuhësore. Bota po ndryshon vazhdimisht dhe arsimi duhet të mbajë ritmin. Mësuesit duhet t'i përshtatin qasjet e tyre të mësimdhënies në përputhje me nevojat e brezit aktual të studentëve. Kjo përfshin integrimin e teknologjisë, multimedias dhe aktiviteteve ndërvepruese në klasë për të angazhuar studentët në mënyrë efektive (Dimo, 2014).

Gjuha dhe letërsia janë komponentë jetikë të identitetit të një kulture. Mësimi i gjuhës dhe letërsisë shqipe ndihmon në ruajtjen e trashëgimisë kulturore shqiptare duke ia kaluar brezit të ri. Kjo ndjenjë e identitetit kulturor mund të rrënjosë krenarinë dhe përkatësinë mes studentëve. Mësuesit efektivë kanë fuqinë për të frymëzuar dhe ndezur një pasion për të mësuar te

studentët e tyre. Kur studentët ndihen të motivuar dhe të mbështetur, ata kanë më shumë gjasa të marrin pronësinë e arsimit të tyre dhe të përpiqen për rritje personale dhe akademike (Korthagen, 2004).

Çdo brez studentësh vjen me grupin e vet të sfidave dhe preferencave të të mësuarit. Aftësia për t'u përshtatur dhe për të gjetur zgjidhje për sfida të ndryshme është thelbësore për ruajtjen e një mjedisi mësimor pozitiv dhe përmbushjen e nevojave të nxënësve të ndryshëm. Mësimdhënia është një profesion që lë një ndikim të qëndrueshëm në jetën e studentëve. Në kërkim të ekselencës në mësimdhënie e gjuhës dhe letërsisë shqipe, pedagogët janë përballur me sfida të përditshme që kërkojnë qasje novatore dhe përmirësim të vazhdueshëm. Nëpërmjet viteve të kërkimit cilësor, vëzhgimeve dhe analizave, ne eksplorojmë pengesat e shumanshme që hasen në klasë dhe rëndësinë e gjetjes së zgjidhjeve të shpejta (Clifford, 1988).

Në këtë studim, ne eksplorojmë përshtatshmërinë e testit të Maturës Shtetërore në matjen e zotërimit të gjuhës, nevojën për një model ndërkom-bëtar të standardizuar dhe se si kurrikula e AML-së adreson kërkesat e tregut global të punës. Për më tepër, ne propozojmë përdorimin e një teze me fokus shqiptarin për të thelluar mirëkuptimin kulturor dhe për të nxitur identitetin kombëtar.

2. Testi i Maturës Shtetërore: Sfidë vlerësimi

Testi i Maturës Shtetërore, i krijuar për të vlerësuar njohuritë dhe aftësitë e nxënësve në përfundim të arsimit të mesëm të lartë, përballet me disa kufizime kur bëhet fjalë për matjen e aftësive gjuhësore dhe të analizës letrare në gjuhën dhe letërsinë shqipe. Testi aktual shpesh i jep përparësi njohurive faktike të veprave letrare dhe rregullave gjuhësore në vend që të vlerësojë aftësinë e studentëve për ta zbatuar atë njohuri në skenarë të jetës reale. Mund të mos vlerësojë në mënyrë efektive përdorimin gjuhësor, komunikimin dhe aftësitë e të menduarit kritik të studentëve. Testi i Maturës Shtetërore tenton të mbështetë në pyetje të standardizuara dhe kërkesa eseistike, duke u lënë pak hapësirë studentëve për të shfaqur kreativitetin dhe mendimin e tyre origjinal. Kjo mund të pengojë aftësinë e tyre për t'u shprehur plotësisht dhe për të zhvilluar zërin e tyre unik si shkrimtarë. Kufizimet kohore të testit mund të mos lejojnë studentët të demonstrojnë plotësisht

aftësitë e tyre gjuhësore dhe aftësitë e analizës letrare. Nxitimi në provim mund të çojë në pasaktësi dhe nënperfaqësim të aftësive të vërteta të studentëve (Kalo & Haxhihyseni, n.d.).

Për të adresuar kufizimet e testit të Maturës Shtetërore, ka nevojë për një sistem vlerësimi më gjithëpërfshirës që të përfshijë në mënyrë holistike të gjitha aspektet gjuhësore, duke përfshirë aftësinë gjuhësore, të menduarit kritik dhe analizën letrare. Zbatimi i vlerësimeve të bazuara në performancë, të tilla si prezantime, debate dhe detyra të zgjeruara me shkrim, mund të ofrojnë një matje më të saktë të aftësive gjuhësore të studentëve. Këto vlerësime mund të pasqyrojnë më mirë aftësinë e tyre për të komunikuar në mënyrë efektive dhe për t'u angazhuar me tekste letrare. Hartimi i vlerësimeve që pasqyrojnë përdorimin e gjuhës reale dhe skenarët e analizës letrare mund të ofrojnë një vlerësim më autentik të aftësive gjuhësore të studentit. Detyrat që kërkojnë nga studentët të zbatojnë gjuhën në situata praktike, mund të shfaqin kompetencën e tyre përtej përmbytjes së memorizuar (Bean & Melzer, 2021).

Integrimi i praktikave të vlerësimit formues gjatë gjithë vitit akademik mund t'u ofrojë studentëve reagime të vazhdueshme, duke i ndihmuar ata të gjurmojnë përparimin e tyre dhe të identifikojnë fushat për përmirësim. Kjo qasje mund të nxisë një proces të vazhdueshëm mësimor dhe të zvogëlojë presionin e një provimi përfundimtar me aksione të larta. Kërkimi i modeleve ndërkombëtare mund të ofrojë njohuri të vlefshme për vlerësime më të sakta dhe cilësore të aftësive gjuhësore (McCallum & Milner, 2021). CEFR është një kornizë e njohur gjerësisht që vlerëson aftësinë gjuhësore në nivele të ndryshme (A1 deri në C2). Miratimi i këtij kuadri mund të ofrojë një mënyrë të standardizuar për të vlerësuar aftësitë gjuhësore të studentëve dhe për të vendosur objektiva të qarta mësimore. Vende si Finlanda dhe Suedia kanë përqafuar modele të vlerësimit të performancës që fokusohen në aftësitë e studentëve për të zbatuar aftësitë gjuhësore në situata të jetës reale (Weir, 2005). Këto modele theksojnë kompetencat praktike të komunikimit dhe analitike. Disa vende përdorin vlerësime të bazuara në portofol ku studentët përpilojnë një koleksion të punës së tyre me kalimin e kohës. Kjo qasje mundëson një pamje më tërësore të zhvillimit gjuhësor dhe arritjeve të nxënësve.

Përgatitja e studentëve për të ardhmen kërkon të shkosh përtej memorizimit përmendësh dhe të mësuarit pasiv. Si mësues, sfida është të inkurajosh të menduarit kritik, analizën dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve. Angazhimi i studentëve në diskutime dhe debate rreth letërsisë dhe çështjeve shoqërore mund të nxisë këto aftësi thelbësore. Mësuesit efektivë janë nxënës gjatë gjithë jetës. Ata përqafojnë mundësitë e zhvillimit profesional, marrin pjesë në seminare dhe ndjekin arsimim të mëtejshëm për të rritur vazhdimisht aftësitë e tyre të mësimdhënies. Ky përkushtim ndaj të mësuarit gjithashtu jep një shembull për studentët, duke i motivuar ata të jenë gjithashtu nxënës gjatë gjithë jetës (Rao & Chan, 2009). Një nga qëllimet kryesore është përgatitja e studentëve për karrierën dhe rolet e tyre të ardhshme në shoqëri. Kjo përfshin jo vetëm dhënien e njohurive për lëndën, por edhe nxitjen e cilësive, si empatia, puna në grup, komunikimi dhe përshtatshmëria, të cilat janë jetike për suksesin në botën profesionale.

Si përfundim, kufizimet aktuale të testit të Maturës Shtetërore kërkojnë një sistem vlerësimi gjithëpërfshirës që vlerëson më saktë aftësitë gjuhësore dhe aftësitë e analizës letrare. Eksplorimi i modeleve ndërkombëtare mund të ofrojë njohuri të vlefshme për hartimin e një qasjeje vlerësimi që përgatit më mirë studentët për përpjekjet e tyre të ardhshme dhe shfaq aftësitë e tyre të vërteta gjuhësore.

3. Kurrikula e AML: Përmbushja e Kërkesave të Terrenit Global

Saktësia dhe matja cilësore e testit të Maturës Shtetërore në vlerësimin e arritjeve, aftësive dhe zotërimit të gjuhës amtare shqipe kanë qenë objekt debati dhe shqyrtimi. Teksa testi i Maturës Shtetërore shërben si një moment historik i rëndësishëm në vlerësimin e njohurive dhe aftësive gjuhësore të nxënësve në përfundim të arsimit të mesëm, ai ka disa kufizime në ofrimin e një vlerësimi gjithëpërfshirës. Testi i Maturës Shtetërore fokusohet kryesisht në testimin e njohurive të nxënësve për veprat letrare, rregullat gjuhësore dhe fusha të veçanta të përmbajtjes. Ai përfshin detyra të tilla si analizimi i teksteve letrare, shkrimi i eseve dhe demonstrimi i aftësive gjuhësore. Megjithatë, disa kritikë argumentojnë se theksi i testit në njohuritë e përmbaj-

tjes faktike mund të mos pasqyrojë plotësisht aftësitë e përgjithshme gjuhësore dhe aftësitë analitike të studentëve (Collier, 2014).

Zotërimi i gjuhës është një aftësi shumëplanëshe që përfshin jo vetëm gramatikën dhe fjalorin, por edhe aftësinë për të komunikuar në mënyrë efektive, për të menduar në mënyrë kritike dhe për të shprehur idetë në mënyrë krijuese. Mbështetja e testit në pyetjet e standardizuara dhe kërkesat e esesë mund të kufizojë mundësitë e studentëve për të shfaqur aftësitë e tyre gjuhësore në situata të jetës reale dhe të mbytë kreativitetin e tyre. Për më tepër, kufizimet kohore të provimit mund të mos lejojnë studentët të demonstrojnë plotësisht zotërimin e tyre të gjuhës. Nxitimi në test mund të çojë në pasaktësi dhe mund të mos përfaqësojë me saktësi aftësitë e vërteta gjuhësore të studentëve (Dali, 2017).

Në Shqipëri, kurrikula e AML-së është krijuar për të përfshirë hapësira të ndryshme të përdorimit të gjuhës që janë të rëndësishme për përgatitjen e studentëve për tregun e punës. Këto hapësira përfshijnë jo vetëm aftësinë gjuhësore në lexim dhe shkrim, por edhe komunikimin gojor, aftësitë e të dëgjuarit dhe analizën kritike. Duke u fokusuar në këto aspekte, kurrikula i pajis studentët me aftësitë e nevojshme gjuhësore për të komunikuar në mënyrë efektive në mjedise të ndryshme profesionale. Kurrikula e AML në Shqipëri njih rëndësinë e të shkruarit si një kompetencë më vete. Aftësitë e forta të të shkruarit janë thelbësore për profesione të ndryshme në vend, si gazetaria, biznesi, marrëdhëniet me publikun dhe academia. Duke zhvilluar aftësitë e të shkruarit të studentëve, kurrikula i fuqizon ata të shprehin idetë në mënyrë të qartë, koherente dhe bindëse, duke rritur kështu punësueshmërinë e tyre në një sërë fushash (Miço, 2019).

Pamja e punës në Shqipëri është subjekt i ndryshimit për shkak të globalizimit, përparimeve teknologjike dhe ndryshimit të kushteve ekonomike. Kurrikula e AML-së thekson përshtatshmërinë si një aftësi thelbësore për studentët për të lundruar në shtigjet e paparashikuara të karrierës dhe në tregun gjithnjë në ndryshim të punës. Duke nxitur përshtatshmërinë, studentët janë të përgatitur të përqafojnë mundësi të reja, të mësojnë aftësi të reja dhe të qëndrojnë konkurrues në një mjedis profesional dinamik. Kjo qasje gjithëpërfshirëse i pajis studentët shqiptarë me aftësitë gjuhësore, aftësitë e të menduarit kritik dhe fleksibilitetin e nevojshëm për të shkëlqyer në ka-

rrierën e tyre të ardhshme dhe për të pasur sukses në një peizazh pune gjithnjë në zhvillim.

Një qasje empatike kulturore: roli i një teze të përqendruar te shqiptarët

Zbatimi i një teze për gjuhën dhe letërsinë shqipe, me në qendër tekstet shqipe, ka një potencial të jashtëzakonshëm për të pasuruar njohuritë dhe mirëkuptimin kulturor mes studentëve. Duke eksploruar vepra letrare, tekste historike dhe trashëgimi gjuhësore nga tradita e pasur letrare e Shqipërisë, studentët mund të thellojnë lidhjen e tyre me kulturën e tyre amtare. Kjo tezë do t'i nxiste studentët të angazhohen në mënyrë kritike me trashëgiminë e tyre, duke nxitur një ndjenjë krenarie dhe vlerësimi për gjuhën dhe letërsinë shqipe (Gardinier, 2012).

Një qasje kulturore empatike ndaj mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqipe luan një rol kryesor në forcimin e identitetit kombëtar dhe promovimin e pranimit të trashëgimisë së dikujt. Duke përfshirë literaturë që pasqyron perspektiva dhe përvoja të ndryshme, studentët mund të zhvillojnë një kuptim më të gjerë të identitetit të tyre kulturor dhe përvojave të bashkëqytetarëve të tyre. Ky eksplorim empatik ushqen një ndjenjë uniteti dhe përfshirjeje, duke thyer barrierat dhe stereotipat dhe duke nxitur një vlerësim kolektiv për tapiceri të pasur të kulturës shqiptare (Morel, 2013).

Parashikimi i një sistemi arsimor që nxit ndjeshmërinë, vlerësimin dhe dashurinë për kulturën e nënës përfshin pedagogji transformuese dhe ridizajnim të kurrikulës. Duke hyrë në kurrikulën rreth të kuptuarit kulturor dhe trashëgimisë gjuhësore, edukatorët mund të rrënjosin te studentët një respekt të thellë për rrënjët e tyre. Kjo qasje shkon përtej teksteve shkollore dhe testeve të standardizuara, duke krijuar hapësirë për lidhje personale me gjuhën, letërsinë dhe historinë e Shqipërisë. Duke nxitur ndjeshmërinë, sistemi arsimor ushqen individë të dhembshur që janë të përkushtuar për të ruajtur dhe pasuruar trashëgiminë e tyre kulturore (Rector-Aranda, 2019).

Përqafimi i një qasjeje kulturalisht empatike, e plotësuar nga një tezë e fokusuar te shqipja në edukimin e gjuhës dhe letërsisë ka potencialin për të krijuar një përvojë arsimore transformuese. Një qasje e tillë mund t'i fuqizojë studentët me një kuptim më të thellë të trashëgimisë së tyre kulturore,

duke nxitur një ndjenjë të fortë të identitetit kombëtar dhe duke promovuar unitetin midis komuniteteve të ndryshme (Corres et al., 2020). Duke parashikuar një sistem arsimor që ka prioritet ndjeshmërinë, vlerësimin dhe dashurinë për kulturën e nënës, ne i hapim rrugën një brezi individësh të dhembshur që i ruajnë rrënjët e tyre gjuhësore dhe letrare dhe kontribuojnë në mënyrë kuptimplote në ruajtjen dhe krenimin e trashëgimisë së pasur kulturore të Shqipërisë.

Shpalosja e thelbit të gjuhës dhe të letërsisë shqipe për një identitet kombëtar të përfortuar

Një tezë e përqendruar vetëm në gjuhën dhe letërsinë shqipe, e përqendruar në tekste të shkruara nga autorë shqiptarë, mbart një potencial të rëndësishëm për të transformuar qasjen e mësimdhënies dhe kurrikulën (Elezi & Trushaj, 2017). Duke i zhytur studentët në trashëgiminë e tyre letrare, kjo qasje mund të çojë në një kuptim më të thellë dhe më të nuancuar të gjuhës, kulturës dhe identitetit të tyre kombëtar. Një tezë e fokusuar te shqipja u mundëson studentëve të eksplorojnë pasurinë e veprave letrare të prodhuara nga autorë shqiptarë gjatë historisë. Nga poezitë epike si "Këngë Kreshnikësh" te romanet dhe poezitë moderne, studentët thellohen në një varg shkri-mesh të larmishme që kapin thelbin e kulturës, traditave dhe përvojave historike shqiptare (Elsie & Mathie-Heck, 2004).

Nëpërmjet studimit të teksteve shqipe, studentët mund të krijojnë një lidhje të fortë kulturore me trashëgiminë e tyre. Ata zhyten në histori, tema dhe gjuhë që rezonojnë me përvojat e tyre të jetuara dhe përvojat e paraardhësve të tyre. Kjo lidhje kultivon ndjeshmërinë, pasi studentët fitojnë një kuptim më të thellë të rrënjëve të tyre kulturore dhe përvojave të përbashkëta të bashkëqytetarëve të tyre shqiptarë. Një qasje me në qendër shqiptarin nxit ndjenjën e krenarisë dhe identitetit kombëtar. Nxënësit mësojnë të vlerësojnë veçantinë dhe pasurinë e kulturës së tyre amtare, duke përfortuar lidhjen e tyre me kombin shqiptar. Kjo ndjenjë identiteti është jetike për të ushqyer një ndërgjegje të fortë qytetare dhe një angazhim për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore shqiptare (Acevedo et al., 2015).

Analizimi i teksteve shqipe u ofron studentëve mundësinë për të thelluar njohuritë e tyre gjuhësore. Ata ndeshen me fjalor, gramatikë dhe mjete letrare komplekse të përdorura nga autorët shqiptarë, duke rritur aftësitë e tyre

gjuhësore në lexim, shkrim dhe analizë kritike. Një aftësi e rritur gjuhësore i fuqizon më tej studentët të shprehen në mënyrë elokvente dhe efektive. Duke u fokusuar në tekstet shqipe, pedagogët marrin pjesë aktive në ruajtjen e gjuhës dhe letërsisë shqipe. Kjo ruajtje është thelbësore për ruajtjen e autenticitetit të gjuhës dhe për të siguruar që brezat e ardhshëm të vazhdojnë të vlerësojnë dhe vlerësojnë trashëgiminë e tyre letrare (Gkaintartzi, Kiliari & Tsokalidou, 2016).

Ekspozimi ndaj veprave të shkrimtarëve shqiptarë mund të ndezë kreativitet dhe frymëzim te studentët. Ndërsa eksplorojnë stilet dhe temat e ndryshme në letërsinë shqipe, disa studentë mund të inkurajohen të bëhen shkrimtarë, poetë ose studiues të ardhshëm, duke kontribuar në trashëgiminë e vazhdueshme të letërsisë shqipe. Studimi i teksteve shqipe i inkurajon studentët të përqafojnë diversitetin dhe të pranojnë këndvështrime të ndryshme brenda kulturës së tyre. Ata ndeshen me zëra dhe narrativa të ndryshme që formësojnë identitetin kolektiv shqiptar, duke promovuar gjithëpërfshirjen dhe mirëkuptimin (Zhupa, 2015).

Si përfundim, një tezë e bazuar vetëm në gjuhën dhe letërsinë shqipe ka potencialin për të revolucionarizuar qasjen e mësimdhënies, për të thelluar njohuritë kulturore dhe për të nxitur ndjeshmërinë, pranimin dhe një ndjenjë të forcuar të identitetit kombëtar. Duke i zhytur studentët në trashëgiminë e tyre letrare, pedagogët luajnë një rol jetik në ruajtjen e pasurisë së gjuhës dhe kulturës shqipe, duke frymëzuar brezat e ardhshëm që të ruajnë rrënjët e tyre dhe të kontribuojnë në sixhadenë gjithnjë në zhvillim të letërsisë shqipe.

Konkluzione

Si përfundim, përfshirja e gjuhës dhe e letërsisë shqipe në sistemin arsimor u mundëson studentëve të rilidhen me trashëgiminë e tyre kulturore përmes veprave të përjetshme të autorëve shqiptarë, duke çuar në një kuptim më të thellë të identitetit të tyre. Duke i zhytur studentët në origjinën e tyre letrare, kurrikula arsimore kultivon ndjeshmërinë dhe ndjenjën e solidaritetit, duke promovuar pranimin dhe vlerësimin e këndvështrimeve të ndryshme brenda kulturës shqiptare. Për më tepër, analiza e teksteve të ndërlikuara

rrit aftësinë gjuhësore të studentëve, duke i fuqizuar ata të shprehin idetë e tyre me saktësi dhe elokuencë.

Prioriteti i letërsisë shqipe luan gjithashtu një rol vendimtar në ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore, duke rrënjësuar një ndjenjë të thellë krenarie për identitetin kombëtar. Ekspozimi ndaj pasurisë së letërsisë shqipe shërben si burim frymëzimi për studentët që të bëhen novatorë, shkrimtarë dhe studiues të ardhshëm, duke kontribuar kështu në trashëgiminë e qëndrueshme të emincencës letrare shqipe.

Qasja e përqendruar në Shqipëri përfaqon gjithëpërfshirjen, duke festuar narrativat e ndryshme që formësojnë përvojën kolektive shqiptare. Duke inkurajuar një qasje të ndjeshme kulturalisht, edukatorët hapin rrugën për një brez të ardhshëm që vlerëson trashëgiminë e tyre gjuhësore dhe letrare, duke nxitur një shoqëri të bazuar në mirëkuptim dhe pranim.

Si rekomandim, mund të themi që të përfshihen autorë shqiptarë të gjallë dhe vepra bashkëkohore në kurrikulë për t'u ofruar studentëve një lidhje me çështjet moderne shoqërore dhe dinamikat kulturore. Kjo përfshirje nxit rëndësinë dhe inkurajon studentët të angazhohen me shprehjet letrare aktuale, duke ushqyer të kuptuarit e tyre për peizazhin kulturor shqiptar gjithnjë në zhvillim.

Referencat:

- Acevedo, S. M., Aho, M., Cela, E., Chao, J. C., Garcia-Gonzales, I., MacLeod, A., ... & Olague, C. (2015). Positionality as Knowledge: From Pedagogy to Praxis. *Integral Review: A Transdisciplinary & Transcultural Journal for New Thought, Research, & Praxis*, 11(1).
- Bean, J. C., & Melzer, D. (2021). *Engaging ideas: The professor's guide to integrating writing, critical thinking, and active learning in the classroom*. John Wiley & Sons.
- Clifford, J. (1988). *The predicament of culture: Twentieth-century ethnography, literature, and art* (Vol. 1). Harvard University Press.
- Collier, V. P. (2014). How long? A synthesis of research on academic achievement in a second language. In *The New Immigrant and Language* (pp. 49-71). Routledge.
- Corres, A., Rieckmann, M., Espasa, A., & Ruiz-Mallén, I. (2020). Educator competences in sustainability education: A systematic review of frameworks. *Sustainability*, 12(23), 9858.
- Dali, K. (2017). The way of WalDorF: Fostering creativity in LIS programs. *Journal of Documentation*, 73(3), 407-431.
- Dimo, M. (2014). Psycho-Pedagogical Requirements of Methodical Apparatus in the Textbooks of Albanian Language and Literature. *Mediterranean Journal of Social Sciences*, 5(20), 2368.
- Elezi, P. G. D., & Trushaj, A. P. A. (2017). Albanian Education Issues in the Eye of the Reforms, Priority Development for New Perspectives. *European Journal of Social Science Education and Research*, 4(4), 1-7.
- Elsie, R., & Mathie-Heck, J. (Eds.). (2004). *Songs of the Frontier Warriors*. Bolchazy-Carducci Publishers.
- Gardinier, M. P. (2012). Agents of change and continuity: The pivotal role of teachers in Albanian educational reform and democratization. *Comparative Education Review*, 56(4), 659-683.
- Gkaintartzi, A., Kiliari, A., & Tsokalidou, R. (2016). Heritage language maintenance and education in the Greek sociolinguistic context: Albanian immigrant parents' views. *Cogent Education*, 3(1), 1155259.

- Kalo, V., & Haxhihseni, S. Need For Improvement In The Literature Curriculum Design And Its Implementation–The Case Of Albanian High Schools.
- Korthagen, F. A. (2004). In search of the essence of a good teacher: Towards a more holistic approach in teacher education. *Teaching and teacher education*, 20(1), 77-97.
- Lubchenco, J. (1998). Entering the century of the environment: a new social contract for science. *Science*, 279(5350), 491-497.
- McCallum, S., & Milner, M. M. (2021). The effectiveness of formative assessment: student views and staff reflections. *Assessment & Evaluation in Higher Education*, 46(1), 1-16.
- Miço, H. (2019). The Teaching Profession in Albania and the Continuous Need for Improvement through Teacher Training Reforms. *Rethinking Teacher Education for the 21st Century Trends, Challenges and New Directions*. Opladen, Berlin and Toronto: Verlag Barbara Budrich, 150.
- Morel, A. F. (2013). Identity and conflict: Cultural heritage, reconstruction and national identity in Kosovo. *Architecture_MPS*, 3(1), 1-21.
- Mukminin, A., Rohayati, T., Putra, H. A., Habibi, A., & Aina, M. (2017). The long walk to quality teacher education in Indonesia: Student teachers' motives to become a teacher and policy implications. *İlköğretim Online*, 16(1).
- Palvia, S., Aeron, P., Gupta, P., Mahapatra, D., Parida, R., Rosner, R., & Sindhi, S. (2018). Online education: Worldwide status, challenges, trends, and implications. *Journal of Global Information Technology Management*, 21(4), 233-241.
- Rao, N., & Chan, C. K. (2009). Moving beyond paradoxes: Understanding Chinese learners and their teachers. In *Revisiting the Chinese learner: Changing contexts, changing education* (pp. 3-32). Dordrecht: Springer Netherlands.
- Rector-Aranda, A. (2019). Critically compassionate intellectualism in teacher education: The contributions of relational–cultural theory. *Journal of Teacher Education*, 70(4), 388-400.
- Weir, C. J. (2005). Limitations of the Common European Framework for developing comparable examinations and tests. *Language testing*, 22(3), 281-300.
- Zhupa, A. (2015). Gender Socialization in Albanian Schools: Reading the Texts, Listening to the Teachers. *The International Journal of Humanities Education*, 13(2), 15.

Blerta ALIU

IMAZHI I GRUAS NË TEKSTET E MUZIKËS SË POPULLARIZUAR SHQIPE

Abstrakt:

Ky punim synon të vërë në pah mënyrën e portretizimit të gruas në muzikën e popullarizuar shqipe, duke i kushtuar vëmendje të posaçme stereotipizimit dhe objektivizimit të gruas përmes teksteve muzikore, të cilat transmetohen përmes platformave digjitale. Gjithashtu punimi sjell në pah perceptimet e audiencës kosovare mbi konstruktimin e imazhit të gruas përmes prodhimeve muzikore ku në shumicën e rasteve gruas i atribuohen vlera që lidhen me aspekte vizuale teksa portretizohen si lakmitare, të varura ekonomikisht nga burrat dhe jo mjaftueshëm profesioniste në fusha të caktuara. Perceptimet e audiencës përmes anketimit tregojnë se disa prej stereotipave më të shpeshtë gjinor që i hasin nëpërmes muzikës, kanë të bëjnë pikërisht me rolin e gruas dhe mënyrën sipërfaqësore të pasqyrit të saj përmes teksteve shpesh vulgare të cilat e shndërrojnë në objekt trupin e gruas. Trajtimi i literaturës relevante, analiza kualitative dhe ajo kuantitative synojnë t'i shpërfaqin mesazhet që përcillen përmes muzikës, të cilat e marginalizojnë rolin e gruas në shoqëri dhe duke e reduktuar atë në nivele jopërmbytëse që kryesisht lidhen me paraqitje vizuale-ekspozim trupor.

***Fjalët kyçe:** muzikë e popullarizuar shqipe, stereotipa gjinore, portretizimi i gruas.*

Hyrje

Muzika, si një formë e artit përshkon çdo shoqëri njerëzore. Shpesh përdoret për relaksim, tejkalim të emocioneve të fuqishme, ngritje të humorit, disponim më të mirë për kryerjen e aktiviteteve rutinore, për t'u përgatitur për ndonjë aktivitet apo për të stimuluar koncentrimin. Me pak fjalë, muzika mund të përdoret për të përmirësuar mirëqenien. Kjo formë e artit që ka një ndikim të madh te njerëzit, e posaçërisht te të rinjtë, ndikon në zhvillim të identitetit dhe vetë-prezantimit.

Duke pasur një rol të posaçëm në zhvillimin intelektual, social dhe personal të fëmijëve dhe të rinjve, muzika analizohet në këtë punim në kontekstin e përmbajtjes tekstuale duke lënë anash vlerat e tjera muzikore që bartin këngët e analizuara. Krahas vijës melodike, tekstet muzikore kanë shumë rëndësi për audiencën. Megjithatë, shpesh herë në muzikën e popullarizuar hasim në tekste të cilat përcjellin përmbajtje dhe mesazhe të papërshtatshme. Sidomos kur është fjala për këngët e dashurisë që kanë të bëjnë me ndarjen e tradhtinë, aty paraqiten gratë dhe vajzat në role tejet negative duke mos i lënë anash edhe tekstet që i dedikohen bukurisë së gruas, e që janë të reduktuara kryesisht në linjat trupore, fytyrë të bukur apo specifika të tjera vizuale, të cilat forcojnë stereotipat gjinorë dhe objektivizojnë gruan.

E bazuar në faktin se vazhdimisht jemi të ekspozuar ndaj përmbajtjeve që përcjellin mesazhe të tilla, punimi është ndërtuar mbi hipotezën se “Gruas i atribuohen vlera joadekuate dhe sipërfaqësore në tekstet e muzikës së popullarizuar shqipe”.

Metodologjia

Për analizë të teksteve muzikore janë përzgjedhur këngët më të popullarizuara shqipe përgjatë vitit 2022, përkatësisht këngët që janë dëgjuar më së shumti në atë periudhë. Mbledhja e korpusit është realizuar përmes kërkesës zyrtare në uebfaqen Popnable e cila ka ofruar listën e këngëve më të dëgjuara online përgjatë vitit 2022. Nga lista prej 20 këngëve shqip më të dëgjuara të vitit 2022, shumica prej tyre me miliona herë përmes platformës digjitale “YouTube”, janë analizuar të gjitha tekstet për të parë mënyrën e portretizimit të gruas në to. Janë bërë matje të opinionit publik përmes anketimit, ku janë vënë në pah perceptimet e qytetarëve për tekstet e këngëve të

popullarizuara shqipe. Për këtë të fundit, është zhvilluar edhe intervistë me përfaqësues të shoqërisë civile dhe aktivistë që merren me çështje feministe. Është shqyrtuar literatura dhe studime përkatëse mbi rolin e muzikës në krijimin e identiteteve gjinore.

Shfletimi i literaturës

Tekstet muzikore vlerësohet të kenë një rol të madh në zhvillimin kulturor dhe jo vetëm. Tekstet e këngëve janë më shumë se thjesht “pasqyra e shoqërisë”, ato kanë një ndikim të fuqishëm në formësimin e saj. Andaj është më rëndësi të analizohen dhe të identifikohen problematikat dhe vlerat që përcillen përmes këtyre produkteve të medias. Nëse marrim për bazë muzikën e popullarizuar shqipe, shumë prej teksteve muzikore të popullarizuara shihen si problematike. Tekstet e muzikës së popullarizuar shqipe përmbajnë gjuhë diskriminuese e të dhunshme ndaj grave dhe vajzave. Në këto tekste, veçanërisht gratë dhe vajzat portretizohen me gjuhë mizogjene e seksiste, rëndom duke u paraqitur si objekte seksi. Aktivistet feministe që analizojnë këto produkte, konsiderojnë se te këngët popullore shqipe zakonisht gratë i përshkruajnë në terma konservatorë. Ndërsa këngët rep/hip hop i portretizojnë gratë në format më të dhunshme e mizogjene. Megjithatë, shpeshherë sikur objekte seksi, përveç në tekste, kjo mendësi paraqitet edhe vizuelisht në spote.

Edhe studimet ndërkombëtare tregojnë se zhanret që kanë fraksionin më të lartë të këngëve që kanë përmbajtje seksiste janë Hip hop, R&B dhe soul, pavarësisht nga gjinia e artistit. Studimi shkencor “Analizë në shkallë të gjerë e paragjyqimeve gjinore dhe seksizmit në tekstet muzikore”, i realizuar me këngët më të popullarizuara në gjuhën angleze përgjatë pesë dekadave (1960-2010) vë në pah se lidhur me paragjykimet gjuhësore, tekstet e meshkujve solo këngëtar përmbajnë më shumë paragjyqime gjinore sesa ato të femrave solo këngëtare. Kjo, për shembull, mund të vërehet për stereotipin që i përshkruan burrat si më të fortë dhe më të fokusuar për të qenë të suksesshëm dhe në anën tjetër gratë si të prirura për të qenë më pranë familjes.

Qartësisht artistët në botën e muzikës kanë shumë pushtet mbi formësimin kulturor të ideve e identiteteve në shoqëri, sidomos për dukje. Andaj konsiderohet tejet me rëndësi që këta artistë të jenë më të ndërgjegjshëm dhe

të vetëdijshëm për dëmin që e shkaktojnë përveç kur objektivizojnë gra, por edhe kur prezantojnë modele të bukuri së të paarritshme për masën, gjë që shkakton ankth dhe pasiguri te vajzat e reja.

Analiza dhe rezultatet

Analiza përqendrohet në identifikimin e mënyrave se si paraqiten gratë në tekstet e muzikës së popullarizuar shqipe. Se si portretizohen ato kundrejt burrave, çfarë përfaqësojnë, a paraqiten në role të stereotipizuara, a objektivizohen, apo a ka elemente të seksizmit në këngë, janë disa prej çështjeve të cilat janë analizuar. Subjekt i analizës janë 20 këngët më të dëgjuara të vitit 2022 në gjuhën shqipe. Shumica e këtyre këngëve, përkatësisht 15 prej tyre janë këngë të cilat janë lansuar po atë vit, kurse 5 prej tyre janë këngë që janë lansuar para vitit 2022, por që kanë vazhduar të jenë të popullarizuara dhe shumë të dëgjuara edhe në atë periudhë. Këto këngë janë dëgjuar me miliona herë në platforma digjitale dhe vetëm në Youtube ato së bashku kanë marrë mbi 2.4 miliardë shikime. Këngët më të dëgjuara të vitit 2022 i dedikohen temës së dashurisë, me përjashtim të njërës prej tyre (Don Xhoni-Trust me). Kryesisht dashuria e dështuar, problemet në çift, xhelozia dhe konfliktet, pendimi dhe lutjet për ribashkim janë elementet që karakterizojnë tekstet e këtyre këngëve. Megjithatë, në shumicën e këtyre këngëve vërehet qartazi se gratë dhe vajzat portretizohen me gjuhë mizogjene e seksiste, paraqiten si objekte seksi dhe stereotipizohen.

Nga analiza e 20 këngëve më të popullarizuara shqipe shihet se në tri këngë gruaja është paraqitur si objekt seksi, kurse në pesë këngë ajo është subjekt i gjuhës denigruese dhe përmbajtjeve që nxisin dhunë.

Po ashtu, këto këngë forcojnë stereotipat gjinorë dhe marginalizojnë rolin e gruas në shoqëri dhe duke e reduktuar atë në nivele jopërmbajtësor që kryesisht lidhen me paraqitje vizuale-ekspozim trupor. Një gjë e tillë haset në shumicën e teksteve të analizuar më poshtë.

Ajo që vihet re në këtë analizë, është fakti që kryesisht këngët e zhanrit Hip hop dhe R&B kanë përmbajtje seksiste dhe në shumicën e rasteve ato janë të kënduara nga artistët burrat.

Mënyrat e paraqitjes së grave në tekstet muzikore

Për të parë mënyrën se si janë portretizuar gratë në 20 këngët më të popullarizuara shqipe përgjatë vitit 2022, janë analizuar përmbajtjet tekstuale duke u kushtuar vëmendje frazave që i dedikohen apo implikojnë gratë dhe vajzat.

1. Butrint Imeri & Don Xhoni-Corazon

Kënga i kushtohet një dashurie të dështuar. Gruaja paraqitet në rolin e palës indiferente në një çift të ndarë, teksa burri kërkon që të jenë bashkë sërish. Burri i dashuruar, duke vuajtur i kërkon gruas rikthim përmes frazës: “hajde folëm pak-Hajde merrëm me t’mirë -Edhe kthejëm prapë”, kështu duke kërkuar që gruaja t’i bëjë lajka, ani pse në këtë rast ai është duke vuajtur për të. Kjo e shpërfaq qasjen patriarkale të trajtimit në çift, ku burrat krahas ndjenjave që kanë sërish konsiderojnë që gruaja të jetë ajo që “I kthen dhe i merrë me të mirë”. Tutje teksti vazhdon në krahasimin e gruas me drogën, përkatësisht kokainën. Më tej, tenton të joshet gruaja përmes stolive: “T’i blej diamantat, s’më ke mu për trëndafila”, është fraza pasuese që forcon seterotipin që gruaja është e varur ekonomikisht nga burri dhe se joshet pas gjërave materiale siç janë diamantet. Teksti degradon në frazën pasuese kur thuhet se “Jam i gatshëm me ti ba 2-3 kopila”. Kjo qasje ndaj çështjes së riprodhimit është plotësisht e papërshtatshme dhe tregon një mungesë të ndjeshmërisë ndaj partneres dhe familjes.

2. Butrint Imeri-Kuku

Bëhet fjalë për një këngë dashurie. Një tekst gruaja paraqitet si pala që ka “ikur” nga lidhja pa ofruar shpjegime. Ndonëse teksti shpjegon një lidhje problematike, me nervozë, fjalosje, xhelozë e të qara si: “Mos kaj, edhe pse çdo ditë perlahemi, bebe” apo ”Nervoz pa ty, xheloz me ty”, burri prapë pyet gruan “Pse shkove” apo “Pse na le”, duke e konsideruar si të panatyrshme ikjen e gruas nga një ambient abuziv.

3. Dhurata Dora & Soolking-Zemër

Kënga i kushtohet një dashurie të dështuar. Gruaja është në rolin e palës që ka përfunduar zemërthyer si pasojë e gënjeshtreve nga i dashuri. Megjithatë, fundi i tekstit e nxjerr në pozitë më të mirë, si palë që tashmë i ka tejkaluar momentet e këqija dhe që po shkon në drejtim të gjetjes së “një dashurie të re”.

4. Elvana Gjata x DJ Gimi-O x Bardhi – EX

Tekst që i dedikohet dashurisë. Një lidhje e shkëputur. Gruaja tashmë ka një lidhje të re dhe pretendon që ish i dashuri do të pendohet për ndarjen nga ajo.

Ndërkaq burri vazhdon të pretendojë që gruaja është e dashuruar në të. “Tonë’ natën për mu’ fol me shoqe; S’e pranojshe, po u tranojshe, xhelozojshe“, është fraza përmes të cilës ai e shpreh këtë bindje ndonëse thekson se tashmë është bërë vonë për lidhjen që patën.

5. Dhurata Dora-Criminal

Këngë që i dedikohet dashurisë. Gruaja i këndon një burri problematik të cilin e përshkruan si kriminel dhe më të cilin është në lidhje dashurie. Lidhur me këtë ajo i bënë thirrje të dashurit që të përmirësohet nëse dëshiron ta ketë atë afër vetës. Po ashtu i kërkon besnikëri dhe dashuri të dyanshme.

6. Don Xhoni-Katile

Këngë që i dedikohet dashurisë. Gruaja portretizohet si indiferente në një relacion dashurie. I vihet epiteti i “Katiles”, pasi, sipas tekstit, ajo i ofron qasje burrit vetëm në momentin që ajo ka nevojë për të. Nuk zbërthehet më tutje se çfarë konkretisht e bën gruan që të mbajë këtë epitet.

7. Loredana & Don Xhoni-Gjuj Për To

Këngë i dedikohet dashurisë dhe që promovon dhunën në një nivel problematik. Gruaja dhe burri përshkruhen tejet të dashuruar. Megjithatë si matës për dashurinë e fuqishme ndaj njëri-tjetrit, shpërfaqin gatishmërinë për të vrarë për njëri-tjetrin. Kjo vërehet qartazi te fraza:

“Na dy kuptohum veq tu pa
Jam i gatshem per ty me vra
Kallxom nervoz kush t'ka bo
Kallxom se kurr n'jet nuk e la un temen pa e bo”.

Përdorimi i dhunës dhe gatishmëria që përmes veprave të dhunshme të dëshmohej dashuria dhe besnikëria për partnerin/en shpërfaq një qasje tejet problematike. Përmes këtij mesazhi që afekton si burrin ashtu edhe gruan promovohet dhuna dhe aktet kriminale si mjete për të “ruajtur dhe kultivuar” dashurinë mes dy të rinjve.

8. DJ Gimi-O x Ricky Rich x Dardan - Habibi [Albanian Remix]

Këngë që i dedikohet dashurisë me një tekst të shkurtër dhe përsëritës. Gruaja merr epitetin e “habibi” që nga arabishtja do të thotë “e dashur”. Burri ia dedikon vargjet duke i bërë me dije që ajo është e vetmja për të.

9. Elgit Doda - TL (Toxic Love)

Kënga i dedikohet një lidhjeje dashurie me probleme ashtu siç e përshkruan edhe titulli i saj “Dashuri toksike”. Gruaja përshkruhet si xhelozë dhe nxitëse e konflikteve në çift. Ju këndohet sfidave dhe ndjenjave të vuajtjes në një lidhje problematike ku burri i lutet gruas që të kthehet, sepse e dashuron.

10. FINEM ft. LIGHT - KU JE TI

Kënga i kushtohet dashurisë, konkretisht një çifti të ndarë. Burri e kërkon dëshpërimisht kthimin e partneres. E përshkruan vuajtjen dhe dashurinë për të teksa ajo është indiferente dhe është larguar. E krahason me “heroinën”, për të treguar varësinë dhe pamundësinë që të qëndrojë larg saj. Tutje situata vështirësohet kur ai paraqet gatishmëri për të vdekur për të e madje edhe për të vrarë dikë. Përmes këtij akti të dhunshëm dhe kriminal tenton të shprehë dashurinë dhe besnikërinë e madhe ndaj partneres që tashmë e ka braktisur.

11. Noizy & Mozzik- Bonjour Madame

Një tekst që i dedikohet dashurisë, tejet eksplisit dhe i shoqëruar me terminologji vulgare. Gruaja shihet si objekt seksi duke i përshkruar linjat e saja trupore dhe duke u komentuar kryesisht për aspekte vizuale. Flitet për veshmbathje dhe brende të mirënjohura ndërkombëtare të veshjeve të shtrenjta të cilat i posedon gruaja. Megjithatë, prezantohet si vlerë fakti që ajo i ka blerë vetë ato dhe nuk i ka dhuratë nga i dashuri. Teksti tutje degradon duke u lëshuar në përshkrim të intimitetit seksual.

12. Dafina Zeqiri ft MUMA - DASHNI

Teksti i dedikohet dashurisë. Një çift i ndarë që po kalon një periudhë vuajtjesh në mungesë të njëri-tjetrit. Gruaja paraqitet si palë që i kërkon partnerit t'i lënë inatet dhe të kaluarën pas dhe të bashkohen sërish.

13. Elgit Doda- Ku Je

Një tekst muzikor që i dedikohet dashurisë së humbur. Burri shpreh vuajtjen e tij pasi e dashura i është larguar. Do të dijë se ku është ajo dhe e paraqet vetën fajtor për këtë largim. Megjithatë, e sheh gruan si palë që nuk ishte në gjendje t'ia falte gabimet.

14. Kida & Ledri Vula & Butrint Imeri- Dale

Një tekst që flet për dashurinë e një çifti që përcillet me inate dhe dyshime. Gruaja paraqitet si palë e dashuruar, megjithatë mban rezervat e saj në çift. Përmes frazës "Baby kom ni qe ti tonave i thu "Mi Corazon", ajo shpreh dyshime për besnikërinë e partnerit. Në anën tjetër, ajo vlerësohet posaçërisht për aspektin vizual duke u krahasuar me këngëtare, modele dhe të famshme që shquhen për bukurinë e tyre.

15. Don Xhoni- Trust Me

Teksti pasqyron një tematikë që lidhet me qerim hesapesh mes burrave. Konkretisht është ftesë për kundërshtarët për një përballje. Një tekst i shoqëruar me vulgaritet dhe fraza tejet problematike që nxisin dhunë dhe urrejtje. Në të dy raste involvohet në mënyrë tepër vulgare gruaja. Në mënyrë brutale

flitet për “rrjepje të lëkurës”. Më pas, si formë ofenduese për burrat përdor krahasimin e tyre me gra duke përdorur emërtime tejet denigruese për gruan.

16. Noizy & Yll Limani -Alkool

Teksti i dedikohet dashurisë. Përshkruan burrin e dashuruar që i përgjërohet të dashurës që të jenë bashkë. Atë e krahason me alkoolin duke aluduar në një gjendje varësie ndaj saj.

Gruaja paraqitet si palë që e lëndon vazhdimisht burrin, por që kjo gjë nuk e dekurajon burrin ta dashurojë atë. Po ashtu, gruaja paraqitet si palë që kërkon vëmendje gjatë tërë kohës.

17. Yll Limani- Lshoja Zanin

Një këngë që i dedikohet dashurisë. Përshkruhen vuajtjet e burrit për shkak se është braktisur nga e dashura. Ai e akuzon atë që nuk e ka mbajtur fjalën e dhënë dhe “besën“ që do të jenë bashkë përgjithmonë. Madje supozon që ajo është e gëzuar me vuajtjet e tij.

18. Elvana Gjata & Mozzik- Ska

Një tekst që i dedikohet një dashurie të dështuar. Flet për një çift të ndarë dhe një romancë që nuk zgjati shumë. Në këtë tekst gruaja paraqitet si palë e dëmtuar në lidhje. “Ti ma ke honger hakun mu, Shijen e hidht se jam helmu, O ma ke nxi e mo s'te du”, janë fraza që flasin se gruaja ka humbur ndjenjat ndaj partnerit për shkak se nuk është trajtuar mirë në lidhje.

19. Noizy & Dhurata Dora -Mi Amor

Teksti i këngës i dedikohet dashurisë. Flitet për një çift të dashuruar dhe të përkushtuar ndaj njëri-tjetrit. Megjithatë, te frazat kur burri shpreh dashurinë ndaj partneres ai e konsideron të rëndësishëm ta bindë atë për ndjenjat që ka, duke i thënë se e do “më shumë se për një natë”. Më pas vazhdon me objektivizimin e gruas përmes frazës, “Po du mi thon krejt botes shife ça kom kap”.

20. Fifi -Diell

Këngë që i dedikohet dashurisë. Gruaja i shpreh ndjenjat e forta të dashurisë. Madje ajo e paraqet veten në rolin e “skizofrenes dhe të papërmbyturës” kur është fjala për dashurinë ndaj partnerit.

Titulli i këngës	Këngëtari/ja	Viti i publikimit në platformën Youtube	Shikueshmëria në platformën Youtube (deri në korrik 2023)	Tekstshkruesi/ja	Portretizimi i gruas në tekstin muzikor
Corazon	Butrint Imeri & Don Xhoni-	2022	75M	N/A	-Indiferente -Objektivizohet duke u krahasuar me kokainën -Stereotipizohet si lakmitare në gjëra materiale si diamantet -Degradohet në aspektin e riprodhimit
Kuku	Butrint Imeri	2022	71M	Butrint Imeri, Bardhi	-Gruaja pjesë e një mjedisit agresiv në një lidhje mes xhelozisë dhe grindjeve të vazhdueshme -Fajësohet për ikjen dhe shpëputjen e lidhjes
Zemër	Dhurata Dora & Soolking	2019	787M	BIGBANG, Dhurata Dora, Soolking	-Zemërthyer -Palë që u është nënshtruar gënjeshtreve të njëpasnjëshme të partnerit.
EX	Elvana Gjata & DJ Gimi-O & Bardhi	2022	64M	N/A	-Palë që ka krijuar lidhje të re dhe tenton ta bëjë xheloz ish të dashurin. -Portretizohet si xheloze dhe ende e dashuruar në ish të dashurin.
Criminal	Dhurata Dora	2022	41M	Dhurata Dora, Tonic, Denk, Hägi	-Portretizohet në rolin e këshilldhënëses dhe motivueses për të lënë anash shpërhitë e këqija në raport me të dashurin problematik .

Katile	Don Xhoni	2022	89M	Don Xhoni	-Mban epitetin “katile”. -Shfrytëzon burrin për nevoja të saj.
Gjuj Per To	Loredana & Don Xhoni	2022	40M	Don Xhoni & Loredana	-E dashuruar. -E gatshme për të bërë veprime kriminale, deri në vrasje për hirë të dashurisë dhe partnerit. -Promovuese e dhunës.
O Habibi [Albanian Remix]	Dj Gimi	2021	120M	N/A	-Epitetin habibi -Gëzon dashurinë e burrit
TL (Toxic Love)	Elgit Doda	2022	38M	Donald Veshaj, Alban Kondi, Eglid Doda, Romeo Veshaj	-Xheloze. -Konfliktuozë.
Ku Je Ti	Finem	2022	38M	Finem&Light	-Indiferente
Bonjour Madame	Noizy & Mozzik	2022	512K	N/A	-Objekt seksi. -Linja të bukura trupore. -e pavarur ekonomikisht nga burri.
Dashni	Dafina Zeqiri & MUMA	2022	42M	MUMA & ELINEL	-Dëshiron kthimin te partneri; -Dëshiron ta lërë pas të kaluarën dhe inatet.
Ku Je	Elgit Doda	2022	32M	Eglid Doda, Olsi Bylyku, Albatros Rexha	-Palë që nuk fal gabime.
Dale	Kida & Ledri Vula & Butrint Imeri	2021	151M	Butrint Imeri, Ledri Vula, Bardhi	-E dashuruar -Dyshuese -E bukur vizualisht
Trust Me	Don Xhoni	2022	33M	Don Xhoni	-Krahasime degraduese -Subjekt i vulgaritetit
Alkool	Noizy & Yll Limani	2022	62M	Tonic x Denk, Noizy, Yll Limani	-Zemërthyesë -Kërkon vëmendje
Lshoja Zanin	Yll Limani	2021	32M	Yll Limani	-Shkel premtimet -Shpërfillëse ndaj ndjenjave të partnerit
Ska	Elvana Gjata & Mozzik	2022	23M	Mozzik	-Palë e dëmtuar

Mi Amor	Noizy & Dhurata Dora	2021	128M	Dhurata Dora, Noizy	-Objektivizohet
Diell	Fifi	2022	26M	Fifi	-E dashuruar marrëzisht

Fig.1. Portretizimi i gruas në tekstet e muzikës së popullarizuar shqipe

Perceptimi i audiencës për tekstet e muzikës së popullarizuar shqipe

Për të parë perceptimet e audiencës kosovare lidhur me përmbajtjen e për tekstet e muzikës së popullarizuar shqipe, është zhvilluar një anketë që ka matur opinionin e tyre. Anketimi është realizuar online, nëpërmjet “Google Forms”. Pyetësi i ndërtuar është aplikuar nga 85 respondentë, të zgjedhur me metodën e rastësishme të monstimrit, ku 89% prej tyre i takojnë gjinisë femërore dhe 11% gjinisë mashkullore.

Pjesëmarrësit u takojnë grupmoshave të ndryshme, ku 74.1% prej tyre janë të moshës nga 18 deri në 30 vjeç, 12.9% të moshës nga 25 deri në 35 vjeç dhe 12.9% të moshës nga 35 deri në 45 vjeç.

Të dhënat e anketës tregojnë se 98.8% e të anketuarve janë dëgjues të muzikës së popullarizuar shqipe. Madje më tepër se gjysma e tyre (58.8%) janë dëgjues të rregullt të muzikës shqipe teksa pjesa tjetër dëgjojnë nganjëherë. Vetëm 1.2% e respondentëve janë shprehur se nuk dëgjojnë asnjëherë muzikë shqipe.

Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve janë shprehur se dëgjojnë muzikë të të gjitha zhanreve (28.2%), përderisa zhanri me përqindjen më të lartë të dëgjuesve mbetet muzika argëtuese (23.5%) e pasuar nga muzika hip-hop (18.8%), R’n’B (9.4%) dhe pop (8.4). Dëgjueshmëri më të ulët del të ketë muzika popullore (4.7%), rock (3.5%), klasike (1.2%) dhe elektronike (1.2%).

Platformat digjitale, si Youtube dhe Spotify mbeten kanalet kryesore përmes të cilave dëgjojnë muzikë.

Shumica dërmuese e tyre, respektivisht 89.4% e të anketuarve kanë theksuar se i shfrytëzojnë këto platforma për dëgjimin e muzikës shqip. Të

dhënat e anketës tregojnë se vetëm 4.7% e tyre e shfrytëzojnë radion për të dëgjuar muzikë e pasuar nga TV-ja me 3.5%. Opsionet si CD-ja apo të tjera janë preferuar vetëm nga 2.4% e respondentëve.

Tekstet e këngëve që dëgohen del të jenë shumë të rëndësishme për audiencën. Gati gjysma e të anketuarve (49.4%) janë shprehur se tekstet muzikore kanë shumë rëndësi për ta. 40% e tyre kanë theksuar se iu kushtojnë mesatarisht rëndësi teksteve teksa 8.2% e të anketuarve theksojnë që rrallë herë u kushtojnë rëndësi teksteve. Vetëm për 2.4% të të anketuarve, tekstet nuk kanë aspak rëndësi.

Janë kryesisht tekstet për jetën në përgjithësi (28.2%) dhe për problemet e ndryshme jetësore (27.1%) ato që ju bëjnë më së shumti përshtypje pjesëtarëve të audiencës.

Por edhe tekstet për dashurinë janë të rëndësishme. Mbi 22% e respondentëve kanë theksuar se u bëjnë përshtypje tekstet e këngëve për dashurinë, 11.8% për çështje sociale, 4.7% për familjen dhe 5.9% për tematika të tjera. (shih grafikën 1)

A kanë rëndësi për ju tekstet e këngëve që pëlqeni?

85 responses




Fig.2 Rëndësia e teksteve muzikore për dëgjuesit/audiencën

Megjithatë, shumica dërrmuese kanë theksuar të kenë përjetuar një eksperiencë të njëjtë teksa kanë dëgjuar muzikë shqipe të popullarizuar. 97.6% e të anketuarve kanë hasur tekste muzikore në shqip me përmbajtje të papërshtatshme dhe vulgare. (shih grafikën 2)



Fig.3 Përshtypja e audiencës mbi përmbajtjen e teksteve muzikore

Gjithashtu 95.3% e të anketuarve kanë hasur tekste muzikore në shqip me përmbajtje që forcojnë stereotipat gjinorë. (shih grafikën 3)



Fig.4 Ndikimi i teksteve muzikore në forcimin e stereotipave gjinorë

Sa i përket mënyrës së si portretizohen vajzat dhe gratë në tekstet e muzikës së popullarizuar shqipe, 36.5% e të anketuarve mendojnë se ato portretizohen në rolin e gruas që ka linja të bukura trupore. Tutje, 35.3% e të anketuarve mendojnë që gruaja në këngë portretizohet në rolin e gruas që kërkon lidhje dashurie me partnerin që ka qëndrueshmëri financiare para të gjitha vlerave të tjera. Kurse 17.5% e të anketuarve vlerësojnë se gratë përmes këngëve portretizohen në rolin e gruas së bukur që është e varur financiarisht nga burri. Kurse 3.5% e respondentëve mendojnë që portretizimi bëhet në rolin e gruas së bukur, 2.4% në rolin e kuzhinieres, 2.4% në rolin e amvisës.

Vetëm 1.2% e të anketuarve mendojnë që gratë portretizohen si të sukseshme në punë dhe jetë përmes muzikës.

Megjithatë, askush nuk e ka mohuar se portretizimi i gruas në tekste muzikore në nivele jopërmbytësore, por kryesisht në nivele që lidhen me paraqitje vizuale-ekspozim trupor, ndikon negativisht në imazhin dhe mënyrën e perceptimit të grave dhe vajzave në realitet.

Gati 89% e të anketuarve kanë theksuar se besojnë që tekstet e tilla muzikore ndikojnë negativisht në imazhin dhe mënyrën e perceptimit të grave dhe vajzave në realitet.

Teksa 11% e të anketuarve mendojnë se një gjë e tillë ndoshta mund të ndikojë negativisht në imazhin dhe mënyrën e perceptimit të grave dhe vajzave në realitet. (shih grafikën 4)



Përfundim

Pas analizës së kryer, ky punim sjell përfundim se tekstet e këngëve të popullarizuara shqipe përmajnë gjuhë diskriminuese e të dhunshme ndaj grave dhe vajzave. Gjithashtu gratë dhe vajzat objektvizohen dhe stereotipizohen në shumicën e teksteve. Audiencia kosovare pohon se portretizimi i gruas në tekste muzikore në nivele jopërmbytësore, por kryesisht në nivele që lidhen me paraqitje vizuale-ekspozim trupor, ndikon negativisht në imazhin dhe mënyrën e perceptimit të grave dhe vajzave në realitet.

Referencat:

- Davis, Sheila. “POP LYRICS: A Mirror and a Molder of Society.” ETC: A Review of General Semantics 42, no. 2 (1985).
<http://www.jstor.org/stable/42576743>.
- Betti, L., Abrate, C. & Kaltenbrunner, A. Large scale analysis of gender bias and sexism in song lyrics. EPJ Data Sci. (2023). <https://doi.org/10.1140/epjds/s13688-023-00384-8> Po aty
- Susan Hallam and Evangelos Himonides, The Power of Music: An Exploration of the Evidence. Cambridge, UK: Open Book Publishers, 2022, <https://doi.org/10.11647/OBP.0292>.
- Intervistë, Trina Binaku, aktiviste feministe, “Kolektivi për median dhe veprim feminist”, korrik 2023

Iljaz REXHA

SHTRIRJA E VENDBANIMEVE MESJETARE MBI BAZEN E TOPONIMIT *BARD BARL-BARZ* BRENDA DHE JASHTË AREALIT TË DARDANISË

Kumtesa jonë ka për objekt trajtimi dhe shqyrtimi disa toponime parasllave të substratit të protoshqipes që janë regjistruar shumë pak në burime sllave të shek. XIII-XIV, ndërsa në mënyrë të hollësishme janë shënuar në regjistrat osmanë të shek. XV dhe XVI. Toponime këto, që në mungesë të gjurmëve epigrafike dhe atyre arkeologjike në mënyrë transparente, na dëshmojnë se gjatë adminstaratave të invaduesëve të huaj, emërtimet e këtyre toponimeve i kanë marrë nga goja e popullsisë shqipfolëse të cilat i ka emërtuar në gjuhën e vet popullore të protoshqipes. Po ashtu, do të sjellim edhe dëshmi të tjera toponomastike që dëshmojnë se kanë ekzistuar gjatë mesjetës disa vendbanime me dubleta, me nga dy emërtime, me ato të emërtuara me gjuhën popullore të shqipes dhe të riemërtuara në mënyrë administrative në gjuhën sllave, ku gjatë Mesjetës administrata sllave, emërtimet e toponimeve shqipe i ka eliminuar nga përdorimi zyrtar, në jetën e përditshme, por në kujtesën e popullsisë autoktone të etnisë së popullsisë arbërore -shqiptare ato janë ruajtur dhe kanë mbijetuar deri në Mesjetën e vonë. Në vijim do të sjellim vendbanime, toponime parasllave mbi bazën e substratit *iliro- arban* :*Bard,, Barl, Barz*. Dëshminë e parë për emrin *Bardinus*, me formë latine, na e jep historiani i njohur çek *Konstantin Jireček*, që e has në Pag të Dalmacisë, po ashtu te gjeografi arab Al-Idrisi është shënuar ononimi Mali Bard në fund të shek. XI dhe në fillim të atij XII. Pastaj, toponime mbi bazën *substratit iliro-dardan bard* e hasim në dokumentet raguziane dhe sllave gjatë shek. XIV, siç del i regjistruar mikrotoponimi Bashtina-*Bardina* në

anën e Prizrenit. Në Akt -dhuratën e mbretit Dushan të vitit 1354-1355, në fshatin Dobrushë, përmendet, midis disa personave, edhe **Gin Beli** (Edhe në Acta Diplomatica (Aktet Diplomatike) për Arbrinë mesjetare, përmendet një person me emrin **Gon Albi (Gjon Bardhi)**. Trajta e parë **Gon Beli**, e dëshmon sllavizimin, kurse trajta e dytë, **Gon Albi**, romanizimin e onomastikonit arbëror-shqiptar.

Emri Bard është shumë i lashtë, i takon proviniençës ilire-dardane nga **Bardus**, i përhapur më vonë edhe te shumë popuj të tjerë të Ballkanit, që nga koha ilire-antike. Sipas studiuesit kroat Duje Rendic Miočević, në onomastikën shqiptare ky emër ka depërtuar nëpërmjet gjuhës dhe shkrimit latin me trajtën **Bardius**. Është i njohur fakti se gjuha latine, pas pushtimeve romake të viseve të banuara me popullsi ilire, bëhet mjeti kryesor i të shprehurit shkrimor të ilirëve dhe në mënyrë të padiktuar, i ka futur format romake në onomastikën e vjetër tradicionale ilire.

Lidhur me këtë problematikë, Anton Mayeri, Hans Krahe dhe disa studiues të tjerë, emrat **Bardus, Bardulis, Bardibalus, Bardeius, Bardurius**, i konsiderojnë me prejardhje ilire.

Për praninë e antroponimit Bard në viset e Kosovës gjejmë të dhëna edhe në dokumentet mesjetare serbe të zyrës së Stefan Dushanit. Edhe albanologët shqiptarë, Eqrem Çabej dhe Idriz Ajeti pohojnë se fjala me bazën **bard dhe barz**, qoftë antroponim, patronim apo toponim, rrjedh nga fjala iliro-shqipe **bardh**, shumë e dendur dhe e përhapur në trojet gjuhësore shqiptare në **Siujdhesën e Ilyricumit**.

Fjala **bard**, përveç në burimet e tjera mesjetare, latine, greke, sllave del edhe në defterët kadastralë osmanë, si antroponim dhe si toponim, me trajtat: **Bardulius, Bardilis, Bardus, Bardos, Barda, Bardo, Bardonja, Bardan, Bardiq, Bardyl** – dhe variantet: **barz, barl, Barç, pard, bal dhe vard**, si reflekse të fjalës **bard**. Emrat me bazën dhe semantizmin (**bardh**), si dhe variantet e ndryshme të lartpërmendura, i trajton edhe linguisti ynë, Shefki Sejdiu, si reflekse të fjalës **bard**.

Disa studiues vendas të Kosovës: Akademik Idriz Ajeti, Akademik Rexhep Ismajli, Akademik Besim Vokshi, Akademik Mehmet Halimi, Prof. dr. Shefki Sejdiu. Prof. dr. Ruzhdi Ushaku. Prof. dr. Muhamet Tërnavë, Prof. dr. Jahja Drançolli. Qemajl Murati, Prof. dr. Begzat Baliu Dr. Rexhep Doçi. e disa të tjerë qysh në gjysmën e shekullit të 20-të, filluan të merren me stu-

dime onomastike dhe toponomastike mesjetare në arealin e Kosovës e Maqedonisë, dhe me punimet e tyre shkencore vënë një bazament për hulumtimet e mëtejme në zhvillimin e onomastikës shqiptare në trojet e banuara me popullsi të etnisë albane. Mirëpo, gjatë dekadës së dytë të shekullit 21, pothuajse kjo lëmi shkencore mjerisht ka stagnuar të studiohet nga studiuesit e gjeneratave të reja, çka është një e metë e madhe.

Shumë studiues që u morën me zbërthimin e prejardhjes së hidronimit *Vardar*, apo të trajtës së hershme *Bardarios*, si: I. Duridanov, V. Beshieriev, V. Georgiev, J. Zaimov, këtë hidronim e nxjerrin nga një bazë indo-evropiane ***Suordo-uori** « **i zi ujë** » përkatësisht « lumë me ujë të zi ». Ndërsa studiuesi bullgar J. Ivanov këtë hidronim e bie të ardhur nga **Var** (i madh) dhe **dar** (lum, ujë, det), etimologji të cilën e mbështesin edhe L. Stanovska e M. Miovski, që u morën me emërtimin e hidronimit **Vardar**. Me këtë temë në mënyrë analitike është marrë edhe linguisti i njohur kosovar Shefki Sejdiu, i cili etimonin e këtij hidronimi e çon te një strukturë bitematike indo-evropiane **Borgh-uori** (« **i bardhë uji** »), « **ujë i bardhë, lum i bardhë** », me zhvillimet fonetike **ievr.** në shqipen **o > a, gh < d**, kundruall tezës së dijetarëve të sipërpërmendur.

Nga të gjitha etimologjitë e mëparshme të hidroleksemës **Vardar**, mendojmë se më e drejtë mbetet kjo e fundit, siç pohon edhe studiuesi Qemal Murati, i cili i sillet kësaj hidrolekseme.

Lidhur me prejardhjen dhe shtrirjen e emrit **Bard**, janë marrë edhe disa studiues të tjerë, si P. Ilievski, M. Grkoviq, S. Gashi, R. Doçi, E. Sedaj, P. Daka, Q. Murati, M. Halimi, R. Abdyli, e të tjerë.

Sipas studiuesit maqedon Ilievski dhe studiueses serbe Gërkoviq, emri shqiptar **Bardo**, nga **bel**, del mjaft i shpeshtë në arealin e Ballkanit, që ka lidhje me emrin iliro-dardan **Bardilis**.

Në vijim, po i japim të dhënat e materialit onomastik që i kemi hulumtuar në burimet sllave dhe në regjistrat kadastralë osmanë të toponimit mbi bazën **Bard, Barl, Barz**.

Bardus i Kurshumlisë

Ky vendbanim përmendet në mesjetë në defterin e shekullit XV me formën e latinizuar **Bardus**, por ngjan të jetë krijuar në kohën antike. Toponimi në fjalë është shënuar në hartën topografike austriake të vitit 1689, po ashtu në trajtën **Bardus**.

Ky vendbanim është regjistruar edhe në defterët e hollësishëm të Sanxhakut të Krushevcit-Alaca Hisar, në afërsi të Kurshumlisë, i shkruar me grafinë arabo-osmane _____, që mund të lexohet si **Bardus** dhe **Bardush**, me këta kryefamiljarë: **Belati** i biri Rada-s, **Gjura** i biri Damjan-it, **Leshjan** i biri Obrad-it, Obrad i biri Obran-it, Stajko i biri i Dabzhiv-it. Ky vendbanim në atë kohë kishte 4 shtëpi, tani del vetëm si mikrotoponim. Siç shihet, emrat e kryefamiljarëve të këtij vendbanimi ishin sllavizuar, ndërsa emri **Belati**, ishte kalkuar nga emri **Bard**.

Edhe pse në këtë vendbanim të lashtë mesjetar jetonin Arbanët, pasardhësit e ilirëve që e formuan këtë vendbanim, por me depërtimin e sllavëve në viset e Dardanisë, popullsia vendase – Arbane, gradualisht u sllavizua jo vetëm në aspektin onomastik, por edhe në atë etnik. Deri në vitin 1878 në këtë vendbanim jetonin shqiptarët, por, pas luftërave turko-serbe (1877-1878) banorët e tij u dëbuan me dhunë përgjithmonë nga ushtria serbe. Një pjesë e banorëve që mbeti gjallë, u vendos në rrethinën e Vushtrrisë, ku edhe sot e kësaj dite e mbajnë emrin e vendbanimit të hershëm si mbiemër, në formën e deformuar **Parduzi** dhe **Pardyzi**, për **Bardus**.

Në defterin e botuar nga Olga Zirojeviq-historiane dhe Ismail Eren-osmanist nga Stambolli, përmendet një toponim me emrin **Bord** në rajonin e Toplicës, ku një spahi kishte një pjesë të timarit të tij. Por këta nuk japin kurrfarë shpjegimi tjetër. Mendojmë se ky toponim është shënuar nga administrata sllave paraosmane me formën **Bord**, me alternimin e **a**-së në **-o**, nga forma burimore **Bard** është përfutur **Bord**.

Jashtë arealit të Dardanisë, në Defterin e timareve të Sanxhakut të Duka-gjinit të shek. XV, në hapësirën e nahijes së Dibrës, është shënuar edhe një toponim me emrin **Bardus-Barduz**. Gjurmët e tij vihen re në sistemin patronimik të shqipes, ku ky emër është i gjallë si llogar i shumë familjeve të sotme shqiptare, si **Parduz-Barduz**.

Bardin, emri tjetër Davidofc i Nahijes Petrush të Nishit

Ky vendbanim del i regjistruar në defterin e shek. XVI të Sanxhakut të Krushevcit, me formën sllave **Bardin**. Përbri tij është shënuar edhe emri tjetër **Davidofc**. Së pari, administrata mesjetare sllave emrin me bazë ilire-arbane **Bard** e kishte sllavizuar me sufiksin **-in**, **bard+in > Bardin**, e pastaj e kishte emërtuar edhe me emrin **Davidofc**. Të dy emërtimet e këtij vendbanimi, administrata osmane i shënoi ashtu sikurse i gjeti në regjistrat kishtarë të kësaj ane.

Vendbanimi kishte 11 shtëpi dhe 6 beqarë. Emrat e kryefamiljarëve ishin të sferës sllavo-krishtere, si: Dobrivoj i biri i Radofc-it me bashtinë, Petri i biri i Radic-s, Radohina i biri i Radic-s, Cvetko i biri i Radonja-s, Radosav i biri i Radic-s me bashtinë, Nedelko i biri i Radosav-it me bashtinë, Stepan i biri i Bogdan-it me bashtinë, Mihajl i biri i Radonja-s me bashtinë, Todor i biri i **Belonik-ut**, Nedelko i biri i Radovan-it me bashtinë, Petko i biri i Radonja-s me bashtinë, Petri i biri i Todor-it, Marko i biri i Jovan-it.

Nga sa mund të shihet, edhe pse toponimi ishte vendbanim i hershëm, i substratit iliro-arban, përveç 1 kryefamiljari, që mbante patronimin Beloniku, të gjithë emrat e tyre ishin sllavizuar.

Berdonic i nahijes së Bolvanit-Leskofcit

Ky vendbanim del i regjistruar në defterin e shek. XVI të Sanxhakut të Krushevcit, në nahijen e Bolvanit të Leskovcit, me formën **Berdonic**, me alternimin tingullit **e**, në vend të **a**, **Bardonic**, zgjeruar me formantin e sllavishtes **-ic**. Toponimi është sajuar nga apelativi i shqipes **bard**, me sufiksin e greqishtes **on** dhe prapashtesa sllave **ic**, **bard+on+ic > Bardonic**.

Toponimi gjendej diku ndërmjet Bolvanit dhe Leskovcit, i cili sot me këtë emër nuk ekziston.

Bardiqi i Petrushës

Ky toponim del i regjistruar në defterët e shek. XV dhe XVI, me formën sllave **Bardiq**, nga **bard+iq** > **Bardiq**.

Një shekull më vonë, vendbanimi në fjalë është regjistruar në defterin e hollësishëm të Sanxhakut të Krushevcit të vitit 1530/1532, me këta kryefamiljarë: Stepan Dimitri me bashtinë, Nikola Niko me bashtinë, Mirko Radic me bashtinë, **Belina** Bogdan-i me bashtinë, Dabzhiv Radic me bashtinë, Vuk i biri i Stepan-it me bashtinë, **Petre** i biri i Nikola-s, Stojan i biri i Dana-s, Pavl i biri i **Bratul**-it me bashtinë, **Petre** i biri i Nikola me bashtinë, Mirko i biri i **Bratul**-it, Jovan i biri i Radosav-it, **Dimitre** i biri i Nikola, Radivoj i biri i Todor-it, Stojan i biri i Radic, Pavl i biri i Nikola, Vuk i biri i Vladko-s, Protin i biri i Nikola, **Pavl** i biri i Gojina, Ivan i biri i Jovan-it, Zhivko i biri i **Niko**-s.

Përveç disa emrave të krishterë me forma karakteristike, që i mbanin vllëhtë dhe shqiptarët, si **Petri**, **Dimitri**, **Bratul**, **Pavli**, emrat e kryefamiljarëve të tjerë ishin të sferës sllavo-krishtere.

Ky vendbanim *kishte 12 shtëpi, 3 beqarë dhe dy manastire: Sveti Gjorgji (Shën Gjorgji dhe Sveti Boja (Shën Boja).*

Manastiret ishin të shënuara me emrat e formave të shqipes **Gjergji**, **Boja**, cilësuar nga administrata kishtare me fjalën sllave **Sveti**, i **Shenjët**.

Bardeva e Shtipit

Ky vendbanim del i regjistruar në defterin e timareve të Vojnukëve, të Sanxhakut të Qustendilit dhe të Krushevcit në vitin 1486, në rrethinën e Shtipit.

Toponimi është regjistruar në këtë defter me shenja diakritike, që lexohet shumë qartë, si: **Bardeva**, nga fjala protoshqipes **bard-** **bardh** dhe me prapashtesën sllave **-eva**, **bard+eva** > **Bardeva**. Në këtë Defter të timarit nuk ka të dhëna demografike as antroponomike, por janë regjistruar vetëm 4 vojnukë, që ishin në shërbim të logjistikës të ushtrisë osmane, si: Kalush i biri i Permil-it, Tominko i biri i Dançul-it, Bogdan i biri i tij dhe Dimitri i biri i Permil-it.

Po në këtë defter hasim dhe toponimin me formën tjetër **Bardofc**, që gjendej ndërmjet Qustendilit dhe Sofjes, i cili më vonë nuk haset në burimet shkrimore.

Bardofci i Shkupit

Ky toponim, si vendbanim, për herë të parë përmendet në defterin e hollësishëm të Sanxhakut të Rumelisë të vitit 1451/1452, me formën **Bardofci**, mbi bazën e substratit **bard- bardh**, me prapashtesën sllave **ofci**, **bard** > **ofci** > **Bardofci**. Në atë kohë në këtë vendbanim ishte e regjistruar vetëm një shtëpi e konfesionit islam.

Në dëfterin e mëvonshëm sumar të vitit 1455, të cilin e dëshifroi dhe e botoi Hazim Shabanoviç, është shënuar me formën turke **Bardofçe**, ndërsa, ai e transkriboi si **Bardovce**. Vendbanimi edhe në këtë vit kishte vetëm një shtëpi me kryefamiljarin e besimit islam.

Si duket, fshati ishte braktisur për shkak të pasigurisë, sepse më vonë, kur filloi të stabilizohet administrata osmane në nahijen e Shkupit, sipas defterit të vitit 1467/1468, të cilin e botoi Arkivi i Maqedonisë, shihet se është bërë regjistrimi i popullsisë, përkatësisht i kryefamiljarëve të këtij vendbanimi, ku na dalin të regjistruar katër shtëpi dhe dy të veja si kryefamiljare, që do të thotë se në fshat përsëri janë kthyer tri shtëpi. Por tani të gjithë kryefamiljarët mbanin emra të onomastikonit islam, përveç njërit, që edhe pas islamizimit të babait të tij, e kishte ruajtur patronimin (mbiemrin) **Bull-i**, ndërsa emrin e kishte marrë **Haxhi**, duke e mbuluar emrin e tij të mëherëshëm të krishterë. Siç dihet, edhe sot e kësaj dite, disa familje shqiptare këtë emër e mbajnë si mbiemër të vëllazërisë së tyre.

Përveç këtij kryefamiljari, kemi edhe dy kryefamiljarë që kishin qenë të krishterë, tani të konvertuar (të islamizuar) dhe mbanin emrat islamë, ndërsa mbiemrat i kishin zëvendësuar me emrin **Abdullah** (i devotshmi i Zotit).

Për të pasur një pasqyrë më të qartë po sjellim këtu emrat e kryefamiljarëve të këtij vendbanimi sipas radhës, ashtu siç janë regjistruar në defter: **Ali-u** shërbetor i **Halil-it**, **Musa** i biri i **Abdullahut**, **Ajdin-i** shërbetor i **Haxhi Bulli-t**, **Shahin-i** i biri i **Abdullah-ut**, e veja **Gjylshah-e**, e veja tjetër po me të njëjtin emër **Gjylshah-e**.

Nga emri **Abdullah** (në funksion të mbiemrit) mund të konkludojmë se **Musa** dhe **Shahini** që më parë ishin të krishterë vendas, tani konvertuar (të islamizuar) të këtij vendbanimi, e jo banorë të ardhur nga jashtë. Zakonisht, shqiptarët e krishterë (vendës) me rastin e islamizimit, në fillim preferonin emrat **Musa** (Mojsi), **Jusuf** (Jozef), **Davud** (David), e të tjerë, që ishin të ngjashëm me emrat e krishterë dhe i mbanin stërgjyshërit e tyre, ose i merrnin edhe emrat mbi bazë zonomike, si: **Hamëz** (Luan), **Arsllan** (Luan) **Arnaut**, **Shahin** (Skifter) **Arnaut**, **Dogan** (Petrit) **Arnaut**, **Timurtash Arnaut** etj.

Kemi raste kur personat e islamizuar e ruanin emrin popullor apo etnik, si mbiemër **Arbanas**, **Arvanit**, **Arnaut**, apo emrin tradicional shqiptar si patronim – mbiemër **Gjon**, **Gjin**, **Tanush** e të tjerë. Në shumicën e rasteve, të islamizuarit në vend të patronimit – mbiemrit të mëhershëm të krishterë, pagëzoheshin me atë **Abdullah**, dhe në këtë mënyrë humbej çdo gjurmë e emrit të të parëve të tyre, dhe për këtë arsye është shumë vështirë të hetohet gjenealogjia e familjeve shqiptare në periudha të ndryshme historike. Meqë onomastikoni shqiptar gjatë shekujve të kaluar, sidomos gjatë mesjetës, ishte i huaj dhe i llojllojshëm.

Ky vendbanim është regjistruar edhe në defterin e Sanxhakut të Shkupit të vitit 1568/1569, në trajtën e shquar si në shqipe **Bardofci**, ndërsa përgatitësi i defterit Aleksandër Stojankovski e transkribon me trajtën **Bardovce**. Në këtë defter nuk kemi të dhëna për gjashtë kryefamiljarët e këtij vendbanimi, sikurse para 100 vjetëve, por tani përmenden vetëm gjashtë çifligje si timare të bejlerëve. Se çka ndodhi me banorët e mëparshëm të këtij vendbanimi nuk thuhet asgjë. Po ashtu është shënuar edhe një mezra-truall në këtë vendbanimin me emrin **Qerim** si çifllig, duke theksuar se ishte i njohur me emrin **Takijaxhi Balibeg. Bardofci**, edhe në Sallnamen e Vilajetit të Kosovës, është regjistruar sipas natyrës së gjuhës turke **Bardofçe**, edhe pse në burimet e hershme ishte shënuar me formën **Bardofci**, sipas natyrës së gjuhës shqipe.

Ky toponim mesjetar është formuar në mesjetën e hershme, me siguri mbi bazë të emrit shqip dhe të banorëve të vendosur në këtë trevë para vendosjes së administratës sllave në **Dardani**, por siç shihet administrata sllave e ndryshoi trajtën e mirëfilltë të shqipes **Bardi-Bardhi** të natyrës shqipe

me prapashtesën –**ofci** dhe –**ovce**, **Bardofci** dhe **Bardofce**, trajtë të cilën e shënoi edhe administrata osmane, që do të thotë fshati i **Bardos**, i **Bardhit**

Bardani-Bardonja

Ky vendbanim mesjetar shqiptar, për herë të parë del i regjistruar në nahijen e Rudinës së Dukagjinit, në defterin e Rumelisë, në vitin 1451-1452.

Toponimi është shënuar në dy mënyra, me trajtën **Bardani- Bardhani** si strukturë toponimike, dhe me formën **Bardonja- Bardhonja** si strukturë antroponimike.

Ky vendbanim nuk mund të identifikohet as me **Bardoniqin**, as me **Bardosanin**, që sot përfshihen në komunën e Gjakovës, sepse që të tri këto vendbanime ekzistonin në të njëjtën periudhë dhe në të njëjtën hapësirë të Dukagjinit.

Disa studiues të onomastikës, mendojnë se **Bardani** apo forma tjetër e mëvonshme **Bardonja**, që përmenden në dy defterët e Sanxhakut të Dukagjinit nga vitet 1571-1591, mund të identifikohen pikërisht me **Bardoniqin** e sotëm, që do të ishte analoge me strukturën e toponimit në fjalë. Mirëpo në defterin e Sanxhakut të Shkodrës nga viti 1582 na del të përmendet vendbanimi me trajtën sllave **Bardoniqi**, që atëherë ishte përfshirë në nahijen e Pejës dhe antroponomia e këtij vendbanimi ndryshonte rrënjësisht nga ajo e vendbanimit me emrin **Bardani** apo **Bardonja**. Kjo na shtyn të mendojmë se këtu kemi të bëjmë me dy vendbanime të ndryshme, pa marrë parasysh që janë me substrat iliro-dardan të njëjtë.

Vendbanimi **Bardani-Bardonja**, si duket, ishte vend malor dhe jashtë arealit të Gjakovës. Por ekziston mundësia që po ky toponim të gjallojë diku në territorin e Tropojës apo të Lumës së sotme, meqë nahija e Rudinës, si njësi administrative, përfshinte edhe një pjesë të territoreve të të Shqipërisë etnike.

Ky vendbanim, në vitin 1451-1452, kishte vetëm 10 shtëpi, me 10 kryefamiljarë, duke i shënuar vetëm emrat e tyre, pa patronimet, që është rast i veçuar në kadastrat osmane-turke për viset tona, ku zakonisht janë shënuar të bijtë e kujt janë apo farefisnia e ngushtë me të parët e tyre, kur ka munguar patronimi. Në vazhdim po sjellim edhe emrat e këtyre familjarëve, si zot shtëpie, që ishin shënuar pa patronime: **Gjergji**, **Kostandin-i**, **Tanush-i**,

Dimitri, Vasili, Nikola, Tanush-i (tjetër-I.R.), **Gjini, Gjoni, Gjergji** (tjetër - I. R.).

Nga vetë emrat e këtyre kryefamiljarëve shihet qartë se ata mbanin emra karakteristikë të onomastikonit tradicional të krishterë.

Ky vendbanim pas 130 vjetësh përsëri ishte regjistruar në defterin e Sanxhakut të Dukagjinit të vitit 1571, me trajtën **Bardonja**, me 2 kryefamiljarë, që e kishin pranuar fenë islame, ndërsa 10 kryefamiljarë ende mbanin emra karakteristikë shqiptarë, që përfaqësonin 10 shtëpi e 1 beqar. Siç shihet, vendbanimi ishte shtuar vetëm për 2 shtëpi.

Në vijim po sjellim edhe emrat e kryefamiljarëve të këtij vendbanimi: **Mustafa Gika (Gjika), Ali Papa tani të islamizuar, Biba Kola, Andre Kola, Gac Kola, Nue Gika, Doda Nue, Tola Papa, Papa Tola, Dida Prenda, Prend Tenda (?) dhe Gika Kola**, të cilët mbanin emra të larmishëm, krahasuar me emrat e regjistruar para 130 vjetësh.

Vendbanimi në fjalë, pas 20 vjetësh, në një defter tjetër të Sanxhakut të Dukagjinit nga viti 1591, përsëri ishte regjistruar me të njëjtën formë **Bardonja**, dhe ishte shtuar për 3 kryefamiljarë, që kishte 15 shtëpi. Emrat e kryefamiljarëve: **Mustafa Gika, Ali Papa, Mustafa Geci, Gika Tola, Ali Tola, Gika Kola, Buda Gika, Andre Nikola, Gika Tola, Nina Tita, ? , Noca Tita, Tola Bata, Martin Tita, Gjini Tola**.

Vendbanimi **Bardani-Bardonja** mendojmë se nuk mund të identifikohet me katundin **Bardoniq** të sotëm, që përmendet në vitin 1582, e që bënte pjesë në nahijen e Pejës. Fshati me emrin **Bardonja** regjistrohet përsëri në vitin 1591, dhe bënte pjesë në nahijen e Rudinës, e jo në atë të Pejës, e cila kishte ekskluzivisht emra karakteristikë shqiptarë, kurse **Bardoniqi**, trajta shqipe e sllavizuar **Beliq** (shek. XIV) - paraqitet edhe me një emër tjetër sllav **Rupa-Rupina** (shek. XVI), dhe, në këtë kohë, emrat e kryefamiljarëve të tij ishin të sferës sllave të krishterë!

Nga defteri i vitit 1582, administrata e mëhershme sllave paraosmane, emrin e mirëfilltë të shqipes **Bardi** e sllavizoi me prapashtesën sllave **-iq**, si **Bardoniq**, e pastaj e emërtoi edhe me një emër tjetër sllav **Rupina**, duke tentuar që ta heqë prej përdorimit emrin e mëhershëm popullor **Bardi** të shqipes.

Bardiza – Bardica

Ky vendbanim mesjetar del të përmendet në defterin e sanxhakut të Shkodrës të vitit 1582, por në vitin 1485 nuk ishte përfshirë në ndonjë timar të spahinjve dhe mbeti jashtë regjistrimit. Sot është një vend i braktisur – mal me vreshta. Mendoj se nuk mund të identifikohet me **Bardin mbi Shkodër**, që është i regjistruar në Regjistrin e Kadastrës së Shkodrës të vitit 1416-1417, as me **Bardanjolin** e hartave topografike austriake të viteve 1881, por **Bardiza** e vitit 1582, që del në hartat austriake të vitit 1881 me formën e sllavizuar **Bardica**, që shihet se është larg **Bardit**, në jug të Shkodrës.

Mendoj se forma e vjetër e saj ishte me **Bardiz**, me prapashtesën shqipe –**ëz**, por nga administrata sllave më vonë dhe nga ajo osmane, u deformua në **Bardiza/Bardica**.

Antroponimia e këtij vendbanimi mesjetar, e veshur pjesërisht me emra sllavë, sikurse edhe e disa vendbanime të tjera në rrethin e Shkodrës, është me mjaft interes. Meqë popullsi sllave atje nuk kishte pasur kurrë, por vetëm sllavizim të onomastikës shqiptare, po japim regjistrin e emrave të kryefamiljarëve: Iljas Goga, Kola Vuka, Deda Vuka, Lulo Vuka, Gaspar (Gaspër) Andrea, Deda Maresh-i, Mark Maresh-i, Andrea Mark-u, Gjon Deda, Vuka Doda, Mark Gaspar-i, Lika Litoprend-i, bashtina e Gjon Maresh-it në zotërim të Marës; Luka Kola, Mustafa Nik-a, bashtina e Gjonliq-it (Gjolekës-I.R.). Vendbanimi kishte 11 shtëp, 2 beqarë dhe 2 çifligje.

Nga antroponimia e këtij vendbanimi shihet qartë se banorët shqiptarë, edhe pas një shekulli të sundimit të administratës osmane, vazhdonin të ruanin emra tipikë sllavë, siç janë: **Vuk**, si pasojë e ndikimit të administratës dhe të kishës sllave mesjetare në rrethinën e Shkodrës. Kur ndikimet e administratës sllave ishin aq të forta në antroponiminë e vendbanimeve në rrethin e Shkodrës, atëherë është krejtësisht e natyrshme që në vendbanimet e tjera të Kosovës dhe të Maqedonisë, si dhe në Sanxhakun e Nishit, të jenë shumë më të ndjeshme, meqë ishin më gjatë nën sundimin e shtetit mesjetar serb.

Bardoniq, emri tjetër sllav – Beliq

Ky toponim mesjetar mendojmë se është sajuar me bazën e substratit iliro- dardan-arban nga *Bard + on sufiks grek + sufiksi sllave –iç Bardoniç-Bardhaniq* dhe është sajuar trajta sllave *Bardoniq*, ndërsa trajta greke ishte *Bardon*, sikurse *Damastion* dhe *Laberion*, këtu nuk kemi të bëjmë me kompozitë, nga *Bard + Nika*, që disa studiues mendojnë se është sajuar nga dy emra vetjakë, Bardhi dhe Nika.

Në defterin e Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 me emërtimin e përshtatur në trajtën sllave – *Beliq*, të cilin siç shihet nga regjistrimet e mëvonshme, e kishte përkthyer administrata e shtetit mesjetar serb, që pas një shekulli na del vetëm në trajtën *Bardoniq*. Administrata osmane, në fillim, shumicën e vendbanimeve i regjistroi ashtu siç i gjeti të regjistruara në dokumentet mesjetare serbe, e sidomos në ato të kishave dhe të manastireve sllave, që i mbanin shënimet e sakta për ato vendbanime që ishin feude apo prona të tyre. Por, më vonë, pas një shekulli të sundimit osman, ku popullsia filloi përsëri të përdorte emrat e hershëm burimorë, siç është rasti jo vetëm me këtë toponim, me dy emërtime: njëri administrativ e tjetri popullor, por edhe me *Bardosanin* (*Bardhoshanën*) dhe me dubletën e tij administrativë *Lipovac*. Pastaj me *Palabardin* (Palabardh) me dubletën e tij sllave mbi bazë përkthimi *Belopavliq*, që të tri këto vendbanime sot gjenden në rrethin e sotëm të Gjakovës. Këta shembuj tregojnë se administrata shtetërore dhe kishtare kishte kryer sllavizimin e toponimeve shqiptare, duke zëvendësuar emërvendet shqiptare me ato sllave. Por, sipas regjistrimeve të mëvonshme, u vërtetua se ato, pavarësisht nga trajtat administrative, ishin ruajtur thellë në ndërgjegjen e popullsisë, për t'u rishfaqur përsëri.

Bardoniqi, me emrin e kalkuar *Beliq*, në vitin 1485 kishte 39 shtëpi, 9 beqarë dhe dy të veja. Antroponimia e kryefamiljarëve të tij ishte pothuajse e sferës së krishterë me elemente sllave. Edhe pas 100 vjetësh, ndikimi i Patrikanës së Pejës vazhdoi në antroponiminë shqiptare. Vendbanimi ishte regjistruar edhe në vitin 1582, ku na del me formën *Bardoniq* dhe jo me atë *Beliq*. Në këtë vit vendbanimi kishte 14 shtëpi dhe 3 bashtina. Në vazhdim po i japim edhe emrat e tyre: Miladin **Boja**, Ugrin **Boja**, Vuksan **Boja**, **Daba Boja**, Petko **Boja**, Nikolla **Boja**, Bozhidar Gruja, **Radulin** Marku, Ivanko Marko, Millosh Stojan, Voja Radosav, Mirko **Radulin**, Gjura

Dançu, bashtina Bozhidar, në zotërim të të birit të Milush-Miloshit, bash-tina e Ahmetit në zotërim të Radosav Dabzhivit (tash në zotërim të fshatit), bashtina Nikosav në zotërim të Nikosavit (tani në zotërim të fshatit).

Nëse analizohen trajtat e patronimeve të këtij vendbanimi, atëherë kemi 6 kryefamiljarë me emra sllavë me patronimin **Boja**, që edhe sot e kësaj dite e mbajnë shqiptarët. Pastaj kemi 4 kryefamiljarë me patronimet që janë tipike arumune: **Radulin** dhe **Dançu** dhe vetëm 4 kryefamiljarë me emra dhe mbiemra tipikë sllavë, që banorët e etnisë albanë të këtij vendbanimi i kishin trashëguar nga administrata mesjetare kishtare sllave.

Bordoniq – Bardoniq

Ky toponim ishte shënuar në regjistrin osman të shek. XVI, në formën *Bordoniq*, me alternimin e **a**-së në **o** dhe në vend të trajtës burimore *Bardaniq* në defter është shënuar forma e shtrembëruar sllave *Bordoniq* në vend të formës **Bardhaniq**.

Vendbanimi në fjalë përmendet në defterin e Sanxhakut të Prizrenit në nahijen e Rozhajës, të vitit 1530. Meqë Defteri është i tipit të timarëve për të ardhura të spahinjve dhe funksionarëve të tjerë të lartë osmanë, në të cilin ishin shënuar vetëm të ardhurat e tyre, këtu nuk ka të dhëna të tjera antropo-nimike. Ky vendbanim nuk haset në regjistrimet e mëvonshme. Ndoshta ka mundësi të gjallojë ende me ndonjë emër malor të mikrotoponimizuar, meqë, sipas defterit të Sanxhakut të Prizrenit të shek. XVI, në vetë vendbanimin e Rozhajës ka ekzistuar mëhalla me emrin *Bardiq*.

Bardosan - Bradosan emri sllav Lipovac

Ky vendbanim përmendet në defterin e Sanxhakut të Shkodrës, në vitin 1582, që në atë kohë ishte përfshirë në Nahijen e Pejës, me formë të shtrembëruar metatetike *Bradosan*, nga *Bardosan*, që në disa burime të mëvonshme e hasim në këtë formë. Administrata sllave e kohës më vonë e zëvendësoi me emrin tjetër sllav – *Lipovac*.

Ky vendbanim sot gjendet në afërsi të Gjakovës. E hasim në hartat topografike austriake si *Bard-os-ane*, nga **bard** > **os** sufiksi grek dhe sufiksi slav-*ane* = *Bardosane* Në vend të formës burimore të shqipes *Bardhoshan*

apo Bardhushan. Në regjistrimin e regjistrin zyrtar të vendbanimeve të ish-Jugosllavisë e gjejmë të shënuar me formën *Bardusan e jo Berdosan, sepse* banorët e këtij vendbanimi e quajnë me formën joburimore *Berdosan*, gjë që mendojmë se shqiptimi dialektor i popullsisë së kësaj ane zakonisht fone-mën *-a* e zbusin me *-e = a > e*, sikurse në fjalët *barku > berku, nalt > nelt*, etj. Ky toponim i hershëm mesjetar nuk mund të lidhet me sintagmën *bërd* të fjalës sllave dhe të asaj shqipe **thanë+sanë > *Berdosan*, që do të na japë kuptimin *Kodra e Thanës*.

Po të ishte rrënja e kësaj fjale sllave *bërd*, atëherë administrata sllave e mesjetës nuk do të kishte *nevojë ta zëvendësont me fjalën tjetër sllave lipovac* me kuptim *blinishtë.të* ..Shtrembërimi i këtij toponimi është bërë për shkak të moskuptimit të domethënies së fjalës *bard* dhe në fillim është përdorur në një formë tjetër të shtembëruar *Bradosan*, në vend të asaj *Bardosan- Bardhushan*.

Meqë, emrat e kryefamiljarëve të këtij vendbanimi janë të larmishëm dhe të llojlojshëm, që tregojnë procesin e islamizimit të popullsisë shqiptare në mesjetën e vonë, në vijim, tek ata, po i japim në tërësi: Hysejn Lika, Mehmet Andrea, Ferid ? Andrea, Ferhat Gjoni, Mehmet Kola, Hasan Papa, Kurt Gjini, Ibrahim Doçi, Mustafa Kurti, Bali Bici, Hasan Gjoni, Sinan Gjoni, Ahmet Miloç?, Mehmet Ali, Mehmet Biba, Ilja Baci, Mustafa Peca, Osman Gjini, Pervan Bisa, Ferhat Miljat, Hasan Ferhati, Ali Gac-i, Hasan Gac-i, Hysein Kola, Hizir Kasemi, Jusuf Geci, Pervane Biba, Mustafa Andrea, Kurt Kasemi, Mehmet Bisa?, Hysein Seferi, Mustafa Geci, Hysein Biba, Hasan Gjeka, Hasan Abdullahi, Dervish Mehmeti, Hamza Gaci, Hizir Nika, Ali Iljasi, Mustafa Ali, Skender Ali, Ibrahim Doda, Ali Doda, Hasan Akja?, Memi Akja?, Gjon Nua, Nika Doçi, Bisa Andrea, Biba Bardi, Andrea Bardi, Prend Biba, Miha Leshjani, Prend Miha, Gjon Baci, Petre Nua, Rad Bardi, Prend Deda, Gjon Prendi, Andrea Gjoni, Marko Laçi, Lazar Lika, Noja Lazari, Gega Pana, Marko Kola, Lika Leshjani, Bic Boja, Lazar Capa, Bisa Dimitri, Pejo Geci, Geci Goga, Bac Geci, Milesha Leka, Lika Stepa, bashtina **Dudalla?** (Dud(ë)+ suf. demin. –alla) në zotërim të Andrea Gjonit, Stojan Gega, Luka Stepa, Koka Vladeda (Vla+Deda.-I.R.)?, Bashtina **Gjon Bardi** në zotërim të Hasan Papës, bashtina **Arnik** (Arranik), bashtina **Papas** në zotërim të banorëve të fshatit.

Nga inventari i emrave të këtij vendbanimi shihet qartë se vetëm katër banorë kishin emra të trashëguar sllavë nga e kaluara, gjysma e kryefamiljarëve mbanin emra tradicionalë shqiptarë, ndërsa gjysma tjetër e kryefamiljarëve të islamizuar, dalin me emra orientale, të cilët e kishin ruajtur patronimin e të parëve të tyre tradicional shqiptar.

Po ashtu, edhe nga antroponimia e këtij vendbanimi, shihet se kah fundi i shekullit XVI, antroponimia sllave vërtet ishte braktisur nga popullsia shqiptare, në krahasim me dy shekujt e mëparshëm, që mbanin më shumë antroponimi sllave të imponuar nga faktorët politiko-shoqërorë dhe të kishës ortodokse, siç u pa nga krisobulat e manastireve sllave të shekullit XIII-XIV, si edhe të defterëve të parë të shekullit XV, meqë këta defterë ishin hartuar dhe përpiluar, duke u bazuar në shënimet e dokumenteve të administratës kishtarë sllave të atyre shekujve.

Bardofc, emri tjetër Polin Dol

Ky vendbanim del i regjistruar në Defterin e timareve për Sanxhakun e Prizrenit të vitit 1530, në formën **Bardanja**, dhe krahas tij me emrin tjetër sllav **Polindol**.

Mirëpo, pas 61 vjetësh, përsëri e hasim në Defterin e hollësishëm të Sanxhakut të Dukagjinit nga viti 1591, por tani në formën **Bardofc** dhe me emrin tjetër sllav **Poljindol**, që ishte regjistruar në kuadrin e nahijes së Lumës. Por duhet theksuar se në këtë Defter në një vend, ku jepet antroponimia e këtij vendbanimi, përbri toponimit **Bardanja**, është shënuar emri tjetër **Rudofc**, për çka mendojmë se është gabim i përpiluesit të këtij defteri, sepse, gabimisht e ka regjistruar në nahijen e Rudinës, në vend se ta regjistrojë në nahijen e Lumës, që në atë kohë administrativisht i takonte asaj dhe sot e kësaj dite ekziston me formën shqipe si **Bardhoc**.

Këtë vendbanim nuk e hasim në defterët e shekullit XV, por nuk do të thotë se ai nuk ekzistonte edhe më herët. Me rastin e regjistrimeve të shek. XV është lënë jashtë, meqë nuk ishte përfshirë në sistemin e timarit, apo të haseve perandorake. Siç shihet, edhe këtij vendbanimi nga administrata sllave i ishte ndërruar emri, por meqë nuk kishte popullsi sllave në të, emri i ri i imponuar nuk pati jetë të gjatë dhe ai mbeti vetëm si gjurmë në burimet shkrimore, ndërsa emri i lashtë i emërtuar nga popullsia autoktone vazhdoi

të gjallojë deri në vitin 1881, kur e hasim në rajonin e nahijes së Lumës, në hartat topografike austriake me formën **Bardofci**, por jo edhe trajtën sllave **Polindol**.

Për të pasur një pasqyrë të antroponomisë së këtij vendbanimi, po sjellim emrat e kryefamiljarëve të tij nga viti 1591: Ali **Kola**, Hysejin **Tita**, Mehmet **Nika**, Mehmet **Doda**, Xhafer **Doda**, Jusuf **Peja**, Mustafa **Nina**, Hasan **Bardi**, Ali **Doçi**, Hasan **Tana**, Hysein **Hasani**, Mustafa **Dida**, Ali **Doçi**, Husein **Dida**, Ahmet **Nina**, Sinan **Kola**, **Iljas** i varfër, Ali **Doçi** tjetër, Ferhat **Peca**, Mustafa **Geci**, Pervan **Geci**, Sulejman **Kola**, Muastafa **Peca**, Ali **Peca**, Memi **Doçi**, Doda **Gega**, Koka **Gega**, Peja **Doda**, Peja **Doda** tjetër, Gjura **Ila**, Dida **Peja**, Peja **Biba**, Peja **Laja**, Laja **Peja** – tjetër, Doda **Gjoni**, Nina **Dida**, Doda **Dida**, Dida **Laja**, Prent **Ilja**, çiftliku i **Ali Abdullahut**, bashtina **Andreja Kola**, në zotërim të Laja **Peja**-s.

Shumica e emrave të këtyre kryefamiljarëve, qofshin të krishterë ose islamë, i kanë mbajtur banorët shqiptarë të këtij vendbanimi, meqë kanë përfunduar me nyjën e shquar **-a** të shqipes. Edhe kryefamiljarët e këtij vendbanimi me emra të huaj, siç është emri romak **Tita** nga **Titus**, si edhe emri **Peja** dhe ai **Nina** me etimologji të errët, që po ashtu përfundojnë me nyjën e shquar **-a** të shqipes, bartësit e tyre janë kryefamiljarë të përkatësisë shqiptare.

Mjekërbard, emri tjetër sllav Duga Shuma

Ky vendbanim del po ashtu në dy defterët e Sanxhakut të Dukagjinit, në nahijen e Rudinës nga viti 1571 dhe 1591, si një kompozit i shq. **Mjekër+bardhë**. Toponimi në fjalë ishte kalkuar nga administrata mesjetare kishtare sllave me formën sintagmatike të serbishtes **Duga Shuma** (flokë-gjatë).

Është me interes të theksohet se ky vendbanim më vonë, sipas Sallnames të Vilajetit të Kosovës, për shkak të intransparencës së tij nga administrata osmane ishte përkthyer me kompozitën e gjuhës **turke Ak Sakall – Mjekërbardh**. Njëherësh e kemi edhe toponimin **Bellobrad** në Opojë, që mendojmë se kemi të bëjmë me një kalk që administrata e atëhershme sllave paraosmane e përshtati nga fjala shqipe **Mjekërbardhë** me atë në serbishte **Belobrad**.

Në vetë dëfterët është shënuar se vendbanimi gjendej në një vend malor jopjellor dhe pa vende të përshtatshme për mbjellje. Ky vendbanim është fshati i sotëm **Mjekërbardh** në veri të maleve të Shqipërisë, në afërsi me Kosovën, që në vitin 1571 kishte 17 shtëpi.

Për të krahasuar antroponominë e këtij vendbanimi me defterin e mëvonshëm të vitit 1591, po sjellim së pari emrat e kryefamiljarëve të vitit 1571, siç ishin: Gac Nisha, Vata Lika, Luca Biba, Biba Doçi, Vata Doçi, Puta Andrea, Bac Lala, Deda Nisha, Gac Baci, Andre Baca, Vata Nina, Puta Gika, Duka Deja, Gec Vata, Papa Kola, Kola Nisha, Luc Vata.

Ky vendbanim, në vitin 1591, ishte dyfishuar, dhe antroponimia e kryefamiljarëve të këtij vendbanimi kishte ndryshuar, meqë, pas 20 viteve, disa kryefamiljarë të krishterë kishin marrë emra tipikë të onomastikonit islam dhe, për ta mbajtur parasysh këtë ndryshim onomastik, po i japim emrat e tyre: Mehmet Vata, Rexhep Baci, Hysejn Lika, Mustafa Lika, Dan Abdullah, Danko Spana, Iskender Koka, çifliku i Shadi Xhaferit, Omer Duka, Hasan Lika, Luca Biba, Mana Luca, Biba Doçi, Gjon Biba, Gac Bici, Biba Gaci, Puta Andrea, Lika Bici, Hysejn Lika, Biba Lika, Doda Nina, Biba Tana, Biba Marki, Gac Andrea, Valça Puta, Kola Noci, Tana Andrea, Tita Gaci, Vata Baci-Taçi, Gjon Dakina.

Palabardi, emri tjetër – Belopavliq

Ky vendbanim si toponim bitematik, për herë të parë del në defterët kadastralë osmanë të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 dhe të atij të vitit 1497, që është regjistruar në kazanë e Pejës me trajtën e kalkuar sllave – **Belopavliq**, marrë nga forma më e vjetër e shqipes – **Palabardi**. Administrata osmane, trajtat e kalkuara sllave, si zakonisht, në regjistrimet e para të vendbanimeve të shekullit XV, që i bëri, i kishte marrë nga administrata dhe kisha sllave.

Në vitin 1485 dhe 1497 ky vendbanim kishte vetëm 5 shtëpi dhe 1 beqar, e këta ishin: Pavli (Pali), i biri i Gjorgjit (Gjergjit), Gjura, i vëllai i tij; Gjura, i biri i **Nikelit**; Dimitri, i ardhur (prishliq); Dabzhivi, i ardhur (prishliq) dhe **Leka** i ardhur (prishliq). Natyrisht se këto të dhëna antroponimike të këtyre kryefamiljarëve janë marrë nga administrata mesjetare serbe, meqë këta të fundit cilësohen si ardhacakë në këtë vendbanim dhe, më vonë, ky apelativ

serb, me kohë, u shndërrua në patronimin e familjeve serbe *Doshliq*. Po të kishin ardhur pas vendosjes së administratës osmane, këta do të cilësoheshin dhe shënoheshin në defter, me fjalën osmane-turke “*muhaxhir*” (*muhacir*). *Edhe forma e emrave si Gjura, Leka, Dimitri e Nikeli* na duken më afër natyrës së shqipes sesa sllavishtes, meqë në këtë shekull emrat e krishterë të formave sllave i hasim zakonisht, si: *Gjurin, Gjurko, Gjuriqin, Gjurishiq, Dimitar, Dimitrije, Lekashin, Lekoviç*.

Pas 100 vjetësh, në vitin 1582 ky vendbanim ishte regjistruar po ashtu me trajtën e trashëguar nga koha e administratës mesjetare serbe, *Bellopavliq*, por tash vetëm si truall (mezra) pa banorë, me tri bashtina, që punohej nga jashtë: bashtina e *Paul (Pal) Lika-s*, bashtina e *Donuko-s* (kompozitë nga *Don + Uka*) dhe bashtina e *Dabo-s*. Në bazë të emrave të ish-poseduesve të mëhershëm të bashtinave dy prej kryefamiljarëve mund të pohojmë se janë me prejardhje etnike shqiptare. Siç duket, ky vendbanim qe i braktisur deri në shek. XVII-XVIII, kur del si mikrotoponim në një dokument osman si *Palabardhi*, por i ribanuar sërish në shek XIX po ashtu me trajtën *Palabardi*.

Pra, më nuk shfaqet trajta e kalkuar sllave *Belopavliq*. Edhe në Sallnamen e Vilajetit të Kosovës, ky toponim është shënuar me formën *Palabard* (pa dubletin e saj *Belopavliq*) në kazanë e Jakovës (Gjakovës). Ky fakt më shtyri të mendoj se ky vendbanim mund të identifikohet vetëm me *Palabardhin* e mëhershëm, të cilit administrata mesjetare sllave i kishte dhënë formë sllave - *Belopavliq*.

Edhe nahija *Belopavliq* në Mal të Zi, tani fshat, sipas Shpiro Kulishiqit, është kalk nga *Palabardhi* i shqipes.

Lumbarz-i i Deçanit

Ky vendbanim, emrin e ka marrë sipas lumit me të njëjtin emër, të cilin administrata sllave e quan *Bistrica*. Nuk del i shënuar në burimet e hershme mesjetare, meqë ka mbetur jashtë regjistrimeve të timareve të sistemit osman, gjatë shekujve XV-XVI. Nuk ka dyshim se toponimi është mjaft i vjetër, të cilin për të parën herë e kam gjetur të shënuar në një dokument gjyqësor të provinencës osmane-turke nga shek. XVII, origjinali i të cilit ruhet te orientalisti Jusuf Lataj nga i njëjti fshat, dokument ky që u zhduk

nga lufta e fundit në Kosovë (1998-1999), por fotokopja ruhet në Fondin « Varia » në Arkivin Kombëtar të Kosovës Prishtinë dhe një kopje në bibliotekën personale të autorit (Iljaz Rexha).

Ky toponim bitematik dygjymtyrësh, në këtë dokument ishte shënuar me formën turke **Lumbarz**, i sajuar nga trajta e mirëfilltë e shqipes **Lumbar-dhi**.

Toponime të ngjashme të shënuara me formën **barz**, gjatë shek. XV-XVI, hasen në regjistra osmanë edhe në Mal të Zi.

Edhe në Sallnamen e Vilajetit të *Kosovës të shek. XIX, është shënuar me formën e njëjtë turke Lumbarz*, kurse trajta serbe del me formën *Ljumbarda*.

Në defterët e shek. XVI, përmendet vendbanimi **Sharban-ofc**, që ishte regjistruar edhe me emrin tjetër **O-Bardiq**, dhe i takonte nahijes së Vushtrrisë. Mendojmë se këtu kemi të bëjmë me fshatin e sotëm **Sharban** afër **Rimanishtes**, komuna e Prishtinës.

Se cili toponim ishte më i vjetër nuk kemi të dhëna, por, ndoshta, emri i dytë i këtij vendbanimi me prefiksin **o** me bazën **-bard** dhe me prapashtesën sllave **-iq**, supozojmë se është trajta më e hershme.

Barlova e Kurshumlisë

Ky vendbanim del i regjistruar në defterët e timareve të Sanxhakut të Krushefit të shek. XVI, me format e shtrembëruara **Borlofc** në vend të **Barlofc**, i sajuar nga fjala e protoshqipes **bard** e shtrembëruar në **barl**, me prapashtesën sllave **-ofc** si **barl+ofc > Barlofc**.

Ky toponim është i regjistruar edhe në hartat topografike austriake nga vitet 1689-1690 me formën sllave **Barlovo**, e cila gjendet në afërsi të Kurshumlisë. Pasardhësit e muhaxherëve që u dëbuan nga ushtria serbe në vitin 1877-1878 nga ky vendbanim, thonë se stërgjyshërit e tyre këtë vendbanim e kanë quajtur me emrin **Bardhova**.

Edhe në hartat dhe në regjistrat e vonshëm serbë, këtë vendbanim e gjejmë të shënuar me formën sllave **Barlovo**.

Diku ndërmjet Prijepoles dhe Vishegradit, del i shënuar toponimi me formën e shtrembëruar **Badra**, që mendojmë se është ndryshuar me anë të metatezës nga toponimi i shqipes **Barda**.

Barleva – Barlova

Në rrafshin e Kosovës, në defterin e vilajetit Vlk të vitit 1455, del i regjistruar vendbanimi Barileva e Prishtinës me grafinë arabo-osmane _____, që lexohet **Barileva**, e jo **Bariljevo**, siç e kanë transkribuar paleografët osmanë nga Sarajeva. Kjo strukturë monotematike, sipas meje, është sajuar nga baza e fjalës **bar+il+evo>Barilevo**. Fjala **bar** është e etimologjisë së errët, shtesa **il** është relik i gjuhëve romane dhe prapashtesa sllave **-evo**. Cilët faktorë kanë ndikuar të formohet kjo strukturë, mbetet çështje e hapur.

Në vitin 1455, emrat e kryefamiljarëve të këtij vendbanimi ishin të sferës sllavo-krishtere, por në mesin e tyre, i hasim: Radislav i biri i Berjash-it (paleografët e Sarajevës e kanë lexuar gabimisht Prijashin shih librin II të faksimileve të dokumentave origjinale), Radisllav i biri i Gjolasho-s (Gjo(n)Lasho-s). Radivoj i biri i tij dhe Radiha i vëllai i tij; Radica i biri i Dushman-it, Dushman i biri i Prodan-it, Dragush i biri i tij, Luliq (Luli) (bari) govedar. Emrin Dushman, paleografët nga Sarajeva, e kanë konsideruar të sferës së onomastikonit tradicional shqiptar.

Ndërsa, në dy defterë të gjysmës së dytë të shek. XVI, **Barileva**, del e regjistruar dy herë me grafinë arabo-osmane _____, me formën **Barleva**. Kjo strukturë, sipas kësaj forme, është sajuar nga **barl** dhe sufiksi sllav-**eva** – **Barleva**, dhe mënyra tjetër mund të lexohet si **Barlova** mbi bazën **bardh** të shqipes.

Si duket, forma e mëhershme **Barilevo** është e deformuar nga administratat e huaja në mesjetë, meqë regjistrimet e shek. XVI janë bërë në bazë të hulumtimeve të terrenit, ndërsa në shekujt e mëhershëm janë bërë në bazë të dhënave të regjistrave kishtare sllave. Se cila formë është më e drejtë dhe më e saktë, mbetet çështje studimi të mëtejme.

Në këtë vendbanim ishte regjistruar edhe një mikrotoponim si **Bashtina e baktisur**. Kjo bashtinë ishte në anën tjetër të Lumit, dhe në zotërim të **Ahmet Mahmudit**. Në vitin 1556-1577, Vendbanimi kishte 62 kryefamiljarëve, ende kryesisht me antroponomi krishtere-sllave, por edhe disa kryefamiljarë me emra të onomastikonit islam. Përveç këtyre, hasim edhe në kryefamiljarë me emra të krishterë, që në mesjetë i mbanin shqiptarët e besimit të krishterë **Mark Simon-i; Dimjo Pavl-i; Pavli Luk; Mliko Tushati; Stojan Tom-a; etj.**

Në këtë regjistër osman në vitin 1556-1557, në kuadër të fshatit **Barleva**, ishte regjistruar edhe **Mulliri** në zotërim të **Hizri Ibrahimit**, individ që kishte kaluar në fenë islame dhe që ishte i detyruar për çdo vit të jepte nga 150 groshë për shkollimin e fëmijëve në Prishtinë.

Për të hyrë dhe për të dalë nga fshati, pra për të kaluar lumin, në mesjetë, kanë ekzistuar dy-tri ura, që quheshin **Vigus-a** (Trap-lloj ure, për të kaluar vetëm një person).

Në fshatin Zubovc të Gostivarit, ekziston një mikrotoponim dhe vëllezëri me emrin **Barlevci** e ngjashme me trajtën e fshatit **Barilevë** të Prishtinës.

Meqë në defterët osmanë për Bosnjën të shek. XV na del vendbanimi me emrin **Barila** në anën e Shalës së Bajgorës, atëherë toponimi **Barilevski Katund**, që është regjistruar në Krisobulen e mbretit Millutin të vitit 1313-1315, mendoj se ka të bëjë me **Barilen e Shalës së Bajgorës** e jo me vendbanimin **Barilevë** të sotme të Prishtinës, që ishte shumë larg nga Manastiri i Banjskës.

Në regjistrat osmanë të shek. XVI, ishte i regjistruar një vendbanim dygjymtyrësh me emrin **Borli Dol** në rrethinën e Duboçicës. Pjesa e parë e toponimit ishte shënuar nga administrata sllave me formën e shtrembëruar **Borli** në vend të **Barli**, dhe pjesa e dytë e tij me fjalën serbe **dol** nga **dolina**.

Si duket ky toponim ka qenë qysh herët i kalkuar nga administrata sllave nga **Lug Barli (Bardhi)**, në formën e shtrembëruar **Borli Dol>Barli Dol**.

Në hapësirën në mes Nishit dhe Pirotit, në defteret osmanë të shek. XVI, del i regjistruar vendbanimi si toponim me formën e shtrembëruar **Barlofc**, i sajuar nga emri i protoshqipes **Bard**, me formën sllave **barl+ofc>Barlofc**.

Jashtë hapësirës gjeografike të Dardanisë, në Malësinë e Krajës së Ulqinit, në burimet arkivore mesjetare hasen edhe këto toponime me emrin: **Bardoni i Bunës**, **Bardani** me emrin tjetër **Berlat** në anën e Shqipërisë Veriore, **Bardiqi** në nahijen e Kelmendit dhe **Barzani** në nahijen e **Kuçit** në Mal të Zi. Në rrethinë të Sofjes hasim një toponim me emrin **Bardofc**, si edhe një toponim tjetër me emrin **Barlofc** dhe Kështjella Bardona, në rrethinë të Janinës-Greqi.

Përveç toponimeve me bazën **bard**, për herë të parë, në burimet e shkruara osmane, pikërisht në defterin e **Sanxhakut Arvanit**, të vitit 1431, në fshatin Barç, në nahijen e Tomorrit, përmendet kryefamiljari me emrin **Barda**, i biri i Fatmirit (**Barda** veled-i Fatmir), duke theksuar se ishte i biri i

spahiut të krishterë. Pra, është rast i rrallë që në Mesjetë të del emri Fatmir. Patronimi Fatmir, haset edhe në dy raste të tjera në një defter të shek. XV në një fshat të nahijes së Tetovës.

Nga kjo e dhënë e këtij defteri, shihet qartë se emri protoshqiptar **Bard**, në burimet mesjetare del mjet i shpeshtë. Disa antroponime shqiptare, i përballuan ndikimet e onomastikonit romak, bizantin dhe sllav, duke e ruajtur vazhdimësinë e tyre në disa troje gjuhësore shqiptare deri në kohën paraosmane.

Duke krahasuar origjinalin, përkatësisht faksimilin e defterit të krahinës së Vukut nga viti 1455, me përkthimin dhe transkribimin e tij, kemi konstatuar se këtë antroponim, të cilin përgatitësit e këtij defteri nga Sarajeva e kanë lexuar dhe e kanë transkribuar si **Pardo** dhe **Pardos**, ndërsa ne e kemi lexuar dhe transkribuar si *Bardo* dhe *Bardosh* < *Bardh* dhe *Bardhosh*. Natyrisht se ky emër është në funksion të patronimit dhe është shënuar pa shenja diakritike, përveç një rasti ku grafema me këtë shenjë diakritike më tepër na jep të drejtë ta lexojmë fonemën fillestare si **-b** se sa si **-p**, sepse fonema fillestare është shënuar me një shenjë diakritike- pikë (.)

Këtë antroponim e kemi lexuar si **Bard** duke u mbështetur në defteret e tjerë pak më të vonshëm, siç është rasti në defterin e fund shekullit XV, ku e kemi hasur kryefamiljarin Pava, i biri i Bardoviq-it (Bardi), Grashticë-Prishtinë, me grafemën që është dhënë me shenja diakritike, d.m.th. vetëm me një pikë (.), e cila na bën të mundur që fonemën e parë ta lexojmë vetëm si **-b**. Po të ishte shënuar grafema fillestare me tri pika, eventualisht edhe me dy pika, atëherë fonema e parë do të duhej të lexohej vetëm si **p**. Në raste kur nuk shënohen shenjat diakritike, atëherë mund të ketë dilema rreth leximit të këtyre fonemave arabo-osmane. Natyrisht, dilema mund të ketë edhe kur nuk kemi njohuri të mjaftueshme për prejardhjen e emrave të vjetër, që kanë qenë karakteristike në antikë dhe në mesjetë për trevat e caktuara gjuhësore, në të cilat në marrëdhënie reciproke kanë gjalluar dhe janë gërshtuar gjuhë të ndryshme.

Arsyeja tjetër që më shtyri që këtë antroponim ta lexoj si *Bard* është se në defterët më të vonshëm të shekullit XV dhe XVI e kam hasur më shpesh në Sanxhakun e Dukagjinit dhe atë të Prizrenit, e sidomos në defterët për Tetovën, Shkupin dhe Gostivarin, të cilin përgatitësit e defterëve për Maqedoni, Sokolovski dhe Stojanovski, këtë emër e kanë lexuar si **Bard**, **Bardo**. Po ashtu edhe Selami Pulaha këtë emër gjithnjë e lexon **Bard** dhe **Bardo**.

Ky emër ishte karakteristik dhe më i dendur në Rrafshin e Dukagjinit dhe në trevat perëndimore të Maqedonisë së sotme, ndërsa në pjesën veriore dhe lindore të Kosovës kishte mbetur si gjurmë në burimet shkrimore, çka do të thotë se, në të kaluarën kishte ekzistuar edhe në këto troje, siç është rasti me kryefamiljarin **Bardo** që përmendet në Medvegjë.

Të dhënat onomastike, të cilat i kemi hulumtuar në defterët e shek. XV, me bazën **bard**, po i japim në vazhdim: Peja i biri i Barda-s, Mahalla e Pop Prodan-it (Prodanus) në Novobërdë ; Pava i biri i Bardoviq-it (Bardi), Grashticë-Prishtinë ; Radic Barla (Bardhi), Domajofç-Novabërdë ; Stepan, i biri i Bardo-s, Vushtri ; Radisav, i biri Bardokçan-it, Vushtri ; Bardyl (Bardul), i biri i Radiq-ës, Tugjevc-Vushtri ; Bardo, i biri i Oliver-it, Novosellë-Prishtinë ; Bogdan i biri i Bardosa (Bardosha), Gjilan-Moravë ; Bardo, i biri i Ostaja-s, Klinë e Epërme-Vushtri ; Bogdan i biri i Barl-it ; Barli, i biri i Kodin-it, Çirez-Llap ; Gjon- i biri i Bardo-s, Dimitr-i i biri i Bardo-s, Pepa, i biri i Bardo-s dhe Bardo, i biri i Bardo-s (Bardoshit)-Junik-Pejë ; Bogdan-i, i biri Bardo-s ; Teodor-i, i biri i Bardo-s, Siqevc-Pejë; Bardo, i biri Prepjaç-it, Çermë-Pejë ; Bardo, i biri i Prebil-it, Nivokaz-Altën Ilija ; Bardo, i biri i Gjin-it, Nikolla i vëllai i tij, Gjon-i, i biri i Bardo-s, Bozhani ; Dimitr-i, i biri i Bardo-s, Kamenicë-Pejë ; Bardo, i biri i Gjon-it, Dobrosh i Madh-Pejë ; Lazar-i, i biri i Bardo-s, Shishman-Gjakovë ; Barbarn-i, i biri i Bardo-s, Popovci-Gjakovë ; Bardo, i biri i Dabzhiv-it, Ponoshec-Gjakovë ; Meshko, i biri i Bardo-s, Stublla-Pejë ; Nikolla i biri i Bardo-s, Rogan-Pejë ; Bardo, i vëllai i Ilijes, banor i fshatit Uça-Pejë ; Gjin-i, i biri i Bardo-s, Bardo i biri i Stepan-it-Lipovc ; Mioman-i, i biri i Bardo-s, Lipovc-Pjë ; Bard-i, i biri i Nik-ës-Brelonicë-Pejë ; Bardo, i biri i Vukç-es, Kosh-Pejë ; Dobrashin-i, i biri i Bardo-s, Nemiloviq-Pejë; Brajica, i biri i Bardo-s, Përçevë-Pejë.

Në fund duhet theksuar se patronimi **Bard**, edhe pas islamizimit të bano-rëve në trojet shqiptare, e ruajti edhe mëtej vazhdimësinë e vet si mbiemër i protoshqipes, i regjistruar në defterët osmanë. Në mungesë të sistemit fonetik të tingullit **-dh**, kjo shkronjë është reprodukuar me tingullin **-d** dhe **-l** z, si p.sh. **Hysen Barda** dhe **Hasan Barda** në Prizren, **Ali Barda** dhe **Jusuf Barla** në rrethinë të Vushtrisë.

Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë

SEMINARI XLI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE
KULTURËN SHQIPTARE
Prishtinë, 14 – 25 gusht, 2023